VENDIME

TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

2025

VENDIMET PËRFUNDIMTARE
TË GJYKATËS KUSHTETUESE 2025

I

Volumi I

VENDIME
TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
2025

Vendime 1-26

Volumi I

© Botim i Gjykatës Kushtetuese
Tiranë, 2026

ISBN 9789928861580 (Set)
ISBN 9789928861597 (v. 1)

PRINTED AND BOUND IN ALBANIA BY ONUFRI

Rr. “Konferenca e Pezës”, Nr. 71, Kodi Postar 1027, Tiranë;
Tel & Fax 00355 42 220 017 / 270 399
www.onufri.com; E-mail: info@onufri.com

Përmbajtja

Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 (V-1/25) 7
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 (V-2/25) 62
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 (V-3/25) 85
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 (V-4/25) 113
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 (V-5/25) 123
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 (V-6/25) 145
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 (V-7/25) 170
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 (V-8/25) 184
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 (V-9/25) 255
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 (V-10/25) 272
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 (V-11/25) 286
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 (V-12/25) 304
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 (V-13/25) 332
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 (V-14/25) 348
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 (V-15/25) 372
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 (V-16/25) 381
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 (V-17/25) 390
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 (V-18/25) 408
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 (V-19/25) 425
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 (V-20/25) 436
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 (V-21/25) 465
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 (V-22/25) 497
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 (V-23/25) 518
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 (V-24/25) 530
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 (V-25/25) 548
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 (V-26/25) 577

Indeks i vendimeve të vitit 2025 623

Vendim nr. 1, datë 17.01.2025
(V-1/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 17 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SALI BERISHA,** përfaqësuar nga avokatët Klodiana Gjyzari dhe Genc Gjokutaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurori Arben Kraja.
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Legjislativ, Merita Qato.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 520, datë 30.12.2023 dhe nr. 521, datë 27.12.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 15 (87-2024-23), datë 25.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-667 (94), datë 09.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 27, 29, 42, 46, pika 1, 70, pika 1, 73, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së**

Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, pika 1, shkronjat "b" dhe "c", 6, 7, 8, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 9, 14, 15, 25 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 08.08.1991 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike"; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Sali Berisha (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, u njoh me aktet e paraqitura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), i cili nuk ka mbajtur qëndrim për çështjen, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është aktualisht një politikan, drejtues i partisë kryesore opozitare dhe deputet i Kuvendit, si dhe ish-president dhe ish-kryeministër. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, Prokuroria e Posaçme në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (*KP*). Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-

klubit sportiv "Partizani"), procesin e ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe të zhvillimit të pronës.

2. Me urdhrin e datës 02.10.2023 prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim me shtetasit J.M. dhe F.B., të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Për sa i përket kërkuesit, faktet penale objekt hetimi lidhen me sjelljen e dyshuar të tij gjatë kohës kur ai ka ushtruar funksionin e Kryeministrit, pas vitit 2005, në proceset e kthimit të pronës, të privatizimit të pronës shtetërore (objekteve të klubit sportiv "Partizani" në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Klubit Shumësportesh Partizani në varësi të Ministrisë së Kulturës), të ndryshimit të destinacionit dhe të zhvillimit të pronës, duke favorizuar shtetasit J.M., F.B. e XH.B., ku këta të fundit dhe shoqëria e lidhur me ta kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh. Për këto procese dyshohet se janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*.

3. Në datën 16.10.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin, për të cilin është kërkuar vendosja e masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas Prokurorisë së Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se nga ana e kërkuesit, në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër, janë kryer veprime konkrete dhe aktive në drejtim të: përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve dhe të projektvendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vet politikë, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku përfitues i drejtpërdrejtë ishte edhe shtetasi J.M., bashkëshorti i vajzës së tij; kryerjes së kontrolleve administrative, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin procesin e privatizimit të klubeve sportive në favor edhe të shtetasit J.M.; vendosjes në dispozicion të shtetasit J.M. të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin

e procesit të kthimit të pronës, privatizimit të pronës shtetërore dhe ndryshimit të destinacionit të pronës edhe në favorin e këtij shtetasi. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, përfitimi i parregullt në favor të shtetasit J.M. lidhet me dyshimin se të gjitha këto procedura, pavarësisht interesit publik në lidhje me nevojën për ambiente sportive, janë bërë me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë pronën dhe për ta përdorur atë për përfitime materiale, ku si të tilla janë konsideruar të gjitha ato përfitime monetare që ky shtetas ka marrë përmes shoqërisë ndërtuese, konkretisht nga shpërndarja e fitimeve të saj të akumuluara ndër vite përpara se ai të deklarohej bashkortak i saj, të llogaritura në shumën 672,976,832 lekë ose 5,420,345 euro.

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 (*vendimi nr. 112/2023*), ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar për kërkuesin masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të KPP-së. Me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 (*vendimi nr. 117/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka disponuar me vazhdimin e këtyre masave. Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 05.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

5. Ndërkohë, një prej detyrimeve të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së të Shkallës së Parë, të konfirmuar me vendimin nr. 117/2023 të kësaj të fundit, konkretisht "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", nuk është përmbushur prej tij (kërkuesit). Në këtë rast, referuar procesverbaleve të datave 06.11.2023, 20.11.2023, 04.12.2023 dhe 18.12.2023, të mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për paraqitjen e kërkuesit, rezulton se ky i fundit nuk është paraqitur në asnjë nga këto data. Për këtë arsye, Prokuroria e Posaçme, me argumentin se nga ana e kërkuesit nuk janë zbatuar këto vendime, për shkak se ai nuk ka ekzekutuar detyrimet e vendosura për të, konkretisht të paraqitej në Policinë Gjyqësore, me kërkesën nr. 16688 prot., datë 12.12.2023 dhe relacionin bashkëlidhur saj, bazuar në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, i ka kërkuar Kuvendit dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit për zëvendësimin e masave të sigurimit personal nga "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"

dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", në atë të "Arrestit në burg/shtëpi", të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të KPP-së.

6. Për këtë arsye, në datën 18.12.2023 është zhvilluar mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (*Këshilli*), në të cilën kanë qenë të pranishëm dhe kanë shprehur qëndrimet e tyre, përveç deputetëve anëtarë të Këshillit, edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësit e kërkuesit. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, Këshilli ka vendosur t'i rekomandojë seancës plenare pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit.

7. Po ashtu, Kuvendi, i mbledhur në seancë plenare në datën 21.12.2023, me vendimin nr. 127, datë 21.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Në datën 22.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë (gjyqtarit të hetimeve paraprake) kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, e cila është pranuar me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të asaj gjykate (*vendimi nr. 520/2023*), duke u caktuar ndaj kërkuesit masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" dhe duke u urdhëruar kërkuesi të mos largohet nga banesa e tij, si edhe të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të.

8. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet që vijnë si rezultat i zbatimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të po asaj gjykate, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore. Sipas asaj gjykate, ekziston "dyshimi i arsyeshëm", i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore/hetuesit dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në rastin konkret nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, jemi para kushteve kur duhet të zëvendësohen masat e sigurimit të dhëna ndaj

tij me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë shtetasi nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe të funksionit të tij aktual si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë ende rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, të shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" me masën "Arresti në shtëpi".

9. Mbi ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.01.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 520/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për kontrollin e ligjshmërisë së autorizimit të dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë janë të pabazuara, pasi dalin jashtë juridiksionit gjyqësor dhe posaçërisht atij penal, respektimi i të cilit është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykimit, për shkak se gjykatat në këtë rast verifikojnë vetëm nëse ky autorizim i kërkuar është dhënë. Bazuar në përcaktimet e nenit 231 të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar, njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë, se kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij. Edhe GJKKO-ja e Apelit, njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ka konsideruar se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit, ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të kërkuesit në kufizim të lirisë së tij të komunikimit dhe së drejtës së shprehjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në respektim të kufijve diskrecionalë të caktuar nga pika 2 e nenit 237 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka përzgjedhur një kufizim që është proporcional dhe i motivuar nga interesi publik që prevalon mbi interesin personal

të individit. Në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit, GJKKO-ja e Apelit lidhur me kërkesën/pretendimin e kërkuesit për cenimin e pavarësisë dhe paanësisë nga gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë, dhe të rrëzuar nga një gjyqtare tjetër e së njëjtës gjykatë, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, e ka vlerësuar si të bazuar rrëzimin e asaj kërkese. Sipas GJKKO-së së Apelit të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuesit në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit e gjithë procedura e ndjekur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për caktimin e gjyqtares që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares nga shqyrtimi i çështjes, është në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe kërkesat ligjore të dispozitave të neneve 18 dhe 19 të KPP-së. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-667 (94), datë 09.04.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 15 (87-2024-23), datë 25.01.2024 të GJKKO-së së Apelit. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancitë e lidhura me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre. Lidhur me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ai kolegj ka vlerësuar se janë të pambështetura në ligj e prova, pasi, në thelb, mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes nga gjyqtari, si edhe drejtimi dhe menaxhimi i procesit gjyqësor (nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve) konform tagrave që i njeh ligji. Në lidhje me themelin e çështjes, Kolegji Penal ka vlerësuar se të gjitha pretendimet që lidhen me ligjshmërinë e autorizimit të dhënë nga Kuvendi janë të pabazuara. Në rastin kur procedohet ndaj një deputeti të Kuvendit, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykata verifikon sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së, vetëm nëse autorizimi i kërkuar është dhënë ndërsa dhënia apo jo e autorizimit është në diskrecion të Kuvendit dhe ky kontroll i ligjshmërisë së dhënies së autorizimit nga Kuvendi dhe më tej marrja dhe lejimi i provave lidhur me një pretendim të tillë dalin jashtë juridiksionit gjyqësor, kjo për arsye se kompetenca për heqjen e imunitetit në çështjet penale është e vetë parlamentit (neni 73 i Kushtetutës).

11. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e tjera të kërkuesit kanë marrë përgjigje të argumentuara nga gjykatat më të ulëta. Sipas tij, pjesa e pretendimeve që lidhet me vlerësimin e rrethanave të faktit del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, por, megjithatë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit, duke evidentuar "shmangien e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikjen e kërkuesit" (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë veç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi.

12. Procesi gjyqësor në të cilin janë vendosur masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin e saj nr. 81, datë 21.11.2024, (*vendimi nr. 81/2024*), ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës, duke shfuqizuar

këto vendime gjyqësore vetëm për pjesën që kanë caktuar masën "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", për shkak të cenimit të parimit të proporcionalitetit, në aspektin e domosdoshmërisë së kësaj mase, në kushtet kur qëllimet e saj përmbushen nga masa tjetër e dhënë ndaj kërkuesit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

13. Ndërkohë, në datën 18.11.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë zëvendësuar masat e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" me masën "Arresti në shtëpi". Ky ankim kushtetues është regjistruar në datën 18.11.2024.

14. Në datën 26.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Gjithashtu, rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 674, datë 27.11.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit dhe revokimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në shtëpi", për shkak se nuk ekzistojnë më nevojat e sigurimit. Në vijim, për ankimin e Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Apelit, në datën 03.01.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit të lartpërmendur të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në shtëpi" me masën e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

16. Në datën 25.11.2024 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë një kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, e cila u pranua nga Gjykata.

17. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 03.12.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes, e cila është plotësuar me argumente shtesë në datën 13.01.2025. Po ashtu, i njëjti gjyqtar, në datën 10.01.2025 ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet nr. 30, datë 14.01.2025 dhe nr. 1, datë 14.01.2025, me shumicë votash, ka vendosur rrëzimin e kërkesave.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka cenuar:

18.1. *Procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit,* të parashikuar

nga neni 73 i Kushtetutës, për shkak se procedura e ndjekur në Kuvend për dhënien e autorizimit është bërë në kundërshtim me këtë dispozitë, pasi nuk është ndjekur procedura e parashikuar nga Kushtetuta për kufizimin e lirisë së deputetit në caktimin e masës së sigurimit që pretendohet se nuk është zbatuar nga kërkuesi. Masa e sigurimit ndaj kërkuesit është dhënë bazuar në informacione të pasakta dhe në mungesë të informacionit për ekzistencën e faktit penal, si edhe për veprimtari që mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit, i parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës. Kërkuesi ka kundërshtuar procedurën e shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit në Kuvend, por gjykatat nuk i kanë shqyrtuar pretendimet e tij me arsyetimin se nuk mund të përbëjnë objekt vlerësimi gjyqësor. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për dhënien e masës së arrestit në shtëpi. Ishte detyrë e gjykatave të verifikonin nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e masave të sigurimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Ndërkohë, sipas kërkuesit, procedura për dhënien e autorizimit duhet të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor. Procedura e ndjekur nga Kuvendi është në shkelje të neneve 288 dhe 289 të KPP-së, pasi Kuvendi nuk ka verifikuar ekzistencën e faktit penal. Autorizimi për heqjen e lirisë së kërkuesit është dhënë bazuar në informacione të paplota, gjysmë të vërteta, në lidhje me detyrimet e masës së sigurimit që është pretenduar se nuk është përmbushur. Procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë e paragjykuar politikisht, nisur nga deklarimet në Këshillin për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin të deputetëve B.Ç., L.N., E.F. dhe E.A. Po ashtu, në këtë procedurë nuk janë shqyrtuar të gjitha provat, pasi ato nuk janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, por është bërë vetëm duke shqyrtuar vendimet gjyqësore që kishin caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e Policisë Gjyqësore. Pra, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij dhe nuk është verifikuar nga Kuvendi ekzistenca e këtij fakti penal.

18.2. Parimet e *paanshmërisë dhe pavarësisë,* pasi sipas neneve 42 dhe 48-51 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe

krimin e organizuar" (*ligji nr. 95/2016*), gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë nën vëzhgimin e një oficeri hetues. Ky vëzhgim mbulon të gjitha komunikimet elektronike dhe të tjera të gjyqtarëve, përfshirë edhe ato të familjarëve të tyre, dhe është i pakufizuar në kohë e hapësirë, si edhe nuk miratohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje. Në këtë kuptim, gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë objekt i një monitorimi që nuk paraqet asnjë garanci ligjore dhe institucionale. Një vëzhgim i tillë i vazhdueshëm ngre dyshime serioze për pavarësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Nuk është e mundur që një gjyqtar që gjendet nën një vëzhgim të tillë nga një hetues anonim, sipas nenit 42 të ligjit nr. 95/2016, të jetë një autoritet gjyqësor që plotëson kushtet e pavarësisë. Për më tepër, hetuesi i komunikimeve është pjesë e Byrosë Kombëtarë të Hetimit (*BKH*), e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuesit dhe i mbron ato përpara gjykatave. Ky ligj cenon procesin e rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, sepse nuk garanton pavarësinë e gjyqtarëve. Gjithashtu, është cenuar edhe parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë I.GJ., që ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është shkarkuar nga detyra e gjyqtares nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (*ish-KLD*) në vitin 1996, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi në cilësinë e Presidentit të Republikës. Kjo kërkesë është paraqitur edhe në GJKKO-në e Shkallës së Parë, ku gjyqtarja për të cilën është paraqitur kërkesa për përjashtim ka caktuar edhe gjyqtaren tjetër që do të shqyrtonte këtë kërkesë për përjashtim, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm. Si përfundim, kërkesa për përjashtim nuk është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023.

18.3. *Të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë dhe shteruese pretendimeve të ngritura. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për pretendimin e tij për mbikëqyrjen e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme nga Prokuroria e Posaçme. Arsyetimi i

gjykatave në lidhje me procedurat për përjashtimin e gjyqtares është telegrafik. GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar përse ka refuzuar marrjen e provave të kërkuesit. Arsyetimi arbitrar i GJKKO-së së Apelit nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila nuk është shprehur as për cenimin e parimit të pavarësisë për shkak të dispozitave të ligjit nr. 95/2016. Gjykatat nuk kanë arsyetuar pretendimin e kërkuesit në lidhje me mosekzistencën e kushtit procedural "Shkelja e detyrimeve që lidhen me një masë tjetër sigurimi", të parashikuar nga neni 231 i KPP-së, duke qenë se vendimet me të cilat janë caktuar masat e sigurimit nuk i janë njoftuar atij.

18.4. Kërkuesi ka ngritur pretendime edhe në drejtim të *së drejtës për mbrojtje efektive, të lidhur me parimin e barazisë së armëve,* duke argumentuar se GJKKO-ja e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim vendimin e saj nr. 23, datë 05.01.2024 (vendimi për papranueshmërinë e kërkesës për përjashtim), të kërkuar prej tij. GJKKO-ja e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim në vendimin e saj të ndërmjetëm për mosmarrjen e kësaj prove. Kjo provë ishte e rëndësishme, pasi provonte që kërkesa për përjashtimin e gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë me një vendim të formës së prerë, është konsideruar e paraqitur brenda afatit dhe nuk është shqyrtuar për shkak se gjyqtarja për të cilën kërkohej përjashtimi kishte shpallur vendimin përfundimtar.

18.5. *Parimin e sigurisë juridike,* për shkak të mungesës së qartësisë dhe qëndrueshmërisë në interpretimin e dispozitave procedurale penale në zbatimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Nga interpretimi i neneve 246 dhe 417 të KPP-së, rezulton se vendimet të cilat kufizojnë lirinë personale të individit nuk janë menjëherë të ekzekutueshme, por ekzekutimi i tyre pezullohet nga ankimi. Për shkak të paqartësisë në lidhje me momentin e lindjes së detyrimit për zbatimin e masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që është pretenduar se nuk janë zbatuar nga kërkuesi dhe që më tej janë bërë shkak për kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, si edhe nga zbatimi dhe interpretimi i ndryshëm i kufizimit të së drejtës personale të kërkuesit nga autoritetet shtetërore, cenimi i lirisë së kërkuesit me vendimet objekt të këtij ankimi kushtetues, nuk e plotëson kushtin

e procedurave të parashikuara në ligj, në aspektin e qartësisë së këtyre procedurave.

18.6. *Lirinë personale,* për shkak se nuk është respektuar procedura e parashikuar në ligj në lidhje me mosekzistencën e shkakut procedural për të cilin është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit, pasi vendimi gjyqësor mbi bazën e të cilit ishin caktuar masat e sigurimit personal nuk ka qenë i ekzekutueshëm deri në datën 21.11.2023 kur ka marrë formë të prerë. Shkaku për të cilin është zëvendësuar masa e sigurimit nuk ka ekzistuar, pasi nuk janë respektuar dispozitat që rregullojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Edhe pse masat e sigurimit për kërkuesin janë dhënë nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe gjykatat kanë pranuar argumentet e Prokurorisë së Posaçme se ai nuk është paraqitur në Policinë Gjyqësore, ato (gjykatat) nuk kanë hetuar kur ka lindur detyrimi i kërkuesit për t'i zbatuar ato masa sigurimi të caktuara me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Arsyetimi i gjykatave se detyrimi për zbatimin e masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit"* ka lindur menjëherë me shpalljen e vendimit, është i gabuar dhe në kundërshtim me nenin 417 të KPP-së. Pra, zbatimi i masave të sigurimit personal "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit"* ka qenë arbitrar, pasi detyrimi për zbatim për kërkuesin lindte pasi të shqyrtohej ankimi nga GJKKO-ja e Apelit. Pas marrjes formë të prerë të vendimit nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, Prokuroria e Posaçme nuk ka nxjerrë urdhër, për pasojë vendimi nuk është vënë asnjëherë në ekzekutim dhe për kërkuesin nuk ka lindur asnjë detyrim. Procedura e caktimit të masave të sigurimit të vendosura ndaj kërkuesit ka qenë e paligjshme, për rrjedhojë edhe zëvendësimi i masës për shkak të moszbatimit të njërës prej masave të sigurimit të vendosura me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë është e paligjshme.

18.7. *Parimin e proporcionalitetit,* duke i kufizuar edhe të drejta të tjera të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë liria personale, e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit, e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar, për shkak se kufizimi i tyre është bërë pa ligj. Këto kufizime nuk janë të nevojshme, pasi

fakti penal i dyshuar, për të cilin është duke u kryer hetimi, nuk ka lidhje me ushtrimin nga kërkuesi të të drejtave që janë kufizuar nga gjykatat. Kufizimi nuk është proporcional. Gjykatat nuk kanë arsyetuar përse nevojat e sigurimit nuk garantoheshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë "Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar" dhe "Garancia pasurore". Gjykatat nuk mund të përcaktojnë kufizime tej atyre të përcaktuara nga ligji. Ato i kanë kufizuar kërkuesit të drejtat politike dhe të lirisë së shprehjes, pavarësisht se në ushtrim të tyre nuk ka kryer ndonjë fakt të pretenduar penal dhe nuk është duke u hetuar për ndonjë fakt penal që ka lidhje me këto të drejta dhe liri. Në vendimet e ankimuara mungon tërësisht arsyetimi. Masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal. Fakti për të cilin është regjistruar procedimi penal nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi është veprimtari politike që rrjedh nga funksioni i deputetit.

18.8. *Parimin e mosdiskriminimit,* për shkak se kërkuesi është kryetari i partisë opozitare me numrin më të lartë të deputetëve në Kuvend. Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin.

19. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

19.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimeve të *pavarësisë dhe paanshmërisë*, për shkak të përcaktimeve të neneve 49-51 të ligjit nr. 95/2016, është i pabazuar, pasi ky i fundit parashikon një mjet mbikëqyrës për GJKKO-të, Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, si një masë parandaluese kundër korrupsionit në këto institucione, por pa cenuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të hetuesve. Sistemi i kontrollit i parashikuar në ato dispozita është i garantuar nga një procedurë strikte. Ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohet të dëgjojë telefonatat që shkelin të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Parashikimet e dispozitave të kundërshtuara nga kërkuesi janë parashikuar shprehimisht në nenin 135, pika 4, të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vendoset para faktit që duhet të shqyrtojë vetë dispozitën kushtetuese, ndërkohë që sipas

nenit 131, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

19.2. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës *së mbrojtjes efektive* është i pabazuar, pasi ai gjatë gjithë kohës që ka qenë në masën e sigurimit "Arresti në shtëpi" ka komunikuar vazhdimisht me mbrojtësit e tij. Kjo konfirmohet edhe nga ankimet e bëra prej tij ndaj vendimit të caktimit të masës së sigurimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe ankimin në këtë Gjykatë.

19.3. Pretendimi për antikushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi për *heqjen e imunitetit* është i pabazuar. Në lidhje me këtë pretendim edhe gjykatat e kanë dhënë përgjigjen e tyre në vendimet që kanë shqyrtuar ankimet e kërkuesit kundër vendimit që ka vendosur masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", ku thelbi i tyre ishte se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi nuk është objekt i vlerësimit gjyqësor.

19.4. Pretendimi i kërkuesit se nuk është zbatuar procedura e parashikuar në ligj për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi shkaku për të cilin është zëvendësuar ajo nuk ka ekzistuar, është i pabazuar. Sipas akteve konstatohet se edhe pse kërkuesi ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos u njohur me vendimin nr. 112/2023, në fakt, rezulton se ai është njohur me atë vendim, i cili u është vënë në dispozicion edhe mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrin për të marrë në dorëzim akte për llogari të tij Gjithashtu, referuar të gjitha të dhënave të publikuara nga mediat, rezulton se kërkuesi është njohur me disponimin e vendimit nr. 112/2023, që ka caktuar masat e sigurimit personal të vendosura ndaj tij. Në këtë kuptim, rezulton se ka qenë vetë kërkuesi që ka refuzuar të marrë në dorëzim atë vendim, megjithëse ai është njohur me përmbajtjen e tij.

19.5. Pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal është i pabazuar, pasi fakti penal është konfirmuar nga të dyja gjykatat në mënyrë të plotë dhe të qartë. Ky fakt penal është konsoliduar në vijim dhe çështja penale në ngarkim të tij është në fazën e gjykimit.

19.6. Pretendimi i kërkuesit se gjykatat nuk kanë argumentuar nevojshmërinë e masës së sigurimit personal, duke i cenuar edhe lirinë e shprehjes, të drejtat politike dhe lirinë e organizimit,

është i pabazuar. Referuar vendimeve të gjykatave rezulton se ato kanë bërë një analizë tërësore të rezultateve të hetimit dhe në këtë mënyrë kanë konkluduar me vendimmarrje në përputhje me dispozitat përkatëse. Ato vendime nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore, të paqarta ose në mungesë të elementeve formale. Edhe pse me masë sigurimi "Arresti në shtëpi", kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të shprehjes, lirinë politike dhe atë të organizimit. Kushtet dhe kriteret në caktimin e masave të sigurimit janë analizuar qartësisht nga gjykatat.

20. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim përpara Gjykatës, duke mos mbajtur një qëndrim në lidhje me çështjen, por ka paraqitur kopje të akteve të procedurës parlamentare të ndjekur në rastin konkret për dhënien e autorizimit për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit.-

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

21. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae,* Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë vendosur ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", për shkak të mospërmbushjes të masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" të caktuar ndaj tij me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Këto të fundit (vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023)

kanë caktuar ndaj kërkuesit edhe masën tjetër të sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", por duke qenë se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" është zëvendësuar për shkak se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin e masës së sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", Gjykata do t'u referohet atyre vendimeve vetëm për këtë masë sigurimi.

23. Gjykata vëren, gjithashtu, se me vendimin e datës 27.11.2024 GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e kërkuesit dhe ka revokuar masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në shtëpi", ndërsa GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 03.01.2025, ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Në kushtet kur vendimi gjyqësor objekt ankimi nuk prodhon më efekte për kërkuesin, Gjykata do të vlerësojë, së pari, nëse ai (kërkuesi) mbart ende statusin e "viktimës" që do ta legjitimonte për të paraqitur një ankim para kësaj Gjykate. Për këtë qëllim, Gjykata sjell në vëmendje interpretimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas të cilit fjala "viktimë", sipas kontekstit të nenit 34 të KEDNJ-së, përcakton personin që preket drejtpërdrejt nga veprimi ose mosveprimi konkret. Sipas GJEDNJ-së, një vendim ose masë (e mëvonshme) në favor të kërkuesit, në parim, nuk është e mjaftueshme për ta privuar atë nga statusi i tij si "viktimë", nëse autoritetet vendase nuk kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, duke korrigjuar më pas shkeljen konkrete të Konventës (*shih Afërdita Hysa kundër Shqipërisë, datë 21 shkurt 2023, § 52*).

24. Për këtë arsye, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, duke pasur parasysh se masa e sigurimit me heqje lirie ndaj kërkuesit (vendimi gjyqësor objekt ankimi) nuk u pranua për shkak të konstatimit të paligjshmërisë së saj, por si rezultat i ndryshimit të nevojave të sigurimit, kërkuesi e ruan statusin e viktimës dhe, për pasojë, legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësisht se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" është zëvendësuar nga gjykatat me një masë më të lehtë, konkretisht me masën "Detyrimi për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, dhe ai proces është ende në pritje të gjykimit nga Gjykata e Lartë, kërkuesi e mbart ende statusin e viktimës, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur.

25. Po ashtu, Gjykata evidenton se edhe ndryshimet e vazhdueshme të masës së sigurimit në ngarkim të kërkuesit nuk mund të konsiderohen si korrigjim, duke qenë se kërkesat për ndryshimin e masës së sigurimit mund të bëhen nga i dyshuari në çdo kohë dhe fati i tyre (pranimi ose jo nga gjykata) përcaktohet ekskluzivisht nga ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius* nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar. Thënë ndryshe, pavarësisht se masa e sigurimit e kundërshtuar nga kërkuesi "Arresti në shtëpi" nuk është më në fuqi për shkak të revokimit e, më pas, ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkese nuk sjellin më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se kërkuesi ka qenë duke vuajtur një masë heqjeje të lirisë, për të cilën ai pretendon se është jokushtetuese dhe në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e tij.

26. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi", duke qenë se ato lidhen me heqjen e lirisë së individit dhe konsiderohen përfundimtare për qëllime të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 13, datë 13.03.2024; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Po për sa i përket plotësimit të kriterit të shterimit, Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi i ka shteruar formalisht të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm.

28. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ky kriter kërkon që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë*

09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese). Për sa i përket plotësimit të këtij kriteri në drejtim të pretendimeve të paraqitura, Gjykata vëren se pretendimet e ngritura nga kërkuesi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, për shkak të mungesës së qartësisë dhe qëndrueshmërisë në interpretimin e neneve 246 dhe 417 të KPP-së, nga ku nuk rezulton e qartë nëse vendimet që kufizojnë lirinë personale të individit me masa sigurimi personal pezullohen ose jo nga ankimi i paraqitur në gjykatën e apelit; për cenimin e *lirisë personale*, për shkak se përmbushja e detyrimit të masës të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij ka lindur vetëm pasi vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka disponuar për të është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit; për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit,* për shkak se Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin, ky i fundit nuk i ka ngritur as në ankimin e drejtuar GJKKO-së së Apelit, as në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se lidhur me këto pretendime dhe argumente ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

29. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, rezulton që ai t`i ketë parashtruar ato në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme dhe në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, konsiderohet se ai i ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

30. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 09.04.2024, u është komunikuar mbrojtësve të kërkuesit në adresat e tyre të postës elektronike në datën 29.09.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 18.11.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

31. Në lidhje me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, ai verifikohet në drejtim të përmbajtjes dhe natyrës së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të pavarësisë* së gjyqtarëve të GJKKO-së për shkak të përmbajtjes së dispozitave të ligjit nr. 95/2016, të cilat përcaktojnë kontrollin periodik të telekomunikimeve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe familjarëve të tyre të afërt nga BKH-ja. Po ashtu, në pretendimin e tij për cenimin e së *drejtës së aksesit*

dhe standardit të arsyetimit, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për pretendimin për efektet e regjimit të vëzhgimit për pavarësinë e gjyqtarëve të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas kërkuesit, vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka vendosur masën e sigurimit personal, e cila pretendohet nga Prokuroria e Posaçme se nuk është zbatuar prej tij, nuk i është njoftuar. Gjykata konstaton, gjithashtu, se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *imunitetit parlamentar*, duke argumentuar, ndër të tjera, se procedura e ndjekur në Kuvend për dhënien e autorizimit është bërë në kundërshtim me nenin 73 të Kushtetutës, për shkak se nuk është ndjekur procedura e parashikuar nga Kushtetuta për kufizimin e lirisë së deputetit në caktimin e masës së sigurimit që pretendohet se nuk është zbatuar prej tij.

32. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se në vendimin e saj nr. 81/2024, ajo ka marrë në shqyrtim edhe përmbajtjen e neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, duke vlerësuar se ato nuk cenojnë parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë në gjykim dhe se ligji përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve në mënyrën se si realizohet kontrolli (*shih paragrafët 65-77*). Po ashtu, në vendimin e saj nr. 81/2024, Gjykata ka vlerësuar se argumenti i kërkuesit, sipas të cilit Kuvendi duhet të japë autorizimin në rastin e caktimit të masave të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore dhe të ndalimit të daljes jashtë shtetit, nuk pajtohet me parashikimin e nenit 73 të Kushtetutës dhe autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale (*shih paragrafët 58-59*) . Në vlerësimin e saj, me vendimin nr. 81/2024, Gjykata ka evidentuar se nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë marrë të gjitha masat për njoftimin kërkuesit të vendimit nr. 112/2023, i cili ka disponuar për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit dhe pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë të bazuara (*shih paragrafin 87*).

33. Në këtë kuptim, Gjykata ripohon se kur ajo është shprehur më parë me vendim përfundimtar për themelin e pretendimeve të ngritura nga palët, ai vendim përbën pengesë për Gjykatën që të rimarrë përsëri në shqyrtim të njëjtat pretendime, të ngritura për të njëjtat shkaqe (*shih vendimin nr. 60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, duke pasur parasysh se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të posaçëm, si rrjedhojë e parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 95/2016, cenimit të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë

përgjigje atij lidhur me pretendimin për efektet e regjimit të vëzhgimit për pavarësinë e gjyqtarëve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që lidhen përsëri me dispozitat e ligjit nr. 95/2016, si edhe mosnjoftimit të vendimit nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, dhe imunitetit parlamentar, për shkak se nuk është ndjekur nga Kuvendi procedura e parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës për dhënien e autorizimit për heqjen e lirisë së deputetit, i janë nënshtruar tashmë vlerësimit kushtetues dhe janë bërë objekt i një vendimmarrjeje të mëparshme kushtetuese me vendimin nr. 81/2024, duke u gjendur të pabazuara, Gjykata çmon se ato nuk mund të merren në shqyrtim.

34. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi ka argumentuar se caktimi i masës së sigurimit "Arresti në shtëpi", pavarësisht se ajo ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së masave të caktuara me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duhet të respektojë edhe kriteret e tjera të parashikuara në nenin 27 të Kushtetutës dhe dispozitat përkatëse procedurale penale. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuesit lidhen me pasojat që ka sjellë zëvendësimi i masave të sigurimit në ushtrimin prej tij të të drejtave dhe lirive të tjera kushtetuese, siç janë liria personale, e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit dhe e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar. Sipas kërkuesit, këto kufizime nuk janë të nevojshme, pasi fakti penal i dyshuar, për të cilin është duke u kryer hetimi penal, nuk ka lidhje me ushtrimin prej tij të të drejtave dhe lirive që janë kufizuar nga gjykatat dhe kufizimi nuk është proporcional. Po sipas kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret nuk garantoheshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë "Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar" apo "Garancia pasurore". Në aspektin procedural, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e garancive që ofron e drejta për proces të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, në drejtim të parimit të paanshmërisë, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë nga ish-KLD-ja në kohën që drejtohej nga kërkuesi në cilësinë e Presidentit të Republikës, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, së drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me parimin e barazisë së armëve, si edhe imunitetit parlamentar.

35. Gjykata, fillimisht, evidenton se masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuesit është "Arresti në shtëpi". Gjithashtu, Gjykata vëren se me anë të kësaj mase, kërkuesi është urdhëruar të mos largohet nga banesa, si edhe

të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të, detyrime të cilat kanë intensitet të tillë që mund të barazohen me heqjen e lirisë. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se neni 27 i Kushtetutës garanton lirinë personale dhe funksionin e deputetit që ushtron kërkuesi, si edhe thelbin e argumenteve të tij për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, vlerëson t'i shqyrtojë ato nën prizmin e lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe së drejtës substanciale për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuesi, të mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit "Arresti në shtëpi".

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

36. Gjykata ka pohuar se ndërkohë që aspekti substancial i lirisë personale mbrohet nga neni 27 i Kushtetutës, për aspektin procedural të kësaj lirie ajo ka theksuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura. Po sipas Gjykatës, garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 19, datë 04.04.2023*), sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi të lidhura me garancitë e parashikuara nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, procedura e parashikuar nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së, kur është rasti, duhet të plotësojë të njëjtat garanci si ato të kërkuara në nenin 6 § 1 të Konventës për çështjet penale ose civile dhe ajo duhet të ketë karakter gjyqësor dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për llojin e heqjes së lirisë në fjalë (*shih vendimin nr. 83, datë 05.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Lidhur me kufizimin e lirisë personale, Gjykata vëren se sipas nenit 27, pika 2, shkronja "b", të Kushtetutës, liria e personit mund të kufizohet edhe për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës. Kurse sipas nenit 5, pika 4, të KEDNJ-së çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë, me qëllim që kjo e

fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

38. Nga ana tjetër, sipas nenit 42 të Kushtetutës, liria dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

39. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se aspekti substancial i lirisë personale duhet analizuar nën dritën e nenit 27 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 83, datë 05.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), ndërsa aspekti procedural i saj nën atë të nenit 28 të saj të lidhur me nenin 42.

40. Po kështu, duke qenë se kërkuesi gëzon statusin e deputetit dhe procesi gjyqësor për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" me masën "Arresti në shtëpi" paraprihet nga procesi që zhvillon Kuvendi, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për dhënien e autorizimit për caktimin e masës "Arresti në shtëpi", Gjykata në vijim do të verifikojë në aspektin procedural si procedurën e zhvilluar nga Kuvendi, ashtu edhe procedurën e zhvilluar nga gjykatat.

41. Në këtë kuptim, Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuesit, në vijim do të shqyrtojë aspektet procedurale që kanë të bëjnë me: *i)* procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit; *ii)* të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit; *iii)* parimin e paanshmërisë në kuadër të ankimeve të bëra gjatë procesit gjyqësor, për shkak të lirimit të gjyqtares I.Gj. nga detyra nga ish-KLD-ja dhe për shkak të mosmarrjes në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit të pretendimit të kërkuesit për paraqitjen e kërkesës së dytë për përjashtimin e asaj gjyqtareje, si aspekte procedurale të të drejtave substanciale të sipërpërmendura; *iv)* aspektin substancial të kufizimit të këtyre të drejtave në drejtim të parimit të proporcionalitetit të masës së sigurimit të vendosur për kërkuesin.

B.1.1. Për aspektet procedurale të cenimit të lirisë personale

B.1.1.1. Për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit

42. Kërkuesi ka pretenduar se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë paragjykuar politikisht, nisur nga deklarimet e bëra në Kuvend në mbledhjen e Këshillit nga deputetët të B.Ç., L.N.,

E.F. dhe E.A. Sipas kërkuesit, procedura e zhvilluar në Kuvend ka qenë e paragjykuar politikisht, nisur nga dhënia e opinionit në lidhje me kërkesën e deputetit B.Ç. dhe opinionet e anëtarëve të tjerë të Këshillit. Në vlerësimin e kërkuesit, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nga Këshilli nuk janë shqyrtuar të gjitha provat, pasi ato nuk janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, por janë shqyrtuar vetëm vendimet gjyqësore që kishin caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e Policisë Gjyqësore për përmbushjen e atyre masave. Pra, sipas kërkuesit, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij dhe nuk është verifikuar nga Kuvendi ekzistenca e këtij fakti penal. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për dhënien e masës së arrestit në shtëpi. Po sipas kërkuesit, ishte detyrë e gjykatave të verifikonin nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

43. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar, duke argumentuar, se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi gjykatat e kanë dhënë përgjigjen e tyre në vendimet që kanë shqyrtuar ankimet e kërkuesit kundër vendimit që ka vendosur masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", ku thelbi i tyre ishte se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi nuk ishte objekt i vlerësimit gjyqësor. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal është i pabazuar, pasi fakti penal është konfirmuar nga të dyja gjykatat në mënyrë të plotë dhe të qartë dhe se ky fakt penal është konsoliduar në vijim dhe çështja penale në ngarkim të tij është në fazën e gjykimit në themel.

44. Gjykata ka pohuar se regjimi i imuniteteve, në çdo rast, synon, nga njëra anë, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike nga zyrtarët e lartë të shtetit, të cilët nuk duhet të druhen se veprimtaria e tyre shtetërore mund të bëhet shkas për pasoja personale, si, për shembull, një padi civile ose një akuzë penale. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, dispozitat që përbëjnë regjimin e imuniteteve synojnë të garantojnë përgjegjshmërinë e këtyre funksionarëve të lartë në qoftë se, në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezulton se veprimet e tyre nuk janë të motivuara nga interesi publik, por nga interesi privat ose keqbesimi (*shih vendimin nr. 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij (imunitetit parlamentar) është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht dhe se paprekshmëria e tij duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye për të dyshuar se në vendimin për ndjekjen penalisht të deputetit ka elemente partiako-politike (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se paprekshmëria penale ndihmon për të arritur pavarësinë e plotë të Parlamentit, duke parandaluar çdo mundësi të procedimeve penale të motivuara politikisht (*fumus persecutionis)* dhe mbron pakicën parlamentare nga presioni ose abuzimi i shumicës parlamentare. Mekanizmi për zbatimin e detyrimit parlamentar, që konsiston në marrjen e një vendimi për të hequr apo jo imunitetin, është një nga mënyrat me të cilat Parlamenti ushtron autonominë e tij (*shih vendimin Kart kundër Turqisë, datë 3 dhjetor 2009, § § 96, 101)*

47. Në lidhje me procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit, Komisioni i Venecias ka mbajtur qëndrimin se është e vështirë për Kuvendin (komisionin parlamentar përkatës) të vlerësojë heqjen e imunitetit pa u futur në detajet dhe themelin e akuzave penale të rastit specifik dhe pa formuar një opinion paraprak. Gjithashtu, sipas Komisionit të Venecias, kjo është në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, sipas të cilit vetëm gjykatat mund të vlerësojnë përgjegjësinë penale individuale. Organi parlamentar që shqyrton kërkesat për heqje imuniteti nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes si të tillë (*shih raportin CDL-AD (2014) 011 të Komisionit të Venecias).*

48. Për sa më lart, referuar edhe pretendimeve të kërkuesit, për të vlerësuar nëse në rastin konkret ka pasur cenim të procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit parlamentar, Gjykata, në vijim, do ta analizojë këtë pretendim, duke u bazuar në aktet e Këshillit (procesverbali dhe raportet), aktet mbi të cilat anëtarët e Këshillit kanë vlerësuar dhënien e autorizimit, si edhe rrethanat e rastit konkret. Në këtë kuptim, Gjykata do ta analizojë nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së arrestit ndaj kërkuesit ka qenë e ndikuar politikisht dhe nëse ka qenë e bazuar në prova të mjaftueshme.

49. Në rastin konkret, rezulton se Prokuroria e Posaçme në datën 12.12.2023 i është drejtuar Kuvendit me kërkesë për dhënien e autorizimit

për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit (kërkuesit) nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, për shkak se kërkuesi nuk kishte zbatuar detyrimet e vendosura më parë ndaj tij, duke paraqitur edhe relacionin shoqërues, si edhe provat ku mbështeste kërkesën e saj. Sipas Prokurorisë së Posaçme, në rastin konkret përmbushen kërkesat e parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të KPP-së, pasi personi nën hetim (kërkuesi), në mënyrë të përsëritur, nuk ka zbatuar detyrimet që i janë ngarkuar nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore. Për këtë arsye, Kuvendi ka nisur procedurën për shqyrtimin e kësaj kërkese të Prokurorisë së Posaçme, duke thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 18.12.2023.

50. Referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, si dhe akteve bashkëlidhur kërkesës, rezulton që kërkesa, relacioni dhe provat (procesverbalet e oficerit të Policisë Gjyqësore për paraqitjen e kërkuesit dhe vendimet gjyqësore që kanë vendosur masat e sigurimit personal, të cilat nuk janë zbatuar prej tij) të jenë vënë në dispozicion të anëtarëve të tij. Rezulton, gjithashtu, që mbrojtësit e kërkuesit t`i kenë kërkuar Këshillit pezullimin e procedurës për dhënien e autorizimit nga Kuvendi deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese të çështjes së paraqitur nga kërkuesi për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Në lidhje me këtë kërkesë anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje kanë votuar për rrëzimin e saj. Në vijim, anëtarët e Këshillit i kanë drejtuar pyetje prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësve të kërkuesit. Po kështu, rezulton që në mbledhje të kenë shprehur mendimin e tyre në lidhje me kërkesën për dhënien e autorizimit të Kuvendit edhe deputetja E.F., si edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputeti B.Ç., i cili ka pohuar se "*ne [...] si grup parlamentar do të votojmë çdo kërkesë për heqje imuniteti [...]*" *(faqe 62)*. Në vlerësimin e këtyre anëtarëve të Këshillit (E.F. dhe B.Ç.) vetë kërkuesi është shprehur që të jetë pa imunitet dhe se ai nuk ka respektuar dhe ka injoruar vendimet e gjykatave, si edhe se në rastin konkret janë rënduar nevojat e sigurimit, pasi ai ka mobilizuar njerëz duke i sjellë pranë godinave të Kuvendit dhe pretendon t'i sjellë sërish në sallën e seancave plenare për të bllokuar punën e Kuvendit dhe dhënien e autorizimit.

51. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli i ka rekomanduar seancës plenare dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së

kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Megjithatë, për sa kohë që në lidhje me arsyet e dhënies së autorizimit ka pasur mendime të ndryshme ndërmjet anëtarëve të Këshillit, seancës plenare i janë paraqitur dy raporte rekomanduese. Sipas njërit raport (i deputetëve të shumicës anëtarë të Këshillit) kërkesa e paraqitur nga mbrojtësit e kërkuesit për pezullimin e procedurës për dhënien e autorizimit është e pabazuar në ligj, pasi nuk ka asnjë dispozitë ligjore mbi të cilën të mbështetet ajo, si edhe nuk ka asnjë vendim të Gjykatës për pezullimin e kësaj procedure. Sipas këtij raporti, Këshilli nuk mund të marrë në shqyrtim bazueshmërinë në prova dhe fakte të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, pasi do të cenonte parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe se vlerësimin nëse janë ose jo kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi personal e kanë gjykatat, bazuar në parashikimet e KPP-së. Po sipas këtij raporti, nga pikëpamja formale kërkesa e Prokurorisë së Posaçme është në përputhje me kërkesat ligjore dhe ai organ legjitimohet ta paraqesë atë në Kuvend. Sipas anëtarëve të shumicës, kërkesa plotëson kriteret e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, pasi bëhet për ato shkaqe që parashikon kjo dispozitë dhe është në përputhje edhe me nenin 228, pikat 1 dhe 2, të KPP-së, duke u shoqëruar me relacionin shpjegues dhe provat përkatëse, sipas kërkesave të kësaj dispozite. Gjithashtu, sipas këtij raporti, gjatë shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, nuk rezulton që ajo të jetë bërë në kushtet e ndikimit politik apo të një natyre/ndërhyrje tjetër të padrejtë që të bjerë ndesh me interesat e drejtësisë.

52. Sipas raportit tjetër rekomandues (i deputetit të pakicës anëtar i Këshillit), nga analiza e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, relacionit shoqërues dhe përgjigjeve të prokurorëve në mbledhjen e Këshillit konstatohet pa asnjë dyshim ekzistenca e procedimit penal ndaj kërkuesit dhe rrjedhimisht arrihet në përfundimin se plotësohet kushti ligjor se ndaj tij ekziston procedimi penal. Gjithashtu, sipas këtij raporti, konstatohet pa asnjë dyshim se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme tregon kushtet ligjore për veprimet e arrestit dhe të kontrollit, në përputhje me nenin 288 të KPP-së dhe evidentohen qartazi kushtet e neneve 228, 229, 230, 231, pika 1 dhe 260, pika 3, të KPP-së, që lidhen me *i)* dyshimet e arsyeshme të bazuara në prova; *ii)* rrezikun përkundrejt procedimit; *iii*) papërshtatshmërinë e masave të tjera. Në vijim, në këtë raport është pohuar se në vlerësimin në themel të çështjes për mbajtjen ose jo të imunitetit, në këtë rast vërehen lehtësisht plotësimet e kritereve në favor të dhënies së autorizimit, duke u renditur edhe arsyet për këtë pohim.

53. Në rastin konkret, në lidhje me argumentin e kërkuesit se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për pretendimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit, Gjykata vëren se sipas gjykatave, GJKKO-së së Apelit dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet e ngritura nga kërkuesi se gjykata e shkallës së parë duhet të kontrollonte ligjshmërinë e autorizimit të dhënë nga Kuvendi, del jashtë juridiksionit gjyqësor dhe posaçërisht atij penal, respektimi i të cilit është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykimit. Po sipas atyre gjykatave, në të kundërt me sa pretendon kërkuesi, në rastin kur procedohet ndaj një deputeti të Kuvendit, gjykata verifikon sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së, vetëm nëse ky autorizim i kërkuar është dhënë, ndërsa dhënia ose jo e autorizimit nga Kuvendi për të hequr imunitetin ose mburojën procedurale ndaj deputetit është në diskrecion të tij dhe ka si qëllim jo të pengojë hetimet, por të mbrojë funksionin e deputetit nga sulmet abuzive të pushteteve të tjera (*shih faqen 14 të vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe paragrafin 52 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

54. Për sa më lart, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi, dhe i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për të. Në vlerësimin e Gjykatës, shqyrtimi i pretendimit për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi nuk hyn në juridiksionin e gjykatave që shqyrtojnë masat e sigurimit personal. Për këtë arsye, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

55. Po kështu, referuar pretendimit tjetër të kërkuesit se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë e paragjykuar politikisht, bazuar në sa u parashtrua më sipër nga aktet e Kuvendit (procesverbalit të Këshillit dhe dy raporteve rekomanduese), Gjykata çmon se edhe pse gjatë diskutimit të anëtarëve të Këshillit, në mbledhjen e këtij të fundit, nga disa deklarata të anëtarëve të atij Këshilli, vërehen nuanca politike në trajtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme ose edhe paracaktimi i mënyrës së votimit të tyre, kjo është e pranueshme në kontekstin e diskutimeve në një institucion politik të përbërë nga përfaqësues të politikës, siç është Kuvendi, dhe nuk do të thotë se dhënia e autorizimit ka qenë e ndikuar politikisht. Për më tepër që kërkuesi në kërkesën e tij i referohet në tërësi opinioneve/deklaratave dhe pyetjeve të deputetëve anëtarë të Këshillit, por nuk ka treguar dhe nuk ka arritur

të provojë se si këto opinione/deklarata ose pyetje kanë paragjykuar vendimmarrjen e Këshillit.

56. Në arritjen e këtij përfundimi, Gjykata ka parasysh edhe se, siç del qartësisht nga diskutimet në Këshill, qëllimi i deklaratave/pohimeve të deputetëve, në kuadër të procedurës parlamentare për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit, ka qenë arsyetimi lidhur me ekzistencën e kushteve për dhënien ose jo të autorizimit dhe jo përcaktimi i fajësisë ose pafajësisë penale të tij. Gjykata thekson, gjithashtu, se fakti që procedura parlamentare për dhënien e autorizimit për heqjen e lirisë së kërkuesit është vënë në lëvizje për shkak të mospërmbushjes nga kërkuesi të detyrimeve të vendosura më parë nga gjykatat, konkretisht për zbatimin e masës së sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", është një tjetër tregues i rëndësishëm i faktit që ajo (procedura) nuk ka qenë e ndikuar politikisht. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata çmon se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit nuk ka qenë e paragjykuar politikisht dhe pretendimi i tij në këtë drejtim nuk është i bazuar.

57. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit se në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij, Gjykata vlerëson të theksojë se në procedurën për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit, pra heqjes së imunitetit të tij, nga Kuvendi nuk është i nevojshëm administrimi i të gjithë dosjes gjyqësore në ngarkim të deputetit, por vetëm i atyre akteve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se deputeti ka kryer shkeljen për të cilën kërkohet autorizimi, që në rastin konkret janë vendimet gjyqësore që kanë caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për (mos)paraqitjen e tij sipas detyrimeve të vendosura në ato vendime. Në këtë rast, Gjykata, bazuar edhe në raportin e Komisionin të Venecias, mbështet qëndrimin e këtij të fundit se organi parlamentar që shqyrton kërkesën për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes dhe nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës apo bazueshmërinë e procedimit penal. Në këtë rast, duhet të ekzistojë një prezumim themelor se imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit janë të motivuara politikisht (*shih raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2014)001 (maj 2014)*). Pra, në vlerësimin e Gjykatës, Kuvendi, në shqyrtimin e kërkesës për heqjen e imunitetit, nuk duhet të

vlerësojë përgjegjësinë penale të deputetit dhe as (pa)fajësinë e tij, por vetëm të sigurohet se ekziston dyshimi i arsyeshëm që ai (deputeti) të ketë kryer shkeljet për të cilat kërkohet heqja e imunitetit, si edhe që kjo kërkesë për heqjen e imunitetit parlamentar të mos jetë e ndikuar politikisht.

58. Në këtë kuptim, Gjykata çmon të theksojë se natyra e vendimeve të marra nga organet politike të Kuvendit, siç mund të jetë në rastin konkret Këshilli, të cilat në vetvete kanë natyrë politike, nuk mund të jetë e njëjtë me natyrën e një vendimi gjyqësor. Për këtë arsye ai jo domosdoshmërisht duhet të plotësojë të njëjtat kritere të një vendimi gjyqësor. Gjithashtu, Gjykata thekson se edhe pse procedura parlamentare për heqjen e imunitetit duket sikur ndërhyn në parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak se mund të perceptohet si një lloj gjykimi politik për themelin e çështjes së (pa)fajësisë së deputetit, kjo procedurë nuk duhet kurrsesi të ketë natyrën e një procedimi gjyqësor ose t'i ngjajë atij, dhe në asnjë rast organi që zhvillon këtë procedurë nuk duhet të vlerësojë (pa)fajësinë e deputetit të cilit kërkohet t'i hiqet imuniteti, e cila vlerësohet vetëm nga gjykatat. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson të ripohojë qëndrimin e saj se imuniteti i deputetit nuk përbën përjashtim nga rregulli, sipas të cilit çdo person që kryen një vepër penale është subjekt i përgjegjësisë penale, që ndiqet nga prokurorët dhe në fund vendoset nga gjykatat e pavarura (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Për këtë arsye, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata vlerëson se aktet e paraqitura nga organi i akuzës për dhënien nga Kuvendi të autorizimit për arrestimin e kërkuesit, pra heqjes së imunitetit të tij, duket se sjellin mjaftueshëm të dhëna për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, nuk është i bazuar.

B.1.2.2. Për cenimin e procedurës gjyqësore

B.1.2.2.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

60. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i gjykatave për procedurat për përjashtimin e gjyqtares është telegrafik dhe vendimet përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë e shteruese pretendimeve të ngritura prej tij. Po ashtu kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar se përse ka refuzuar marrjen e provave të tij dhe se arsyetimi arbitrar i asaj gjykate nuk është riparuar

as nga Gjykata e Lartë. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë arsyetuar pretendimin e tij në lidhje me mosekzistencën e kushtit procedural "Shkelja e detyrimeve që lidhen me një masë tjetër sigurimi", të parashikuar nga neni 231 i KPP-së, duke qenë se vendimet me cilat janë caktuar masat e sigurimit nuk i janë njoftuar atij.

61. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar duke argumentuar se vendimet e gjykatave nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore, të paqarta ose në mungesë të elementeve formale, duke plotësuar kështu elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjykatat i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për pretendimet e ngritura prej tij.

62. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve), përfshirë edhe pretendimet që mund të ngrihen nga pala tjetër, e ndryshme nga kërkuesi, në kuadër të ankimeve që mund të bëhen gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi *(shih vendimet nr. 73, datë 17.10.2024; nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

63. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre

(*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me shkaqet që kanë çuar në pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe caktimin ndaj tij të masës "Arresti në shtëpi", si në drejtim të kritereve dhe kushteve për caktimin e masave të sigurimit me natyrë shtrënguese, ashtu edhe në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi dhe nëse ky arsyetim plotëson standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

66. Gjykata vëren se me kërkesën e datës 22.12.2023, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 228-232, 237, 244 dhe 260 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata zëvendësimin e masave të sigurimit personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", të vendosura më parë ndaj kërkuesit, me masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", për shkak se kërkuesi nuk ka zbatuar vendimin e gjykatave, edhe për pasojë edhe një prej masave të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore.

67. Pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", duke e urdhëruar atë të mos largohej nga banesa, si dhe të mos komunikonte me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të. Sipas gjykatës, kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet e tij që vijnë si rezultat i zbatimit dhe respektimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe 117/2023 të GJKKO-së së Shkallë së Parë, duke mos u paraqitur përpara Policisë Gjyqësore në katër raste. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kushti bazë për

caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur para oficerit të Policisë Gjyqësore dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet e gjykatës. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në rastin konkret nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, është para kushteve kur duhet të zëvendësohen ato masa me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", duke qenë se çështja ndodhet në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore, dhe se kërkuesi, për shkak të marrëdhënieve të krijuara për shkak të statusit të tij të mëparshëm si Kryeministër i vendit ose atij aktual, si deputet i Kuvendit, mund të ndikojë ose ndërhyjë në prishjen apo asgjësimin e provave, si edhe krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çka, sipas tyre, do të sillte një hetim të mangët. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë akoma rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, të shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" dhe "*Ndalimi i daljes jashtë shtetit",* në atë "*Arresti në shtëpi*" (*shih faqet 33 e në vijim të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

68. Gjatë gjykimit në GJKKO-në e Shkallës së Parë, kërkuesi në datën 26.12.2023 ka paraqitur pranë asaj gjykate kërkesën me objekt përjashtimin e gjyqtares I.Gj. nga shqyrtimi i çështjes. Referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se sipas urdhrit nr. 381, datë 04.12.2023 të zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, është bërë përditësimi i ndarjes së gjyqtarëve sipas gatishmërisë për muajin dhjetor të vitit 2023. Po ashtu, rezulton se në

datën 26.12.2023, zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka nxjerrë urdhrin nr. 418, datë 26.12.2023, sipas të cilit, duke qenë se dy gjyqtarë të asaj gjykate, përkatësisht gjyqtaret F.H. dhe E.D., kishin rënë dakord për zëvendësimin e njëra-tjetrës në gatishmërinë përkatëse, sipas shkresës nr. 3572, prot., datë 26.12.2023, bazuar në nenin 37, paragrafi "b", të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*), ka urdhëruar përditësimin e ndarjes së gjyqtarëve sipas gatishmërisë. Ndërkohë, rezulton se sipas vendimit nr. 57, datë 20.11.2023 "Për dhënien e lejes", zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka miratuar kërkesën e gjyqtares E.D. për dhënien e lejes vjetore për periudhën 26.12.2023 - 29.12.2023. Kështu, me urdhrin nr. 421, datë 26.12.2023, zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke qenë se vetë ajo si gjyqtare e gatshme nuk mund të merrte në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për përjashtim, si edhe duke qenë se gjyqtarja pasardhëse e gatshme, E.D., ishte me leje vjetore, ka caktuar gjyqtaren R.P. si gjyqtare pasardhëse të gatshme për të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. Gjyqtarja R.P., pasi administroi edhe mendimin e vet gjyqtares I.Gj. për këtë kërkesë të kërkuesit, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ka vendosur deklarimin e papranueshmërisë së saj. Gjithashtu, rezulton se kërkuesi ka paraqitur përsëri një kërkesë për përjashtimin e gjyqtares I.Gj., e cila ka mbërritur në atë gjykatë në datën 03.01.2024 dhe nuk është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 23, datë 05.01.2023, për shkak se në datën 30.12.2023 ishte zhvilluar gjykimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit. Pra, kërkesa për përjashtim ishte paraqitur pas dhënies së vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit.

69. Mbi ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.01.2024, ka arsyetuar se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për përjashtimin e gjyqtares I.Gj. nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 20, pika 1, i KPP-së, dhe për këtë arsye nuk përmbush kushtet për pranueshmërinë e saj. Sipas asaj gjykate, e gjithë procedura e ndjekur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për caktimin e gjyqtares që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares I.Gj. nga shqyrtimi i çështjes, është në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe kërkesat ligjore të dispozitave të neneve 18 dhe 19 të KPP-së. Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nuk ka pranuar të marrë në shqyrtim vendimmarrjen e shpallur më pas, *ex post,*

nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë, sepse ai ishte i panevojshëm për vendimmarrjen. Sipas GJKKO-së së Apelit, i pabazuar është edhe shkaku tjetër i ngritur në ankim nga kërkuesi, sipas të cilit gjyqtarja I.Gj. nuk ka pranuar provat e paraqitura nga ai, pasi një vlerësim/çmuarje e tillë nga ajo gjyqtare është bërë në ushtrimin e funksionit gjyqësor të çështjes konkrete dhe në përputhje me diskrecionin e saj të lejuar nga ligji procedural penal (*shih faqet 11-13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë se kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij. Edhe sipas asaj gjykate, masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të kërkuesit në kufizim të lirisë së tij të komunikimit dhe të së drejtës së shprehjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në respektim të kufijve diskrecionalë të caktuar nga pika 2 e nenit 237 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka përzgjedhur një kufizim që është proporcional dhe i motivuar nga interesi publik që prevalon mbi interesin personal të individit (*shih faqet 15 e vijuese të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

70. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancitë e lidhura me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre (*shih paragrafin 44 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Lidhur me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ai kolegj ka vlerësuar se janë të pambështetura në ligj e prova, pasi, në thelb, mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes nga gjyqtari, si edhe te drejtimi dhe menaxhimi i procesit gjyqësor (nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve) konform tagrave që i njeh ligji. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtares, sipas nenit 17, pika 1, shkronja "e", të KPP-së, janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të argumentuara si nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë që ka disponuar me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, po ashtu edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka shqyrtuar ankimin edhe ndaj këtij vendimi, duke u dhënë

përgjigje të arsyetuara pretendimeve të të hetuarit. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se duke mbajtur në konsideratë këto fakte, edhe pretendimi i kërkuesit për shkelje nga GJKKO-ja e Apelit, që nuk ka pranuar si provë vendimmarrjen e GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkesën e dytë për përjashtim, nuk e cenon vendimmarrjen objekt rekursi, pasi kjo provë nuk ndikon dhe as passjell një vendimmarrje të ndryshme, e si e tillë me të drejtë është konsideruar një provë e panevojshme (*shih paragrafët 44, 48, 50 dhe 51 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

71. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se pjesa e pretendimeve që lidhen me vlerësimin e rrethanave të faktit del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, por, megjithatë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar si të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij Kolegji, gjykatat më të ulëta i kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit, duke evidentuar "shmangien e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikjen e kërkuesit" (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë veç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt

rekursi (*shih paragrafët 52-58 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

72. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit), në vlerësimin e tyre për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për arsyet të cilat kanë justifikuar zëvendësimin e saj, duke shfaqur një kujdes të veçantë në realizimin e procesit ndaj tij, si dhe duke arsyetuar për masën e duhur të sigurimit personal dhe nëse ishte e "mjaftueshme" për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar, që lidhej me mospërmbushjen nga ai të detyrimeve të vendosura më parë nga gjykatat. Po kështu, ato (gjykatat) kanë analizuar se vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, rrezikun që paraqet për t'iu shmangur hetimit, si edhe prishjes ose të vërtetësisë së provave, nëse ndaj tij nuk do të vendosej ajo masë e sigurimit personal.

73. Në vlerësimin e gjykatës, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, arsyetimi i GJKKO-së së Apelit dhe i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me procedurat për përjashtimin e gjyqtares, rezulton se i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të tij të ngritur në ankim/rekurs. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata konstaton se edhe arsyetimi i atyre gjykatave për këtë pjesë të vendimit nuk rezulton të jetë kontradiktor, telegrafik ose arbitrar. Po ashtu, Gjykata evidenton se gjykatat kanë arsyetuar në vendimet e tyre edhe për pretendimin e ngritur nga kërkuesi për kërkesën për përjashtim të paraqitur nga ai (*shih faqen 11 të vendimit të GJKKO-së Apelit dhe paragrafët 50 e në vijim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*), dhe se ky arsyetim i tyre, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të tij dhe nuk rezulton kontradiktor ose arbitrar, duke plotësuar kështu standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

74. Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së zëvendësimit të masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas vendosjes së masës konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar edhe rëndësinë e faktit se kërkuesi në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet për zbatimin e njërës prej masave të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, që është bërë shkak për vendosjen e masës konkrete. Pra, në këtë kuptim, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat kanë arsyetuar edhe në lidhje me ekzistencën e kushtit procedural/ligjor për zëvendësimin e masës së

sigurimit, duke qenë se ai ishte në dijeni dhe ishte njoftuar për vendimet gjyqësore, të cilat kishin caktuar masën e sigurimit personal ndaj tij, moszbatimi i së cilës u bë shkak për zëvendësimin me masën tjetër "Arresti në shtëpi". Për më tepër, Gjykata rithekson qëndrimin e saj në vendimin nr. 81/2024 lidhur me këtë pretendim, ku ajo (Gjykata) pajtohet me vlerësimin e gjykatave të zakonshme se kërkuesi ishte në dijeni dhe ishte njoftuar për vendimet gjyqësore, të cilat kishin caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Prandaj, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit ka marrë përgjigje të arsyetuar me vendimin nr. 81/2024 të Gjykatës.

75. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjykatat kanë evidentuar edhe faktin se duke qenë se çështja ndodhet në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore, kërkuesi, për shkak të marrëdhënieve të krijuara prej statusit të tij të mëparshëm si Kryeministër i vendit ose atij aktual, si deputet i Kuvendit, mund të ndikojë ose ndërhyjë në prishjen apo asgjësimin e provave, si edhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çka, sipas tyre, do të sillte një hetim të mangët. Po ashtu, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në faktet dhe informacionet e administruara rregullisht gjatë procesit, kanë analizuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga kërkuesi, sikundër edhe për ekzistencën e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal.

76. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, Gjykata konstaton se gjykatat i kanë dhënë përgjigje për pretendimet kryesore të tij, përfshirë këtu edhe pretendimin për mosarsyetimin nga GJKKO-ja e Apelit për mosmarrjen e provës (*shih faqen 13 e vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Në këtë kuptim, rezulton se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese në lidhje me objektin e çështjes së paraqitur për shqyrtim përpara tyre dhe thelbin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Referuar arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi, të pasqyruara më sipër në këtë vendim, ndryshe nga sa pretendon ai, Gjykata vëren se në tërësinë e tyre ato nuk rezultojnë arbitrare, telegrafike në lidhje me procedurat e përjashtimit të gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, jologjike dhe të pamjaftueshme, si dhe kontradiktore ose të paqarta për sa u përket të dhënave të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ato nuk cenojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

77. Nisur nga sa më sipër, bazuar në standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se edhe Kolegji Penal

i ka pasqyruar në vendimin objekt kundërshtimi shkaqet e ngritura në rekursin e ushtruar nga kërkuesi dhe pasi i ka marrë në shqyrtim ato, i ka gjetur të pabazuara, duke vlerësuar, në thelb, se nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka dhënë argumente të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e përfundimit të çështjes. Gjithashtu, bazuar në standardet kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se edhe ai i përmbush elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai ka respektuar elementet formale, duke pasqyruar të dhënat e palëve në procesin gjyqësor penal, shkaqet e parashtruara në ankim dhe rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ka mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë arbitrar, alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e tij. Për rrjedhojë vendimi i Kolegjit Penal nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të aksesit dhe standardit të arsyetimit të tij.

78. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore janë të pabazuara.

B.1.2.2.2. Për cenimin e parimit të paanshmërisë

79. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarja I.Gj., e cila ka dhënë ndaj tij masën shtrënguese të sigurimit personal "Arresti në shtëpi", është shkarkuar nga detyra e gjyqtares në vitin 1996, nga ish-KLD-ja, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi, në cilësinë e Presidentit të Republikës. Sipas kërkuesit, ai ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e kësaj gjyqtareje, e cila është shqyrtuar nga një gjyqtare tjetër e GJKKO-së së Shkallës së Parë, e caktuar po nga gjyqtarja I.Gj., në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, dhe në përfundim, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ajo kërkesë nuk është pranuar. Po sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim vendimin e ndërmjetëm nr. 23, datë 05.01.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për papranueshmërinë e kërkesës për përjashtimin e gjyqtares së GJKKO-së së Shkallës së Parë për shkaqe anshmërie.

80. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur asnjë argument për të prapësuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në drejtim të testit subjektiv. Ndërsa për sa i përket

pretendimit për cenimin e mbrojtjes efektive, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ai është i pabazuar, pasi gjatë gjithë kohës që ka qenë nën masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", kërkuesi ka komunikuar vazhdimisht me mbrojtësit e tij. Sipas Prokurorisë së Posaçme, kjo konfirmohet edhe nga ankimet e bëra nga ai ndaj vendimit të caktimit të masës së sigurimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe ankimin në këtë Gjykatë.

81. Neni 28 pika 2, i Kushtetutës parashikon se paraburgimi ose lirimi i individit vendoset nga gjyqtari. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata çmon se ai duhet të përmbushë garancitë kushtetuese të gjykatës së pavarur dhe të paanshme të përcaktuara nga neni 42 i Kushtetutës. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

82. Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 7, datë 11.03.2008; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar *(shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

83. Bazuar në sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë në vijim nëse shqyrtimi nga gjyqtarja I.Gj. i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për

zëvendësimin e masave të sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuesit ka vënë në dyshim respektimin e parimit të paanshmërisë në aspekt të testit subjektiv në atë gjykim dhe nëse gjykatat më të larta i kanë garantuar atij të drejtën e mbrojtjes efektive, duke shqyrtuar pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë.

84. Gjykata, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se gjyqtarja I.M. (I.Gj.) ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin nr. 7, datë 08.02.1996 të ish-KLD-së është shkarkuar për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës. Në atë kohë rezulton që kryetar i ish-KLD-së të ketë qenë kërkuesi, për shkak të funksionit të tij si President i Republikës, funksion ky *ex officio* sipas legjislacionit në fuqi. Rezulton, gjithashtu, që kjo gjyqtare të jetë emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mallakastër me vendimin nr. 8, datë 23.08.1996 të po ish-KLD, e cila edhe në atë kohë drejtohej po nga kërkuesi.

85. Ndërkohë, GJKKO-ja e Apelit, duke iu referuar edhe arsyetimit të vendimit nr. 521, datë 27.12.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares I.Gj., ka vlerësuar se ajo (kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për përjashtimin e gjyqtares I.Gj.) nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 20, pika 1, i KPP-së, dhe për këtë arsye nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë së saj (*shih faqen 11 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Edhe sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet e kërkuesit për njëanshmërinë e gjyqtares I.Gj., referuar nenit 17, pika 1, shkronja "ë", të KPP-së, janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të arsyetuar si nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ashtu edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka shqyrtuar ankimin ndaj këtij vendimi, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit (*shih paragrafin 50 i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

86. Gjykata, referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi nr. 7, datë 08.02.1996 i ish-KLD-së, vëren se gjyqtari mund të shkarkohej nga ai organ [...] për pamjaftueshmëri profesionale (*neni 147, pika 6*). Ish-KLD-ja përbëhej nga Presidenti i Republikës, kryetari Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe nëntë gjyqtarë të të gjitha niveleve [...] (*neni 147, pika 1*). Bazuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave, Gjykata vëren se shkarkimi i gjyqtarëve bëhej nga një organ kolegjial (ish-KLD-ja), vendimet e të cilit, si rregull, merren sipas formulës së parashikuar për shumicën e votave të anëtarëve të tij, ndërkohë që nuk rezulton dhe nuk

është provuar nga kërkuesi që ai, në cilësinë e kryetarit të këtij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtim. Pavarësisht se kërkuesi ka ushtruar në atë kohë detyrën e kryetarit të ish-KLD-së, nuk rezulton që ai të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtares I.Gj. ose të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj.

87. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Gjykata evidenton se qenia e kërkuesit në cilësinë e kryetarit të një organi kolegjial, i cili ka disponuar për lirimin nga detyra të gjyqtares I.Gj., nuk është shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e asaj gjyqtareje në këtë rast, për sa kohë nuk rezulton dhe nuk është provuar që ai (kërkuesi), në cilësinë e kryetarit të atij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtim ose të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtares apo të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj. Për më tepër, siç edhe rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, gjyqtarja I.Gj. edhe pse është shkarkuar nga detyra e gjyqtares në vitin 1996 nga ish-KLD-ja, kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi, në cilësinë e Presidentit të Republikës, është rikthyer në detyrë, në të njëjtin vit, po nga ish-KLD-ja e drejtuar nga kërkuesi, çka tregon se pretendimet që lidhen me shkarkimin e asaj gjyqtareje neutralizohen nga riemërimi më pas i saj. Në vlerësimin e Gjykatës, ky fakt nuk është i mjaftueshëm për të treguar paragjykimin e gjyqtares I.Gj. në drejtim të vlerësimit të kërkesës së prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuesit.

88. Gjithashtu, Gjykata konstaton se nga gjyqtarja I.Gj. nuk është kryer asnjë veprim ose sjellje konkrete që të vërë në dyshim paanshmërinë e saj në drejtim të testit subjektiv. Veprimet e gjyqtares I.Gj., në cilësinë e zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, për caktimin e një gjyqtareje tjetër për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e saj nga shqyrtimi i çështjes, janë kryer në ushtrimin nga ajo të detyrave administrative dhe menaxhuese në drejtimin e asaj gjykate dhe lidhen vetëm me funksionin e saj si zëvendëskryetare, ndaj për këtë arsye nuk ndikojnë në paanshmërinë e saj. Në vlerësimin e Gjykatës, nga gjyqtarja I.Gj. është ndjekur procedura e zakonshme në përditësimin e listës që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, që në rastin konkret lidhet me zëvendësimin e gjyqtarëve të gatshëm dhe këto veprime nuk ngrenë dyshime për paanshmërinë e saj, për shkak se nga ajo është vepruar në përputhje me parashikimet e KPP-së dhe ligjit nr. 98/2016, si edhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

89. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se gjyqtarja I.Gj. ka

ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm për paanshmërinë e saj në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete nuk ka arsye të përligjura që rrezikojnë dhe vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares I.Gj. dhe ky dyshim nuk është objektivisht i justifikueshëm. Gjithashtu, Gjykata evidenton se nga GJKKO-ja e Apelit janë dhënë arsyet dhe është arsyetuar për mosmarrjen në shqyrtim të provës së paraqitur nga kërkuesi, për shkak se ajo ishte e panevojshme për gjykimin konkret (*shih faqen 13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim nuk është i bazuar. Për më tepër, Gjykata evidenton se kërkesa e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares I.Gj. është marrë në shqyrtim nga një gjyqtare tjetër e së njëjtës gjykatë dhe i është dhënë përgjigje e arsyetuar, si edhe, po ashtu, ky pretendim është parashtruar edhe në ankimet në gjykatat më të larta, të cilat, pasi e kanë marrë në shqyrtim, i kanë dhënë përgjigje kërkuesit se është i pabazuar (*shih faqet 11-13 të GJKKO-së së Apelit dhe paragrafët 44-51 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

90. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë nuk përbëjnë shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares I.Gj. në drejtim të testit subjektiv. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ato nuk janë të bazuara.

B.2. Për aspektin substancial

B.2.1. Për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare

91. Kërkuesi ka pretenduar se me zëvendësimin e masës së sigurimit personal, atij i janë kufizuar edhe të drejta dhe liri të tjera të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit, e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar dhe se kufizimi i tyre është bërë pa ligj. Sipas tij, kufizimi nuk është proporcional dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar pse nevojat e sigurimit nuk garantoheshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë "Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar" dhe "Garancia pasurore", si edhe se gjykatat nuk mund të përcaktojnë kufizime tej atyre të përcaktuara nga ligji.

92. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat kanë argumentuar nevojshmërinë e masës së sigurimit personal, duke bërë një analizë tërësore të rezultateve të hetimit dhe në këtë mënyrë kanë konkluduar me vendimmarrje në përputhje me dispozitat përkatëse. Sipas Prokurorisë së Posaçme, edhe pse me masë sigurimi "Arresti në shtëpi",

kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të shprehjes, lirinë politike dhe atë të organizimit dhe se kushtet dhe kriteret në caktimin e masave të sigurimit janë analizuar qartësisht nga gjykatat.

93. Bazuar në sa më sipër, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara, që kanë caktuar ndaj kërkuesit një masë sigurimi më të rëndë, atë "Arresti në shtëpi", duke kufizuar lirinë e tij personale, i kanë kufizuar edhe të drejtën për të ushtruar veprimtarinë parlamentare, në kuptim të së drejtës për t'u zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës. Nëse përgjigjja e kësaj pyetjeje është pozitive, Gjykata do të vlerësojë më tej nëse kjo ndërhyrje është e ligjshme dhe në respektim të kushteve e kritereve të përcaktuara në nenet 228, 229 e vijues të KPP-së, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Për këtë qëllim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe parimin e subsidiaritetit, do të verifikojë në nëse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar dhe interpretuar në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sigurimit të caktuar ndaj tij, si dhe nëse kanë mbajtur në konsideratë se ajo përmbush qëllimin për të cilin është caktuar.

94. Në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur, Gjykata evidenton se ajo garantohet nga neni 45 i Kushtetutës dhe, sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t`u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

95. Ndërkohë, Gjykata ripohon se çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave e lirive të tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një "nevoje sociale urgjente" dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë "relevante dhe të mjaftueshme". Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për aq sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të

brendshëm; ashpërsia e kufizimit (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

96. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti dhe se ai do të konsiderohet arbitrar, midis të tjerash, në rastet kur nuk është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm do të përbënte cenim të lirisë personale. Në këtë drejtim, Gjykata ka identifikuar disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë personale, siç janë: a) rreziku që i dyshuari/akuzuari në qoftë se do të lihej i lirë do të largohej dhe nuk do të paraqitej përpara gjykatës; b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë do të ndërmerrte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë; c) rreziku që i dyshuari/akuzuari nëse do të lihej i lirë do të kryente vepra penale të tjera (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

97. Në lidhje me kriteret që duhet të plotësohen për të justifikuar nga pikëpamja kushtetuese kufizimin e lirive dhe të të drejtave kushtetuese, Gjykata vëren se lidhur me interesin publik, rregullat procedurale penale që lejojnë vendosjen e masave të sigurimit personal i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj ai është i prezumuar (*shih vendimin nr. 83, datë 05.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e tij kushtetuese është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik.

98. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së. Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata do të analizojë nevojën për kufizimin e lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë parlamentare në raport me nevojat konkrete për mbarëvajtjen e procedimit penal. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata rithekson se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për

mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

99. Në gjykimin kushtetues lidhur me nevojën e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të kërkuesit, Gjykata analizon fillimisht nëse masa konkrete e sigurimit e vendosur për të (kërkuesin) është e nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ajo është vendosur. Më tej, Gjykata vlerëson nëse masa e vendosur është e përshtatshme për të realizuar këtë qëllim. Së fundi, Gjykata vlerëson nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra.

100. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 520/2023, ka arsyetuar se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet që vijnë si rezultat i zbatimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të po asaj gjykate, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore/hetuesit dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në rastin konkret, nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet për zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, është para kushteve kur duhet të zëvendësohen masat e sigurimit të dhëna ndaj tij, me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që të justifikojnë masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë shtetasi nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe funksionit të tij aktual si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë akoma rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit

personal ndaj tij, e shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" në masën "Arresti në shtëpi" (*shih faqet 35-39 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

101. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit në arsyetimin e saj ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka interpretuar dhe zbatuar ligjin procedural penal korrektësisht, se ky zëvendësim i masës së sigurimit personal vjen në zbatim të kombinuar të neneve 231 me 260, pika 3, të KPP-së, që kërkojnë verifikimin e shkeljes së detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit në fuqi të lidhura me rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes së kryer. Edhe sipas GJKKO-së së Apelit, kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij, urdhërime që nisur nga natyra e masës së sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", në ditë dhe orë të caktuara, e parespektuar asnjëherë nga ai, që prej lindjes së detyrimit përkatës, dëshmon për rëndësinë e shkeljes, ndërsa në vlerësim të motiveve dhe rrethanave të shkeljes së kryer, rezulton se ato nuk janë objektive dhe në lehtësim të pozitës së shkelësit. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar drejt dhe në lidhje elementet provuese që përligjin caktimin e një mase më pak shtrënguese personale dhe aktualisht zëvendësim *in peus* të saj, pasi ka vlerësuar qëndrueshmërinë e kushteve të përgjithshme, nevojat e sigurimit të të hetuarit dhe mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë ose të shuarjes së veprës penale për të cilën dyshohet. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi" është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm (*shih faqet 16 e vijuese të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

102. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar si të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në

zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë i vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit duke evidentuar "shmangien e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikjen e kërkuesit" (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë përveç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 54 e vijues të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

103. Lidhur me nevojën e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të kërkuesit, nëse masa konkrete e sigurimit e vendosur mbi të (kërkuesin) është e nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ajo është vendosur dhe nëse është e përshtatshme për të realizuar këtë qëllim, si edhe nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

104. Kështu, sipas njërit qëndrim, masa e sigurimit personal "Arresti në shtëpi", e caktuar ndaj kërkuesit, nuk ka qenë proporcionale ndaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës për këtë shkak .

105. Në linjë me këtë qëndrim, dy gjyqtarë mbajtën qasjen se në caktimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuesit gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenet 228 dhe 229 të KPP-së për caktimin e masave të sigurimit personal në

raport me parashikimet e nenit 260, pika 3, të KPP-së. Sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen kur: *i)* ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; *ii)* i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; *iii)* për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Kurse sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret dhe çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Nga ana tjetër, sipas nenit 260, pika 3, të KPP-së, kur nevojat e sigurimit rëndohen ose personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese. Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite (neni 260), rezulton se në rastin e masave shtrënguese, që është edhe rasti konkret: *së pari,* zëvendësimi i një mase personale sigurimi mund të vendoset si kur bëhet fjalë për rëndimin e nevojave të sigurimit, çka nënkupton se masa e mëparshme nuk u përgjigjet më atyre, ashtu edhe në rastin e mosekzekutimit të detyrimeve që lindin nga masa e sigurimit; *së dyti,* ajo nuk vendos asnjë detyrim për gjykatën për zëvendësimin ose caktimin e një mase tjetër sigurimi; *së treti,* edhe në rast se gjykata pranon kërkesën e prokurorit ajo vlerëson rast pas rasti nëse nevojat e sigurimit kërkojnë zëvendësimin me një masë tjetër më të rëndë ose caktimin e një mase shtesë. Për rrjedhojë, jo vetëm në kuptim të kësaj dispozite, por edhe në kuptim të dispozitave të tjera procedurale penale që lejojnë caktimin e një mase sigurimi, veçanërisht në rastin kur gjykata investohet për zëvendësimin e një mase për shkak se nuk janë zbatuar detyrimet e saj, nuk kërkohet dhe nuk imponohet caktimi i një mase kufizuese si ajo e arrestit, e cila duhet të mbetet si *ultima ratio,* por nënkuptohet realizimi i një procesi vlerësimi dhe analize nga gjykatat e zakonshme në drejtim të nevojës për zëvendësimin e masës së mëparshme me një më të rëndë, ashtu edhe në drejtim të përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së re me nevojat e sigurimit në momentin e caktimit të saj.

106. Thënë sa më sipër, në rastin konkret gjykatat e zakonshme nuk

kanë arritur të arsyetojnë se përse masa e arrestit në shtëpi ishte në rastin konkret e vetmja masë që mund të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal dhe mosvënien në rrezik të tij, pavarësisht se ajo është *ultima ratio*. Në kohën e caktimit të masës së sigurimit personal "Detyrimi për t`u paraqitur në policinë gjyqësore", gjykatat kanë konkluduar se ajo ishte masa e përshtatshme për plotësimin e nevojave të sigurimit në procedimin penal ndaj kërkuesit, çka do të thotë se ato kanë vlerësuar se nuk ekzistonte në atë moment asnjë rrezik për helmimin e provave ose shmangien e drejtësisë nga kërkuesi, dhe për këtë shkak nuk u caktua masa e arrestit. Zëvendësimi i kësaj mase sigurimi është kërkuar nga prokurori jo për shkak të rëndimit të nevojave të sigurimit, pra për shkak të ndryshimit të tyre krahasimisht me momentin e caktimit të masës së parë, por për shkak se kërkuesi nuk ka ekzekutuar detyrimin për t`u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore në ditën dhe orën e përcaktuar për të nga gjykata, çka do të thotë se nuk kanë ndryshuar ata faktorë përcaktues, të tillë që vënë në rrezik vetë procedimin penal (helmimi i provave ose rreziku i ikjes). Pavarësisht kësaj, gjykatat, në kuptim të përmbajtjes së nenit 260, pika 3, të KPP-së dhe nenit 231 të po këtij kodi, që përcaktojnë llojet e masave shtrënguese, nuk kanë arsyetuar në drejtim të nevojës së zëvendësimit të masës me një më të rëndë dhe as në drejtim të përshtatshmërisë së masës së arrestit në shtëpi, pra se përse ishte masa e vetme në rastin konkret dhe se përse nuk ishte i përshtatshëm caktimi i një mase sigurimi shtrënguese tjetër ose ndaluese shtesë.

107. Referuar përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se ato kanë analizuar vetëm ekzistencën e "dyshimit të arsyeshëm" se kërkuesi është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe, sipas tyre, moszbatimi në mënyrë të përsëritur i detyrimeve që i ngarkohen nga ligji procedural penal dëshmon rëndësinë e shkeljes. Po kështu, nga njëra anë, gjykatat kanë pranuar se nevojat e sigurimit vijojnë të jenë në të njëjtin stad dhe mosrespektimi i detyrimeve që përmban masa e sigurimit personal në fuqi "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" në ditë dhe orë të caktuara, që prej lindjes së këtij detyrimi, dëshmon për rëndësinë e shkeljes, ndërsa në vlerësim të motiveve dhe rrethanave të shkeljes së kryer, rezulton se ato nuk janë objektive dhe në lehtësim të pozitës së shkelësit. Nga ana tjetër, gjykatat janë shprehur se nevojat aktuale të sigurimit, që janë "shmangia e dëmtimit të hetimeve" dhe "ikja e kërkuesit", e bëjnë të përshtatshme me nevojat e sigurimit llojin e masës shtrënguese "Arresti në shtëpi" sipas rrethanave të rastit konkret. Këto qëndrime të gjykatave

janë kontradiktore, për sa kohë që qartësisht masa e sigurimit në rëndim të pozitës së kërkuesit lidhet vetëm me mosekzekutimin e detyrimeve që kanë lindur nga masa e mëparshme, ndërkohë që qartësisht nevojat e sigurimit nuk kanë ndryshuar që prej momentit kur është caktuar ajo masë, pra nuk kanë ndryshuar duke u rënduar dhe nuk arsyetohet se cilat janë ato rrethana të reja që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave të këtij procedimi (ose helmimin e provave) apo shmangien e drejtësisë. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë në drejtim të proporcionalitetit elementet që duhet të analizohen prej tyre gjatë caktimit të një mase sigurimi, pra se përveçse e nevojshme, masa e arrestit në shtëpi ishte edhe përshtatshme dhe proporcionalisht e ashpër, pra se asnjë masë tjetër shtrënguese nuk do të ishte në gjendje të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal dhe mosvënien në rrezik të tij.

108. Sipas qasjes së gjyqtares tjetër që ka mbajtur qëndrimin se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" nuk ka qenë proporcionale, në analizën e kushteve dhe kritereve për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më rënduese siç është "Arresti në shtëpi", duhej të analizohej nëse zëvendësimi ishte i nevojshëm, proporcional, i justifikuar, i përshtatshëm dhe nëse masa rrezikonte të ishte më e ashpër kundrejt qëllimit. Ndonëse kërkuesi ka dëshmuar mospërmbushje të masës së sigurimit "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*", përsëri në analizë të nenit 231 të KPP-së vërehet se qëllimi i normës është të parashikojë zëvendësimin me një masë sigurimi më të rëndë, si një *mundësi* dhe jo si një detyrim. Prandaj, Prokuroria e Posaçme mund të kishte treguar një kujdes të shtuar për të nxitur kërkuesin për përmbushjen e detyrimeve ligjore, qoftë edhe duke parë ndonjë alternativë zgjidhjeje për të aplikuar kundrejt një afati të shkurtër me efekt nxitës kombinimin e një mase shtrënguese me një masë ndaluese. Ndonëse në pamje të parë dhe teorikisht rezulton se zëvendësimi i masës është kryer në mbështetje të nenit 228 të KPP-së, përsëri gjykatat e posaçme për të konkluduar për përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin duhet të analizonin *edhe* ndikimin e rrethanave të rastit konkret për mirëfunksionimin e demokracisë në vend. Në këtë këndvështrim, në analizë të: (i) *statusit/cilësive individuale të kërkuesit* të lidhura me rolin e tij në shoqëri, me moshën dhe personalitetin, vërehet lehtësisht se kërkuesi gëzon një status të dyfishtë juridik: si individ dhe si lider i partisë më të madhe opozitare. Ndërkohë, në analizë të (ii) *kontekstit të situatës aktuale politike e sociale* rezulton se koha kur është caktuar masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" përkon me periudhën e përgatitjes për zgjedhje të përgjithshme

parlamentare, gjatë së cilës normalisht forcat politike planifikojnë një plan masash për përgatitjen e fushatës elektorale, takime me zgjedhësit, angazhime mediatike etj. Kalimi i drejtpërdrejtë te një masë rënduese që sjell tashmë heqjen e lirisë ndaj kreut të opozitës passjell vënien në dyshim jo vetëm të garantimit të konkurrimit politik dhe procesit të zgjedhjeve, por edhe vetë mirëfunksionimin e pluralizmit politik dhe demokracisë në vend. Ndonëse në vendimin nr. 81/2024 është mbajtur qëndrimi që masa e sigurimit "*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*" është proporcionale në drejtim të përshtatshmërisë, sepse nga intensiteti i saj nuk e pengonte kërkuesin të përmbushte detyrimet e tij qytetare dhe politike, në rastin konkret përshkallëzimi në drejtim të masës "Arresti në shtëpi" (*e cila bie nën spektrin e masave që kufizojnë lirinë personale*) ka rënduar pozitën e kërkuesit, duke e "penalizuar" atë në një mënyrë më të ashpër se sa do të ishte e justifikuar, e arsyeshme, e përshtatshme dhe e nevojshme. Në konkluzion, sipas qëndrimit të kësaj gjyqtareje, zëvendësimi i masës me "Arresti në shtëpi" si joproporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj dhe, për rrjedhojë, pretendimin e kërkuesit të bazuar.

109. Ndërkohë, sipas qëndrimit tjetër, neni 27, pika 1, i Kushtetutës kërkon, së pari, që heqja e lirisë të jetë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, që do të thotë se çdo privim i lirisë, nga njëra anë, duhet të bazohet në një normë ligjore substanciale dhe sipas rregullave ligjore procedurale, ndërsa, nga ana tjetër, duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 27, pra të mbrojë individin nga arbitrariteti. Me pak fjalë, në parim, heqja e lirisë është e ligjshme nëse kryhet me vendim gjykate. Në vijim, neni 27, pika 2, i Kushtetutës përmban një listë shteruese të rasteve të lejueshme të heqjes së lirisë, që janë në të njëjtën linjë me ato të nenit 5, paragrafi 1, të KEDNJ-së. Për këtë të fundit, GJEDNJ-ja ka pohuar se zbatueshmëria e njërit rast nuk e përjashton domosdoshmërisht një rast tjetër; paraburgimi, në varësi të rrethanave, mund të justifikohet sipas më shumë se një shkaku të parashikuar në nënparagrafët e nenit 5 (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.07.2010, §35; Enhorn kundër Suedisë, datë 25.01.2005, § 34; Eriksen kundër Norvegjisë, 27.05.1997, § 76*). Në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, duhet evidentuar se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" ndaj kërkuesit është caktuar me vendim gjyqësor jo vetëm për shkak të dyshimit të arsyeshëm të kryerjes së veprës penale (neni 27, pika 2, shkronja "c"), por edhe për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës (neni 27, pika 2, shkronja "b").

110. Neni 27, pika 2, shkronja "b", i Kushtetutës lejon kufizimin e lirisë kur një urdhër i ligjshëm i gjykatës nuk zbatohet, që do të thotë se gjykata

mund të vendosë heqjen e lirisë së individit për të realizuar qëllimin e urdhrit të ligjshëm të gjykatës, që nuk është zbatuar dhe jo për të ndëshkuar individin. Për këtë arsye, është me rëndësi vendimtare gjetja e ekuilibrit të duhur midis rëndësisë që ka në një shtet të së drejtës zbatimi i urdhrave të ligjshme të gjykatës dhe lirisë personale. GJEDNJ-ja, në gjykime të ngjashme, ka pohuar se çështja e proporcionalitetit merr rëndësi të veçantë në vlerësimin e përgjithshëm të situatës. Qëllimi i vendimit, mënyra e zbatimit të vendimit dhe kohëzgjatja e paraburgimit janë çështje që duhet të merren në konsideratë (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.07.2010, § 40*). Po ashtu, natyra e detyrimit ligjor që rrjedh nga vendimi gjyqësor, duke përfshirë objektin dhe qëllimin e tij thelbësor, personin që ndalohet, rrethanat e veçanta që çuan në paraburgim dhe kohëzgjatjen e ndalimit janë të rëndësishme (*shih Vasileva kundër Danimarkës, nr. 52792/99, §§ 36-38, 25 shtator 2003*).

111. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, fillimisht vlen të theksohet se objekti i këtij gjykimi kushtetues lidhet *vetëm* me procesin gjyqësor për zëvendësimin e dy masave të sigurimit me atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, pra me caktimin dhe jo me kohëzgjatjen e masës së arrestit në shtëpi. Lidhur me këtë të fundit, kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues dhe as nuk ka treguar që i ka shteruar paraprakisht mjetet juridike në dispozicion, pra duke i ngritur ato paraprakisht te gjykatat e zakonshme. Kërkuesi ka zgjedhur që pretendimet e tij për masat e sigurimit të caktuara në të njëjtin procedim penal t'i paraqesë në Gjykatë përmes ankimeve kushtetuese të veçanta për secilin proces gjyqësor, siç ishte rasti për caktimin e dy masave të sigurimit dhe për zëvendësimin e tyre me atë të arrestit në shtëpi, ndërsa mbetet e hapur mundësia për procesin e tretë gjyqësor për zëvendësimin e masës së arrestit në shtëpi, që është në shqyrtim e sipër në gjykatat e zakonshme.

112. Në vijim, duke analizuar në tërësi të dhënat e çështjes konkrete në raport me standardet kushtetuese, nxirret përfundimi se gjykatat e zakonshme fillimisht kanë caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi i daljes jashtë shtetit", duke mbajtur në konsideratë jo vetëm rëndësinë e lirisë personale, por edhe mundësinë e ushtrimit të funksionit të deputetit në kuadër të së drejtës për t'u zgjedhur. Në këtë kuptim, me vendimin gjyqësor për caktimin e këtyre dy masave, gjykatat kanë nxjerrë urdhrin e ligjshëm që kërkuesi të paraqitej një herë në dy javë në Policinë Gjyqësore, por ky urdhër i ligjshëm u refuzua të zbatohej nga kërkuesi të paktën 4 herë radhazi, në datat 06.11.2023,

20.11.2023, 04.12.2023 dhe 18.12.2024. Duke mos zbatuar këtë urdhër të gjykatës, kërkuesi vuri në dyshim përmbushjen e qëllimit të ligjshëm, për të cilin ishin caktuar masat e sigurimit – konkretisht atë të mbarëvajtjes së procedimit penal ndaj tij, duke theksuar se mbarëvajtja e procedimit penal i shërben ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Po ashtu, refuzimi publik për të zbatuar vendimin e gjykatës nga kërkuesi, në cilësitë e tij personale të deputetit dhe të drejtuesit të një force të rëndësishme politike, vë në dyshim parimin e shtetit të së drejtës, i cili bazohet në ndarjen e pushteteve dhe kërkon respektimin e vendimeve gjyqësore.

113. Për arsyet e mësipërme, gjykatat e zakonshme kanë zbatuar në mënyrë të saktë dhe me mirëbesim zëvendësimin e dy masave të sigurimit në atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, duke vendosur ekuilibrin e duhur midis qëllimit për zbatimin e urdhrave të gjykatës, si dhe rëndësisë së lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale vazhdonte të ekzistonte dhe në shtesë të tij kërkuesi nuk kishte përmbushur urdhrin e ligjshëm të gjykatës 4 herë radhazi, duke lënë pa efekte masën e sigurimit të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se legjislacioni procedural penal (neni 232 i KPP-së) si masë përshkallëzuese përpara asaj të arrestit në shtëpi parashikon dhe atë të garancisë pasurore, por ajo mund të caktohet *vetëm* nëse nga personi nën hetim ose një person tjetër për të ofrohet garanci pasurore (neni 236, pika 1, i KPP-së), që nuk ka ndodhur në rastin konkret. Si përfundim, nisur nga rrethanat konkrete të çështjes në fjalë, kufizimi i lirisë së kërkuesit përmes masës së sigurimit të arrestit në shtëpi ishte proporcional .

114. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit në drejtim të procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit dhe parimit të paanshmërisë, si aspekte procedurale të të drejtave substanciale, janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit. Kurse për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe të drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare, në aspektin e proporcionalitetit të masës, në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ai konsiderohet i rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e

vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.01.2025
Shpallur më 06.03.2025

Vendim nr. 2, datë 21.01.2025
(V-2/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtare, me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (D) 2024, që u përket:

KËRKUESE: **DASHMIRA ZARO**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

ARBEN ÇABEJ, SHEFIKO ÇABEJ, LULJANA ÇABEJ, ESMERALDA ÇABEJ, JUNIK ÇABEJ, EDUART ÇABEJ, ROZETA ÇABEJ, ILIR ILIADHI, MIRELA ILIADHI, NEBIJE ÇABEJ, LORENC ÇABEJ, DORJANA ÇABEJ, SANIE CIKO, VASIL NDINO, ELISABETA ÇABEJ, ANILA ÇABEJ, ALTIN ÇABEJ, ALFRED LILAJ, HYRIJE LILAJ, NATASHA SHKURTI (LILAJ), në mungesë,

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Ëngjëll Agaçi,

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, përfaqësuar nga Etleva Malile, me autorizim,

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Llambriola Misto,

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi,

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, në mungesë,

BASHKIA GJIROKASTËR, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Nertil Nebiaj,

SHOQËRIA "A.L. ASFALT" SH.P.K., në mungesë,
SHOQËRIA "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" SH.P.K., në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2666, datë 26.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes.
Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin brenda 3 muajve të çështjes nr. 31154-02296-86-2023.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141 dhe pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Arben Çabej, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë *(MIE)*, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit *(MEKI)*, Avokaturës së Shtetit, Bashkisë Gjirokastër, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Bashkia Gjirokastër ka nxjerrë lejen zhvillimore nr. 6, datë 16.07.2014 për projektin në Parkun e Viroit, sistemimin e tij, rikonstruktimin e rrugës së parkut dhe ndriçimin e trotuarit nga ana e qytetit. Kontrata për zbatimin e projektit është lidhur me operatorët ekonomikë "A.L. Asfalt" sh.p.k. dhe "Eral Construksion Company" sh.p.k., bazuar në procedurat e prokurimit publik.

2. Me pretendimin se zhvillimi i projektit prekte pasurinë e tyre, në datën 08.09.2014 kërkuesja dhe subjekti i interesuar Arben Çabej i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me kërkesë për sigurimin e padisë dhe pezullimin e punimeve të nisura, ndërsa në datën 03.11.2014 kanë ngritur padi në gjykatë kundër Bashkisë Gjirokastër e të tjerë, me objekt kallëzimin e një punimi të ri dhe dëmi të mundshëm, detyrimin e tyre të kthejnë sendin ose të paguajnë vlerën e plotë të pronës, si dhe sigurimin e padisë përmes pezullimit të punimeve.

3. Gjatë kohës që çështja po shqyrtohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me kërkesë të Bashkisë Gjirokastër dhe propozim të ministrisë së linjës, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 322, datë 15.04.2015 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: Sistemim i Parkut të Viroit, rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit" *(VKM nr. 322/2015)*. Një prej pronarëve të shpronësuar, që prekeshin nga realizimi i projektit, ishte edhe kërkuesja.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në datën 11.09.2014 ka rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë, ndërsa në datën 08.06.2015 ka shpallur moskompetencën lëndore për shqyrtimin e padisë, duke ia dërguar aktet e çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Ndonëse kërkuesja dhe Arben Çabej kanë paraqitur rekurs të veçantë, vendimi për kompetencën është lënë në fuqi me vendimin e datës 03.12.2015 të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datën 08.02.2016. Në përfundim të gjykimit, kjo e fundit, me vendimin nr. 383, datë 09.06.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar Ministrinë e Zhvillimit Urban të shpërblejë paditësit dhe bashkëpronarët e tjerë për efekt shpronësimi në shumën 119.717.920

lekë, sipas pjesëve takuese, si dhe rrëzimin e kërkimeve të tjera të padisë. Kundër këtij vendimi kërkuesja dhe të tjerë kanë paraqitur apel.

5. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 07.09.2016. Pas disa ditësh, në datën 21.09.2016, kërkuesja i është drejtuar kryetarit të asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, të cilën e ka përsëritur në datën 22.02.2017. Bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, që hynë në fuqi në datën 05.11.2017, kërkesa i është përcjellë Gjykatës së Lartë dhe është regjistruar në këtë të fundit në datën 05.03.2018. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se ndërkohë gjykata e apelit e kishte vënë në lëvizje çështjen e kërkueses, duke caktuar seancën gjyqësore. Mbi bazën e këtij konstatimi, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 5, datë 17.04.2018, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, me arsyetimin se gjykata e apelit kishte ndërmarrë hapat për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes.

6. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit ka përfunduar shqyrtimin e çështjes së kërkueses dhe, me vendimin nr. 2276, datë 04.06.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Pas rigjykimit të çështjes, ku bashkëpronarët e tjerë të pronës kanë marrë pjesë si ndërhyrës kryesorë, duke kërkuar edhe ata detyrimin e të paditurve të paguajnë vlerën e plotë të saj, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 326, datë 14.06.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi kërkuesja dhe të tjerë kanë paraqitur apel.

7. Me vendimin nr. 39, datë 15.02.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër të datës 14.06.2019 dhe pushimin e çështjes, me arsyetimin se prona, objekt gjykimi, tashmë i ishte nënshtruar procedurës së shpronësimit, procedurë që nuk ishte kundërshtuar nga paditësit.

8. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, i cili është regjistruar me nr. 31003-00134-2022, datë 10.05.2022. Në datën 14.06.2022 ajo i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të rekursit të veçantë. Në datën 08.09.2022 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kohëzgjatja prej 5 muajsh e shqyrtimit të rekursit nuk e kishte kaluar afatin ligjor 2-vjeçar të parashikuar si afat të arsyeshëm orientues për shqyrtimin e çështjeve administrative në Gjykatën e Lartë.

9. Në datën 06.09.2022 (dy ditë përpara se Gjykata e Lartë të vendoste rrëzimin e kërkesës për përshpejtim), kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të rekursit të veçantë dhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për mbrojtjen e së drejtës së saj. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 148, datë 09.11.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimet ishin haptazi të pabazuara në kushtet kur nuk konstatohej vonesë në shqyrtimin e rekursit të kërkueses.

10. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar rekursin e veçantë të kërkueses dhe ka konstatuar se kërkimi për vlerën e pronës ishte ngritur përpara se të hynte në fuqi VKM-ja nr. 322/2015 për shpronësimin, ndaj gjykata e apelit kishte gabuar kur kishte vendosur pushimin e gjykimit për këtë kërkim, ndërsa lidhur me kërkimet për rivendikimin e pronës dhe kallëzimin e një punimi të ri, vlerësimi i gjykatës së apelit ishte i drejtë. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2656 (113), datë 23.03.2023, ka vendosur (i) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të dytë për sa i përket kërkimit për vlerën e pronës, (ii) lënien në fuqi të vendimit për kërkimet e tjera.

11. Pas këtij vendimi të Gjykatës së Lartë, çështja e kërkueses është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 07.09.2023, me nr. 31154-02296-86-2023. Në datën 09.01.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, të dërguar për herë të tretë për gjykim në gjykatën e apelit. Në kërkesën e nënshkruar personalisht prej saj, kërkuesja ka parashtruar se, pas kthimit për rigjykim, ajo i ishte drejtuar me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit si relatorit fillestar, ashtu edhe relatores së caktuar më pas. Po sipas kërkueses, ndonëse bazuar në nenin 460, pikat 3 dhe 4, të KPC-së dhe kreun II, pika 3.2, shkronja "a", të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" *(vendim nr. 78/2019 i KLGJ-së)*, çështja duhej shqyrtuar me përparësi, gjykimi vazhdonte prej 9 vjetësh.

12. Në datën 26.02.2024 gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, për shkak se nuk ishte nënshkruar nga një avokat. Sipas Gjykatës së Lartë, pavarësisht se kërkueses i ishte kërkuar ta

nënshkruante kërkesën nga një avokat dhe të paraqiste aktin e përfaqësimit, sipas parashikimeve të neneve 474 dhe 399/5 të KPC-së, ajo nuk i kishte plotësuar këto të meta.

13. Në datën 12.07.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 26.09.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

14. Me vendimin nr. 30, datë 17.01.2024 "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*", Këshilli i Ministrave i ka kaluar kësaj ministrie kompetencat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ndaj në gjykimin e çështjes së kërkueses është bërë zëvendësimi procedural dhe palë ndërgjyqëse është MEKI.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesja*,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

15.1. *E drejta për proces të rregullt* ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

15.1.1. *E drejta e aksesit,* pasi Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës, si rrjedhojë e mosnënshkrimit të saj nga avokati i autorizuar me prokurë, pa pasur detyrim ligjor dhe në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese.

15.1.2. *E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm* dhe *parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykimi i çështjes vijon prej më shumë se 9 vjetësh e 6 muajsh. Shqyrtimi i saj për herë të tretë në gjykatën e apelit nuk ka përfunduar ende, në kundërshtim me nenin 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së. Seanca e parë në gjykatën e apelit është zhvilluar në dhomën e këshillimit në datën 03.11.2024, seancat gjyqësore janë caktuar në intervale kohore të njëjta me çështjet që gjykohen për herë të parë ose të dytë. Gjykimi zvarritet nga njoftimi me shpallje i subjekteve. Gjykimi në apel është pezulluar në kundërshtim me nenin 297 të KPC-së dhe në shkelje të *parimit të disponibilitetit,* pasi bashkëpronarët janë thirrur në gjykim kryesisht nga gjykata e shkallës së parë, pa qenë pjesë e ndërgjyqësisë së detyrueshme. Vendimi i pezullimit nuk plotëson *standardin kushtetues të arsyetimit*.

15.2. *E drejta për një mjet ligjor efektiv*, pasi Gjykata e Lartë duke kthyer kërkesën, nuk i ka dhënë përgjigje kërkimit për të urdhëruar gjykatën e apelit të përfundojë gjykimin brenda 3 muajve.

16. ***Subjekti i interesuar, Arben Çabej****,* në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

16.1. Gjykata e Lartë ka cenuar *të drejtën e aksesit*, si dhe *të drejtën për një mjet ligjor efektiv*, pasi neni 399/5 i KPC-së nuk kërkon nënshkrimin nga mbrojtësi të kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit.

16.2. Kërkueses i është cenuar edhe *e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi nga regjistrimi për herë të tretë i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka kaluar mbi një vit dhe për çështjen nuk ka ende një vendim. Intervalet kohore të caktimit të seancave nga kjo gjykatë nuk kanë asnjë ndryshim nga çështjet e tjera që gjykohen për herë të parë ose të dytë.

16.3. Gjykata e apelit kur vendosi pushimin e gjykimit të çështjes ka cenuar parimet e *gjykimit të çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj* dhe *sigurisë juridike*, pasi nuk ka respektuar konkluzionet e vendimit të mëparshëm të saj të datës 04.06.2018, si dhe të vendimit të Gjykatës së Lartë që i kishte përcaktuar kompetencën.

17. ***Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se:

17.1. Pretendimi për *cenimin e së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi neni 399/5, pika 2, i KPC-së kërkon depozitimin e prokurës kur kërkesa për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e gjykimit bëhet nga avokati. Kërkuesja duhet të kishte plotësuar të metën e kërkesës, duke e nënshkruar atë nga mbrojtësi. Për këtë shkak, ajo *nuk ka shteruar mjetet juridike efektive*.

17.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm* është i pabazuar. *Sjellja e palëve në proces* dhe *e autoriteteve* nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Gjykata e apelit ka vepruar brenda afateve ligjore për të siguruar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Ajo ka zhvilluar seanca çdo muaj, duke caktuar edhe dy në muaj. Gjykimi është pezulluar në zbatim të nenit 297, shkronja "c", të KPC-së, sepse një nga palët ka ndërruar jetë. Edhe pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, gjykata e apelit ka zhvilluar seancë në datën 15.10.2024, në të cilën ka verifikuar se shkaku i pezullimit nuk ka rënë.

18. ***Subjektet e interesuara, MKEI-ja, MIE-ja*** **dhe** ***Bashkia Gjirokastër*****,** kanë prapësuar se janë të pabazuara pretendimet për cenimin e së *drejtave të aksesit dhe për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, me të njëjtat argumente të paraqitura nga Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit. Në shtesë të atyre argumenteve, ato kanë evidentuar se gjykimi në shkallë të dytë ka zgjatur edhe për shkak të ngarkesës së punës në atë gjykatë.

19. ***Subjektet e tjera të interesuara*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

20. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

22. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete *(shih vendimet nr. 6, datë 15.02.2024; nr. 64, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni në fuqi parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të

zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Gjykata vëren se kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, pasi i është drejtuar më parë me kërkesë Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 399/6, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj nga Gjykata Administrative të Apelit, kërkesë e cila ishte nënshkruar personalisht prej saj. Me vendimin nr. 00-2024-2666, datë 26.02.2024, gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës, si rrjedhojë e mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit dhe të aktit të përfaqësimit, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së.

24. Në kontekstin e këtyre rrethanave, kërkuesja ka pretenduar se e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike, por Gjykata e Lartë duke ia kthyer kërkesën, për shkak të formalizmave të tepruar, i ka cenuar asaj të drejtën e aksesit në gjykatë dhe atë të zgjidhjes efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së. Ndërsa subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se kërkuesja nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, për sa kohë kërkesën për konstatimin e shkeljes, që ia ka drejtuar Gjykatës së Lartë, nuk e ka shoqëruar me prokurën e avokatit, ndaj kthimi i kërkesës ishte në përputhje me ligjin procedural.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kthimi pa veprim i kërkesave drejtuar Gjykatës së Larë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një pengesë të aksesit në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv *(shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se kërkuesja ka shfrytëzuar mjetin juridik në dispozicion të saj, duke e paraqitur kërkesën në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit nuk e ka shqyrtuar themelin e kërkesës, por ia ka kthyer

kërkueses me arsyetimin se duhej nënshkruar nga një avokat dhe se duhej paraqitur akti i përfaqësimit, ndonëse kërkesa ishte nënshkruar personalisht nga vetë kërkuesja. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka mbajtur qasje formaliste dhe e ka shndërruar kërkesën në mjet ankimi joefektiv. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, ndaj prapësimi i subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, në këtë drejtim është i pabazuar.

27. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës në datën 12.07.2024, ndërsa vendimi gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes, i cili mban datën 26.02.2024, i është njoftuar kërkueses me postë elektronike në datën 12.07.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

28. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, që garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, pretendim që përfshihet në kompetencën e Gjykatës. Në këtë pikë duhet evidentuar se kërkuesja e ka përmbushur detyrimin për shterimin e mjeteve juridike, duke iu drejtuar paraprakisht me kërkesë Gjykatës së Lartë, por kjo e fundit e ka kthyer atë pa veprime (*shih paragrafin 26 të vendimit*), duke mos i dhënë përgjigje pretendimit për cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkueses, pra duke mos përmbushur rolin e saj subsidiar për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore. Duke mbajtur në konsideratë që thelbi i së drejtës kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm lidhet me kohëzgjatjen e procedurave, shkak për të cilin ligji procedural ka caktuar afatin e shpejtë 45-ditor për shqyrtimin e kërkesave të tilla nga gjykatat e zakonshme, Gjykata arrin në përfundimin se kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë nuk i përgjigjet mbrojtjes së të drejtës themelore në fjalë, ndaj çmon se duhet ta analizojë ajo vetë themelin e pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

29. Kërkuesja ka pretenduar se çështja e saj po gjykohet përtej afatit të arsyeshëm, gjykimi vazhdon prej më shumë se 9 vjetësh dhe aktualisht

çështja po shqyrtohet për herë të tretë nga Gjykata Administrative e Apelit në intervale të njëjta kohore me çështje të tjera që po shqyrtohen për herë të parë ose të dytë pranë asaj gjykate. Sipas saj, gjykimi është pezulluar për të thirrur në gjykim trashëgimtarët e palëve ndërgjyqëse që kanë ndërruar jetë, pjesëmarrja e të cilëve nuk është detyrim ligjor. Subjekti i interesuar, Arben Çabej, i është bashkuar qëndrimit të kërkueses, duke parashtruar se çështja është kthyer për shqyrtim për herë të tretë në gjykatën e apelit dhe seancat gjyqësore janë caktuar në intervale të gjata kohore.

30. Subjektet e tjera të interesuara, Këshilli i Ministrave MIE-ja, MEKI-ja, Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Gjirokastër, kanë prapësuar se pretendimi i kërkueses është i pabazuar, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka vepruar brenda afateve ligjore, duke zhvilluar seanca çdo muaj, madje edhe dy herë në muaj. Sipas tyre, gjykimi është pezulluar në përputhje me ligjin dhe lidhet me rregullimin e ndërgjyqësisë. Po sipas tyre, kohëzgjatja e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit është rrjedhojë edhe e ngarkesës së punës.

31. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi *(shih vendimet nr. 27, datë 11.04.2024; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Gjykata vëren se çështja e kërkueses është e natyrës administrative dhe ka të bëjë me kundërshtimin e veprimeve të kryera në pronën e kërkueses, si rrjedhojë e zbatimit të një projekti të Bashkisë Gjirokastër, si dhe rivendikimin e pronës ose shpërblimin e saj. Procesi gjyqësor është vënë në lëvizje përmes padisë së paraqitur nga kërkuesja, që është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë në datën 03.11.2014 dhe deri më sot nuk ka ende një zgjidhje përfundimtare nga gjykatat e zakonshme për të gjitha kërkimet e padisë, të cilat kanë ndryshuar gjatë gjykimit. Kështu, kërkimet fillestare të kërkueses për kallëzimin e një punimi të ri dhe për padinë e rivendikimit kanë përfunduar së shqyrtuari me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 23.03.2023. Ndërsa kërkimi për vlerën e pronës, i parashtruar nga kërkuesja në formën e shtesës së objektit të padisë në datën 26.12.2014 dhe nga ndërhyrësit kryesorë (bashkëpronarët e tjerë të pronës) në rigjykimin e çështjes në shkallë të parë, për të cilin Gjykata e Lartë ka kthyer çështjen për rishqyrtim në apel, vijon të jetë në shqyrtim

në gjykatat e zakonshme prej rreth 10 vjetësh. Çështja është regjistruar për herë të tretë në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 07.09.2023 dhe ndonëse ka kaluar rreth 1 vit e 4 muaj, gjykimi në shkallë të dytë për këtë kërkim nuk ka përfunduar.

33. Për sa u takon këtyre fakteve, Gjykata vëren se KPC-ja, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të parë e në apel nga fillimi i tij në secilën shkallë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së) dhe afatin 2-vjeçar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit të çështjeve civile nga Gjykata e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së), i cili gjen zbatim edhe në shqyrtimin e çështjeve administrative.

34. Duke analizuar rrethanat e mësipërme, Gjykata konstaton se gjykimi i çështjes së kërkueses në tërësi ka tejkaluar afatet ligjore, por ajo nuk ka paraqitur kundërshtime për ecurinë e çështjes në shkallët e ndryshme të gjykimit, duke i orientuar ato vetëm për vonesën në gjykimin e fundit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku çështja e saj po shqyrtohet për herë të tretë. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse tejzgjatja e afatit është e paarsyeshme, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkueses; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja *(shih vendimet nr. 65, datë 02.10.2024; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

(i) Sjellja e kërkueses

35. Gjykata vëren se ndonëse kërkesëpadia kishte të bënte me kundërshtimin e veprimeve të organit administrativ, Bashkisë Gjirokastër, ajo e ka paraqitur atë në datën 11.09.2014 në gjykatën e rrethit gjyqësor, e cila ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar aktet gjykatës administrative të shkallës së parë. Kërkuesja ka rekursuar vendimin për shpalljen e moskompetencës në Gjykatën e Lartë dhe kjo e fundit e ka vlerësuar të drejtë atë. Në vijim, çështja është regjistruar në gjykatën administrative. E gjithë procedura, nga momenti i depozitimit të kërkesëpadisë në gjykatën e rrethit deri në regjistrimin e çështjes në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, pas zgjidhjes së kompetencës nga Gjykata e Lartë, ka zgjatur rreth 1 vit e 3 muaj. Për sa u

takon veprimeve të tjera të kërkueses, rezulton se përgjatë procesit gjyqësor ajo ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se sjellja e kërkueses, përmes depozitimit të kërkesëpadisë në gjykatën jokompetente dhe rekursimit të vendimit gjyqësor që i dërgonte çështjen për shqyrtim gjykatës kompetente, ka sjellë një vonesë në kohëzgjatjen tërësore të gjykimit të çështjes së saj, por nuk ka qenë shkak për vonesën në gjykimin që po zhvillohet aktualisht në gjykatën e apelit.

(ii) Kompleksiteti i çështjes

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e këtij kriteri marrin rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

38. Në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se çështja e kërkueses është gjykuar dy herë në shkallë të parë, tre herë në shkallë të dytë dhe një herë në Gjykatën e Lartë. Objekti i padisë së saj ka pasur më tepër se një kërkim, si dhe është ndryshuar prej saj gjatë gjykimit, duke u kërkuar pagesa e vlerës së plotë të pronës me të marrë njoftimin e Bashkisë Gjirokastër se prona do të shpronësohej për interes publik. Po kështu, numri i palëve ndërgjyqëse është rritur vijimësisht dhe aktualisht aty marrin pjesë 2 paditës, 12 ndërhyrës kryesorë, 4 të paditur, 1 ndërhyrës dytësor në mbështetje të paditësve dhe 11 persona të tretë, nga të cilat 3 janë institucione shtetërore. Edhe provat e shqyrtuara kanë qenë të shumta, përfshirë aktet e ekspertimit dhe pyetjet me shkrim të ekspertit. Po ashtu, legjislacioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nuk ka qenë i thjeshtë, pasi përfshinte jo vetëm atë për të drejtat e pronësisë, por edhe ligjet për kompetencat e pushtetit vendor dhe atij qendror. Për tepër, legjislacioni ka pësuar edhe ndryshime gjatë gjykimit, siç ishte hyrja në fuqi e VKM-së nr. 322/2015. Një rrethanë tjetër lidhej edhe me pandeminë COVID-19, që ka ndikuar në ecurinë e çështjes.

39. Më konkretisht, *gjykimi i parë* i çështjes nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, i zhvilluar pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr.

322/2015, ka zgjatur 4 muaj, ndërsa gjykimi i ankimeve të paraqitura prej saj dhe personave të tjerë në Gjykatën Administrative të Apelit rreth 1 vit e 8 muaj. Gjatë gjykimit në shkallë të dytë palët kanë paraqitur kërkesa të ndryshme procedurale. Kërkuesja ka kërkuar kalimin procedural të palëve në proces, ndërsa subjektet e tjera kanë kërkuar thirrjen në gjykim të personave të tretë, si dhe të ndërhyjnë si palë në gjykim. Në përfundim, gjykata e apelit ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në shkallë të parë, duke vlerësuar se gjykata e asaj shkalle duhej të orientonte palën paditëse (përfshirë kërkuesen) në lidhje me ndërgjygjësinë ose të thërriste si persona të tretë në gjykim bashkëpronarët e tjerë dhe Këshillin e Ministrave, nëse objekt i shqyrtimit gjyqësor do të ishte edhe VKM-ja nr. 322/2015.

40. *Gjykimi për herë të dytë* (rigjykim) nga gjykata e shkallës së parë ka zgjatur rreth 1 vit, nga gjykata e apelit rreth 2 vjet e 8 muaj, ndërsa nga Gjykata e Lartë rreth 10 muaj. Në gjykimin në shkallë të parë palët kanë parashtruar kërkesa të ndryshme për shtimin e objektit të padisë, thirrjen në gjykim të personave të tretë, ndërhyrjen si persona të tretë ose si trashëgimtarë, pushimin e gjykimit në lidhje me pozitën e ndërhyrësit dytësor, si dhe pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e një tjetër çështjeje nga Gjykata e Lartë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar të nevojshme kryerjen e ekspertimit vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe topografisë. Në lidhje me gjetjet e aktit të ekspertimit, kërkuesja ka bërë pyetje dhe kërkesa shtesë, të cilave eksperti u ka dhënë përgjigje përmes sqarimeve plotësuese. Në shkallë të dytë vonesa në shqyrtimin e çështjes lidhet edhe me situatën e përgjithshme të krijuar në vend nga pandemia Covid-19. Në përfundim, gjykata e apelit ka vendosur pushimin e gjykimit, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Lartë, duke u kthyer çështja për rigjykim sërish në gjykatën e apelit për sa i përket kërkimit të kërkueses për pagimin e vlerës së plotë të pronës.

41. *Gjykimi për herë të tretë* në gjykatën e apelit ka filluar me regjistrimin e çështjes në datën 07.09.2023. Ajo është rishortuar tre herë për shkak të pranimit të kërkesave për dorëheqje të dy gjyqtarëve të parë të caktuar me short. Gjyqtarja e fundit ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për njoftimin e palëve në proces, duke kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për adresat e disave prej tyre. Në kushtet kur në gjykim është konstatuar se disa nga palët kanë ndërruar jetë, gjykata ka proceduar me kalimin procedural të të drejtave të tyre tek trashëgimtarët. Po kështu, kalimi procedural është bërë nga gjykata edhe për palët në gjykim subjekte publike, të drejtat dhe përgjegjësitë e të cilave u kanë

kaluar organeve të tjera shtetërore. Ndërsa në datën 11.07.2024 gjykata ka konstatuar se një person i tretë (një prej bashkëpronarëve) ka ndërruar jetë dhe për këtë shkak ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në thirrjen e trashëgimtarëve të tij.

42. Për sa i takon vendimit të pezullimit, Gjykata evidenton se nga materialet e çështjes nuk rezulton të ketë një vendim të një gjykate më të lartë që të jetë shprehur se thirrja në gjykim e palëve ndërgjygjëse nga gjykata e apelit është në kundërshtim me parimin e disponibilitetit të padisë. Për këtë arsye, duke mbajtur në konsideratë parimin e subsidiaritetit dhe faktin që çështja është ende në gjykim, vlerëson se argumenti i kërkueses se thirrja e palëve ndërgjyqëse është bërë shkak për vonesën në gjykimin e çështjes nuk qëndron. Po ashtu, në ndryshim nga sa kërkuesja pretendon, Gjykata çmon se vendimi i pezullimit, i cili është një vendim i ndërmjetëm, plotëson standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi në pjesën arsyetuese tregon shkakun ligjor të pezullimit në raport me rrethanat e çështjes, si dhe bazën ligjore të zbatuar.

43. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se nisur nga natyra dhe objekti i padisë, e cila deri në mars të vitit 2023 përmbante 3 kërkime, volumi i konsiderueshëm i legjislacionit dhe ndryshimet e tij, numri i lartë i palëve në proces, kërkesat procedurale të paraqitura prej tyre, kalimet procedurale të kryera nga gjykatat përgjatë procesit, thirrjet në gjykim të subjekteve që për shkak trashëgimie ose ndryshimi përgjegjësie kanë ndërhyrë në të drejtat e subjekteve të mëparshme në gjykim, si dhe njoftimet për gjykimin e palëve që kanë hyrë në të drejtat e subjekteve që kanë ndërruar jetë, çështja paraqitet komplekse në këndvështrimin kushtetues në atë masë që e bën faktor përcaktues të kohëzgjatjes tërësore të gjykimit të çështjes së kërkueses, si dhe të tejzgjatjes së gjykimit aktual në gjykatën e apelit.

(iii) Sjellja e autoriteteve

44. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

45. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se përgjatë procesit gjyqësor gjykatat kanë vepruar në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe nuk rezulton të jenë bërë pengesë në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes. Ato kanë marrë masa për garantimin e të drejtave substanciale dhe procedurale të palëve të përfshira në proces, duke vendosur pa vonesa për kërkesat e paraqitura prej tyre gjatë gjykimit, si dhe duke garantuar pjesëmarrjen e tyre përgjatë procesit.

46. Gjykata vëren, gjithashtu, se Gjykata Administrative e Apelit (ku tashmë është duke u gjykuar çështja e kërkueses) ka informuar me shkrim në datën 26.12.2024 se pranë saj ndodhen për shqyrtim 23.866 çështje, ndërsa ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë. Aktualisht aty po shqyrtohen çështjet e regjistruara në vitin 2018, si dhe çështjet me përshpejtim shqyrtimi për kërkesën e palëve, ndërsa numri i çështjeve në ngarkim të gjyqtares relatore në datën 07.09.2024 ka qenë 2742. Po sipas këtij informacioni, data e ardhshme e seancës gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së kërkueses është caktuar data 30.01.2025.

47. Pavarësisht kësaj ngarkese të lartë pune dhe numrit të ulët të gjyqtarëve, të shkaktuar nga reforma në drejtësi, e cila gjithsesi nuk shkarkon autoritetet shtetërore nga detyrimi për të garantuar të drejtën kushtetuese të individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 27, datë 11.04.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*, Gjykata vëren se pas kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, çështja e kërkueses është marrë në shqyrtim me përparësi nga gjykata e apelit, duke respektuar rregullat e vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së. Ajo ka zhvilluar 9 seanca gjyqësore, të caktuara në intervale kohore të arsyeshme në raport me shkakun e shtyrjes së tyre. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit në datën 11.07.2024, për shkak të ndërrimit jetë të një pale në proces dhe thirrjes në gjykim të personave që kanë ndërhyrë në të drejtat e saj, duke vepruar sipas parashikimeve ligjore me qëllim administrimin e përshtatshëm të drejtësisë. Edhe pas pezullimit, ashtu siç kanë vënë në dukje subjektet e interesuara, gjykata e apelit ka vepruar aktivisht, duke caktuar seancë për të verifikuar ekzistencën e shkakut të pezullimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se sjellja e gjykatave nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e çështjes së kërkueses.

(iv) Rëndësia e asaj që rrezikon kërkuesja

48. Gjykata ka theksuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Kjo do të thotë se

disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë", duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 65, datë 02.10.2024; nr. 67, datë 07.12.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në rastin kur çështja gjyqësore ka në objektin e saj të drejtën e pronës private, Gjykata ka pohuar se përfshihet në listën e çështjeve me interes të rëndësishëm, pasi prona private përbën jo vetëm të drejtë themelore, por edhe një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit *(shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr.1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pjesa e padisë së kërkueses aktualisht për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit ka të bëjë me të drejtën substanciale të pronës. Kështu, në lidhje me kërkimet e saj të ngritura në kërkesëpadi për pagimin e vlerës së plotë të pronës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se Bashkia Gjirokastër, duke mos respektuar ligjin për shpronësimin, ka ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, duke zhveshur kërkuesen (dhe paditësin tjetër) nga posedimi i pronës në kundërshtim me ligjin. Për rrjedhojë, ajo është përgjegjëse për shkeljen e parimit të ligjshmërisë dhe dëmin e shkaktuar kërkueses, ndaj duhet të përgjigjet për zënien e pronës së paluajtshme në mënyrë të paligjshme dhe pasojat që vijnë prej saj *(shih faqen 13, paragrafi 24, të vendimit të Gjykatës së Lartë për çështjen e themelit)*.

50. Në këndvështrim të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, që ka përcaktuar se në gjykimin administrativ kërkimi lidhet me të drejtën substanciale të pronës, Gjykata çmon se interesi i kërkueses për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i rëndësishëm.

51. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjykata çmon se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për detyrimin e nënshkrimit nga mbrojtësi të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, si shkak për kthimin e kërkesës, nuk është në përputhje me Kushtetutën. Si rrjedhojë e atij interpretimi, vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për akses në gjykatë dhe atë për zgjidhje efektive, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së, ndaj duhet shfuqizuar. Po kështu, në vlerësim tërësor të rrethanave të analizuara sipas kritereve kushtetuese përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të

procesit, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i pabazuar, për shkak të kompleksitetit të çështjes, ndaj kërkimi për këtë të drejtë kushtetuese duhet rrëzuar.

52. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses duhet të pranohet pjesërisht (*shih paragrafin 25 të vendimit*), sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2666, datë 26.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.01.2025
Shpallur më 19.02.2025

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkueses Dashmira Zaro, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2666, datë 26.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes. Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin brenda 3 muajve të çështjes me nr. 31154-02296-86-2023*", ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i takon vlerësimit të pretendimit të kërkueses për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes, pasi çmoj se duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës edhe për këtë kërkim.

2. Në çështjen konkrete rezulton se në shtator të vitit 2014 kërkuesja dhe shtetasi Arben Çabej kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për pezullimin e punimeve që kishin nisur të kryheshin në pasurinë e tyre, ndërsa në nëntor të këtij viti kanë paraqitur kërkesëpadi për kallëzimin e një punimi të ri dhe dëmi të mundshëm, detyrimin e Bashkisë Gjirokastër dhe operatorëve ekonomikë "A.L. Asfalt" sh.p.k. dhe "Eral Construksion Company" sh.p.k. (me të cilët është lidhur kontrata për zbatimin e projektit për sistemimin e Parkut të Viroit, rikonstruktimin e rrugës së parkut dhe ndriçimin e trotuarit nga ana e qytetit), të kthejnë pronën e tyre ose të paguajnë vlerën e plotë të saj, si dhe sigurimin e padisë përmes pezullimit të punimeve.

3. Pas vënies në lëvizje të procesit gjyqësor, në prill të vitit 2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 322 për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që prekeshin nga realizimi i projektit në Parkun e Viroit, ndërsa në qershor të vitit 2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka shpallur moskompetencën e saj lëndore për shqyrtimin e padisë, duke ia dërguar aktet për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Vendimi i gjykatës së rrethit për kompetencën është lënë në fuqi me vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datën 08.02.2016. Me vendim të dhënë 4 muaj më vonë, kjo e fundit ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke detyruar Ministrinë e Zhvillimit Urban të shpërblejë kërkuesen dhe bashkëpronarët e tjerë për efekt shpronësimi, sipas pjesëve takuese, ndërsa pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit,

në qershor të vitit 2019, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë. Në shkurt të vitit 2022 gjykata e apelit ka vendosur pushimin e çështjes për të gjitha kërkimet, vendim i cili është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mars të vitit 2023, duke u kthyer çështja sërish për shqyrtim në apel, për sa i përket kërkimit për pagesën e vlerës së plotë të pronës objekt shpronësimi, ku dhe është regjistruar në datën 07.09.2023.

4. Përgjatë këtyre procedurave kërkuesja u është drejtuar gjykatave të zakonshme me kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave. Në lidhje me to, me vendimin e prillit 2018, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës së saj të datës 21.09.2016, të përsëritur në datën 22.02.2017, duke vlerësuar se nga Gjykata Administrative e Apelit, ndaj së cilës ngriheshin pretendimet, ishin ndërmarrë hapat për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes. Po kështu, me vendimin e nëntorit 2019, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare të kërkesës së kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të rekursit të saj nga Gjykata e Lartë, duke vlerësuar se pretendimet ishin haptazi të pabazuara. Në datën 09.01.2024 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të rigjykimit të çështjes tashmë nga Gjykata Administrative e Apelit, ku çështja ishte kthyer për shqyrtim. Në datën 26.02.2024 gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës, me arsyetimin se pavarësisht se kërkuesja kishte marrë dijeni për detyrimin e nënshkrimin të saj nga mbrojtësi dhe shoqërimin me akt përfaqësimi, nuk i kishte plotësuar në kohë këto të meta. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesja përmes ankimit kushtetues individual konkret, në të cilin është pretenduar, krahas shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në tërësi e nga Gjykata Administrative e Apelit në veçanti, edhe cenimi i së drejtës së aksesit dhe së drejtës për mjet juridik efektiv nga Gjykata e Lartë.

5. Për sa u takon këtyre pretendimeve, me të drejtë, shumica ka çmuar si antikushtetues dhe në shkelje të së drejtës së aksesit e së drejtës për zgjidhje efektive interpretimin e ligjit nga Gjykata e Lartë për detyrimin e nënshkrimit nga mbrojtësi të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit. Ashtu si edhe shumica ka vlerësuar, qasja formaliste e mbajtur nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka çuar në mungesën

e efektivitetit të mjeteve juridike të përcaktuara shprehimisht nga ligjvënësi në nenet 399/1 e vijues të KPC-së dhe në shkeljen e nenit 13 të KEDNJ-së *(shih paragrafët 25 dhe 51 të vendimit)*. Megjithatë, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin e kërkueses duhej të ishte vendosur edhe konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi njohja vetëm e shkeljes së të drejtës së kërkueses për akses dhe për zgjidhje efektive pa konstatimin e cenimit të kësaj të drejte do të bënte që garantimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së, të mbetej teorik dhe iluzor dhe jo praktik e efektiv, siç kërkon GJEDNJ-ja.

6. Po kështu, shumica, me të drejtë, ka vlerësuar të shqyrtojë pretendimet e kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, duke konstatuar se çështja vijon të jetë në shqyrtim në gjykatat e zakonshme prej rreth 10 vjetësh dhe se, pas kthimit për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë, ajo është në pritje të një vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit prej më shumë se 1 viti e 4 muajsh, ndërkohë që neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë dhe afatin 2-vjeçar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit të çështjeve civile nga Gjykata e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së), i cili gjen zbatim edhe në shqyrtimin e çështjeve administrative. Në këto rrethana, për të përcaktuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese, shumica ka marrë në analizë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e saj; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja *(shih paragrafët 34-50 të vendimit)*.

7. Shumica ka çmuar se: (i) kërkuesja është bërë pjesërisht shkak për tejzgjatjen e gjykimit si rrjedhojë e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatën jokompetente dhe rekursimit të vendimit të gjykatës për dërgimin e çështjes gjykatës kompetente, ndërsa ka vlerësuar se veprimet e tjera gjatë gjykimit janë kryer prej saj në përputhje me të drejtat procedurale *(shih paragrafët 35-36 të vendimit)*; (ii) nisur nga natyra dhe objekti i padisë, volumi i konsiderueshëm i legjislacionit dhe ndryshimet e tij, numri i palëve në proces, kërkesat procedurale të paraqitura prej tyre, kalimet procedurale të kryera nga gjykatat përgjatë procesit, thirrjet në gjykim të subjekteve që për shkak trashëgimie ose ndryshimi përgjegjësie kanë ndërhyrë në të drejtat e subjekteve të mëparshme në gjykim, si dhe njoftimet për gjykimin e palëve që kanë hyrë në të drejtat e subjekteve që kanë ndërruar jetë, çështja paraqitet komplekse në këndvështrimin kushtetues, në atë

masë që e bën faktor përcaktues të kohëzgjatjes tërësore të gjykimit të çështjes së kërkueses, si dhe të tejzgjatjes së gjykimit aktual në gjykatën e apelit *(shih paragrafët 38-43 të vendimit);* (iii) sjellja e autoriteteve nuk është bërë shkak për kalimin e afatit të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së *(shih paragrafin 47 të vendimit);* (iv) në këndvështrim të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, që ka përcaktuar se në gjykimin administrativ kërkimi lidhet me të drejtën substanciale të pronës, interesi i kërkueses për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm është i rëndësishëm *(shih paragrafin 50 të vendimit)*.

8. Ndërsa bashkohem me shumicën për sa i përket kalimit të afatit të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, pas kthimit të saj nga Gjykata e Lartë, kritereve kushtetuese mbi të cilat ajo ka vlerësuar pretendimin e kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, kompleksitetit të çështjes dhe interesit të kërkueses për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ndaj qëndrim pjesërisht të kundërt me të për sa i përket vlerësimit të kriterit të *"sjelljes së kërkueses"*, ndërsa të kundërt për sa i përket vlerësimit të kriterit të *"sjelljes së autoriteteve"*.

9. Kështu, në lidhje me kriterin e *"sjelljes së kërkueses"*, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket faktit se gjatë gjykimit kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, por nuk bie dakord me të për sa i përket qëndrimit se ajo është bërë pjesërisht shkak për tejzgjatjen e gjykimit si rrjedhojë e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatën jokompetente dhe rekursimit të vendimit të gjykatës për dërgimin e çështjes gjykatës kompetente. Në kundërshtim nga sa shumica arsyeton, përdorimi i mjeteve juridike në dispozicion përmes paraqitjes së kërkesëpadisë nga kërkuesja, ndonëse jo në gjykatën kompetente, ka pasur si qëllim zgjidhjen e çështjes për të cilën ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor dhe nuk ka synuar abuzimin me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për qëllime të zgjatjes në kohë të këtij procesi.

10. Për sa i përket kriterit të *"sjelljes së autoriteteve"*, shumica ka marrë në analizë informacionin e dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit në lidhje me çështjet për shqyrtim përpara saj në raport me numrin e gjyqtarëve, çështjet për shqyrtim nga gjyqtarja relatore dhe numrin e seancave të zhvilluara prej saj për çështjen e kërkueses. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se sjellja e autoriteteve nuk është bërë shkak për kalimin e afatit të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së, ndërkohë që është ndalur në vlerësimin e kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes në secilën gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, pa marrë në analizë

vendimin e gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Lartë për kthimin kërkueses të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave nga Gjykata Administrative e Apelit. Në ndryshim nga shumica, çmoj se në rastin e kërkueses qasja tejet formaliste dhe në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese *(shih vendimet nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)* që ky gjyqtar ka mbajtur përmes vendimit të datës 26.02.2024, ka ndikuar në tejzgjatjen e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, duke bërë që mjeti juridik i konsideruar efektiv nga ligjvënësi të ndikojë në tejzgjatjen e procesit gjyqësor, duke çuar edhe në vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues për zgjidhjen e çështjes.

11. Në këndvështrim të sa më sipër, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se sjellja e autoriteteve nuk ka qenë në nivelin e duhur për sa i përket eficiencës së gjykimit. Kjo për shkak se, në zbatim të dispozitave të KPC-së që rregullojnë paraqitjen e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, ishte detyrë e Gjykatës së Lartë t'i garantonte kërkueses mjetet juridike efektive të përcaktuara në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, duke marrë në shqyrtim, analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në lidhje me pretendimet e ngritura prej saj në kërkesën drejtuar kësaj gjykate në datën 09.01.2024.

12. Po kështu, ashtu, si shumica ka pranuar, nisur nga natyra e kërkimeve të kërkueses në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën subjektive të pronës, interesi i kërkueses në çështje është i lartë. Megjithatë, krahas këtij fakti, një faktor tjetër që Gjykata duhej të kishte marrë në konsideratë në rastin konkret, ashtu siç ajo ka vlerësuar edhe në raste të mëparshme *(shih vendimin nr. 25, datë 11.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese),* është edhe mosha e kërkueses, e cila rezulton të jetë 77 vjeçe, ndaj edhe në këtë aspekt, tejzgjatja e procedurave gjyqësore paraqet rrezik për realizimin në kohë prej saj të së drejtës së pronës.

13. Në përfundim, bazuar në argumentet e mësipërme, duke pasur parasysh sjelljen e kërkueses dhe moshën e saj, si dhe sjelljen e autoriteteve, vlerësoj se krahas shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të së drejtës së kërkueses për akses në atë gjykatë dhe për mjete juridike efektive, Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin edhe të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit.

Anëtare: Sonila Bejtja

Vendim nr. 3, datë 21.01.2025
(V-3/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 24.09.2024, 07.10.2024 dhe 21.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (F) 2024, që u përket:

KËRKUES: **FLORION BREGASI,** përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë të posaçme.
SADETE TOPI, FATBARDHA SHPENDI, LAVDIJE KETA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
ZANA BREGASI, VIOLETA KOÇI (EGRO), MERITA VELEDI (EGRO), ARBEN EGRO, AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONËS, **AVOKATURA E SHTETIT,** përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3707 (537), datë 27.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 18, 33, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit si përfaqësuese e Agjencisë së Trajtimit të Pronës *(ATP)*, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara Zana Bregasi, Violeta Koçi (Egro), Merita Veledi (Egro) dhe Arben Egro, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Florion Bregasi është një nga trashëgimtarët e nënës së tij, S.B. Kjo e fundit sikundër edhe kërkueset Sadete Topi, Fatbardha Shpendi dhe Lavdije Keta, por edhe shtetasja N.G., janë disa nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasit M.A.

2. Mbi kërkesën e trashëgimtarëve ligjorë të M.A., me vendimin nr. 347, datë 24.09.2008 *(vendimi nr. 347/2008)*, Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(ZRKKP)* Vlorë ka vendosur njohjen e së drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve të M.A., kthimin atyre në natyrë të sipërfaqes 203.800 m^2 brenda sipërfaqes së njohur, si dhe kompensimin për pjesën tjetër prej 137.200 m^2, të shndërruar në tokë bujqësore dhe të ndarë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën".

3. Vendimi nr. 347/2008 i ZRKKP-së, Vlorë është shqyrtuar kryesisht nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës *(AKKP),* bazuar në nenet 16, pika 1, shkronja "ç" dhe 18, pika 1, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar *(ligji nr. 9235/2004)* dhe me vendimin nr. 3844/6, datë 20.10.2009 ai ka vendosur shfuqizimin e vendimit të ZRKKP-së, Vlorë dhe kthimin asaj të çështjes për rishqyrtim, me qëllim pozicionimin e saktë të pronës nga trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar dhe argumentimin e saktë të vendndodhjes së saj e të mënyrës së konvertimit të sipërfaqes *300 vreten* në *360.000 m^2*. Çështja në vijim nuk është rishqyrtuar as nga

ZRKKP-ja, Vlorë, as nga AKKP-ja, pas suprimimit të zyrave rajonale në qarqe me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 *(ligji nr. 10207/2009)*.

4. Në datën 26.07.2013 kërkueset Sadete Topi, Fatbardha Shpendi dhe Lavdije Keta, si dhe shtetaset S.B. (trashëgimlënësja e kërkuesit Florion Bregasi) dhe N.G., si trashëgimtare ligjore të M.A., i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 3844/6, datë 20.10.2009 të AKKP-së, duke pretenduar se ai është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore referuar nenit 116, shkronja "b", të Kodit të Procedurave Administrative (ligjit të kohës nr. 8485, datë 12.05.1999), duke iu referuar për këtë edhe vendimit nr. 27, datë 26.05.2010 *(vendimi nr. 27/2010)* të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* i cili, sipas tyre, kishte fuqi edhe në rastin konkret.

5. Me vendimin nr. 904, datë 27.01.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 3844/6, datë 20.10.2009 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, duke vlerësuar se ky vendim është marrë në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ndërsa ka cenuar një vendim të një organi *quasi* gjyqësor të formës së prerë, duke u bazuar në nenin 16, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 9235/2004, që është shfuqizuar me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës, vendim ky që ka efekte edhe për rregullimin e konfliktit në rastin konkret referuar nenit 76, pika 2, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë çështja e pronës nuk është shqyrtuar ende.

6. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim pala e paditur, AKKP-ja, e cila ka pretenduar se vendimi i drejtorit të saj të përgjithshëm është marrë në përputhje me kompetencën që ligji i kohës i njihte dhe se vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk kishte efekt prapaveprues në rastin konkret, pasi ka dalë pas vendimit të drejtorit të saj të përgjithshëm në rastin konkret. Mbi këtë ankim, me vendimin nr. 3392, datë 14.10.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të njëjtën linjë arsyetimi.

7. Vendimi i gjykatës së apelit është kundërshtuar sërish me rekurs nga pala e paditur, AKKP-ja dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3707 (537), datë 27.09.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë së kërkuesve.

8. Në datën 25.01.2024 kërkuesi Florion Bregasi, trashëgimtar ligjor i paditëses S.B. në procesin gjyqësor si më lart, i është drejtuar Gjykatës me

ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë. Po kështu, në datën 26.01.2024, kërkueset Sadete Topi, Fatbardha Shpendi dhe Lavdije Keta i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë me të njëjtin objekt. Me vendimin e datës 05.04.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur bashkimin e çështjeve, bazuar në nenin 1, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 8577/2000, nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* dhe nenin 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, si dhe kalimin e tyre për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Fillimisht, seanca plenare për shqyrtimin e çështjes është caktuar në datën 24.09.2024, por për arsye të dorëheqjes nga funksioni të gjyqtares relatore, zhvillimi i saj është shtyrë për në datën 07.10.2024. Në këtë datë Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës për të kërkuar informacion nga organet shtetërore.

9. Nga materialet e paraqitura dhe procedura e njoftimit të palëve në gjykim, Gjykata konstatoi se krahas kërkuesit Florion Bregasi, paditësja S.B. në procesin gjyqësor të kundërshtuar ka lënë si trashëgimtarë ligjorë edhe shtetasit Zana Bregasi dhe V.B., ndërsa ky i fundit ka ndërruar jetë në datën 02.01.2023. Në këto kushte, Gjykata thirri në gjykim si subjekt të interesuar shtetasen Zana Bregasi. Po ashtu, Gjykata konstatoi se edhe shtetasja N.G., gjithashtu palë paditëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ka ndërruar jetë, duke lënë pas fëmijët Violeta Koçi (Egro), Merita Veledi (Egro) dhe Arben Egro. Sipas informacionit të noterit H.Z., e ndjera ka lenë testament pranë zyrës së tij noteriale, por nuk është vijuar me lëshimin e dëshmisë testamentare. Në këto kushte, Gjykata ka kërkuar aktin e çeljes së trashëgimisë nga trashëgimtarët e saj dhe në vijim, në mungesë të paraqitjes së këtij akti, ajo u ka kërkuar palëve mendim në lidhje me personat që duhet të thirreshin në gjykim si subjekte të interesuara në vend të së ndjerës N.G. Mbrojtësi i kësaj të fundit gjatë procesit gjyqësor, njëherazi edhe i kërkuesve, përfshirë edhe në këtë Gjykatë, parashtroi se ka njoftuar fëmijët e së ndjerës për mundësinë e zëvendësimit procedural dhe nevojën për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Megjithatë, u shpreh ai, gjykimi në këtë Gjykatë mund të vazhdojë pa thirrur në gjykim trashëgimtarët e së ndjerës, pjesëmarrja e të cilëve nuk ndikon në zgjidhjen e saj, në kushtet kur çështja është paraqitur nga kërkuesit, të cilët tërheqin të njëjtat interesa me të ndjerën N.G. Në vijim, Gjykatës nuk iu paraqit dëshmia e trashëgimisë të së ndjerës.

10. Në rrethanat e mësipërme, ndërsa trashëgimtarët e mundshëm të së ndjerës N.G., fëmijët e saj, kanë marrë dijeni për gjykimin kushtetues të

çështjes, si personalisht, ashtu edhe përmes përfaqësuesit ligjor të nënës së tyre, si dhe nisur nga fakti se Gjykatës nuk iu vu në dispozicion ndonjë dokument që përcaktonte kalimin e të drejtave të së ndjerës, Gjykata vijoi gjykimin e çështjes, duke legjitimuar fëmijët e saj si palë në gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara.

11. Po kështu, Gjykata vëren se, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës", Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është transformuar në Agjencinë e Trajtimit të Pronës. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emërtimet e këtij institucioni janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës kur janë kryer veprimet dhe janë marrë vendimet përkatëse.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se u janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

12.1.1. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, ndonëse gjykatë ligji, Gjykata e Lartë ka vlerësuar provat shkresore të administruara në gjykim dhe shkaqet përse drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka shfuqizuar e kthyer çështjen për rishqyrtim në ZRKKP-në, Vlorë. Në tejkalim të parashikimeve të nenit 16 të KPC-së, kjo gjykatë ka arsyetuar se paditësve u ka kaluar afati ligjor për kundërshtimin gjyqësisht të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, ndërkohë që duhej të shprehej dhe të dispononte nëse ekzistonin shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Po kështu, në cenim të nenit 6 të KPC-së, Gjykata e Lartë ka arsyetuar për mangësitë e hetimit administrativ të ZVRPP-së, Vlorë pa qenë pretenduar një gjë e tillë nga palët në proces.

12.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, për shkak se:

12.1.2.1. Rekursi i AKKP-së është depozituar tej afatit ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 476, pika 1, i KPC-së. AKKP-ja ka qenë e pranishme në shpalljen e vendimit nga gjykata e apelit, çka do të thotë se ka

marrë njoftim për vendimin e kësaj gjykate në datën 14.10.2014 të shpalljes së tij. Vendimi i gjykatës së apelit përbënte *res judicata,* për rrjedhojë pranimi i rekursit të paraqitur jashtë afatit ligjor ka cenuar parimin e sigurisë juridike.

12.1.2.2. Vendimi i ZRKKP-së, Vlorë ka marrë formë të prerë pa u ankimuar brenda afatit, duke u shndërruar në titull ekzekutiv, ndërsa vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e këtij vendimi, ndryshe nga sa ka pranuar Gjykata e Lartë, është marrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, pasi: *(i)* shqyrtimi kryesisht i vendimit të ZRKKP-së, Vlorë është bërë në kapërcim të afatit të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar me ligjin nr. 9684, datë 06.02.2007 *(ligji nr. 9684/2007)*, i cili parashikonte afatin 30-ditor si për ankimin e vendimit të ZRKKP-së, ashtu edhe për shqyrtimin kryesisht të këtij vendimi nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së. Në rastin e tyre, vendimi i drejtorit të përgjithshëm është dhënë pas rreth një viti nga vendimi i ZRKKP-së, Vlorë; *(ii)* disponimi për kthimin e çështjes për rishqyrtim në ZRKKP-në, Vlorë është në kundërshtim me ligjin e kohës, referuar të cilit drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ose duhet të linte në fuqi vendimin e ZRKKP-së ose të zgjidhte vetë në themel çështjen; *(iii)* shqyrtimi kryesisht i vendimit të ZRKKP-së, Vlorë vjen në kundërshtim me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës, sipas të cilit vendimet e KKKP-ve, funksionet e të cilave u transferuan në ZKKP-të në qarqe, merrnin formë të prerë nëse nuk ankimoheshin brenda afateve ligjore. Vendimi i ZRKKP-së, Vlorë kishte natyrën e një vendimi *quasi* gjyqësor, për rrjedhojë vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e tij, i marrë pas kalimit të afatit ligjor, përbën akt absolutisht të pavlefshëm. Gjykata e Lartë, duke konsideruar të ligjshëm vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, u ka cenuar kërkuesve të drejtën e pronës.

12.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi konkluzioni i Gjykatës së Lartë se afati i kundërshtimit gjyqësisht të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së kishte kaluar, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe praktikës gjyqësore. Edhe arsyetimi i kësaj gjykate se në rastin konkret nuk gjen zbatim efekti prapaveprues i vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës është i pabazuar dhe në interpretim të gabuar të ligjit. Deri në momentin që gjykata e apelit është shprehur në themel, nuk ka pasur vendimmarrje të AKKP-së për çështjen, çka përligj qëndrimin e gjykatës së rrethit dhe të apelit se plotësoheshin kriteret e fuqisë prapavepruese të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë se vendimet gjyqësore që kanë pranuar padinë i kanë hequr, pa shkak, mundësinë AKKP-së për t'u shprehur konform detyrës funksionale, është i pabazuar në ligj dhe në vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës. ZRKKP-të nuk funksionojnë më, pasi janë suprimuar, ndërkohë që AKKP-ja nuk e ka shqyrtuar ende çështjen, edhe pse kanë kaluar vite. Arsyetimi i kësaj gjykate se kërkueseve u mungon legjitimiteti aktiv substancial për të investuar gjykatën ose organin administrativ, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004 dhe vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës.

12.2. *Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës,* pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të kundërt me vendimin e Gjykatës lidhur me pavlefshmërinë e akteve administrative të AKKP-së, që kanë prishur vendimet e formës së prerë të ZRKKP-ve, duke i quajtur ato të ligjshme.

13. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, si përfaqësuese e subjektit të interesuar, ATP-së,*** ka prapësuar se:

13.1. Pretendimet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike,* si rrjedhojë e paraqitjes së rekursit të AKKP-së tej afatit ligjor 30-ditor, janë të pabazuara. Rekursi është dërguar në rrugë postare në datën 13.11.2013 dhe është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.11.2013, pra brenda afatit ligjor 30-ditor. Po kështu, edhe pretendimet se vendimi i ZRKKP-së, Vlorë përbënte titull ekzekutiv dhe për pavlefshmërinë absolute të vendimit të

drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së janë të pabazuara. Procesi administrativ është iniciuar nga AKKP-ja brenda afatit ligjor, përmes kërkimit të dosjes gjyqësore me shkresën nr. 3844/1 prot., datë 02.10.2008 të saj, dhe vendimmarrja e këtij organi është konform ligjit të kohës.

13.2. Në kundërshtim nga sa kërkuesit pretendojnë, kontrolli i Gjykatës së Lartë është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar prova të reja, por, në gjendjen që kanë qenë aktet, ka vendosur përfundimisht për çështje thelbësore, lidhur me mungesën e legjitimitetit aktiv substancial për të investuar gjykatën. Kërkueset kanë marrë dijeni për vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së me shkresën nr. 3844/6, datë 20.01.2009, pra kohë përpara datës së paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë. Për rrjedhojë, pretendimet për cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara.

13.3. Vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatës së apelit, pretendimet e ngritura në rekurs nga AKKP-ja, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, në të cilën u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, duke u shprehur edhe në lidhje me veprimtarinë e organit administrativ. Në këto kushte, ai përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, për rrjedhojë edhe pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë, gjithashtu, të pabazuara.

13.4. Përfundimi i arritur nga Gjykata e Lartë lidhur me efektet e fuqisë prapavepruese të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndaj edhe pretendimet e kërkuesve për cenimin e *standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës* janë të pabazuara. Ligji i shfuqizuar nga Gjykata nuk ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së vendimit nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së.

14. ***Subjektet e interesuara Zana Bregasi, Violeta Koçi (Egro), Merita Veledi (Egro) dhe Arben Egro*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, ndonëse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

15. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata vëren se Sadete Topi, Fatbardha Shpendi dhe Lavdije Keta kanë qenë palë ndërgjyqëse në çështjen objekt ankimi kushtetues individual, ndërsa Florion Bregasi është trashëgimtar i shtetases S.B., e cila ka qenë, gjithashtu, palë në këtë proces. Si të tillë, ata legjitimohen *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme të gjykimit, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 50, datë 20.06.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 31, datë 03.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, për shfuqizimin e vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, është marrë në kapërcim të kompetencave

të tij ligjore, pasi: *(i)* shqyrtimi kryesisht i vendimit të ZRKKP-së, Vlorë është bërë në kapërcim të afatit 30-ditor të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 9235/2004, ndërsa vendimi i tij është dhënë pas rreth një viti nga vendimi i ZRKKP-së, Vlorë; *(ii)* disponimi për kthimin e çështjes për rishqyrtim në ZRKKP-në, Vlorë është në kundërshtim me ligjin e kohës, referuar të cilit drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ose duhet të linte në fuqi vendimin e ZRKKP-së ose të zgjidhte vetë në themel çështjen. Për sa u takon këtyre argumenteve në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se ato nuk janë paraqitur dhe nuk janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, duke u parashtruar nga kërkuesit vetëm përpara saj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve për këto argumente nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual pasi janë ankuar në rrugë gjyqësore ndaj vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së. Nisur nga fakti se Gjykata e Lartë ka disponuar në lidhje me vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta që kanë pranuar padinë e tyre, duke vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve dhe rrëzimin e padisë, Gjykata çmon se kërkuesit i kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për pretendimet ndaj vendimit administrativ të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së dhe vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë.

20. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.09.2023, ndërsa kërkesat janë paraqitur në këtë Gjykatë në datat 25.01.2024 dhe 26.01.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

21. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Duke pasur parasysh se argumentet në themel të tyre parashtrohen në drejtim të vlerësimit të provave nga Gjykata e Lartë, zbatimit të gabuar të ligjit nr. 9235/2004 nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, si dhe interpretimit e zbatimit të gabuar të ligjit, praktikës gjyqësore e vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon t'i analizojë ato në vijim në kuadër të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

22. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka vlerësuar provat shkresore të administruara në gjykim dhe shkaqet përse drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka shfuqizuar dhe kthyer çështjen për rishqyrtim në ZRKKP-në, Vlorë. Në tejkalim të parashikimeve të nenit 16 të KPC-së, ajo ka arsyetuar se paditësve u kishte kaluar afati ligjor për kundërshtimin gjyqësisht të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së dhe se atyre u mungonte legjitimiteti aktiv substancial, ndërkohë që duhej të shprehej dhe të dispononte nëse ekzistonin shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Po sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë ka arsyetuar për mangësitë e hetimit administrativ të ZVRPP-së, Vlorë, pa qenë pretenduar një gjë e tillë nga palët në proces. Ajo është shprehur se vendimet gjyqësore që kanë pranuar padinë i kanë hequr, pa shkak, mundësinë AKKP-së për t'u shprehur konform detyrës funksionale, ndërkohë që AKKP-ja nuk e ka shqyrtuar ende çështjen, edhe pse kanë kaluar vite.

23. Subjekti i interesuar, ATP-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj janë të pabazuara. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar prova të reja, por, në gjendjen që kanë qenë aktet, ka vendosur përfundimisht për çështje thelbësore lidhur me mungesën e legjitimitetit aktiv substancial për të investuar gjykatën. Kërkueset kanë marrë dijeni për vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së kohë përpara datës së paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë.

24. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas nenit 141, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"*. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin

juridik *(shih vendimet nr. 36, datë 30.04.2024; nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit. Procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta *(shih vendimet nr. 36, datë 30.04.2024; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në këndvështrim të jurisprudencës së mësipërme kushtetuese, Gjykata do të shqyrtojë në vijim nëse pretendimet e kërkuesve për cenimin nga Gjykata e Lartë të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj janë ose jo të bazuara në këndvështrimin kushtetues. Për këtë qëllim Gjykata do të analizojë vendimin e kësaj gjykate në raport me vendimet e gjykatave të faktit, për të përcaktuar nëse Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve nga gjykatat më të ulëta, si dhe nëse ajo ka vepruar ose jo brenda kompetencave të saj si gjykatë ligji.

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së kërkueseve dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 3844/6, datë 20.10.2009 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, me arsyetimin se ky vendim është marrë në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ndërsa ka cenuar një vendim të një organi *quasi* gjyqësor të formës së prerë, duke u bazuar në nenin 16, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 9235/2004, që është shfuqizuar me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës, vendim ky që ka efekte edhe për rregullimin e konfliktit në rastin konkret

referuar nenit 76, pika 2, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë çështja e pronës nuk është shqyrtuar ende. Ndërkohë, gjykata e apelit ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit për sa i përket arsyetimit të kësaj të fundit për kapërcimin nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së të kompetencave të njohura me ligj dhe efektet prapavepruese të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, referuar nenit 76, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

29. Vendimi i gjykatës së apelit është kundërshtuar me rekurs nga AKKP-ja, e cila ka pretenduar se vendimi i drejtorit të saj të përgjithshëm është marrë në përputhje me kompetencën që ligji i kohës i njihte dhe se vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk kishte efekt prapaveprues në rastin konkret, pasi ka dalë pas vendimit të drejtorit të saj të përgjithshëm në rastin konkret.

30. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimet e gjykatave më të ulëta janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit. Sipas tij, padia në rastin konkret synon të bëj nul një vendim të drejtorit të përgjithshëm i AKKP-së, i cili në marrjen e atij vendimi ka vepruar konform kompetencave të dhëna nga ligji i posaçëm i kohës. Vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi ai ka dalë jo vetëm pas ushtrimit të nismës nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, por edhe pas vendimmarrjes së tij. Sipas Kolegjit Civil, nuk jemi para rasti të parashikuar në nenin 76, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, për efektet prapavepruese të vendimit të Gjykatës, pasi padia e kërkuesve është dorëzuar në gjykatë në datën 26.07.2013. Po sipas tij, nuk jemi as para rastit të parashikuar nga shkronja "c" e kësaj dispozite, pasi vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së i ka prodhuar pasojat e tij dhe çështja vijon të jetë në juridiksionin administrativ, ndaj gjykatat nuk mund të ndërhyjnë ende. Krahas kësaj, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar edhe se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së jo vetëm nuk paraqet pavlefshmëri absolute, por as pavlefshmëri relative, gjë e cila nuk është kundërshtuar nga palët brenda afatit ligjor. Po sipas tij, siç është konstatuar në vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, hetimi administrativ nga ZRKKP-ja, Vlorë ka qenë i mangët, mangësi e cila e bën të pavlefshëm vendimin e saj.

31. Në analizë të vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se ajo gjykatë nuk ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve të pranuara nga gjykatat më të ulëta, por, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, të përcaktuara në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës, ka vendosur të ndryshojë vendimet e tyre dhe ta zgjidhë vetë çështjen në themel vetëm për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit nga ato dhe konkretisht

të ligjit nr. 9235/2004 dhe të ligjit nr. 8577/2000 në lidhje me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës. Vlen të përmendet se, megjithëse pranon se objekt gjykimi ka qenë pretendimi për pavlefshmërinë absolute të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Gjykata e Lartë është shprehur se ky vendim nuk është i prekur as nga pavlefshmëria relative, gjë e cila, sipas saj, nuk është kundërshtuar brenda afatit ligjor. Dhe po ashtu, ajo gjykatë është shprehur edhe për pavlefshmërinë e vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, të konstatuar nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së. Gjykata vlerëson se këto konstatime të Gjykatës së Lartë, pavarësisht se nuk kanë qenë relevante për gjykimin, nuk kanë pasur asnjë rëndësi dhe ndikim për përfundimet e arritura për themelin e çështjes dhe për sa i përket zbatimit të ligjit dhe, në këtë kuptim, për vendimmarrjen e asaj gjykate. Vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka evidentuar në vendimin e saj konstatime për fakte të parëndësishme për çështjen dhe vendimmarrjen e saj, nuk mund të çojë në përfundimin se ajo ka vepruar në kapërcim të kompetencave të saj. Bazuar në këto konsiderata, në kundërshtim nga sa kërkuesit pretendojnë, Gjykata vlerëson se kontrolli i Gjykatës së Lartë është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, ndaj çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk janë të bazuara.

B.2. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit

32. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të paraqitjes së rekursit të AKKP-së tej afatit ligjor 30-ditor, si dhe për shkak të vendimmarrjes së drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, i cili ishte shndërruar në titull ekzekutiv, pasi nuk ishte ankimuar nga palët. Po sipas kërkuesve, arsyetimi i Gjykatës së Lartë se në rastin e tyre nuk gjente zbatim vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit e praktikës gjyqësore dhe vjen në kundërshtim me vendimin e Gjykatës lidhur me pavlefshmërinë administrative të akteve të AKKP-së, që kanë prishur vendimet e formës së prerë të ZRKKP-ve.

33. Subjekti i interesuar, ATP-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* janë të pabazuara, pasi rekursi është depozituar brenda afatit ligjor. Po kështu, vendimi i ZRKKP-së, Vlorë nuk përbënte titull ekzekutiv, pasi procesi administrativ është iniciuar nga AKKP-ja brenda afatit ligjor, përmes kërkimit të dosjes gjyqësore

me shkresën nr. 3844/1 prot., datë 02.10.2008 të saj dhe vendimmarrja e këtij organi është konform ligjit të kohës. Po sipas ATP-së, përfundimi i arritur nga Gjykata e Lartë lidhur me efektet e fuqisë prapavepruese të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës është i drejtë e i bazuar në ligj, pasi ligji i shfuqizuar nga Gjykata nuk ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së vendimit nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së. Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs dhe vendimi i saj është në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

34. Në funksion të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i afateve ligjore nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, pasi mospërcaktimi i tyre do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 29, datë 15.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*. Respektimi i afatit ligjor garanton, mes të tjerash, qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si edhe besueshmërinë e individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin *(shih vendimet nr. 62, datë 31.07.2017; nr. 2, datë 29.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

35. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka për qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje *(shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 14, datë 27.02.2017; nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kushtetuese, Gjykata e ka analizuar sigurinë juridike të lidhur edhe me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të saj nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 17, datë 10.04.2015; nr. 5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa u takon vendimeve të saj, Gjykata ka theksuar se ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit *(shih vendimet nr. 20, datë 05.04.2023; nr. 44, datë 29.06.2015; nr. 5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese)*.

36. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimet nr. 41, datë 29.05.2024; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

37. Sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike parashtrohen në dy drejtime, konkretisht: *(i)* paraqitjes së rekursit jashtë afatit ligjor 30-ditor dhe *(ii)* qëndrimit të Gjykatës së Lartë lidhur me vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, i cili, sipas tyre, kishte marrë formë të prerë, duke u shndërruar në titull ekzekutiv. Gjykata çmon të analizojë në vijim këto pretendime në kuadër të parashikimeve të KPC-së në lidhje me afatin e paraqitjes së rekursit përkundrejt të dhënave që kanë rezultuar gjatë gjykimit kushtetues, si dhe rregullimeve të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave në fuqi në datën e vendimit të kundërshtuar të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së në raport me arsyetimin e Gjykatës së Lartë për efektet e vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, që shfuqizoi si antikushtetuese kompetencën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin kryesisht të vendimeve të zyrave rajonale.

39. Për sa i takon pretendimit për paraqitjen e rekursit jashtë afatit ligjor 30-ditor, Gjykata vëren se ky afat parashikohej nga neni 443 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në fuqi në kohën e depozitimit të rekursit nga AKKP-ja. Po kështu, Gjykata evidenton se vendimi nr. 3392 i Gjykatës

së Apelit Tiranë për çështjen mban datën 14.10.2014, ndërsa sipas informacionit të Avokaturës së Shtetit të vënë në dispozicion të Gjykatës me shkresën nr. 2502/5 prot., datë 17.10.2024 dhe kopjes së librit të postës, rezulton se rekursi i AKKP-së është depozituar në shërbimin postar në datën 13.11.2014, referuar vulës datare të postës, pra brenda afatit ligjor. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të depozitimit të rekursit jashtë afatit ligjor nga AKKP-ja, janë të pabazuara.

40. Gjykata evidenton se ligji nr. 9235/2004, sipas përmbajtjes së tij në momentin e ushtrimit të nismës për shqyrtimin kryesisht dhe të marrjes së vendimit nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së në rastin konkret, pra në periudhën tetor 2008 - tetor 2009, parashikonte se vendimet e zyrave rajonale në qarqe për njohjen e së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale, mund të ankimoheshin nga subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në zyrën e AKKP-së në qendër *(neni 18, pika 1)* dhe nëse nuk ankimoheshin ose nuk shqyrtoheshin nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbënin titull ekzekutiv *(neni 16, pika 3).* Nga ana tjetër, zyra e AKKP-së në qendër kishte edhe përgjegjësinë për shqyrtimin, me nismën e vet, të vendimeve të dhëna nga zyrat rajonale në qarqe *(neni 16, pika 1, shkronja "ç"),* ndërkohë që drejtori i përgjithshëm i AKKP-së kishte të drejtë të shqyrtonte kryesisht, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark, ku pas shqyrtimit kryesisht ai vendoste lënien në fuqi të vendimit, shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij ose kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së *(neni 18, pika 1).*

41. Gjykata evidenton, gjithashtu, se me vendimin e saj nr. 27/2010 është vendosur shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i neneve 15, pika 1, shkronja "c", "ç", "d" dhe "dh", si dhe 16 të ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar me ligjin nr. 10207/2009, dispozita të cilat mbartin të njëjtat probleme me ato të neneve 16 dhe 18 para ndryshimeve të tyre. Vendimi i Gjykatës ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 81, datë 05.07.2010.

42. Me vendimin nr. 27/2010, Gjykata, ndër të tjera, ka shfuqizuar edhe dispozitat ligjore për kompetencën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shqyrtimin, me nismën e vet, pa ankim nga palët, të vendimeve të zyrave rajonale për kthimin dhe kompensimin e pronave, me arsyetimin

se cenonin parimin e sigurisë juridike, i cili garanton individin se një marrëdhënie juridike e përcaktuar nga një vendim i formës së prerë është e pandryshueshme (*shih paragrafin 44*). Gjykata ka vërejtur se organet e kthimit dhe kompensimit të pronës shprehen për njohjen e së drejtës subjektive të pronës, ndaj vendimet e tyre janë akte *sui generis*, ndërsa vetë ato janë quajtur nga GJEDNJ-ja me termin *quasi gjykatë* (*shih paragrafin 46*). Në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës nuk zbatohen parimet e revokimit dhe shfuqizimit të akteve të organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës, pasi mungon interesi publik, përveçse ato organe dhe aktet e tyre nuk janë tipike administrative (*shih paragrafin 52*). Individi mund t'i drejtohet AKKP-së në rrugë administrative dhe pas konsumimit të saj, mund të vërë në lëvizje gjykatën e zakonshme për të kundërshtuar vendimin përfundimtar të organit administrativ (*shih paragrafin 53*). Vendimet e paankimuara të organeve të kthimit dhe kompensimit të pronës konsiderohen të formës së prerë dhe të ekzekutueshme (*shih paragrafin 56*), ndaj ato nuk mund të vihen në diskutim as nga palët në proces, as nga organet shtetërore të çfarëdo natyre qofshin. Nëse vendimeve të gjykatave apo atyre të organeve *quasi gjyqësore* do t'u hiqej efekti i sigurisë juridike nga cilido qoftë, nuk mund të flitej më për pushtet gjyqësor, pasi vendimi do të kishte vetëm fuqi deklarative (*shih paragrafin 57*).

43. Në analizë të materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se as kërkuesit dhe as Avokatura e Shtetit nuk kanë ushtruar ankim kundër vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, sipas së drejtës së njohur nga neni 18, pika 1, i ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar. Ndërkohë, me shkresën nr. 3844/1 prot., datë 02.10.2008, brenda afatit ligjor 30-ditor për shqyrtimin kryesisht të vendimit të ZRKKP-së, AKKP-ja ka tërhequr dosjen e kërkuesve, ndërsa me shkresën nr. 3844/9, datë 20.10.2009, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka njoftuar shtetasin A.A. (përfaqësuesi me prokurë i trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar) për vendimin e tij nr. 3844/6, datë 20.10.2009, si dhe për të drejtën e ushtrimit të ankimit në rrugë gjyqësore.

44. Në datën 26.07.2013 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së. Kjo gjykatë ka çmuar të drejta pretendimet e ngritura nga kërkueset, duke vlerësuar se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin me nismë të vendimit të ZRKKP-së, Vlorë është marrë në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ndërsa ka cenuar një vendim të një organi *quasi* gjyqësor të

formës së prerë referuar për këtë jurisprudencës së GJEDNJ-së në çështjen *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë* dhe vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, duke u bazuar në nenin 16, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 9235/2004, që është shfuqizuar me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës, vendim ky që ka efekte edhe për rregullimin e konfliktit në rastin konkret referuar nenit 76, pika 2, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë çështja e pronës nuk është shqyrtuar ende.

45. Bazuar në ankimin e AKKP-së, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë të drejtë dhe të bazuar në ligj. Sipas gjykatës së apelit, vendimi objekt gjykimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak se është marrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, ndërsa me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës janë shfuqizuar dispozitat e ligjit nr. 9235/2004 që i njihnin atij kompetencën për të shqyrtuar kryesisht vendimet e zyrave rajonale në qarqe, vendim i Gjykatës ky i detyrueshëm për zbatim edhe në rastin konkret, referuar nenit 76, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

46. Në rekursin kundër vendimit të gjykatës së apelit, AKKP-ja, sikurse edhe në ankimin e saj më parë, ka pretenduar se vendimi i drejtorit të saj të përgjithshëm është marrë në përputhje me kompetencën që ligji i kohës i njihte dhe se vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk kishte efekt prapaveprues në rastin konkret, pasi ka dalë pas vendimit të drejtorit të saj të përgjithshëm.

47. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimet e gjykatave më të ulëta janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit. Sipas tij, padia në rastin konkret synon të bëjë nul një vendim të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, i cili në marrjen e atij vendimi ka vepruar konform kompetencave të dhëna nga ligji i posaçëm i kohës. Po sipas tij, vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi ai ka dalë jo vetëm pas ushtrimit të nismës nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, por edhe pas vendimmarrjes së tij. Sipas Kolegjit Civil, nuk jemi para rastit të parashikuar në nenin 76, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, për efektet prapavepruese të vendimit të Gjykatës, pasi padia e kërkuesve është dorëzuar në gjykatë në datën 26.07.2013. Po sipas tij, nuk jemi as para rastit të parashikuar nga shkronja "c" e kësaj dispozite, pasi vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së i ka prodhuar pasojat e tij dhe çështja vijon të jetë në juridiksionin administrativ, ndaj gjykatat nuk mund të ndërhyjnë ende.

48. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vëren se drejtori i përgjithshëm i AKKP-së e ka marrë vendimin e kundërshtuar në një moment kur ligji nr. 9235/2004 i njihte kompetencën për shqyrtimin kryesisht të vendimeve të zyrave rajonale në qarqe dhe se ky vendim i tij është kundërshtuar nga kërkuesit në gjykatë, për pavlefshmëri absolute, disa vjet pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, përmes të cilit janë shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën ato dispozita të ligjit të posaçëm që parashikonin kompetencën si më lart të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së. Gjykatat e faktit kanë pranuar pretendimet e kërkuesve duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së si të marrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, duke iu referuar për këtë vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, i cili, sipas tyre, kishte fuqi prapavepruese edhe në rastin konkret, referuar ligjit nr. 8577/2000, nenit 76, pikës 2, shkronjës "c" (sipas gjykatës së shkallës së parë) dhe shkronjës "b" (sipas gjykatës së apelit). Në ndryshim nga ato gjykata, Gjykata e Lartë ka arritur në një përfundim të ndryshëm, se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së nuk ishte absolutisht i pavlefshëm, pasi ishte marrë në përputhje me ligjin e posaçëm të kohës dhe se vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk kishte fuqi prapavepruese në atë rast. Sipas saj, vendimi i Gjykatës ka dalë pas vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, çështja e kërkuesve nuk ka qenë në gjykim në momentin e daljes së vendimit të Gjykatës dhe nuk jemi në kushtet e pasojave të paezauruara të ligjit të shfuqizuar, për sa kohë ligji është zbatuar dhe vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së i ka prodhuar efektet, ndërsa vendimi i ZRKKP-së, Vlorë nuk është më në fuqi dhe çështja është në shqyrtim përpara juridiksionit administrativ. Për rrjedhojë, në kundërshtim nga sa kërkuesit pretendojnë, interpretimi nga Gjykata e Lartë i ligjit nr. 9235/2004 për kthimin dhe kompensimin e pronës, si dhe i ligjit nr. 8577/2000 në lidhje me efektin prapaveprues të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, jo vetëm nuk duket që të jetë arbitrar apo haptazi i paarsyeshëm nga këndvështrimi kushtetues, por ajo gjykatë, në mënyrë të plotë, ka parashtruar në vendimin e saj të gjitha argumentet mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv. Po ashtu, ajo gjykatë nuk rezulton të kenë vënë në diskutim fuqinë detyruese të përgjithshme të atij vendimi të Gjykatës.

49. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhura me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk janë të bazuara.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin

e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa e kërkuesve duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.01.2025
Shpallur më 27.02.2025

MENDIM KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkuesve Florion Bregasi, Sadete Topi, Fatbardhe Shpendi dhe Lavdije Keta, me objekt: "*Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3707 (537), datë 27.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i takon vlerësimit të pretendimit të kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë të caktuar me ligj, pasi për këtë kërkim çmojmë se duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

2. Në çështjen konkrete rezulton se me vendimin nr. 347/2008 ZRKKP-ja, Vlorë ka vendosur njohjen e së drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar M.A., kthimin atyre në natyrë të një sipërfaqeje brenda sipërfaqes së njohur, si dhe kompensimin për pjesën tjetër të shndërruar në tokë bujqësore dhe të ndarë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". Në datën 20.10.2009, pothuajse 1 vit e një muaj pas dhënies së tij, me vendimin nr. 3844/6, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, bazuar në nenet 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 347/2008 dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në ZRKKP-në, Vlorë.

3. Në vitin 2013 trashëgimtaret e M.A. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, duke pretenduar, ndër të tjera, se në dosje ndodheshin dy shkresa me përmbajtje të ndryshme të tij, ku sipas njërës rezultonte se nuk e kishte ushtruar të drejtën e nismës për shqyrtimin kryesisht të vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, ndërsa sipas tjetrës e kishte ushtruar këtë të drejtë, duke vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 347/2008 dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në ZRKKP-në, Vlorë. Po sipas tyre, vendimi i ZRKKP-së, Vlorë kishte marrë formë të prerë, pasi nuk ishte ankimuar, ndaj vendimmarrja e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e tij binte ndesh me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës.

4. Në datën 27.01.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke vlerësuar se vendimi i kundërshtuar i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së përbënte akt absolutisht të pavlefshëm, pasi ishte nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij, në shkelje të parimit të sigurisë

juridike, së drejtës së kërkueseve për pronën, si dhe vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës, i cili, sipas nenit 76, pika 2, shkronjat "b" dhe "ç", të ligjit nr. 8577/2000, gjente zbatim edhe në rastin e tyre. Gjykata e rrethit ka konstatuar se deri në datën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes dosja administrative nuk i ishte përcjellë ZRKKP-së, Vlorë, e cila, për më tepër, nuk ekzistonte më. Në lidhje me çështjen, ajo ka vlerësuar se vendimi i ZRKKP-së, Vlorë kishte marrë formë të prerë, pasi nuk ishte ankimuar brenda afateve ligjore, duke u shndërruar në titull ekzekutiv, ndaj shqyrtimi i tij nga drejtori i përgjithshëm i AKKP-së cenonte parimin e sigurisë juridike. Nga ana tjetër, neni 16, pika 1, i ligjit nr. 9235/2004, mbi të cilin ishte mbështetur vendimmarrja e drejtorit të përgjithshëm, ishte shfuqizuar me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës, i cili, sipas rregullimeve të ligjit organik të Gjykatës, kishte efekt prapaveprues edhe për çështjen në shqyrtim.

5. Kundër vendimit të gjykatës së rrethit ka ushtruar ankim AKKP-ja, duke pretenduar se vendimi i kundërshtuar i drejtorit të përgjithshëm ishte marrë në përputhje me nenin 107, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative *(KPA)* të kohës; bazuar në nenin 137 të këtij kodi palët duhej të ezauronin rrugën administrative dhe më pas të ndiqnin atë gjyqësore; vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk e bënte të pavlefshëm vendimin e drejtorit të përgjithshëm i AKKP-së, pasi në kohën e nxjerrjes së këtij akti ligji njihte mundësinë dhe detyrimin e drejtorit të përgjithshëm të shqyrtonte kryesisht vendimet e ZRKKP-ve.

6. Në datën 14.10.2014 Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se pretendimet dhe shkaqet e ngritura në ankim nga AKKP-ja ishin të pabazuara. Sipas gjykatës së apelit, vendimi i gjykatës së rrethit ishte i drejtë e i bazuar në ligj, ndërsa vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së ishte marrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, në kushtet kur në momentin e kontrollit gjyqësor të vlefshmërisë së tij dispozita ligjore që i njihte të drejtën e nismës për shfuqizimin e vendimit të ZRKKP-së, Vlorë, ishte shfuqizuar si antikushtetuese me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës.

7. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs AKKP-ja, duke parashtruar, në thelb, të njëjtat argumente si në ankim. Në lidhje me të, me vendimin e datës 27.09.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit, si dhe rrëzimin e padisë, duke vlerësuar, në thelb, se çështja ndodhej ende në juridiksionin administrativ dhe se i takonte AKKP-së, e cila kishte përthithur kompetencat e ish-ZRKKP-ve, të shprehej me vendim themeli për çështjen.

8. Në datat 25.01.2024 dhe nr. 26.01.2016 kërkueset Sadete Topi, Fatbardha Shpendi e Lavdije Keta dhe shtetasi Florion Bregasi, trashëgimtar i S.B., palë paditëse në gjykimin e zakonshëm, kanë ushtruar ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin nga Gjykata e Lartë krahas parimit të sigurisë juridike, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, edhe të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj si rrjedhojë e vlerësimit të provave nga Gjykata e Lartë. Në përfundim të shqyrtimit të argumenteve në thelb të këtyre pretendimeve, shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesve, duke vlerësuar se pretendimet e tyre, përfshirë ato për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, janë të pabazuara. Në lidhje me këtë parim shumica ka arsyetuar se Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve të pranuara nga gjykatat më të ulëta, por, në përputhje me kompetencat e saj të përcaktuara në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës, ka vendosur të ndryshojë vendimet e tyre dhe ta zgjidhë vetë çështjen në themel vetëm për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit nga ato dhe konkretisht të ligjeve nr. 9235/2004 dhe nr. 8577/2000 në lidhje me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës. Po sipas shumicës, kontrolli i Gjykatës së Lartë është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në këto kushte, shumica ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk janë të bazuara *(shih paragrafin 31 të vendimit)*.

9. Në ndryshim nga shumica, në analizë dhe vlerësim të vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual, përkundrejt jurisprudencës kushtetuese, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se për pretendimin e kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë të caktuar me ligj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë për arsyet që do t'i parashtrojmë në vijim.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Ajo nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e

vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj *(shih vendimet nr. 43, datë 19.09.2023; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Po sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta *(shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 44, datë 19.07.2016; nr. 36, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

12. Në lidhje me çështjen në shqyrtim, sjellim në vëmendje se sipas neneve 116, shkronja "b" dhe 117 të KPA-së së kohës, akti administrativ quhej absolutisht i pavlefshëm kur ishte nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore. Ai nuk prodhonte pasoja ligjore pavarësisht nëse ishte deklaruar ose jo si i tillë. Secila palë e interesuar mund të kërkonte që akti administrativ të shpallej absolutisht i pavlefshëm dhe kërkesa në fjalë mund të bëhej në çdo kohë. Nga ana tjetër, neni 18 i ligjit nr. 9235/2004, i ndryshuar me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, në fuqi në kohën e njoftimit kërkueseve të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, njihte të drejtën e subjektit të shpronësuar për të bërë ankim ndaj vendimit të këtij organi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.

13. Në këndvështrim të jurisprudencës kushtetuese dhe parashikimeve ligjore, për sa më sipër, në rastit konkret, rezulton se në vendimin për çështjen Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka evidentuar se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së u ishte njoftuar paditëseve, trashëgimtare të të ndjerit M.A., me shkresën nr. 2374, datë 08.07.2013 të AKKP-së dhe se brenda afatit ligjor 30-ditor kërkueset kishin paraqitur kërkesëpadi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij vendimi, konform neneve 116, shkronja "b" dhe 117 të KPA-së *(shih faqen 3 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*. Ky fakt, në thelb, është vlerësuar i drejtë nga gjykata e apelit *(shih faqen 5 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë)*

dhe në lidhje me të AKKP-ja nuk rezulton të ketë paraqitur prapësime në ankimin drejtuar gjykatës së apelit ose rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, Kolegji Civil i kësaj të fundit ka vlerësuar se kërkueset kishin marrë dijeni për vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së shumë kohë përpara datës 26.07.2013 të paraqitjes së padisë në gjykatë dhe, ndonëse kishin pasur mundësi, nuk kishin nisur proces në gjykatë ose nuk ia kishin bërë të ditur këtë gjë gjykatës. Po sipas këtij kolegji, padia e tyre kishte synuar të bënte nul një vendim, i cili nuk mund të goditej më gjyqësisht, për shkak të kalimit të afateve ligjore, duke thirrur në ndihmë për këtë vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës *(shih faqen 4, paragrafi 20, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

14. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se përmes një qëndrimi të tillë Gjykata e Lartë ka marrë në analizë, shqyrtuar dhe vlerësuar faktin e konstatuar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta lidhur me datën e marrjes dijeni të kërkueseve për vendimin e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, pa qenë ngritur pretendime në këtë aspekt në ankim ose rekurs nga AKKP-ja. Për më tepër, objekti i procesit gjyqësor në gjykatat e zakonshme ishte konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, kërkim i cili, sipas nenit 117, pika 2, të KPA-së së kohës, mund të ngrihej në çdo kohë. Në këtë mënyrë, duke argumentuar dhe mbajtur qëndrim të ndryshëm për këtë fakt nga gjykatat më të ulëta, Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me kompetencat e saj ekskluzivisht ligjore dhe jurisprudencën kushtetuese, të cilat përcaktonin detyrimin për fokusimin e vendimmarrjes së kësaj gjykate vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit.

15. Krahas për sa më sipër, rezulton se në lidhje me çështjen gjykata e rrethit ka konstatuar se deri në momentin e shqyrtimit prej saj të kërkesëpadisë nuk kishte vendimmarrje të ZRKKP-së, Vlorë për çështjen dhe se, sipas nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar *(shih paragrafin 13 të këtij mendimi pjesërisht kundër)*, kërkueset kishin ushtruar të drejtën e ankimit gjyqësor kundër vendimit të drejtorit të përgjithshëm që shfuqizonte vendimin e ZRKKP-së, Vlorë *(shih faqet 3 dhe 6 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë)*, konstatime të cilat, në thelb, janë vlerësuar të drejta nga gjykata e apelit *(shih faqen 7, paragrafi i fundit, të Gjykatës së Apelit Tiranë)*. Ndërkohë Gjykata e Lartë ka çmuar se kërkueset nuk kishin legjitimitet aktiv substancial për të investuar gjykatën ose organin administrativ, ndërsa vendimi i ZRKKP-së, Vlorë ishte nxjerrë

në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji nr. 9235/2004 dhe aktet nënligjore përkatëse. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së i kishte sjellë pasojat e veta dhe çështja ishte ende në juridiksionin administrativ. Vendimmarrja e gjykatave për pranimin e padisë i hiqte pa shkak mundësinë ligjore AKKP-së të shprehej konform detyrës së saj funksionale. Ndaj, vendimet që konstatonin pavlefshmërinë absolute të AKKP-së të dhënë në vitin 2009 ishin të pambështetura në prova e në ligj dhe rrjedhojë e keqinterpretimit të fakteve e të ligjit, në cenim të juridiksionit administrativ *(shih faqen 5, paragrafët 21-22, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

16. Në analizë të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, në rastin konkret rezulton se kjo gjykatë ka vlerësuar se kërkueset nuk kishin legjitimitet aktiv për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor pa qenë i ngritur një pretendim i tillë në rekurs nga AKKP-ja, si dhe se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së i kishte sjellë pasojat e veta, ndërkohë që në ankim dhe rekurs AKKP-ja ka pretenduar të kundërtën. Në ndryshim nga gjykata e rrethit dhe ajo e apelit, të cilat kanë vlerësuar faktin e ushtrimit të së drejtës së ankimit gjyqësor të kërkueseve si në përputhje me parashikimin ligjor të nenit 18 të ligjit nr. 9235/2004, të ndryshuar, Gjykata e Lartë ka vlerësuar konkluzionet e gjykatave të ulëta për këtë fakt në interpretim të gabuar të ligjit, duke vendosur vetë për themelin e çështjes, me arsyetimin se ato duhej të shteronin juridiksionin administrativ, pavarësisht se, ashtu siç ishte konstatuar edhe nga gjykatat e faktit dhe është pranuar nga shumica *(shih paragrafin 3 të vendimit),* nga marrja e vendimit të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së objekt shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e zakonshme, deri në dhënien e vendimit nga Kolegjit Civil i saj kishin kaluar mbi 13 vjet e 11 muaj pa vendimmarrje të AKKP-së për çështjen.

17. Duke pasur parasysh qëndrimin e mësipërm të Gjykatës së Lartë në raport me jurisprudencën kushtetuese, në ndryshim nga shumica, çmojmë se në rastin konkret, në vlerësim të ndryshëm të fakteve e provave nga gjykatat e faktit, të cilat përbënin edhe bazën e vendimmarrjeve të tyre, Gjykata e Lartë ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të këtyre gjykatave dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, duke vepruar në kapërcim të kompetencave dhe funksionit të saj si gjykatë ligji. Kontrolli i saj nuk rezulton të jetë fokusuar në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, ndaj, në këtë kuptim, çmojmë se Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me kompetencat e saj të përcaktuara në nenin 141 të Kushtetutës, në cenim

të së drejtës së kërkuesve për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, vlerësojmë se pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë të caktuar me ligj janë të bazuara.

18. Në këto kushte, për të gjitha arsyet e argumentuara më sipër, vlerësojmë se, në rastin konkret, duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës, si rrjedhojë e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtare: Sonila Bejtja

Vendim nr. 4, datë 21.01.2025
(V- 4/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (T) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **TOM DEDAJ**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË, përfaqësuar nga Danja Hobdari dhe Albion Salaj me autorizim.

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR, përfaqësuar nga drejtuesi Abaz Muça.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, 8 dhe 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkuesit Tom Dedaj *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*Prokuroria Dibër*) që ka kërkuar rrëzimin e padisë, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (*sot Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër*) nga data 01.12.2013 deri në datën 01.11.2016, kur është pezulluar me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkak se ndaj tij kishte filluar një procedim penal. Pas deklarimit fajtor të kërkuesit me vendim gjyqësor të formës së prerë, KLP-ja, me vendimin nr. 22, datë 28.01.2019, ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra e prokurorit. Kërkuesi ka vazhduar rrugën gjyqësore përmes ushtrimit të mjeteve të ankimit ndaj vendimit të shkarkimit.

2. Gjatë kohës së pezullimit drejtuesi i Prokurorisë Dibër ka nxjerrë urdhrin e datës 13.09.2017, në zbatim të të cilit kërkuesi është paguar me pagën minimale sipas nenit 110 të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016)*. Në datën 30.11.2018 atij i është ndërprerë pagesa dhe, për këtë shkak, në datën 21.12.2021, ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dhënien e pagës nga data 01.12.2018 e në vazhdim, si dhe përqindjen e interesit për vonesat në dhënien e pagës. Çështja është regjistruar me nr. 31138–07074–80–2021, datë 22.12.2021.

3. Në datën 23.12.2021, nëpërmjet shortit elektronik, çështja e kërkuesit i është caktuar për shqyrtim një gjyqtari, i cili ka filluar shqyrtimin gjyqësor, por nuk e ka përfunduar atë për shkak të emërimit në Gjykatën

Administrative të Apelit. Në datën 13.05.2022 çështja i është nënshtruar sërish shortit elektronik dhe i është caktuar një gjyqtari tjetër, i cili, gjithashtu, ka filluar shqyrtimin gjyqësor, por është larguar nga detyra si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Në datën 06.09.2023 çështja e kërkuesit i është nënshtruar për herë të tretë shortit elektronik dhe i është caktuar gjyqtarit të tretë, i cili, pasi ka kryer veprimet përgatitore në datën 12.09.2023, ka vendosur përsëritjen tërësore të hetimit gjyqësor dhe ka caktuar seancën përgatitore në datën 15.10.2024, duke urdhëruar njoftimin e palëve.

4. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në seancën përgatitore nga gjyqtari i tretë, në datën 15.05.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Administrative të Apelit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka marrë mendimin me shkrim nga gjyqtari relator i çështjes në gjykatën e shkallës së parë, me vendimin nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda afatit ligjor për shkak të volumit të lartë të çështjeve.

5. Në datën 09.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, referuar parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 17.07.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 01.10.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

6. Në datat 31.10.2024 dhe 17.11.2024 kërkuesi ka paraqitur dy kërkesa për përjashtimin e dy gjyqtarëve nga shqyrtimi i çështjes së tij, për të cilat Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet përkatësisht të datave 05.11.2024 dhe 19.11.2024, ka vendosur rrëzimin e tyre, me arsyetimin se nuk plotësoheshin kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i

Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi çështja e tij ka mbi 2 vjet në pritje të gjykimit në shkallë të parë dhe ende nuk ka nisur shqyrtimi i saj, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti.

7.2. *Parimi i mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat në rastin e tij kanë shkelur Kushtetutën, kodet, ligjet dhe legjislacionin evropian për të drejtat e njeriut, duke i shkaktuar pengesa për mosrealizimin e të drejtave që i takojnë. Sipas kërkuesit, sjellja diskriminuese ndaj tij mund të vijë si pasojë e përkatësisë fetare, politike e krahinore ose për shkak të detyrës që ai ka kryer, pasi kolegë të tij për situata të njëjta janë dëmshpërblyer. Në ndryshim nga ata, të cilët janë paguar deri sa u kanë përfunduar çështjet, atij i është ndërprerë paga padrejtësisht prej 8 vjetësh.

8. ***Subjekti i interesuar, KLP-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm* është i pabazuar, pasi gjykata ka qenë në pamundësi objektive për shqyrtimin e çështjes për shkak të ngarkesës dhe zëvendësimit të gjyqtarëve të mëparshëm si pasojë e efekteve të reformës në drejtësi. Seanca përgatitore e caktuar në datën 15.10.2024 është shtyrë për në datën 11.11.2024, pasi kërkuesi ndodhej jashtë vendit për arsye shëndetësore dhe gjykimi ishte duke vijuar normalisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria Dibër,*** ka përcjellë prapësimet e dërguara më herët në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhur me parashtrimet për themelin e çështjes, sipas të cilave ajo ka përmbushur detyrimet e rrjedhura nga neni 110 i ligjit nr. 96/2016, ndaj ka kërkuar rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pabazuar në ligj.

10. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Gjykata vëren se kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit që ka rrëzuar kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e gjykimit dhe dhënien e një dëmshpërblimi të drejtë. Ndërsa në parashtrimet e depozituara për seancën plenare, që mbajnë datat 14.10.2024 dhe 17.11.2024, ai ka kërkuar edhe shfuqizimin e pikës 2 të nenit 399/8 të KPC-së si antikushtetuese, e cila parashikon se "*Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë*", me argumentin se i është cenuar e drejta e ankimit në Gjykatën e Lartë, argument i cili nuk është parashtruar në ankimin fillestar.

13. Gjykata vëren se kërkesa për shfuqizimin e normës ligjore përbën kërkim të veçantë, pasi shton njëkohësisht objektin dhe shkakun ligjor të ankimit. Në kushtet kur kërkesa është paraqitur pas kalimit të çështjes në seancë plenare, Gjykata, bazuar në nenet 1, pika 2 dhe 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, të lexuar në kombinim me nenin 185, pika 1, të KPC-së, çmon se ajo nuk mund të merret në shqyrtim gjatë këtij gjykimi kushtetues, sepse duhet të respektojë kriteret e përgjithshme të formës dhe afateve dhe t'i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit paraprak.

14. Në lidhje me kërkimet e tjera Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen gjyqësore, për të cilën ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

15. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për konstatimin e shkeljes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024.

Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion i kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

16. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 09.07.2024, ndërsa vendimi gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes mban datën 19.06.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat administrative të shkallës së parë dhe apelit nuk i kanë garantuar të drejtën kushtetuese për gjykimin e çështjes së tij (që lidhet me ndërprerjen e padrejtë të pagës prej vitit 2018) brenda afatit të arsyeshëm dhe se ato kanë pasur sjellje diskriminuese, pasi kolegët e tij në të njëjtat situata e kanë përfituar pagesën deri në përfundim të proceseve gjyqësore. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit kërkuesi ka parashtruar vetëm argumentin hipotetik se shkaku mund të lidhet me përkatësinë fetare, krahinore ose detyrën e ushtruar, por pa dhënë ndonjë detaj për rrethanat faktike personale të tij dhe as për ato të sjelljes së gjykatave të zakonshme. Në këtë situatë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim, sepse argumentet e paraqitura janë të pamjaftueshme nga pikëpamja kushtetuese.

18. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së *drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, Gjykata vëren se kjo e drejtë garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, ndaj pretendimi bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

19. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi çështja e tij është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2021, megjithatë gjykimi është ende në fazën fillestare, pasi nuk ka nisur shqyrtimi gjyqësor.

20. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se gjykimi është duke vijuar normalisht në gjykatën e shkallës së parë, seanca përgatitore e datës 15.10.2024 është shtyrë me kërkesë të kërkuesit, pasi ai ndodhej jashtë vendit për arsye shëndetësore dhe seanca e radhës ishte caktuar për në datën 11.11.2024. Gjykata e shkallës së parë, sipas KLP-së, ka qenë në pamundësi objektive për përfundimin e çështjes për shkak të ngarkesës dhe

zëvendësimit të gjyqtarëve si pasojë e reformës në drejtësi. Sipas KLP-së, nuk ekziston ndonjë arsye e veçantë për shqyrtimin me përparësi të çështjes së kërkuesit në raport me çështje të ngjashme ose të regjistruara më herët në atë gjykatë.

21. Ndërsa, subjekti tjetër i interesuar, Prokuroria Dibër, nuk ka prapësuar konkretisht për pretendimin, por ka parashtruar se lidhur me themelin e çështjes ajo ka zbatuar detyrimet ligjore për ndërprerjen e pagës së kërkuesit.

22. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se mosmarrëveshja që po gjykohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka në objektin e saj kundërshtimin e ndërprerjes së pagës së prokurorit për shkak të pezullimit nga detyra deri në shkarkimin e tij. Çështja është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë në datën 22.12.2021 dhe ndonëse kanë kaluar 3 vjet, ajo është ende në fazën fillestare të saj, atë të veprimeve përgatitore.

24. Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar trefish afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ në gjykatën e shkallës së parë. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa i takon *sjelljes së kërkuesit*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda

një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të kërkuesit, konstaton se ai ka shfaqur interes për ecurinë e shpejtë të gjykimit të çështjes, pasi i është drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për përshpejtimin e procedurave, e cila është rrëzuar dhe, në vijim, ka paraqitur ankim kushtetues individual. Në këto rrethana, nuk rezulton që kërkuesi të jetë bërë shkak për vonesën në gjykim, por ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale.

27. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes,* Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj kërkimin për pagën e prokurorit dhe interesat për vonesën, bazuar në ligjin nr. 96/2016, për shkak të së cilës, sipas ligjit procedural, ajo shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari i vetëm. Ndërsa palë të paditura në gjykim janë tre institucione shtetërore, KLP-ja, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria Dibër. Duke iu referuar këtyre aspekteve, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse, e tillë që të justifikojë kohëzgjatjen prej 3 vjetësh në gjykatën e shkallës së parë.

28. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vë në dukje se lloji i çështjes së kërkuesit, për nga objekti i saj, përfshihet në grupin e çështjeve prioritare për shqyrtim, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga marrëdhënia e punës ose ato që rrjedhin nga shpërblimi i dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës *(shih shkronjën "gj" të pikës 3.1. të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", të ndryshuar [vendimi nr. 78/2019]*). Megjithatë, nuk rezulton që gjykimi të jetë zhvilluar me përparësi. Konkretisht, çështja e kërkuesit i është caktuar me short me radhë tre gjyqtarëve të ndryshëm, konkretisht në datat 23.12.2021, 13.05.2022 dhe 06.09.2023, për shkak të largimit të dy gjyqtarëve të parë (gjyqtari i parë për shkak të ngritjes në detyrë, ndërsa gjyqtari i dytë për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar). Dy gjyqtarët e parë kanë kryer veprime gjyqësore, duke filluar shqyrtimin gjyqësor të çështjes përmes marrjes së provave dhe debatimit të tyre, por nuk kanë mundur ta përfundojnë gjykimin. Gjyqtari i fundit i caktuar me short në datën 06.09.2023, pas 6 ditëve, ka nxjerrë urdhrin sipas ligjit procedural për të përsëritur tërësisht hetimin gjyqësor. Megjithatë, gjyqtari e ka kthyer çështjen në fazën e veprimeve përgatitore, të cilën e ka caktuar pas 1 viti e 1 muaji, konkretisht në datën 15.10.2024, duke mos dhënë ndonjë arsye specifike në këtë drejtim, që do të thotë se nuk ka mbajtur në konsideratë as kohën e regjistrimit të çështjes, as natyrën prioritare të saj.

29. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, pa iu referuar rrethanave konkrete të rastit, por duke përdorur një arsyetim formal e standard. Sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë është në pamundësi objektive për të proceduar shpejt, për shkak të evadimit të çështjeve në kushtet e numrit të kufizuar të burimeve njerëzore dhe numrit tepër të lartë të stokut të çështjeve.

30. Gjykata konstaton se ky arsyetim nuk përputhet me të dhënat e tërhequra nga vetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka informuar se në të ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë dhe se kohëzgjatja mesatare e gjykimit të çështjeve në përgjithësi dhe e çështjeve me objekt të ngjashëm të kërkuesit është 1 vit, që është tre herë më e ulët se sa kohëzgjatja e gjykimit të kërkuesit. Po kështu, ajo informon se në kohën kur çështja e kërkuesit i është caktuar gjyqtarit të tretë me short, ai kishte një ngarkesë, gjithsej, prej 332 çështjesh, ndërsa numri i çështjeve të cilat po shqyrtohen aktualisht prej tij është 568, ngarkesë e cila është dukshëm më e ulët se sa ajo e paraqitur nga gjykata e apelit në vendimin e saj – 990 çështje (*shih faqet 5 dhe 10 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*). Për këto arsye, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së të drejtës së kërkuesit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj vendimi i saj duhet shfuqizuar.

31. Duke i analizuar këta tregues, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuesit është rrjedhojë e sjelljes së gjykatave, sipas arsyetimit të mësipërm.

32. Në lidhje me *atë çfarë rrezikon kërkuesi* në procesin gjyqësor, Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë", nevojitet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se në themelin e saj është ndërprerja e pagës si pasojë e shkëputjes së marrëdhënieve të punës së kërkuesit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit, për nga natyra e tyre, kërkojnë vendimmarrje të përshpejtuar (*shih Vocaturo kundër Italisë, 24.05.1991, § 17*), qëndrim i cili është mbajtur edhe nga KLGJ-ja në vendimin e saj nr.

78/2019, e cila i ka vlerësuar ato si çështje prioritare për shqyrtim. Për këto arsye, si dhe duke evidentuar edhe moshën 62 vjeç të kërkuesit, Gjykata çmon se kërkuesit i rrezikohen interesa vetjakë nga vonesa e gjykimit, ndaj çështja e tij duhej të trajtohet me përparësi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

34. Në përfundim, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej më shumë se 3 vjetësh të gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, natyrën jo komplekse të çështjes, sjelljen e autoriteteve, si dhe interesin vetjak të kërkuesit, Gjykata vlerëson se atij i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj kërkesa duhet të pranohet. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon se duhet urdhëruar detyrimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen e kërkuesit me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 50 (86-2024-1175), datë 19.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.01.2025
Shpallur më 19.02.2025

Vendim nr. 5, datë 29.01.2025
(V-5/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 14 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SHOQËRIA "DEA-Z" SH.P.K.,** përfaqësuar nga Zaim Korsi, me prokurë.
ZAIM KORSI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
VIKTOR NDOCI, RIDVAN SOKOLI, KUJTIM SOKOLI, AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2943, datë 10.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 665, datë 29.03.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-4272, datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 31, 71, 71/a e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,
pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e

kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Viktor Ndoci, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi se subjektet e tjera të interesuara, Ridvan Sokoli, Kujtim Sokoli dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nuk paraqitën prapësime, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi rezulton se ndërmjet kërkueses, shoqërisë "DIAMAND" sh.p.k. (*në vijim shoqëria "DEA-Z" sh.p.k.*), e përfaqësuar nga shtetasi Zaim Korsi, si administrator i vetëm i saj dhe shtetases Xh.T. është lidhur kontrata paraprake nr. 2239 rep. nr. 547 kol., datë 02.07.2001. Me anë të kësaj kontrate palët kanë rënë dakord që shtetasja Xh.T., në cilësinë e pronares së truallit, të vërë në dispozicion të palës tjetër, shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k., një sipërfaqe trualli në pronësi të saj, të ndodhur në Rrugën e Elbasanit, Tiranë, për ndërtimin nga shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. të një objekti banimi shumëkatësh, kundrejt detyrimit të shoqërisë për t'i dhënë shtetases Xh.T. si përfitim 22% të sipërfaqes ndërtimore.

2. Në vijim, ndërmjet shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k., përfaqësuar nga Zaim Korsi dhe subjektit të interesuar, shtetasit Viktor Ndoci, këta të fundit në cilësitë e sipërmarrësve dhe investitorëve, dhe shtetases Xh.T., në cilësinë e pronares së truallit, të përfaqësuar nga djali i saj sipas prokurës nr. 2622 rep. dhe nr. 261 kol., datë 17.04.2000, është lidhur "Kontrata e sipërmarrjes paraprake" e datës 23.10.2003 (*kontrata e sipërmarrjes*). Bazuar në këtë kontratë sipërmarrjeje, shtetasja Xh.T. ka vënë në dispozicion të shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. sipërfaqen e truallit 736 m^2 për ndërtimin e një pallati banimi shumëkatësh. Sipas nenit 4 të kësaj kontrate, pronarja e truallit, shtetasja Xh.T., do të përfitonte 1000 m^2 sipërfaqe ndërtimore.

3. Për sa më lart, bazuar në kontratën e sipërmarrjes, subjekti i interesuar Viktor Ndoci dhe shtetasi Zaim Korsi, në cilësinë e investitorëve dhe shoqëria "DEA-Z" sh.p.k., në cilësinë e firmës ndërtuese, e përfaqësuar nga Zaim Korsi, kanë lidhur aktmarrëveshjen e datës 24.01.2004, sipas së cilës financimet për ndërtimin e pallatit do t'i realizonin së bashku në mënyrë të barabartë (50% me 50%) dhe përfitimin neto që do të realizohej nga ndërtimi do ta ndanin në mënyrë të barabartë. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje,

ndërtimin e pallatit do ta realizonte shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. me kosto ndërtimi 250 euro për m^2. Ndërkohë, sipas aktkolaudimit teknik-ekonomik të muajit tetor të vitit 2005, ndërtimi i objektit ka përfunduar në muajin shtator të vitit 2005. Po ashtu, sipas kontratës të datës 13.11.2005, rezulton se shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. ka ndërtuar për llogari të shtetasit Viktor Ndoci një dyqan në katin përdhe, në pallatin e ndërtuar prej saj, me sipërfaqe 232 m^2, me vlerën 450,000 euro.

4. Në vitin 2012 shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. e ka regjistruar objektin e ndërtuar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZRPP*) Tiranë në emër të saj. Duke qenë se ndërmjet shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. dhe subjektit të interesuar Viktor Ndoci nuk është mundur të ndahet me mirëkuptim fitimi i realizuar nga ndërtimi i objektit, subjekti i interesuar, me pretendimin se nuk i janë dorëzuar të gjitha pjesët që i takonin sipas aktmarrëveshjes të datës 24.01.2004, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë me objekt: "Detyrimin e shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. për ta njohur pronar atë të pasurive: njësi me sipërfaqe 212 m^2 dhe 72 m^2; katër vendparkime; detyrimin e shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. t`i shlyejë atij shumën 426,776.5 euro; detyrimin e ZRPP-së, Tiranë të bëjë çregjistrimin e këtyre pasurive në emër të shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. dhe regjistrimin e tyre në emër të tij".

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2943, datë 10.04.2015, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, duke detyruar palët e paditura, shoqërinë "DEA-Z" sh.p.k. dhe shtetasin Zaim Korsi (ortaku i vetëm i shoqërisë), të njohin paditësin (subjektin e interesuar) pronar të pasurisë së paluajtshme, njësi me sipërfaqe 212 m^2, të regjistruar në ZRPP në emër të shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. Në lidhje me kërkimin për çregjistrimin nga ZRPP-ja të pasurisë së paluajtshme të regjistruar në emër të palës së paditur (shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k.) dhe regjistrimin e saj në emër të paditësit (subjektit të interesuar), gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, ndërkohë që për pjesën tjetër të kërkesëpadisë ka vendosur rrëzimin.

6. Sipas gjykatës së shkallës së parë, bazuar në aktekspertimet e administruara në gjykim, fitimet e nxjerra nga ndërtimi i pallatit duhet të ndaheshin midis palëve ndërgjyqëse në raport me masën e financimit të kryer nga secila prej tyre, raport ky në masën 19% paditësi (subjekti i interesuar) dhe 81% pala e paditur (shoqëria "DEA-Z" sh.p.k.). Po sipas gjykatës së shkallës së parë, duke pasur parasysh aktmarrëveshjet midis palëve, përfshirë kontratën e datës 13.11.2005, me të cilën shoqëria

"DEA-Z" sh.p.k. vërteton se ka ndërtuar për llogari të shtetasit Viktor Ndoci një dyqan në katin përdhe të pallatit me sipërfaqe ndërtimi 212 m^2 (*të reduktuar nga 232 m^2 në 212 m^2*) me vlerën 450.000 euro, duke pasur parasysh edhe se për një pjesë punimesh gjatë ndërtimit të pallatit është angazhuar edhe shoqëria në pronësi të shtetasit Viktor Ndoci, si dhe faktin se një pjesë e të ardhurave nga shitja e ambienteve nuk janë arkëtuar akoma (375.000 euro), të cilat do të realizohen dhe përfitohen nga pala e paditur, paditësit duhet t'i njihet vetëm pronësia mbi dyqanin në katin përdhe të pallatit me sipërfaqe ndërtimi 212 m^2 . Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur ankim shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. dhe subjekti i interesuar Viktor Ndoci.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 665, datë 29.03.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2943, datë 10.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë ndryshim: "Detyrimin e shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. për të njohur pronar shtetasin Viktor Ndoci për pronën njësi me sipërfaqe 73 m^2 dhe katër vendparkimet e regjistruara në ZRPP në pronësi të shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k., si edhe shlyerjen e shumës prej 304,610 eurosh dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit".

8. Gjykata e apelit në vendimin e saj ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë nuk është bazuar në konkluzionet e grupit të ekspertëve, në të cilat është dhënë mendim ndryshe nga çfarë ka pranuar në vendim gjykata e shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, në lidhje me fitimin që duhet të marrë secila palë, ajo niset nga përcaktimet që vetë palët kanë bërë në aktmarrëveshjen e datës 24.01.2004, të lidhur mes tyre, e cila në nenin 10 të saj parashikon se "financimi i punimeve të objektit nga data 01.01.2004 e në vazhdim, për pjesën që mbetet pa u mbuluar nga shitjet, do të financohet nga investitori Viktor Ndoci sipas situacioneve". Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs shoqëria "DEA-Z" sh.p.k., e përfaqësuar kërkuesi Zaim Korsi, në cilësinë e administratorit të saj, duke kërkuar prishjen e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, me tjetër trup gjykues.

9. Fillimisht, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 283, datë 17.06.2016, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 665, datë 29.03.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë deri në përfundimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Gjykata e Lartë. Po ashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 283/1, datë 11.12.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit Viktor Ndoci për revokimin e pezullimit. Ndërsa, për sa i përket shqyrtimit të rekursit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me

vendimin nr. 00-2023-4272, datë 25.10.2023, ka vendosur mospranimin e tij, për shkak se nuk përmbante asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

10. Në datën 30.04.2024 shoqëria "DEA-Z" sh.p.k., e përfaqësuar nga shtetasi Zaim Korsi, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.05.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 11.07.2024 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së aksesit,* pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar pretendimet e tyre për shkeljet procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta. Këto shkelje janë paraqitur në rekurs, shtesën e rekursit të datës 13.07.2021 dhe shpjegimet e datës 07.09.2023, ku janë parashtruar shkaqet ligjore që parashikohen nga neni 472 i KPC-së. Referuar këtyre shkaqeve të paraqitura në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore për të dëgjuar edhe palët. Ndryshe nga sa parashtron subjekti i interesuar, në aktet e depozituara në Gjykatën e Lartë kërkuesit nuk kanë paraqitur vetëm pretendime që kanë të bëjnë me analizën e provave, por edhe për kryerjen e shkeljeve të rënda procedurale. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar pretendimet për shkelje procedurale, për mosrespektimin e vendimeve unifikuese dhe për shkeljet e ligjit.

11.2. *Parimit të barazisë së armëve,* pasi edhe pse nga kërkuesit është kërkuar që të thirreshin në gjykim personat e tretë që kishin blerë pasuritë e paluajtshme të kërkuara nga pala paditëse, gjykatat nuk e kanë pranuar këtë kërkesë, duke sjellë kështu dhe mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë, e cila, bazuar në nenin 467 të KPC-së, i bën vendimet gjyqësore të pavlefshme. Ndryshe nga sa parashtron subjekti i interesuar, kërkuesit cenohen drejtpërdrejt në të drejtat e tyre kushtetuese, si pasojë e një procesi jo të rregullt. Personat e tretë me të cilët shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. ka kryer veprime mbi

bazën e kontratave të sipërmarrjes, për pasuritë që gjykatat ia kanë dhënë subjektit të interesuar në kundërshtim me ligjin, kanë dhe do të ngrenë pretendime më pas ndaj shoqërisë.

11.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar,* pasi gjykatat nuk kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet dhe provat shkresore të paraqitura nga kërkuesit, por i kanë anashkaluar ato. Kërkuesit, përveç ankimeve, kanë paraqitur edhe komente dhe shpjegime, por ato nuk janë shqyrtuar nga gjykatat. Ndryshe nga sa parashtron subjekti i interesuar, kërkuesit kanë ngritur pretendime se gjykatat e zakonshme nuk kanë respektuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për t'u mbrojtur, duke mos analizuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga palët.

11.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj pasqyron vlerat e llogaritura nga ekspertët me rezultate të ndryshme dhe u referohet vlerave të tyre pa analizuar se cilën prej tyre ka vlerësuar në marrjen e vendimit. Ajo gjykatë, edhe pse ka thirrur ekspertë të fushës për të bërë llogaritjet, nuk ka dhënë argumente logjike dhe të mjaftueshme për të mbështetur atë çfarë ka pranuar në pjesën urdhëruese të vendimit. Ndërsa gjykata e apelit nuk i ka analizuar pretendimet e paraqitura në ankim nga kërkuesit dhe nuk ka arsyetuar përse i gjen të pabazuara ato. Arsyetimi i saj është jologjik në arritjen e përfundimit për pranimin tërësisht të pretendimeve të paditësit. Pretendimi për mosarsyetim të vendimeve të gjykatave më të ulëta është ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por nuk është riparuar nga kjo e fundit. Në këtë drejtim edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë pasqyruar dhe as analizuar shkaqet e paraqitura në shtesën e rekursit të datës 13.07.2021, të cilat tregonin shkelje të tjera nga gjykatat më të ulëta përveç atyre të paraqitura me rekursin fillestar. Pretendimet për shkeljet procedurale nga gjykatat më të ulëta janë paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe me shpjegimet e datës 07.09.2023, para shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit.

11.5. *Parimit të barazisë përpara ligjit,* pasi gjykatat nuk kanë zbatuar vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndryshe nga sa parashtron subjekti i interesuar, kërkuesit në rekurs e kanë ngritur pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit nga gjykatat më të ulëta. Paraqitja e shtesës së

rekursit nuk ndalohet nga asnjë dispozitë ligjore në fuqi. Sipas jurisprudencës kushtetuese, Gjykata e Lartë kishte detyrimin të shqyrtonte shtesën e rekursit.

11.6. *Ligjshmërisë së marrjes së provave,* pasi edhe pse kërkuesit kanë paraqitur dokumentacion ligjor me fuqi të plotë provuese, ai nuk është vlerësuar nga gjykatat. Edhe pse provohet se paditësi ka dhënë një vlerë minimale të investimit, gjykatat ia kanë kaluar barrën e provës palës së paditur (kërkuesve) për të paraqitur dokumente shkresore për kontributin e saj. Aktet e shkruara me dorë nuk duhet të ishin administruar nga gjykatat si prova shkresore, pasi janë thjesht shënime dhe nuk përbëjnë akt shkresor sipas neneve 246 e vijues të KPC-së. As noterizimi nuk u jep atyre vlerën e provës, për shkak se nuk kanë elementet e nevojshme sipas nenit 259 të KPC-së. Ndryshe nga sa parashtron subjekti interesuar, shënimet që u referohet ky i fundit janë baza ku është referuar gjykata e apelit.

12. ***Subjekti i interesuar, Viktor Ndoci***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

12.1. Pretendimi i kërkuesve për cenimin e *së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi në rekursin e paraqitur nga kërkuesit nuk ka asnjë pretendim për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit apo që vendimet bien ndesh me vendimet unifikuese. Po ashtu, lidhur me shtesën e rekursit, nuk parashikohet në asnjë dispozitë ligjore që të bëhet shtesë rekursi pesë vjet pasi është dhënë vendimi gjyqësor. Gjithsesi, edhe në shtesën e rekursit kërkuesit nuk rezulton të kenë paraqitur asnjë argument për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit apo që vendimet bien ndesh me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Kërkuesit kanë marrë përgjigje nga gjykatat për të gjitha pretendimet e tyre.

12.2. Edhe pretendimi i kërkuesve për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* është i pabazuar, pasi nga kërkuesi Zaim Korsi nuk është paraqitur asnjë dokument bankar që të provojë se është paguar çmimi i njësisë me sipërfaqe 73 m^2 i pretenduar se është blerë nga persona të tretë. Gjithsesi, kërkuesit nuk legjitimohen për këtë pretendim, për shkak se ata nuk mund të paraqesin pretendime për të mbrojtur interesat e personave të tretë, të cilët nëse kanë pretendime për cenimin e të drejtave të tyre mund t'i drejtohen vetë rrugës gjyqësore.

12.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi kërkuesi Zaim Korsi e ka ushtruar këtë të drejtë gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, duke luajtur një rol aktiv si përfaqësues i shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. dhe si individ, duke u bërë pyetje të vazhdueshme ekspertëve, për të cilët paraqiste kundërshtime. Kjo e drejtë e tyre është realizuar edhe nëpërmjet mbrojtësve të tyre, si edhe me rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë.

12.4. Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi tjetër për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi pretendimet e tij për mosarsyetimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit nuk i ka ngritur më parë në rekurs. Po ashtu, pretendimet e kërkuesve për këto vendime lidhen me vlerësimin e provave të marra nga gjykatat. Gjithsesi, rezulton se gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj ka respektuar standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, duke parashtruar rrethanat e çështjes, provat e paraqitura nga palët, si dhe arsyet dhe dispozitat ligjore ku ka mbështetur qëndrimin e saj, duke u dhënë përgjigje edhe pretendimeve të palëve. Ajo gjykatë e ka dhënë vendimin e saj duke u bazuar në provat e dosjes gjyqësore. Edhe vendimi i gjykatës së apelit ka respektuar kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, duke parashtruar shkaqet e ankimit dhe duke marrë në analizë pretendimet e palëve. Ajo gjykatë në vendimin e saj u është referuar provave të paraqitura nga palët, të cilat ndodhen në dosjen gjyqësore dhe kërkuesit nuk kanë sjellë asnjë argument se cila provat nuk janë marrë në shqyrtim prej saj. Pretendimet e kërkuesve për këto vendime lidhen me vlerësimin e provave të marra nga gjykatat. Edhe Gjykata e Lartë ka respektuar kriteret kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Ajo gjykatë në vendimin e saj ka parashtruar të gjitha shkaqet e rekursit të paraqitura nga kërkuesit. Kërkuesit në rekurs nuk kanë paraqitur asnjë argument konkret se cilat kanë qenë shkeljet procedurale ose cilat janë vendimet unifikuese që nuk janë respektuar. Këto argumente kërkuesit nuk i kanë paraqitur as në ankimin kushtetues individual. Në rekurs ata kanë ngritur pretendime që kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin e provave nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë ka paraqitur me hollësi shkaqet e rekursit. Për sa i përket pretendimit për shtesën e rekursit, sipas

nenit 476 të KPC-së, pala e paditur nuk ka të drejtë të paraqes rekurs tej përcaktimeve të kësaj dispozite.

12.5. Lidhur me pretendimin për *ligjshmërinë në marrjen e provave*, argumentet e kërkuesve kanë të bëjnë me vlerësimin e provave që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor në gjykatat e zakonshme. Për këtë arsye, ato nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae,* subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuesit nuk legjitimohen për pretendimin e tyre për cenimin e parimit të barazisë së armëve, për shkak se ata nuk mund të paraqesin pretendime për të mbrojtur interesat e personave të tretë që nuk janë palë në procesin e kundërshtuar.

15. Ndërkohë, në ankimin kushtetues individual kërkuesit, ndër të tjera, kanë pretenduar se është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi edhe pse nga ata është kërkuar që të thirreshin në gjykim personat e tretë që kishin blerë prej shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. pronat e paluajtshme të kërkuara nga pala paditëse, gjykatat nuk e kanë pranuar këtë kërkesë, duke sjellë kështu edhe mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë. Për këtë arsye, sipas tyre, bazuar në nenin 467 të KPC-së, vendimet gjyqësore objekt i ankimit kushtetues individual janë të pavlefshme.

16. Gjykata ka vlerësuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, kërkuesit janë subjekte të

kushtëzuara dhe mund të paraqesin ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre të drejtpërdrejta, duke provuar se janë cenuar në të drejtat e tyre kushtetuese, pra se janë viktima të një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për to (*shih vendimet nr. 6, datë 15.02.2024; nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se kërkuesit duhet të provojnë legjitimimin e tyre si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 65, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më lart, në lidhje me pretendimin e kërkuesve për cenimin e parimit të barazisë së armëve, Gjykata çmon se ata nuk provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në drejtim të së drejtës së cenuar dhe interesit të ligjshëm vetjak, për sa kohë që përmes këtij pretendimi ata synojnë mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë që nuk janë pjesë e këtij gjykimi kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata çmon se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione personae* për këtë pretendim dhe prapësimi i subjektit të interesuar është i bazuar.

18. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual, Gjykata konstaton se në procesin gjyqësor të kundërshtuar kanë qenë palë të paditura shoqëria "DEA-Z" sh.p.k. dhe shtetasi Zaim Korsi, në cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi Zaim Korsi i është drejtuar asaj jo vetëm si palë në procesin të kundërshtuar, por edhe si përfaqësues me prokurë të përgjithshme i kërkueses tjetër, shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. Për rrjedhojë, ata legjitimohen *ratione personae* për t'iu drejtuar Gjykatës për pretendimet e tjera, pasi lidhen me procesin gjyqësor ku kanë qenë palë dhe provojnë interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

19. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, subjekti i interesuar ka parashtruar se pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, kërkuesit nuk e kanë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kriteri i shterimit të mjeteve që ajo shqyrton lidhet edhe me pretendimet e paraqitura nga individi në ankimin kushtetues individual. Sipas Gjykatës, individi të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë duhet t'i ketë paraqitur më parë edhe në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

22. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se edhe pse kërkuesit, në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, në ankimin kushtetues individual nuk kanë ngritur të njëjtat argumente që kanë ngritur në rekurs, referuar këtij të fundit, Gjykata konstaton se ata e kanë ngritur në substancë atë, përderisa kanë kundërshtuar mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykatat më të ulëta lidhur me pretendimet e ngritura për arsyetimin e këtyre të fundit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual ndaj pretendimi i subjektit të interesuar në këtë drejtim nuk është i bazuar.

23. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 25.10.2023, i cili, sipas shkresës nr. 1170/1 prot., datë 05.03.2024 të asaj gjykate, është dorëzuar i arsyetuar në datën 16.01.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 30.04.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

24. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, subjekti i interesuar ka prapësuar se argumentet e kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, si edhe ato për ligjshmërinë e provave kanë të bëjnë me vlerësimin e provave që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë, si të tilla, ato nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

25. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se, në thelb, pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, kërkuesit e kanë lidhur me vlerat e paraqitura nga ekspertët që kanë marrë parasysh ato (gjykatat) në vlerësimin e tyre dhe se kur kanë vlerësuar kontributin e palëve i janë referuar shënimeve të të paditurit. Ndërsa, për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar ata kanë argumentuar se gjykatat nuk kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet dhe provat shkresore të paraqitura prej tyre, por i kanë anashkaluar ato. Gjithashtu, në ankimin kushtetues individual kërkuesit

kanë ngritur pretendime për ligjshmërinë e provave, duke argumentuar se aktet e shkruara me dorë nuk duhet të ishin administruar nga gjykatat si prova shkresore, pasi janë thjesht shënime dhe nuk përbëjnë akt shkresor sipas neneve 246 e vijues të KPC-së dhe se as noterizimi i tyre nuk u jep vlerën e provës, për shkak se nuk kanë elementet e nevojshme sipas nenit 259 të KPC-së. Sipas kërkuesve, ata kanë paraqitur dokumentacion ligjor me fuqi të plotë provuese, që nuk është vlerësuar nga gjykatat dhe megjithëse provohet se paditësi ka dhënë një vlerë minimale, gjykatat ia kanë kaluar barrën e provës palës së paditur (kërkuesve) që të paraqesë dokumente shkresore për kontributin e saj.

26. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këtë kuptim, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesit në mbështetje të pretendimeve të tyre për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, së drejtës për t'u dëgjuar, si edhe ligjshmërisë së provave, Gjykata konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe analizës së provave, si edhe interpretimit e zbatimit të ligjit. Si të tilla, ato nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se në lidhje me këto pretendime, kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë se si vendimet/qëndrimet e atyre gjykatave kanë cenuar këto standarde/parime kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata evidenton se këto pretendime të kërkuesve nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

28. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, duke argumentuar se gjykatat nuk kanë zbatuar vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

29. Në vlerësimin e Gjykatës, sipas parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe në vijim të jurisprudencës së kushtetuese, në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme

e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë *(shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*)

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesit nuk rezultojnë të kenë paraqitur asnjë vendim njësues të praktikës gjyqësore të cilin nuk e kanë zbatuar gjykatat në vlerësimin e çështjes së tyre, duke mos parashtruar asnjë shkak konkret për cenimin e këtij parimi nga ato gjykata. Në këtë kuptim, ky argument i tyre nuk përbën argument kushtetues për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit. Nga ana tjetër, Gjykata rithekson qëndrimin e saj se, kur kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se argumentet e kërkuesve për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

31. Po ashtu, Gjykata vëren se në drejtim të së *drejtës së aksesit* kërkuesit kanë argumentuar se referuar pretendimeve të paraqitura në rekurs, në shtesën e rekursit dhe në shpjegimet e datës 07.09.2023, duke pasur parasysh edhe kompleksitetin e çështjes, Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore për të dëgjuar edhe palët.

32. Në lidhje me mospjesëmarrjen e palëve gjatë fazës së shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se kjo nuk përbën proces të parregullt ligjor, pasi ky rregull i sanksionuar në dispozitat procedurale niset nga fakti se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është seleksionues dhe i kufizuar në raste nga ligji, kështu që s'ka të bëjë me shqyrtimin gjyqësor të çështjes (*shih vendimin nr. 65, datë 04.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit në dhomën e këshillimit të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe nëse krijon bindjen se ato objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, është në

funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 22, datë 06.06.2011; nr. 18, datë 18.05.2011; nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa më lart, në rastin konkret, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale të nenit 480 të KPC-së, sipas të cilave mospranimi i rekursit vendoset në dhomën e këshillimit, pra pa praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga kjo dispozitë. Po ashtu, Gjykata evidenton se kërkuesit, edhe pse kanë barrën e provës në këtë drejtim, nuk kanë arritur të provojnë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Ndaj argumentet e tyre se Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore për të dëgjuar palët janë haptazi të pabazuara.

34. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesve në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, konkretisht ato për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën dhe thelbin e tyre, Gjykata çmon t'i shqyrtojë në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

35. Kërkuesit kanë pretenduar se edhe pse në rekurs kanë ngritur pretendime për shkelje të procesit të rregullt nga gjykatat më të ulëta, Gjykata e Lartë nuk i ka riparuar ato. Sipas kërkuesve, Kolegji Civil nuk ka arsyetuar pretendimet për shkeljet procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta, të paraqitura në shtesën e rekursit të datës 13.07.2021, si dhe në shpjegimet e datës 07.09.2023, të cilat jo vetëm që nuk janë marrë në shqyrtim, por as nuk janë pasqyruar në vendim, në pjesën hyrëse ku parashtrohen shkaqet e rekursit. Në vlerësimin e kërkuesve ky qëndrim i Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese.

36. Subjekti i interesuar ka parashtruar se ky pretendim i kërkuesve është

i pabazuar, pasi në rekursin e paraqitur prej tyre nuk ka asnjë pretendim për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimeve apo që vendimet bien ndesh me vendimet unifikuese. Po ashtu, sipas subjektit të interesuar, në asnjë dispozitë ligjore nuk parashikohet që të bëhet shtesë rekursi pesë vjet pasi është dhënë vendimi gjyqësor. Gjithsesi, subjekti i interesuar ka prapësuar duke argumentuar se edhe në shtesën e rekursit kërkuesit nuk rezulton të kenë paraqitur asnjë argument për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit apo që vendimet bien ndesh me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe se ata kanë marrë përgjigje nga gjykatat për të gjitha pretendimet e tyre.

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në rastet kur pretendimet me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë dhe atyre nuk u jepet përgjigje, arsyetimi i vendimit të asaj gjykate nuk ka përmbushur një ndër funksionet e tij, konkretisht të drejtën e individit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 28, datë 11.04.2024; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura prej kërkuesve në rekurs apo në shtesën e rekursit, nëse ato pretendime kanë natyrë kushtetuese, si edhe nëse ato janë vlerësuar prej saj në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, Gjykata do të analizojë nëse Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

39. Në rastin konkret, rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje

mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesit. Po ashtu, referuar akteve të paraqitura nga kërkuesit bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se ata kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe dy akte të tjera, njërin të titulluar "Shtesë rekursi" (fotokopje të noterizuar të tij), në të cilin është shënuar edhe vula e Gjykatës së Lartë, me numër protokolli 2461 dhe datë depozitimi 13.07.2021, si dhe aktin e titulluar "Shpjegime", të depozituar në Gjykatën e Lartë në datën 07.09.2023, me numër protokolli 4412 (edhe kjo fotokopje e noterizuar). Ndërkohë, sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata vëren se në të gjendet i administruar vetëm akti i titulluar "Shpjegime", i datës 07.09.2023, por nuk rezulton të jetë administruar akti i titulluar "Shtesë rekursi", i datës 13.07.2021. Po ashtu, referuar përmbajtjes së këtyre akteve, Gjykata vëren se ato ndryshojnë vetëm në emërtimin e tyre, por argumentet e parashtruara në to janë të njëjta.

40. Në lidhje me përmbajtjen e tyre (shtesës së rekursit dhe shpjegimeve), Gjykata konstaton se kërkuesit kanë argumentuar se gjykata e apelit nuk ka pasur parasysh se objekti i mosmarrëveshjes ka qenë i paqartë; gjykatat gjatë shqyrtimit të çështjeve kanë detyrimin të vlerësojnë dhe të marrin parasysh të gjithë përmbajtjen e akteve procedurale; gjykatat nuk e kanë zgjidhur çështjen konform shkakut që ka referuar paditësi; gjykata e apelit është shprehur për pasuri të cilat nuk janë objekt i ndonjë marrëveshjeje midis palëve ndërgjyqëse dhe ka disponuar për pasuri të cilat janë në pronësi të personave të tretë, që nuk kanë qenë palë në gjykim; referimi që bën gjykata e apelit se ka akte të shkruara nga i padituri që njeh 50% të fitimit, është në shkelje të rëndë të dispozitave ligjore; këto akte nuk duhet të ishin administruar në gjykim si provë shkresore; noterizimi i shënimeve nuk u jep atyre vlerën e provës; gjykatat kanë anashkaluar analizën dhe vlerësimin e marrëdhënies kontraktore të krijuar, nëse është e tillë që konsiderohet nga ligji si kontratë kalimi pronësie; kontratat nuk janë përpiluar dhe nënshkruar përpara noterit; në kushtet kur nuk ekzistonte asnjë kontratë shitjeje e pasurive të paluajtshme, gjykatat ishin të detyruara të mos i konsideronin si kontrata për tjetërsim pasurie; paditësi nuk ka provuar me asnjë provë, siç e kërkon ligji, që gjykatat t'i njihnin pronësinë; kontrata e datës 13.11.2005, duke mos qenë me akt noterial, nuk mund të konsiderohet si veprim juridik i vlefshëm për tjetërsim pasurie; mosmarrëveshja duhej të ishte zgjidhur duke iu referuar aktmarrëveshjes të datës 25.01.2004; gjykata e apelit ka llogaritur një fitim fiktiv, duke shmangur kontratat e porosisë dhe kontratat përfundimtare të shitjes.

41. Në rastin konkret, referuar vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse të tij, ku parashtrohen pretendimet e rekursuesve, ai kolegj ka pasqyruar, ndër të tjera, edhe pretendimin e kërkuesve që lidhet me pronësinë e dyqanit prej 73 m^2, sipas të cilëve ajo u ka kaluar personave të tretë, po ashtu edhe pretendimin tjetër të tyre se gjykata e apelit në arsyetimin e saj është mbështetur në tregues fiktivë, dy pretendime këto të parashtruara edhe në aktet e sipërpërmendura (shtesa e rekursit dhe shpjegimet). Për sa i përket vlerësimit të shkaqeve të rekursit, sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ato nuk bëjnë pjesë në rastet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Kolegjit Civil, gjykata e apelit ka respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, ka arsyetuar në mënyrë ezauruese shkakun e vendimmarrjes dhe nuk rezulton të ketë zbatim të gabuar të ligjit procedural. Në vlerësimin e Kolegjit Civil vendimmarrja e gjykatës së apelit nuk bie ndesh me ndonjë vendim unifikues të Gjykatës së Lartë dhe pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate (*shih paragrafët 30-31 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

42. Për sa më lart, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është arsyetuar në mënyrë të kufizuar, duke u formuluar në mënyrë standarde. Një arsyetim i tillë është pranuar nga jurisprudenca kushtetuese si në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë që në pjesën hyrëse pasqyrohen shkaqet e ngritura në rekurs. Po ashtu, Gjykata rithekson se ky element është i rëndësishëm në rastin e arsyetimit të kufizuar të vendimit, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe se çështja e tyre është vlerësuar nga Gjykata e Lartë. Në çështjen në shqyrtim, referuar thelbit të argumenteve të parashtruara nga kërkuesit në aktet "Shtesë rekursi" dhe Shpjegime", Gjykata vëren se ato në thelb, kanë natyrë ligjore dhe nuk lidhen me shkelje procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta ose pretendime të cilat kanë të bëjnë me të drejta kushtetuese. Thënë ndryshe, pretendimet e parashtruara nga kërkuesit në aktet shtesë të paraqitura pas rekursit kanë natyrë ligjore dhe jo kushtetuese.

43. Gjithashtu, siç edhe është konstatuar më lart në këtë vendim (*shih paragrafin 40 të vendimit*), Gjykata konstaton se nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se kërkuesit kanë depozituar edhe aktin "Shtesë rekursi", i cili ndonëse ka të njëjtën përmbajtje me aktin "Shpjegime", nuk gjendet në dosje, çka tregon se nuk është vlerësuar prej Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se Gjykata e Lartë

duhet të tregojë kujdes të shtuar dhe duhet të zbatojë dispozitat ligjore në atë mënyrë që t'i garantojë individit garancitë kushtetuese të parashikuara në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 13, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), ku përfshihet edhe administrimi i të gjitha akteve të depozituara nga palët, mbi të cilat zhvillohet më pas gjykimi në atë gjykatë.

44. Gjithsesi, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kjo e metë (mosadministrimi i shtesës së rekursit nga Kolegji Civil) nuk e bën procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë të parregullt, në aspektin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, për sa kohë prej Kolegjit Civil është administruar akti "Shpjegime", i cili ka përmbajtje të njëjtë me aktin "Shtesë rekursi" dhe për sa kohë pretendimet e ngritura në ato akte kanë natyrë ligjore dhe nuk lidhen me shkelje procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta ose pretendime të cilat kanë të bëjnë me të drejta kushtetuese. Në vlerësimin e Gjykatës jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Për rrjedhojë, në rastin konkret, Gjykata çmon se gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura prej kërkuesve në rekurs apo në aktet e paraqitura pas rekursit (aktit "Shpjegime"), duke i vlerësuar ato në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në vlerësimin e Gjykatës, mosmarrja në shqyrtim e shtesës së rekursit dhe mungesa e parashtrimit në vendimin e Gjykatës së Lartë të të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuesit në aktet e depozituara pas paraqitjes së rekursit, të cilat në thelb kishin natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

46. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.01.2025
Shpallur më 26.02.2025

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 14 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar që u përket kërkuesve, shoqërisë "DEA-Z" sh.p.k. dhe Zaim Korsi, me objekt: *"Shfuqizimin e vendimeve nr. 2943, datë 10.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 665, datë 29.03.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-4272, datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë",* edhe pse i bashkohemi shumicës në lidhje me zgjidhjen e saj, pra për rrëzimin e kërkesës, qëndrimi ynë vetëm për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor bazohet në një qasje të ndryshme, në koherencë me atë që kemi mbajtur më parë në çështje të ngjashme *(shih mendimin e pakicës në vendimin nr. 77, datë 05.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

2. Fillimisht çmojmë të evidentojmë faktet relevante në lidhje me pretendimin e kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kështu, në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar Viktor Ndoci, me vendimin e datës 10.04.2015, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së tij. Pas ankimimit të këtij vendimi nga të dyja palët ndërgjyqëse, me vendimin e datës 29.03.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka ndryshuar pjesërisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar plotësisht kërkimin e padisë për njohjen pronar. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesja, shoqëria "DEA-Z" sh.p.k., ka paraqitur rekurs dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 08.07.2016. Ndërsa rekursi ka qenë në pritje për t'u shqyrtuar kjo kërkuese ka depozituar në Gjykatën e Lartë aktin "Shtesë rekursi" dhe në vijim edhe aktin "Shpjegime". Në përfundim të shqyrtimit të rekursit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

3. Në analizë të fakteve të evidentuara kronologjikisht si më lart, konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë mban datën 29.03.2016 dhe shoqëria "DEA-Z" sh.p.k., brenda afatit ligjor 30-ditor, sipas nenit 443, paragrafi 2, të KPC-së, ka ushtruar rekurs ndaj tij në datën 26.04.2016. Në vijim, në datën 13.07.2021, pra pas më shumë se 5 vjetëve nga vendimi i gjykatës së apelit kjo kërkuese ka depozituar në Gjykatën e Lartë aktin

"Shtesë rekursi", ndërsa pas më shumë se 7 vjetëve nga vendimi i gjykatës së apelit, në datën 07.09.2023, ajo ka depozituar në atë gjykatë edhe aktin "Shpjegime". Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit të datës 25.10.2023, duke iu referuar rekursit të datës 26.04.2016, pasi ka shqyrtuar kriteret e pranueshmërisë së shkaqeve të parashtruara në të ka vendosur mospranimin e tij. Në vendimin e saj ajo gjykatë nuk ka evidentuar faktin e paraqitjes nga pala rekursuese (shoqëria "DEA-Z" sh.p.k.) të shtesës së rekursit dhe të shpjegimeve dhe as nuk rezulton të ketë ka arsyetuar në lidhje me pranueshmërinë e tyre.

4. Bazuar në faktet si më sipër, vërehet se shtesa e rekursit, sikundër edhe shpjegimet që janë depozituar në Gjykatën e Lartë gjatë kohës që rekursi ishte regjistruar në atë gjykatë dhe ishte në pritje të shqyrtimit, referuar të cilave kërkuesit ngrenë pretendimin për cenimin e procesit të rregullt në atë gjykatë, datojnë shumë vite pas mbarimit të afatit ligjor për ushtrimin e së drejtës së rekursit. Dispozitat procedurale civile në lidhje me mjetet dhe afatet e ankimit kanë parashikuar rekursin si mjetin e ankimit në Gjykatën e Lartë (neni 442 i KPC-së), afati ligjor i paraqitjes së të cilit është 30 ditë (neni 443 i KPC-së), afat ky që, sipas ligjit procedural të kohës (neni 444 i KPC-së), fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Po kështu, dispozitat procedurale parashikojnë se shkaqet e rekursit janë përcaktuese për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë (neni 473/a). Referuar këtyre rregullimeve ligjore, vlerësojmë se kohëzgjatja e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë nuk nënkupton dhe as mund të shërbejë si shkak për t'i dhënë palës rekursuese të drejtën për të paraqitur në çdo kohë pretendime ose shkaqe të reja për kundërshtimin e procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, të ndryshme ose përtej atyre të parashtruara në rekurs, si akti i vetëm procedural që vë në lëvizje atë gjykim dhe përcakton edhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë, sikurse një gjë e tillë pohohet nga kërkuesit në ankimin e tyre kushtetues individual (*shih paragrafin e fundit në faqen 11 të ankimit kushtetues individual*), sikundër nuk mund të shërbejë as për të zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po kështu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e

shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme *(shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

6. Për rrjedhojë, në rastin konkret, vetëm fakti i mosevidentimit në vendimin e Gjykatës së Lartë të paraqitjes nga kërkuesja, shoqëria "DEA-Z" sh.p.k., të aktit "Shtesë rekursi" dhe të aktit "Shpjegime", për rrjedhojë edhe mungesa e arsyetimit, qoftë edhe minimal, për papranueshmërinë e tyre për shkak të paraqitjes dukshëm jashtë afatit ligjor të parashikuar nga ligji procedural për ushtrimin e këtij mjeti ankimi (rekursi), pa i hyrë faktit nëse në ato akte janë parashtruar ose jo pretendime të reja, të ndryshme nga ato të parashtruara në rekurs dhe të lejuara nga ligji, në vlerësimin tonë nuk mund të përbëjë shkak për të arritur në përfundimin e cenimit nga Gjykata e Lartë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe as mund të vërë në dyshim të drejtën e aksesit të kërkueses, pra për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në atë gjykatë. Edhe duke pranuar se vendimi i Gjykatës së Lartë shfaq një mangësi në aspektin formal të tij, për sa kohë që ajo gjykatë nuk kishte asnjë pengesë që të sqaronte palën rekursuese në lidhje me shkakun për të cilin nuk ka pasqyruar në vendim, për rrjedhojë nuk ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në aktet e tjera të paraqitura përtej rekursit, një mangësi e tillë kurrsesi nuk mund të çojë në një përfundim të ndryshëm në lidhje me pretendimin e kërkuesve për cenimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor.

7. Në përfundim, jemi të qëndrimit se pretendimi i kërkuesve për cenimin nga Gjykata e Lartë të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, është i pabazuar sipas arsyetimit si më sipër.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Ilir Toska, Genti Ibrahimi

Vendim nr. 6, datë 10.02.2025
(V-6/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datën 28.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 5 (Nj) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga deputete Ina Zhupa dhe avokat Franci Nuri, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Gazmend Bici, me autorizim.
AKADEMIA E SHKENCAVE, përfaqësuar Alma Bela, me autorizim.
PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i ligjit nr. 69/2023, datë 21.07.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.07.2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, pika 1, 6, 7, 15, 18, 81, 82, 83, 124, 131, pika 1, shkronjat "a" dhe "e", 134, pika 1, shkronja "c" dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* ligji nr. 53/2019, datë 18.07.2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, jo më pak se një të pestës së deputetëve *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)* dhe të Akademisë së Shkencave *(Akademia)*, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë *(Presidenti)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.07.2019 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 53/2019),* qëllimi dhe objekti i të cilit kanë qenë përcaktimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe funksionimin e Akademisë, përcaktimi i rolit, i organeve përbërëse dhe i atyre që veprojnë pranë saj, si dhe rregullimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera të kërkimit shkencor e të politikave të zhvillimit.

2. Në datën 20.07.2023 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 69/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.07.2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"" *(ligji nr. 69/2023)*. Presidenti e ka kaluar në heshtje, pa dekret, për rrjedhojë ligji është shpallur me kalimin e afatit 20-ditor, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 84 të Kushtetutës dhe ka hyrë në fuqi në datën 06.09.2023, pra 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 124, datë 21.08.2023. Nga përmbajtja e relacionit shoqërues rezulton se qëllimi ka qenë korrigjimi i bazave juridike të ligjit nr. 53/2019 për organizimin dhe funksionimin e Akademisë. Objektivat e tij kanë qenë të lidhura me përbërjen dhe detyrat e Asamblesë, me zgjedhjen e kryesisë, me vlefshmërinë dhe ndërprerjen e mandateve, si dhe me administratën e Akademisë. Me ligjin nr. 69/2023 u riformuluan dhe shfuqizuan dispozitat si vijojnë:

3. U riformulua pika 3 e nenit 6: *"Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas jo shqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit*

të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare. Numri i anëtarëve të nderit është deri në 15. Personat me origjinë shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të "All European Academies", fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë".

4. U riformulua neni 10: *"Anëtarët e jashtëm dhe ata të nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë pa të drejtë vote, si dhe në të gjitha aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë dhe të anëtarëve të saj, të parashikuara në nenet 4 dhe 9 të këtij ligji".*

5. U riformulua pika 3 e nenit 11: "*Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë".*

6. U riformulua pika 4 e nenit 11: "*Mandati i kryetarit dhe i zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai i sekretarit shkencor dhe i drejtuesve të seksioneve është 5 vjet. Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate".*

7. U shfuqizuan pikat 9 dhe 10 të nenit 11, në pikën 4 të nenit 14 fjala "korrespondent" është zëvendësuar me fjalën "i jashtëm" dhe u shfuqizua shkronja "c", pika 2, e nenit 16 të ligjit nr. 53/2019 (sipas së cilës mbushja e moshës 75 vjeç ishte shkak për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Asamblesë).

8. Në datën 10.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 69/2023, i cili ka riformuluar dhe ka ndryshuar disa dispozita të ligjit nr. 53/2019, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 10.06.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

9.1. *Për procedurat parlamentare*

9.1.1. *Procedura e miratimit të ligjit nr. 69/2023 cenon nenin 78, pika 2, të Kushtetutës,* pasi mbledhja e Komisionit

Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik *(Komisioni i Edukimit)* është mbajtur në shkelje të Rregullores së Kuvendit. Më konkretisht, projektligji është futur në kalendarin e punës së Kuvendit për periudhën 22 maj-30 qershor dhe është marrë në shqyrtim në datën 11 korrik 2023. Mbledhja e Komisionit të Edukimit është zhvilluar me anëtarët zëvendësues të komisionit, në shkelje të nenit 21/1, pika 2, të Rregullores së Kuvendit. Kryetarja e komisionit nuk e ka thirrur mbledhjen dhe një e katërta e anëtarëve nuk mund ta thërriste atë pa depozituar kërkesën zyrtare në protokoll, ku të vërtetoheshin firmat e kërkuesve, duke u cenuar pika 2 e nenit 32 të Rregullores Kuvendit. Gjithashtu, programi i punës dhe kalendari i komisionit nuk ishin përgatitur nga kryetari i komisionit sipas nenit 33 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji i paraqitur për miratim në komision nuk ka qenë i shoqëruar me raportin final, sipas nenit 38, pika 5/1, të Rregullores së Kuvendit dhe hartimi e miratimi i tij kanë shkelur nenet 68, pika 2 dhe 70, pikat 3 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, pasi nuk përmbante objektivat që synoheshin të arriheshin, si dhe raportin e hartuar nga komisioni përgjegjës për seancën plenare. Nga pikëpamja formale pretendohet se ligji e ka zanafillën pas vendimit nr. 50 të vitit 2022 të Asamblesë, por ky vendim është vetëm një dokument i brendshëm, pa vlerë juridike, i cili nuk tregon aspak që Akademia të ketë diskutuar, analizuar ose ngritur grup pune për nevojën e ndryshimeve ligjore.

9.2. *Për themelin. Dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 69/2023 cenojnë:*

9.2.1. *Parimet e shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të konfliktit të interesave, si dhe atë të hierarkisë së normave,* pasi ligji duhet të jetë i përgjithshëm dhe në funksion të interesit të shoqërisë dhe jo të një individi të paracaktuar ose të caktueshëm lehtësisht. Nuk mund të konsiderohet ligj një normë, e cila nuk synon rregullimin e situatave të përgjithshme dhe nuk mbart karakter universal, të mbështetur në interesin e përgjithshëm publik që në realitet është shtrembërim i kushteve dhe kritereve të ligjit në funksion ose në shërbim të një individi. Kryetari i Akademisë gjatë kohës që shqyrtohej

ligji nuk i plotësonte kushtet ligjore për të kandiduar sepse sipas ligjit nr. 53/2019 nuk lejohej të kandidonte për dy mandate radhazi, si dhe plotësimi i moshës mbi 75 vjeç përbënte shkak për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Asamblesë. Me ndryshimet e fundit ligjore ai i plotëson kriteret e reja, pasi të dyja këto kushte janë shfuqizuar. Sipas ligjit nr. 69/2023, askush nga akademikët nuk mund të ketë të drejta dhe detyra si akademik ose akademik i asociuar pas moshës 75 vjeç përveç Kryetarit. Ky është një nonsens juridik që nuk mund të ndodhë në një shtet të së drejtës, pasi: ose të gjithë akademikët mbi 75 vjeç do të vazhdojnë të jenë anëtarë të asamblesë, të ushtrojnë të drejta dhe detyra si më parë; ose asnjëri nga ata, sepse *cenohet neni 18 i Kushtetutës, barazia përpara ligjit.* Ligji trajton ndryshe situata të njëjta, krijon diskriminim dhe pabarazi midis anëtarëve të Akademisë, me qëllim favorizimin e kryetarit aktual të institucionit, duke i hapur rrugë rizgjedhjes së tij. Edhe vetë heqja e togfjalëshit *"por jo radhazi",* i parashikuar në ligjin nr. 53/2019, duke i hapur rrugë rizgjedhjes së kryetarit për një mandat të dytë, cenon parimin e barazisë përpara ligjit. Vetë nismëtarët e ligjit janë ata që përfitojnë nga ndryshimet ligjore, duke dëshmuar *se ligji krijon konflikt interesi dhe është në shkelje të Kushtetutës.* Të gjitha këto pretendime duhet të shqyrtohen në këndvështrimin e respektimit *të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.* Parimi i shtetit të së drejtës është trajtuar i lidhur ngushtë edhe me *parimin e hierarkisë së akteve normative*, duke e konsideruar këtë të fundit si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Ligji nr. 53/2019, i ndryshuar me ligjin nr. 69/2023 duhet të garantojë parimin kushtetues të autonomisë dhe lirisë akademike, të parashikuar nga neni 57, pika 7, i Kushtetutës, sipas të cilit statusi i anëtarit të rregullt të Akademisë nuk është i barabartë në të drejta me kryetarin aktual, të cilit i jepen privilegje.

9.2.2. *Parimin e sigurisë juridike,* pasi ligji përmban dispozita që kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe nuk ka qartësinë e nevojshme në zbatim. Nga njëra anë përcakton se personat mbi 75 vjeç fitojnë statusin e anëtarit "emeritus", i cili u heq disa të drejta dhe detyrime, pasi nuk konsiderohen më pjesë e Asamblesë,

por, nga ana tjetër, përjashtohet kryetari, i cili, edhe pse me mbushjen e moshës 75 vjeç, do të vijojë të ushtrojë këtë detyrë. Ligji në fuqi konsideron se faktori moshë, pa përjashtuar askënd, merret si parametri kryesor, sipas të cilit anëtari i Asamblesë kalon në një status tjetër, në anëtar "emeritus", duke u përjashtuar nga detyrimi për të marrë pjesë aktivisht në mbledhjet e Asamblesë, të seksioneve, të komisioneve dhe nga e drejta për t'u zgjedhur në organet drejtuese. Nga njëra anë, ligji nuk e detyron anëtarin "emeritus" të marrë pjesë në veprimtarinë e Akademisë dhe, nga ana tjetër, kryetari (me statusin "emeritus") do të vijojë të drejtojë dhe të organizojë punën e Akademisë. Për këto arsye ligji është kontradiktor dhe i pazbatueshëm.

10. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** ka prapësuar si vijon:

10.1. *Për procedurat parlamentare*

10.1.1. *Pretendimi është i pabazuar,* pasi projektligji i është nënshtruar shqyrtimit në dy komisione parlamentare, në Komisionin e Edukimit, në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut *(Komisioni i Ligjeve),* në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, si dhe në Komisionin e Edukimit gjatë seancës dëgjimore janë ftuar edhe anëtarët e Asamblesë. Në mbledhjen e Komisionit të Edukimit ka qenë kuorumi i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen dhe për të marrë vendim. Projektligji është votuar nga numri i kërkuar i deputetëve sipas Rregullores së Kuvendit dhe, si i tillë, është plotësisht i ligjshëm. Për këtë arsye, pretendimi i kërkuesit nuk ka bazë dhe nuk qëndron. Hartimi i projektligjit nga nismëtari nuk është bërë mbi bazën e një liste moshe me subjektet që aspirojnë për të kandiduar në organet drejtuese, por mbi bazën e një logjike e cila i hap rrugën zgjerimit dhe një përfshirjeje më të gjerë kandidatësh, të cilët sigurisht vendosin të kandidojnë me vullnetin e tyre të lirë. Nga ana tjetër, në transparencë të këtij procesi, komisioni parlamentar përgjegjës, gjatë shqyrtimit të projektligjit ka ftuar në dëgjesë anëtarët e Asamblesë, për

të marrë edhe opinionin e tyre për projektligjin. Projektligjin e ka kundërshtuar vetëm 1 nga 54 anëtarët e Asamblesë, gjë e cila konfirmon qartësisht mbështetjen masive të të gjithë trupës së Akademisë.

10.2. *Për themelin*

10.2.1. *Pretendimi se ligji cenon nenin 18 të Kushtetutës është i pabazuar*, pasi ndryshimet nuk bien ndesh me asnjë normë të Kushtetutës, ato kanë karakter thjesht dhe vetëm teknik. Kërkuesi nuk provon në asnjë pjesë të parashtrimeve që ligji nr. 69/2023 diskriminon personin/kandidatin për të garuar si kryetar për asnjë nga shkaqet e përcaktuara në Kushtetutë, siç janë: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Ligji nr. 69/2023 nuk shpall askënd fitues, por, përkundrazi, zgjeron rrethin e kandidatëve dhe fituesit shpallen me votat e anëtarëve të Asamblesë, me votim të fshehtë e shumicë absolute, sikurse përcakton neni 11, pika 3, i riformuluar nga ligji objekt shqyrtimi. Ligji nuk krijon pabarazi midis akademikëve mbi 75 vjeç, as mes tyre, as në raport me të tjerët, përkundrazi zgjeron të drejtat e tyre. I vetmi kufizim që ka mbetur pas amendimit është pengesa për të kandiduar në organet drejtuese pas moshës 75 vjeç. Ligji nr. 69/2023 ka hequr kufizimin për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Asamblesë në rast se mbush këtë moshë.

10.2.2. *Pretendimi se ligji cenon parimin e sigurisë juridike është i pabazuar, pasi* ligji është në përputhje me frymën kushtetuese dhe praktikën e konsoliduar ndërkombëtare, sepse e drejta për t'u zgjedhur për dy mandate, pa kushte, është e sanksionuar edhe në legjislacionin e akademive të shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë në Evropë. Ligji nr. 69/2023 është në përputhje me nenin 58 të Kushtetutës, i cili garanton se liria e kërkimit shkencor mbrohet me ligj dhe nuk bie ndesh me asnjë dispozitë të Kushtetutës, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar.

11. ***Subjekti i interesuar, Akademia,*** ka prapësuar si vijon*:*

11.1. *Për juridiksionin e Gjykatës*

11.1.1. Akademia nuk është institucion i parashikuar në Kushtetutë, por vetëm i përmendur nga Kushtetuta. Për më tepër,

nëpërmjet kërkesës së paraqitur nga kërkuesi dhe në tërësi nga parashtrimet e faktet e pretenduara është arritur në përfundimin se, në thelb, Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë legjitimitetin e rikandidimit e të zgjedhshmërisë së kryetarit të Akademisë. Pra, Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë një çështje sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c" dhe qëllimisht ngatërrohet me çështjen e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën.

11.2. *Për procedurat parlamentare*

11.2.1. *Pretendimi është i pabazuar,* pasi ligji, si projekt fillestar, është ideuar, kërkuar e mbështetur nga Asambleja me të drejtën që gëzon një institucion autonom për organizimin e vet. Ky vendim është miratuar me shumicën e anëtarëve të Asamblesë dhe me vetëm një abstenim. Pra, ligji nuk krijon pabarazi midis anëtarëve, nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe autonominë e institucionit. Çdo "akuzë" për kapje institucionale ose cenim të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi një institucion kolegjial autonom nuk ndodh të kapë vetveten, të shkelë të drejtat e veta ose edhe të një anëtari të vetëm me anë të ligjit për organizimin e funksionimin e tij. Procedura që është ndjekur për miratimin e ndryshimeve objekt të këtij gjykimi, është e njëjta procedurë që është ndjekur edhe për hartimin e miratimin e ligjit nr. 53/2019. Shtatë vjet më parë Akademisë i është kërkuar ta bëjë vetë reformimin e saj, në respektim të statusit si institucion autonom. Projektligji i ri është hartuar nga një grup pune i ngritur nga Asambleja, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin. Shumicën dërrmuese dhe drejtimin e grupit e përbënin anëtarët e Akademisë. Pas hartimit e marrjes së pëlqimit për të edhe nga ALLEA (European Federation of Sciences and Humanities-grupimi i 60 akademive të vendeve të Bashkimit Evropian), në respekt të autonomisë së Akademisë është vlerësuar që projektligji t'i kalojë drejtpërdrejt Kuvendit nëpërmjet nismës së deputetëve dhe jo të ekzekutivit (qeverisë). Deputeti relator i ligjit ka ndjekur në vazhdimësi veprimtarinë e Akademisë, për rrjedhojë është njohur paraprakisht për nevojën e këtyre ndryshimeve dhe ka marrë nismën për këto ndryshime së

bashku me një koleg. Çdo procedurë është ndjekur dhe është kryer me dijeni të Asamblesë dhe në mënyrë transparente. Zbatimi i Rregullores së Kuvendit është një çështje e brendshme e Kuvendit. Paraqitja e një projektligji me 4-5 nene (saktësisht më 09.01.2023) dhe miratimi pas 6 muajve nuk përbën asnjë privilegj ose shkelje të afateve minimale për shqyrtimin e tij. Pas konfliktit publik-mediatik, ai ka vazhduar në Kuvend. Ndërkohë nismëtarët, në të drejtën e tyre, e kanë tërhequr amendamentin që lidhej me financat, pavarësisht që dukshëm projektligji nuk kishte efekte financiare. Në praktikën parlamentare nuk ka ndodhur që një komision të mos votojë për një projektligj pas shqyrtimit të tij. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Asamble e më pas në Kuvend, në Komisionin e Edukimit dhe veçanërisht në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për mospërputhje të amendamenteve të propozuara me normën kushtetuese. Akademia, me vendimin nr. 50, datë 08.09.2022 të Asamblesë, ka shprehur miratimin e saj për ndryshimet në ligj.

11.3. *Për themelin*

11.3.1. *Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit është i pabazuar,* pasi ndryshimet kryesore në ligj lidhen me: (i) heqjen e kufizimit të numrit të anëtarëve të jashtëm, sepse është hequr kufizimi deri në 10, duke riformuluar nenin 6, pika 3, të ligjit nr. 53/2019; (ii) rizgjedhjen për dy mandate të kryetarit, zëvendëskryetarit, sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve, duke u hequr togfjalëshi *"por jo radhazi".* Riformulimi nuk bie ndesh me asnjë normë të Kushtetutës. Ai është në përputhje të plotë edhe me frymën kushtetuese e praktikën e konsoliduar ndërkombëtare, pasi e drejta për t'u zgjedhur për dy mandate, pa kufizime, është e sanksionuar në legjislacionin e shumë akademive të shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë në Evropë e Shqipëri. Kjo mundësi parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë". Kushtëzimi që mandatet të mos ishin radhazi ishte i pazakontë, e për më tepër sipas ligjit nr. 53/2019 jo vetëm nuk ndalohej rikandidimi, por bëhej i interpretueshëm

për tre mandate. Ndryshimi për heqjen e kufizimit në numër për anëtarët e jashtëm u imponua nga nevoja e hapjes së mëtejshme të Akademisë ndaj diasporës shkencore, e cila është zgjeruar e mbart potenciale të mëdha shkencore. Ky ndryshim, ndër të tjera, ka mundësuar pranimin e 6 anëtarëve të rinj të jashtëm e do të mundësojë pranimin nga personalitete të shquara të shkencës në Diasporë. Përmbajtja e ligjit objekt gjykimi nuk krijon pabarazi midis akademikëve 75 vjeç, as midis tyre, as në raport me të tjerët, përkundrazi zgjeron të drejtat e tyre. Për detyrat e marra anëtarët "emeritus" mbajnë përgjegjësi si të gjithë anëtarët e tjerë Fjalia se "pjesëmarrja e tyre në mbledhje është sipas mundësisë" nuk është kufizim, siç është interpretuar nga kërkuesi, ajo ka vetëm kuptimin që një akademik "emeritus" nuk përballet me ndëshkime për mospjesëmarrje fizike në mbledhje sipas nenit 6, pika, 2 të statutit. I vetmi kufizim që ka mbetur pas amendimit është pengesa për të kandiduar në organet drejtuese pas moshës 75 vjeç, por ndërkohë ligji i ri heq ndërprerjen e mandatit në rast se anëtari mbush këtë moshë, pasi u vlerësua e tepërt që të kishte dy kufizime moshore, si në marrjen e mandatit, ashtu edhe në mbylljen e tij përpara se të kishte përfunduar. Pra, ligji i zgjeron të drejtat e anëtarëve "emeritus" pa asnjë dallim dhe u kthen anëtarëve mbi 75 vjeç të drejtën e votës së anëtarësinë në Asamble të hequr me ligjin e mëparshëm (2007), masë e vlerësuar kjo si antikushtetuese nga Gjykata me vendimin nr. 36, datë 15.10.2007, duke i bërë anëtarë të Asamblesë me të drejta e detyrime të plota. Ligji objekt gjykimi nuk shpall askënd fitues, ai lejon gjithkënd të kandidojë dhe të shpallet fitues me votat e anëtarëve të Asamblesë, me votim të fshehtë e shumicë absolute.

12. ***Subjekti i interesuar, Presidenti***, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III
Procesi në gjykimin kushtetues

13. Kërkuesi në seancën plenare publike i ka parashtruar Gjykatës dy kërkesa paraprake: (i) vendosjen në dispozicion të vendimit për

mosthirrjen e akademikut Artan Fuga, si subjekt i interesuar; (ii) thirrjen e dy deputetëve të nismës ligjvënëse dhe të Presidentit, si dëshmitarë në gjykimin kushtetues.

14. Gjykata, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesat paraprake, ka ritheksuar se bazuar në nenin 39, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 dhe në jurisprudencën kushtetuese, përcaktimi i subjekteve të interesuara është në diskrecion të saj. Në këtë drejtim ajo niset nga interesi që ka thirrja e tyre për të kontribuar në vendimmarrjen për çështjen që shqyrtohet. Vlerësimi i legjitimimit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interesin e subjektit, por edhe të gjykimit kushtetues. Në këtë kuptim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuesit ose edhe kryesisht nga Gjykata *(shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 9, datë 01.03.2021; nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Fillimisht, Gjykata thekson se identifikimi i subjekteve të interesuara është përcaktuar në nenin 26 pika 2 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës e sipas këtyre parashikimeve, rrethi i këtyre subjekteve identifikohet nga Kolegji i Gjykatës, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës. Në atë vendimmarrje të Kolegjit është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike duke u përcaktuar edhe rrethi i subjekteve të interesuara, siç ishin identifikuar edhe nga vetë kërkuesi në kërkesën e tij të datës 10.05.2024. Pavarësisht se ky i fundit, formalisht nuk e kishte kërkuar përfshirjen e akademikut Artan Fuga në cilësinë e subjektit të interesuar, në brendësi të kërkesës së tij i ishte referuar përfshirjes së tij, si subjekt i interesuar. Megjithatë, Kolegji i Gjykatës gjatë shqyrtimit paraprak ka vendosur të mos e përfshijë akademikun Artan Fuga në rrethin e subjekteve të interesuara.

16. Në datën 13.06.2024 vendimi i Kolegjit të Gjykatës i marrë gjatë shqyrtimit paraprak i është njoftuar kërkuesit, duke e bërë me dije se qëndrimin e akademikut Artan Fuga mund ta bënte pjesë të parashtrimeve të tij.

17. Kërkuesi e ka përsëritur kërkesën për përfshirjen e akademikut Artan Fuga edhe në datën 19.06.2024. Në përgjigje të kësaj kërkese, në datën 28.06.2024, nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm të Gjykatës, i është kthyer përgjigje kërkuesit sërish për vlerësimin e sipërcituar të Kolegjit gjatë shqyrtimit paraprak, ku theksohet se Kolegji nuk kishte vlerësuar të thërriste në cilësinë e subjektit të interesuar akademikun Artan Fuga.

18. Në datën 13.07.2024 kërkuesi ka kundërshtuar shkresën e datës 28.06.2024. Pas shqyrtimit të kësaj kërkese, në datën 20.09.2024, atij i është përcjellë në rrugë administrative vlerësimi i trupës së gjyqtarëve të Gjykatës për mospranimin e kërkesës për thirrjen e subjektit të interesuar z. Artan Fuga.

19. Për kërkimin e parë për disponimin e vendimit për mospranimin e kërkesës për të thirrur si subjekt të interesuar akademikun Artan Fuga, Gjykata gjatë vlerësimit mbajti në konsideratë se ajo është vënë në lëvizje nga kërkuesi për kontrollin abstrakt të normës, për rrjedhojë çmoi se akademiku Artan Fuga në rastin konkret nuk është në rrethin e subjekteve të interesuara sipas nenit 39, pika 1 të ligjit nr. 8577/2000. Gjykata evidentoi se edhe vetë ai në një deklaratë ka theksuar se ka interes vetjak ndaj çështjes. Për kërkesën për vënien në dispozicion të vendimit të Kolegjit që ka përcaktuar rrethin e subjekteve të interesuara, nisur nga interesimi i kërkuesit, Gjykata vlerësoi për t'i vendosur në dispozicion, për efekt njohjeje, një kopje të procesverbalit të Kolegjit, ku bazuar në nenin e sipërcituar të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës janë përcaktuar subjektet e interesuara. Për shkresën e datës 13.06.2024 *(shih paragrafin 16 të vendimit),* iu bë me dije se ajo përgjigje administrative ishte një praktikë e shërbimeve ndihmëse të Gjykatës, sipas udhëzimit të dhënë nga Mbledhja e Gjyqtarëve, për të orientuar palët për mënyrën se si ata mund të përfshijnë informacione ose opinione në parashtrimet e tyre.

20. Në lidhje me kërkimin e dytë, Gjykata bazuar në nenin 41 të ligjit nr. 8577/2000 dhe referuar fakteve kushtetuese të çështjes, objekt të provuari në proces, vlerësoi se nuk është e domosdoshme thirrja e dy deputetëve nismëtarë dhe e Presidentit si dëshmitarë. Për rrjedhojë, Gjykata në përfundim vlerësoi rrëzimin e kërkesave paraprake të kërkuesit.

21. Gjithashtu, Gjykata në objektin e parashtrimeve të depozituara në sekretarinë gjyqësore në përfundim të seancës plenare publike konstatoi se kërkuesi ka kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 69/2023 derisa Gjykata të shprehet me vendim përfundimtar. Gjykata vlerëson se në rrethanat kur ky kërkim nuk është parashtruar nga kërkuesi në kërkesën e paraqitur në datën 10.05.2024 dhe nuk është kërkuar as gjatë seancës plenare publike, kërkesa për pezullimin e zbatimit të ligjit e paraqitur vetëm në objektin e parashtrimeve shtesë nuk mund të merret në shqyrtim.

IV
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

22. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit nr. 69/2023 me Kushtetutën, pasi cenon pikën 2 të nenit 78 të saj, si dhe parimet e shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të konfliktit të interesit, të hierarkisë së normave juridike dhe të sigurisë juridike.

23. Subjekti i interesuar, Akademia, për juridiksionin ka parashtruar se në thelb Gjykatës i është kërkuar të shqyrtojë legjitimitetin e rikandidimit dhe të zgjedhshmërisë së kryetarit, për më tepër që Akademia nuk është organ kushtetues. Pra, sipas subjektit të interesuar, Gjykatës i është kërkuar të shqyrtojë një çështje sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c" dhe qëllimisht ngatërrohet me çështjen e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën. Gjatë seancës plenare publike, subjekti i interesuar ka parashtruar se i qëndronte argumentit se Gjykata ka në juridiksion vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit.

24. Gjykata thekson se referuar përmbajtjes së nenit 131 të Kushtetutës, shkronja "a" vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ka në juridiksionin e saj kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 69/2023 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe se pretendimet e subjektit të interesuar, Akademisë, për mungesën e juridiksionit të Gjykatës, për shkak se nuk është organ kushtetues dhe referenca prej tij në nenin 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, janë të pabazuara.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

25. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Për sa i takon legjitimimit të kërkuesit për vënien në lëvizje të Gjykatës për kontrollin abstrakt të normës ligjore, në jurisprudencën kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme është vlerësuar se ky subjekt, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet

shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr. 18, datë 07.07.2022; nr. 55, datë 27.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se ajo është vënë në lëvizje nga një grup prej 37 deputetësh të Kuvendit, të cilët përbëjnë subjektin kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet si në aspektin formal, ashtu edhe substancial për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

26. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në përmbajtjen e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, pasi ligji nr. 69/2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 124, datë 21.08.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, në datën 06.09.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 10.05.2024, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

27. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar argumentet e tij në dy drejtime: (i) për shkeljen e procedurës së miratimit të ligjit sipas nenit 78, pika 2, të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit; (ii) për cenimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, konfliktit të interesit dhe të hierarkisë së normave, si dhe të sigurisë juridike.

28. Fillimisht, në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi në seancën plenare publike ka parashtruar se gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit nr. 69/2023 me Kushtetutën, Gjykata duhet të vlerësojë argumentin nëse deputetët nismëtarë dhe Presidenti kanë ushtruar kompetencat e tyre në përputhje me Kushtetutës, sipas shkronjës "e" të nenit 131 të Kushtetutës të cituar edhe në bazën ligjore të kërkesës. Gjithsesi, kërkuesi gjatë seancës plenare publike nuk i ka kërkuar Gjykatës, që të vendosë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të funksionarëve të sipërcituar dhe në përfundim e ka lënë në çmimin e saj për të vlerësuar nëse janë shkelur të gjitha nenet e vendosura si bazë ligjore në kërkesë.

29. Në vijim të sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkimi për të vlerësuar çështjen duke mbajtur në konsideratë shkronjën "e" të nenit 131 të Kushtetutës, që parashikon shqyrtimin e çështjeve që lidhen, mes të tjerave, edhe me zgjedhshmërinë e papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit dhe deputetëve, është i pabazuar, pasi në rastin konkret nuk jemi përpara rasteve të parashikuara sipas dispozitës kushtetuese të cituar nga kërkuesi.

30. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendimin për

cenimin e parimit të shtetit të së drejtës në drejtim të parimit të hierarkisë së normave juridike dhe të konfliktit të interesit. Gjykata vlerëson se për këtë pretendim kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese se si ky parim është cenuar në drejtim të hierarkisë së normave juridike dhe konfliktit të interesit, ndaj për këtë arsye ai nuk mund të merret në shqyrtim.

31. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit për cenimin e pikës 2 të nenit 78, të Kushtetutës dhe të parimeve të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit, si dhe të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson se hyjnë në juridiksionin kushtetues e në vijim do të vlerësohet bazueshmëria e tyre në themel.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e nenit 78, pika 2 të Kushtetutës

32. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë miratimit të ligjit është cenuar neni 78, pika 2, i Kushtetutës, si dhe neni 32, pika 2 i Rregullores së Kuvendit. Më konkretisht, sipas kërkuesit, në datën 19.07.2023, pas një mbledhjeje të thirrur jo sipas procedurës, duke mos u njoftuar të gjithë anëtarët e komisionit dhe pa praninë e kryetares së komisionit, u votua projektligji. Relacioni që shoqëronte projektligjin nuk jepte argumente konkrete me shpjegime për nenet ku ishte ndërhyrë, për përmirësimet që do të sillte ndryshimi dhe as shpjegim për keqkuptimet që mund të kishin lindur gjatë zbatimit të ligjit. Në çdo rast, pavarësisht nëse mbledhjen e komisionit e kërkon kryetari ose një e katërta e deputetëve, rendin e ditës e përgatit kryetari dhe në rastin konkret, kryetarja ka shprehur gatishmërinë për të zhvilluar mbledhjen pasi deputetët të sillnin kërkesën e protokolluar. Kërkesa për thirrjen e mbledhjes është depozituar ditën e mbledhjes, madje anëtarët e komisionit e kanë dorëzuar atë në protokoll disa orë pas zhvillimit të mbledhjes së komisionit.

33. Ndërsa subjekti i interesuar, Kuvendi ka prapësuar se projektligji i është nënshtruar shqyrtimit në dy komisione parlamentare. Gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, si dhe në Komisionin e Edukimit gjatë seancës dëgjimore janë ftuar edhe anëtarët e Asamblesë së Akademisë. Në Komisionin e Edukimit ka qenë kuorumi i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen dhe për të marrë vendim. Projektligji është votuar nga numri i kërkuar i deputetëve sipas Rregullores së Kuvendit dhe si i tillë është plotësisht i ligjshëm. Për të gjitha këto arsye, sipas subjektit të interesuar pretendimi është i pabazuar.

34. Subjekti i interesuar, Akademia, ka parashtruar se ligji, si projekt fillestar, është ideuar, kërkuar e mbështetur nga Asambleja e Akademisë, me vendimin nr. 50, datë 08.09.2022, me të drejtën që gëzon një institucion autonom për organizimin e vet. Procedura që është ndjekur për miratimin e ndryshimeve objekt i këtij gjykimi, është e njëjta procedure që ishte ndjekur edhe për hartimin e miratimin e ligjit nr. 53/2019. Zbatimi i Rregullores së Kuvendit është një çështje e brendshme e tij. Paraqitja e propozimit për projektligjin me 4-5 nene në Kuvend (saktësisht më 09.01.2023) dhe miratimi pas 6 muajsh nuk përbëjnë asnjë privilegj ose shkelje të afateve minimale për shqyrtim e tij. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Asamble e më pas në Kuvend, në Komisionin për Edukimin dhe veçanërisht në Komisionin e Ligjeve nuk është ngritur asnjë pretendim për mospërputhje të amendamenteve të propozuara me normën kushtetuese.

35. Gjykata vëren se në Kushtetutë, në Kreun III, që rregullon organizimin dhe funksionimin e Kuvendit parashikohet se mbledhjet e Kuvendit realizohen në sesione (neni 74) dhe se Kuvendi diskuton çështjet në seancë plenare (mbledhje), që si rregull bëhet e hapur (neni 79) ose e mbyllur në raste të veçanta (pika 4 e nenit 73). Ndërsa në nenin 77 të Kushtetutës parashikohet: *"Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme".* Ndërsa në vijim, në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës parashikohet: *"Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë".*

36. Bazuar në dispozitat e sipërcituara, Gjykata vëren se në Kushtetutë parashikohen disa forma të mbledhjes së Kuvendit dhe në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës përdoret një koncept i përgjithshëm duke iu referuar "mbledhjet e deputetëve", por nuk është specifikuar mënyra konkrete e realizimit të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimi në pikën 2 të nenit 78 të Kushtetutës se "mbledhjet që mbahen pa u thirrur sipas rregullores nuk sjellin asnjë pasojë" nuk u referohet vetëm seancave plenare/ mbledhjeve të deputetëve në Kuvend, por shtrihet edhe për procedurën e thirrjes së deputetëve në mbledhjet e komisioneve parlamentare të përhershme bazuar në Rregulloren e Kuvendit.

37. Duke mbajtur në konsideratë këtë vlerësim, Gjykata çmon se pika 2 e nenit 78 të Kushtetutës gjen pasqyrim në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 32 të Rregullores së Kuvendit, që parashikon se mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga: (i) kryetari i tij; (ii) jo më pak se një e katërta e anëtarëve të komisionit; (iii) Kryetari i Kuvendit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje.

38. Në drejtim të respektimit të Rregullores së Kuvendit, Gjykata në jurisprudencën e saj, bazuar në parimin e autonomisë parlamentare, ka theksuar se mosrespektimi i Rregullores e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera Rregullorja nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues (*shih vendimet nr. 54, datë 09.07.2024; nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Për sa më lart, pas shqyrtimit të pretendimit për cenimin e pikës 2, të nenit 78 të Kushtetutës, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

40. Sipas njërit qëndrim u vlerësua se pretendimi i kërkuesit për mosrespektimin e procedurës parlamentare gjatë miratimit të ligjit nr. 69/2023 është i bazuar ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar për këtë shkak. Në aspektin e veprimtarisë parlamentare, e cila edhe pse udhëhiqet nga parimi i autonomisë dhe vetërregullimit për disa aspekte të organizimit të funksionimit të Kuvendit dhe organeve të tij, Kushtetuta ka parashikuar në mënyrë të shprehur ato shkelje që e bëjnë jokushtetuese këtë veprimtari duke parashikuar në pikën 2 të nenit 78 edhe pasojën në rastin e mbajtjes së mbledhjeve në rast se ato nuk thirren sipas Rregullores së Kuvendit. Në këtë aspekt, për sa kohë që pasoja është e parashikuar drejtpërdrejt nga Kushtetuta, e vetmja mënyrë e kontrollit të kësaj veprimtarie është mënyra se si janë zbatuar në rastin konkret dispozitat e brendshme rregullatore të Kuvendit.

41. Referuar Rregullores së Kuvendit, mënyra e thirrjes së deputetëve për mbledhjen në komision nëpërmjet postës elektronike (e-mail) nuk rezulton të jetë e parashikuar në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar dhe as nuk mund të deduktohet nga përmbajtja e tyre. Procedura e vetme e zbatuar në praktikën parlamentare, për thirrjen e një mbledhjeje, që duhet të ndiqet për njoftimin e deputetëve, është ajo me shkresë të protokolluar e depozituar në një kohë të arsyeshme duke u krijuar mundësinë deputetëve për të marrë dijeni efektivisht dhe të njihen me materialet që do të shqyrtohen në atë mbledhje. Referuar edhe akteve të kësaj procedure, rezulton se kjo formë thirrje (njoftimi nëpërmjet e-mailit) nuk është përdorur për të gjitha mbledhjet e këtij komisioni. Ndërkohë që për mbledhjen e parë të komisionit (datë 11.07.2023), nuk ka pasur referim nga kërkuesi dhe as kundërshtim për mënyrën e thirrjes së saj, çka nënkupton se ajo është

zhvilluar në përputhje me praktikën parlamentare, mbledhja e radhës e datës 19.07.2023 është kërkuar nga dy deputetët nismëtarë (pra jo nga subjekti një e katërta e deputetëve të komisionit) dhe njoftimi është bërë nëpërmjet e-mailit. Referuar Rregullores se kuvendit, kjo procedure shfaq devijime nga parashikimet procedurale, të aspektit kushtetues që lidhen si me subjektin e legjitimuar për thirrjen e mbledhjes, ashtu edhe formën e njoftimit të anëtarëve të Komisionit të Edukimit.

42. Referuar edhe qëndrimit të kryetares së komisionit, ajo ka kërkuar shprehimisht ndjekjen e rrugës së zakonshme për zhvillimin e kësaj procedure, që është protokollimi i kërkesës sipas Rregullores së Kuvendit, si e vetmja mënyrë për të thirrur mbledhjen e deputetëve dhe për t`i dhënë legjitimitet kushtetues asaj. Për rrjedhojë kjo qasje e saj, përbën konfirmim të faktit se procedura e thirrjes/njoftimit të anëtarëve të komisionit përkatës, nuk ka qenë e rregullt sipas parashikimeve procedurale të Kuvendit. Në këtë aspekt, duke qenë përpara një parashikimi të tillë procedural që çon në një shkelje të nivelit kushtetues nuk ka ndonjë rëndësi në rastin konkret fakti nëse deputetët kanë marrë dijeni dhe janë njohur ose jo me e-mailin e dërguar për thirrjen e mbledhjes, dhe as fakti që *post factum* është depozituar në sekretari kërkesa e firmosur formalisht nga 5 deputetë (një e katërta e anëtarëve të komisionit), përsa kohë që shkelja e kësaj procedure, edhe pa u evidentuar ose provuar ndonjë pasojë e bën procedurën që në nisjen e saj, antikushtetuese sipas nenit 78, pika 2, të Kushtetutës.

43. Për këto arsye, për sa kohë që mbledhja e komisionit të edukimit nuk është thirrur sipas parashikimeve të nenit 78, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, çka veson nga pikëpamja kushtetuese të gjithë procedurën e miratimit të ligjit nr. 69/2023 nuk është e nevojshme vijimi me shqyrtimin dhe vlerësimin e themelit të pretendimeve të kërkuesit për përmbajtjen e këtij ligji .

44. Kështu sipas qëndrimit tjetër, zgjidhja e çështjes ka të bëjë me interpretimin e konceptit kushtetues “thirrje e mbledhjes” e ndërlidhur me parashikimet relevante të Rregullores së Kuvendit, në kushtet kur neni 78 pika 2 i Kushtetutës parashikon se mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores nuk sjellin asnjë pasojë. Koncepti “thirrje e mbledhjes”, në rastin e komisioneve parlamentare, nuk duhet interpretuar në një mënyrë të ngushtë dhe literale që do të prekte thelbin e këtij parashikimi kushtetues i cili, e ngre respektimin e rregullave për thirrjen e mbledhjes në nivelin e një kushti *sine qua non* për vlefshmërinë e mbledhjeve të deputetëve qoftë në nivel komisioni, qoftë në nivel të

seancës plenare. Parashikimi i nenit 78, pika 2 të Kushtetutës nuk duhet të kuptohet thjesht dhe vetëm si një rregullim me natyrë procedurale por si një premisë e rëndësishme për mirëfunksionimin e një organi kolegjial, me konfigurim politik siç është Kuvendi, me pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë e parlamentarizmit në vend. Për këtë arsye, koncepti "thirrje e mbledhjes" përfshin të gjitha dispozitat e Rregullores së Kuvendit që lidhen me mënyrën e caktimit të mbledhjes së Komisionit, të krijimit të rendit të ditës dhe të njoftimit të kohës dhe vendit të mbajtjes së mbledhjes, të cilat parashikohen në nenet 32-33 të Rregullores së Kuvendit. Në këtë pikë, duhet evidentuar se mënyra e funksionimit të Kuvendit, përfshirë atë të komisioneve parlamentare, duhet të udhëhiqet nga bashkëpunimi i sinqertë apo parimi i luajalitetit kushtetues, i cili ka të bëjë, në thelb, me respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Ky parim përfshin edhe detyrimin për sjellje koherente dhe jokontradiktore, pra palët nuk duhet të kenë qëndrime zvarritëse, bllokuese, të paqarta ose të pajustifikuara, në mënyrë që bashkëpunimi midis tyre të jetë mbi baza mirëbesimi dhe korrektese, si dhe të jenë të hapura për qasjet e ndryshme të palës tjetër, por gjithnjë duke respektuar kompetencat që i janë dhënë secilës palë (*shih vendimin nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Sipas neneve 32-33 të Rregullores së Kuvendit, mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga kryetari i tij. Ato mund të thirren edhe me kërkesën e jo më pak se një të katërtës së anëtarëve të komisionit ose me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit, duke përcaktuar në kërkesë dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje (neni 32 pika 2). Kryetari i komisionit përgatit rendin e ditës, organizon punën për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit dhe kryeson mbledhjet e tij (neni 33).

46. Në rastin konkret, Komisioni i Edukimit, që përbëhet nga 19 anëtarë, është mbledhur dhe ka shqyrtuar projektligjin në fjalë në datën 11.07.2023, mbledhje për të cilën nuk ka patur ndonjë kontestim. Në këtë mbledhje, projektligji nuk është miratuar për shkak të mungesës së dokumentacionit (marrje e një mendimi me shkrim). Komisioni i Edukimit ka zhvilluar edhe dy mbledhje të tjera në datat 11.07.2023 dhe 17.07.2023, por projektligji për akademinë nuk ka qenë pjesë e rendit të ditës. Në datën 18.07.2023, në orët e pasdites, dy anëtarë të komisionit, që i përkisnin shumicës parlamentare, kanë dërguar në rrugë elektronike secili kërkesë për mbledhjen e komisionit në datën 19.07.2023, ora 11:00 për shqyrtimin e projektligjit për akademinë. Këtyre dy kërkesave u janë përgjigjur edhe tre deputetë të tjerë të shumicës

parlamentare, që në thelb, kanë dhënë pëlqimin për mbledhjen e komisionit. Ndërsa kryetarja e komisionit, që i përkiste pakicës parlamentare, është përgjigjur duke kërkuar që kërkesa të protokollohej sipas Rregullores së Kuvendit dhe se pas protokollimit, do të veprohej sipas kësaj rregulloreje. Po ashtu, ka pasur edhe përgjigje deputetësh të pakicës parlamentare që kërkonin kohë për t'u përgatitur për çështjen. Secila kërkesë është dërguar veçmas, por brenda të njëjtit zinxhir komunikimi, duke iu drejtuar të gjithë anëtarëve të komisionit. Mbledhja është zhvilluar në datën 19.07.2023, ora 11.00 dhe projektligji është miratuar në Komision, vetëm me pjesëmarrjen e deputetëve të shumicës parlamentare, ndërsa kërkesa është protokolluar e nënshkruar nga pesë deputetët në datën 19.07.2023, ora 14.36.

47. Duke i vlerësuar këto fakte nën dritën e standardeve kushtetuese, nxirret përfundimi se mbledhja e Komisionit të Edukimit, e zhvilluar në datën 19.07.2023, nuk është thirrur sipas Rregullores së Kuvendit. Kërkesa për mbledhjen e komisionit, në ndryshim nga praktika e mëparshme parlamentare për depozitimin e tyre, është dërguar në rrugë elektronike dhe vetëm pas mbledhjes *de facto* të komisionit është depozituar në zyrën e protokollit të Kuvendit. Ndonëse në parim, përdorimi i postës elektronike lehtëson mënyrën e komunikimit dhe *prima facie* duket se thirrja e mbledhjes është bërë nga një e katërta e anëtarëve të komisionit (pesë deputetë), në rastin konkret dërgimi i kërkesës në mënyrë të ndarë nga pesë anëtarë dhe pa iu referuar qartësisht një teksti të përbashkët që të tregonte kohën e mbledhjes dhe çështjen për diskutim vë në dyshim thirrjen e saj. Duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes, në veçanti faktin që bëhej fjalë për një nismë të shumicës parlamentare dhe mënyrën se si u procedua për thirrjen e mbledhjes, mosmarrja në konsideratë e kërkesës së kryetares së komisionit për depozitimin e njoftimit për mbledhjen në zyrën e protokollit, arrihet në konkluzionin se thirrja e mbledhjes, në substancë, nuk ka respektuar parimin e luajalitetit kushtetues dhe dispozitat e Rregullores së Kuvendit.

48. Për sa më lart, në kushtet kur mbledhja e Komisionit të Edukimit nuk është thirrur sipas parashikimeve të nenin 78, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, ajo nuk ka sjellë asnjë pasojë, ndaj për këtë shkak ligji nr. 69/2023 duhej të shfuqizohej për mosrespektim të procedurës së miratimit të tij. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve të tjera të kërkuesit është i panevojshëm .

49. Sipas qëndrimit tjetër, u vlerësua se pretendimi i kërkuesit për cenimin e pikës 2 të nenit 78 të Kushtetutës në drejtim të procedurës

parlamentare nuk është i bazuar. Në këtë drejtim u vlerësua se pretendimet e kërkuesit për mangësitë gjatë shqyrtimit të projektligjit nuk janë të tilla që prekin dispozita të nivelit kushtetues, për rrjedhojë nuk sjellin pasoja të këtij niveli në procedurën parlamentare. Norma kushtetuese ka parashikuar se mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores, nuk sjellin pasoja, ndërkohë që për sa i përket mënyrës se si rregullohen aspektet e brendshme të procedurës për të përmbushur këtë qëllim i janë lënë në diskrecion Kuvendit për t'i rregulluar përmes Rregullores së tij në përputhje me parimin e autonomisë parlamentare dhe të vetërregullimit. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se Kuvendi gëzon një hapësirë të gjerë lirie për të vendosur rregullat e nevojshme, me qëllim vetorganizimin e tij, duke mos kufizuar ushtrimin e të drejtave të deputetëve për shkaqe të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së tij në përputhje me parimin e funksionalitetit dhe efektivitetit *(shih vendimin nr. 48, datë 19.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë aspekt ndërsa qëllimi i thirrjes së deputetëve në mbledhjet e Kuvendit/komisioneve është që të sigurohet ushtrimi i funksionit të deputetit dhe, nëpërmjet tij, edhe ushtrimi i funksionit të vetë këtij organi kushtetues, mënyra dhe forma e realizimit të këtij njoftimi është një çështje që ka të bëjë jo me aspekte të nivelit kushtetues, por lidhet me çështje të njoftimit efektiv të tyre me qëllim garantimin e funksionalitetit të komisioneve, sikundër përbën edhe aspekt të bashkëpunimit mes deputetëve.

50. Në rastin konkret, konstatohet se në datën 09.01.2023 dy deputetë kanë depozituar në Kuvend propozimin për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2029 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", i cili u përfshi në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 22 maj-30 qershor 2023. Në vijim, projektligji është diskutuar fillimisht në mbledhjen e datës 21.06.2023 dhe më pas në atë të datës 11.07.2023, në të cilat është bërë parashtrimi/relatimi i projektligjit dhe deputetët e pranishëm kanë diskutuar mbi të, sikundër Komisioni i Edukimit ka dëgjuar edhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave. Megjithatë Komisioni i Edukimit nuk ka vijuar me votimin e projektligjit të propozuar për shkak se nga Ministria e Financave nuk ishte dorëzuar me shkrim opinioni i kërkuar për efektin financiar të ligjit. Ndërkohë, në datën 18.07.2023 është kërkuar thirrja e mbledhjes nga disa deputetë anëtarë të Komisionit të Edukimit për në datën 19.07.2023, ora 11:00, me rend dite shqyrtimin dhe votimin nen për nen të projektligjit. Në datën e njoftuar është realizuar mbledhja e komisionit, në përfundim

të së cilës projektligji është votuar dhe i ka kaluar për shqyrtim Kuvendit në seancë plenare.

51. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 32, pika 2, të Rregullores, rezulton se thirrja e mbledhjes bëhet nga kryetari i komisionit, një e katërta e anëtarëve të komisionit ose Kryetari i Kuvendit dhe mes këtyre subjekteve nuk është e përcaktuar një shkallë hierarkie, duke nënkuptuar se secili, në çdo moment, mund të kërkojë thirrjen pa u kushtëzuar me veprime të tjera procedurale. Për sa i përket procedurës së thirrjes së deputetëve në mbledhje konstatohet se Rregullorja e Kuvendit nuk ka asnjë parashikim konkret për formën e njoftimit, ndërkohë që ajo kërkon një kërkesë të subjektit të legjitimuar në të cilën duhet të përcaktohen edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Në praktikën parlamentare njoftimi përmes një dokumenti zyrtar (shkresë) bëhet me qëllim dokumentimin nga ana formale të thirrjes së mbledhjes por, në thelb, qëllimi i këtij njoftimi është që të sigurohet, siç është theksuar më sipër, marrja dijeni e deputetëve në mënyrë efektive. Në këtë kuptim, njoftimi efektiv është i rëndësishëm pasi i paraprin ushtrimit të të drejtave të tjera të deputetit me qëllim garantimin e ushtrimit të mandatit parlamentar, i cili është i lidhur me funksionalitetin e vetë organit në të cilin ata bëjnë pjesë (Kuvendi). Njoftimi në rastin konkret për mbledhjen e datës 19.07.2023, është bërë me postë elektronike (e-mail) nga pesë deputetë nëpërmjet adresave elektronike zyrtare dhe u është dërguar deputetëve anëtarë të komisionit. Në datën 19.07.2023, në mbledhjen e komisionit deputetët kërkues kanë konfirmuar vullnetin e tyre për thirrjen e mbledhjes, sikundër është dorëzuar edhe kërkesa formale për thirrjen e saj, e cila është protokolluar po atë ditë. Ky njoftim ka pasur në formë dhe përmbajtje si qëllim thirrjen e mbledhjes, ashtu edhe njoftimin e kohës së saktë të zhvillimit të saj.

52. Nuk rezulton që të jetë pretenduar nga deputetët e Komisionit të Edukimit mosmarrja e njoftimit për thirrjen e mbledhjes nëpërmjet e-mail-it dhe as nuk është ngritur ndonjë pretendim për pamundësi pjesëmarrjeje në mbledhjen e datës 19.07.2023. Për më tepër, rezulton se disa deputetë kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe të tjerë i kanë kthyer përgjigje edhe e-mail-it. Në vlerësimin e këtyre gjyqtarëve, mënyra e njoftimit me postë elektronike (e-mail) është një nga format e komunikimit e njohur nga legjislacioni shqiptar dhe vetë subjekti i interesuar, Kuvendi, ka pranuar se është një formë e praktikës së përditshme të komunikimit mes deputetëve me qëllim njoftimin e tyre dhe vënien në dispozicion të materialeve përkatëse. Për këto arsye, për sa kohë që nuk u provua se kjo mënyrë

njoftimi bie ndesh me Rregulloren e Kuvendit, dhe as që të ketë sjellë pasoja në drejtim të njoftimit efektiv dhe pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhjen e komisionit të datës 19.07.2023, në të cilën u votua projektligji, pretendimet për shkelje të pikës 2 të nenit 78 të Kushtetutës nuk janë të bazuara. Megjithatë, në kushtet kur qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë dhe nuk u arrit shumica e votave për ndonjërën nga qasjet, këta gjyqtarë nuk mund të vijonin me trajtimin e pretendimeve të tjera të kërkuesit për themelin e çështjes, për sa kohë gjyqtarët me qëndrime të ndryshme nga ky më sipër konsideruan të mos vijonin shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të kërkesës .

53. Sipas qëndrimit të gjyqtares tjetër pretendimet për mangësitë gjatë shqyrtimit të projektligjit nuk prekin dispozita të nivelit kushtetues, si dhe mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës, se Kuvendi gëzon një hapësirë të gjerë lirie për të vendosur rregullat e nevojshme të vetëorganizimit të tij të brendshëm dhe, për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e pikës 2 të nenit 78 të Kushtetutës në drejtim të procedurës parlamentare nuk është i bazuar, e duhej vazhduar në themel me kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve të ligjit të kundërshtuar. Nëse do të procedohej në këtë mënyrë pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit duhet të pranohej, për shkak se neni 1 i ligjit nr. 69/2023 (*që ka riformuluar nenin 6, pika 3, të ligjit nr. 53/2019*), që përcakton anëtarët që fitojnë statusin e anëtarit të jashtëm dhe të nderit të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të lexohet i shkëputur nga pika 4 e po këtij neni (*ndonëse e pandryshuar me ligjin nr. 53/2019*), që përcakton se me arritjen e moshës 75 vjeç anëtarët e Akademisë së Shkencave marrin statusin "emeritus" ose të anëtarit të nderit, si dhe nga neni 2 i ligjit nr. 69/2023 (*që ka riformuluar nenin 10 të ligjit nr. 53/2019*), që parashikon heqjen e së drejtës së votës së anëtarit të jashtëm ose atij të nderit.

54. Ndonëse ligji nr. 53/2019 nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues dhe gjatë periudhës nga hyrja në fuqi e tij në vitin 2019 e deri në ndryshimet e bëra me ligjin nr. 69/2023, nenet 6, 10 ose 16 e respektonin parimin e barazisë përpara ligjit, ndryshimet e pjesshme të bëra me ligjin nr. 69/2023 në nenet 10 dhe 16, e deformuan këtë parim duke sjellë një trajtim të ndryshëm midis mandateve të anëtarëve të Akademisë dhe mandatit të kryetarit të saj.

55. Para ndryshimeve ligjore neni 6, pika 4, i ligjit nr. 53/2019 ishte në unison me nenin 10 dhe me nenin 16, pika 2, shkronja "c", të këtij ligji, kur parashikonin në mënyrë të ndërsjellë kufirin maksimal të moshës

75 vjeç për anëtarët e Asamblesë dhe faktin që pas këtij momenti ata merrnin statusin e anëtarit "emeritus" ose të nderit (*nenit 6, pika 4*) dhe, se arritja e moshës 75 vjeç sillte ndërprerjen e mandatit të anëtarit të Akademisë së Shkencave (*neni 16, pika 2, shkronja "c")*. Ndryshimet ligjore që shfuqizojnë nenin 16, pika 2, shkronja "c", të ligjit nr. 53/2019 me nenin 5 të ligjit nr. 69/2023, i cili heq kufirin e moshës për të gjithë anëtarët, përfshirë edhe kryetarin, të cilëve nuk u ndërpritet më mandati me arritjen e moshës 75 vjeç, dhe ndryshojnë nenin 10 të ligjit nr. 53/2019, ku anëtarët e nderit ("emeritus") nuk kanë më të drejtë vote pas moshës 75 vjeç, krijojnë pabarazi përpara ligjit, sepse kjo gjë nuk ndodh në rastin e kryetarit, i cili ka të drejta dhe detyrime të plota që shkojnë edhe përtej së drejtës së votës midis tyre. Për shkak të këtyre dy ndryshimeve ligjore të mësipërme rezulton se jemi para rastit kur persona të njëjtë (*anëtarë të Akademisë së Shkencave*), në kushte të njëjta (*në moshë mbi 75 vjeç*), janë trajtuar ndryshe (*në drejtim të heqjes të së drejtës për të votuar*) pa përligjje të arsyeshme dhe objektive. Për rrjedhojë, kjo situatë passjell cenimin e parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit, prandaj në nenin 2 të ligjit nr. 69/2023, që ka riformuluar nenin 10 të ligjit nr. 53/2019, duhej të shfuqizohej togfjalëshi "*pa të drejtë vote*" .

56. Në përfundim sipas këtij qëndrimi, pretendimi për cenimin e nenit 78, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 2 të Rregullores së Kuvendit është i pabazuar dhe pajtueshmëria e ligjit nr. 69/2023 duhet të analizohet në themel në drejtim të pretendimeve për respektimin e parimeve kushtetuese, por për shkak të mosarritjes së kuorumit prej pesë gjyqtarësh nuk mund të vijohej me shqyrtimin e themelit të pretendimeve.

57. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata konstatoi se nuk ishte e mundur të formohej numri i kërkuar prej 5 gjyqtarësh për të vijuar me shqyrtimin dhe vendimmarrjen për themelin e pretendimeve që lidheshin me cenimin e parimeve të shtetit të së drejtës, barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit, si dhe të sigurisë juridike.

58. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkuesit konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pikat 1, shkronja "c" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.02.2025
Shpallur më 13.03.2025

Vendim nr. 7, datë 20.02.2025
(V-7/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.02.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (T) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **TONIN MHILLI, VERA MHILLI, VALENTIN MHILLI DHE NIKOLIN MHILLI**, përfaqësuar nga avokat Erdi Prifti, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE SHKODËR, përfaqësuar nga drejtor Granit Korbi.
AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Valbona Legisi, Juliana Çoma dhe Irma Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 596 (86-2023-878), datë 20.09.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1702, datë 11.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.
Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 23, 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve Tonin Mhilli, Vera Mhilli, Valentin Mhilli dhe Nikolin Mhilli, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Shkodër (*Drejtoria Vendore e Kadastrës*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit tjetër të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Tonin Mhilli, Vera Mhilli, Valentin Mhilli dhe Nikolin Mhilli janë në marrëdhënie familjare me njëri - tjetrin, përkatësisht prindër dhe fëmijë. Ata, në vitin 2014, në cilësinë e blerësve, kanë lidhur dy kontrata shitblerjeje me tre familjarë të afërm të tyre, në cilësinë e shitësve, me anë të të cilave kanë fituar të drejtën e pronësisë për dy pasuri të paluajtshme, të llojit tokë pemëtore, me sipërfaqe 5038 m^2 dhe 353 m^2, të ndodhura në Pukë. Kontratat e shitblerjes janë regjistruar rregullisht në regjistrin publik pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Pukë.

2. Me urdhrin nr. 471, datë 16.02.2015, ZVRPP-ja, Pukë, bazuar në nenet 59, 75, pika 2, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të shfuqizuar (*ligji nr. 33/2012*), ka vendosur kufizimin e dy pasurive deri në plotësimin nga kërkuesit

të dokumentacionit tekniko-ligjor që ka të bëjë me regjistrimin fillestar të tyre në pronësi të shitësve, me arsyetimin se punonjësit e saj kishin kryer gabim njerëzor, duke konsideruar titull pronësie të vlefshëm për regjistrim një vendim gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së shitësve.

3. Kërkuesit kanë ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin, pavlefshmërinë absolute ose relative të urdhrit të kufizimit, si dhe heqjen e kufizimit për të dyja pasuritë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 553, datë 21.07.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë. Edhe pse kërkuesit kanë paraqitur ankim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 596 (86-2023-878), datë 20.09.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1702, datë 11.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve.

4. Në datën 04.06.2024 kërkuesit, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 05.06.2024.

5. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 30.07.2024, ka vendosur kthimin e kërkesës, duke kërkuar plotësimin e të metave që lidheshin me shterimin e mjeteve juridike për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe me natyrën kushtetuese të pretendimeve të tjera. Kërkuesit, brenda afatit 30-ditor, konkretisht në datën 19.08.2024, i kanë plotësuar të metat, duke paraqitur informacione dhe dokumentacione shtesë.

6. Kolegji i Gjykatës, në datën 23.09.2024, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 02.10.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Në datën 07.02.2019 është miratuar ligji nr. 111/2018 "Për kadastrën", me të cilin kompetencat e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme i kanë kaluar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive vendore të saj. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës në të cilën janë kryer veprimet nga ata.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara u janë cenuar:

8.1. *E drejta e informimit,* e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi ZVRPP-ja, Pukë për kufizimin e vendosur për pasuritë ka njoftuar vetëm një nga kërkuesit, ndërsa nuk ka informuar tre të tjerët.

8.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 të Kushtetutës, pasi pasuritë e tyre janë ende të kufizuara, kufizimi ka tejkaluar afatin ligjor 30-ditor dhe është i pavlefshëm.

8.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.3.1. *E drejta e aksesit substancial* e lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë dhe ajo e apelit nuk kanë shqyrtuar pretendimet kryesore që lidheshin me zgjatjen e kufizimit për pasuritë tej afatit ligjor 30-ditor dhe me mungesën e njoftimit të të gjithë kërkuesve për kufizimin. Gjykatat kanë interpretuar gabim ligjin material dhe atë procedural. Gjykata e apelit ka arsyetuar vetëm për pavlefshmërinë absolute të kufizimit, duke mos u shprehur tërësisht për objektin e padisë, si dhe i është referuar një ligji, i cili nuk kishte hyrë ende në fuqi. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos e konsideruar se çështja kishte rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

8.3.2. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi gjykimi i çështjes së kërkuesve në gjykatën e shkallës së dytë ka tejkaluar afatin ligjor 30-ditor dhe ka zgjatur më shumë se 7 vjet.

9. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për informim* është i pabazuar, pasi kërkuesi Tonin Mhilli, siç parashtrohet edhe në rekurs, në datën 17.02.2015 është njoftuar për vendosjen e kufizimit të pasurive deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko- ligjor.

9.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është haptazi i pabazuar, pasi kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente

kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme. Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe as interpretimin e ligjit që u përket gjykatave të zakonshme.

9.3. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi vendimet e kundërshtuara përmbushin standardet kushtetuese. Gjykata e zakonshme nuk është e detyruar të japë përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur, por nga vendimi duhet të dalë qartë që janë prekur pikat thelbësore të ngritura për çështjen. Ndërsa arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk e cenon procesin e rregullt ligjor.

9.4. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim *të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Ata, siç e pranojnë edhe vetë, nuk i janë drejtuar paraprakisht gjykatave të zakonshme për konstatimin e shkeljes sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

10. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore e Kadastrës,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1. Kërkimi për konstatimin e cenimit të së *drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi nuk është ngritur përpara Gjykatës së Lartë, në bazë të parashikimeve të KPC-së, duke mos shteruar mjetet juridike efektive.

10.2. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë rrjedhojë e *një procesi të rregullt ligjor*, ndaj pretendimet e kërkuesve lidhur me të janë të pabazuara.

11. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,*** ndonëse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit

71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar.

14. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket ankimeve për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijues të KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 2 datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuesit, ndër të tjera, kanë pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, me argumentin se gjykimi i çështjes së tyre në gjykatën e shkallës së dytë ka zgjatur për më shumë se 7 vjet, duke tejkaluar afatin ligjor 30-ditor. Gjithashtu, ata kanë pohuar se nuk kanë kërkuar në gjykatat e zakonshme konstatimin e shkeljes sipas dispozitave të KPC-së me argumentin se, shprehimisht, sipas tyre "*Dihet botërisht që Gjykata e Lartë nuk merr në konsideratë përshpejtimin*

e gjykimit të çështjeve". Subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Kadastrës, kanë prapësuar se ky pretendim nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkuesit nuk kanë shfrytëzuar paraprakisht mjetin juridik të KPC-së, i cili ka hyrë në fuqi në datën 05.11.2017, pra gjatë kohës që çështja e tyre ishte ende në shqyrtim në gjykatën e shkallës së dytë.

16. Gjykata vëren se argumenti i kërkuesve për qëndrimin refuzues të Gjykatës së Lartë ndaj kërkesave të tilla është paraqitur në mënyrë të përgjithshme, për këtë arsye është i pamjaftueshëm për të nxjerrë përfundimin se kërkesa për konstatimin e shkeljes sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së është mjet joefektiv për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim për shkak se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

17. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata konstaton se kërkuesit i janë drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë e kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis* Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë mban datën 11.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 04.06.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae* kërkuesit kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u informuar, të garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, me argumentin se urdhri për kufizimin e pronës nuk i është njoftuar individualisht të gjithë kërkuesve, por vetëm njërit nga ata (kërkuesit Tonin Mhilli). Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi është i pabazuar, pasi njoftimi vetëm i kërkuesit Tonin Mhilli për kufizimin e pronës është i mjaftueshëm.

20. Gjykata vëren se neni 23 i Kushtetutës garanton në thelb të drejtën e kujtdo, që në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore (*pika 2*), si dhe mundësinë të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive (*pika 3*). Gjykata ka pohuar se e drejta e informimit është e drejta

themelore për të marrë dhe dhënë informacion, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e informimit është e lidhur objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik dhe shërben si mjet i rëndësishëm dhe efikas për të kontrolluar demokracinë si formë qeverisjeje (*shih vendimin nr. 56, datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke analizuar pretendimet e kërkuesve në kontekstin e garancive që përcakton neni 23 i Kushtetutës, Gjykata vëren se argumenti i tyre për mungesën e njoftimit nga ZVRPP-ja, Pukë nuk lidhet me të drejtën e informimit. Kjo e fundit, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës përfshin të drejtën e individit, që në përputhje me ligjin, të aksesojë fakte dhe të dhëna që lidhen me ushtrimin e pushtetit publik, në mënyrë që individi i informuar të ketë mundësinë të marrë pjesë në jetën publike. Në thelb, njohja e individit me informacion e ndihmon atë të formojë pikëpamje për gjendjen e shtetit e të shoqërisë, ndërsa autoritetet publike i nxit në drejtim të integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesve nuk ka të bëjë me të drejtën e informimit *per se*, por lidhet, në thelb, me procesin administrativ të kufizimit të pronës, në drejtim të së drejtës së njoftimit, e cila siç është theksuar në jurisprudencën kushtetuese, u paraprin të drejtave të tjera që garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, përfshirë atë për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ (*shih vendimet nr.34, datë 10.04.2017; nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më lart, Gjykata konstaton se kërkuesit, të cilët në regjistrin e pasurive të paluajtshme figurojnë bashkëpronarë për pasuritë e kufizuara nga ZVRPP-ja, Pukë, edhe pse nuk kanë marrë të gjithë njoftim individual, nuk rezulton të jenë penguar për të paraqitur ankim në gjykatë ndaj aktit administrativ për kufizimin e pasurive, bazuar në njoftimin individual që kishte marrë vetëm kërkuesi Tonin Mhilli. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e njoftimit individual për tre kërkuesit e tjerë nuk e ka bërë procesin të parregullt, në kuptimin kushtetues. Me të njëjtin arsyetim Gjykata çmon se është haptazi i pabazuar edhe pretendimi i kërkuesve se gjykatat e zakonshme, duke mos u dhënë përgjigje për këtë pretendim, u

kanë cenuar atyre të drejtën e aksesit substancial. Kjo e fundit nuk duhet të kuptohet se përfshin detyrimin e gjykatave të zakonshme për përgjigje të detajuar dhe të shprehur për çdo pretendim të paraqitur nga palët, përveçse kur pretendimi është përcaktues për zgjidhjen e çështjes. Ashtu siç ka theksuar Gjykata në jurisprudencën e saj, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Më tej, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së pronës private të fituar nëpërmjet kontratave të shitblerjes, për të cilat ata disponojnë certifikata të rregullta pronësie, për shkak të kufizimit të tejzgjatur të vendosur për pasuritë e tyre. Po kështu, sipas tyre, gjykatat e zakonshme i kanë cenuar edhe të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi me mënyrën se si e kanë zgjidhur çështjen, jo vetëm nuk e kanë riparuar shkeljen e së drejtës së pronës, por as nuk u kanë kthyer përgjigje kërkuesve në këtë drejtim. Ndërsa subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme.

24. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë zgjidhur mosmarrëveshjen për urdhrin e kufizimit të pronës, çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të aksesit në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, të lidhur me të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 41 i saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

25. Kërkuesit kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar atyre të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe të drejtën e pronës, si rrjedhojë e kufizimit të vendosur në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në tejkalim të afatit ligjor 30-ditor. Sipas tyre, ky kufizim, vazhdon *de facto* deri ditën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat nuk e kanë riparuar këtë shkelje dhe as nuk i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuesve, i cili ishte pretendimi kryesor i tyre. Sipas kërkuesve, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar

vetëm për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, duke mos u shprehur tërësisht për objektin e padisë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka marrë për bazë pretendimin e tyre se çështja kishte rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, duke vendosur mospranimin e rekursit.

26. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbushin standardet kushtetuese të arsyetimit dhe se gjykata e zakonshme nuk është e detyruar të japë përgjigje të hollësishme për çdo argument të ngritur, por nga vendimi duhet të dalë qartë që janë prekur pikat thelbësore të ngritura për çështjen. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Drejtoria Vendore e Kadastrës, ka prapësuar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor, ndaj pretendimet e kërkuesve lidhur me të janë të pabazuara.

27. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera se, prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë. Ndërsa neni 41 i Kushtetutës parashikon se e drejta e pronës private është e garantuar (*pika 1*) dhe se prona fitohet, ndër të tjera, me blerje (*pika 2*).

28. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit përbën çështje kushtetuese (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i takon së drejtës së pronës, Gjykata ka pohuar se garantimi i saj përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Ajo përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 53 datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse pretendimet e kërkuesve në rekurs lidhen me të drejtën themelore të pronës, shkak për të cilin Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit, duhej të kishte garantuar aksesin substancial, duke u dhënë përgjigje në arsyetimin e vendimit të saj.

32. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se kërkuesit kanë fituar të drejtën e pronësisë për dy pasuri të paluajtshme nëpërmjet dy kontratave të shitblerjes të datës 09.09.2014, të cilat janë regjistruar në regjistrin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Disa muaj pas regjistrimit, konkretisht në datën 16.02.2015, ZVRPP-ja, Pukë ka nxjerrë urdhrin për kufizimin pa afat të pronës së kërkuesve, duke ia kaluar atyre barrën e paraqitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor për të vërtetuar pronësinë e shitësve për pasuritë e paluajtshme, me të cilët ata kishin lidhur kontratë të rregullt shitjeje, e cila ishte regjistruar nga vetë ZVRPP-ja, Pukë. Nuk rezulton që ZVRPP-ja, Pukë të ketë kryer veprime të mëtejshme dhe as që gjykatat e zakonshme të kenë vendosur ndonjë masë sigurimi të tillë, ndaj kufizimi i pronës vazhdon deri në ditën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, pra prej më shumë se 9 vjetësh.

33. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesit janë ankuar në gjykatë kundër urdhrit të kufizimit, duke kërkuar në thelb heqjen e tij. Procesi gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ka përfunduar me vendimin për

rrëzimin e padisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka arsyetuar se urdhri i kufizimit, i cili përbën akt administrativ, është nxjerrë nga organi kompetent, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas procedurës së parashikuar nga ligji. Më konkretisht, regjistruesi ka vepruar sipas kompetencës që i jepte ligji i kohës së nxjerrjes së urdhrit të kufizimit, i cili kishte të bënte me verifikimin e të dhënave të akteve të regjistrimit të pasurive (neni 20, shkronja "e", i ligjit nr. 33/2012). Po kështu, sipas gjykatës së apelit, urdhri i kufizimit është nxjerrë në përputhje me ligjin dhe të dhënat e diktuara nga situata faktike në kohën e nxjerrjes së tij, duke evidentuar se regjistrimi fillestar i pronës është bërë bazuar në një vendim gjyqësor për vërtetimin e faktit dhe jo për njohjen ose fitimin e së drejtës së pronësisë, siç kërkon neni 193 i Kodit Civil. Ndërsa për kohëzgjatjen e urdhrit të kufizimit, duke mbajtur në konsideratë ndryshimet ligjore nga koha e nxjerrjes së tij deri në gjykimin e çështjes, gjykata e apelit ka arsyetuar se dispozitat kalimtare të ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme nuk përmbajnë përcaktime për trajtimin e urdhrave të kufizimit të nxjerra përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe as afatet e tyre (*shih paragrafët 37-42 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

34. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, duke arsyetuar se në përmbajtjen e tij nuk përcaktohet asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

35. Nën dritën e standardeve kushtetuese dhe në kontekstin e rrethanave specifike të rastit konkret, Gjykata konstaton se kufizimi i vendosur nga ZVRPP-ja, Pukë përbën ndërhyrje në të drejtën e pronës së kërkuesve, ndërhyrje e cila referuar shkakut të kufizimit, por edhe periudhës së zgjatjes së tij prej më shumë se 9 vjetësh, prek thelbin e kësaj të drejte. Konstatimi i mungesës së titullit të pronësisë së shitësve vë në dyshim kalimin e së drejtës së pronësisë te kërkuesit, tek të cilët ZVRPP-ja, Pukë ka zhvendosur detyrimin për paraqitjen e dokumentacionit ligjor të regjistrimit fillestar të pronës nga shitësit, pikërisht të një titulli pronësie të vlefshëm për regjistrim. Në këtë kuptim, kufizimi *de facto* u mohon kërkuesve të drejtën e pronësisë, por pretendimet e tyre në këtë drejtim nuk janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Këto të fundit nuk kanë

arsyetuar për pasojat që urdhri i kufizimit ka për të drejtën substanciale të pronës, duke lënë në thelb pa përgjigje pretendimin me natyrë kushtetuese të kërkuesve. Konkretisht, gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim formalist dhe ka përdorur metodën e interpretimit *strictu sensu* të dispozitave kalimtare të ligjit, në të cilat nuk përcaktohet afati i kohëzgjatjes së urdhrit të kufizimit, duke legjitimuar kufizimin e pronës së kërkuesve për 9 vjet radhazi dhe duke anashkaluar faktin që ligji i kohës së nxjerrjes së urdhrit të kufizimit (neni 59 i ligjit nr. 33/2012), por edhe ligji aktualisht në fuqi (neni 27 i ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën"), parashikonin në mënyrë të shprehur se urdhri i ndalimit të veprimeve kadastrale, në çdo rast, zgjat 30 ditë kalendarike nga dita e lëshimit të tij dhe pas këtij afati ai e humbet fuqinë e tij, nëse nuk është vendosur sigurimi i padisë nga gjykata. Në këtë mënyrë, interpretimi i ngushtë i ligjit nga gjykata e apelit ka cenuar thelbin e së drejtës së pronës së kërkuesve, të cilët e kanë fituar këtë të drejtë me anë të blerjes, që mbrohet në mënyrë të shprehur nga neni 41, pika 2, i Kushtetutës. Kjo shkelje nuk rezulton të jetë korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila ndonëse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji.

36. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, e cila shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit që kufizimi pa afat i pasurisë mohonte thelbin e së drejtës së pronës së kërkuesve. Mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim aksesin substancial të kërkuesve dhe standardin kushtetues të arsyetimit të lidhur me të drejtën e pronës. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës nuk mund të reduktohet vetëm në zotërimin

e titullit formal të pronësisë dhe se ajo realizohet përmes ushtrimit të tre tagrave të pronësisë, të cilat janë: (i) e drejta e posedimit të pronës; (ii) e drejta për ta gëzuar pronën, ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj; (iii) e drejta për të disponuar pronën (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1702, datë 11.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
4. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.02.2025
Shpallur më 25.03.2025

Vendim nr. 8, datë 21.02.2025
(V-8/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datat 16.01.2025 dhe 29.01.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 3 (Nj) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,** përfaqësuar nga Oerd Bylykbashi, Ledina Mandija, Ivi Kaso dhe Franc Nuri, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Xhilda Pinci, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja, Elira Kokona dhe Herald Jonuzaj, me autorizim.

BASHKIA DURRËS, përfaqësuar nga Alneida Rroshi dhe Gentian Kallmi, me autorizim.

AUTORITETI PORTUAL DURRËS, përfaqësuar nga Kreshnik Bajraktari dhe Ornela Dalipi, me autorizim.

ALBANIAN SEPORTS DEVELOPMENT COMPANY, përfaqësuar nga Alban Binaj dhe Adenil Pjetri, me autorizim.

EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT, në mungesë.

NSHMI DEVELOPMENT L.L.C., në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i ligjit nr. 79/2022, datë 24.11.2022 "Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a., dhe NSHMI Development L.L.C., për projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit"", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.**
Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 861, datë 29.12.2021 "Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina dhe Jahtet e Durrësit (Durrës Yachts & Marina)" dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Autoriteti Portual Durrës te Ministria e Financave dhe Ekonomisë", të ndryshuar me vendimin nr. 494, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 861, datë 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina dhe Jahtet e Durrësit (Durrës Yachts & Marina)" dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Autoriteti Portual Durrës te Ministria e Financave dhe Ekonomisë", të ndryshuar me vendimin nr. 685, datë 26.10.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 861, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në fondin e pasurive të

paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina dhe Jahtet e Durrësit (Durrës Yachts & Marina)", të ndryshuar", të ndryshuar me vendimin nr. 115, datë 01.03.2023 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të shoqërisë "Albanian Seaports Development Company" sh.a., të pronave të paluajtshme shtetërore, pjesë e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës", si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 79/2022, datë 24.11.2022 "Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a., dhe NSHMI Development L.L.C. për projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit"", si dhe i vendimit nr. 861, datë 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimet nr. 494, datë 21.07.2022; nr. 685, datë 26.10.2022; nr. 115, datë 01.03.2023 të Këshillit të Ministrave, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE: **Nenet 3, 4, pika 1, 5, 6, 7, 11, 13, 15, 17, 18, 41, 42, 59, 116, pika 1, 121, 122, 124, 131, pika 1, shkronja "a", 132 dhe134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 9590, datë 27.07.2006**

“Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”” *(MSA)*; nenet 20, 21, pika 1, 27, 45, 47, 49, pika 1, 50, pika 1, 51, 51/a, pika 1, shkronja “b”, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(kërkuesi)*, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi)*, Këshillit të Ministrave, Bashkisë Durrës, Autoritetit Portal Durrës *(APD)*, Albanian Seports Development Company *(ASDC)*, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e interesuara, Eagle Hills Real Estate Development *(EHRED)* dhe NSHMI Development L.L.C. *(NSHMI)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 949, datë 25.11.2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar marrëveshjen mes tij dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe *(EBA)* për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, ku neni 3, pika 1, i të cilit ka përcaktuar nxitjen dhe krijimin nga secila palë të kushteve të favorshme për investitorët e palës tjetër kontraktuese për kryerjen e investimeve në territorin e saj, si dhe pranimin e këtyre investimeve në përputhje me ligjet e rregulloret e saj.

2. Me ligjin nr. 145/2020, datë 03.12.2020 *(ligji nr. 145/2020)* Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjen “Për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij

ligji, pjesë përbërëse e tij. Neni 6 i marrëveshjes ka përcaktuar, ndër të tjera, listën e projekteve specifike që konsiderohen të një natyre strategjike në përmbushjen e objektivave të kësaj marrëveshjeje dhe marrëveshjeve të mëparshme ekonomike e të bashkëpunimit midis dy palëve, konkretisht: rizhvillimi i Portit të Durrësit; mundësitë e investimeve në industrinë e turizmit, bujqësisë dhe logjistikës në Vlorë, Sarandë dhe Ksamil; investimet në fushën e turizmit në zonën e Përmetit. Po sipas këtij neni, kontratat, programet dhe projektet strategjike të rëna dakord, në përputhje me këtë marrëveshje, nuk do të jenë në asnjë prej palëve që u nënshtrohen prokurimit publik, tenderit publik, procedurës konkurruese publike ose ndonjë procedure tjetër të përcaktuar në legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë ose të EBA-së pas ratifikimit të saj.

3. Ligji i lartpërmendur i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)*, e cila, me vendimin nr. 36, datë 16.06.2023 *(vendimi nr. 36/2023),* ka vendosur rrëzimin e kërkesës së jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit për shfuqizimin si antikushtetues të tij, me arsyetimin se çështja e kontrollit të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit të tyre nuk përfshihet në kategoritë e çështjeve për të cilat Gjykata ka juridiksion për të vendosur dhe se kontrolli i saj shtrihet vetëm ndaj ligjit ratifikues të marrëveshjes në drejtim të respektimit të procedurave kushtetuese në procesin e miratimit të tij. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata ka vlerësuar se procedura e zhvilluar nga Kuvendi në miratimin e ligjit ratifikues të marrëveshjes nuk cenonte parimet dhe standardet kushtetuese.

4. Në vijim të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 145/2020 dhe në zbatim të ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë" *(ligji për investimet strategjike)*, vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 16.12.2015 "Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi" e nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", si dhe vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 14.10.2020 "Për miratimin e planit kombëtar sektorial të transportit detar dhe infrastrukturës portuale", me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (*AIDA*), me vendimin nr. 14/6, datë 02.12.2021 *(vendimi nr. 14/6)*, Komiteti i Investimeve Strategjike *(KIS)*, ka vendosur miratimin e statusit "Investim/ Investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit "Marina & Jahtet e Durrësit" (Durrës Yachts & Marina), si një projekt i integruar turistik dhe i një rëndësie strategjike për vendin, të kushtëzuar

me realizimin e detyrave, planit të veprimit të parashikuar në këtë vendim, si dhe me finalizimin e një marrëveshjeje për formën e bashkëpunimit midis palëve, të vlefshme sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme. Sipas këtij vendimi, projekti do të zhvillohet në një sipërfaqe afërsisht 79 ha, në zonën e Portit të Durrësit, i ndarë në 2 faza zhvillimi dhe do të realizohet nga subjekti aplikues "Symphony Real Estate Development" sh.p.k., si një projekt i integruar me port turistik dhe struktura akomoduese elitare, rezidenca me standard të lartë dhe shërbime në funksion të tyre. Në vendim janë parashikuar edhe masat mbështetëse që i jepen zhvillimit të projektit.

5. Me vendimin nr. 861, datë 29.12.2021 "Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit" (Durrës Yachts & Marina) dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Autoriteti Portual Durrës te Ministria e Financave dhe Ekonomisë" *(VKM nr. 861/2021)*, Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike *(FPPMIS)*, të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, me sipërfaqe totale 80.9 ha, si dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga APD-ja te Ministria e Financave dhe Ekonomisë *(MFE)*, të pasurive të paluajtshme të përcaktuara në shtojcën 1 dhe në planvendosjen bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse të tij.

6. Me vendimin nr. 14/45, datë 18.07.2022 *(vendimi nr. 14/45)*, KIS-i ka miratuar disa ndryshime në vendimin nr. 14/6 të tij, konkretisht në titullin, si dhe në përmbajtjen e pikave 2, 3, 6, 18, 19, 20, 22, 23, 27 dhe 28. Më konkretisht, statusi "Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë" i është dhënë projektit të investimit "Marina & Jahtet e Durrësit" (Durrës Yachts & Marina), për një periudhë 15-vjeçare. Projekti do të realizohet nga subjekti aplikues "Eagle Hills Real Estate Development" sh.p.k. (ish-"Symphony Real Estate Development" sh.p.k.) dhe garantues financiar subjekti NSHMI. Në lidhje me pikën 6 të vendimit nr. 14/6 është parashikuar që deri në krijimin e kushteve të nevojshme procedurale dhe fizike për realizimin e këtij investimi, projekti fillon me Fazën e Zhvillimit Pilot dhe për realizimin e kësaj detyre lidhet një marrëveshje mirëkuptimi midis "Eagle Hills Real Estate Development" sh.p.k. dhe subjektit të posaçëm të ngritur nga APD-ja.

7. Me vendimin nr. 494, datë 21.07.2022 *(VKM nr. 494/2022)*, Këshilli i Ministrave ka bërë disa ndryshime në VKM-në nr. 861/2021, konkretisht në titullin e saj dhe në pikat 1 dhe 2, duke parashikuar transferimin në FPPMIS të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, me sipërfaqe totale 812,600.98 m^2, nga të cilat 54,217.51 m^2 sipërfaqe ndërtimore të përcaktuara në shtojcën 1 dhe në planvendosjen që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Po kështu, është ndryshuar përgjegjësia e administrimit të pasurive të paluajtshme të përcaktuara prej tij nga APD-ja, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Drejtësisë te MFE-ja.

8. Po kështu, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës se MFE-së, me vendimin nr. 108, datë 21.10.2022, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka vendosur se masa e njoftuar prej saj nuk përbënte ndihmë shtetërore, pasi shteti kishte vepruar në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu, për rrjedhojë masat mbështetëse për entitetin ku vetë shteti do të ishte ortak dhe marrëveshjet e propozuara nuk hynin në fushën e zbatimit të ligjit për ndihmë shtetërore. Ndërsa me vendimin nr. 917, datë 24.10.2022, Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur: (i) t'i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që, përpara se porti "Marina & Jahtet e Durrësit" të deklarohet i hapur për trafik ndërkombëtar, të miratojë metodologjinë e përcaktimit të tarifave të shërbimeve portuale të ofruara nga investitori strategjik, të orientuara drejt kostos; detyrimin e investitorit strategjik për të miratuar rregullore për funksionimin e portit, ku të përcaktohet qartë mënyra e operimit të mjeteve lundruese, e drejta e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime pranë këtij porti; miratimin nga investitori strategjik të programeve të përputhshmërisë me ligjin nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" *(ligji nr. 9121/2003)*, të ndryshuar, për të gjitha shërbimet që do të ofrojë në këtë port; (ii) t'i rekomandojë AIDA-s që brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët, investitori strategjik të depozitojë tek Autoriteti i Konkurrencës njoftimin në zbatim të neneve 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003.

9. Në vijim, me vendimin nr. 685, datë 26.10.2022 *(VKM nr. 685/2022)*, Këshilli i Ministrave ka bërë disa ndryshime dhe shtesa të tjera në VKM-në nr. 861/2021. Konkretisht, në pikën 1, fjalët "...me sipërfaqe totale 812,600.98 m^2, nga të cilat 54,217.51 m^2 sipërfaqe ndërtimore..." janë zëvendësuar me "...me sipërfaqe totale 818,318.98 m^2, nga të cilat 61,450.51 m^2 sipërfaqe ndërtimore...". Në pikat 4 dhe 8 shoqëria "Symphony Real

Estate Development" sh.p.k. është zëvendësuar me "Eagle Hills Real Estate Development" sh.p.k. Ndërsa me vendimin nr. 14/61, datë 27.10.2022, KIS-i ka vendosur pranimin e pjesëmarrjes së shtetit në investimin strategjik procedurë e veçantë "Marina & Jahtet e Durrësit" (Durrës Yachts & Marina)" dhe transferimin e statusit strategjik shoqërisë së posaçme që do të krijohet me përbërjen e shoqërive ASDC dhe EHRED dhe me garantues financiar subjektin NSHMI.

10. Me ligjin nr. 79/2022, datë 24.11.2022 *(ligji nr. 79/2022),* Kuvendi ka miratuar marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe EHRED, ASDC e NSHMI për projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", si dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

11. Neni 2 i ligjit nr. 79/2022 parashikon se shoqëria e përbashkët për realizimin e projektit "Marina & Jahtet e Durrësit" përjashtohet nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe kontributin e strehimit social, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin e taksave vendore e për strehimin social dhe se vlera e detyrimit të përjashtuar është pjesë e kontributit të shtetit shqiptar në investim, sipas marrëveshjes së përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji *(pika 1)*. Po kështu, dhënia e lejeve, licencave dhe e akteve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit të investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit" bëhet sipas legjislacionit në fuqi, por, në çdo rast, brenda një afati prej jo më shumë se 150 ditësh *(pika 2)*. Pronat e paluajtshme shtetërore, të transferuara në FPPMIS për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", me vendim të Këshillit të Ministrave i kalojnë në pronësi ASDC-së *(pika 3)*. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 79/2022, kushtet thelbësore që duhet të përmbajë statuti i shoqërisë së përbashkët janë sipas shtojcës 8 që i bashkëlidhet ligjit, ndërsa sipas nenit 4 ASDC-ja lidh marrëveshjen e zhvillimit dhe kontratën për transferimin e titullit të pronësisë sipas tekstit të dokumenteve bashkëlidhur këtij ligji, kurse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidh marrëveshjen "Për Marinën e Durrësit" sipas tekstit të dokumentit bashkëlidhur këtij ligji. Këshilli i Ministrave është ngarkuar për miratimin e aktit nënligjor, sipas pikës 3 të nenit 2 të këtij ligji *(neni 5)*.

12. Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 01.03.2023 *(VKM nr. 115/2023)*, Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin në pronësi të ASDC-së së pronave të paluajtshme shtetërore, pjesë e FPPMIS-së, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", me

vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, sipas shtojcës 1 dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi, pjesë përbërëse të tij.

13. Në datën 22.04.2024 një grup prej 32 deputetësh të Kuvendit, që përbëjnë jo më pak se një të pestën e deputetëve të Kuvendit, i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit, duke pretenduar se aktet e kundërshtuara cenojnë të drejta kushtetuese, çka e bën të nevojshme edhe pezullimin e zbatimit të tyre nga Gjykata. Në datën 24.05.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 04.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për pezullimin e zbatimit të akteve të kundërshtuara, si dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Në datat 04.07.2024 dhe 05.07.2024 subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave, APD-ja, ASDC-ja, Bashkia Durrës dhe EHRED-ja i janë drejtuar Gjykatës me kërkesa për shtyrjen e afatit të parashtrimeve, për të cilat Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

A. Për pezullimin e zbatimit të akteve

14.1. Aktet e kundërshtuara kanë nisur të zbatohen. ASDC-së i është transferuar prona e paluajtshme shtetërore, përfshirë edhe pronë publike, në zbatim të VKM-së nr. 115/2023. Po kështu, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 79/2022 ASDC-ja ka lidhur marrëveshjen e zhvillimit dhe kontratën për transferimin e titullit të pronësisë te zhvilluesi, i cili përbëhet 67% nga EHRED dhe 33% ASDC, ndërsa Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka lidhur marrëveshjen për Marinën e Durrësit. Pasuria shtetërore ka filluar të tjetërsohet në një zonë me 12.000 njësi apartamente, njësi shërbimi ose hotele, ku përmes kompanisë imobilare MEI, shitjet e apartamenteve kanë filluar që në gropë, pa filluar zbatimi i projektit dhe pa u pajisur me lejet e ndërtimit. Në Porto Romano kanë nisur të kryhen shpenzime, të cilat janë lënë jashtë syve të publikut. Ndërtimi nuk po realizohet nga shoqëria që ka marrë përsipër zhvillimin dhe investimin, por nga nënkontraktorë shqiptarë. Kompania arabe e kontraktuar si zhvilluese në pjesën 67% nuk ka nevojë të investojë as në masën 3.4%, pasi projekti

po realizohet në masën 100% me vetëfinancim. Në këto kushte, zbatimi i akteve të kundërshtuara cenon drejtpërdrejt interesin publik.

14.2. Aktet cenojnë pronën e paluajtshme publike shtetërore, si dhe shkelin një sërë parimesh kushtetuese e aktesh ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, siç është edhe MSA-ja. Lejimi i zbatimit të tyre sjell pasoja të pariparueshme.

B. Për juridiksionin e Gjykatës

14.3. Gjykata ka juridiksion për gjykimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 79/2022, për sa kohë që përmes tij janë miratuar marrëveshje të një lloji të veçantë për zhvillimin e projektit strategjik në Portin e Durrësit dhe dispozitat e tij bien ndesh me Kushtetutën dhe MSA-në.

14.4. Gjykata ka juridiksion edhe për shqyrtimin e VKM-ve të kundërshtuara, pasi ato përbëjnë akte nënligjore normative, për sa kohë që përmbajnë vullnetin e shprehur të organit publik në ushtrim të funksioneve publike, rregullojnë marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe nuk shterojnë në zbatimin e tyre. Natyra normative e këtyre akteve lidhet me fuqinë e përgjithshme të tyre, në pikëpamje të aftësisë për të prekur situatën juridike të personave juridikë ose fizikë, përmes krijimit për ta të të drejtave dhe detyrimeve.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Ligji nr. 79/2022 cenon:

14.5. *Identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore* në lidhje edhe me *parimin e shtetit të së drejtës*, pasi krijon pasiguri juridike sa i takon ekzistencës së portit të Durrësit, si porti më i madh në vend. Ndonëse jo i listuar në objektet me rëndësi kulturore trashëgimore, përgjatë 2 mijëvjeçarit ky port i ka dhënë qytetit të Durrësit rëndësi lokale e rajonale, si dhe rëndësi politiko-ushtarake të dorës së parë në antikitetin klasik heleno-romak ose pushtimet barbare, normane, serbe e veneciane të kësaj zone. Ai përbënte ndërfaqe portuale themelore në rrugën e famshme Egnatia, pjesë e sistemit rrugor-detar që lidhte Romën me Kostandinopojën. Në kohën e Princ Vidit, deri në vitin 1920, qenia qytet-port i dha mundësinë Durrësit të ishte kryeqyteti i parë i shtetit. Edhe

nga pikëpamja gjeopolitike, si pjesë përbërëse e NATO-s, Porti i Durrësit përbën një nga daljet më strategjike në Detin Mesdhe, çka e bën atë një ndër portet më të frekuentuara në rajon e më gjerë. Pozicioni shumë i favorshëm gjeografik e bën këtë port më të madhin në Shqipëri dhe ndër më të mëdhenjtë në detet Adriatik e Jon, me nyje të rëndësishme për tregun ndërkombëtar, si për sa i përket transportit të mallrave, ashtu edhe tranzitit të pasagjerëve. Ndonëse ligji për trashëgiminë kulturore parashikon si kriter kohor vjetërsinë më shumë se 70 vjet, ligjvënësi nuk ka verifikuar interesin publik të Portit të Durrësit, për sa u përket vlerave të trashëgimisë historike dhe kulturore që ai mbart. Rëndësia e këtij porti përfshin edhe karakteristikat kryesore të tij si: infrastrukturën, basenin, kanalin hyrës, klimën në gjirin e tij. Me shkresën nr. 341/1, datë 08.03.2020, Drejtoria e Monumenteve të Kulturës e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore ka bërë me dije se, pavarësisht se brenda zonës ku është projektuar investimi nuk ndodhen objekte me status "monument kulture" e "qendër historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" dhe "zonë e mbrojtur", konturi i pronës për zhvillim mbivendoset me kufirin jugor të zonës arkeologjike A dhe B të Durrësit, Parku Arkeologjik Durrës dhe pranë kësaj zone ndodhen monumente kulture të kategorisë së parë, ndaj referuar ligjit nr. 27/2018, datë 17.05.2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar *(ligji nr. 27/2018),* subjekti zhvillues duhet të merrte miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

14.6. *Nenin 11, pika 2, të Kushtetutës*, sipas të cilit prona publike gëzon të njëjtën mbrojtje kushtetuese si prona private, pasi pa konkurrencë, analiza, studime ose vlerësime të plota e të argumentuara për mënyrën e shkëmbimit, ose vlerësimin ekonomik të pronës, përmes ligjit të kundërshtuar, kompanisë së përzgjedhur i janë vënë në dispozicion 82 ha tokë pronë shtetërore. Nisur nga parashikimet e ligjit nr. 145/2020, prona e Portit të Durrësit, ku përfshihen në mënyrë të pandashme pasuria truall dhe ndërtesat, është pronë e paluajtshme publike, që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell përfitime në funksion të publikut të gjerë, për rrjedhojë organet shtetërore duhet të merrnin masa në funksion të mbështetjes buxhetore për përmirësimin e këtyre pasurive dhe jo të kryenin veprime në cenim të tyre.

14.7. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë* në lidhje me *parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi:

14.7.1. Përzgjedhja e kompanisë që do të kryejë investimit është bërë pa garë, duke e trajtuar subjektin ekonomik të përzgjedhur në mënyrë preferenciale, përmes dhënies në përdorim të pasurisë në të cilën shtrihet Porti i Durrësit. Qëllimi i projektit nuk është ndërtimi i portit, por zhvillimi turistik. Në kushtet kur projekti bën fjalë për zhvillimin e turizmit, përmes ndërtimit të apartamenteve, hoteleve dhe njësive tregtare, përzgjedhja e kompanisë EHRED ka kufizuar pjesëmarrjen e kompanive të tjera vendase ose evropiane, si dhe të investitorëve të fuqishëm nga partnerë të tjerë strategjikë të vendit. Kjo përzgjedhje është bërë pa përcaktuar interesin publik ose grupin e interesit, të drejtat e të cilit janë synuar të mbrohen, pa analizë të studimeve dhe strategjive të zhvillimit të Portit dhe zonës së Durrësit.

14.7.2. Ligji është bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ekonomik mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së EBA-së, e cila parashikon se kontratat, programet dhe projektet strategjike të rëna dakord mes dy qeverive nuk do t'i nënshtrohen prokurimit publik, tenderit publik, procedurës konkurruese publike ose ndonjë procedure tjetër të përcaktuar në legjislacionin kombëtar të të dyja vendeve. Gjatë vlerësimit të ligjit nr. 145/2020, Komisioni për Ekonominë dhe Financat i Kuvendit ka pranuar se çdo marrëveshje tjetër që do të nënshkruhet bazuar në këtë marrëveshje, do të trajtohet dhe miratohet si marrëveshje më vete, ndërkohë që raporti i këtij komisioni nuk shprehet për nenin 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit, i cili përjashton procedurat e prokurimit e të konkurrencës publike. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka sqaruar se ky përjashtim bëhet rast pas rasti, me ligj të veçantë ose vendim të Këshillit të Ministrave, sipas specifikës dhe rregullave të prokurimit të dakordësuara nga të dyja palët. Ligji nr. 145/2020 cenon *parimin e sigurisë juridike*, si një nga parashikimet e MSA-së, shtrembëron *konkurrencën*, si dhe *cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, duke favorizuar disa kompani

në raport me kompani të tjera. Ky ligj nuk sqaron se çfarë do të thotë "rizhvillim i Portit të Durrësit" dhe në asnjë rast nuk flet për ndërtim apartamentesh, hotelesh ose njësish tregtare.

14.7.3. Neni 2, pika 1, i ligjit nr. 79/2022 dhe neni 10.12 i marrëveshjes, pjesë integrale e këtij ligji, krijojnë një regjim të posaçëm juridik vetëm për një subjekt të caktuar kundrejt regjimit juridik fiskal të përgjithshëm, të aplikueshëm për sipërmarrësit që veprojnë brenda së njëjtës veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë. Investimi strategjik është përjashtuar nga detyrimi për pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, të përcaktuar nga neni 27 i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar *(ligji nr. 9632/2006)*, në vlerën prej 4% të çmimit të shitjes, si dhe të kontributit për strehimin social, të përcaktuar nga neni 19 i ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar *(ligji nr. 22/2018)*, në vlerën 3% të sipërfaqes funksionale të ndërtimit. Ky regjim devijon haptazi nga regjimi fiskal i aplikueshëm për të gjithë kategorinë e taksapaguesve operatorë ekonomikë sipërmarrës, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin ekonomik të sipërmarrjes dhe ndërtimit. Po kështu, shteti ka vënë në dispozicion të këtij investimi 150 milionë euro (7% e shumës që parashikohet të arkëtohet nga shitja e apartamenteve), të cilat mund të përdoreshin nga pushteti lokal në zhvillimin e qytetit. Përfshirja e shtetit si aksioner në subjektin përfitues nuk justifikon shkeljen e parimeve kushtetuese, për sa kohë që shteti, si subjekt ekonomik në qarkullimin e lirë civil, nuk gëzon privilegje ligjore dhe është i barabartë përpara ligjit me çdo subjekt tjetër privat.

14.7.4. Përdorimi i burimeve shtetërore në favor të sipërmarrësit të përzgjedhur rrezikon shtrembërimin e konkurrencës në sektorin përkatës, pasi ndihma e dhënë nga shteti subjektit përfitues, EHRED dhe ASDC, përfshirë statusin e posaçëm dhe unik, avantazhon këtë sipërmarrës në krahasim me subjektet e tjera që ushtrojnë të njëjtën veprimtari. *Ndihma shtetërore* e dhënë këtij subjekti, përfshirë përjashtimin nga taksat, redukton koston e sipërmarrjes së favorizuar dhe tkurr sektorin e prekur. Fakti që masa ka qëllim arritjen e

një objektivi ekonomik, social ose zhvillimin e një politike të caktuar tregtare, në fushën e punësimit, mjedisit etj., nuk përjashton zbatimin e nenit 107(1) të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian *(TFBE)*. Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar se marrëveshja ka klauzola ekskluziviteti.

14.7.5. Pozita e veçantë që i është dhënë kompanisë së përzgjedhur ndikon negativisht në aktivitetin tregtar të sipërmarrësve/investitorëve të tjerë që, në kushte të njëjta tregu, nuk gëzojnë privilegj fiskal, për sa i përket ofertës dhe çmimit të hedhjes në treg të produktit të sipërmarrjes së tyre kundrejt produktit të sipërmarrësit të privilegjuar, frenon kërkesën në treg për produktin e sipërmarrjes së tyre kundrejt rritjes së kërkesës për produktin e sipërmarrësit të privilegjuar, ul të ardhurat e tyre ekonomike kundrejt rritjes të të ardhurave të sipërmarrësit të privilegjuar, frenon nismën dhe mundësinë ekonomike të tyre për të vijuar aktivitetin tregtar kundrejt rritjes së fuqisë ekonomike të sipërmarrësit të privilegjuar, i cili, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e privilegjit të dhënë, avantazhohet përkundrejt subjekteve të tjera të ngjashme, për sa i përket konkurrimit me çmim të avantazhuar ose marzhit të përfitimit shumë më të lartë në kushte çmimi të njëjtë ose të krahasueshëm.

14.8. *MSA-në*, pasi marrëveshja e miratuar përmes ligjit nr. 79/2022 bie ndesh me nenin 71 të MSA-së, i cili ndalon shtrembërimin e konkurrencës, si dhe nenin 74 të saj, që përcakton liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit. Sipas ligjit për prokurimin publik, kompanitë e komunitetit evropian gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në të njëjtën mënyrë si shoqëritë shqiptare.

14.9. *Të drejtën për transparencë*, të parashikuar nga neni 83 i Kushtetutës, pasi:

14.9.1. Ligji është miratuar pa u zhvilluar seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile ose të grupeve të interesit, pa transparencë ndaj publikut për projektin, për përzgjedhjen e firmës që do të ndërtojë Portin e ri të Durrësit, për humbjet e shtetit shqiptar në kuadër të dëmit efektiv dhe atij të pritshëm, për përfitimet e pritshme në të ardhmen, pa vlerësuar historinë e Portit të Durrësit dhe pa u bërë takime me grupet e interesit për vlerat që ai mbart.

14.9.2. Po kështu, ligji është miratuar pa transparencë edhe ndaj ligjvënësit. Si një ndër parimet kushtetuese, i parashikuar edhe në Rregulloren e Kuvendit, transparenca detyronte propozuesin e projektligjit, Këshillin e Ministrave, që jo vetëm të përmbushte kërkesat e pikës 2 të nenit 68 të Rregullores, por të paraqiste në mënyrë transparente çdo aspekt të projektligjit, çka nënkupton bërjen publike të marrëveshjes së plotë, së bashku me anekset e saj.

14.9.3. Gjatë marrjes në pyetje nga deputetët, ministrja e Financave ka deklaruar se kontrata përmbante pjesë konfidenciale, të cilat nuk përfshiheshin në projektligj. Mungesa e transparencës në identifikimin e projektit, investimit dhe investitorit fundor rrezikon që investimi të burojë nga korrupsioni, krimi i organizuar, trafikimi i paligjshëm, terrorizmi dhe/ose pastrimi i parave. Procesi legjislativ është kryer në mashtrim të ligjit, çka përbën si shkelje të procedurave parlamentare, ashtu edhe shkelje penale.

14.9.4. Ligji është miratuar me *procedurë të përshpejtuar*, kjo edhe për të shmangur miratimin e projektligjit "Për identifikimin e pronarëve përfitues të partnerëve në sektorin publik", çka do të bënte të pamundur miratimin e ligjit objekt kërkese.

14.10. *Parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve* në drejtim të *parimit të decentralizimit dhe të autonomisë vendore*, pasi territori në të cilin do të kryhen ndërtimet mbulohet nga Bashkia Durrës, ndaj bazuar në parashikimet e ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar *(ligji nr. 107/2014)*, lejet e ndërtimit do të duhej të lëshoheshin nga kjo bashki. Subjekti përfitues është përjashtuar nga taksa e infrastrukturës dhe kontributi për strehim social, duke iu dhënë në këtë mënyrë privilegje fiskale dhe duke u krijuar ndaj tij një regjim i posaçëm fiskal. Po kështu, sipas shtojcës 2 të marrëveshjes kuadër të miratuar me ligjin nr. 79/2022, Bashkia Durrës është privuar nga menaxhimi i hapësirave publike, si dhe i vijës bregdetare për 35 vjet. Sipas pikës 10.6.1 të kësaj marrëveshjeje, kontratës së sipërmarrjes, draftkontratës së shitjes të njësive, marrëveshjes për prenotim interesi mes "Durrës Marina" sh.a. e palës së interesuar dhe planit të shlyerjes së vlerës së pronës, menaxhimi i hapësirave publike është e drejtë vetëm e investitorit strategjik, i cili ka të

drejtën ekskluzive për ndërtimin e kompleksit elitar. Si rezultat i ligjit të kundërshtuar, hapësirat publike të krijuara nga zhvillimi i territorit, taksa në infrastrukturë dhe kontributi në banesa sociale nuk do të shkojnë në favor të kësaj bashkie dhe këto kontribute nuk do të përdoren për banorët e Durrësit.

14.11. *Nenin 82, pika 1, të Kushtetutës*, pasi:

14.11.1. Projektligji nuk është shoqëruar me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij, me raporte për dobishmërinë e shtetit në transferimin e portit në Porto Romano ose për vlerësimin e të ardhurave buxhetore për periudhën tranzitore të kalimit. Konkluzioni i arritur nga Komisioni i Financave dhe Ekonomisë së Kuvendit se projektligji nuk shoqërohet me shpenzime financiare shtesë në buxhetin e shtetit nuk është i drejtë, pasi shteti shqiptar preket në aspektet financiare, buxhetore dhe ekonomike. Ky vlerësim bie në kundërshtim me konkluzionin e arritur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit miratimi me ligj është bërë, ndër të tjera, për shkak të vlerës së madhe të investimit.

14.11.2. Projekti shoqërohet me shpenzime të mëdha financiare për shtetin. Vlera e tokës publike "të falur" arrin në 124 milionë euro, ndërsa e truallit rreth 400 milion euro. Taksa e ndikimit në infrastrukturë kap vlerën 84 milionë euro, ndërsa detyrimi për strehimin social llogaritet në shumën 58.5 milionë euro. Po kështu, në mënyrë indirekte, shteti ngarkohet me detyrimin e pastrimit të territorit me një kosto rreth 25 milionë euro. Ndarja e kostove të kredisë, si detyrimin për aksionerin shtetëror, i korrespondon një vlere prej 8.25 milionë eurosh. Totali i kontributit në investim të palës shtetërore arrin vlerën 299.75 milionë euro, ku nuk janë llogaritur kredia prej 50.5 milionë eurosh e marrë për ndërtimin e terminalit të pasagjerëve dhe rregullimin e infrastrukturës së portit, grantet e Bashkimit Evropian *(BE)*, kostot e financimit të portit të ri, pretendimet e kompanive gjermane dhe turke që kanë paditur në arbitrazh shtetin shqiptar në vlerën 140 milionë euro, kostot për të çuar në kufi të zonës së projektit infrastrukturën përkatëse rrugore, kanalizimet, energjinë, ujin etj.

14.11.3. Organi publik që ka shqyrtuar nismën nuk ka siguruar informacion për kuadrin e plotë ligjor, nuk ka bërë vlerësim të situatës aktuale në Portin e Durrësit, të investimeve të bëra, kontratave koncensionare në zbatim e sipër, nuk ka bërë transparente studimet e fundit bashkëkohore lidhur me studimin gjeologjik të truallit ku do të ndërtohet, të studimeve për vendosjen e portit në një hapësirë tjetër, të dhëna lidhur me projekte të ndërtimit të portit të ri dhe financimin e tij, leverdinë ekonomike të shtetit etj. Numri i vogël i jahteve që do të ankorohen në pjesën e dedikuar nuk justifikon shpenzimet e transferimit të pronës shtetërore te privati, sikurse parashikohet në marrëveshjen kuadër, si dhe investimet e ngritjes së portit në Porto Romano. Po kështu, kapacitetet e përpunimit në Porto Romano do të jenë sa 1/10-ta e përpunimit të anijeve me kapacitet të madh, çka tregon se humbjet e pritshme të investimit të pastudiuar do të jenë shumë të mëdha me dëm afatgjatë në buxhetin e shtetit.

14.12. Marrëveshja kuadër e miratuar me ligjin nr. 79/2022 parashikon zbatimin e programit të pasaportës së artë, përmes së drejtës së investitorit të huaj për të aplikuar për shtetësi ose rezidencë në Republikën e Shqipërisë, çka bie ndesh me Kushtetutën, MSA-në, rekomandimet e BE-së, si dhe marrëveshjen për heqjen e vizave mes Shqipërisë dhe BE-së.

C.2. Për VKM-në nr. 816/2021, të ndryshuar

14.13. VKM-ja nr. 861/2021 dhe VKM-të që e kanë ndryshuar atë cenojnë:

14.13.1. *Parimin e hierarkisë së normave* në lidhje me *parimin e shtetit të së drejtës*, pasi kanë disponuar për pasuri të paluajtshme shtetërore publike në kapërcim të tagrave të dhëna nga ligjet për pronat e paluajtshme të shtetit dhe për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore. Kështu, krahas administrimit të pasurisë së paluajtshme shtetërore, përmes VKM-së nr. 861/2021 është vendosur heqja e pasurisë nga lista e inventarit të APD-së, si dhe janë transferuar vijë bregdetare, infrastrukturë aeroportuale e Durrësit, e truallit mbi të cilin janë vendosur këto prona, të cilat përbëjnë pronë publike të

paluajtshme të shtetit. VKM-ja nr. 494/2022 ka disponuar për pasuri publike si vija bregdetare dhe Porti i Durrësit, ndërsa ka për objekt transferimin nga APD-ja në favor të FPPMIS-së dhe ndryshimin e administrimit te MFE-ja. VKM-ja nr. 115/2023 bazohet në ligjin për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, çka nuk është rasti, pasi prona ka kaluar në pronësi të ASDC-së, e cila nuk ka lidhje me pushtetin vendor. Ajo do ta përdorë këtë pasuri në biznesin me shoqërinë arabe, me të cilën do të zhvillojë truallin. Zhvillimi i truallit të transferuar përmes vendimeve të KIS-it nuk ka lidhje me zhvillimin e portit të Durrësit. Zbatimi i këtyre normave në praktikë krijon paqartësi dhe pasiguri.

15. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, ka prapësuar:

A. Për juridiksionin e Gjykatës

A.1. Për ligjin nr. 79/2022

15.1. Kërkuesi ka pretenduar se të drejtat e cenuara nga ligji objekt kërkese garantohen nga ligjet nr. 27/2018, nr. 9632/2006, nr. 22/2018, nr. 107/2014 etj., të cilat kanë të njëjtën fuqi juridike me ligjin nr. 79/2022. Në këto kushte, shqyrtimi i çështjes nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës, pasi ligji i kundërshtuar nuk prek probleme të kushtetutshmërisë. Referenca e kërkuesit në nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës për të pretenduar antikushtetutshmëri nuk e përfshin çështjen në juridiksionin kushtetues.

A.2. Për VKM-në nr. 861/2021, të ndryshuar

15.2. VKM-ja nr. 861/2021 dhe VKM-të që e kanë ndryshuar atë, përbëjnë akte me karakter individual, ndaj nuk i nënshtrohen juridiksionit kushtetues.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

15.3. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, por jo *ratione materiae*. Argumentet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit janë të njëjta me ato të parashtruara në Gjykatë për ligjin nr. 145/2020, për të cilin, me vendimin nr. 36/2023, Gjykata ka vlerësuar se, së bashku me pretendimet për cenimin e identitetit kombëtar, parimit

të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe MSA-së, nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Shfuqizimi i ligjit nr. 79/2022 nga Gjykata do të sillte *de facto* shfuqizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomik mes Këshillit të Ministrave dhe qeverisë së EBA-së, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar sipas nenit 5 të Kushtetutës.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për ligjin nr. 79/2022

15.4. Pretendimet për cenimin e *identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore* nuk mbështeten në argumente dhe në kuadrin ligjor në fuqi për trashëgiminë kulturore. Sipas përkufizimit të ligjit nr. 27/2018 për trashëgiminë kulturore dhe muzetë e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, ndërtimet në Portin e Durrësit nuk janë objekte kulturore dhe nuk kanë statusin "monument kulture", "qendër historike", "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur". Po kështu, funksioni kryesor i portit lidhet me veprimtarinë ekonomike dhe logjistike që përfshin transportin e mallrave dhe të pasagjerëve, dhe nuk përmban elemente që mundësojnë lidhje shpirtërore ose emocionale me komunitetin.

15.5. Pretendimet për cenimin e *pronës shtetërore* janë të pabazuara, pasi ligji nr. 79/2022 është bazuar në ligjin për investimet strategjike, neni 30 i të cilit parashikon të drejtën e shtetit për të qenë bashkëpjesëmarrës në investimet strategjike, përmes kontributit të tij, i cili, sipas akteve nënligjore në zbatim të ligjit, mund të jetë në kapital ose në natyrë.

15.6. Pretendimet për *cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike* dhe *parimit të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit* janë të pabazuara, pasi:

15.6.1. Ligji për investimet strategjike dhe ligji nr. 93/2015, datë 27.07.2015 "Për turizmin", i ndryshuar *(ligji për turizmin)* u japin të drejtë të gjitha subjekteve të aplikojnë për të marrë statusin e investitorit strategjik dhe për projekte në fushën e turizmit. Edhe pse ligjvënësi ka zgjedhur të përjashtojë nga procedurat specifike konkurruese subjektet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto ligje, kjo nuk nënkupton diskriminimin e subjekteve të tjera. Marrëveshja e bashkëpunimit me EBA-në nuk e ka zhveshur Këshillin

e Ministrave nga diskrecioni për të përzgjedhur projektin më të mirë për zonat e identifikuara në marrëveshje. Sipas kësaj marrëveshjeje, shteti shqiptar ka detyrimin të pranojë propozimin e një subjekti tregtar të EBA-së.

15.6.2. Ligji është në përputhje edhe me nenin 155 të Kushtetutës dhe nuk krijon pabarazi në zbatimin e detyrimeve tatimore e as përfitime të padrejta. Miratimi i tij është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës, pasi kufizimet janë vendosur me ligj për ndërtimin e një projekti me interes publik, si dhe janë proporcionale. Ligji garanton interesin publik përmes ruajtjes së vlerës së aksioneve të shtetit pavarësisht investimeve ose shpenzimeve shtesë të investitorit; nuk lejon vendosjen kolateral nga investitori të aseteve shtetërore, përfshirë edhe tokën, për të siguruar financim; njeh të drejtën vendimmarrëse dhe të vetos së shtetit në Mbledhjet e Asamblesë për çështjet e rëndësishme që lidhen me planin e biznesit, buxhetin etj. Marina, infrastruktura e portit dhe bregdeti do të mbeten pronë shtetërore dhe do t'i kthehen shtetit pas 35 vjetëve. Në rastin e shkeljes së detyrimeve të marra përsipër shteti ka të drejtë të ndërpresë marrëdhëniet dhe t'i marrë aksionet investitorit pa kundërshpërblim. Ligji garanton një garë të hapur, por me kritere dhe procedura të rrepta për investitorët e huaj dhe vendas, të cilët paraqesin propozim me ndikim në zhvillimin e një sektori me rëndësi në ekonominë e vendit. Objektivi i ligjvënësit për zhvillimin e ekonomisë është mjaftueshëm i rëndësishëm për kufizimin e së drejtës.

15.7. Pretendimet për cenimin e *MSA-së* janë të pabazuara, pasi:

15.7.1. Ato kanë të bëjnë me marrëveshjen e miratuar me ligjin nr. 145/2020, sipas të cilit përzgjedhja e investitorit të paracaktuar bëhet pa garë. Kjo marrëveshje dhe MSA-ja gjenden në nivel të njëjtë hierarkik, ndaj Gjykata nuk mund të vendosë për papajtueshmërinë mes tyre. Neni 74 i MSA-së lejon konkurrimin e shoqërive të komunitetit njësoj si ato shqiptare, ndërkohë që marrëveshja e bashkëpunimit përjashton procedurat e konkurrimit, pasi procedurat e përzgjedhjes së subjekteve, sipas rregullave të zakonshme të konkurrimit dhe tenderimit, nuk garantojnë në çdo rast

përzgjedhjen e subjektit për realizimin e investimit dhe të projektit. Edhe ligjet nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" *(ligji për prokurimin publik)* e nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik dhe privat" *(ligji për koncesionet dhe partneritetin publik privat)*, të përafruara me legjislacionin e BE-së dhe nenin 74 të MSA-së, parashikojnë zbatimin e tyre deri në atë masë sa nuk bien ndesh me një marrëveshje ndërkombëtare. Nga ana tjetër, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka evidentuar shkelje të rregullave të konkurrencës ose pasoja negative që mund të shkaktohen në treg.

15.7.2. Po kështu, pretendimet e kërkuesit se ligji përbën *ndihmë shtetërore* janë të pabazuara, pasi me vendimin nr. 108, datë 21.10.2022, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka vlerësuar se masat e marra nuk përbënin ndihmë të tillë.

15.8. Pretendimet për cenimin e *parimit të transparencës* janë të pabazuara, pasi:

15.8.1. Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit nr. 79/2022 është realizuar në mënyrë transparente, duke i garantuar çdo deputeti aktet që kanë shoqëruar projektligjin, marrjen e informacionit të nevojshëm përmes pyetje-përgjigjeve me përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave, përfshirë aktet që kanë shoqëruar projektligjin në debatin parlamentar. Moszhvillimi i seancave dëgjimore në procedurën e përshpejtuar nuk e bën atë jotransparente, pasi procesi i shqyrtimit në komisione ka qenë publik, palët e interesuara kanë pasur mundësi të kërkonin të merrnin pjesë në shqyrtimin e ligjit në komisione dhe Kuvendi u ka siguruar mekanizmat për realizimin e kësaj të drejte. Pretendimet për mënyrën e zhvillimit të procedurës parlamentare janë të natyrës procedurale, të parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkak për antikushtetutshmërinë e ligjit.

15.8.2. Po kështu, projektligji dhe dokumentacioni shoqërues i tij janë publikuar në datën 10.11.2022 në faqen zyrtare të Kuvendit, së bashku me procesverbalet e mbledhjeve, raportet e komisioneve parlamentare dhe procesverbalin e seancës së datës 24.11.2022.

15.8.3. Pretendimet për miratimin e ligjit me *procedurë të përshpejtuar* nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi

legjislacioni parashikon edhe këtë mënyrë të miratimit të ligjeve, pa e lidhur atë me plotësimin e ndonjë situate ose kriteri të posaçëm, por e lë në çmimin e Këshillit të Ministrave, si propozues, si dhe Kuvendit. Në relacionin shpjegues të Këshillit të Ministrave dhe në raportet e komisioneve të Kuvendit është argumentuar nevoja e përdorimit të këtij mjeti kushtetues.

15.9. Pretendimet për cenimin e *nenit 82, pika 1, të Kushtetutës* janë të pabazuara. Sipas relacionit të Këshillit të Ministrave bashkëshoqërues të projektligjit, si dhe nga shqyrtimi në komisionet parlamentare, miratimi i ligjit nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi investimi do të realizohet nga investitori privat.

15.10. Ligji nuk cenon parimet e *ndarjes dhe të balancimit të pushteteve* e të *autonomisë vendore*, pasi:

15.10.1. Pasuria e paluajtshme e Portit të Durrësit nuk ka qenë në pronësi ose administrim të Bashkisë Durrës, por nën administrim të APD-së. Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të pronave është e drejtë e Këshillit të Ministrave. Po kështu, sipas nenit 28 të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, lejet e ndërtimit për llojet e zhvillimit komplekse dhe investime strategjike lëshohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit *(KKT)* e jo nga Bashkia Durrës, ndërsa sipas nenit 19 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" *(VKM nr. 408/2015)*, llojet e zhvillimit komplekse përfshijnë edhe portet e investimet strategjike, siç është edhe projekti i investimit në fjalë.

15.10.2. Në asnjë dispozitë të tij ligji nuk cenon të drejtën e Bashkisë Durrës për të menaxhuar hapësirat e përbashkëta publike. Sipas nenit 10.6.1. të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, investitori mund të administrojë hapësirat e përbashkëta publike vetëm nëse lejohet nga legjislacioni në fuqi.

15.10.3. Pretendimet e kërkuesit se Bashkia Durrës është përjashtuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe kontributi për strehimin social, janë të pabazuara, pasi neni 6 i ligjit nr. 9632/2006 përjashton nga taksat vendore subjektet e

përcaktuara shprehimisht në këtë ligj ose në ligje të tjera të veçanta dhe se, për çdo përjashtim nga këto taksa, pushteti vendor kompensohet për efektet financiare nga buxheti i shtetit. Për më tepër, Bashkia Durrës nuk ka shprehur ndonjë rezervë për kontributet e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe strehimit social edhe pse ka qenë pjesë e grupit negociator të marrëveshjes.

C.2. Për VKM-në nr. 861/2021, të ndryshuar

15.11. Pretendimet e kërkuesit se VKM-ja nr. 861/2021 cenon *parimet e hierarkisë së akteve* dhe *shtetit të së drejtës*, janë të pabazuara, pasi ato nuk janë parashtruar në këndvështrimin kushtetues, por vetëm ligjor. Si të tilla, ato nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës. Për më tepër, kjo VKM dhe ndryshimet që ajo ka pësuar kanë dalë në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjit për investimet strategjike dhe ligjit nr. 79/2022, të cilat kanë autorizuar shprehimisht miratimin e këtyre akteve, në garantim të parashikimeve të nenit 118 të Kushtetutës.

16. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, krahas prapësimeve të Kuvendit, për sa i përket *juridiksionit të Gjykatës për ligjin nr. 79/2022 dhe VKM-të nr. 861/2021, nr. 494/2022, nr. 685/2022 e 115/2023*, *legjitimimit të kërkuesit* dhe *themelit të pretendimeve*, ka prapësuar edhe për sa më poshtë:

A. Për juridiksionin e Gjykatës

16.1. Pretendimet e kërkuesit se ligji nr. 79/2022 cenon MSA-në kanë të bëjnë, në thelb, me ligjin nr. 145/2020, për të cilin Gjykata ka mbajtur qëndrim, ndaj ato nuk i nënshtrohen juridiksionit kushtetues.

16.2. Referuar kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, VKM-ja nr. 861/2021 dhe VKM-të nr. 494/2022, nr. 685/2022 dhe nr. 115/2023 që e kanë ndryshuar atë janë akte nënligjore me karakter individual. Në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, objekt gjykimi kushtetues mund të jenë vetëm aktet nënligjore normative. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka provuar që VKM-të konkrete t'i jenë nënshtruar gjykimit në gjykatën administrative të shkallës së parë ose

Gjykatës Administrative të Apelit dhe këto të ishin mjete joefektive.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

16.3. Kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet për cenimin e parimeve të decentralizimit, autonomisë vendore dhe ndarjes e balancimit të pushteteve. Në kushtet kur parashikimet e marrëveshjes përcaktojnë përjashtimin fiskal vetëm për projektin në fjalë, i cili prek vetëm Bashkinë Durrës, e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën i përket kësaj bashkie dhe jo kërkuesit.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për ligjin nr. 79/2022

16.4. Pretendimet për cenimin e *identitetit dhe të trashëgimisë kulturore*, për shkak të lidhjes së vlerës kulturore e Portit të Durrësit me veprimtarinë e tij janë të pabazuara, pasi një veprimtari e tillë nuk përfshihet në përcaktimet e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Për më tepër, ligji nr. 79/2022 ka parashikuar një proces të qartë për vlerësimin e impaktit kulturor të projektit. Porti do të vazhdojë të ekzistojë, pasi zhvendosja do të prekë vetëm aktivitetin e tij industrial, ndërsa porti aktual do të vazhdojë si port turistik, ku do të ankorohen anije dhe jahte.

16.5. Pretendimet për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike*, *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit* janë të pabazuara, pasi:

16.5.1. Nismat ligjore që synojnë rritjen ekonomike të vendit, nxitjen e investimeve të huaja dhe ofrimin e masave mbështetëse janë parashikuar nga ligjet për investimet e huaja dhe për turizmin, të ndryshuara. Me ratifikimin e marrëveshjes me EBA-në, Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër një sërë detyrimesh, veçanërisht për sa u përket projekteve të parashikuara specifikisht në këtë marrëveshje, siç është edhe projekti për zhvillimin e Portit të Durrësit, për të cilin neni 22, shkronja “b”, i ligjit për investimet strategjike dhe neni 35 i ligjit për turizmin kërkojnë miratimin nga Kuvendi. Në rastin konkret, për projektin në fjalë është ndjekur procedura administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16.5.2. Përjashtimi i projektit nga taksa e ndërtimit në infrastrukturë

dhe kontributi i strehimit social është bërë në përputhje me nenin 155 të Kushtetutës, ligjin për investimet strategjike dhe VKM-në nr. 1030/2015 "Për organizmin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike *(VKM nr. 1030/2015)*. Ky përjashtim konsiderohet kontribut i shtetit në kapitalin e shoqërisë, i cili do të mblidhet në formën e dividentit nga fitimi. Praktika të tilla janë ndjekur dhe më parë nga shteti shqiptar për projektet me rëndësi kombëtare dhe interes të lartë publik. Krahasimi i subjekteve sipërmarrëse me subjektet e tjera private nuk është objektiv dhe real, pasi këta të fundit ndodhen në kushte të ndryshme e operojnë në fusha të ndryshme, për rrjedhojë të drejtat dhe detyrimet e tyre janë të ndryshme.

16.5.3. Neni 8, pika 1, i ligjit për prokurimin publik, i cili është në përputhje me Direktivën 2014/24 të BE-së, parashikon moszbatimin e procedurave të konkurrimit në rastet e përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare, e cila parashikon rregulla të posaçme prokurimi. Ky rregullim përcaktohet edhe në nenin 5 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, i cili është në përputhje me nenin 14 të Direktivës 2014/23 të BE-së. Në këtë kuptim, pretendimet për shkeljen e *nenit 71 të MSA-së*, që përcakton përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, si dhe *nenin 74 të saj*, për sa u përket rregullave të konkurrencës, janë të pabazuara.

16.6. Pretendimet se marrëveshja e miratuar me ligjin objekt kundërshtimi përbën *ndihmë shtetërore* janë gjithashtu të pabazuara. Aktet e BE-së nuk ndalojnë krijimin e një shoqërie të posaçme me aksionarë shtetërorë, por përcaktojnë detyrimin e ndërmarrjeve të kësaj shoqërie për të njoftuar krijimin e saj tek Autoriteti i Konkurrencës. Edhe në rastin konkret, për të garantuar legjitimitetin e kushteve të marrëveshjes, përmes AIDA-së është kërkuar mendim nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore, të cilat nuk kanë konstatuar problematika në këtë drejtim.

16.7. Kufizimi i së drejtës është bërë në përputhje me *nenin 17 të Kushtetutës*, konkretisht me ligj, për një interes publik dhe është

proporcional. Projekti do të ketë impakt shumë të madh në ekonominë e vendit e sektorë të ndryshëm si ndërtimi, turizmi dhe peshkimi. Ai do të kërkojë fuqi punëtore të kualifikuar, duke nxitur krijimin e shkollave e kurseve të specializuara dhe rritjen e cilësisë së krahut të punës. Kjo do të sjellë standarde të reja zhvillimi e ndërtimi në vend, duke ndikuar pozitivisht në konkurrencën dhe cilësinë e industrive të ndërtimit e turizmit. Projekti do të përmirësojë imazhin e vendit, duke tërhequr investitorë dhe turistë ndërkombëtarë dhe do të dëshmojë mundësitë e sigurta të investimit në vend. Po kështu, Plani i Përgjithshëm Kombëtar "Shqipëria 2030 (2016)" synon rritjen dhe fuqizimin e porteve kryesore ekzistuese me qëllim rritjen e funksionit turistik të qendrave të banuara. Masat e miratuara me ligjin nr. 79/2022 janë të justifikuara dhe të nevojshme për arritjen e objektivit të qeverisë, përfitimin maksimal në të mirë të interesit publik. Përfitimet e projektit do të jenë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e kompanisë, si dhe të tërthorta, përmes projektit. Aksionet e shtetit në projekt nuk do të zvogëlohen, por do të mbeten në masën 33%.

16.8. Pretendimet për cenimin e *parimit të transparencës* janë të pabazuara, pasi procesi i përzgjedhjes së partnerëve dhe investitorit strategjik është bërë në mënyrë transparente dhe është mbikëqyrur nga institucionet kompetente. Vendimet e KIS-it janë publikuar dhe regjistruar në regjistrin e investimeve strategjike, si dhe i janë njoftuar AIDA-së. Po kështu, edhe miratimi i ligjit është bërë me transparencë.

16.9. Pretendimet për marrjen e pasaportës shqiptare përmes investimit janë të pabazuara, pasi Raporti i Komisionit Evropian i cituar nga kërkuesi nuk referon ligjin objekt shqyrtimi. Për më tepër, sipas nenit 10.11 të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, investitorët e huaj do të kenë të drejtë të aplikojnë për shtetësi dhe/ose rezidencë vetëm nëse e lejon legjislacioni shqiptar.

16.10. Pretendimet për cenimin e *parimit të autonomisë vendore* janë të pabazuara, pasi pasuritë e paluajtshme, pjesë e projektit, nuk kanë qenë ndonjëherë në pronësi ose administrim të Bashkisë Durrës, por pronë shtetërore.

16.11. Pretendimet për cenimin e *nenit 82 të Kushtetutës* janë të pabazuara, pasi, siç është theksuar në dokumentet shoqëruese të

projektligjit dhe raportet e komisioneve parlamentare, ligji nuk sjell shpenzime financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Sipas marrëveshjes, pesha e investimit do të jetë në ngarkim vetëm të palës investuese. Ligji ka 2 vjet që është miratuar dhe nuk ka pasur kosto shtesë të mbuluar nga buxheti i shtetit.

C.2. Për VKM-në nr. 861/2021, të ndryshuar

16.12. Pretendimet se VKM-ja nr. 861/2021 cenon *parimet e hierarkisë së akteve* dhe *shtetit të së drejtës*, janë të pabazuara, pasi ligjet për pronat e paluajtshme të shtetit, për transferimin e tyre njësive të qeverisjes vendore dhe për investimet strategjike ngarkojnë në mënyrë të shprehur Këshillin e Ministrave për transferimin e pronës shtetërore, duke përcaktuar edhe mënyrën përkatëse.

17. ***Subjekti i interesuar, Bashkia Durrës***, ka prapësuar:

A. Për legjitimimin

17.1. Kërkuesi *nuk legjitimohet* për pretendimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë, pasi parashikimet e marrëveshjes i referohen përjashtimit fiskal për një rast individualisht të përcaktuar, siç është projekti në fjalë, i cili prek vetëm Bashkinë e Durrësit. Në këto kushte, e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën për këtë pretendim i përket vetëm kësaj bashkie.

B. Për themelin e pretendimeve

17.2. Pretendimet për cenimin e *parimit të autonomisë vendore* janë të pabazuara, pasi ndërtimi i projektit do të ndikojë në rritjen e të ardhurave të saj, përmes taksave dhe tarifave vendore, si për sa u përket ndërtesave për banim që do të krijohen, ashtu edhe përmes shërbimeve të ndryshme për biznes. Disa nga taksat që do të përfitohen janë taksat për ndërtesat, për truallin, taksa e fjetjes në hotel, taksat e tabelës për qëllime identifikimi e reklame, taksa për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Po kështu, tarifat që do të aplikohen janë ato të pastrimit e të largimit të mbetjeve, ndriçimit publik, gjelbërimit, transportit publik, parkimit të automjeteve, të zënies së sipërfaqeve të hapësirës publike, plazheve private, lejeve të ushtrimit të aktivitetit etj.

18. ***Subjektet e interesuara, APD-ja dhe ASDC-ja,*** krahas prapësimeve të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, për sa i përket *juridiksionit të*

Gjykatës për ligjin nr. 79/2022, VKM-të nr. 861/2021, nr. 494/2022, nr. 685/2022 dhe nr. 115/2023, legjitimimit të kërkuesit dhe parimeve *të decentralizimit e autonomisë vendore*, kanë prapësuar edhe për sa më poshtë:

18.1. Pretendimet për cenimin e *identitetit kombëtar dhe të trashëgimisë kulturore* janë të pabazuara, pasi ndërtimet e portit nuk përbëjnë objekte kulturore dhe nuk kanë impakt kulturor. Asnjë nga fazat e projektit nuk prek veprimtarinë operacionale të portit, i cili do të zhvendoset në Porto Romano. Kjo veprimtari nuk mbart lidhje emocionale ose shpirtërore me komunitetin dhe nuk përbën tipar dallues ose simbol kombëtar. Zhvendosja e aktivitetit portual është hedhur si ide që me masterplanin e vitit 2008 dhe është konfirmuar më vonë me Planin e Biznesit të këtij porti 2009-2015.

18.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës publike* janë të pabazuara, pasi pasuria e paluajtshme e vënë në dispozicion të projektit përbën kontribut të shtetit në investim. Pronësia e tokës do t'i kalojë pjesë-pjesë zhvilluesit, shoqërisë së përbashkët "Durrës Marina" sh.a., ku shteti zotëron 33% të aksioneve. Sipas nenit 10.8 të marrëveshjes kuadër dhe Marrëveshjes së Marinës, pronësia e infrastrukturës kritike detare, përfshirë kalatat, basenin e portit dhe kanalin hyrës do të mbeten gjithmonë pronë shtetërore dhe e patjetërsueshme. Nga zona zhvillimore prej 60 hektarësh, 20% e truallit do të kthehet në hapësirë publike për qytetin e Durrësit, e cila do të jetë në pronësi të shtetit.

18.3. Pretendimet për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimit të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit* janë parashtruar nga kërkuesi në mënyrë teorike e hipotetike, pa u shoqëruar me prova konkrete, pa analizë të tregut e të të ardhurave ose të ndikimeve të mundshme negative të masave mbështetëse. Subjekte tregtare me veprimtari të ngjashme me kompaninë nuk kanë shfaqur shqetësime dhe nuk kanë paraqitur ankim në këtë Gjykatë, çka tregon se nuk ka cenim real të lirisë së veprimtarisë së tyre ekonomike. Mungesa e procedurave konkurruese nuk është e barasvlershme me mungesën e konkurrencës, pasi ligji për investimet strategjike dhe ligji për turizmin njohin të drejtën e cilitdo investitor, përfshirë edhe të atyre me seli ose origjinë në BE, që përmbushin kushtet dhe kriteret të aplikojnë për zhvillimin e projekteve të investimit. Ligji nuk cenon as *parimin e barazisë*

përpara ligjit, pasi zbatohet ndaj subjekteve në kushte të njëjta dhe jo të ndryshme. Vlera e detyrimit të përjashtuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe kontributin e strehimit social përbën kontributin e shtetit shqiptar në investim, e cila konvertohet në aksione të ASDC-së që do të vilen përmes fitimit që shteti do të marrë nga kompania në bazë të aksioneve që zotëron. Për më tepër, legjislacioni shqiptar lejon shprehimisht përjashtimin nga procedurat konkurruese të investimeve strategjike. Miratimi me ligj i një marrëdhënieje kontraktuale me një investitor strategjik është praktikë e përhershme e shtetit shqiptar dhe shfuqizimi i ligjit nr. 79/2022 do të cenonte këtë praktikë. Ligji nr. 79/2022 është miratuar në përputhje me ligjet për investimet strategjike dhe turizmin, si dhe VKM-të e nxjerra në këtë drejtim. Qëllimi i tij ka qenë nxitja e investimeve me potencial të lartë për zhvillimin ekonomik të vendit, qasje kjo që ka sjellë frytet e veta në turizmin shqiptar. Shembull i ngjashëm i investimeve nga EBA-ja është ai Porte Montenegro, i cili ka transformuar bregdetin malazez në qendër turistike.

18.4. Pretendimet për cenimin e *nenit 17 të Kushtetutës* janë të pabazuara, pasi ndërhyrja është bërë me ligj për një interes publik dhe është proporcionale. Projekti nxit turizmin elitar, ndikon në zhvillimin ekonomik e infrastrukturor të zonës, krijon vende të reja pune, përmirëson cilësinë e jetës për banorët lokalë, ndikon pozitivisht në mjedis, promovon imazhin turistik të vendit e kulturën lokale. Ky interes përcaktohet në dispozitat e marrëveshjes, si dhe mbrohet përmes dispozitave të tjera të saj. Objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës. Masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, nuk janë arbitrare, të padrejta ose të bazuara në vlerësime alogjike.

18.5. Pretendimet për cenimin e *MSA-së* janë të pabazuara, pasi investitori nuk ka përfituar një të drejtë ekskluzive dhe mungesa e procedurave konkurruese është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili është në përputhje me direktivat e BE-së. Marrëveshja kuadër është vlerësuar nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore si në përputhje me rregullat e mbrojtjes së konkurrencës. Edhe shtetet e tjera, siç është Bullgaria, në legjislacionin e tyre për zhvillimin e investimeve kanë përcaktuar shitjen investitorit të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit ose të bashkisë. Nga

ana tjetër, pretendimet e kërkuesit për cenimin e MSA-së kanë të bëjnë, në thelb, me marrëveshjen kuadër të miratuar me ligjin nr. 145/2020, për të cilën Gjykata ka mbajtur qëndrim në vendimin nr. 36/2023 të saj. Në kushtet kur kjo marrëveshje dhe MSA-ja qëndrojnë në të njëjtin nivel, çështja nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës.

18.6. Pretendimet e kërkuesit për mungesën e *transparencës* në lidhje me pronarët fundorë përfitues të investitorit, janë të pabazuara, pasi këta pronarë janë deklaruar në marrëveshjen kuadër dhe janë regjistruar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues kohë përpara depozitimit të projektligjit në Kuvend. Fakti i shitjes së kuotave të shoqërisë "Symphony Invest Limited" te shoqëria "North East Real Estate Holdings Limited" nuk ka ndryshuar pronarët përfitues të investitorit. Po në kuadër të këtij parimi, pretendimet e kërkuesit se investimi prej 2 miliardë eurosh i investitorit është joreal, është i pabazuar, pasi marrëveshja e vitit 2015 përcakton qartë se krahas parave në investim përfshihen edhe pasuritë e paluajtshme, aksionet, letrat me vlerë, obligacionet, huatë, të drejtat dhe pretendimet për para, sipas kontratave që kanë një vlerë financiare, pronësia intelektuale. Nga ana tjetër, kontrata tip e zhvillimit për investimet në turizëm, e miratuar me VKM-në nr. 691, datë 05.10.2016, ashtu si edhe kontratat koncesionare, të cilat janë nënshkruar nga të gjitha qeveritë shqiptare, pavarësisht spektrit politik, kërkon si kusht për efektivitetin e saj konfirmimin nga investitori që ka gjetur financimin. Zhvillimi i projekteve, përfshirë edhe ato madhore, nuk varet nga vlera e kapitalit fillestar të shoqërisë, por nga shëndeti financiar dhe mundësia për të gjetur financim.

18.7. Pretendimet në lidhje me ndjekjen e *procedurës së përshpejtuar* për miratimin e projektligjit nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Neni 83, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 28 i Rregullores së Kuvendit nuk kërkojnë dhënien e arsyeve nga Këshilli i Ministrave për propozimin e procedurës së përshpejtuar në miratimin e një projektligji. Nga ana tjetër, fakti i përzgjedhjes së kësaj procedure nuk nënkupton favorizimin e investitorit nga qeveria ose Kuvendi.

18.8. Pretendimet për marrjen e të ashtuquajturave "pasaporta të arta" janë të pabazuara. Raporti i Komisionit Evropian, të cilit kërkuesi i referohet në këtë drejtim, nuk bën fjalë për projektin konkret, marrëveshjet e lidhura në funksion të tij ose ligjin nr. 79/2022,

ndërsa në raportin e vitit 2023 Komisioni Evropian ka raportuar pezullimin nga Shqipëria të nismës për ngritjen e një skeme shtetësie për investitorët. Kërkuesi ka keqinterpretuar dispozitën përkatëse të marrëveshjes, e cila përcakton shprehimisht se zbatimi i kësaj të drejte kërkon plotësimin e kritereve të legjislacionit të zbatueshëm vendas.

18.9. Pretendimet për cenimin e *nenit 82, pika 1, të Kushtetutës* janë të pabazuara. Këshilli i Ministrave ka vlerësuar se projektligji nuk shoqërohet me shpenzime financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi sipas marrëveshjes kuadër pesha e investimit bie mbi investitorin. Pretendimet për pastrimin e territorit, si detyrim buxhetor i shtetit, janë të pabazuara, pasi këto kosto do të përballohen nga kompania. Vetëm nëse këto kosto do të përballohen drejtpërdrejt nga investitori, atëherë ato do të rimbursohen proporcionalisht nga kompania, duke i shpërndarë investitorit para nga dividenti i ASDC-së.

19. ***Subjektet e interesuara, EHRED dhe NSHMI,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

20. Gjykata vëren se objekt i këtij gjykimi kushtetues janë si ligji nr. 79/2022, ashtu edhe VKM-të nr. 861/2021, nr. 494/2022, nr. 685/2022 e nr. 115/2023, ndaj ajo do të analizojë në vijim juridiksionin e saj për secilin prej tyre.

A.1. Për ligjin nr. 79/2022

21. Kërkuesi ka pretenduar, në thelb, se Gjykata ka juridiksion për gjykimin e kushtetutshmërisë së ligjit nr. 79/2022, për sa kohë që përmes tij janë miratuar marrëveshje të një lloji të veçantë për zhvillimin e projektit strategjik në Portin e Durrësit dhe dispozitat e tij bien ndesh me Kushtetutën dhe MSA-në.

22. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë pretenduar, në thelb, se ligji i kundërshtuar nuk prek probleme të kushtetutshmërisë, por të ligjshmërisë, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues. Po sipas tyre, referenca e kërkuesit në nenet 116

dhe 122 të Kushtetutës për të pretenduar antikushtetutshmëri nuk e përfshin çështjen në juridiksionin e Gjykatës.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i natyrës së akteve normative, ligjvënësi ka zgjedhur të parashikojë në legjislacionin e brendshëm modele të tilla që lejojnë Kuvendin të ndërhyjë për miratimin edhe të akteve që, pavarësisht se nuk normojnë rregulla të përgjithshme sjelljeje, mbartin në vetvete interes publik ose kombëtar (*shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim Gjykata ka marrë edhe më parë në shqyrtim ligje të cilat kanë miratuar marrëveshje të llojeve të ndryshme, duke vënë në dukje se marrëveshja që i bashkëlidhet një ligji merr veshje formale me ligj edhe pse tipikisht nuk përbën akt me karakter të përgjithshëm, që normon rregulla të përgjithshme sjelljeje. Megjithatë, në vlerësimin e Gjykatës, vetëm veshja formale me ligj nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar juridiksionin kushtetues, për sa kohë që ai nuk aktivizohet automatikisht vetëm sepse një akt i caktuar me natyrë jonormative vishet formalisht me ligj për shkak të miratimit të tij nga Kuvendi, duke qenë se juridiksioni kushtetues është i lidhur ngushtësisht edhe me natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura *(shih vendimin nr. 34, datë 24.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, edhe në çështjen në shqyrtim, duke qenë se bëhet fjalë për kontrollin e kushtetutshmërisë së një ligji që ka miratuar një marrëveshje të një lloji të veçantë për zhvillimin e projektit strategjik në Portin e Durrësit, pra për një rast përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm i natyrës të aktit të miratuar nga Kuvendi, Gjykata nuk ndalet vetëm në veshjen formale me ligj të marrëveshjes në fjalë, por thekson se natyra e pretendimeve të ngritura është përcaktuese për juridiksionin e saj.

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se parashikimet e ligjit nr. 79/2022 dhe të marrëveshjes së miratuar përmes tij cenojnë: *a) identitetin kombëtar e trashëgiminë kulturore në lidhje me parimin e shtetit të së drejtës*, të garantuara nga nenet 3 e 4 të Kushtetutës, për shkak se: (i) ligjvënësi nuk ka verifikuar interesin e Portit të Durrësit, si porti më i madh në vend, në drejtim të vlerave historike e kulturore që i mbart; (ii) kufiri i pronës së dhënë për zhvillim investimit strategjik mbivendoset me kufirin e zonave arkeologjike, pranë të cilave ndodhen edhe monumente kulture të kategorisë së parë; *b) mbrojtjen e pronës publike*, të garantuar nga neni 11, pika 2, i Kushtetutës, për shkak të vënies së pronës shtetërore në dispozicion të kompanisë së përzgjedhur për

investimin strategjik pa konkurrencë; *c) lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të konkurrencës së lirë*, të garantuar nga neni 11, pika 1, i Kushtetutës në lidhje me *parimin e barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës*, si dhe me *MSA-në, sipas nenit 122 të Kushtetutës*, për shkak se: (i) përzgjedhja e kompanisë që do të kryejë investimin është bërë pa garë e në mënyrë preferenciale;, si dhe se (ii) ndihma e dhënë nga shteti subjektit përfitues të investimit strategjik, përmes përjashtimit nga detyrimi për pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë e kontributit për strehimin social, ka krijuar një regjim të posaçëm juridik të posaçëm, në shtrembërim të konkurrencës së lirë; *c) të drejtën për transparencë ndaj publikut dhe deputetëve*, të garantuara nga nenet 23, pika 3 dhe 83 të Kushtetutës, pasi: (i) ligji është miratuar pa u zhvilluar seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile ose grupeve të interesit; (ii) gjatë procesit të miratimit të tij nuk janë bërë publike marrëveshja e plotë së bashku me anekset e saj dhe investitori fundor i projektit; (iii) ligji është miratuar me procedurë të përshpejtuar; *ç) nenin 82, pika 1, të Kushtetutës,* pasi: (i) projektligji nuk është shoqëruar me shpenzimet financiare; (ii) zbatimi i ligjit prek aspektet financiare, buxhetore e ekonomike të shtetit; *d) parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve* në drejtim *të parimeve të decentralizimit dhe autonomisë vendore*, për shkak se: (i) ka parashikuar dhënien e lejeve të ndërtimit nga KRRT-ja dhe jo Bashkia Durrës; (ii) ka përjashtuar investitorin strategjik nga detyrimi për pagesën e taksës në infrastrukturë dhe kontributi për strehimin social, duke cenuar të ardhurat e Bashkisë Durrës; (iii) ka përjashtuar Bashkinë Durrës nga menaxhimi i hapësirës publike, si dhe i vijës bregdetare për 35 vjet.

26. Për sa më sipër, duke pasur parasysh se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me të drejta, liri dhe parime kushtetuese, Gjykata vlerëson se ajo ka juridiksion për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit objekt kërkese, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, jo vetëm për faktin se marrëveshja e miratuar me të dhe që i bashkëlidhet për këtë shkak ka marrë veshje formale me ligj, por edhe bazuar në natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, si elemente përcaktuese të juridiksionit kushtetues.

A.2. Për VKM-të nr. 861/2021, nr. 494/2022, nr. 685/2022 dhe nr. 115/2023

27. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar se VKM-të nr. 861/2021, nr. 494/2022, nr. 685/2022 dhe nr. 115/2023 përbëjnë akte

nënligjore normative, për sa kohë që përmbajnë vullnetin e shprehur të organit publik në ushtrim të funksioneve publike, rregullojnë marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe nuk shterojnë në zbatimin e tyre. Po sipas kërkuesit, natyra normative e këtyre akteve lidhet me fuqinë e përgjithshme të tyre, në pikëpamje të aftësisë për të prekur situatën juridike të personave juridikë ose fizikë, përmes krijimit për ta të të drejtave dhe detyrimeve.

28. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se VKM-ja nr. 861/2021 dhe ndryshimet e saj përbëjnë akte me karakter individual, ndaj nuk i nënshtrohen juridiksionit kushtetues. Po sipas këtyre subjekteve, në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, objekt i gjykimit kushtetues mund të jenë vetëm aktet nënligjore normative. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka provuar që VKM-të konkrete t'i jenë nënshtruar gjykimit në gjykatën administrative të shkallës së parë ose Gjykatës Administrative të Apelit dhe këto të ishin mjete joefektive.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor *(shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 89, datë 28.12.2017; nr. 36, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës Gjykata ndalet, paraprakisht, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj për shqyrtimin substancial të aktit normativ *(shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 37, datë 12.06.2015; nr. 54, datë 05.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Gjykata ka individualizuar tre kritere që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: (i) subjektet të cilave u drejtohet akti - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktuar në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; (ii) objekti - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; (iii) karakteri shterues/joshterues - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme *(shih vendimet nr. 3, datë*

30.01.2024; nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 86, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Po sipas Gjykatës, në shqyrtimin e natyrës së aktit ajo nuk e analizon atë, duke iu referuar thjesht emërtimit zyrtar të tij (VKM, urdhër, udhëzim ose vendim këshilli bashkiak), ose bazës juridike të referuar, por duke shqyrtuar objektin dhe përmbajtjen e aktit *(shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Duke pasur parasysh kriteret e mësipërme të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, në rastin konkret Gjykata konstaton se, sa i përket kriterit të parë, *subjekteve të së drejtës*, VKM-ja nr. 861/2021 u drejtohet Bashkisë Durrës, APD-së, MFE-së, AIDA-s, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës *(ASHK)* dhe institucioneve që kanë në përgjegjësi administrimi pasuritë e vëna në dispozicion të projektit strategjik. VKM-të nr. 494/2022 dhe nr. 685/2022 u drejtohen Bashkisë Durrës, APD-së, MFE-së, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Drejtësisë, AIDA-s, ASHK-së dhe institucioneve përgjegjëse për transferimin e pasurive në fjalë. Ndërsa VKM-ja nr. 115/2023 u drejtohet ASDC-së, EHRED-së, NSHMI-së, MFE-së dhe ASHK-së. Kjo do të thotë së VKM-të e kundërshtuara u drejtohen subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës.

32. Po kështu, për sa i përket kriterit të dytë, *objektit të tyre*, Gjykata konstaton se VKM-ja nr. 861/2021 ka si objekt transferimin në FPPMIS të pronave të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Marina dhe Jahtet e Durrësit" e ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga APD-ja te MFE-ja. VKM-ja nr. 494/2022 ka si objekt bërjen e disa ndryshimeve në VKM-në nr. 861/2021 dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga APD te MFE-ja, VKM-ja nr. 685/2022, bërjen e ndryshimeve dhe shtesave në VKM-në nr. 861.2021, të ndryshuar, ndërsa VKM-ja nr. 115/2023 transferimin në pronësi të ASDC-së të pronave të paluajtshme shtetërore, pjesë e FPPMIS-së me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës. Pra VKM-të kanë për objekt krijimin dhe ndryshimin e marrëdhënieve juridike konkrete të së drejtës administrative.

33. Për sa i përket kriterit të tretë, *karakterit të akteve*, nisur nga përmbajtja e VKM-ve në fjalë, Gjykata konstaton se efektet e tyre shtrihen në mënyrë të njëhershme te subjektet e së drejtës të cilave ato u drejtohen, duke krijuar të drejta dhe detyrime për këto subjekte, që do të thotë se karakteri i tyre është shterues.

34. Për sa më sipër, bazuar në kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, si dhe në objektin e përmbajtjen e VKM-ve të kundërshtuara, Gjykata çmon se ato përbëjnë akte normative me karakter individual, për rrjedhojë nuk përfshihen në juridiksionin e saj.

B. Për legjitimimin e kërkuesit

35. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen një procesi kushtetues. Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, të saj, ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese që legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues.

B.1. Për legjitimimin ratione personae

36. Kërkuesi ka pretenduar, në thelb, se, si subjekt i pakushtëzuar, ai legjitimohet në kontrollin abstrakt të ligjit nr. 79/2022, ndërsa subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Bashkia Durrës, kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimet për cenimin e parimeve të decentralizimit, autonomisë vendore dhe ndarjes e balancimit të pushteteve, për arsye se, në kushtet kur parashikimet e marrëveshjes përcaktojnë përjashtimin fiskal të taksës së ndikimit në infrastrukturë vetëm për projektin në fjalë, i cili prek vetëm Bashkinë Durrës, e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën i përket kësaj bashkie dhe jo kërkuesit.

37. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa për kundërshtimin e ligjit nr. 79/2022 është paraqitur nga një grup prej 32 deputetësh të Kuvendit, të cilët përbëjnë subjektin kushtetues, jo më pak se një të pestën e deputetëve të Kuvendit, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në aspektin formal.

38. Për sa i përket aspektit substancial, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se jo më pak se një e pesta e deputetëve, si subjekt i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka të drejtë të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Sipas Gjykatës, interesi publik i këtyre funksionarëve publikë është i prezumuar, pasi një kërkesë e tyre vë në lëvizje një kontroll abstrakt e objektiv të aktit normativ dhe interesi publik që kërkohet të mbrohet lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe funksionimin e shtetit të së drejtës *(shih vendimet nr. 1, datë 25.05.2024; nr. 34, datë 24.04.2024; nr. 18, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 79/2022, si në aspektin formal, në kushtet kur kërkesa është paraqitur nga një numër prej 32 deputetësh të Kuvendit, ashtu edhe në aspektin substancial, duke pasur parasysh interesin publik të prezumuar të tij për pretendimet e ngritura, ndaj i vlerëson të pabazuara prapësimet e subjekteve të interesuara në këtë drejtim.

B.2. Për legjitimimin ratione temporis

40. Neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën është 2 vjet nga hyrja në fuqi e tij.

41. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ligji nr. 79/2022, së bashku me marrëveshjen kuadër bashkëlidhur tij, janë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 173, datë 22.12.2022 dhe kanë hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në këtë fletore, ndërsa kërkesa është regjistruar në Gjykatë në datën 22.04.2024, pra brenda afatit ligjor.

B.3. Për legjitimimin ratione materiae

42. Kërkuesi ka pretenduar se ligji nr. 79/2022 cenon *identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore* në lidhje me *parimin e shtetit të së drejtës*, të garantuara nga nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës; *mbrojtjen e pronës publike*, të garantuar nga neni 11, pika 2, i Kushtetutës; *lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë,* të garantuar nga neni 11, pika 1, i Kushtetutës në lidhje me *parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, si dhe me *MSA-në*, sipas nenit 122 të Kushtetutës; *të drejtën për transparencë ndaj publikut*, të garantuar nga neni 23, pika 3, i Kushtetutës dhe *ndaj deputetëve*, sipas nenit 83 të Kushtetutës; *nenin 82, pika 1, të Kushtetutës,* për sa i përket shoqërimit të projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare; *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve* në drejtim të *parimit të decentralizimit e të autonomisë vendore*, sipas nenit 113 të Kushtetutës; pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

43. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi shfuqizimi i ligjit nr. 79/2022 nga Gjykata do të sillte *de facto* shfuqizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomik mes Këshillit të Ministrave dhe qeverisë së EBA-së, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar sipas nenit 5 të Kushtetutës.

44. Gjykata vëren se, për sa i takon cenimit të *identitetit kombëtar dhe trashëgiminë kulturore në lidhje me parimin e shtetit të së drejtës*, kërkuesi ka pretenduar se në miratimin e ligjit nr. 79/2022 ligjvënësi nuk ka verifikuar nëse Porti i Durrësit mbartte vlera të trashëgimisë historike dhe kulturore, si dhe se Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ka vlerësuar se kufiri i pronës për zhvillim mbivendoset me kufirin jugor të zonës arkeologjike A dhe B të Durrësit, Parku Arkeologjik Durrës dhe pranë kësaj zone ndodhen monumente kulture të kategorisë së parë.

45. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk mbështeten në kuadrin ligjor në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe se veprimtaria e portit nuk përmban elemente që mundësojnë lidhje shpirtërore ose emocionale me komunitetin. Për më tepër, ligji nr. 79/2022 ka parashikuar një proces të qartë për vlerësimin e impaktit kulturor të projektit. Porti do të vazhdojë të ekzistojë, pasi zhvendosja do të prekë vetëm aktivitetin e tij industrial. Po sipas tyre, ndërtimet në Portin e Durrësit nuk janë objekte kulturore dhe nuk kanë statusin "monument kulture", "qendër historike", "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur", sipas përkufizimit të ligjit nr. 27/2018 dhe vlerësimit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

46. Nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e *identitetin kombëtar dhe të trashëgiminë kulturore në lidhje me parimin e shtetit të së drejtës* ngrihen në drejtim të: (i) statusit të Portit të Durrësit si trashëgimi kulturore;, si dhe të (ii) gjetjeve të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për mbivendosjen e kufijve të projektit me kufijtë e zonave arkeologjike të mbrojtura dhe ndikimit potencial të zhvillimit të projektit në monumentet e kulturës të ndodhura pranë.

47. Neni 3 i Kushtetutës përcakton identitetin dhe trashëgiminë kombëtare si një prej bazave që shteti ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se trashëgimia kulturore është pjesë e trashëgimisë së popullit, si dhe përbën kujtesën e prekshme dhe të paprekshme të asaj që njeriu ka krijuar (dhe vazhdon të krijojë) për pasardhësit e tij. Po sipas Gjykatës, në këtë drejtim ligji nr. 27/2018 ka parashikuar një proces të veçantë vlerësimi për të përcaktuar nëse objekte të caktuara hyjnë ose jo në trashëgiminë kulturore *(shih vendimin nr. 29, datë 20.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

48. Referuar jurisprudencës së saj, si dhe bazuar në thelbin e

pretendimeve të kërkuesit, Gjykata, duke pasur në vëmendje edhe procesin për përcaktimin e statusit të objekteve që përbëjnë trashëgimi kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, në rastin konkret do të analizojë nëse pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me çështje të natyrës kushtetuese, pra të tilla që cenojnë parashikimet e nenit 3 të Kushtetutës ose lidhen me çështje që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit për trashëgiminë kulturore.

49. Për sa i takon pretendimit për *statusin e Portit të Durrësit si trashëgimi kulturore* (i), Gjykata vë në dukje se ligji nr. 27/2018 ka përcaktuar se çfarë do të konsiderohet pasuri kulturore, klasifikimin e tyre, mënyrën e verifikimit e të deklarimit të interesit kulturor, regjistrimin e pasurisë kulturore, institucionet përgjegjëse në këtë drejtim etj. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve, në rastin konkret Gjykata vëren se nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, por edhe gjatë gjykimit nuk u provua që Porti i Durrësit të jetë vlerësuar si trashëgimi kulturore, të jetë regjistruar si e tillë ose në lidhje me të të jetë paraqitur kërkesë për deklarimin e interesit kulturor, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për statusin e Portit të Durrësit si trashëgimi kulturore kanë të bëjnë me çështje që parashikohen nga ligji nr. 27/2018, i cili ka përcaktuar kriteret dhe mekanizmat se si një pasuri, edhe në rastet kur ajo është në pronësi shtetërore, shpallet trashëgimi kulturore kombëtare, pra, thënë ndryshe, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për trashëgiminë kulturore, çka nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, prandaj ato nuk do të merren në shqyrtim.

50. Në lidhje me pretendimin për *gjetjet e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore* (ii), mbi bazën e të cilave kërkuesi pretendon se zhvillimi i projektit strategjik krijon mbivendosje me zona arkeologjike, Gjykata vëren se, sipas gjetjeve të këtij instituti, mbivendosja mes zonave në fjalë ndodh vetëm në kufirin e tyre, në pjesën jugore të sipërfaqes së pronës për zhvillim. Ashtu siç rezultoi edhe gjatë gjykimit, kjo nënkupton se këto zona janë vetëm kufitare, çka në thelb do të thotë se sipërfaqet e tyre nuk krijojnë mbivendosje me njëra-tjetrën, por ato kanë kufi të përbashkët. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për mbivendosjen e kufijve të zonës ku do të zhvillohet projekti me kufijtë e zonave të mbrojtura kanë të bëjnë në vetvete me procesin e zbatimit të projektit të investimit strategjik, proces i cili, pavarësisht subjektit investitor ose statusit të tij (investitor strategjik), i nënshtrohet në çdo rast rregullave të legjislacionit në fuqi për marrjen nga organet përkatëse të lejeve dhe

miratimeve për zhvillimin e pronës objekt të projektit, përfshirë këtu edhe miratimet përkatëse nga Këshilli i Trashëgimisë Kulturore Materiale. Për pasojë edhe ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

51. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se ligji nr. 79/2022 cenon *pronën publike*, të garantuar nga neni 11, pika 2, i Kushtetutës, pasi pa konkurrencë, analiza, studime ose vlerësime të plota të argumentuara për mënyrën e shkëmbimit ose vlerësimin ekonomik të pronës, përmes ligjit të kundërshtuar kompanisë së përzgjedhur i janë vënë në dispozicion 82 ha tokë pronë shtetërore.

52. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për sa më sipër ngrihen në dy drejtime: (i) *mbrojtjes së pronës publike*, të garantuar nga neni 11, pika 2, i Kushtetutës, sipas të cilit prona private dhe publike mbrohen njëlloj me ligj, (ii) *lirisë së veprimtarisë ekonomike*, të sanksionuar në nenin 11, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse miratimi i ligjit nr. 79/2022 dhe i marrëveshjes bashkëlidhur tij ka sjellë cenim të këtyre parashikime kushtetuese, Gjykata çmon të shqyrtojë në vijim pretendimet e parashtruara nga kërkuesi, duke i analizuar ato në këndvështrim të garancive që ofrojnë dispozitat kushtetuese në fjalë. Po kështu, duke qenë se pretendimet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, si rrjedhojë e përzgjedhjes pa konkurrencë të kompanisë që do të realizojë projektin, parashtrohen nga kërkuesi edhe në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit dhe MSA-në, Gjykata do t'i analizojë ato së bashku.

53. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për *cenimin e pronës publike (i)*, subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se vënia e pronës shtetërore në dispozicion të investimit strategjik është bazuar në ligjin për investimet strategjike dhe jo ligjin objekt shqyrtimi kushtetues. Po sipas këtyre subjekteve, neni 30 i ligjit për investimet strategjike parashikon edhe të drejtën e shtetit për të qenë bashkëpjesëmarrës në investim, i cili, sipas akteve nënligjore në zbatim të ligjit, mund të jetë përmes kontributit në kapital ose në natyrë. Sipas subjekteve të interesuara, edhe në rastin konkret, pasuria e paluajtshme shtetërore e vënë në dispozicion të projektit përbën kontribut të shtetit në investim.

54. Neni 11, pika 2, i Kushtetutës parashikon se prona private dhe publike mbrohen njëlloj me ligj. Gjykata vëren se në zbatim të këtij

parashikimi kushtetues, ligjvënësi ka miratuar ligjin për investimet strategjike, i cili parashikon, ndër të tjera, edhe vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për qëllime të zhvillimit e të realizimit të projekteve investuese strategjike. Po kështu, për sa i përket mënyrës së vënies në dispozicion të kësaj pasurie, ky ligj ka parashikuar se ajo bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave *(nenet 8 dhe 27)*.

55. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se neni 2, pika 3, i ligjit objekt shqyrtimi, ka parashikuar se pronat e paluajtshme shtetërore të transferuara në FPPMIS për zhvillimin e realizimin e projektit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit" kalojnë në pronësi të ASDC-së me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këndvështrim të këtij rregullimi ligjor, Gjykata vë në dukje se ligji nr. 79/2022 nuk normon për herë të parë të drejtën për transferimin e pronës publike, por detajon një të drejtë të parashikuar nga ligji për investimet strategjike. Thënë ndryshe, kjo mënyrë e transferimit të pasurisë së paluajtshme shtetërore për qëllime të nxitjes së investimeve strategjike në vend nuk parashikohet si institut juridik nga ligji objekt shqyrtimi, por është një e drejtë që parashikohet nga ligji për investimet strategjike, për shkak të statusit të projektit si investim strategjik. Në këtë kuptim, ligji objekt shqyrtimi kushtetues vetëm sa ka zbatuar modelin e përcaktuar nga ligjvënësi në ligjin për investimet strategjike. Për sa i takon këtij të fundit, i pyetur në seancë, kërkuesi pranoi se vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit për investimet strategjike, për aq sa ai lidhej me ligjin nr. 79/2022, nuk ishte objekt i kërkesës së tij drejtuar Gjykatës.

56. Për sa më sipër, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për cenimin e pronës publike, të garantuar nga neni 11, pika 2, i Kushtetutës kanë të bëjnë me modelin e parashikuar nga ligjvënësi në ligjin për investimet strategjike, i cili nuk është objekt i kontrollit kushtetues, ndaj, për rrjedhojë, çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

57. Kërkuesi gjithashtu ka pretenduar se ligji nr. 79/2022 cenon *lirinë e veprimtarisë ekonomike në lidhje me parimin e barazisë përpara ligjit dhe MSA-në* (ii), për shkak të përzgjedhjes pa konkurrencë e në mënyrë preferenciale të kompanisë që do të kryejë investimin. Sipas tij, kjo përzgjedhje ka kufizuar pjesëmarrjen e kompanive të tjera vendase ose evropiane, si dhe të investitorëve të fuqishëm nga partnerë të tjerë strategjikë të vendit, në kundërshtim me nenet 71 dhe 74 të MSA-së. Po sipas kërkuesit, ligji për prokurimin publik përcakton se kompanitë e komunitetit evropian gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në të njëjtën mënyrë si shoqëritë shqiptare.

58. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja i kanë prapësuar si të pabazuara këto pretendime. Sipas tyre, legjislacioni në fuqi njeh të drejtën e kujtdo për të investuar në fushën e turizmit e për të aplikuar në marrjen e statusit të investitorit strategjik, si dhe të drejtën e shtetit për të qenë bashkëpjesëmarrës në investime strategjike. Edhe pse ligjvënësi ka zgjedhur të përjashtojë nga procedurat konkurruese subjektet të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto ligje, kjo nuk nënkupton diskriminimin e subjekteve të tjera. Edhe ligjet për prokurimin publik e për koncesionet dhe partneritetin publik e privat, të përafruara me legjislacionin e BE-së dhe nenin 74 të MSA-së, parashikojnë zbatimin e tyre deri në atë masë sa nuk bien ndesh me një marrëveshje ndërkombëtare.

59. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se përzgjedhja e zhvilluesit pa konkurrim është parashikuar në marrëveshjen ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe EBA-së, të miratuar me ligjin nr. 145/2020 për qëllime të nxitjes dhe të mbrojtjes së investimeve mes dy vendeve dhe jo ligjin objekt shqyrtimi. Për më tepër, sipas ligjit për investimet strategjike, konkurrimi ndërmjet zhvilluesve realizohet në fazën e marrjes së statusit të investitorit strategjik dhe jo gjatë fazave të tjera të procedurës së zhvillimit dhe realizimit të projekteve, të cilave, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, u është dhënë statusi i investimeve strategjike. Në këto kushte, për sa kohë që përzgjedhja në këtë mënyrë e zhvilluesit të projektit të investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit" nuk është realizuar për shkak të ligjit nr. 79/2022, por për shkak të zbatimit të ligjit për investimet strategjike, në kuadër të të cilit ky projekt ka fituar statusin e investimit strategjik dhe investitori strategjik ka fituar të drejtën për ta realizuar atë, Gjykata çmon se, ashtu siç u vlerësua edhe më lart *(shih paragrafët 55-56 të vendimit),* pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe MSA-së për këtë shkak nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ligji për investimet strategjike nuk është objekt i shqyrtimit kushtetues.

60. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike në lidhje me MSA-në, për shkak të vënies në dispozicion të pronës shtetërore investitorit strategjik pa konkurrencë, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për investimet strategjike dhe, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim. Po kështu, për sa kohë që edhe pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, të parashtruara nga kërkuesi në lidhje me lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe MSA-në, kanë të bëjnë me ligjin për investimet strategjike dhe jo me

ligjin objekt të gjykimit kushtetues, Gjykata çmon se ato gjithashtu nuk mund të merren në shqyrtim.

61. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se ligji nr. 79/2022 cenon *të drejtën për transparencë ndaj publikut*, pasi ai është miratuar pa u zhvilluar seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile ose të grupeve të interesit, pa transparencë ndaj publikut për projektin, për përzgjedhjen e firmës që do të ndërtojë Portin e ri të Durrësit, për humbjet e shtetit shqiptar dhe përfitimet e pritshme në të ardhmen dhe pa u bërë takime me grupet e interesit për vlerat që porti mbart. Po sipas kërkuesit, ligji është miratuar pa *transparencë edhe ndaj ligjvënësit*. Kjo e drejtë detyronte Këshillin e Ministrave, që jo vetëm të përmbushte kërkesat e pikës 2 të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, por të paraqiste në mënyrë transparente çdo aspekt të projektligjit, çka nënkupton bërjen publike të marrëveshjes së plotë, së bashku me anekset e saj, si dhe të investitorit fundor të projektit. Po kështu, sipas kërkuesit, miratimi me *procedurë të përshpejtuar* i tij është bërë *për shmangien e miratimit të projektligjit "Për identifikimin e pronarëve përfitues të partnerëve në sektorin publik"*.

62. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se miratimi i ligjit është bërë në garantim të së drejtës për transparencë ndaj publikut, pasi aktet bashkëshoqëruese të tij janë publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit dhe procesi i shqyrtimit në komisione ka qenë publik, ku palët e interesuara kanë pasur mundësi të kërkonin të merrnin pjesë dhe Kuvendi u ka siguruar mekanizmat për realizimin e kësaj të drejte. Po sipas këtyre subjekteve, çdo deputeti i janë vënë në dispozicion aktet që kanë shoqëruar projektligjin dhe ata kanë marrë informacionin e nevojshëm edhe përmes pyetje-përgjigjeve me përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave. Pretendimet për mënyrën e zhvillimit të procedurës parlamentare janë të natyrës procedurale, të parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkak për antikushtetutshmëri, ndërsa pretendimet për miratimin e ligjit me *procedurë të përshpejtuar* nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi legjislacioni parashikon edhe këtë mënyrë të miratimit të ligjeve, pa e lidhur atë me plotësimin e ndonjë situate ose kriteri të posaçëm. Në relacionin shpjegues të Këshillit të Ministrave dhe në raportet e komisioneve të Kuvendit është argumentuar nevoja e përdorimit të këtij mjeti kushtetues.

63. Sipas APD-së dhe ASDC-së, pretendimet e kërkuesit për mungesën e transparencës për pronarët fundorë përfitues të investitorit janë të pabazuara, pasi këta pronarë janë deklaruar në marrëveshjen kuadër

dhe janë regjistruar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues kohë përpara depozitimit të projektligjit në Kuvend. Fakti i shitjes së kuotave të shoqërisë "Symphony Invest Limited" te shoqëria "North East Real Estate Holdings Limited" nuk ka ndryshuar këta pronarë. Nga ana tjetër, miratimi i ligjeve me procedurë të përshpejtuar parashikohet shprehimisht nga Kushtetuta dhe fakti i përzgjedhjes së kësaj procedure nuk nënkupton favorizimin e investitorit nga qeveria ose Kuvendi.

64. Bazuar në thelbin e argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e parimit të transparencës në miratimin e ligjit nr. 79/2022 parashtrohen nga kërkuesi në katër drejtime, konkretisht mungesës së transparencës: *(i)* ndaj publikut dhe grupeve të interesit; *(ii)* ndaj deputetëve; *(iii)* lidhur me mosbërjen publik të pronarit fundor përfitues të investitorit; *(iv)* për shkak të miratimit të tij me procedurë të përshpejtuar.

65. Gjykata vlerëson të shqyrtojë në vijim këto pretendime të kërkuesit për të përcaktuar nëse procedura e miratimit të ligjit nr. 79/2022 është zhvilluar në përputhje me kërkesat kushtetuese për transparencën ndaj publikut dhe grupeve të interesit. Në vijim, Gjykata do të analizojë pretendimet për mungesën e transparencës në procesin e miratimit të ligjit në Kuvend, duke u ndalur fillimisht në juridiksionin e saj për shqyrtimin e kësaj veprimtarie legjislative. Po kështu, pretendimet që lidhen me mosbërjen publike të pronarit fundor përfitues të investitorit strategjik do të shqyrtohen si në aspektin e transparencës ndaj publikut, ashtu edhe të transparencës ndaj deputetëve. Së fundmi, Gjykata do të vlerësojë nëse miratimi i ligjit nr. 79/2022 përmes një procedure të përshpejtuar është kryer në pajtim me parashikimet kushtetuese dhe nëse një procedurë e tillë ka cenuar të drejtën e kërkuesit për transparencë në këtë proces.

66. Në lidhje me pretendimet për cenimin e *së drejtës për transparencë ndaj publikut dhe grupeve të interesit (i)*, Gjykata vëren se ato parashtrohen në kuadër të parashikimeve të nenit 23, pika 3, të Kushtetutës, sipas të cilit kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Në këtë drejtim, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar rolin e veçantë të transparencës së veprimtarisë së autoriteteve shtetërore në kuadër të garantimit të aksesit të publikut në informacion dhe përfshirjes së tij në proceset e veprimtaritë që sjellin ndikim ndaj tij *(shih vendimin nr. 3, datë 30.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

67. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vë në dukje se vendimet nr. 14/6, 14/45 e nr. 14/61 të KIS-it për dhënien projektit të statusit të investimit

strategjik, realizimin e tij nga EHRED-ja me garantues financiar NSHMI-në, pranimin e pjesëmarrjes së shtetit në investim dhe transferimin e statusit strategjik shoqërisë së posaçme të krijuar mes ASDC-së dhe EHRED-së, me garantues financiar NSHMI-në, janë publikuar në faqen zyrtare të këtij organi. Po kështu, projektligji për miratimin e marrëveshjes kuadër për projektin, relacioni i projektligjit, materialet për transferimin e truallit, akti i themelimit të shoqërisë "Durrës Marina", sh.a., masterplani, plani i biznesit, marrëveshja e zhvillimit, si dhe raportet e komisioneve përkatëse të Kuvendit për projektligjin janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Kuvendit. Gjykata konstaton gjithashtu se edhe diskutimet e projektligjit në mbledhjet e tre komisioneve përkatëse të Kuvendit (Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisionin për Ekonominë dhe Financat, Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin) kanë qenë publike dhe kushdo, qoftë edhe grupet e interesit, kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në to.

68. Për sa më sipër, Gjykata vëren se, në përputhje me nenin 23, pika 3, të Kushtetutës, në procesin e miratimit të ligjit nr. 79/2022 publiku dhe grupet e interesit kanë pasur akses në informacionin për projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", si dhe u është dhënë mundësia të ndjekin mbledhjet e komisioneve të Kuvendit lidhur me diskutimet për projektligjin në fjalë, për rrjedhojë çmon se pretendimet e kërkuesit për mungesën e transparencës ndaj publikut dhe grupeve të interesit janë haptazi të pabazuara.

69. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *transparencës ndaj deputetëve (ii)*, Gjykata evidenton se, ndonëse në kërkesë kërkuesi i është referuar nenit 83 të Kushtetutës, pretendimet e tij parashtrohen në kuadër të parashikimeve të nenit 68, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, për sa u takon materialeve që duhet të ishin vënë në dispozicion të deputetëve së bashku me projektligjin për miratimin e marrëveshjes kuadër për qëllime të zhvillimit të procedurës ligjvënëse.

70. Në këtë drejtim, ashtu siç Gjykata ka theksuar edhe më parë, për shkak të parimit të vetërregullimit të Kuvendit, juridiksioni i saj për kontrollin e zbatimit të dispozitave të Rregullores së Kuvendit është i kufizuar dhe mosrespektimi i kësaj rregulloreje e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues, që gjejnë pasqyrim në të *(shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 1, datë 16.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

71. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se në pretendimin

e tij kërkuesi nuk ka evidentuar normën kushtetuese të cenuar përgjatë procesit ligjvënës në këtë aspekt. Argumentet e tij parashtrohen në drejtim të atyre parashikimeve të Rregullores së Kuvendit, të cilat, për sa kohë nuk përbëjnë reflektim të dispozitave kushtetuese konkrete, nuk mund të bëhen objekt vlerësimi kushtetues. Për më tepër në këtë drejtim, Gjykata vëren se projektligji objekt kontrolli kushtetues, krahas shqyrtimit në komisionet përkatëse, është shqyrtuar edhe në seancë plenare të Kuvendit, ku deputetet kanë pasur mundësi të bëjnë pyetje, si dhe të shprehin mendimet e qëndrimet e tyre në lidhje me të. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të transparencës ndaj deputetëve nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, por vetëm në kuadër të zbatimit të Rregullores së Kuvendit, për rrjedhojë ato nuk mund të merren në shqyrtim.

72. Në lidhje me pretendimin për *mosbërjen publik të pronarit fundor përfitues të investitorit strategjik (iii)*, të parashtruara nga kërkuesi, si në drejtim të transparencës ndaj publikut, ashtu edhe ndaj deputetëve, Gjykata vëren se ato ngrihen në dy aspekte, konkretisht për sa i takon: *(a)* investitorit strategjik; *(b)* garantuesit financiar, subjektit NSHMI.

73. Për sa u përket të dhënave *për investitorin strategjik (a)*, gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe dëgjimit të pretendimeve të parashtruara nga palët, Gjykata vëren se të dhënat që lidhen me shoqërinë e përbashkët "Durrës Marina", e cila është krijuar dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 79/2022 për zhvillimin dhe realizimin e projektit të investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", janë publike dhe, si të tilla, të aksesueshme nga subjektet e interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transparencën dhe aksesin në informacion.

74. Për sa u përket të dhënave *për garantuesin financiar të projektit (b)*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit ngrihen në drejtim të mungesës, gjatë shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare të Kuvendit, të transparencës së ministres së Financave në lidhje me këtë garantues. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje se ligji nr. 112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", i ndryshuar *(ligji nr. 112/2020)*, ka përcaktuar se ai zbatohet për subjektet raportuese, personat juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas parashikimit të nenit 2, pika 1, të tij. Po sipas këtij ligji, si pronar përfitues do të konsiderohet individi i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individi në emër të të cilit po kryhet një transaksion ose veprimtari dhe përfshin të paktën individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë

direkte ose indirekte të një përqindjeje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votimit, ose të pjesëmarrjen në kapitalin e atij entiteti, përfshirë përmes mbajtjes së aksioneve ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, ose përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij *(neni 3, pika 1)*. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve, Gjykata vëren se garantuesi financiar i projektit, NSHMI, nuk rezulton të jetë i regjistruar si person juridik në Republikën e Shqipërisë dhe, për rrjedhojë, nuk është subjekt i ligjit nr. 112/2020. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të paraqesë argumente kushtetuese për sa i përket transparencës për garantuesin financiar të projektit "Marina & Jahtet e Durrësit", ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

75. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për *mungesën e transparencës, për shkak të procedurës së përshpejtuar (iv)*, Gjykata evidenton se një procedurë e tillë parashikohet shprehimisht në nenin 83, pika 2, të Kushtetutës, kur ajo kërkohet nga Këshilli i Ministrave. Në zbatim të kësaj dispozite kushtetuese, Rregullorja e Kuvendit, në nenin 28 të saj, ka përshkruar në mënyrë të detajuar një tërësi veprimesh procedurale që duhet të zbatohen gjatë shqyrtimit dhe miratimit të një projektligji me procedurë të përshpejtuar.

76. Gjykata, ashtu siç ka pranuar edhe më parë, thekson se evidentimi qartësisht i bazës kushtetuese në pjesën hyrëse të projektligjit përbën një garanci më shumë për respektimin e kritereve procedurale gjatë procedurës së miratimit të ligjit. Në rastet kur kjo procedurë vihet në diskutim në aspektin kushtetues, ajo verifikon veçanërisht natyrën e projektligjit, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe objektin e tij *(shih vendimin nr. 20, datë 15.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ky verifikim është i nevojshëm për të siguruar që procesi legjislativ është zhvilluar në përputhje me parimet kushtetuese.

77. Në rastin konkret, referuar përmbajtjes së projektligjit nr. 79/2022 të propozuar nga Këshilli i Ministrave, Gjykata evidenton se ai ka përcaktuar qartësisht ndjekjen e procedurës së përshpejtuar, sipas nenit 83, pika 2, të Kushtetutës për qëllime të miratimit të marrëveshjes kuadër për projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit". Referuar natyrës së ligjit, Gjykata vëren se ai nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 81 i Kushtetutës, për të cilat neni 83, pika 3, i Kushtetutës ka përjashtuar shprehimisht ndjekjen e procedurës së përshpejtuar. Në këtë situatë, duke pasur parasysh se ndjekja e procedurës së përshpejtuar në miratimin e ligjit nr. 79/2022 nuk bie në kundërshtim me normat

kushtetuese, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për transparencë ndaj ligjvënësit, si rrjedhojë e miratimit të ligjit përmes kësaj procedure, është i pabazuar.

78. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për mungesën e transparencës ndaj publikut dhe grupeve të interesit në miratimin e ligjit nr. 79/2022, për mosbërjen me dije të pronarit fundor të investitorit strategjik, si dhe për miratimin e ligjit me procedurë të përshpejtuar, janë haptazi të pabazuara, ndërsa pretendimet për mungesën e transparencës ndaj deputetëve, si dhe për mosbërjen me dije të pronarit fundor të garantuesit financiar të investimit strategjik nuk mund të merren në shqyrtim.

79. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka parashtruar gjithashtu se *përfitimi i së drejtës për të aplikuar për shtetësi ose rezidencë në Republikën e Shqipërisë* nga investitorët e huaj që do të blejnë drejtpërdrejt nga prona e investitorit strategjik, bie ndesh me Kushtetutën, MSA-në, rekomandimet e BE-së, si dhe me marrëveshjen për heqjen e vizave mes Shqipërisë dhe BE-së. Subjektet e interesuara, APD-ja dhe ASDC-ja, kanë prapësuar se kërkuesi ka keqinterpretuar dispozitën përkatëse të marrëveshjes, e cila përcakton shprehimisht se zbatimi i kësaj të drejte kërkon plotësimin e kritereve të legjislacionit të zbatueshëm vendas.

80. Gjykata vëren se pretendimet e mësipërme të kërkuesit ngrihen ndaj parashikimit të pikës 10.11 të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, sipas të cilit, investitorët e huaj do të kenë të drejtë të aplikojnë për shtetësi dhe/ose rezidencë vetëm nëse plotësojnë kriteret e kërkuara nga legjislacioni i zbatueshëm. Për sa i takon këtij rregullimi të marrëveshjes, Gjykata evidenton se, si në kërkesën drejtuar asaj, ashtu edhe gjatë gjykimit, kërkuesi nuk ka identifikuar dispozitën kushtetuese konkrete të cenuar si rrjedhojë e këtij parashikimi, në raport me kuadrin rregullator në fuqi. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimet për cenimin e Kushtetutës, MSA-së, rekomandimeve të BE-së, si dhe marrëveshjes për heqjen e vizave mes Shqipërisë dhe BE-së nuk mund të merren në shqyrtim.

81. Po kështu, në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore*, për shkak se, bazuar në parashikimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, lejet e ndërtimit do të duhej të lëshoheshin nga Bashkia Durrës dhe jo KKT-ja. Po sipas tij, me ligjin nr. 79/20222 investitorit strategjik i janë dhënë privilegje fiskale, përmes përjashtimit të pagesës së taksës në infrastrukturë dhe kontributit në banesa sociale, në cenim të parimit të autonomisë

vendore. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se, sipas marrëveshjes kuadër të miratuar me ligjin objekt gjykimi, Bashkia Durrës është privuar nga menaxhimi i hapësirave publike dhe i vijës bregdetare për 35 vjet.

82. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se këto pretendime janë të pabazuara, pasi sipas nenit 28 të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, lejet e ndërtimit për llojet e zhvillimit komplekse dhe investime strategjike lëshohen nga KKT-ja e jo nga bashkia, ndërsa sipas nenit 19 të VKM-së nr. 408/2015, llojet e zhvillimit komplekse përfshijnë edhe portet e investimet strategjike. Po sipas tyre, ligji për sistemin e taksave vendore përjashton nga taksat vendore subjektet e përcaktuara shprehimisht në të ose në ligje të tjera të veçanta, si dhe se për çdo përjashtim pushteti vendor kompensohet për efektet financiare nga buxheti i shtetit. Për sa i takon menaxhimit të hapësirave publike, subjektet e interesuara kanë prapësuar se asnjë dispozitë e ligjit nuk cenon të drejtën e Bashkisë Durrës për t'i menaxhuar ato dhe se, sipas marrëveshjes kuadër, investitori mund të administrojë hapësirat e përbashkëta publike vetëm nëse lejohet nga legjislacioni në fuqi. Edhe sipas Bashkisë Durrës, ligji nuk cenon parimin e autonomisë vendore, përkundrazi, projekti do të ndikojë në rritjen e të ardhurave të saj përmes taksave dhe tarifave vendore.

83. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të decentralizimit dhe të autonomisë vendore ngrihen në tre drejtime, konkretisht: (*i) dhënies së lejeve të ndërtimit të projektit nga qeverisja qendrore dhe jo ajo vendore, (ii) përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare, (iii) menaxhimit të hapësirave publike të projektit nga investitori strategjik*. Duke pasur parasysh parashikimet kushtetuese dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Gjykata çmon të analizojë në vijim këto pretendime të kërkuesit për të përcaktuar nëse ndërhyrja e ligjvënësit me ligjin objekt gjykimi dhe me marrëveshjen kuadër të miratuar përmes tij ka çuar në shkelje të parimeve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore.

84. Për sa i përket pretendimit *(i) për dhënien e lejeve të ndërtimit nga qeverisja qendrore dhe jo ajo vendore*, Gjykata vë në dukje se parimi i decentralizmit të pushtetit dhe i autonomisë vendore garantohen nga neni 13 i Kushtetutës, ndërsa në nenin 113 të saj kushtetutëbërësi ka përcaktuar kufijtë e shtrirjes së autonomisë së pushtetit vendor. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se shumë çështje kanë implikime si vendore, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë

dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Po sipas Gjykatës, është e lejueshme që çështje me rëndësi kombëtare e strategjike për interesat e vendit dhe që lidhen me miratimin e masterplaneve dhe të studimeve urbanistike rajonale e më gjerë, të ushtrohen nën autoritetin e pushtetit qendror, i cili është përgjegjës për politikën e zhvillimit ekonomik e politik të vendit. Megjithatë, do të konsiderohej si cenim i së drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse ligjvënësi, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre, saqë ekzistenca ose vetëqeverisja e tyre do të bëheshin të pandjeshme *(shih vendimet nr. 4, datë 02.02.2015; nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

85. Gjykata vëren se në zbatim të parashikimeve kushtetuese, përmes ligjeve të veçanta ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë më të detajuar përgjegjësitë që i përkasin pushtetit qendror dhe atij vendor. Për sa u takon pretendimeve të kërkuesit, neni 28 i ligjit nr. 107/2014, në fuqi në kohën e miratimit të ligjit objekt gjykimi, përcaktonte KKT-në si autoritetin përgjegjës për dhënien e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, si dhe për ato të lidhura me investime strategjike për interesat e vendit, ndërsa me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 41/2024, datë 02.05.2024, ka zgjeruar kompetencat e këtij organi, duke parashikuar tashmë se Këshilli Kombëtar i Territorit dhe i Ujit *(KKTU)* është autoriteti përgjegjës vendimmarrës për: leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për të gjitha llojet e zhvillimeve komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit të territorit; leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit bregdetar, sipas legjislacionit në fuqi; investime strategjike për interesat e vendit; dhënien e autorizimit për ndërtimin e strukturave ankoruese dhe portuale *(pika 1, shkronjat "a", "b", "c" dhe "dh")*, ndërsa sipas nenit 19 të VKM-së nr. 408/2015, llojet e zhvillimit komplekse për vendimmarrjen e të cilave është përgjegjës KKTU-ja, në bazë të nenit 28 të ligjit nr. 107/2014, janë edhe investimet strategjike, sipas ligjit përkatës *(pika 1, shkronja "s")*.

86. Duke iu referuar rrethanave konkrete të çështjes, Gjykata çmon të evidentojë paraprakisht se ligji objekt shqyrtimi kushtetues nuk ka krijuar një regjim të veçantë juridik, jashtë kuadrit ligjor ekzistues, për dhënien e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit. Në këtë kontekst, projekti "Marina & Jahtet e Durrësit", i konsideruar si një investim strategjik me rëndësi për interesat e vendit, është klasifikuar në kategorinë e zhvillimeve komplekse, konform përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014. Po kështu, sipas

parashikimeve të këtij ligji, objektet që do të ndërtohen në kuadër të këtij projekti, përfshirë infrastrukturën ankoruese dhe portuale, ndodhen brenda brezit bregdetar.

87. Në këtë situatë, Gjykata vë në dukje se si përpara hyrjes në fuqi të ligjit objekt shqyrtimi, ashtu edhe aktualisht, dhënia e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit për projektet komplekse të investimit strategjik ka qenë dhe vazhdon të mbetet kompetencë e KKTU-së, pra e qeverisë qendrore dhe ligji objekt shqyrtimi nuk ka bërë ndryshime në kompetencat që i përkasin organit vendor. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim kanë të bëjnë, në thelb, me modelin e parashikuar nga ligji nr. 107/2014, i cili nuk është objekt shqyrtimi kushtetues, për rrjedhojë çmon se ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

88. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimeve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore, për shkak të *(ii) përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare*, Gjykata vëren se, sipas nenit 155 të Kushtetutës, taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, si dhe përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve caktohen me ligj. Në këndvështrim të këtij rregullimi kushtetues, në rastin konkret Gjykata vëren se përjashtimi, sipas nenit 2, pika 1, të ligjit nr. 79/2022, i shoqërisë së përbashkët për realizimin e projektit nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe kontributin e strehimit social është bërë me ligj të Kuvendit dhe se në përjashtimin e investitorit strategjik nga detyrimet financiare ligjvënësi ka ushtruar të drejtën e tij në përputhje me nenin 155 të Kushtetutës. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të autonomisë vendore, për shkak të përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare, janë të pabazuara.

89. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore, për shkak të dhënies së lejeve të ndërtimit dhe të zhvillimit të projektit të investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit" KKTU-së dhe jo bashkisë, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi kanë të bëjnë me ligjin nr. 107/2014, i cili nuk është objekt shqyrtimi kushtetues, ndërsa ato për përjashtimin e investitorit strategjik nga detyrimet financiare janë të pabazuara.

90. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore, për shkak të parashikimeve të marrëveshjes kuadër të miratuar me ligjin nr. 79/2022, që kanë njohur *të drejtën ekskluzive të*

investitorit strategjik për të menaxhuar hapësirat e përbashkëta publike të projektit, duke pasur parasysh argumentet që qëndrojnë në thelb të këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se ato janë të tilla që kërkojnë shqyrtimin e tyre në themel.

91. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se ligji nr. 79/2022 cenon edhe nenin 82, pika 1, të Kushtetutës, pasi projekti shoqërohet me shpenzime të mëdha financiare dhe humbjet e pritshme të investimit të pastudiuar do të jenë shumë të mëdha me dëm afatgjatë në buxhetin e shtetit. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se zbatimi i ligjit nuk sjell shpenzime financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi pesha e investimit bie mbi investitorin, por edhe nëse do të ketë kosto shtesë, ato nuk do të jenë buxhetore.

92. Neni 82, pika 1, i Kushtetutës përcakton se propozimi i ligjeve, ku është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Në lidhje me çështjen në shqyrtim, referuar akteve bashkëshoqëruese të projektligjit, Gjykata vëren se propozimi për miratimin i tij i është parashtruar fillimisht Këshillit të Ministrave nga ministri i Financave dhe Ekonomisë. Më pas, përmbajtja e projektligjit i është propozuar Kuvendit nga Këshilli i Ministrave. Sipas relacionit bashkëshoqërues të projektligjit, rezulton se zbatimi i tij nuk shoqërohet me shpenzime financiare shtesë për buxhetin e shtetit, çka është pranuar edhe nga komisionet respektive të Kuvendit. Po kështu, Gjykata vëren se në kërkesë kërkuesi nuk ka parashtruar argumente konkrete në kuadër të rritjes së shpenzimeve ose pakësimit të të ardhurave në buxhetin e shtetit si rrjedhojë e zbatimit të ligjit të kundërshtuar. Në këto kushte, Gjykata çmon që pretendimet e kërkuesit se zbatimi i ligjit passjell shpenzime financiare shtesë në buxhetin e shtetit janë haptazi të pabazuara *ratione materiae*.

93. Në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesi ka pretenduar edhe se ligji nr. 79/2022 cenon *lirinë e veprimtarisë ekonomike, konkurrencën e lirë e MSA-në*, për shkak se ndihma e dhënë nga shteti subjektit përfitues të investimit strategjik, përmes përjashtimit nga detyrimi për pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë e kontributi për strehimin social, krijon një regjim të posaçëm juridik për këtë subjekt kundrejt regjimit juridik fiskal të përgjithshëm, çka shtrembëron konkurrencën e lirë.

94. Neni 11, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës parashikojnë se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe se kufizimet e lirisë

ekonomike mund të bëhen vetëm me ligj, për një arsye të rëndësishme publike. Po kështu, neni 71 i MSA-së, e cili është bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm pas ratifikimit me ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, ndalon, ndër të tjera, çdo ndihmë shtetërore që shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar sipërmarrje të caktuara, kurse neni 74 i kësaj marrëveshjeje vendos për shtetin shqiptar detyrimin për liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, si për sa u përket kompanive shqiptare, ashtu edhe atyre komunitare.

95. Duke pasur parasysh parashikimet e mësipërme, si dhe se pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, konkurrencës së lirë dhe MSA-së parashtrohen në kuadër të ndihmës shtetërore të dhënë subjektit investues strategjik përmes ligjit objekt shqyrtimi kushtetues, çka përbën pretendim të natyrës kushtetuese, Gjykata çmon t'i analizojë ato në themel në drejtim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, konkurrencës së lirë dhe MSA-së në lidhje me ndihmën shtetërore përmes përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare.

96. Për sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të *decentralizimit dhe të autonomisë vendore* në lidhje me menaxhimin e hapësirave publike, si dhe të *lirisë së veprimtarisë ekonomike, konkurrencës së lirë e MSA-së* përmes përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare.

C. Për themelin e pretendimeve për ligjin nr. 79/2022

C.1. Për cenimin e parimeve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore në lidhje me menaxhimin e hapësirave publike

97. Kërkuesi ka pretenduar se sipas shtojcës 2 të marrëveshjes kuadër të miratuar me ligjin nr. 79/2022, Bashkia Durrës është privuar nga menaxhimi i hapësirave të përbashkëta publike, si dhe i vijës bregdetare për 35 vjet. Po kështu, sipas pikës 10.6.1 të kësaj marrëveshjeje, kontratës së sipërmarrjes, draftkontratës së shitjes së njësive, marrëveshjes për prenotim, interesi mes "Durrës Marina" sh.a. e palës së interesuar dhe planit të shlyerjes së vlerës së pronës, menaxhimi i hapësirave publike është e drejtë vetëm e investitorit strategjik, që ka të drejtën ekskluzive për ndërtimin e kompleksit elitar.

98. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar se ligji nuk cenon të drejtën e Bashkisë Durrës për të menaxhuar hapësirat e përbashkëta publike. Sipas pikës 10.6.1 të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, investitori mund

të administrojë hapësirat e përbashkëta publike vetëm nëse lejohet nga legjislacioni në fuqi.

99. Neni 13 i Kushtetutës parashikon se qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazën e parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore, ndërsa neni 113 i Kushtetutës ka rregulluar aspekte të ndryshme të ushtrimit të autonomisë vendore. Po kështu, në kuadër të këtyre garancive kushtetuese, me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999, Kuvendi ka ratifikuar Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, e cila ka përcaktuar, ndër të tjera, detyrimin për respektimin e parimeve të decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore, subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

100. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues që konsiston, midis të tjerave, në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të funksioneve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror, ndërsa parimi i decentralizimit kërkon që zgjidhja t'i besohet qeverisë vendore, përveç rasteve kur natyra dhe përmasa e problemit është e tillë që i takon një zone shumë të madhe territoriale dhe me interesa të rëndësishëm ekonomikë. Në këtë drejtim, Gjykata ka pranuar se shumë çështje kanë implikime, si vendore, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes *(shih vendimet nr. 54, datë 05.12.2014; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor "*funksionet e veta*", sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre *(shih vendimet nr. 37, datë 12.06.2015; nr. 54, datë 05.12.2014; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

101. Në rastin konkret, për arritjen e një konkluzioni në lidhje me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore Gjykata do të analizojë nëse, për sa i takon menaxhimit të hapësirës publike që do të krijohet si rrjedhojë e realizimit të projektit "Marina & Jahtet e Durrësit", parashikimet e nenit 10.6.1 të marrëveshjes, pjesë e ligjit nr. 79/2022, bien ose jo ndesh me këto parime.

102. Gjykata vëren se marrëveshja e miratuar me ligjin nr. 79/2022, në pikën 10.6 të saj, ka përcaktuar të drejtën për të menaxhuar zonat e përbashkëta. Kështu, sipas pikës 10.6.1, në masën që përmbush kërkesat e

legjislacionit të zbatueshëm dhe siç mund të kërkohet për t'u mbajtur cilësia e shërbimeve për një përdorim të përzier të klasit botëror të zhvillimit të pasurive të paluajtshme, ASDC-ja dhe/ose qeveria e Shqipërisë bien dakord që investitori strategjik (ose shoqëritë e kontrolluara të tij në pronësi të plotë), do të kenë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme për zonat e përbashkëta të seksioneve për t'u zhvilluar në sheshin e projektit: a) të drejtën dhe detyrimin për të zhvilluar dhe mirëmbajtur infrastrukturën e nevojshme brenda sheshit të projektit (duke përfshirë rrugët, trotuaret, parqet, peizazhet etj.), (zonat e përbashkëta publike); b) të drejtën dhe detyrimin për të zhvilluar zonat e përbashkëta të ndërtesave të banimit dhe tregtare (zonat e përbashkëta private) dhe të drejtën për të ofruar shërbime të menaxhimit të pronës për zonat e përbashkëta private dhe zonat e përbashkëta publike dhe të drejtën për të vendosur tarifa adekuate për menaxhimin e pronës për shërbime të tilla, sipas kushteve të marrëveshjes së bashkëpunimit me klientët dhe kushteve të këtij neni; c) të drejta të tjera të nevojshme për të menaxhuar siç duhet seksionet e zhvilluara të sheshit të projektit, në mënyrë që të arrihet niveli i përvojës së kërkuar të Eagle Hills, përfshirë, por pa u kufizuar në të drejtën për të operuar dhe për të menaxhuar zonat e përbashkëta publike dhe private për 35 vjet (ose kushte të tjera të rritura, siç mund të bihet dakord), duke përfshirë, pa kufizim, të drejtat për të menaxhuar reklamat dhe kioskat, pikat e ushqimit dhe të pijeve ose atraksione të tjera, siç përdoren zakonisht në vende publike në komunitetet me masterplan.

103. Nga ana tjetër, pika 10.6.5 e marrëveshjes kuadër ka përcaktuar se qeveria shqiptare, përmes institucioneve të saj qeveritare, merr përsipër të bashkëpunojë dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme maksimale për të mundësuar, sa herë që kërkohet nga investitori strategjik, zbatimin e të drejtave të sipërpërmendura për mirëmbajtjen dhe menaxhimin. Nëse klientët ose investitori strategjik nuk arrijnë të lidhin një marrëveshje për menaxhimin e zonave të përbashkëta publike dhe/ose private ose nëse kjo/këto marrëveshje, pasi të jenë lidhur do të ndërpriten për çfarëdo arsye, në varësi të paragrafit 10.6.2, investitori strategjik nuk do të jetë i detyruar të ofrojë shërbimet e tij menaxhuese dhe këto hapësira të përbashkëta do të menaxhohen sipas legjislacionit të zbatueshëm.

104. Në analizë të kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht të nenit 23 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, i cili ka përcaktuar funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe përgjegjësitë e tyre; nenit 4/1 të ligjit

nr. 107/2014, të shtuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, që ka përcaktuar se çfarë do të konsiderohet hapësirë publike, si dhe mënyrën e menaxhimit të saj; vendimeve nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" *(VKM nr. 1096/2015)* dhe nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" *(nr. 671/2015)*, të cilët kanë përcaktuar mënyrën, rregullat, kushtet dhe procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike, Gjykata vëren se ligjvënësi ka njohur mundësinë e subjektit privat për të administruar dhe menaxhuar hapësirat e përbashkëta publike, përmes lidhjes së marrëveshjeve në formën e partneritetit publik-privat. Gjykata vëren gjithashtu se edhe me ndryshimet e bëra ligjit nr. 107/2014 me ligjin nr. 41/2024, datë 02.05.2024, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit objekt ankimi kushtetues, mënyra e menaxhimit të hapësirës publike nuk ka ndryshuar.

105. Në këndvështrim të këtij kuadri ligjor, në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se modeli i menaxhimit të hapësirave publike përcaktohet nga ligji nr. 107/2014 dhe VKM-të nr. 1096/2015 e nr. 671/2015, ndërsa sipas pikës 10.6.1 të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, zbatimi i së drejtës së investitorit strategjik (ASDC dhe EHRED) për të menaxhuar zonat e përbashkëta publike ose private në seksionet e zhvilluara të sheshit të projektit, do të bëhet në masën që përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se pika 10.6.1 e marrëveshjes nuk përjashton, por, përkundrazi, njeh zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për lidhjen e marrëveshjes së partneritetit publik-privat për administrimin dhe menaxhimin e zonave të përbashkëta (publike ose private) që do të krijohen nga zhvillimi i projektit. Po sipas parashikimeve të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, lidhja e një marrëveshjeje partneriteti publik-privat për menaxhimin e hapësirave publike nuk rezulton të jetë absolute, për sa kohë që pika 10.6.5 e saj parashikon mundësinë e moslidhjes ose të ndërprerjes së marrëveshjes së partneritetit dhe menaxhimin në këto raste të hapësirave të përbashkëta publike sipas legjislacionit të zbatueshëm. Në këtë kuptim, parashikimet e marrëveshjes nuk përjashtojnë të drejtën e pushtetit vendor për të mbikëqyrur mënyrën e menaxhimit të hapësirës së përbashkët publike nga subjekti privat.

106. Për sa më sipër, Gjykata vëren se parashikimet e kontestuara të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022 nuk krijojnë një model të posaçëm në menaxhimin e hapësirave të përbashkëta publike ose private të projektit, por respektojnë modelet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Në interpretim të parashikimeve të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022 përkundrejt neneve 13 dhe 113 të Kushtetutës, të cilat garantojnë autonominë vendore të pushtetit lokal, Gjykata thekson se menaxhimi i hapësirave publike, në parim, përfshihet brenda funksioneve të pushtetit vendor dhe, në rastin konkret, menaxhimi i hapësirave të projektit nga investitori strategjik (shoqëri e përbashkët privat-shtet), sipas nenit 10.6.1 të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, nënkupton mundësinë e pjesëmarrjes së investitorit privat në menaxhim, e cila në vetvete nuk shmang të drejtën e pushtetit vendor për ushtrimin e rolit të tij mbikëqyrës e kontrollues të këtij menaxhimi ose ushtrimin drejtpërsëdrejti të kësaj përgjegjësie në rastet e parashikuara në pikën 10.6.5 të marrëveshjes në fjalë.

107. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të decentralizimit dhe të autonomisë vendore për menaxhimin e hapësirave publike është i pabazuar.

C.2. Për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, konkurrencës së lirë dhe MSA-së në lidhje me ndihmën shtetërore përmes përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare

108. Kërkuesi ka pretenduar se neni 2, pika 1, i ligjit nr. 79/2022 dhe neni 10.12 i marrëveshjes, pjesë integrale e këtij ligji, krijojnë një regjim të posaçëm juridik vetëm për një subjekt të caktuar kundrejt regjimit juridik fiskal të përgjithshëm, të aplikueshëm për sipërmarrësit që veprojnë brenda së njëjtës veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë. Sipas tij, ky regjim devijon haptazi nga regjimi fiskal i aplikueshëm për të gjithë kategorinë e taksapaguesve operatorë ekonomikë sipërmarrës, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin ekonomik të sipërmarrjes dhe ndërtimit, pasi investimi strategjik është përjashtuar nga detyrimi për pagimin e taksës së infrastrukturës, të përcaktuar nga neni 27 i ligjit nr. 9632/2006 në vlerën prej 4% të çmimit të shitjes, si dhe kontributit për strehimin social, të përcaktuar nga neni 19 i ligjit nr. 22/2018 në vlerën 3% të sipërfaqes funksionale të ndërtimit. Po sipas kërkuesit, përfshirja e shtetit si aksionar në subjektin përfitues nuk justifikon shkeljen e parimeve kushtetuese, për sa kohë që shteti, si subjekt ekonomik në qarkullimin e lirë civil, nuk gëzon privilegje ligjore dhe është i barabartë përpara ligjit me çdo subjekt tjetër privat. Ndihma e dhënë nga shteti subjektit përfitues, shoqërisë së përbashkët "Durrës Marina", avantazhon këtë sipërmarrës në krahasim me subjektet e tjera që ushtrojnë të njëjtën veprimtari. Kjo ndihmë redukton

koston e sipërmarrjes së favorizuar, tkurr sektorin e prekur dhe bie në kundërshtim me MSA-në, e cila ndalon shtrembërimin e konkurrencës.

109. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se ligji nr. 79/2022 është në përputhje edhe me nenin 155 të Kushtetutës dhe nuk krijon pabarazi në zbatimin e detyrimeve tatimore e as përfitime të padrejta, ndërsa sipas Këshillit të Ministrave ky ligj është bazuar në ligjin për investimet strategjike, neni 30 i të cilit parashikon të drejtën e shtetit për të qenë bashkëpjesëmarrës në investimet strategjike, përmes kontributit të tij, i cili, sipas akteve nënligjore në zbatim të ligjit, mund të jetë në kapital ose në natyrë. Po sipas Këshillit të Ministrave, përjashtimi i shoqërisë së përbashkët nga pagesa e taksës në infrastrukturë dhe kontributi për strehim social përbën kontributin e shtetit në kapitalin e shoqërisë, i cili do të mblidhet në formën e dividentit nga fitimi. Praktika të tilla janë ndjekur edhe më parë nga shteti shqiptar për projektet me rëndësi kombëtare dhe me interes të lartë publik. Po kështu, miratimi i ligjit është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës. Objektivi i ligjvënësit për zhvillimin e ekonomisë është mjaftueshëm i rëndësishëm për kufizimin e së drejtës. Nga ana tjetër, pretendimet se marrëveshja e miratuar me ligjin objekt kundërshtimi përbën *ndihmë shtetërore* janë gjithashtu të pabazuara. Aktet e BE-së nuk ndalojnë krijimin e një shoqërie të posaçme me aksionarë shtetërorë, por përcaktojnë detyrimin e ndërmarrjeve të kësaj shoqërie për të njoftuar krijimin e saj tek Autoriteti i Konkurrencës. Edhe në rastin konkret, për të garantuar legjitimitetin e kushteve të marrëveshjes, përmes AIDA-s është kërkuar mendim nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore, të cilat nuk kanë konstatuar problematika në këtë drejtim.

110. Krahas prapësimeve të parashtruara nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, subjektet e interesuara APD-ja dhe ASDC-ja kanë prapësuar edhe se ligji nr. 79/2022 nuk është kundërshtuar nga subjektet tregtare me veprimtari të ngjashme, çka tregon se nuk ka cenim real të lirisë së veprimtarisë së tyre ekonomike. Sipas këtyre subjekteve, vlera e detyrimit të përjashtuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe kontributin e strehimit social përbën kontributin e shtetit shqiptar në investim, e cila konvertohet në aksione të shoqërisë "Durrës Marina" që do të vilen përmes fitimit që shteti do të marrë nga kompania në bazë të aksioneve që zotëron. Po sipas këtyre subjekteve, pretendimet për cenimin e nenit 17 të Kushtetutës janë të pabazuara. Objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës dhe masat e marra

janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me këtë objektiv. Pretendimet për cenimin e *MSA-së* janë gjithashtu të pabazuara, pasi investitori nuk ka përfituar një të drejtë ekskluzive.

111. Në kuadër të ndihmës shtetërore, Gjykata Evropiane e Drejtësisë *(GJED)* ka theksuar se kjo lloj ndihme përfshin çdo mjet financiar përmes të cilit autoritetet publike mund të mbështesin sipërmarrje, pavarësisht nëse këto mjete janë ose jo asete të përhershme të sektorit publik *(shih vendimet e GJED-së për çështjet C-78/76 Steinike Sc Weinlig kundër Gjermanisë, datë 22.03.1977, § 21; C-290/83 Komisioni kundër Francës, datë 30.01.1985, § 14; C-67/85, 68/85 dhe 70/85 Van der Kooy dhe të tjerë kundër Komisionit, datë 02.02.1988, § 35; C-305/89 Italia kundër Komisionit, datë 21.03.1991, §13; C-482/99, Franca kundër Komisionit, datë 16.05.2002, § 37)*, ku me sipërmarrje do të kuptohet çdo person fizik ose juridik që ushtron aktivitet ekonomik, pavarësisht statusit ligjor ose mënyrës se si financohet *(shih vendimin e GJED-së C-41/90, Höfner and Elser kundër Macrotron GmbH, datë 23.04.1991, § 21)*. Po sipas GJED-së, koncepti i "ndihmës shtetërore" nuk mbulon masat që bëjnë dallim midis sipërmarrjeve, të cilat, në dritën e objektivit të ndjekur nga regjimi juridik në fjalë, janë në një situatë të krahasueshme faktike dhe ligjore, dhe për rrjedhojë *a priori* selektive, kur shteti në fjalë është në gjendje të tregojë se ky diferencim është i justifikuar, pasi rrjedh nga natyra ose struktura e përgjithshme e sistemit, pjesë e së cilës është edhe kjo masë *(shih vendimin e GJED-së C-374/17, datë 19.12.2018, § 44)*.

112. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se përjashtimi i shoqërisë së përbashkët privat-shtet që do të zhvillojë dhe realizojë projektin "Marina & Jahtet e Durrësit" nga detyrimi i pagesës së taksës në infrastrukturë dhe kontributi i strehimit social përbën ndihmë shtetërore, e cila bie në kundërshtim me nenin 11, pika 1, të Kushtetutës dhe nenet 71 dhe 74 të MSA-së. Në këto kushte, Gjykata, në vijim, do të analizojë këto pretendime të kërkuesit përkundrejt parashikimeve të nenit 11, pika 1, të Kushtetutës, jurisprudencës kushtetuese, si dhe nenit 71 të MSA-së, për të përcaktuar nëse këto përjashtime përbëjnë ose jo ndihmë shtetërore.

113. Gjykata vëren se neni 2, pika 1, i ligjit nr. 79/2022 ka përcaktuar se shoqëria e përbashkët për realizimin e projektit "Marina & Jahtet e Durrësit", me kapital 67% EHRED dhe 33% ASDC *(pika 4.5.1 e marrëveshjes kuadër)*, përjashtohet nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe kontributin e strehimit

social sipas legjislacionit në fuqi për sistemin e taksave vendore dhe për strehimin social. Vlera e detyrimit të përjashtuar është pjesë e kontributit të shtetit shqiptar në investim, sipas marrëveshjes së përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji. Po kështu, sipas pikës 10.12 të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022, qeveria shqiptare do t'i kontribuojë projektit vlerën e shumës së kontributit në fondin e banesave sociale të projektit dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë, të cilën investitori strategjik përndryshe do të jetë i detyruar ta paguajë gjatë periudhës së zhvillimit deri në datën e përfundimit (kontributi tatimor i qeverisë shqiptare). Lejet e ndërtimit/certifikatat e përdorimit të lëshuara për investitorin strategjik do të njohin plotësisht përjashtimin e investitorit strategjik për detyrimin për të paguar ose kontribuuar çdo tatim të lidhur me banesat sociale dhe tatimin mbi ndikimin në infrastrukturë gjatë kësaj periudhe.

114. Gjykata vëren gjithashtu se detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë parashikohet nga neni 27 i ligjit nr. 9632/2006. Sipas pikës 2 të këtij neni, në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi ose për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4% deri në 8% të çmimit të shitjes për metër katror *(pika 2)*. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe për ndërtime që destinohen për përdorim, ndër të tjera, në sektorin e turizmit, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1% deri në 3% të vlerës së investimit *(pika 3, shkronja "a")*, ndërsa për projekte të infrastrukturës për ndërtimin, ndër të tjera, të porteve, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1% të vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit *(pika 3, shkronja "b")*. Kurse, pika 7 e nenit 27 ka përcaktuar përjashtimin nga pagesa e kësaj takse të investimeve të kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".

115. Po kështu, kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik parashikohet në nenin 19 të ligjit nr. 22/2018, ku sipas pikës 1 të tij, çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa

shpërblim për të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale.

116. Në analizë të parashikimeve të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 79/2022 përkundrejt legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, Gjykata evidenton se dispozitat e marrëveshjes kanë përcaktuar përjashtimin e investitorit strategjik, shoqërisë së përbashkët privat-shtet, nga detyrimet për pagesën e taksës në infrastrukturë dhe kontributit për strehimin social. Megjithatë, në vlerësimin në tërësi të kësaj mase, Gjykata vëren se shteti është bërë bashkëpjesëmarrës në investimin strategjik në masën 33% të aksioneve të tij në projekt, ndaj, në këtë situatë, pavarësisht lehtësive në dukje të dhëna investitorit strategjik, shoqërisë së përbashkët privat-shtet, për qëllime të realizimit të projektit të investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", shteti është pjesëmarrës në fitimin që do të realizohet nga zhvillimi dhe zbatimi i projektit, në masën e pjesëmarrjes së tij në kuotat e shoqërisë së përbashkët. Në këtë këndvështrim, edhe pse ndarja e dividentit do të kryhet në një kohë më të vonë, konkretisht në përfundim të realizimit të projektit dhe vënies së tij në zbatim, ajo përbën një detyrim financiar, përmbushja e të cilit çon në pakësimin e masës së fitimit të shoqërisë. Kjo do të thotë se detyrimi financiar i investitorit strategjik vetëm është shtyrë në kohë.

117. Për sa më sipër, Gjykata vëren se, në këmbim të përjashtimit nga detyrimet ligjore për pagesën e taksës në infrastrukturë dhe të kontributit për strehimin social, shteti do të realizojë fitime si rrjedhojë e realizimit dhe zhvillimit të projektit të investimit strategjik, të cilat ligji objekt shqyrtimi kushtetues i ka përcaktuar si detyrime të investitorit strategjik. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendohet, investitori strategjik "Durrës Marina" nuk është vendosur në situatë të privilegjuar në raport me investitorët strategjikë vendas ose të huaj, të cilët operojnë në vend, ndaj çmon se pretendimet e kërkuesit se përjashtimi i shoqërisë së përbashkët privat-shtet që do të zhvillojë dhe do të realizojë projektin "Marina & Jahtet e Durrësit" nga detyrimi i pagesës së taksës në infrastrukturë dhe kontributi i strehimit social përbën ndihmë shtetërore është i pabazuar.

118. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe

72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.02.2025
Shpallur më 11.04.2025

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga një grup prej 32 deputetësh të Kuvendit (jo më pak se një e pesta), me objekt shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 79/2022 dhe të akteve nënligjore të lidhura me projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", ndërsa bashkohem me shumicën se vendimet e Këshillit të Ministrave janë akte individuale, ndaj nuk i nënshtrohen juridiksionit kushtetues (*shih paragrafët 27-34 të vendimit*), jam kundër qëndrimit të saj për rrëzimin e kërkesës lidhur me ligjin, për të cilën vlerësoj se duhej të ishte pranuar. Për të njëjtat argumente procedurale, të cilat i kam shprehur në mendimin e pakicës, që shoqëron vendimin nr. 34, datë 24.04.2024, për ligjin miratues të marrëveshjes për administrimin e Parkut Kombëtar të Butrintit, çmoj se edhe në rastin në shqyrtim ligji nr. 79/2022 bie ndesh me Kushtetutën, pasi nuk respekton parimet kushtetuese që lidhen me funksionet e Kuvendit dhe sistemin normativ. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet mbi të cilat bazohet qëndrimi im.

2. *Së pari*, për rolin dhe funksionet e Kuvendit, Gjykata ka pohuar se demokracia kushtetuese e vendosur në Kushtetutë bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve dhe në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është një nga organet e autoritetit të shtetit, kompetencat e të cilit dhe, për pasojë, sfera e veprimtarisë së tij, është përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Kuvendi gëzon, brenda këtyre limiteve, një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien. Brenda kësaj sfere shkalla e autonomisë së Kuvendit është më e madhe se në sfera të tjera të kompetencave të tij, për shkak të faktit se ai është organi ligjvënës i shtetit (*shih vendimet nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese)*.

3. Në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese Kuvendi kryen funksione legjislative, kontrolluese, emëruese dhe buxhetore. Në rastin në gjykim, është e nevojshme analiza e funksionit legjislativ, që ka të bëjë me miratimin e ligjeve dhe funksionin kontrollues. Ky i fundit, siç ka theksuar jurisprudenca kushtetuese, është i rëndësishëm në një shoqëri demokratike, sepse ai materializohet pikërisht në rolin e deputetëve, që,

nga njëra anë, miratojnë ligjet dhe, nga ana tjetër, ushtrojnë kontrollin mbi pushtetet e tjera deri në atë masë që ky pushtet zbatohet. Në këtë drejtim, *kontrolli parlamentar* nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive, sipas rasteve konkrete. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kontrolli, krijohet mundësia e kontrollit publik të funksionimit të administratës shtetërore (*shih vendimet nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese)*.

4. Miratimi në Kuvend i marrëveshjeve të administrimit të pasurive shtetërore në funksion të projekteve strategjike, ku përfshihet edhe rasti konkret, është tregues i interesit publik që ato paraqesin. Megjithatë rëndësia e interesit publik për miratimin e këtyre lloj marrëveshjeve në Kuvend nuk duhet interpretuar, siç ka ndodhur në rastin konkret, se Kuvendi duhet të vërë në lëvizje procesin legjislativ dhe në përfundim të nxjerrë një ligj, pra të ushtrojë funksionin legjislativ.

5. *Së dyti*, në rastin e miratimit të kontratave administrative të tilla Kuvendi duhet të ndërhyjë për të ushtruar funksionin kontrollues ndaj pushtetit ekzekutiv, për shkak të interesit publik që vihet në diskutim i lidhur me zhvillimet e pritshme nga një projekt me rëndësi strategjike. Pa u zhveshur nga funksioni i tij kryesor, ai i ligjbërjes, Kuvendi ka të drejtën gjithashtu të miratojë edhe akte të tjera me natyrë juridike që ndjekin qëllime të ndryshme nga ai i rregullimit normativ, siç janë vendimet, të cilat janë të përshtatshme për të realizuar funksionin kontrollues. Në të kundërt, praktika e nxjerrjes së ligjeve përmes procedurës parlamentare ligjvënëse, siç ka ndodhur në rastin konkret, për të ushtruar funksion kontrollues, jo vetëm që deformon funksionin ligjvënës të Kuvendit, por e largon atë nga funksioni kontrollues mbi ekzekutivin në një republikë parlamentare.

6. *Së treti,* miratimi i kontratave administrative me ligj, që duket se është një praktikë që po përdoret nga Kuvendi edhe në raste të tjera, në fakt denatyron sistemin normativ të vendit, sepse një ligj i tillë merr tiparet e aktit individual, ai zbatohet për një marrëdhënie juridike të caktuar ndaj subjekteve të individualizuara dhe shteron në zbatimin e tij. Një ligji të tillë i mungojnë karakteristikat e aktit normativ, ai është pa përmbajtje, nuk rregullon situata dhe sjellje në mënyrë të përgjithshme. Në këtë mënyrë, ky lloj ligji nuk lejon as interpretimin e normave të tij, proces i cili kryhet gjatë zbatimit të normave me karakter të përgjithshëm. Për këtë arsye, një akt miratues i Kuvendit, që emërtohet ligj dhe që vjen si rezultat i procedurës

parlamentare ligjvënëse, është e pamundur që, për nga natyra e tij, të bëhet pjesë e sistemit normativ dhe të renditet në piramidën e akteve normative, sipas neneve 4 dhe 116 të Kushtetutës, duke u shndërruar, për pasojë, në një akt të pushtetit publik jashtë nomenklature.

7. *Së katërti,* qasja e Kuvendit për miratimin me ligj të marrëveshjes, përmes procedurës parlamentare ligjvënëse, deformon edhe procedurat e kontrollit gjyqësor të saj, si një akt të vullnetit të palëve. Kështu, për sa kohë që marrëveshja nuk përbën akt normativ, veshja e saj me ligj e përjashton nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ndërsa Gjykatën e vendos në situatën që të pranojë në juridiksionin e saj kontrollin e akteve me natyrë individuale. Një qasje e tillë nuk përputhet me parimin e shtetit të së drejtës, i cili imponon kërkesën që rendi juridik të ketë një sistem të plotë dhe të qartë ankimesh dhe procedurash gjyqësore, të cilat bëjnë të mundur që aktet e nxjerra nga organet e pushtetit publik t'i nënshtrohen kontrollit të përputhshmërisë me Kushtetutën dhe aktet e tjera të sistemit normativ, kur ato akte cenojnë parime kushtetuese, të drejta themelore ose interesa të ligjshëm.

8. Në përmbledhje të arsyeve të mësipërme dhe bazuar në nenet 4, 81-85, 116 dhe 131, shkronja "a", të Kushtetutës, vlerësoj se ligji objekt kundërshtimi është i papajtueshëm me Kushtetutën në aspektin formal, për sa kohë që Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me kompetencat dhe procedurën parlamentare ligjvënëse. Për rrjedhojë, Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën pjesërisht dhe të vendoste shfuqizimin e ligjit objekt kërkese.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në çështjen nr. 3 (Nj) 2023 të Regjistrit Themeltar, me palë dhe objekt si më sipër, ndaj qasje të ndryshme nga shumica në drejtim të juridiksionit të Gjykatës për kontrollin e akteve që i bashkëlidhen ligjit nr. 79/2022 "Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a., dhe NSHMI Development L.L.C., në lidhje me projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit"", konkretisht të marrëveshjes kuadër, të statutit të shoqërisë së përbashkët, të marrëveshjes së zhvillimit dhe kontratës për transferimin e titullit të pronësisë dhe të marrëveshjes "Për Marinën e Durrësit". Kjo qasje bazohet mbi të njëjtat argumente ku kam bazuar edhe qëndrimin tim kundër në vendimin nr. 34, datë 24.04.2024, i cili ka pasur për objekt kundërshtimin e ligjit miratues të marrëveshjes për administrimin e Parkut Kombëtar të Butrintit.

2. Në vlerësimin tim, ndërsa vetë ligji i miratuar nga Kuvendi, formalisht dhe substancialisht, bën pjesë në aktet që sipas nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës i nënshtrohen juridiksionit kushtetues, kjo nuk është e mjaftueshme për të bërë pjesë të këtij kontrolli edhe çdo akt që i bashkëlidhet një akti të tillë normativ. Unë i qëndroj qasjes se një marrëveshje ose një akt tjetër juridik i miratuar me ligj dhe që i bashkëlidhet atij, duke mos mundur të marrë vetëm për këtë shkak natyrën e aktit që e miraton (ligjit) dhe e bën pjesë të rendit të brendshëm, duhet t`i nënshtrohet në çdo rast verifikimit të kritereve që përcaktojnë natyrën normative të akteve që i nënshtrohen kontrollit kushtetues abstrakt, për sa kohë jemi përpara dy akteve juridike të mëvetshme që as marrin, as i japin njëri-tjetrit natyrën e tyre normative ose individuale.

3. Shumica ka vlerësuar se Gjykata ka juridiksion për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit objekt kërkese, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, jo vetëm për faktin se marrëveshja e miratuar me të dhe që i bashkëlidhet për këtë shkak ka marrë veshje formale me ligj, por edhe bazuar në natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, si elemente përcaktuese të juridiksionit kushtetues (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Kjo qasje e shumicës, në vijim edhe të asaj të mbajtur në çështjen e Parkut të Butrintit (*vendimi nr. 34, datë 24.04.2024*),

është e ndryshme nga ajo e mbajtur gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 145/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe" (*vendimi nr. 36, datë 10.06.2023*), ku Gjykata vuri në diskutim statusin e aktit të miratuar në raport me atë të aktit miratues (ligjit), që i jep efektivitet në rendin e brendshëm ligjor. Gjykata vlerësoi, në thelb, se pavarësisht faktit se akti juridik i bashkëlidhet ligjit dhe është pjesë përbërëse e tij, ai nuk merr për këtë shkak të njëjtën vlerë juridike, por në këto raste kemi të bëjmë me dy akte të ndryshme që nuk marrin natyrën dhe vlerën juridike të njëri-tjetrit.

4. Në vlerësimin tim, edhe në rastin konkret, Kuvendi, pavarësisht se ka ndërhyrë përmes miratimit me një akt normativ të një marrëveshjeje kuadër të lidhur mes Këshillit të Ministrave dhe disa shoqërive të së drejtës private të huaj, por edhe të një marrëveshjeje për zhvillimin dhe akteve që rrjedhin apo kanë për bazë atë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, ai nuk merr cilësinë e palës në këto marrëveshje dhe, si i tillë, nuk është i autorizuar të ndërhyjë për të ndryshuar ose shuar këtë marrëdhënie të së drejtës private. Dhënia e pëlqimit dhe shfaqja e vullnetit të Kuvendit nuk ndryshojnë natyrën e marrëveshjes dhe akteve pjesë të saj, për rrjedhojë nuk e bëjnë atë pjesë të rendit juridik normativ të brendshëm. Miratimi i marrëveshjes me ligj nga Kuvendi nuk sjell asnjë efekt në përmbajtjen e saj apo të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe efektet që prodhon për to. Pavarësisht miratimit të saj me ligj, ky i fundit nuk i jep dispozitave të marrëveshjes karakter normativ, që është kriteri që përcakton juridiksionin kushtetues për kontrollin abstrakt të aktit.

5. Për sa më sipër, vlerësoj se, edhe në rastin konkret, për sa kohë gjendemi përpara akteve juridike të ndryshme, ushtrimi i juridiksionit kushtetues është i lejueshëm vetëm ndaj ligjit miratues, ndërkohë që aktet juridike që i bashkëlidhen këtij ligji, për sa kohë që nuk kanë natyrë normative, duke qenë ato akte të vullnetit mes palëve të saj, pra me natyrë të pastër individuale, përjashtohen nga juridiksioni kushtetues në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës. Parashikimet e marrëveshjes dhe të akteve të tjera juridike, pavarësisht se janë miratuar nga Kuvendi me ligj, nuk transformohen në norma me natyrë abstrakte dhe të përgjithshme, që, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese, është elementi përcaktues i juridiksionit kushtetues. Në masën në të cilën fusha e veprimit të marrëveshjes është e përcaktuar në mënyrë konkrete, për shkak të qëllimit *intuitu personae* të saj, që ka të bëjë me natyrën personale të

marrëdhënies kontraktore të lidhur specifikisht mbi bazën e cilësive ose karakteristikave të palëve të përfshira, ajo ka karakter individual, duke qenë e konceptuar për t`u zbatuar jo në një numër të pacaktuar rastesh konkrete, në funksion të përfshirjes së tyre në hipotezën e normës, por në një rast të vetëm të përcaktuar. Duke qenë përpara akteve me natyrë thelbësisht individuale, vlerësoj se qëndrimi i shumicës se ato janë veshur formalisht me ligj, për shkak se janë miratuar me ligj nga Kuvendi, është i papranueshëm në aspektin kushtetues.

6. Duke u munguar akteve bashkëlidhur ligjit natyra normative, si i vetmi kriter që, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", të Kushtetutës, i bën ato të afta t`i nënshtrohen kontrollit kushtetues abstrakt, nuk ka asnjë relevancë për çështjen konkrete natyra e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, për sa kohë që ajo nuk përcakton juridiksionin kushtetues në drejtim të kompetencës konkrete që ushtron Gjykata, por lëndën e këtij kontrolli në çdo rast kur ajo vihet në lëvizje për shqyrtimin e një çështjeje që bën pjesë në juridiksionin kushtetues në kuptim të nenit 131, pika 1, të Kushtetutës.

7. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin tim kontrolli kushtetues në rastin konkret mund të shtrihej vetëm ndaj dispozitave të ligjit nr. 79/2022, por jo edhe të marrëveshjeve të miratuara përmes tij. Këto të fundit janë marrëveshje/kontrata shtetërore dhe pavarësisht se janë të lidhura me subjekte të huaja (të së drejtës private), dallojnë në mënyrë esenciale nga traktatet ndërkombëtare të cilat lidhen midis subjekteve të së drejtës ndërkombëtare publike, për të cilat, vetëm në mënyrë përjashtimore përpara ratifikimit me ligj të Kuvendit, Gjykata ka kompetencë të shqyrtojë kushtetutshmërinë e tyre.

8. Pasi është sqaruar sa më sipër në drejtim të juridiksionit të Gjykatës, në vijim do të ndalem në vetë përmbajtjen e ligjit miratues nr. 79/2022. Fillimisht evidentoj se ai ka 6 dispozita. Konkretisht, përmes nenit 1 të tij është miratuar marrëveshja kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company sh.a. dhe NSHMI Development L.L.C. për projektin e investimit strategjik "Marina & Jahtet e Durrësit", si dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje kuadër sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji. Neni 2 i ligjit ka rregulluar disa aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me regjimin e posaçëm në zbatim të marrëveshjes, i cili shtrihet në drejtim të: përjashtimit të shoqërisë së përbashkët për realizimin e projektit "Marina & Jahtet e Durrësit" nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit

në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe kontributin e strehimit social sipas legjislacionit në fuqi (pika 1); dhënies së lejeve, licencave dhe akteve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit brenda një afati prej jo më shumë se 150 ditësh (pika 2); kalimit me VKM në pronësi të shoqërisë "Albanian Seaports Development Company" sh.a. të pronave të paluajtshme shtetërore, të transferuara në FPPMIS (pika 3). Kurse përmes nenit 3 të ligjit është miratuar statuti i shoqërisë së përbashkët që do të krijohet sipas marrëveshjes kuadër, duke përcaktuar se kushtet thelbësore të atij statuti janë sipas shtojcës 8 që i bashkëlidhet ligjit. Në vijim, neni 4 i ligjit përcakton se Albanian Seaports Development Company sh.a. lidh marrëveshjen e zhvillimit dhe kontratën për transferimin e titullit të pronësisë sipas tekstit të dokumenteve bashkëlidhur këtij ligji (pika 1), ndërsa Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidh marrëveshjen "Për Marinën e Durrësit" sipas tekstit të dokumentit bashkëlidhur këtij ligji. Ndërkohë, neni 5 i ligjit ngarkon Këshillin e Ministrave për miratimin e aktit nënligjor sipas pikës 3 të nenit 2 të këtij ligji, kurse neni 6 i tij përcakton hyrjen në fuqi të ligjit nr. 79/2022.

9. Në vlerësimin tim, një akt juridik i Kuvendit synon të rregullojë marrëdhënie sociale të përgjithshme, pra një sferë më të gjerë raportesh juridike në kuadër dhe interes të shoqërisë, për rrjedhojë për nga qëllimi kushtetues është një akt me zbatim të përgjithshëm. Në këtë kuptim, nëse qëllimi i lidhjes së një marrëveshjeje/kontrate synon interesin e palëve të saj, qëllimi i ligjbërjes synon interesin e përgjithshëm të shoqërisë. Ndërsa ligji ka natyrë unilaterale, duke i dhënë shprehje vullnetit të ligjvënësit, përmbajtja dhe forma e të cilit përcaktohen nga nevoja për të rregulluar një fushë të caktuar të marrëdhënieve sociale, marrëveshja/kontrata është një akt që përcakton një marrëdhënie bilaterale, ku secila nga palët ka shprehur vullnetin e saj nëpërmjet paraqitjes së ofertës nga njëra palë dhe pranimit të saj nga pala tjetër.

10. Në këtë kuptim, ligji nr. 79/2022 për nga natyra e tij, për shkak të çështjes që ka synuar të rregullojë përmes neneve 1, 3 dhe 4 të tij, bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës që parashikohet në preambulën dhe nenet 3 dhe 4, pika 1, të Kushtetutës, pjesë e rëndësishme e të cilit është ndarja e pushteteve, e parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës. Kjo pasi Kuvendi ka ndërhyrë në rregullimin e një çështjeje që nuk bën pjesë në ato që i përkasin pushtetit ligjvënës. Ndërhyrja e Kuvendit në këtë rast përmes miratimit me ligj të marrëveshjes kuadër, të statutit të shoqërisë së përbashkët, të marrëveshjes së zhvillimit dhe kontratës për transferimin e titullit të

pronësisë dhe të marrëveshjes "Për Marinën e Durrësit", pra përmes një akti me natyrë të përgjithshme, e bën këtë veprimtari jokushtetuese. Kuvendi ka ndërhyrë për rregullimin e një çështjeje që i përket vlerësimit dhe miratimit nga pushteti ekzekutiv, duke qenë përpara një marrëveshjeje vullneti, që në praktikë realizohet përmes ofertës dhe pranimit të saj, pra me natyrë të pastër ekzekutive. Vullneti i ligjvënësit në këtë rast nuk është i shprehur në cilësinë e organit përfaqësues të vullnetit të popullit, pra si vullnet i një lloji autoritar, por vetëm me synimin për t`i dhënë vlerë juridike dispozitave të një marrëveshjeje që është detyruese dhe sjell pasoja vetëm ndaj palëve të saj.

11. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, miratimi i marrëveshjes kuadër, i statutit të shoqërisë së përbashkët, i marrëveshjes së zhvillimit dhe kontratës për transferimin e titullit të pronësisë dhe i marrëveshjes "Për Marinën e Durrësit" përmes ligjit nr. 79/2022 e veson vetë aktin nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, për sa kohë bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe parimin e ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve. Nisur nga kjo, mbajta qëndrimin se nenet 1, 3 dhe 4 të ligjit në fjalë duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën, çka, nga ana tjetër, do të hiqte pengesën e çdo kontrolli të mundshëm nga sistemi gjyqësor i zakonshëm të atyre akteve juridike me natyrë individuale të mëvetësishme nga ligji, duke u garantuar në këtë mënyrë edhe respektimi i parimit të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vlerësoj të theksoj, gjithashtu, se Kushtetuta i ka njohur Kuvendit në mënyrë të shprehur kompetencën për të miratuar ligje të tilla me natyrë individuale vetëm në raste përjashtimore, siç është ai për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vetëm për çështje të caktuara, me qëllim që t`i bëjë pjesë edhe të rendit të brendshëm juridik. Ndërkohë që parashikimi i një kompetence të tillë me ligje të veçanta, për miratimin edhe të marrëveshjeve të lidhura mes subjekteve të së drejtës, pavarësisht se njëri prej tyre mund të jetë organi ekzekutiv, nuk përputhet as me funksionin e organit legjislativ dhe as me qëllimin e ligjbërjes.

12. Mbi këtë qasje dhe argumente konstatoj se ligji nr. 79/2022, përveç dispozitave të mësipërme (nenet 1, 3 dhe 4) përmban edhe parashikime ligjore që synojnë rregullimin dhe normimin e çështjeve të veçanta. Kështu, ligji ka rregulluar disa aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me regjimin e posaçëm në zbatim të marrëveshjes (neni 2), sikundër edhe rezervën ligjore relative në lidhje këtë regjim të posaçëm (neni 5). Duke pasur parasysh përmbajtjen e këtyre dispozitave dhe qëllimin e tyre, si dhe faktin se organi

ligjbërës nuk ndalohet nga Kushtetuta për të rregulluar me ligj të veçantë edhe çështje të caktuara që mbartin interes publik, vlerësoj se parashikimet e neneve 2 dhe 5 të ligjit nr. 79/2022 plotësojnë kriteret për t`iu nënshtruar kontrollit të pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën.

13. Për sa i përket themelit të pretendimeve në lidhje me këto dispozita, që kanë të bëjnë me cenimin e parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore në lidhje me menaxhimin e hapësirave publike dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, konkurrencës së lirë dhe MSA-së lidhje me ndihmën shtetërore përmes përjashtimit të investitorit strategjik nga detyrimet financiare, unë i bashkohem qëndrimit të shumicës se ato janë të pabazuara, ndaj duhet të rrëzohen, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit.

Anëtar: Ilir Toska

Vendim nr. 9, datë 04.03.2025
(V-9/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 04.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 23 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQATA "DËSHMITARËT E JEHOVAIT NË SHQIPËRI",** përfaqësuar nga presidenti Arben Vasili.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Engjëll Agaçi.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar me autorizim nga Valbona Legisi dhe Irma Qosja.

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET, në mungesë**.**

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i refuzimit nga institucionet shtetërore dhe gjyqësore të trajtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.**

Konstatimi i mungesës së mjeteve juridike efektive për përmbushjen e të drejtave sipas Konventës Evropiane dhe të drejtave kushtetuese të subjektit kërkues.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese të lirisë së mendimit, ndërgjegjes e fesë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Rivendosja e këtyre të drejtave kushtetuese

të shkelura si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor, në mungesë të mjeteve juridike efektive për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të cenuara.

BAZA LIGJORE: Nenet 10, 18, 24, 42, pika 2, 46, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja i, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 9, 11, 13 dhe 14, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 18, 22, 26 dhe 27 të "Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike", ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7510, datë 08.08.1991 *(Pakti)*; nenet 49, pika 3, shkronja "e", 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Komitetit Shtetëror për Kultet, mungesën e mendimit me shkrim nga Avokati i Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shoqata "Dëshmitarët e Jehovait në Shqipëri" (*kërkuesja*) është person juridik privat i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, në formën

juridike të shoqatës dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse. Qëllimi i veprimtarisë së kërkueses lidhet me shpërndarjen e njohurive fetare.

2. Kërkuesja referon se nga viti 2018 e deri në vitin 2021 ka mbajtur një korrespondencë të vazhdueshme me Kryeministrinë dhe Komitetin Shqiptar të Kulteve *(KSHK),* ku ka kërkuar vazhdimisht lidhjen e një marrëveshjeje midis Kryeministrisë dhe vetë asaj, sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 5, të Kushtetutës, me qëllim njohjen e komunitetit fetar të dëshmitarëve të Jehovait si "bashkësi fetare" në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se nuk ka pasur një përgjigjeje konkrete lidhur me thelbin e kërkesave të kërkueses, kjo e fundit i është drejtuar me ankesë Avokatit të Popullit, i cili, në përfundim të hetimit administrativ, ka rekomanduar që Kryeministria dhe KSHK-ja të garantonin të drejtën e kërkueses. Në përgjigje të kësaj, me shkresën nr. 6563, datë 20.01.2021, Kryeministria ka njoftuar Avokatin e Popullit dhe për dijeni KSHK-në dhe kërkuesen se nga ana e saj nuk ka pasur një kërkesë formale për fillimin e një procedure administrative lidhur me kërkesat e kësaj të fundit.

3. Në vijim, sipas kërkueses, në datën 12.03.2021, përmes shërbimit postar, ajo i ka dërguar Këshillit të Ministrave një kërkesë zyrtare për fillimin e procedurave për lidhjen e një marrëveshjeje mes palëve për njohjen e komunitetit fetar të Dëshmitarëve të Jehovait si "bashkësi fetare" në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë, në datën 22.06.2021, në mungesë të një përgjigjeje, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi me objekt detyrimin e organit publik për të kthyer një përgjigje për kërkesën e datës 12.03.2021, saktësimin e detyrimit të organit publik që të marrë parasysh detyrimet që burojnë nga Kushtetuta, KEDNJ-ja dhe Pakti për trajtim të barabartë, të paanshëm dhe të drejtë të kërkesës, si dhe detyrimin e organit publik për të lidhur një marrëveshje me kërkuesen sipas parashikimeve të nenit 10, pika 5, të Kushtetutës, e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, brenda një afati që do të konsiderohet i arsyeshëm nga gjykata.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3377, datë 01.12.2021, ka vendosur rrëzimin e një pjese të padisë dhe pushimin e gjykimit sa i përket kërkimit për detyrimin e organit publik për të lidhur një marrëveshje me kërkuesen. Ajo gjykatë ka argumentuar se lidhur me detyrimin për kthimin e një përgjigjeje nga organi publik, nuk rezulton e provuar që shkresa të jetë administruar pranë protokollit të këtij organi. Gjithashtu, për kërkimin tjetër, ajo gjykatë ka argumentuar se e drejta e pretenduar nga kërkuesja buron

drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe jo nga marrëdhëniet juridiko-civile, ndaj pala e paditur nuk kishte legjitimim pasiv për t'u thirrur në gjykim e për rrjedhojë padia konsiderohet si një padi që nuk mund të ngrihej referuar nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* dhe nenit 50, shkronja "d", të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*. Gjithashtu, në këtë gjykim ka paraqitur "*amicus curiae*" edhe Avokati i Popullit, i cili ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në hetimin administrativ. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja.

5. Aktualisht çështja objekt i ankimit kushtetues ndodhet pranë Gjykatës Administrative të Apelit në pritje të gjykimit me numër regjistri themeltar nr. 17125, regjistruar me nr. 31138-01804-86-2022 sistemi, datë 31.05.2022. Në datën 04.01.2024 kërkuesja ka paraqitur kërkesë pranë asaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, drejtuar relatorit të çështjes, referuar nenit 460, pika 3, të KPC-së, kërkesë që nuk është marrë parasysh. Në datën 09.02.2024 kërkuesja i është drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të procesit të saj administrativ.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë informacion nga gjyqtarja relatore në Gjykatën Administrative të Apelit, lidhur me ngarkesën e kësaj të fundit (e cila kishte 2450 çështje në gjykim dhe gjykonte rreth 30 çështje në muaj), me vendimin nr. 00-2024-1360, datë 04.04.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses, me arsyetimin se Gjykata Administrative e Apelit gjendet në pamundësi objektive për ta marrë në shqyrtim këtë kërkesë për shkak të ngarkesës së madhe që ajo gjykatë ka. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka argumentuar se nëse ajo do të shqyrtonte të gjitha çështjet që u ka kaluar afati në apel, duke urdhëruar përshpejtimin e tyre, kjo situatë do të krijonte situatën absurde të marrjes së një vendimi të pazbatueshëm objektivisht.

7. Në datën 19.07.2024 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 29.07.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 07.10.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare në bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e:

8.1. *Së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në aspektet e mëposhtme:

8.1.1. *Parimit të paanshmërisë,* pasi gjyqtarja A.A. që ka dhënë vendimin e rrëzimit të kërkesëpadisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka qenë edhe pjesë e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm gjykuar pranë kësaj gjykate.

8.1.2. *Së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm,* pasi autoritetet shtetërore për vite me radhë nuk kanë trajtuar kërkesat e ligjshme të saj, për çështjen, si dhe nuk i kanë kthyer përgjigje, duke mos bashkëpunuar për kërkesat e vazhdueshme. Për sa u takon autoriteteve gjyqësore, konkretisht Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut *(GJEDNJ),* duke mos e pranuar kërkesën e saj për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, ndërkohë që çështja është në pritje të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit për më shumë se dy vjet dhe kanë kaluar rreth tre vjet e gjysmë nga nisja e procedurave gjyqësore.

8.2. *Së drejtës për mjete juridike efektive për përmbushjen e të drejtave sipas KEDNJ-së dhe të drejtave kushtetuese të subjektit kërkues,* pasi aktualisht në Republikën e Shqipërisë nuk ekziston një kuadër ligjor specifik që të rregullojë mënyrën se si një komunitet fetar mund të nënshkruajë marrëveshje me Këshillin e Ministrave (referuar pikës 5 të nenit 10 të Kushtetutës) për t'u kategorizuar "bashkësi fetare" dhe për të përfituar benefitet e dhëna nga ligji nr. 10140, datë 15.05.2009 "Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave" *(ligji nr. 10140/2009)*. Gjithashtu edhe pse çështja nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata është mjeti i fundit ligjor efektiv për realizimin e të drejtave kushtetuese, si dhe është

kompetente për të marrë në shqyrtim këtë çështje në themel, pasi është provuar se mjetet e tjera juridike në dispozicion nuk janë efektive.

8.3. *Së drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes e fesë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit*, pasi autoritetet shtetërore me mosveprimin e tyre, duke mos e klasifikuar si bashkësi fetare një komunitet që ka ekzistuar në Shqipëri prej rreth 100 vjetësh, kanë cenuar lirinë e ndërgjegjes dhe besimit, barazinë në trajtimin e komuniteteve fetare, duke e diskriminuar atë, si dhe lirinë e tubimit. Mungesa e vullnetit nga ana e Kryeministrisë për të hyrë në një marrëveshje me kërkuesen përbën shkelje të neneve 10, 24 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9, 11 dhe nenit 1 të protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Nga këto mosveprime, kërkueses i kanë ardhur pasoja financiare lidhur me përjashtimin nga taksa të ndryshme, pasoja të tjera, siç është vendosja në një dritë të pafavorshme në sytë e opinionit publik dhe pengimi për sigurimin e ndihmës shpirtërore në institucionet e vuajtjes së dënimeve penale, duke i kufizuar në këtë mënyrë të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese.

9. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

9.1. *Për legjitimimin e palës kërkuese dhe shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion* rezulton se pretendimet për cenimin e së drejtës për mjete juridike efektive dhe së drejtës së besimit fetar të lidhur me parimin e mosdiskriminimit nuk duhet të merren në shqyrtim, sepse kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

9.2. *Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm* nuk rezulton që pretendimi të jetë ngritur në nivel kushtetues. Mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit lidhet me situatën ku gjendet aktualisht sistemi gjyqësor si pasojë e reformës në drejtësi. Çështja nuk hyn tek ato të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme dhe mund të kenë përparësi në shqyrtim, si dhe nuk ka pasur sjellje të palëve që të kenë ndikuar në vonesa, ndërkohë që sjellja e autoriteteve gjyqësore ka qenë korrekte.

9.3. *Për cenimin e të drejtave konventore e kushtetuese dhe pasojat e ardhura kërkueses* rezulton se pasojat e renditura nga kërkuesja nuk sjellin shkeljen e asnjë të drejte kushtetuese. Këto pretendime

të natyrës substanciale mund të bëhen objekt gjykimi vetëm pasi të përfundojë gjykimi i themelit të çështjes në të gjitha shkallët e juridiksionit gjyqësor. Këshilli i Ministrave nuk rezulton të ketë heshtur ose të ketë refuzuar ndonjë kërkesë, përkundrazi është angazhuar me përgjigjen e kthyer Avokatit të Popullit.

9.4. *Për kuadrin ligjor në fuqi*, marrëdhëniet mes shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen nga ligji dhe mbi këtë bazë është krijuar në vitin 1999 edhe Komiteti Shtetëror për Kultet, me qëllim bashkërendimin e marrëdhënieve midis tyre. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që ky komitet të ketë dhënë një mendim i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të kërkueses, pasi kuadri ligjor i zbatueshëm nuk parashikon që shteti duhet të shprehet me anë të organeve të tij publike në mënyrë detyruese për pretendimet për t'u njohur si bashkësi fetare.

10. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

10.1. *Për legjitimimin e palës kërkuese dhe shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion* rezulton se pretendimet për cenimin e së drejtës për mjete juridike efektive dhe së drejtës së besimit fetar të lidhur me parimin e mosdiskriminimit nuk duhet të merren në shqyrtim, sepse kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

10.2. *Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm* nuk rezulton që pretendimi të jetë ngritur në nivel kushtetues. Mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit lidhet me situatën ku gjendet aktualisht sistemi gjyqësor si pasojë e reformës në drejtësi. Çështja nuk hyn tek ato të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme dhe mund të kenë përparësi në shqyrtim, si dhe nuk ka pasur sjellje të palëve që të kenë ndikuar në vonesa, ndërkohë që sjellja e autoriteteve gjyqësore ka qenë korrekte.

10.3. *Lidhur me cenimin e të drejtave konventore e kushtetuese dhe pasojat e ardhura kërkueses* rezulton se pasojat e renditura nga kërkuesja nuk sjellin shkeljen e asnjë të drejte kushtetuese. Këto pretendime të natyrës substanciale mund të bëhen objekt gjykimi vetëm pasi të përfundojë gjykimi i themelit të çështjes në të gjitha shkallët e juridiksionit gjyqësor. Këshilli i Ministrave nuk rezulton të ketë heshtur ose të ketë refuzuar ndonjë kërkesë, përkundrazi është angazhuar me përgjigjen e kthyer Avokatit të Popullit.

10.4. *Për kuadrin ligjor në fuqi*, marrëdhëniet mes shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen nga ligji dhe mbi këtë bazë është krijuar në vitin 1999 edhe Komiteti Shtetëror për Kultet, me qëllim bashkërendimin e marrëdhënieve midis tyre. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që ky komitet të ketë dhënë një mendim i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të kërkueses, pasi kuadri ligjor i zbatueshëm nuk parashikon që shteti duhet të shprehet me anë të organeve të tij publike në mënyrë detyruese për pretendimet për t'u njohur si bashkësi fetare.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete *(shih vendimet nr. 6, datë 15.02.2024; nr. 64, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa

u takon kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni në fuqi parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nga ana e Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se kërkuesja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike, sepse e ka paraqitur ankimin kushtetues individual pasi ka përdorur edhe kërkesën për përshpejtim drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila e ka refuzuar kërkesën e saj. Ndërkohë për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë, ky pretendim lidhet me gjykimin në Gjykatë të Lartë, ndaj kërkuesja nuk ka mjet tjetër në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar përveç ankimit kushtetues individual.

15. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për mjete juridike efektive, si dhe cenimin e së drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes e fesë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Gjykata vëren se, në thelb, nëpërmjet ankimit kushtetues individual kërkuesja pretendon që legjislacioni shqiptar nuk ka një kuadër rregullator për fushën, si dhe faktin se asaj i shkelet një e drejtë substanciale si ajo e besimit, duke u trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me besime të tjera fetare. Në pretendimet e saj, ajo, gjithashtu, sjell në vëmendje faktin se edhe pse çështja nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata është mjeti i fundit ligjor efektiv për realizimin e të drejtave kushtetuese, si dhe është kompetente për të marrë në shqyrtim këtë çështje në themel, pasi është provuar se mjetet e tjera juridike në dispozicion nuk janë efektive.

16. Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit për këtë fakt kanë parashtruar të njëjtat argumente, se pretendimet për cenimin e së drejtës për mjete juridike efektive dhe së drejtës së besimit fetar të lidhur me parimin e mosdiskriminimit nuk duhet të merren në shqyrtim, sepse kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

17. Gjykata vëren se kërkuesja nuk ka arritur të provojë faktin se mjetet

juridike në dispozicion nuk janë efektive për zgjidhjen e pretendimeve të saj. Për sa më sipër, lidhur me pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për mjete juridike efektive, si dhe të së drejtës kushtetuese të lirisë së mendimit, ndërgjegjes e fesë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, kjo e fundit nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Kjo do të thotë se kërkuesja ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e interesave të saj gjatë gjykimit të çështjes në dy shkallët e tjera të gjyqësorit, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Ndaj, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Gjykata konstaton se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi jo vetëm shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 04.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 19.07.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm dhe cenimin e parimit të paanshmërisë. Për sa i takon këtij të fundit kërkuesja ka pretenduar se gjyqtarja A.A., që ka dhënë vendimin e rrëzimit të kërkesëpadisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka qenë edhe pjesë e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm gjykuar pranë asaj gjykate.

20. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata ka theksuar se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme *(shih vendimin nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Në rastin konkret, duke pasur parasysh karakteristikat e secilit vendim, ku ai i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhet me themelin e çështjes, ndërkohë që vendimi i dhënë nga Kolegji Administrativ lidhet me kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykata vëren se pjesëmarrja e gjyqtares A.A. në këto dy gjykime nuk përbën cenim të parimit të paanshmërisë. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përderisa çështjet, në shqyrtimin e të cilave ka marrë pjesë gjyqtarja, kanë objekt të ndryshëm, ato nuk krijojnë dyshime për cenimin e parimit të paanësisë gjatë procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkueses është haptazi i pabazuar.

22. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm të çështjes së saj të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, në referim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ai përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

23. Kërkuesja ka pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i refuzimit nga institucionet shtetërore dhe gjyqësore të trajtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Sipas saj, autoritetet shtetërore për vite me radhë nuk i kanë trajtuar kërkesat e ligjshme për çështjen, duke mos i kthyer përgjigje dhe duke mos bashkëpunuar për kërkesat e vazhdueshme. Për sa u takon autoriteteve gjyqësore, konkretisht Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të GJEDNJ-së duke mos e pranuar kërkesën e saj për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, ndërkohë që çështja është në pritje të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit për më shumë se dy vjet dhe ndërkohë që kanë kaluar rreth tre vjet e gjysmë nga nisja e procedurave gjyqësore. Gjithashtu, për sa i takon çështjes së përshpejtimit, rezulton se, sipas saj, çështja nuk paraqet kompleksitet, sjellja e saj ka qenë korrekte, ndërsa për sa i takon sjelljes së autoriteteve rezulton se argumentet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk janë në harmoni me standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja dhe vetë Gjykata dhe për sa u takon pasojave të ardhura, vonesat në gjykim pengojnë rivendosjen e të drejtave kushtetuese të shkelura.

24. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e

Shtetit, kanë prapësuar se pretendimi i kërkueses është i pabazuar, pasi nuk rezulton që ajo ta ketë ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues. Mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të shihet nën dritën e rrethanave konkrete në të cilat ndodhet aktualisht sistemi gjyqësor, si reforma në drejtësi dhe ngarkesa individuale e gjyqtarit relator. Për sa i takon interesit të kërkueses rezulton se kjo çështje nuk hyn tek ato të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme dhe mund të kenë përparësi në shqyrtim, siç janë çështjet që lidhen me pensionet, kujdestarinë etj. Gjithashtu, nuk ka pasur sjellje të palëve që të kenë ndikuar në vonesa, si dhe sjellja e autoriteteve gjyqësore ka qenë korrekte referuar ngarkesës së gjyqtarit relator të çështjes dhe faktit që çështja e kërkueses është regjistruar në apel në vitin 2022, ndërkohë që ajo gjykatë po shqyrton çështje të regjistruara në vitin 2017.

25. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Gjykata vëren se çështja e kërkueses është e natyrës administrative dhe ka të bëjë me detyrimin e organit publik për të marrë në shqyrtim kërkesën e saj që pretendohet se është paraqitur në datën 12.03.2021. Procesi gjyqësor është vënë në lëvizje përmes padisë së paraqitur nga kërkuesja, që është depozituar në gjykatën e shkallës së parë në datën 22.06.2021 dhe deri më sot nuk ka ende një zgjidhje përfundimtare nga gjykatat e zakonshme për të gjitha kërkimet e padisë. Mbi bazën e ankimit të kërkueses, çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 31.05.2022 dhe deri në datën 19.02.2025 nuk ka ende një datë të planifikuar për gjykim nga gjyqtari relator. Pra, ndonëse kanë kaluar rreth 4 vjet nga paraqitja e pretenduar e kërkesës pranë organit publik dhe rreth 3 vjet e 9 muaj nga paraqitja e kërkesëpadisë, ende nuk ka një vendimmarrje për çështjen.

27. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata evidenton se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 30-ditor

për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a")

28. Duke analizuar rrethanat e mësipërme, Gjykata konstaton se gjykimi i çështjes së kërkueses në tërësi ka tejkaluar afatet ligjore. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse tejzgjatja e afatit është e paarsyeshme, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkueses; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja *(shih vendimet nr. 65, datë 02.10.2024; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Për sa i takon *sjelljes së kërkueses*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ajo ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Lidhur me sjelljen e kërkueses, ajo ka qenë në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim, përkundrazi nuk e ka humbur interesin, madje e ka shfaqur atë në mënyrë të pandërprerë, duke kërkuar përshpejtimin e çështjes, fakt ky i pranuar edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj.

31. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se lidhur me vlerësimin e kriterit të *kompleksitetit të çështjes* marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Për sa i takon këtij kriteri, Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj detyrimin e organit shtetëror për fillimin e një procedure administrative. Gjykimi në shkallën e parë është zhvilluar në seancë

gjyqësore publike dhe krahas kërkueses në gjykim janë thirrur si palë ndërgjyqëse Kryeministria (përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit), Këshilli i Ministrave, Komiteti Shtetëror për Kultet, si dhe Avokati i Popullit për dhënien e një *amicus curiae*. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e ka përfunduar gjykimin brenda 6 muajve dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë dhe pushimin e saj për një nga kërkimet. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se çështja e kërkueses nuk paraqitet komplekse në atë masë që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj rreth 2 vjet e 9 muaj në shkallë të dytë.

33. Lidhur me *sjelljen e autoriteteve*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Në lidhje me këtë kriter, Gjykata konstaton se ankimi në çështjen e kërkueses është në pritje për shqyrtim prej rreth 2 vjetësh e 9 muajsh në Gjykatën Administrative të Apelit. Ai i është caktuar me short pesë gjyqtarëve, konkretisht në datat 31.05.2022, 16.03.2023, 19.09.2023, 12.01.2024 dhe 13.11.2024, për shkak të organizimit të brendshëm të punës në atë gjykatë.

35. Pavarësisht kësaj, përveç organizimit të shorteve dhe lëvizjes së çështjes nga njëri gjyqtar relator tek tjetri, nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera me çështjen. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes, duke vlerësuar se gjykata e apelit është në pamundësi objektive, për shkak të ngarkesës së madhe që ajo gjykatë ka. Gjithashtu, Gjykata vëren se referuar shkronjës "i" të pikës 3.1 të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "*Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit*", përcaktohet se çështjet që paraqesin interes publik duhet të shqyrtohen me përparësi. Gjykata e Lartë në këtë rast nuk ka arsyetuar se përse çështja e kërkueses nuk përfshihet në këtë kategori, ndonëse ajo ka parashtruar se çështja në fjalë lidhet me të drejtën e besimit fetar që ushtrohet nga një numër besimtarësh të saj.

36. Gjykata konstaton se në datën 31.05.2022, kur çështja e kërkueses është regjistruar, Gjykata Administrative e Apelit ishte nën organikën e

saj, kishte në përbërje 11 gjyqtarë nga 13 gjyqtarë gjithsej. Ndërkohë që aktualisht ajo gjykatë është me organikë të plotësuar, 13 gjyqtarë dhe në atë gjykatë janë duke u shqyrtuar çështjet e regjistruara në vitin 2018 dhe ato me përshpejtim gjykimi mbi kërkesën e palëve, ndërsa janë në pritje për shqyrtim 79 çështje të ngjashme me atë të kërkueses. Gjyqtari relator, të cilit i është caktuar për shqyrtim së fundmi çështja e kërkueses, ka për shqyrtim 2024 çështje gjyqësore, ndërkohë që nuk rezulton që ndonjë nga relatorët të ketë kryer ndonjë veprim me dosjen. Gjithashtu, për më tepër, Gjykata evidenton se kërkuesja pretendon se ka paraqitur kërkesë në datën 12.03.2021, për të cilën nuk ka marrë përgjigje nga organet publike, duke iu drejtuar më pas Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

37. Bazuar në treguesit e mësipërm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses lidhet me ngarkesën në Gjykatën Administrative të Apelit shkaktuar nga ngarkesa në atë gjykatë si pasojë edhe e zbatimit të reformës në drejtësi. Në këtë drejtim, Gjykata thekson në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa tërësore prej rreth 3 vjetësh e 9 muajsh që nga paraqitja e kërkesëpadisë, nga të cilat 2 vjet e 9 muaj në Gjykatën Administrative të Apelit dhe me rreth 1 viti e 9 muaj shkelje mbi afatin e arsyeshëm, është rrjedhojë e sjelljes së gjykatave.

38. Në lidhje me *atë çfarë rrezikon kërkuesja* në procesin gjyqësor, Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" nevojitet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkueses në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Kërkuesja e lidh interesin e saj për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit edhe me ndikimin dhe ndjeshmërinë që çështja paraqet për anëtarët e komunitetit fetar që ajo përfaqëson. Gjithashtu, kërkuesja pretendon se me lidhjen e marrëveshjes

do të mund të përfitojë edhe nga lehtësirat financiare dhe jo vetëm, që përcaktohen nga ligji nr. 10140/2009. Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë të drejtën e besimit fetar dhe individët që preken nga gjykimi i çështjes së themelit, të cilët nga kërkuesja paraqiten si komunitet, Gjykata çmon se është i rëndësishëm interesi i kërkueses që rrezikohet nga vonesa.

40. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret kohëzgjatja tërësore e shqyrtimit të çështjes së kërkueses në raport me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon ajo ka tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues. Po ashtu, Gjykata çmon se edhe vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për rrjedhojë vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit duhet të shfuqizohet. Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët dhe nuk mund të rëndojë mbi ta.

41. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 dhe duke mbajtur në konsideratë volumin e punës së Gjykatës Administrative të Apelit, numrin e çështjeve të ngjashme dhe ngarkesën e gjyqtarit relator, Gjykata çmon se duhet urdhëruar përfundimi i gjykimit të çështjes së kërkueses brenda 6 muajve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1360, datë 04.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen e kërkueses brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 04.03.2025
Shpallur më 04.04.2025

Vendim nr. 10, datë 13.03.2025
(V-10/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Dh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **DHURATA BOÇI, ELVISA BOÇI, ROSELA BOÇI,** përfaqësuar nga avokatët Oliana Andoni dhe Adriatik Lapaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

BASHKIA DIVJAKË, përfaqësuar nga nënkryetari Eris Stambolliu.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE, e përfaqësuar nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm Tomor Harizi.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT, përfaqësuar nga drejtori Ilir Proda.

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT, përfaqësuar nga sekretarja e përgjithshme Ledina Beqiraj Agalliu.

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Ledion Lako.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Valbona Legisi dhe Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1447, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 21, 42, 131, pika 1, shkronja "f", pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 71 e 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueseve, Dhurata Boçi, Elvisa Boçi dhe Rosela Boçi, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Bashkia Divjakë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (*Policia e Shtetit*), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (*MTM*), Agjencia Kombëtare e Bregdetit (*AKB*), Drejtoria e Përgjithshme Detare (*DPD)* dhe Avokatura e Shtetit, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Dhurata Boçi (kërkuesja e parë) është nëna e kërkueseve Elvisa Boçi (kërkuesja e dytë) dhe Rosela Boçi (kërkuesja e tretë). Në datën 09.07.2017 kërkuesja e parë dhe bashkëshorti i saj, njëherazi babai i dy kërkueseve të tjera, kanë shkuar në plazhin e Divjakës së bashku me kërkuesen e tretë, në atë kohë e mitur në moshën 11 vjeç. Bashkëshorti dhe kërkuesja e tretë kanë shkuar të shohin një ishull të krijuar në det, ndërsa kërkuesja e parë ka ndenjur në çadër. Pas rreth gjysmë ore kërkuesja e parë ka dëgjuar njerëzit pranë që flisnin për një person të mbytur në det dhe ka parë një autoambulancë. Kur është afruar ka parë kërkuesen e tretë që ishte e shokuar dhe bashkëshortin e pajetë.

2. Me marrjen e njoftimit për ngjarjen është krijuar grupi hetimor i Policisë Gjyqësore, që ka kryer disa veprime procedurale, si këqyrjen e kufomës, ekspertimin mjekoligjor të saj dhe marrjen e deklarimeve nga të pranishmit. Nga ekspertimi mjekoligjor i kufomës është konstatuar se kufoma kishte përmbajtje shkume në rrugët e jashtme të frymëmarrjes, dëmtime të shkaktuara nga një mjet i fortë mprehës, por shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej, pasi nuk ishte kryer autopsia mjekoligjore. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (*Prokuroria Lushnjë*) në datën 24.07.2017, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronja "ç" dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk përbënte vepër penale. Sipas Prokurorisë Lushnjë, pavarësisht se ekspertimi mjekoligjor nuk përcaktonte shkencërisht shkakun e vdekjes, duke u bazuar pjesërisht tek ekspertimi dhe deklarimet e personave të pyetur, nxirrej përfundimi se vdekja ishte aksidentale si rezultat i asfiksisë mekanike nga mbytja në det.

3. Në datën 28.05.2018 kërkueset kanë ngritur padi në gjykatë me objekt detyrimin e Bashkisë Divjakë, DPD-së, Policisë së Shtetit, MTM-së dhe AKB-së për shpërblimin e dëmit për shkak të humbjes së jetës së bashkëshortit/babait të tyre. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 325, datë 13.03.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin, ndër të tjera, se nga interpretimi i kuadrit ligjor në fuqi, institucionet shtetërore, të thirrura si palë të paditura, nuk legjitimoheshin pasivisht, pasi nuk kishin kryer ndonjë veprim të paligjshëm që të kishte ndikuar në humbjen e jetës së viktimës. Më konkretisht, sipas asaj gjykate, Bashkia Divjakë nuk kishte pajisur asnjë subjekt me leje përdorimi në plazhin e Divjakës; DPD-ja përgjigjet sipas ligjit vetëm për mjetet lundruese dhe ngjarja nuk kishte pasur lidhje me mjetet lundruese; Policia e Shtetit ishte angazhuar plotësisht nëpërmjet planeve të punës për mbarëvajtjen e sezonit turistik, ndaj nuk kishte përgjegjësi për ngjarjen; ndërsa AKB-së ligji nuk i jepte kompetenca për të caktuar roje bregdetare ose marrjen e masave të tjera. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni gjykata e shkallës së parë i është referuar edhe vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se ngjarja nuk përbënte vepër penale.

4. Ndonëse kërkueset kanë paraqitur apel, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 629 (86-2023-903), datë 21.09.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi, por duke shtuar se organet shtetërore nuk mund

të përgjigjen për dëmin jashtëkontraktor, në kushtet kur shkaku i vdekjes së viktimës nuk është përcaktuar nga akti i ekspertimit (*shih paragrafin 2 të vendimit*).

5. Kërkueset kanë paraqitur rekurs, duke parashtruar, ndër të tjera, se qëndrimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me kuadrin ligjor që rregullon kompetencat dhe detyrimet e institucioneve për sigurinë në det e në plazhe dhe se përgjegjësia e tyre nuk buron nga fakti nëse kanë dhënë ose jo leje përdorimi te subjektet private, por nga detyrimi ligjor për të marrë të gjitha masat e nevojshme që jeta dhe shëndeti i çdo qytetari të jenë të siguruar në plazhe, ndaj ato janë përgjegjëse për humbjen e jetës së familjarit të tyre. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1447, datë 08.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e tij haptazi nuk mbështeten në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

6. Në datën 01.08.2024 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 16.10.2024 Kolegji vendosi kalimin në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkueset,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë u janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit nuk ka shqyrtuar dhe nuk është shprehur për pretendimet lidhur me shkeljet e rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit. Ndonëse kërkueset kanë identifikuar përgjegjësitë ligjore të autoriteteve shtetërore për sigurinë në plazhe, Gjykata e Lartë ka legjitimuar vendimin e gjykatës së apelit, e cila ka vlerësuar se autoritetet shtetërore nuk kishin legjitimitet pasiv, duke mos respektuar nenin 15 të Kushtetutës.

7.1.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse rekursi nuk përmban shkaqe nga

ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit 49/2012. Pretendimet e kërkueseve kishin natyrë kushtetuese, ndaj Gjykata e Lartë duhet të mbante qëndrim të shprehur për to. Vendimit të gjykatës së apelit i mungon arsyetimi ligjor, duke përsëritur pa asnjë argument vendimin e shkallës së parë. Gjykata e Lartë duhet të kishte shqyrtuar çështjen në seancë e të prishte vendimin e apelit duke e rikthyer për rishqyrtim në po atë gjykatë.

7.2. *E drejta e jetës dhe e drejta për zhdëmtim në përputhje me ligjin,* të garantuara nga nenet 21 dhe 44 të Kushtetutës, sepse organet shtetërore nuk kanë marrë masat e duhura për sigurinë në plazhin e Divjakës dhe si rezultat bashkëshorti/babai i kërkueseve ka humbur jetën, ndërsa gjykatat e zakonshme nuk i kanë njohur të drejtën e shpërblimit të dëmit kërkueseve.

8. ***Subjekti i interesuar, Bashkia Divjakë,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkueseve nuk qëndrojnë, pasi dëmi nuk është shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej saj, por për pakujdesi të viktimës, që për të kaluar në pjesën tjetër të ishullit ka shmangur urën me dru dhe se nga mjekësia ligjore nuk është kryer autopsia për të vërtetuar shkakun e vdekjes.

9. ***Subjekti i interesuar, DPD-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se ajo nuk ka përgjegjësi në shkaktimin e tragjedisë, pasi ligji e ngarkon me përgjegjësi vetëm për mjetet lundruese dhe detare. Ajo nuk ka detyrë të patrullojë në zonat e plazheve për qëllime pushimi ose mjediset relaksuese. Humbja e jetës së viktimës nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë incidenti me mjet lundrues dhe zona ku ka ndodhur ngjarja nuk ka aktivitete lundrimore. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit, pasi është i qartë, i kuptueshëm dhe nuk ka përplasje mes fakteve.

10. ***Subjekti i interesuar, Policia e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar. Gjykata e Lartë ka respektuar të drejtat e kërkueseve për akses, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Vendimi i Gjykatës së Lartë, për shkak të natyrës së tij, ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit. Argumentet e dhëna janë të mjaftueshme për të mbështetur mospranimin e rekursit. Vendimi nuk përmban mangësi ose kundërthënie, si dhe nuk rezulton alogjik.

11. ***Subjekti i interesuar, MTM-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor është i

pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim të drejtë, i cili shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nuk paraqet mangësi të cilat ndikojnë negativisht në drejtim të garantimit të së drejtës, nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie ose të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm. Pretendimet nuk kanë natyrë kushtetuese, ndaj i përkasin juridiksionit gjyqësor të gjykatave të zakonshme. MTM-ja ka funksione politikëbërëse, të cilat i ka realizuar plotësisht, ndaj nuk ka përgjegjësi për humbjen e jetës së viktimës. Gjykatat e zakonshme duhet të sqaronin faktin nëse ngjarja ka ndodhur në plazh publik ose privat.

12. ***Subjekti i interesuar, AKB-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se u qëndron parashtrimeve të dhëna gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme. Institucioni është krijuar në vitin 2014 dhe nuk ka pasur kompetenca administrimi në vijën bregdetare, në plazhet publike dhe në ato private, të dhëna me qira subjekteve nga njësitë e qeverisjes vendore. Në kohën e ngjarjes vepronin disa vendime të Këshillit të Ministrave për sigurinë në plazhe, që nuk përcaktonin përgjegjësi të AKB-së, ndaj ky institucion nuk duhet të jetë palë në gjykim. Gjykatat e zakonshme duhet të sqaronin nëse personi i mbytur gjendej në plazh publik ose privat. Megjithatë, AKB-ja ka njoftuar institucionet kompetente për rëndësinë e shërbimit të sigurisë (*lifeguard*).

13. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

13.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi:

13.1.1. Gjykata e Lartë nuk ka cenuar *të drejtën e aksesit* të kërkueseve. Ajo ka kryer veprimtarinë seleksionuese dhe ka konstatuar se rekursi nuk ngrinte shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, duke vendosur mospranimin e tij. Lidhur me themelin e çështjes, kërkueset kanë marrë përgjigje shteruese nga gjykata e apelit, ndaj pretendimet e tyre nuk ngrenë problematikë kushtetuese.

13.1.2. Vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit respekton *standardin e arsyetimit të vendimit*, duke mbajtur parasysh natyrën e tij. Ai përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, pretendimet e ngritura në ankim/ rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, në të cilën i është dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim/rekurs.

13.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së jetës* nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkueset *nuk kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion* në kushtet kur ky pretendim nuk është ngritur në rekurs. Për më tepër, këtij pretendimi i është dhënë përgjigje shteruese nga gjykatat e faktit, të cilat kanë vlerësuar se institucionet shtetërore nuk kanë kryer veprime të paligjshme, si pasojë e të cilave të jetë shkaktuar vdekja e viktimës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkueset, në cilësinë e familjarëve të afërt të viktimës (bashkëshortja dhe dy fëmijët), kanë ngritur padi në gjykatat e zakonshme për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga humbja e jetës së tij, proces i cili ka përfunduar me mospranimin e rekursit të tyre nga Gjykata e Lartë. Në kushtet kur ato kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkueset justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

16. Një kriter tjetër ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sipas të cilit individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë

Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se kërkueset i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm të vënë në lëvizje prej tyre nëpërmjet padisë, ankimit dhe rekursit, duke i shteruar mjetet juridike në dispozicion nga ana formale. Për sa i takon substancës së pretendimeve, kërkueset ankohen për procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për të cilin i vetmi mjet juridik në dispozicion është ankimi kushtetues. Ndërsa në lidhje me të drejtën e jetës, duke mbajtur në konsideratë se objekti i gjykimit të zakonshëm ka të bëjë me shpërblimin e dëmit për shkak të humbjes së jetës së familjarit të tyre, Gjykata çmon se ato e kanë ngritur në substancë edhe këtë pretendim, ndaj nuk qëndron prapësimi i subjekteve të interesuara, Policisë së Shtetit dhe Avokaturës së Shtetit, se kërkueset nuk i kanë shteruar mjetet juridike.

18. Kërkueset legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 08.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 01.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkueset kanë pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar se vendimi i mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për cenimin e së drejtës së jetës së bashkëshortit/babait të tyre nga mungesa e masave të sigurisë nga institucionet publike në plazhin e Divjakës. Sipas tyre, vendimi i Gjykatës së Lartë i ka dhënë fund një procesi gjyqësor, në të cilin nuk ka marrë përgjigje pyetja se cili institucion shtetëror ishte përgjegjës për të zbatuar rregullat ligjore të sigurisë së jetës dhe shëndetit në plazh, pasi të gjitha institucionet janë vlerësuar se nuk kishin ndonjë detyrim.

20. Lidhur me të drejtën e jetës, e cila ka qenë objekti i gjykimit në gjykatat e zakonshme, Gjykata evidenton se neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj, duke vendosur në këtë mënyrë detyrime pozitive në radhë të parë për ligjvënësin që të parashikojë rregulla ligjore për mbrojtjen e jetës së individit dhe më pas për gjykatat e zakonshme, të cilat kanë përgjegjësinë e verifikimit nëse detyrimet ligjore për mbrojtjen e jetës janë përmbushur nga institucionet shtetërore të ngarkuara nga ligji. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkueseve lidhen

me procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, çmon se pretendimet në thelb kanë të bëjnë me aksesin në gjykatë dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor, si aspekte të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ky i fundit parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë (ku përfshihet edhe e drejta e jetës), nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

21. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkueset kanë parashtruar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, ndonëse pretendimet e tyre kishin të bënin me shkelje të rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e faktit, të cilat kishin rrëzuar padinë e tyre për shpërblimin e dëmit nga humbja e jetës së familjarit të tyre, me arsyetimin se autoritetet shtetërore nuk kishin asnjë përgjegjësi për të zbatuar masat për sigurinë e jetës në plazhin e Divjakës. Sipas tyre ky qëndrim bie ndesh me parimin e nenit 15 të Kushtetutës, sipas të cilit organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Në këtë mënyrë, sipas kërkueseve, ato nuk kanë marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimet e ngritura në rekurs, të cilat kishin natyrë kushtetuese, ndërsa arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk shpjegon përse ato pretendime nuk përbënin shkaqe ligjore për rekurs.

23. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se pretendimet e kërkueseve janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë, sipas ligjit, ka kryer veprimtarinë seleksionuese dhe ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk parashikoheshin nga ligji. Sipas subjekteve të interesuara, kërkueset kanë marrë përgjigje shteruese për pretendimet e tyre nga gjykatat e faktit, ndaj e drejta e aksesit në gjykatë nuk është cenuar. Po ashtu, sipas tyre, vendimi i Gjykatës së Lartë, për shkak të natyrës së tij – vendim i mospranimit të rekursit, është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit, pasi tregon pretendimet e ngritura në rekurs dhe vlerësimin me arsyetim të kufizuar që ato nuk parashikohen nga ligji si shkak për rekurs.

24. Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa

përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit ose të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimet nr. 70, datë 24.11.2016; nr. 10, datë 04.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimin nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Sipas Gjykatës, vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë*

07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Gjykata ripohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkueset kanë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin lidhur me dëmin e shkaktuar nga humbja e jetës së familjarit të tyre, për shkak të mungesës së masave të sigurisë në plazh, duke shqyrtuar nëse vendimi i mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

30. Fillimisht, Gjykata vëren se në kohën e humbjes së jetës së familjarit të kërkueseve, rregullat e sigurisë në plazhe parashikoheshin nga VKM-ja nr. 321, datë 28.05.2014 "Për sigurinë në det, plazhe, ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", e ndryshuar (*VKM-ja nr. 321/2014*). Kjo VKM, e miratuar në bazë të disa ligjeve që lidhen me kufirin shtetëror, detar, mjetet lundruese, qeverisjen vendore, mjedisin dhe turizmin, përcakton rregullat minimale dhe të detajuara, të zbatueshme gjatë periudhës së sezonit turistik 15 maj - 15 tetor, edhe për sa i përket sigurisë në plazhe, përfshirë edhe bregdetin, duke i ndarë zonat në plazhe publike (zona të hapura për përdorim publik dhe që ofrojnë mjete minimale për përdorim me kushtet e sigurisë dhe higjienës) dhe stacione plazhi, këto të fundit si struktura veprimtarie private nga personat fizikë ose juridikë. Pavarësisht ndarjes së zonave të plazhit, në publike dhe private, VKM-ja nr. 321/2014 përcakton se në çdo zonë ka një minimum masash sigurie, që lidhen me kufizimin e shënjuar të distancave të lejuara nga bregu, shenjat për lejimin ose jo të notimit, shenjat për plazhet e autorizuara ose jo, përfshirë ato për pasigurinë në notim në plazhet e pautorizuara, ofrimin

e shërbimit nga vrojtuesit e trajnuar dhe pajisjen e tyre me materialet përkatëse, krahas vendosjes së kullave të vrojtimit.

31. Gjithashtu, në këtë VKM janë detajuar edhe përgjegjësitë e organeve shtetërore (subjekteve të interesuara), sipas hapësirës së kompetencave ligjore të tyre, me qëllim garantimin e kushteve të sigurisë në plazhe, në zonat çlodhëse edhe në bregdet. Këto përgjegjësi përfshijnë identifikimin e zonave të përshtatshme si zona çlodhëse, të konsideruara të sigurta dhe të shëndetshme për njerëzit, menaxhimin dhe administrimin e tyre, si dhe kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të kushteve të sigurisë. Me fjalë të tjera, përgjegjësitë kanë të bëjnë me marrjen e masave dhe vendosjen e pajisjeve që synojnë uljen e rrezikut ndaj jetës së personave, të cilët ushtrojnë aktivitete çlodhëse në zona bregdetare të autorizuara.

32. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se familjari i kërkueseve ka humbur jetën ndërsa ishte duke notuar në plazhin e Divjakës, ngjarje për të cilën Prokuroria Lushnjë ka arritur në përfundimin se ishte aksidentale, e shkaktuar nga asfiksia mekanike si rezultat i mbytjes në det. Mbi bazën e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në të cilin përcaktohej se shkaku i humbjes së jetës së viktimës ishte mbytja në det, kërkueset kanë ngritur padi në gjykatat administrative, duke kërkuar shpërblimin e dëmit, me pretendimin se organet shtetërore nuk kishin marrë masat për sigurinë e jetës në plazhin e Divjakës, të parashikuara nga VKM-ja nr. 321/2014.

33. Nën dritën e standardeve kushtetuese dhe në kontekstin e rrethanave specifike të rastit konkret, Gjykata konstaton se kërkueset i janë drejtuar gjykatave të zakonshme duke paraqitur pretendimin për shpërblimin e dëmit që lidhej me humbjen e jetës së familjarit të tyre, si rezultat i mosveprimit të paligjshëm të organeve shtetërore për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit në plazh, sipas tyre në një zonë plazhi publik, pretendim i cili është me natyrë kushtetuese, sepse lidhet me të drejtën e jetës të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i *KEDNJ*-së. Konkretisht, pretendimi i kërkueseve lidhet me detyrimin pozitiv të shtetit për të marrë masat e nevojshme për të përcaktuar faktet dhe përgjegjësinë e personave përgjegjës, si dhe për t'i ofruar dëmshpërblimin e duhur viktimës në rastin kur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit ka ardhur si rezultat i neglizhencës së shtetit (*shih Sinim kundër Turqisë, datë 06.06.2017, § 59*). Për më tepër, detyrimi pozitiv i shtetit jo vetëm duhet të ekzistojë në teori, por duhet të zbatohet edhe në praktikë (*shih Sarishvili-Bolkvadze kundër Gjeorgjisë, datë 19.07.2018, § 90)*.

34. Në vijim, Gjykata vëren se gjykatat e faktit nuk e kanë marrë në shqyrtim themelin e pretendimit të kërkueseve, duke arsyetuar se asnjë prej organeve publike të thirrura në gjykim nuk kishte përgjegjësi ligjore për ruajtjen e sigurisë së jetës në plazhin publik të Divjakës. Ato nuk rezulton të kenë verifikuar dhe përcaktuar fillimisht faktet që qëndronin në themel të mosmarrëveshjes, lidhur me zonën ku ka humbur jetën familjari i kërkueseve dhe shkakun e vdekjes së tij, për të shqyrtuar në vijim, mbi këtë bazë faktesh, nëse ishin të zbatueshme detyrimet ligjore për masat e sigurisë dhe shëndetit në plazh, si dhe nëse ndonjë organ shtetëror kishte përgjegjësinë për zbatimin dhe për kontrollin e zbatimit të tyre nën dritën e kuadrit ligjor që rregullon masat e sigurisë në plazhe. Pavarësisht se, nga njëra anë, prokurori në vendimin për mosfillimin e procedimit penal tërthorazi ka pranuar se vdekja e familjarit të kërkueseve ka ndodhur në një zonë plazhi dhe, nga ana tjetër, neni 36 i ligjit nr. 49/2012, kur kundërshtohet mosveprimi administrativ, ia kalon barrën e provës organit publik, gjykatat e faktit kanë arsyetuar në mënyrë standarde se barra e provës i përket kërkueseve, në cilësinë e paditëseve. Për rrjedhojë, ato kanë interpretuar në mënyrë formale dhe *strictu sensu* kuadrin ligjor, interpretim që nuk ka marrë në konsideratë qëllimin e ligjit dhe, si pasojë, gjykatat kanë nxjerrë përfundimin se rregullat e sigurisë së jetës janë të zbatueshme vetëm në strukturat private të plazhit dhe se organet shtetërore në këto raste janë të përjashtuara *apriori* nga përgjegjësia. Ky interpretim i ngushtë i ligjit nga gjykatat e faktit duket se ka cenuar thelbin e së drejtës së jetës dhe kjo shkelje nuk rezulton të jetë korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila ndonëse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji. Në këtë mënyrë, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar të drejtat e aksesit në gjykim dhe të ankimit efektiv të kërkueseve.

35. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në

drejtim të pretendimit të kërkueseve që interpretimi i kuadrit ligjor nga gjykatat e faktit mohonte thelbin e së drejtës së jetës, për sa u takon detyrimeve pozitive të shtetit. Mospranimi i rekursit të kërkueseve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkueseve.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueseve duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1447, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 13.03.2025
Shpallur më 10.04.2025

Vendim nr. 11, datë 13.03.2025
(V-11/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ILIR PAJA,** përfaqësuar nga avokat Ardian Visha, me akt përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Arqile Koca, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 370 akti, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1340 (30-2023-4400), datë 28.07.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-184, datë 06.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Pezullimi i vendimit nr. 370 akti, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe lirimi i menjëhershëm nga vuajtja e dënimit i kërkuesit deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 34, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijues, 45 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë**

10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 514, pika 1, shkronja "dh", i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*);

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë *(Prokuroria për Krimet e Rënda)* ka regjistruar procedimin penal nr. 28 të vitit 2008 në ngarkim të kërkuesit për kryerjen e veprave penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 79/c e 22 dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*), që lidhet me ngjarjet e datës 06.03.2008, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vijim të procesit penal, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 6 vjet e 8 muaj burgim për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 88, paragrafi i parë dhe 278, paragrafi i dytë, të KP-së, me vendimin nr. 23, datë 06.04.2010, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

2. Rezulton gjithashtu, se gjatë hetimeve paraprake të këtij procedimi penal janë administruar edhe akte të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 55/6, datë 06.03.2008, të cilat lidheshin me letërporosinë e autoriteteve të drejtësisë italiane me objekt kallëzimin e fakteve kriminale të konsumuara në Itali, nga kërkuesi, letërporosi së cilës i ishte dhënë rrugë nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë me shkresën nr. 1679/1 prot. OTH, datë 05.03.2008. Sipas akteve të dërguara nga autoritetet

e drejtësisë italiane, në atë shtet ndaj kërkuesit është regjistruar procedimi penal nr. 34416 i vitit 2006, R.G.N.R. Lidhur me faktet e kallëzuara për kryerjen nga kërkuesi të veprave penale në territorin e shtetit italian, Prokuroria për Krimet e Rënda ka vendosur ndarjen e çështjes, duke regjistruar për këto të fundit një procedim penal të ri me nr. 28/1 të vitit 2008.

3. Procedimi penal nr. 28/1 i vitit 2008, fillimisht është pushuar, ndërsa autoritetet e drejtësisë italiane nuk kanë ekzekutuar letërporosinë për dërgimin e akteve procedurale me vlerë provuese në lidhje me faktet e kallëzuara për kryerjen nga kërkuesi të veprave penale në territorin e shtetit italian. Në vijim, pas dërgimit të akteve të kërkuara, hetimi për këtë procedim penal ka rifilluar dhe kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, për kryerjen e veprave penale: *(1)* "Vrasja me dashje", të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit ekuadorian Ramires Saca Louis Gonzalo, të parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të KP-së; *(2)* "Vrasja me dashje", të kryer në bashkëpunim dhe mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit tjetër ekuadorian Orellana Calle Jose Enrique, të parashikuar nga nenet 76, 25 e 22 të KP-së; *(3)* "Rrëmbimi dhe mbajtja peng", i shtetases rumune Lascar Nina Alexandra, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së; *(4)* "Plagosja e lehtë me dashje", të kryer në bashkëpunim, në dëm të po asaj shtetaseje, të parashikuar nga nenet 89 e 25 të KP-së; *(5)* "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura", në dëm të po asaj shtetase, të parashikuar nga neni 102, paragrafi i parë, i KP-së; *(6)* "Mbajtja pa leje e armëve luftarake", më tepër se një herë dhe në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së; *(7)* "Mbajtja pa leje e municioneve luftarake", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i tretë, i KP-së. Kërkuesi është dërguar për gjykim me këto akuza. Gjatë gjykimit të çështjes, organi i prokurorisë ka ndryshuar cilësimin juridik për dy veprat e para penale, duke e akuzuar kërkuesin për veprën penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", të kryer në bashkëpunim, kundër dy ose më shumë personave, të parashikuar nga nenet 79, shkronja "dh" dhe 25 të KP-së. Kurse për veprën penale "Plagosja e lehtë me dashje", organi i prokurorisë ka kërkuar pushimin e akuzës për shkak të amnistisë së kësaj vepre sipas nenit 5 të ligjit nr. 9678, datë 13.01.2007 "Për dhënie amnistie".

4. Në përfundim të gjykimit në lidhje me akuzat e mësipërme, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 51, datë 10.10.2011 (*vendimi nr. 51/2011*), ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin

për kryerjen e veprave penale: *(1)* "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", të kryer në bashkëpunim, kundër dy ose më shumë personave, të parashikuar nga nenet 79, shkronja "dh" dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim; *(2)* "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim dhe 3,000,000 lekë gjobë; *(3)* "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura", të parashikuar nga neni 102, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim; *(4)* "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55 të KP-së, gjykata e ka dënuar kërkuesin me 23 vjet burgim e 3,000,000 lekë gjobë dhe përfundimisht, në aplikim edhe të nenit 406, pika 1, të KPP-së, ka vendosur dënimin e tij me 15 vjet e 4 muaj burgim dhe 2,000,000 lekë gjobë. Në lidhje me akuzat për veprat penale "Plagosja e lehtë me dashje" në dëm të shtetases rumune, të parashikuar nga nenet 89 e 25 të KP-së dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i tretë, i KP-së, ajo gjykatë ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të amnistisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 20.10.2011, pasi ndaj tij nuk është bërë ankim.

5. Rezulton se me vendimin nr. 58, datë 04.10.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është vendosur bashkimi i dënimit prej 15 vjetësh e 4 muajsh burgim të dhënë për kërkuesin me vendimin nr. 51/2011, me dënimin tjetër prej 6 vjetësh e 8 muajsh burgim, të dhënë me vendimin nr. 23, datë 06.04.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (shih paragrafin 1), duke iu caktuar një dënim i vetëm prej 17 vjetësh burgim dhe 2.000.000 lekë gjobë, si dhe duke përcaktuar si datë të fillimit të vuajtjes së dënimit atë të arrestimit, datën 06.03.2008. Po kështu, rezulton se me vendimin nr. 65 akti, datë 06.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe akteve të dala në zbatim të tij, ndaj kërkuesit është aplikuar dënimi alternativ "Qëndrimi në shtëpi", për pjesën e mbetur të dënimit prej një viti, tetë muajsh e nëntë ditëve burgim, duke u liruar menjëherë nga burgimi.

6. Nga ana tjetër, rezulton, gjithashtu, se autoritetet e drejtësisë italiane kanë vijuar procedimin penal (nr. 34416/2006) ndaj kërkuesit, për faktet penale të ngjara në territorin e shtetit italian dhe, në përfundim të procesit gjyqësor, me vendimin penal nr. 1/2021, datë 18.01.2021 të Gjykatës së Asizit Milano - Seksioni i parë (*vendimi i gjykatës italiane*), konfirmuar me

vendimin nr. 47/2021, datë 24.11.2021 të Gjykatës së Asizit të Apelit Milano (hedhur poshtë rekursi me vendimin nr. 2218/2022 regjistri i përgjithshëm, datë 24.06.2022 të Gjykatës së Kasacionit), ai është dënuar me 25 vjet e 4 muaj burgim për kryerjen e veprave penale: *(1)* "Vrasja me dashje", në dëm të shtetasit ekuadorian Ramires Saca Louis Gonzalo; *(2)* "Vrasja me dashje e mbetur në tentativë", në dëm të shtetasit tjetër ekuadorian Orellana Calle Jose Enrique; *(3)* "Rrëmbimi i personit", në dëm të shtetases rumune Lascar Nina Alexandra; *(4)* "Marrëdhënie seksuale me dhunë", në dëm të po asaj shtetase; *(5)* "Armëmbajtja pa leje", të parashikuara nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal italian. Për sa i përket akuzës për mbajtjen në shtëpi dhe sjelljen në vende publike të një pistolete gjysmë automatike të kalibrit 7.65, me numër serie 32496, model Browing 10/22, të pajisur me silenciator, kërkuesi është deklaruar i pafajshëm nga gjykata italiane, për shkak se nuk e kishte kryer faktin penal.

7. Për ekzekutimin e dënimit të dhënë me vendimin e gjykatës italiane kërkuesi është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma Itali dhe në datën 03.11.2022, ora 21:30, sipas procesverbalit të mbajtur nga oficerët e Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, ai është arrestuar me qëllim ekstradimin e tij për këtë shkak. Në bazë të kërkesës së organit të prokurorisë, me vendimin nr. 2324 regj., them., datë 05.11.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në burg" për qëllime ekstradimi. Procedura e ekstradimit të kërkuesit nuk ka vijuar, pasi autoritetet e drejtësisë italiane kanë dërguar kërkesë për "Njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal italian në ngarkim të shtetasit shqiptar Ilir Paja".

8. Kërkesa e autoriteteve të drejtësisë italiane, me shkresën nr. 3580/9 prot., datë 23.11.2022 të ministrit të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila në vijim ia ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit ka paraqitur në gjykatë kërkesë për njohjen e vendimit të gjykatës italiane të dhënë ndaj kërkuesit.

9. Fillimisht, me kërkesë të organit të prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1010 regj., them., datë 03.12.2022, ka vendosur revokimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" të dhënë ndaj kërkuesit për qëllime ekstradimi dhe caktimin e po së njëjtës masë sigurimi për efekt të njohjes dhe ekzekutimit në Shqipëri të vendimit penal të huaj në ngarkim të tij (vendimit të gjykatës italiane).

10. Gjatë shqyrtimit të çështjes kërkuesi e ka kundërshtuar kërkesën e

prokurorisë për njohjen e vendimit penal të gjykatës italiane, me pretendimin se për të njëjtat fakte penale për të cilat është dënuar me vendimin penal të huaj që kërkohet të njihet, ai është dënuar edhe me vendimin nr. 51/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, dënim të cilin, sipas tij, e ka kryer tashmë. Për rrjedhojë, ai ka pretenduar se bazuar në nenin 514 të KPP-së, ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) vendimi i gjykatës italiane nuk duhet të njihet dhe ai duhet të lirohet menjëherë nga paraburgimi.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 370 akti, datë 28.03.2023, ka pranuar kërkesën e prokurorisë për njohjen e vendimit të gjykatës italiane, duke caktuar për kërkuesin dënimin: *(1)* me 20 vjet burgim për kryerjen e veprës penale "Vrasja me dashje", në dëm të shtetasit ekuadorian Ramires Saca Luois Gonzales, të parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të KP-së; *(2)* me 20 vjet burgim për kryerjen e veprës penale "Vrasja me dashje", e mbetur në tentativë, në bashkëpunim, në dëm të shtetasit tjetër ekuadorian Orellana Calle Jose Enrique, të parashikuar nga nenet 76, 22 e 25 të KP-së; *(3)* me 12 vjet burgim për kryerjen e veprës penale "Rrëmbim ose mbajtje peng personi", në bashkëpunim, në dëm të shtetases rumune Lascar Nina Alexandra, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së; *(4)* me 4 vjet burgim për kryerjen e veprës penale "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura" në bashkëpunim, në dëm të së njëjtës shtetase rumune, të parashikuar nga neni 102, paragrafi i dytë, i KP-së; *(5)* me 3 vjet burgim për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, ajo gjykatë e ka dënuar përfundimisht kërkuesin me 25 vjet dhe 4 muaj burgim. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit, ajo gjykatë ka arsyetuar se ai është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 51/2011 për akuza të ngjashme, por jo të njëjta dhe po ashtu, bazuar në arsyetimin e vendimit të gjykatës italiane, të përkthyer zyrtarisht, konstatohet se veprat penale për të cilat është dënuar me vendimin penal të huaj kanë kualifikim të ndryshëm ligjor nga ato për të cilat është dënuar nga gjykata shqiptare. Po sipas asaj gjykate, referuar përmbajtjes së vendimit penal të gjykatës italiane, rezulton se faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të tij nuk janë të njëjta me ato të gjykuara në shtetin shqiptar me vendimin nr. 51/2011. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

12. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1340 (30-2023-4400), datë 28.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 370 akti, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi është gjykuar në juridiksione të ndryshme për vepra të ndryshme penale, ndërkohë që referuar vendimit penal të gjykatës italiane, vendimi i dënimit në shtetin shqiptar nuk përbën shkak për mosvazhdimin e gjykimit të çështjes të filluar në shtetin italian. Gjykata e apelit, në të njëjtën mënyrë si ajo e shkallës së parë, ka vlerësuar se kërkuesi është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për akuza të ngjashme, por jo të njëjta me ato për të cilat është dënuar me vendimin penal të gjykatës italiane dhe se faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të atij vendimi nuk janë të njëjta me ato të gjykuara në shtetin shqiptar me vendimin nr. 51/2011. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka bërë rekurs kërkuesi, duke pretenduar se me vendimin penal të gjykatës italiane ai është dënuar për kryerjen e të njëjtave fakte penale për të cilat është dënuar me vendimin nr. 51/2011 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ndaj njohja e atij vendimi penal të huaj përbën cenim të parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*).

13. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-184, datë 06.02.2024, mbështetur në nenet 433 dhe 441 të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat i kanë argumentuar vendimet në përputhje me faktin dhe ligjin dhe vendimmarrja e tyre nuk ka vend për t'u cenuar. Sipas atij kolegji, veprat penale për të cilat është dënuar kërkuesi me vendimin e gjykatës italiane kanë kualifikim të ndryshëm ligjor nga veprat penale për cilat është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 51/2011 dhe faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të vendimit të gjykatës italiane (ku bëhet fjalë për dëmtimet ndaj shtetases rumune Nina Lascar) nuk janë të njëjta me ato të gjykuara më parë nga gjykata shqiptare.

14. Në datën 11.06.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.07.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 18.09.2024 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 05.11.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po në këtë datë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka

marrë në shqyrtim edhe kërkesën e kërkuesit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 370 akti, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në kuptim të përmbajtjes së nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000 ka vendosur shqyrtimin e saj në seancë plenare.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se është cenuar parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*), pasi:

15.1. Vendimi penal i gjykatës italiane, i njohur nga gjykatat shqiptare me vendimet objekt kërkese, e ka dënuar kërkuesin për të njëjtat fakte penale të kryera në vitin 2006 në Itali, për të cilat ai është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me vendimin nr. 51/2011, dënim të cilin e ka shlyer tashmë. Gjykatat e kanë njohur vendimin penal të gjykatës italiane në kundërshtim me nenin 514, pika 1, shkronja "dh", të KPP-së. Në gjykimin e themelit të çështjes penale, për akuzat në kuadër të procedimit penal nr. 28/1 të vitit 2008, prokuroria, pas kalimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit në seancë gjyqësore, ka kërkuar përpara gjykatës ndryshimin e cilësimit juridik të veprave penale "Vrasja me dashje", të kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit Ramires Saca Louis Gonzalo dhe "Vrasja me dashje", të kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit Orellana Calle Jose Enrique, në atë "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", të kryer në bashkëpunim, kundër dy ose më shumë personave. Veprat dhe faktet penale për të cilat është dënuar kërkuesi nga gjykatat e të dyja shteteve janë të njëjta, edhe pse përpara gjykatës organi i akuzës ka kërkuar rikualifikim të këtyre veprave penale.

15.2. Kualifikimi i ndryshëm i të njëjtit fakt penal, nuk justifikon cenimin e parimit *ne bis in idem*. Interpretimi që gjykatat i kanë bërë këtij parimi, në kuadër të procesit gjyqësor për njohjen e vendimit penal të huaj, përbën precedent të rrezikshëm për sigurinë juridike, pasi të njëjtit fakt gjykatat mund t'i japin kualifikim të ndryshëm, duke e dënuar kështu dy herë të njëjtin subjekt. Faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të vendimit të gjykatës italiane

(që bëjnë fjalë për dëmtimet e shtetases rumune Nina Lascar), nuk mund të kualifikohen si vrasje me paramendim. Gjykata italiane e ka kualifikuar këtë fakt si "Rrëmbim ose mbajtje peng të personit", në bashkëpunim dhe "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura", në bashkëpunim. Gjykatat shqiptare kanë veçuar një fakt penal, të cilin nuk e kanë përfshirë në vendimin e njohjes dhe pikërisht këtë fakt e përdorin për të justifikuar dënimin e dyfishtë të kërkuesit.

16. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. Në arsyetimin e tyre gjykatat kanë gabuar në lidhje me "faktin penal" (përmendur si "vepra penale"), i cili parashikohet nga nenet 7 dhe 514, pika 1, shkronja "dh", të KPP-së, dhe njësimin e kualifikimit ligjor të atij fakti penal në rastin e kërkuesit. Referuar akteve dhe vendimeve gjyqësore rezulton se faktet penale të vrasjes së shtetasit Louis Gonzalo Saca Ramires dhe vrasjes së mbetur në tentativë të shtetasit Orelana Calle janë gjykuar me vendim të formës së prerë edhe nga juridiksioni shqiptar, por janë përfshirë në figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 79, shkronja "dh", i KP-së "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", ndërkohë që nga juridiksioni italian janë kualifikuar si dy figura veprash penale më vete. Për këtë arsye është cenuar parimi *ne bis in idem.*

16.2. Edhe në lidhje me qëndrimin se faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të vendimit penal të gjykatës italiane (dëmtimi i shtetases rumune Nina Lascar) nuk janë të njëjta me ato të gjykuara me vendimin nr. 51/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, arsyetimi i gjykatave nuk është shterues, duke cenuar të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Nga gjykatat nuk është arsyetuar se çfarë faktesh janë vendosur në secilin vendim në raport me dëmtimet e shkaktuara asaj shtetase, ku është ndryshimi i fakteve mes tyre, sikurse dhe mënyra e ndikimit në vendimmarrje. Gjykatat nuk kanë bërë asnjë analizë për faktet e tjera penale, si ai i rrëmbimit, marrëdhënies seksuale me dhunë ose armëmbajtjes pa leje. Për rrjedhojë, kërkuesit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

19. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 06.02.2024, i cili i është njoftuar mbrojtësit të tij në adresën elektronike në datën 18.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

21. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*), për shkak se gjykatat shqiptare

kanë njohur vendimin e gjykatës italiane edhe pse kërkuesi ishte dënuar më parë, për të njëjtat fakte, nga gjykatat shqiptare, dënim të cilin, sipas tij, e ka kryer tashmë. Për rrjedhojë, ky pretendim, duke qenë me natyrë kushtetuese, do të merret në vijim në shqyrtim nga Gjykata në drejtim të bazueshmërisë së tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (ne bis in idem).

22. Kërkuesi ka pretenduar se me vendimin e gjykatës italiane, të njohur nga gjykatat shqiptare me vendimet objekt të ankimit kushtetues, ai është dënuar për disa fakte penale të kryera në vitin 2006 në Itali, për të cilat ai është dënuar më parë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me vendimin nr. 51/2011, dënim të cilin ai e ka shlyer. Sipas kërkuesit, njohja e vendimit penal të gjykatës italiane nga gjykatat shqiptare është bërë në kundërshtim me nenin 514, pika 1, shkronja "dh", të KPP-së, duke sjellë si pasojë dënimin e tij sërish për të njëjtat vepra penale për të cilat ai është dënuar më parë me vendim të formës së prerë të gjykatës shqiptare.

23. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, kërkuesit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor. Sipas këtij subjekti, pretendimi i kërkuesit është i bazuar, pasi faktet penale të vrasjes së shtetasve ekuadorianë janë gjykuar me vendim të formës së prerë edhe nga juridiksioni shqiptar, të përfshira në figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 79, shkronja "dh", i KP-së, ndërkohë që nga gjykata italiane janë kualifikuar si dy figura veprash penale më vete. Sipas tij, në lidhje me dëmtimet e shtetases rumune, arsyetimi i gjykatave nuk është shterues, pasi nuk është arsyetuar se çfarë faktesh janë vendosur në secilin vendim në raport me këtë fakt penal, ku është ndryshimi i këtyre fakteve mes tyre, sikurse edhe mënyra e ndikimit në vendimmarrje. Prokuroria e Përgjithshme ka parashtruar se nga gjykatat nuk është bërë asnjë analizë për faktet e tjera penale, si ai i rrëmbimit, marrëdhënies seksuale me dhunë ose armëmbajtjes pa leje.

24. Sipas nenit 34 të Kushtetutës "*askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj*". Gjykata ka pohuar se *ratio* i kësaj dispozite kushtetuese është sanksionimi i parimit "*të mosgjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale*" (*ne bis*

in idem) dhe parimit të "*gjësë së gjykuar*" (*res judicata*), të cilat vijnë si garanci në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të individit në fushën penale (*shih vendimet nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 1, datë 26.01.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi *ne bis in idem* parashikon se askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim përfundimtar, pra për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. *Kriteri "e njëjta vepër*" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepre penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Në këtë kuptim, Gjykata ka pohuar se nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Ky parim është sanksionuar edhe në nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti. Në zbatim të këtij parimi, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur shkelje të parimit *ne bis in idem* kur faktet që kishin qenë në zanafillë të të dyja procedimeve penale ndaj kërkuesit ishin, në thelb, të njëjta (*shih Ruotsalainen kundër Finlandës, datë 16 qershor 2009, §§ 50-57*). Po ashtu, ajo ka gjetur shkelje edhe kur dy vendime penale që kanë dënuar kërkuesin kishin të bënin saktësisht me të njëjtat ngjarje dhe faktet që përbënin veprën penale më të lehtë për të cilën ishte dënuar kërkuesi ishin, në thelb, të njëjta me ato që përbënin veprën penale më të rëndë, për të cilën ai ishte dënuar përsëri, duke gjetur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së (*shih Maresti kundër Kroacisë, datë 25 qershor 2009, §§ 63-64*).

26. Po ashtu, Gjykata konstaton se parimi *ne bis in idem* është parashikuar edhe në nenin 7 të KPP-së, sipas të cilit askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëjtin fakt penal për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente. Ky parim parashikohet edhe në procedurën e njohjes së vendimeve penale të huaja të rregulluar nga nenet 512-518 të KPP-së, ku neni 514 parashikon si kusht ndalues atë që për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person në shtetin shqiptar të mos jetë dhënë një vendim i formës së prerë ose të zhvillohet një procedim penal (pika 1, shkronja "dh").

27. Për sa më sipër, Gjykata, në kuptim të parimit *ne bis in idem* dhe elementeve të tij, do të verifikojë fillimisht nëse njohja e vendimit të gjykatës italiane nga gjykatat shqiptare ka sjellë praktikisht dënimin e kërkuesit edhe një herë për të njëjtat fakte penale të kryera në territorin e atij shteti, për të cilat ai ishte dënuar më parë me vendim të gjykatës shqiptare (vendimi nr. 51/2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda), pavarësisht cilësimit ligjor të tyre. Në varësi të përfundimit të kësaj analize, Gjykata do të vlerësojë më tej se si zbatohet ky parim, në kuptim të së drejtës së brendshme, në rastin kur vendimi tjetër penal i dënimit që pretendohet se është dhënë për të njëjtat fakte penale i përket një juridiksioni gjyqësor i huaj. Në situatën që parashikimi i nenit 514, pika 1, shkronja "dh", të KPP-së vjen në zbatim të këtij parimi, Gjykata do të verifikojë, duke iu referuar arsyetimit të gjykatave të zakonshme, mënyrën se si ato kanë interpretuar dhe zbatuar këtë dispozitë procedurale penale gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje të vendimit penal të huaj. Po ashtu, Gjykata do të verifikojë, në drejtim të parimit të subsidiaritetit, nëse Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj për kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata, referuar fakteve me natyrë kushtetuese që kanë rëndësi për këtë gjykim dhe përmbajtjes së vendimit të gjykatës italiane, vëren se kërkuesi është dënuar nga gjykata italiane për kryerjen e veprave penale: *(1)* "Vrasja me dashje", ndaj shtetasit ekuadorian Ramires Saca Louis Gonzalo; *(2)* "Vrasja me dashje e mbetur në tentativë", në dëm të shtetasit tjetër ekuadorian Orellana Calle Jose Enrique, ngjarje këto të ndodhura në Bresso-Milano, rruga "Don Vercesi", në afërsi të parkut Nord, rreth orës 22:00 të datës 02.09.2006; *(3)* "Rrëmbimi i personit", në dëm të shtetases rumune Laskar Nina Alexandra, ngjarje e ndodhur në Lacchiarella dhe Buscate-Milano, duke nisur nga ora 02:30 e datës 03.09.2006 deri në orën 14:30 të datës 04.09.2006; *(4)* "Marrëdhënie seksuale me dhunë", në dëm të së njëjtës shtetase rumune, ngjarje e ndodhur në Milano në datat 03.09.2006 dhe 04.09.2006; *(5)* "Armëmbajtja pa leje", ngjarje e ndodhur në Bresso-Milano në datën 02.09.2006 dhe në Buscate-Milano në datën 04.09.2006.

29. Për sa u përket fakteve penale për të cilat kërkuesi është dënuar nga

gjykata shqiptare me vendimin nr. 51/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezulton se ajo gjykatë në lidhje me: *(1)* veprën penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", të kryer në bashkëpunim, kundër dy ose më shumë personave, në dëm të shtetasve ekuadorianë Ramires Saca Louis Gonzalo dhe Orellana Calle Jose Enrique, i referohet ngjarjes së ndodhur në rrugën "Don Vercesi", në Bresco-Milano, në afërsi të parkut Nord, rreth orës 22:00 të datës 02.09.2006; *(2)* veprat penale "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit", të kryer në bashkëpunim; *(3)* veprën penale "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura", në dëm të shtetases rumune Lascar Nina Alexandra, u referohet ngjarjeve të ndodhura në Lacchiarela dhe Buscate-Milano, nga ora 02:30 e datës 03.09.2006 deri në orën 14:40 të datës 04.09.2006; *(4)* veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", u referohet ngjarjeve të ndodhura në Bresso-Milano në datën 02.09.2006 dhe në Buscate-Milano në datën 04.09.2006.

30. Gjykata, bazuar në sa më sipër, konstaton se disa nga veprat penale, për të cilat kërkuesi është dënuar si me vendimin nr. 51/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ashtu edhe me vendimin penal të gjykatës italiane, të njohur me vendimet gjyqësore objekt kërkese, u referohen të njëjtave fakte penale të ndodhura në territorin e shtetit italian dhe kanë të bëjnë me të njëjtat veprime konkrete të dënueshme penalisht, pavarësisht kualifikimit të ndryshëm ligjor të tyre nga organet gjyqësore të shteteve në fjalë. Për rrjedhojë, për sa kohë ndodhemi përpara të njëjtave fakteve penale, që kanë të bëjnë me të njëjtat ngjarje kriminale dhe veprime të paligjshme, për të cilat kërkuesi është dënuar si nga gjykata shqiptare, ashtu dhe nga gjykata italiane, konsiderohet se në rastin konkret janë të pranishme elementet e parimit *ne bis in idem.*

31. Megjithatë, Gjykata vëren se këto dy vendime gjyqësore të formës së prerë janë dhënë nga dy juridiksioneve të ndryshme penale, ndërkohë që si neni 34 i Kushtetutës ashtu edhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së parashikojnë veprimin e këtij parimi kur individi dënohet penalisht nga gjykatat e të njëjtit juridiksion. Gjykata, bazuar në faktet me natyrë kushtetuese që rezultojnë nga aktet bashkëlidhur kërkesës dhe ato të dosjes gjyqësore, konstaton se kërkuesi, pas lirimit nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me burgim të dhënë me vendimin e gjykatës shqiptare, është arrestuar nga autoritetet shqiptare fillimisht për qëllime ekstradimi në shtetin italian dhe më pas për qëllime të njohjes së vendimit penal të huaj, dhe vijon të jetë i burgosur tashmë për vuajtjen e dënimit të caktuar

sipas vendimit të njohjes së vendimit penal të gjykatës italiane. Referuar përmbajtjes së nenit 516 të KPP-së, përmes njohjes së vendimit penal të huaj ky i fundit bëhet i ekzekutueshëm në rendin e brendshëm dhe sjell efekte në drejtim të ekzekutimit të masës së dënimit të dhënë nga gjykata e huaj. Për rrjedhojë, është pikërisht vendimi i gjykatës shqiptare ai që e bën efektiv dhe praktikisht të detyrueshëm për zbatim vendimin e gjykatës së huaj në Shqipëri, duke prodhuar pasojat penale ndaj kërkuesit. Në këtë kuptim, vendimi i gjykatës së huaj vleftësohet me vendim të gjykatës shqiptare dhe për nga efektet konsiderohet sikur është dhënë nga gjykatat shqiptare. Referuar përmbajtjes së dispozitave procedurale penale, në kuadër të njohjes së vendimit penal të huaj, gjykata ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e disa kritereve, përfshirë edhe atë të parashikuar nga shkronja "dh" e pikës 1 të nenit 514 të KPP-së, që ndalon njohjen e vendimit penal të gjykatës së huaj kur për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë. Për rrjedhojë, edhe qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e një ndalimi të tillë duket se ka qenë ai për të mos lejuar ekzekutimin në vendin tonë të një vendimi penal të huaj nëse ai bën fjalë për të njëjtat veprime ose fakte penale. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se zbatimi i parimit *ne bis in idem* duket se nuk përjashtohet edhe në rastet kur bëhet fjalë për njohjen e vendimeve penale të huaja. Qëllimi i këtij parimi është pengimi i ndjekjes penale dhe i gjykimit të dyfishtë në të njëjtin juridiksion dhe mbrojtja e sigurisë juridike. Në këtë drejtim vlen të theksohet se vendimi i njohjes së një vendimi penal të huaj nuk është vendim penal i ri. Ai ka natyrë deklarative, konfirmuese dhe ekzekutuese, ndërsa konkretizon pasojat reale penale ndaj personit. Megjithatë, në rastin kur në një shtet ekziston një vendim penal i formës së prerë (përfundimtar) për të njëjtin fakt penal, njohja nga ai shtet i një vendimi penal të huaj shndërrohet në të vërtetë në një gjykim të dyfishtë pikërisht nga pasojat reale që prodhon vendimi i njohjes, ndërsa për shkak të këtij vendimi i dënuari përballet me të njëjtat pasoja si në rastin e një dënimi të ri. Në këtë kuptim, njohja e vendimit penal të huaj në një situatë të tillë do të çonte në mbivendosje të autoriteteve penale, për pasojë edhe në gjykim të dyfishtë dhe pasiguri juridike të personit.

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 514, pika 1, shkronja "dh", të KPP-së, në këndvështrim të parimit *ne bis in idem*, gjykatat e shkallës së parë dhe e apelit kanë vlerësuar se kërkuesi është gjykuar në juridiksione të ndryshme për vepra të

ndryshme penale, ndaj ky parim nuk gjen zbatim. Po sipas atyre gjykatave, vendimi nr. 51/2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka të bëjë me akuza të ngjashme, por jo të njëjta dhe krimet për të cilat ai është dënuar nga gjykata italiane kanë kualifikim të ndryshëm ligjor nga veprat për cilat është dënuar nga gjykata shqiptare. Sipas gjykatave, faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të vendimit italian (dëmtimet ndaj shtetases rumune) nuk janë të njëjta me ato të gjykuara me vendimin nr. 51/2011. Po ashtu, gjykatat e faktit kanë arsyetuar se sipas gjykatës italiane vendimi i dënimit në shtetin shqiptar nuk përbën shkak për mosvazhdimin e gjykimit të çështjes të filluar në atë shtet ndaj kërkuesit, dhe për këtë arsye gjykimi nga ajo nuk mund të pengohet dhe, gjithashtu, nuk mund të aplikohet as neni 649 i KPP-së italian në lidhje me vendimin e dhënë në Shqipëri (*shih faqet 11-12 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe 12-13 të vendimit të gjykatës së apelit*).

33. Në rekursin në Gjykatën e Lartë kërkuesi, ndër të tjera, ka ngritur edhe pretendimin për cenimin e parimit *ne bis in idem,* pretendim të cilin Kolegji Penal e ka konsideruar të pabazuar, duke vlerësuar, në të njëjtën mënyrë si gjykatat e faktit, se për sa kohë që kërkuesi është gjykuar nga juridiksione të ndryshme dhe për vepra të ndryshme penale, parimi *ne bis in idem* nuk gjen zbatim në rastin konkret. Në përfundim, mbështetur në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja "a", të KPP-së, Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit (*shih paragrafët 24 dhe 27-32 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

34. Për sa më lart, Gjykata konstaton se edhe pse disa nga veprat penale për të cilat është dënuar kërkuesi si me vendimin nr. 51/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ashtu edhe me vendimin e gjykatës italiane, kanë të bëjnë me të njëjtat fakte penale të ndodhura në territorin e shtetit italian, interpretimi i gjykatave të faktit se nuk bëhet fjalë për të njëjtat vepra penale vetëm mbi argumentin e cilësimit të ndryshëm ligjor të tyre, por pa analizuar në drejtim të parimit *ne bis in idem* nëse bëhej fjalë për të njëjtat veprime, sjellje e fakte që formojnë bazën e veprave penale për të cilat kërkuesi është dënuar nga të dyja juridiksionet, është një interpretim ligjor haptazi i paarsyeshëm, i cili nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 26, datë 09.04.2024; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, në këndvështrim të parimit të subsidiaritetit,

që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë duhet të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Bazuar në standardet e mësipërme, duke pasur parasysh natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, pavarësisht këtyre shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, ka marrë të mirëqenë analizën dhe vlerësimin e atyre gjykatave, por nuk është ndalur, në këndvështrim të parimit të sanksionuar në nenin 34 të Kushtetutës dhe në kuptim të përmbajtjes dhe frymës së neneve 7 dhe 514 të KPP-së, në verifikimin e fakteve penale për të cilat ai është dënuar në të dyja rastet me vendime të formës së prerë, për të arritur në përfundimin nëse ndodhej përpara veprave penale të njëjta në kuptim të parimit *ne bis in idem*. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal nuk rezulton të jetë i argumentuar në drejtim të shkaqeve mbi të cilat ai ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs, si më sipër, që kanë të bëjnë me shkelje të parimeve kushtetuese në procesin penal, nuk janë nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Gjykata çmon të theksojë, gjithashtu, se në vlerësimin e fakteve me natyrë kushtetuese për qëllime të kësaj analize kushtetuese, në funksion të qëndrimit të saj për çështjen, ajo nuk është ndalur në analizën dhe verifikimin e secilit fakt penal që ka përbërë elemente të secilës vepër penale për të cilën kërkuesi është dënuar si me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare, ashtu edhe të gjykatave italiane, për sa kohë kjo është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë gjatë rigjykimit të çështjes, në funksion të verifikimit të zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit, pikërisht për sa i përket parimit *ne bis in idem,* duhet të ndalet në analizimin e argumenteve të parashtruara nga ato, përfshirë edhe të atij se faktet e përmendura në pikat 5 dhe 6 të vendimit penal të huaj nuk janë të njëjta me ato të gjykuara në shtetin shqiptar me vendimin nr. 51/2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, por duke mos treguar ato gjykata mënyrën se si korrespondojnë këto fakte me pjesën urdhëruese për sa i përket veprave penale dhe dënimit.

36. Për rrjedhojë, në përputhje me standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe bazuar në faktet e rastit konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk e ka kryer rolin e saj që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, pasi nuk ka ushtruar funksionin e saj për kontrollin e zbatimit dhe interpretimit

të ligjit të zbatueshëm, konkretisht të nenit 514 të KPP-së, nga gjykatat më të ulëta, çka vë në dyshim respektimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) të parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës.

37. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

38. Për sa i përket kërkesës për pezullimin e vendimit nr. 370 akti, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata vendosi rrëzimin e saj, për sa kohë çështja do të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-184, datë 06.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 13.03.2025
Shpallur më 11.04.2025

Vendim nr. 12, datë 18.03.2025
(V-12/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Blerina Basha, në datën 18.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 22 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SHOQËRIA "KSAMILI INVESTMENT" SH.P.K.**
REBANI BOCAI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, përfaqësuar nga Lorena Goxhobelli, drejtore e përgjithshme.
DREJTORIA VENDORE E AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, SARANDË, përfaqësuar nga drejtor Eugen Prifti.
AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Valbona Legisi, Juliana Çoma dhe Irma Qosja.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr.13558/8823/5702/4829/4337 akti, datë 10.11.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-776, datë 29.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit ose në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës**

së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, Rebani Bocai dhe shoqërisë "Ksamili Investment" sh.p.k.*(kërkuesit),* të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*DVASHK*), Sarandë, së cilës i janë deleguar kompetencat për të paraqitur prapësime edhe në emër të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Rebani Bocai dhe shoqëria "Ksamili Investment" sh.p.k., në të cilën i pari është ortak dhe administrator, figurojnë pronarë të dy pasurive të paluajtshme me vendndodhje në Ksamil, Sarandë, të regjistruara në regjistrat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Sarandë (sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë), konkretisht të pasurive nr. 1/797 dhe nr. 4/448, zona kadastrale nr.2297, e para me sipërfaqe 15440 m^2, ndërsa e dyta me sipërfaqe 64998,4 m^2. E gjithë pasuria fillimisht është fituar nga kërkuesi Rebani Bocai, i cili më pas ka tjetërsuar një pjesë të saj në favor të kërkueses tjetër, shoqërisë "Ksamili Investment" sh.p.k.

2. Pasuria është fituar nga Komuniteti Bektashian, Gjyshata Gjirokastër (*Komuniteti Bektashian*), të cilit, me vendimin nr. 188, datë 14.05.2008 (*vendimi nr. 188/2008*) të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të qarkut Vlorë (*ZRAKKP*) i është njohur e drejta e pronësisë për sipërfaqen 137,5 ha kullotë, truall dhe pemishte, e ndodhur në Ksamil, Sarandë, me kufizimet përkatëse, nga e cila i është

kthyer sipërfaqja 118,28 ha kullotë dhe pemishte. Ky vendim në vijim është ndryshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. 1130, datë 12.11.2008 (*vendimi nr. 1130/2008*), duke iu njohur Komunitetit Bektashian e drejta e pronësisë për sipërfaqen e përgjithshme 160,9 ha, nga e cila i është kthyer sipërfaqja 137,5 ha. Vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

3. Në kushtet e refuzimit të kërkesës për regjistrimin e vendimit të njohjes të së drejtës së pronësisë dhe kthimit të pronës, Komuniteti Bektashian ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor, në përfundim të të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 581, datë 30.04.2009, ka detyruar ZVRPP-në, Sarandë për regjistrimin e vendimit nr. 1130/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Ky vendim, në vijim, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. 273, datë 07.07.2009 *(vendimi nr. 273/2009).* Vendimi i gjykatës së apelit në këtë rast, pavarësisht paraqitjes rekurs kundër tij, është ekzekutuar nga ZVRPP-ja, Sarandë, duke regjistruar pronën në regjistrat e pasurive të paluajtshme në favor të Komunitetit Bektashian dhe, në vijim, ky i fundit, një pjesë të pronës e ka tjetërsuar në favor të kërkuesit Rebani Bocai. Ndërkohë, për rekursin e paraqitur, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2014-775(88), datë 11.02.2014 (*vendimi nr. 88/2014*), ka prishur vendimin nr. 273/2009 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit. Për këtë çështje palët nuk kanë parashtruar informacion të mëtejshëm.

4. Në datën 20.01.2014, me urdhrin nr. 48 *(urdhri nr. 48/2014),* regjistruesi i ZVRPP-së, Sarandë ka vendosur masën e kufizimit për pasurinë e kërkueses, shoqërisë "Ksamili Investment" sh.p.k., për shkakun se kishte mbivendosje me pasurinë e shtetasit K.B. Po kështu, pas një kontrolli nga Njësia Task Forcë për Verifikimin e Ligjshmërisë dhe Mënyrës së Tjetërsimit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore pranë Kryeministrisë dhe rekomandimit të bërë nga ajo, regjistruesi i ZVRPP-së, Sarandë ka nxjerrë urdhrin nr. 1006, datë 25.07.2014 (*urdhri nr. 1006/2014),* për vendosjen e masës së kufizimit për pasuritë e paluajtshme, si dhe transaksionet e kryera në to, të përfituara në bazë të vendimit nr. 188/2008 të ZRAKKP-së, Vlorë, në kushtet kur regjistrimi i pronës në favor të Komunitetit Bektashian ishte bërë në bazë të vendimit nr. 273/2009 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, i cili në vijim është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 88/2014. Po kështu, regjistruesi i ZVRPP-së, Sarandë ka nxjerrë edhe urdhrin nr. 1065, datë 06.08.2014 *(urdhri nr. 1065/2014),* duke vendosur të njëjtin kufizim

me afat deri në përfundimin e procesit gjyqësor për regjistrimin e pronës në favor të Komunitetit Bektashian.

5. Ndërkohë Këshilli i Ministrave ka paraqitur padi në gjykatë, me objekt kundërshtimin e disa vendimeve të ZRAKKP-së, Vlorë, ndër to edhe të vendimit nr. 188/2008 të dhënë në favor të Komunitetit Bektashian, duke kërkuar detyrimin e subjekteve të shpronësuara, sipas atyre vendimeve, të njihnin shtetin shqiptar si pronar për 12/96 ose 1/8-ën pjesë ideale të pronës së ndodhur në vendin e quajtur "Kullota e Ksamilit", Sarandë. Pas shpalljes së moskompetencës tokësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me kërkesë të Këshillit të Ministrave, me vendimin nr. 1255 regj., datë 15.07.2016, ka vendosur marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar ZVRPP-në, Sarandë të mos kryejë asnjë veprim për pronat e fituara me vendimet e kundërshtuara në padi. Edhe për vendimin e sigurimit të padisë palët nuk kanë parashtruar informacion nëse ai ishte kundërshtuar në gjykatat më të larta dhe për vendimmarrjet e tyre. Megjithatë, nga të dhënat në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, vërehet se në atë gjykatë në datën 06.10.2017 është regjistruar çështja nr. 11243-03145-00-2017, me objekt kundërshtimin e vendimeve të KKKP-së dhe lejimi i masës së sigurimit të padisë, ku si rekursues pasqyrohen Komuniteti Bektashian dhe dy nga të padituri e tjerë, shtetasit A.Ç.(T) dhe F.K.(Ç), ndërsa statusi i çështjes pasqyrohet "Në proces".

6. Ndërsa situata e regjistrimit të pasurisë paraqitej si më lart, kërkuesja, shoqëria "Ksamili Investment" sh.p.k. i ka kërkuar ZVRPP-së, Sarandë ndarjen e pasurisë nr. 4/448, me sipërfaqe 64998,4 m^2. Në përgjigje të kërkesës, me shkresat nr. 72 prot., datë 11.01.2018 dhe nr. 470/1 prot., datë 24.01.2018, ZVRPP-ja, Sarandë i ka bërë me dije kërkueses se nuk mund t'i ofrohej shërbimi i kërkuar për shkak të barrëve që rëndonin mbi pasurinë dhe konkretisht: *(1)* me vendimin gjyqësor nr. 1255 regj., datë 15.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me të cilin është marrë masa e sigurimit të padisë, moskryerja e veprimeve për atë pasuri; *(2)* me urdhrin e regjistruesit nr. 1065/2014, me të cilin është vendosur masë kufizimi për pasurinë dhe transaksionet e kryera në të; *(3)* me urdhrin e regjistruesit nr. 1006/2014, me të cilin është vendosur masa e kufizimit për pasurinë dhe transaksionet e kryera në të; *(4)* me urdhrin e regjistruesit nr. 48/2014, me të cilin është vendosur masa e kufizimit për pasurinë, për shkak të mbivendosjes; *(5)* me kontratën e hipotekimit nr. 3107 rep. dhe nr. 531/3 kol., datë 16.12.2011, me të cilën pasuria është vendosur si garanci

në favor të "Union Bank" sh.a. Në vijim, shoqëria kërkuese ka paraqitur padi në gjykatë për kundërshtimin e refuzimit për ndarjen e pasurisë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 61, datë 01.02.2018, ka vendosur pranimin e saj, duke urdhëruar ZVRPP-në, Sarandë të kryente ndarjen e pasurisë nr. 4/448 sipas planeve të rilevimit bashkëlidhur aplikimit të kërkueses. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar dhe ZVRPP-ja, Sarandë e ka zbatuar atë.

7. Në datën 13.03.2018, pas refuzimit të kërkesës për heqjen e të gjitha barrëve për pasuritë e regjistruara në pronësi të tyre, kërkuesit kanë paraqitur padi në gjykatë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 202, datë 12.04.2018, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të padituren, ZVRPP-në, Sarandë të heqë masën e kufizimit dhe çdo barrë tjetër të vendosur mbi pasuritë respektive të paditësve (kërkuesve), me përjashtim të kontratës së hipotekimit, si dhe t'i pajisë ata me certifikatë pronësie, kartelë dhe hartë treguese për pasuritë e tyre. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se ZVRPP-ja, Sarandë, nëpërmjet veprimeve për vendosjen e masës së kufizimit për pasuritë e kërkuesve, ka cenuar rëndë sigurinë e tyre juridike, pasi ata, duke qenë të sigurt për pronësinë e Komunitetit Bektashian, i kanë fituar pasuritë nga ky i fundit nëpërmjet veprimeve juridike, duke u bërë pronarë të ligjshëm të tyre. Sipas saj, urdhrat e regjistruesit të ZVRPP-së, Sarandë janë marrë në kapërcim të kompetencave funksionale dhe në kundërshtim me nenet 59 dhe 75 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (*ligji nr. 33/2012*). Në vlerësimin e gjykatës, kufizimi i pronës në bazë të vendimit gjyqësor për sigurimin e padisë është bërë në kapërcim të kompetencave, pasi ai është vendosur për llogari të Komunitetit Bektashian, i cili nuk është pronar i tyre, ndërkohë që paditësit (kërkuesit) nuk janë as palë në atë konflikt gjyqësor, shqyrtimi i të cilit vijon ende në gjykatën e shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim e paditura ZVRPP-ja, Sarandë, si dhe Avokatura e Shtetit, ndërsa paditësit (kërkuesit) kanë paraqitur kundërankim.

8. Ndërsa kjo çështje ndodhej në pritje të shqyrtimit nga Gjykata Administrative e Apelit, ka përfunduar gjykimi i padisë së Këshillit të Ministrave dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2019-1022, datë 07.06.2019, ndër të tjera, ka vendosur rrëzimin e padisë për sa i përket vendimit të ZRAKKP-së, Vlorë të dhënë në favor të Komunitetit Bektashian, duke urdhëruar edhe heqjen e masës së sigurimit të padisë. Çështja në vijim është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila,

fillimisht, ka vendosur ndarjen e ankimeve dhe gjykimin e tyre si çështje më vete. Për sa i përket çështjes me të paditur Komunitetin Bektashian, me vendimin nr. 20-2022-567/07, datë 04.11.2022, ajo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, si dhe rivendosjen e masës së sigurimit të padisë të vendosur nga gjykata e shkallës së parë në kuadër të këtij procesi gjyqësor. Edhe për këtë çështje palët nuk kanë parashtruar informacion të mëtejshëm. Megjithatë, nga të dhënat në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë vërehet se në atë gjykatë, në datën 11.07.2023, është regjistruar çështja nr. 11249-00376-00-2023, me objekt anulimin e vendimit nr. 188/2008 të dhënë në emër të Komunitetit Bektashian, ku si rekursues pasqyrohet ky i fundit, ndërsa statusi i çështjes "Në proces".

9. Për sa i përket çështjes së vënë në lëvizje nga kërkuesit për heqjen e barrëve për pasuritë e tyre *(shih paragrafin 7 të vendimit)*, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 13558/8823/5702/4829/4337 akti, datë 10.11.2022, bazuar në nenin 297, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC),* ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e gjykimit të çështjes civile me paditës Këshillin e Ministrave, Avokaturën e Shtetit dhe të paditur Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe Komunitetin Bektashian (Teqeja Bektashiane e Zallit), me objekt: "Kundërshtimin e vendimit nr. 188/2008 të ZRAKKP-së, Vlorë të dhënë në emër të subjektit, Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, Komunitetit Bektashian Shqiptar (Teqeja e Zallit)". Sipas asaj gjykate, çështja që ajo po shqyrtonte nuk mund të zgjidhej përpara se të zgjidhej mosmarrëveshja civile ndërmjet shtetit dhe Komunitetit Bektashian, e cila ka shkaktuar edhe lindjen e mosmarrëveshjes administrative, për të cilën nuk ka ende një vendim të formës së prerë. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë ushtruar rekurs të veçantë, duke pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka zbatuar gabim ligjin procedural, nenin 297, shkronja "a", të KPC-së, duke cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme për të drejtën e pronës së fituar në mënyrë të ligjshme, e drejtë e cila nuk është pjesë e procesit gjyqësor civil për shkak të të cilit është pezulluar gjykimi i çështjes së tyre administrative.

10. Me vendimin nr. 00-2024-776, datë 29.02.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuesve, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*).

11. Në datën 01.07.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar më 12.07.2024. Kolegji i Gjykatës, në datën 19.09.2024, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, në datën 01.10.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur kanë parashtruar:

A) Për legjitimimin në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive:

12.1. Vendimet e kundërshtuara sjellin efekte mbi të drejtat e kërkuesve në të njëjtën masë dhe mënyrë si dhe një vendim përfundimtar themeli, pasi i vënë në pamundësi për të ushtruar tagrat e së drejtës së pronës, të fituar sipas ligjit dhe të pakontestuar me vendim gjyqësor përfundimtar. Vendimet kanë natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues pasi: *i)* ndërhyjnë në të drejtën kushtetuese të pronës, në një nga tagrat e saj, që do të vazhdojë deri në përfundim të një procesi tjetër gjyqësor ku kërkuesit nuk janë palë, ndaj nuk mund të sjellë pasoja ndaj tyre; *ii)* kohëzgjatja e pezullimit nuk mund të përllogaritet saktësisht, por duke pasur parasysh kohëzgjatjen mesatare të çështjeve në gjykata kufizimi bën të pamundur, në thelb, ushtrimin e së drejtës së pronës; *iii)* pasojat janë të drejtpërdrejta në të drejtën e pronës; *iv*) kërkuesit nuk kanë mjete të tjera juridike që t`u garantojnë mbrojtje efektive për pretendimet për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të tillë; *v)* vendimi i kundërshtuar ka një masë të caktuar autonomie dhe ndonëse i shërben procesit të themelit, qëndron i pavarur prej tij, në kuptim të efekteve që sjell.

B) Për themelin kërkuesit kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar:

12.2. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

12.2.1. *Së drejtës së aksesit formal dhe substancial në gjykatë,* pasi në mënyrën se si gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë

trajtuar çështjen, ato kanë cenuar të drejtën e kërkuesve për të pasur një shqyrtim gjyqësor dhe përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në padi, duke i vendosur në pamundësi për të kërkuar të drejtat e ligjshme për shkak se nuk kanë asnjë mundësi dhe mjet tjetër për t`i rivendosur ato në gjendjen që procesi ndodhet. Gjykata e apelit ka pezulluar gjykimin e çështjes administrative duke iu referuar një procesi tjetër gjyqësor civil ku kërkuesit nuk janë palë dhe nuk kanë mundësi të mbrohen e të shprehin pretendimet e tyre, si dhe duke bërë një analizë dhe interpretim të gabuar të nenit 297 të KPC-së. Kjo nuk u riparua nga Gjykata e Lartë, e cila nuk mori në analizë dhe as u dha përgjigje asnjë prej pretendimeve të rekursit, edhe pse kishin të bënin me të drejtën e pronës dhe parimin e sigurisë juridike.

12.2.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi arsyetimi i vendimeve të gjykatave është i mangët, jo i plotë, kontradiktor me faktet dhe pretendimet e kërkuesve, përveçse Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar shkaqet e rekursit të veçantë për të drejtat themelore të pretenduara të shkelura. Gjykata e apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit pasi çështja nuk mund të zgjidhej përpara se të zgjidhej çështja civile midis shtetit dhe Komunitetit Bektashian, duke mos argumentuar lidhjen direkte mes dy çështjeve, ndërkohë që kërkuesit nuk janë pjesëmarrës në procesin civil dhe as përfitues të titullit të pronësisë të dhënë përmes vendimit të kundërshtuar të ZRAKKP-së, Vlorë, por kanë fituar të drejta pronësie përmes akteve që nuk janë kundërshtuar në atë proces. Gjykatat kanë anashkaluar faktin se objekti i padisë së kërkuesve lidhet me veprimet administrative të ZVRPP-së, Sarandë dhe nuk ka për objekt origjinën e së drejtës së pronës ose mënyrën e fitimit të saj.

12.2.3. *Parimit të sigurisë juridike në aspektin e pritshmërive të ligjshme,* pasi pasuritë janë fituar nga kërkuesit në mënyrë të ligjshme, me kontrata dhe akte që nuk janë kundërshtuar dhe nuk janë objekt i proceseve gjyqësore. Konflikti civil mes palëve të tjera, Këshillit të Ministrave dhe Komunitetit Bektashian, që çoi në pezullimin e gjykimit administrativ, nuk mund të cenojnë pronën dhe të drejtat e kërkuesve, për

sa kohë ata nuk janë palë në atë proces gjyqësor. Pezullimi i çështjes cenon këtë parim, pasi krijon pasiguri për të ardhmen. Gjykatat ua kanë kaluar kërkuesve barrën e provës, duke zhvendosur përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore në drejtim të pronarëve të ligjshëm pa arsyetim dhe sqarim për qëndrimet e tyre.

12.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit,* për shkak se në çështje të ndryshme nuk mund të mbahen qëndrime të njëjta. Gjykata e Lartë ka referuar në një vendim tjetër, por objekti i atij gjykimi është i ndryshëm, pasi heqja e një kufizimi të vendosur në zbatim të një vendimi gjyqësor për sigurimin e padisë është i ndryshëm nga heqja e kufizimit duke u bazuar në paligjshmërinë e urdhrave të kufizimit të nxjerrë nga ZVRPP-ja, Sarandë përpara marrjes së masës së sigurimit të padisë në një proces tjetër gjyqësor.

12.4. *Të drejtën e pronës,* pasi edhe pse titulli i pronësisë së kërkuesve nuk është vënë në diskutim, sipas mënyrave dhe formave të parashikuara nga ligji, për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar, kërkuesit janë vënë në pamundësi për të ushtruar tagrat e pronësisë, sepse gjykatat, në mënyrë indirekte, kanë legjitimuar dhe lejuar veprimet e paligjshme të organit administrativ, ZVRPP-së, Sarandë. Duke pasur parasysh se procesi gjyqësor i pezulluar mund të zgjasë për një kohë të pacaktuar, një kohëzgjatje e tillë përbën shpronësim *de facto* pa shpërblim në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës, pasi kufizimi është në atë masë sa cenon thelbin e së drejtës së pronës, duke e bërë atë iluzive. Ndërhyrja në të drejtën e pronës nuk është e ligjshme, sepse edhe pse formalisht është bazuar në nenin 297 të KPC-së, për shkak të interpretimit arbitrar të kësaj dispozite, ajo nuk plotëson kriterin e ligjshmërisë. Për sa kohë që nuk ka një vendim gjyqësor që të ketë vlerësuar të paligjshëm mënyrën e fitimit të pronësisë nga kërkuesit dhe për sa kohë titulli i tyre i pronësisë nuk është pjesë e procesit gjyqësor ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komunitetit Bektashian, duke mos pasur ata asnjë mundësi për të ngritur pretendimet e tyre në atë proces gjyqësor, çdo veprim administrativ ose vendim gjyqësor ndaj tyre është jokushtetues.

13. ***Subjekti i interesuar, DVASHK-ja, Sarandë,*** ka parashtruar se ka refuzuar kryerjen e shërbimit për ndarjen e pasurive objekt gjykimi për shkak të masave kufizuese të vendosura për to, përfshirë edhe me

vendimin nr. 1255 regj., datë 15.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, ndërsa për këtë ka bërë shënimet përkatëse në kartelat e pasurisë, por edhe pse ka pasur një vendim të tillë gjyqësor, ajo ka zbatuar në vijim vendimin nr. 61, datë 01.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër për ndarjen e pasurive të kërkuesve. Këta të fundit, në vijim, kanë lidhur kontrata premtim shitjeje, të cilat nuk janë regjistruar për shkak të masës së sigurimit të padisë që rëndon mbi pronat, mbi të cilat janë ngritur disa objekte të legalizuara ose në proces legalizimi, përveçse mund të jenë kryer edhe transaksione të tjera, por që janë evidentuar vetëm në kartelat dixhitale të pasurisë. Masa e sigurimit të padisë është rivendosur me vendimin nr. 20-2022-576/07, datë 04.11.2022 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

14. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se:

A) Për legjitimimin e kërkuesve:

14.1. Kërkuesit nuk legjitimohen për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi vendimi për pezullimin e gjykimit të çështjes nuk mund të konsiderohet vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës, referuar për këtë dhe nenit 451 të KPC-së. Për mosmarrëveshjen administrative të vënë në lëvizje nga kërkuesit nuk ka ende një vendim përfundimtar, ndërkohë që gjykimi i asaj çështjeje është pezulluar për shkak të mosmarrëveshjes civile për vlefshmërinë e titullit të pronësisë të Komunitetit Bektashian, mosmarrëveshje e cila ka shkaktuar edhe atë administrative.

B) Për themelin:

14.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit formal dhe substancial në gjykatë nuk qëndron, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka garantuar të drejtën e aksesit të kërkuesve, për më tepër kur çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore në prani të palëve. Edhe Gjykata e Lartë e ka garantuar këtë të drejtë, e cila, lidhur me rekursin e veçantë, ka arsyetuar në mënyrë ezauruese, mbështetur në parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, duke respektuar kufijtë e rekursit dhe juridiksionin rishikues të saj që kanë të bëjë vetëm me çështje të zbatimit të ligjit material dhe procedural. Kërkuesit as nuk kanë provuar se janë privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tyre.

14.3. Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk qëndron, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar qartë shkakun e pezullimit, bazuar në nenin 297, shkronja "a", të KPC-së. Për sa kohë që titulli i pronësisë mbi të cilin kërkuesit kanë fituar pronësinë është objekt shqyrtimi gjyqësor dhe për pasurinë është vendosur masa e sigurimit të padisë për të mos u bërë veprime tjetërsimi, me të drejtë ajo gjykatë ka vendosur pezullimin e gjykimit të mosmarrëveshjes administrative, pasi fillimisht duhet të zgjidhet mosmarrëveshja civile për të drejtën e pronësisë. Edhe arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është tregues se pasi ka marrë në shqyrtimin rekursin e veçantë, ajo ka arritur në përfundimin se në të nuk janë ngritur argumente nga ato të përcaktuara nga ligji, duke u dhënë përgjigje atyre. Bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), nuk është e detyrueshme që një gjykatë t'i japë përgjigje të hollësishme çdo argumenti të paraqitur, por mjafton që në vendim të dalë qartë se janë prekur pikat thelbësore të ngritura.

14.4. Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi kërkuesit e bazojnë në argumente që lidhen me themelin e çështjes. Ata, në thelb, nuk ngrenë çështje kushtetutshmërie, por indirekt kërkojnë t'u jepet zgjidhje pretendimeve të tyre për themelin e mosmarrëveshjes.

14.5. Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në çështjen tjetër të referuar për të njëjtën tipologji gjykimi.

14.6. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës nuk qëndron, pasi kërkuesit ngrenë pretendime që kanë të bëjnë me themelin e shqyrtimit të çështjes gjyqësore dhe jo me shkeljet konkrete të dispozitave kushtetuese, ndërkohë që shqyrtimi i atyre pretendimeve është pjesë e juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

15. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pika 2, të Kushtetutës, përfshihen edhe personat juridikë, sikurse edhe shoqëria tregtare në këtë gjykim. Në këtë këndvështrim, kërkuesit legjitimohen *ratione personae* si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Në lidhje me kriterin paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesit kanë pretenduar se i kanë shteruar ato, pasi vendimet e kundërshtuara që kanë vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative, konsiderohen përfundimtare për pasojën që kanë sjellë për të drejtën e tyre të pronësisë, në kuptim të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, e cila lejon individin që të mbrojë të drejtat kushtetuese substanciale të cenuara nga aktet e pushtetit ose vendimet gjyqësore, referuar qasjes së Gjykatës dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së. Në lidhje me këtë kriter të legjitimimit, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka pretenduar se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive, pasi vendimet e kundërshtuara, që kanë vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative, nuk mund të konsiderohen përfundimtare në kuptim të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës.

18. Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore.

Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se, në rastin konkret, objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është vendosur pezullimi i gjykimit të çështjes administrative të vënë në lëvizje nga kërkuesit, ashtu edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuesve, duke lënë kështu praktikisht në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Për rrjedhojë, në aspektin formal, objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim gjyqësor i ndërmjetëm, në kushtet kur ai nuk është dhënë në përfundim të një gjykimi themeli dhe as nuk ka zgjidhur në themel çështjen në mënyrë përfundimtare. Megjithatë, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se në mënyrë përjashtimore vendimet e ndërmjetme mund të bëhen pjesë e juridiksionit kushtetues në rast se plotësohen këto kushte: *(i)* vendimi duhet të ketë vendosur për të drejtën e individit të pretenduar si të cenuar, pra shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar ose, thënë ndryshe, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; *(ii)* vendimi të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet e cenuar; *(iii)* vendimi duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar për sa më sipër, Gjykata do të verifikojë edhe në rastin konkret nëse vendimi i ndërmjetëm, objekt i ankimit kushtetues individual, plotëson kriteret për t`u konsideruar përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton, fillimisht, se çështja gjyqësore ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara është e natyrës administrative dhe është vënë në lëvizje nga kërkuesit, të cilët kanë pretenduar paligjshmërinë

e veprimeve të organit administrativ (ish-ZVRPP-së, Sarandë) në vendosjen e masave kufizuese për pasuritë tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme, duke kërkuar për këtë shkak heqjen e atyre masave. Për sa u përket këtyre të fundit, kufizimi, në kuptim të ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, i pamundëson subjektit të regjistruar pronar kryerjen e veprimeve juridike për tjetërsimin e pasurive të tij. Nga ana tjetër, vendosja e masës kufizuese për pasurinë mund të shërbejë si shkak pengues edhe për zhvillimin e pronës. Ndërkohë, masat kufizuese për pasuritë e regjistruara në pronësi të kërkuesve janë vendosur përmes tre urdhrave të regjistruesit të ish-ZVRPP-së, Sarandë, që datojnë në vitin 2014, e që përmbajnë edhe shkakun për të cilin kufizimet janë vendosur. Po kështu ato kanë të bëjnë edhe me veprimet e regjistruesit, në vitin 2016, në zbatim të një vendimi gjyqësor për marrjen e masës së sigurimit të padisë, përmes të cilit ish-ZVRPP-ja, Sarandë është urdhëruar të mos kryejë asnjë veprim në lidhje me pronën e fituar me një vendim të ZRAKKP-së, Vlorë, i cili është dhënë në një proces gjyqësor ku kërkuesit nuk janë palë, por i tillë është subjekti (Komuniteti Bektashian), nga i cili ata e kanë fituar pronësinë. Ndërsa gjykata administrative e shkallës së parë ka pranuar padinë e kërkuesve, duke hequr masat kufizuese të vendosura për pasuritë dhe duke urdhëruar pajisjen e tyre me dokumentet e pronësisë, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative deri në përfundim të gjykimit të çështjes civile, në të cilën kundërshtohet vendimi i ZRAKKP-së, Vlorë i dhënë në favor të subjektit nga i cili kërkuesit kanë fituar të drejtën e pronësisë, proces në të cilin është dhënë edhe vendimi për sigurimin e padisë i zbatuar nga regjistruesi i ish-ZVRPP-së, Sarandë.

22. Duke pasur parasysh për sa më sipër, si dhe faktin se kufizimi për pronën ka filluar në vitin 2014 mbi bazën e aktit administrativ dhe në vitin 2016 për shkak të vendimit gjyqësor për marrjen e masës së sigurimit të padisë ku ai vijon ende për shkak të vendimmarrjes objekt gjykimi, është kjo kohëzgjatje që e bën këtë rast përjashtimor për qëllime të kontrollit kushtetues. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se ndonëse masa e pezullimit të gjykimit nuk ndërhyn *per se* në të drejtën e pronës, ai vendim, duke qenë i ndërlidhur me vetë kufizimin, konsiderohet se ka sjellë *fe facto* pasoja në drejtim të vetë ushtrimit të kësaj të drejte. Në këtë drejtim mbahet parasysh edhe se, ndërsa kufizimi pretendohet të ketë ardhur si pasojë e veprimeve të organit administrativ, në kushtet kur Gjykata Administrative e Apelit ka pezulluar gjykimin, në themel të të cilit është pikërisht kontrolli

i ligjshmërisë së atyre veprimeve administrative, përfshirë edhe për sa i përket zbatimit të një vendimi për sigurim padie të dhënë pikërisht në procesin civil që ka shërbyer si shkak pezullimi, ajo praktikisht, përmes vendimit të saj, ka lejuar vijimin e pasojave të pretenduara si të paligjshme. Për rrjedhojë, vendimi i pezullimit të gjykimit, në rastin konkret, ndonëse në aspektin formal është vendim i ndërmjetëm që nuk vendos për themelin e çështjes, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, ai ka ndërhyrë në ushtrimin e së drejtës kushtetuese individuale, të pronës private, ndërhyrje e cila vazhdon deri në përfundimin e procesit civil.

23. Po kështu, vendimi është bërë objekt i rekursit të veçantë në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e tij, duke i gjetur të pabazuara shkaqet e parashtruara nga kërkuesit dhe, për rrjedhojë, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke ligjëruar indirekt masën kufizuese të së drejtës së pronës të pretenduar të cenuar. Gjithashtu, ky vendim ka një masë të caktuar autonomie nga procesi gjyqësor i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi i mosmarrëveshjes administrative vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel në atë gjykim nuk është i aftë të riparojë në masën e duhur efektet e sjella nga vendimi i ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit në procesin të vënë në lëvizje nga kërkuesit. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa ka prapësuar subjekti i interesuar Avokatura e Shtetit, Gjykata vlerëson se në këtë rast kriteri i shterimit të mjeteve juridike konsiderohet i plotësuar.

24. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis,* në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 29.02.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 01.07.2024. Duke pasur parasysh se kjo e fundit është dita e parë e punës pas ditëve të pushimit javor, ankimi kushtetues individual konsiderohet i paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

25. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit formal dhe substancial në gjykatë, e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të sigurisë juridike e të të drejtave të fituara, sikundër cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe së drejtës së pronës, të cilat *prima facie* janë pretendime me natyrë kushtetuese.

26. Për sa u përket argumenteve të parashtruara në mbështetje të këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit kërkuesit kanë pretenduar se referimi i Gjykatës së Lartë në vendime

të tjera të saj (vendimi nr. 00-2024-469, datë 13.02.2024, në çështjen me paditës E.C.) bie ndesh me këtë parim, pasi në çështje të ndryshme nuk mund të mbahen qëndrime të njëjta. Sipas tyre, në rastin konkret, objekti i gjykimeve është i ndryshëm, sepse kërkimi për heqjen e një kufizimi të vendosur në zbatim të një vendimi gjyqësor për sigurimin e padisë është i ndryshëm nga ai për heqjen e kufizimit të vendosur përmes urdhrave të paligjshëm të ZVRPP-së, Sarandë përpara marrjes së masës së sigurimit të padisë në një proces tjetër gjyqësor. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, qoftë në rastin në shqyrtim, ashtu dhe atë të referuar në vendimin e kundërshtuar, ka mbajtur të njëjtin qëndrim për rekurset e paraqitura në lidhje me vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit për pezullimin e gjykimit të atyre çështjeve, në të cilat, në thelb, është kundërshtuar kufizimi i vendosur për pasuritë, të cilat, në origjinë, janë fituar nga i njëjti subjekt (Komuniteti Bektashian), me ndryshimin e vetëm se në rastin tjetër pasuria është transferuar nga kërkuesit. Në këtë kuptim, argumentet e parashtruara nga kërkuesit, në aspektin kushtetues, nuk janë të mjaftueshme për të provuar në cenimin e këtij parimi nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, ky pretendim i tyre nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Në drejtim të *parimit të sigurisë juridike,* kërkuesit kanë pretenduar, në thelb, se ata i kanë fituar pasuritë e paluajtshme në mënyrë të ligjshme dhe se titujt e tyre të pronësisë nuk janë objekt i procesit gjyqësor civil që ka çuar në pezullimin e gjykimit administrativ. Në këtë mënyrë, sipas tyre, gjykatat nuk kanë sqaruar lidhjen midis këtyre dy çështjeve (asaj civile dhe asaj administrative) dhe përmes pezullimit të gjykimit i kanë lënë ata pa mjete për të mbrojtur të drejtën e pronës nga arbitrariteti. Kurse në këndvështrim të *së drejtës së pronës private,* kërkuesit kanë pretenduar se ajo u është cenuar për shkak të interpretimit arbitrar të nenit 297 të KPC-së nga gjykatat, të cilat, duke pezulluar gjykimin e gjykimit, në mënyrë indirekte, kanë legjitimuar dhe lejuar veprimet e paligjshme të organit administrativ. Sipas tyre, zgjatja në kohë e vetë procesit gjyqësor përbën *de facto* shpronësim pa shpërblim në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e argumenteve, mbi të cilat kërkuesit kanë mbështetur pretendimet e tyre, si dhe duke pasur parasysh se vendimet e kundërshtuara janë përfundimtare për qëllimet e nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës *(shih paragrafët 20-23 të vendimit),* do t'i trajtojë pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të së drejtës substanciale të pronës private. Gjykata, referuar praktikës së saj, sipas së cilës pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt

analizohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale, edhe në rastin konkret do të ndalet në vlerësimin e tyre për aq sa ato ndikojnë në vetë të drejtën substanciale të pronës private. Konkretisht, për sa i takon aspektit procedural të së drejtës së pronës, Gjykata vëren se, pretendimet, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar nenin 297 të KPC-së në drejtim të lidhjes që ekziston midis dy proceseve gjyqësore, atij civil dhe atij administrativ, çka ka sjellë pasoja në mosshqyrtimin e themelit të padisë administrative të ngritur nga ata, për rrjedhojë në mosmarrjen e një përgjigjeje përfundimtare, si në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të organit administrativ, ashtu edhe në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave të faktit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson t`i shqyrtojë këto pretendime të kërkuesve në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si elemente të së drejtës për proces të rregullt.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës në aspektin procedural

B.1.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Sipas kërkuesve, gjykatat kanë cenuar të drejtën për një shqyrtim gjyqësor dhe për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në padi dhe në rekursin e veçantë. Sipas tyre, gjykata e apelit ka pezulluar gjykimin e çështjes administrative, duke iu referuar një procesi tjetër gjyqësor civil ku ata nuk janë palë dhe nuk kanë mundësi të mbrohen e të shprehin pretendimet e tyre, duke bërë një analizë dhe interpretim arbitrar të nenit 297 të KPC-së, gjë që nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila nuk i ka shqyrtuar pretendimet e tyre në rekursin e veçantë edhe pse ato lidhen me të drejtën e aksesit, të drejtën e pronës dhe parimin e sigurisë juridike. Kërkuesit kanë pretenduar se arsyetimi i vendimeve gjyqësore është i mangët, jo i plotë, kontradiktor me faktet dhe pretendimet e tyre, ndërkohë që gjykata e apelit nuk ka argumentuar lidhjen direkte mes çështjes administrative dhe asaj civile, edhe pse ata nuk janë palë në procesin civil dhe as nuk janë përfitues të titullit të pronësisë të dhënë përmes vendimit të kundërshtuar të ZRAKKP-së, Vlorë. Po sipas kërkuesve, gjykatat kanë anashkaluar faktin se objekti i padisë së tyre lidhet me veprimet administrative të ZVRPP-së, Sarandë dhe nuk ka për objekt origjinën e së drejtës së pronës ose mënyrën e fitimit të saj, ndërkohë që

pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, me mirëbesim, me kontrata dhe akte, të cilat nuk janë kundërshtuar dhe nuk janë objekt i proceseve gjyqësore. Ata kanë pretenduar se titulli i pronësisë nuk është vënë në diskutim sipas mënyrave dhe formave të parashikuara nga ligji dhe se janë vënë në pamundësi për të ushtruar tagrat e pronësisë, sepse në mënyrë indirekte gjykatat kanë legjitimuar dhe lejuar veprimet e paligjshme të organit administrativ, ZVRPP-së, Sarandë. Gjithashtu, sipas kërkuesve, zgjatja në një kohë të pacaktuar të procesit gjyqësor civil, për të cilin është vendosur pezullimi i gjykimit administrativ, përbën *de facto* shpronësim pa shpërblim në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës.

29. Sipas subjektit të interesuar, DVASHK-së, Sarandë, ajo ka refuzuar kryerjen e shërbimit për ndarjen e pasurive objekt gjykimi për shkak të masave kufizuese të vendosura për to, përfshirë edhe me vendimin nr. 1255 regj., datë 15.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, ndërsa për këtë ka bërë shënimet përkatëse në kartelat e pasurisë, por edhe pse ka pasur një vendim të tillë gjyqësor, ka zbatuar në vijim vendimin nr. 61, datë 01.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër për ndarjen e pasurive të kërkuesve, ndërkohë që këta të fundit kanë lidhur më pas kontrata premtimi shitjeje, të cilat nuk janë regjistruar për shkak të masës së sigurimit të padisë që rëndon mbi pronat. Sipas këtij subjekti, për këto të fundit janë ngritur disa objekte, të legalizuara ose në proces legalizimi, përveçse mund të jenë kryer edhe transaksione të tjera, por që janë evidentuar vetëm në kartelat dixhitale të pasurisë. Së fundi, sipas tij, masa e sigurimit të padisë është rivendosur me vendimin nr. 20-2022-576/07, datë 04.11.2022 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

30. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë garantuar të drejtën e aksesit, për më tepër, kur në gjykatën e apelit çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore në prani të palëve, kurse Gjykata e Lartë ka arsyetuar për rekursin mbështetur në parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Po sipas këtij subjekti, gjykata e apelit ka arsyetuar qartë shkakun e pezullimit të gjykimit bazuar në nenin 297, shkronja "a", të KPC-së dhe për sa kohë titulli i pronësisë mbi bazën e të cilit kërkuesit kanë fituar pronësinë është objekt shqyrtimi gjyqësor dhe për pasurinë është vendosur masa e sigurimit të padisë për të mos u bërë veprime tjetërsimi, me të drejtë ajo gjykatë ka arsyetuar se fillimisht duhet të zgjidhet mosmarrëveshja civile për të drejtën e pronësisë. Sipas tij, edhe arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë në

dhomën e këshillimit është tregues se, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin, ajo ka arritur në përfundimin se ata nuk kanë ngritur argumente nga ato të përcaktuara nga ligji. Sipas subjektit të interesuar, kërkuesit, në thelb, nuk ngrenë çështje kushtetuetshmërie, por indirekt kërkojnë t'u jepet zgjidhje pretendimeve të tyre për themelin e mosmarrëveshjes.

31. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe për të pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin gjithashtu edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element thelbësor i një vendimi të drejtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, edhe pse detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, Gjykata ka theksuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, ajo gjykatë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për

të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme, në referim të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata, në vijim, do të ndalet në vlerësimin nëse gjykatat e zakonshme, përmes qëndrimit të tyre në rastin e kërkuesve, duke vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative, u kanë cenuar të drejtën për të pasur përgjigje përfundimtare për themelin e mosmarrëveshjes administrative për të cilën ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor dhe nëse qëndrimi i Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit të veçantë për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykata e apelit plotëson kriteret e arsyetimit në aspektin kushtetues.

34. Gjykata vëren se kërkuesit, pronarë të dy pasurive të paluajtshme të fituara nga Komuniteti Bektashian, të cilat janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, i janë drejtuar gjykatës me padi për heqjen e masave kufizuese të vendosura për pasuritë e tyre nga ZVRPP-ja, Sarandë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka pranuar padinë, duke detyruar ZVRPP-në, Sarandë të heqë masën e kufizimit dhe çdo barrë tjetër të vendosur për pasurinë e tyre, me përjashtim të kontratës së hipotekimit dhe t'i pajisë ata me dokumentet e pronësisë. Gjykata Administrative e Apelit, e vënë në lëvizje mbi ankimin e ZVRPP-së, Sarandë dhe Avokaturës së Shtetit, ka vlerësuar se ky gjykim është i lidhur me procesin gjyqësor civil të vënë në lëvizje me padinë e Këshillit të Ministrave për kundërshtimin edhe të vendimit nr. 188/2008 të ZRAKKP-së, Vlorë të dhënë në favor të Komunitetit Bektashian, akt mbi të cilin janë fituar edhe pasuritë e paluajtshme të tjetërsuara kërkuesve dhe se vijon edhe masa e sigurimit e dhënë gjatë atij për urdhërimin e ZVRPP-së, Sarandë të mos kryejë asnjë veprim për pronat e fituara me vendimet e kundërshtuara në padi. Duke vlerësuar se çështja e kërkuesve nuk mund të zgjidhej përpara se të zgjidhej mosmarrëveshja civile ndërmjet shtetit dhe Komunitetit Bektashian, ajo gjykatë, bazuar në nenin 297, shkronja "a", të KPC-së, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative.

35. Kërkuesit e kanë kundërshtuar këtë vendim me rekurs të veçantë, duke parashtruar se gjykata e apelit ka zbatuar gabim nenin 297, shkronja "a", të KPC-së, pasi nuk evidentohet ekzistenca e të dyja kushteve të kërkuara nga kjo dispozitë. Sipas tyre, çështja civile, për shkak të së cilës është pezulluar gjykimi i çështjes administrative, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me të, ndërsa kërkuesit nuk janë as palë pjesëmarrëse dhe

as subjekti përfitues sipas vendimit të ZRAKKP-së, Vlorë të kundërshtuar në procesin gjyqësor civil, ndaj ai vendim gjyqësor nuk mund t'u kundërdrejtohet atyre dhe as mund të shtrijë efektet për pasuritë e tyre. Kërkuesit kanë pretenduar se edhe e drejta e tyre e pronësisë nuk është goditur gjyqësisht, duke ngelur e pacenuar, por ata nuk mund të gëzonin të pashqetësuar pronën e fituar në mënyrë të ligjshme me kontrata shitblerjeje dhe në mirëbesim, të regjistruar edhe në ZVRPP-në, Sarandë.

36. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuesve, duke vlerësuar se në të nuk ngrihen shkaqe ligjore. Ai kolegj ka arsyetuar se i takon palës rekursuese të parashtrojë në rekurs në mënyrë të qartë dhe të plotë shkaqet ligjore dhe argumentet përkatëse, përndryshe vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit mbetet e pacenueshme dhe, nga ana tjetër, u takon gjykatave administrative të faktit përcaktimi i fakteve dhe vlerësimi nëse gjykimi administrativ duhet të pezullohet sipas rasteve të përcaktuara në nenin 297 të KPC-së.

37. Gjykata vëren se, sipas nenit 297 të KPC-së, që parashikon institutin e pezullimit të gjykimit, ai vendoset, mes të tjerash, edhe kur çështja nuk mund të zgjidhet përpara se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative (shkronja "a"). Në rastin konkret, rezulton se gjykata e apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative të kërkuesve për këtë shkak, duke e konsideruar se çështja në shqyrtim përpara saj është e lidhur me çështjen civile të pronësisë që ndodhet në një proces tjetër gjyqësor, të vënë në lëvizje nga Këshilli i Ministrave, për kundërshtimin e vendimit për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e kompensimin e pronës në favor të Komunitetit Bektashian, duke pretenduar bashkëpronësinë e shtetit për të. Megjithatë, gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për efektet e vendimit të pezullimit ndaj së drejtës së pronës të kërkuesve, të cilët, për shkak të kufizimit të vendosur për pasuritë e paluajtshme nga ana e ZVRPP-së, Sarandë verifikimi i ligjshmërisë të të cilit ka ngelur i pezulluar në pritje të procesit gjyqësor civil, nuk mund ta ushtrojnë lirisht atë.

38. Gjykata çmon të theksojë në këtë drejtim se ndërsa zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të

Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata konstaton gjithashtu se pretendimi kryesor i kërkuesve në rekursin e veçantë ka të bëjë me zbatimin në rastin konkret të kësaj dispozite procedurale (neni 297, shkronja "a", i KPC-së) nga gjykata e apelit dhe pasojat e ardhura për këtë shkak jo vetëm në të drejtën për proces të rregullt (aspekte të saj), por edhe në vetë ushtrimin e së drejtës substanciale të pronës private. Gjykata e Lartë, edhe pse formalisht ka marrë në shqyrtim rekursin e veçantë të kërkuesve në dhomën e këshillimit, në aspektin substancial ajo nuk rezulton të këtë shqyrtuar thelbin e pretendimeve të parashtruara në të, edhe pse ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së pronës të kërkuesve për shkak të mënyrës se si gjykatat kanë zbatuar nenin 297 të KPC-së. Gjykata e Lartë ndonëse ka evidentuar në vendimin e saj se juridiksioni i gjykatës së ligjit vihet në lëvizje vetëm kur bëhet fjalë për çështje të zbatimit të ligjit procedural dhe material, ajo nuk ka kontrolluar në këtë aspekt mënyrën e zbatimit të ligjit nga Gjykata Administrative e Apelimit, me argumentin se shqyrtimi i padisë administrative, pra ende pa përfunduar me një vendim përfundimtar në shkallë të dytë, bën të pamundur kontrollin dhe vlerësimin se cila duhet të jetë fusha ku duhet të shtrihet hetimi gjyqësor administrativ në raport me kufijtë e shqyrtimit të mosmarrëveshjes administrative. Kjo qasje e Gjykatës së Lartë e ka bërë formal kontrollin e shtruar nga ajo të shkaqeve të rekursit të veçantë, edhe pse ky mjet mbrojtjeje u garantohet palëve nga legjislacioni procedural, sikundër kontrollin e saj, në kuptim të parimit të subsidiaritetit, të pretendimeve me natyrë kushtetuese. Në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata e Lartë nuk është shprehur për shkakun thelbësor mbi të cilin është bazuar rekursi i veçantë, pra për mënyrën se si gjykata e apelit ka zbatuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm (neni 297, shkronja "a", i KPC-së), për sa kohë që vendimi i pezullimit të gjykimit praktikisht ka lejuar vijimin e efekteve të masave kufizuese të pasurive të vendosura

nga organi administrativ, duke mos u shprehur gjykata për ligjshmërinë e asaj veprimtarie dhe, në këtë mënyrë, duke mos marrë kërkuesit përgjigje përfundimtare për pretendimet dhe kërkimet në padinë e tyre administrative.

40. Gjykata ka theksuar se gjykatat duhet të shkojnë përtej tekstit formal të ligjit dhe përmes interpretimit të frymës dhe qëllimit të normës ligjore të synojnë vetë të drejtën *(shih vendimin nr. 68, datë 08.10.2024*). Nën dritën e këtij standardi, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, duke mos u shprehur për thelbin e shkaqeve të parashtruara në rekursin e kërkuesve, nuk ka kontrolluar ligjshmërinë e shkakut të pezullimit të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, duke mos mbajtur në konsideratë as faktin që prona e tyre është e kufizuar prej pothuajse 11 vjetësh dhe se pezullimi i gjykimit e zgjat *de facto* kufizimin e saj edhe për një periudhë tjetër të papërcaktuar. Në këtë mënyrë, mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë u ka shkaktuar atyre cenimin e të drejtës së aksesit të lidhur edhe me të drejtën për ankim efektiv në një gjykatë më të lartë, për sa kohë ata nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet në thelb me natyrë kushtetuese.

41. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mënyra se si ka vepruar Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, duke mos marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve për vendimmarrjen e gjykatës së apelit, vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke mos synuar kështu të drejtën dhe duke sjellë, për pasojë, cenimin e së drejtës së tyre të aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit në drejtim të së drejtës për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura nga ata. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve në këtë drejtim është i bazuar.

42. Për sa më lart, përderisa Gjykata i gjeti të bazuara pretendimet e kërkuesve në drejtim të aspektit procedural të së drejtës së pronës, si dhe për sa kohë që çështja do të dërgohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila, në përputhje me kompetencat e saj, do të marrë në shqyrtim dhe do t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesve, vlerëson të mos të ndalet më tej në vlerësimin e aspektit substancial të kësaj të drejte kushtetuese (të pronës).

43. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural, konkretisht të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-776, datë 29.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.03.2025
Shpallur më 23.04.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesve Rebani Bocai dhe shoqërisë "Ksamili Investment" sh.p.k., me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr.13558/8823/5702/4829/4337 akti, datë 10.11.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-776, datë 29.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit ose në Gjykatën e Lartë",* jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, pasi vlerësoj se kërkesa nuk plotëson kriteret paraprake të pranueshmërisë për shqyrtim në seancë plenare. Konkretisht, kërkuesit nuk legjitimohen për vënien në lëvizje të Gjykatës, sepse vendimet objekt kundërshtimi nuk janë përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues dhe, si të tilla, nuk mund t'i nënshtrohen këtij gjykimi. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, do të parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes, në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se kërkuesit rezultojnë pronarë të dy pasurive të paluajtshme në Ksamil, Sarandë, të fituara nga Komuniteti Bektashian, të cilit i është njohur e drejta e pronësisë me vendim të ZRAKKP-së, Vlorë dhe njohur me një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, i cili ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar. Në vijim, ndaj pasurisë së kërkuesve është vendosur masa e kufizimit nga ana e regjistruesit të ZVRPP-së Sarandë, pasi rezultonte se kishte mbivendosje me pasurinë e një shtetasi tjetër. Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave ka ngritur padi në gjykatë, me objekt kundërshtimin edhe të vendimit të dhënë në favor të Komunitetit Bektashian, duke pretenduar të drejta pronësie për atë pasuri, proces në të cilin kërkuesit nuk rezulton se janë palë. Paralel me këtë proces, kërkuesja, "Ksamili Investment" sh.p.k. i ka kërkuar ZVRPP-së, Sarandë ndarjen e pasurisë, e cila ka refuzuar kërkesën dhe në vijim, i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, e cila ka vendosur urdhërimin e ZVRPP-së, Sarandë që të kryente ndarjen e pasurisë. Në vijim, pas refuzimit të kërkesës për heqjen e të gjitha barrëve mbi pasuritë e regjistruara në pronësi të tyre, kërkuesit kanë paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila ka

vendosur detyrimin e ZVRPP-së, Sarandë të heqë masën e kufizimit dhe t'i pajisë ata me certifikatë pronësie. Gjykata e apelit ka vendosur pezullimin e gjykimit administrativ për heqjen e barrës mbi pasurinë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes civile me paditës Këshillin e Ministrave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis shtetit dhe Komunitetit Bektashian. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, të cilët në vijim i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet të cilat kanë vendosur pezullimin e gjykimit administrativ deri në përfundim të procesit gjyqësor civil.

3. Në analizë të kritereve të legjitimimit, shumica ka vlerësuar se, në aspektin formal, objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim gjyqësor i ndërmjetëm, në kushtet kur ai nuk është dhënë në përfundim të një gjykimi themeli dhe as nuk ka zgjidhur në themel çështjen në mënyrë përfundimtare (*shih paragrafin 19 të vendimit*). Gjithsesi, sipas shumicës, ndonëse masa e pezullimit të gjykimit nuk ndërhyn *per se* në të drejtën e pronës, ai vendim, duke qenë i ndërlidhur me vetë kufizimin, konsiderohet se ka sjellë *de facto* pasoja në drejtim të vetë ushtrimit të kësaj të drejte, vendimi është bërë objekt i rekursit të veçantë në Gjykatën e Lartë dhe ky vendim ka një masë të caktuar anatomie nga procesi i themelit, pasi procesi civil i themelit nuk është i aftë të riparojë efektet e sjella nga vendimi i ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit. Në këtë kuptim, shumica e ka konsideruar të përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive (*shih paragrafët 22-23 të vendimit*).

4. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës pasi çmoj se vendimet objekt kundërshtimi nuk mund të konsiderohen përfundimtare sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës jo vetëm në aspektin formal, ashtu sikurse ka vlerësuar shumica, por edhe në aspektin substancial. Kështu, në referim të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

5. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për proces të rregullt ligjor, mund të

pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29 datë 16.04.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Sikurse shumica ka referuar në vendim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se, në mënyrë përjashtimore, vendimet e ndërmjetme mund të bëhen pjesë e juridiksionit kushtetues në rast se plotësohen këto kushte: *(i)* vendimi duhet të ketë vendosur për të drejtën e individit të pretenduar si të cenuar, pra shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar ose, thënë ndryshe, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; *(ii)* vendimi të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet e cenuar; *(iii)* vendimi duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në kuptim të standardeve të mësipërme, vlerësoj se pasojat e pretenduara nga kërkuesit për të drejtën e pronës nuk rezulton të kenë ardhur drejtpërdrejt nga vendimi i pezullimit objekt kundërshtimi, por nga procesi civil në të cilin është vënë në diskutim, në thelb, titulli i pronësisë së Komunitetit Bektashian, subjekti nga i cili kërkuesit kanë përfituar pasuritë në fjalë. Për këtë shkak, gjykata administrative, duke pasur parasysh faktin që në procesin civil kërkuesit nuk janë palë dhe ndikimin që do të kishte përfundimi i atij procesi në drejtim të vetë titullit të pronësisë së tyre ka pezulluar gjykimin duke arsyetuar se përse është i zbatueshëm neni 297, shkronja "a" i KPC-së në rastin konkret.

8. Nga ana tjetër, nuk rezulton që kërkuesit të kenë pengesë ligjore dhe as nuk kanë argumentuar ose pretenduar pamundësinë e tyre për të ndërhyrë në procesin civil, duke kërkuar si mbrojtjen e së drejtës së tyre të pronës, ashtu edhe heqjen e masës kufizuese për pasurinë. Në këtë kuptim edhe për kohëzgjatjen e kufizimit të pronës, kriter ky që është konsideruar si vendimtar nga shumica për të konsideruar këtë rast përjashtimisht përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih paragrafin 22 të*

vendimit), individi kishte ende mjete në dispozicion për të garantuar të drejtat e tij kushtetuese.

9. Për rrjedhojë, duke qenë se vendimi i kufizimit nuk ka pasur pasoja të drejtpërdrejta në të drejtën e pronës së kërkuesve, arrihet në përfundimin se vendimeve objekt kërkese u mungon edhe kriteri i autonomisë nga procesi civil i titullit të pronësisë të Komunitetit Bektashian, çka bën që këto vendime të ndërmjetme të kundërshtuara të mos marrin natyrën përfundimtare që kërkohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

10. Në konkluzion, vlerësoj se vendimet gjyqësore në të cilat është vendosur pezullimi i gjykimit të çështjes nuk duket se ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi të drejtën substanciale të pronës, pasi është procesi tjetër civil, i cili përcakton në mënyrë përfundimtare për të (për të drejtën e pronësisë mbi pronën) dhe si të tilla, ato nuk mund të kenë masën e autonomisë nga procesi i themelit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i ankimit kushtetues individual nuk duhet të tejkalonte kriteret paraprake për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, prandaj kërkesa duhet të rrëzohej.

Anëtare: Fiona Papajorgji

Vendim nr. 13, datë 25.03.2025
(V-13/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 25.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **DEAR MUÇA**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT, përfaqësuar nga Ilir Proda, drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5683, datë 05.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes/cenimit të së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes me përparësi.
Konstatimi i shkeljes të së drejtës së aksesit dhe sigurisë juridike në një gjykatë të caktuar me ligj.
Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Dear Muça *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit *(DPPSH)* dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dear Muça ka ushtruar detyrën e specialistit të marrëdhënieve me publikun dhe përfaqësimit ligjor në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër. Me urdhrin nr. 91/2, datë 28.01.2003 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit është larguar nga detyra me motivacionin "Për shkelje të rënda në mënyrë të përsëritur të disiplinës në punë".

I. Procesi parë gjyqësor

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me padi për anulimin e aktit administrativ nr. 91/2, datë 28.01.2003 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rikthimin në vendimin e mëparshëm të punës dhe pagesën për kohën e mbetur pa punë padrejtësisht, si dhe dëmshpërblimin për atë kohë. Me vendimin nr. 22, datë 20.01.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur anulimin e aktit administrativ dhe detyrimin e palës së paditur, DPPSH-së, për të dëmshpërblyer kërkuesin me 6 muaj paga, si dhe rrëzimin e kërkimit për kthimin në punë. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 05.05.2004.

II. Procesi i dytë gjyqësor

3. Kërkuesi ka pretenduar se pas anulimit të aktit administrativ i ka lindur e drejta për të përfituar dy paga mujore dhe tre vjet pagesë kalimtare. Për këtë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me padi, e

cila, me vendimin nr. 26, datë 18.01.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova e në ligj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesi është larguar nga Policia e Shtetit për thyerje disipline dhe vendimi për të mos përfituar pagesë kalimtare bazohet në nenin 6 të ligjit nr. 8661, datë 18.09.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit" (*ligji nr. 8661/2000*), ku janë të përcaktuara rastet kur punonjësi i policisë ndërpret karrierën për disa arsye, mes të cilave për thyerje disiplinore dhe në këtë rast nuk mund të përfitojë pagesë kalimtare.

4. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 269, datë 07.02.2008, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe pranimin e padisë, duke detyruar Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër për të paguar pagesën kalimtare në masën e dy pagave dhe 50 % të pagës bazë nga data 01.02.2003-31.12.2004. Pas rekursit të ushtruar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër dhe kundërrekursit të kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1139 (207), datë 26.04.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit me arsyetimin se vendimi i marrë nga ajo gjykatë ishte i drejtë.

III. Procesi i tretë gjyqësor

5. Kërkuesi në datën 22.05.2018 i është drejtuar me kërkesë DPPSH-së për njohjen e vjetërsisë në punë për efekt të shërbimit në Policinë e Shtetit, ku përfshihej edhe koha e ndërprerjes së karrierës nga data 01.02.2003 deri në 31.12.2004. Në përgjigje të kësaj kërkese, me shkresën nr. 707/10 prot., datë 20.06.2018, drejtori i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse në DPPSH ka informuar kërkuesin se për përfitimin e pensionit të parakohshëm duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10142/2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 10142/2009*), sipas të cilit e drejta për pension të parakohshëm, për meshkujt, përfitohet kur plotësohet vjetërsia në shërbim 15 vjet dhe mosha 47 vjeç.

6. Në datën 06.06.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi për detyrimin e DPPSH-së për të nxjerrë aktin administrativ për njohjen e vjetërsisë në punë (shërbim), ku të përfshihej koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të urdhrit të padrejtë

të deklaruar me vendim gjykate, për efekt të shpërblimeve dhe përfitimeve ligjore si punonjës i Policisë së Shtetit.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2945 (80-2018-3008), datë 24.07.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Sipas saj, kërkuesi nuk gëzon legjitimitet për t'i kërkuar DPPSH-së që t'i njohë vjetërsinë në punë si punonjës policie, për sa kohë ky kërkim mund t'i drejtohet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH)* dhe mund ta përfitojë vetëm me plotësimin e kushteve të tjera për përfitimin e pensionit. Kjo gjykatë ka vijuar në arsyetim se kërkuesi nuk e ka mbushur moshën për pension dhe as ka paraqitur kërkesë për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10142/2009 *(shih faqet 11-12 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë)*.

8. Kërkuesi në datën 07.08.2018 ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja është regjistruar në datën 28.09.2018 dhe vijon të jetë në pritje për t'u gjykuar në atë gjykatë. Sipas informacionit në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit çështja është me statusin "në përpunim".

9. Në vijim, pra pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në DRSSH-në, Tiranë për përfitimin e pensionit të parakohshëm. Kërkesa është regjistruar me nr. 3638 regjistrimi, datë 11.11.2019 në njësinë përkatëse të vendbanimit të tij.

10. Kërkuesi ka përsëritur kërkesën e tij *(shih paragrafin 5 të vendimit),* duke iu drejtuar DPPSH-së në datën 13.11.2019 dhe Ministrisë së Brendshme në datën 19.10.2021. Për këto kërkesa nuk rezulton të ketë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

11. Në kushtet kur çështja ishte ende në proces në Gjykatën Administrative të Apelit, kërkuesi në datën 08.11.2023 ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak të kalimit të afatit 1-vjeçar të gjykimit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5683, datë 05.12.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se gjyqtari relator i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve, që i ishin ngarkuar atij sipas radhës së vjetërsisë së tyre.

12. Ndërkohë, kërkuesi në datën 14.11.2023 i është drejtuar përsëri DPPSH-së me kërkesë me të njëjtin kërkim. Me shkresën nr. 1101-D-1

prot., datë 11.12.2023, DPPSH-ja ka kthyer përgjigje se për të përfituar pensionin e parakohshëm duhet të plotësohen kushtet e moshës dhe vjetërsisë në shërbim të përcaktuara në ligjin nr. 10142/2009. Kërkuesi e ka kundërshtuar shkresën duke iu drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje. Në datën 26.03.2024 ka përsëritur kërkimin e tij duke iu ridrejtuar DPPSH-së, e cila, me shkresën nr. 614-2/D, datë 08.05.2024, ka kthyer përgjigje se kërkesa e tij nuk mund të zgjidhet në rrugë administrative, pasi pretendimet e tij janë në proces gjyqësor dhe nuk janë zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

13. Në datën 06.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në datën 28.09.2018.

14. Në vijim, në datën 21.08.2024 *(data e shërbimit postar)* kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 28.10.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është *cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor* të drejtim të*:*

15.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi çështja në Gjykatën Administrative të Apelit ka më shumë se 6 vjet që nuk shqyrtohet, kur ajo ka detyrimin që ta shqyrtojë brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit. Procesi është në shkelje të afateve të arsyeshme dhe Gjykata duhet të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Thelbi i mosmarrëveshjes që pritet të gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe vonesa në gjykim ka shkaktuar dëm në sigurimin e mjeteve për jetesë. DPPSH-ja nuk i ka njohur kërkuesit të drejtën kushtetuese dhe ligjore të fituar me vendimin nr. 00-2012-1139 (207), datë 26.04.2012 të Gjykatës së Lartë.

15.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka gjykuar çështjen edhe pas më shumë se 6 vjetësh.

15.3. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm bie ndesh me jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës procesi i vetingut dhe mungesa e gjyqtarëve nuk mund të justifikojnë mosshqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

16. ***Subjekti i interesuar, DPPSH-ja,*** ka prapësuar se pretendimi për shkeljen e afatit të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit është i pabazuar. Për më tepër, pretendimi nuk është ngritur më parë në shkallët më të ulëta të gjyqësorit. Në vlerësim të standardeve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ),* në lidhje me afatin e arsyeshëm, nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar ose të jetë shtyrë gjykimi për shkak kërkesave apo sjelljes të palëve. Sjellja e Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur si pasojë e volumit të lartë të çështjeve të mbetura pa u gjykuar për një kohë të gjatë në raport me pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore për të përballuar volumin e punës. Një situatë e tillë e vendos organin gjyqësor në kushtet e pamundësisë objektive për procedim. Mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësimin dhe qëndrimin abuziv të gjyqtarit, por për shkak të pamundësisë objektive dhe pa vullnetin e saj, pra nuk kemi cenim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

17. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** ka prapësuar se:

17.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm* nuk është ngritur në nivel kushtetues. Në vlerësimin e kritereve për përcaktimin e kohëzgjatjes së arsyeshme, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave konkrete në të cilat ndodhet sistemi gjyqësor, siç janë zbatimi i reformës në drejtësi dhe ngarkesa individuale e gjyqtarit relator. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim edhe shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për të cilat ka mbajtur qëndrim koherent në raste të së njëjtës natyrë dhe vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës është marrë në zbatim të ligjit. Për sjelljen dhe interesin e palëve ndërgjyqëse, nuk konstatohet që të kenë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Për sa i përket asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga vonesa në gjykatën e

apelit, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra e rëndësia e të cilave do të justifikonte trajtimin me përparësi të çështjes.

17.2. *Pretendimi për konstatimin e shkeljes të së drejtës së aksesit dhe sigurisë juridike nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk është parashtruar nga kërkuesi me argumente, por në mënyrë deklarative në pjesën hyrëse të kërkesës, për rrjedhojë nuk duhet të merret në shqyrtim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

18. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

19. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit tej një afati të arsyeshëm.

20. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm,

Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 60, datë 19.09.2024; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka parashtruar se kërkuesi pretendimin për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nuk e ka paraqitur më parë në shkallët më të ulëta të gjyqësorit, duke mos shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

22. Gjykata konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, sipas parashikimit të nenit 399/6, shkronja "b", të KPC-së, që parashikon se në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë. Për këtë kërkesë Kolegji Administrativ, me vendimin nr. 00-2023-5683, datë 05.12.2023, ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se i vetmi mjet në dispozicion i kërkuesit për rivendosjen në vend të së drejtës të cenuar është ankimi kushtetues individual, pra kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive dhe pretendimi i DPPSH-së në këtë drejtim është i pabazuar.

23. Për legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 05.12.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 21.08.2024. Referuar dokumentacionit të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit të çështjes, rezulton se vendimi i kundërshtuar i është komunikuar individualisht avokatit të kërkuesit, R.I., në datën 02.07.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi jo vetëm shkelja është vazhduese, por nisur nga data 02.07.2024 ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

24. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se

kërkuesi ka parashtruar argumente për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgjykimit të çështjes brenda afatit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, shkelje që ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së aksesit dhe të parimit të sigurisë juridike. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se në thelb argumentet e kërkuesit janë të parashtruara në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pretendim i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe në vijim Gjykata do të analizojë bazueshmërinë e tij.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

25. Kërkuesi ka pretenduar se procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit ka mbi 6 vjet që vijon dhe vonesa ka shkaktuar dëm në të drejtën personale dhe mjetet për jetesë, sikurse është pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi në Policinë e Shtetit.

26. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar se në vlerësim të standardeve të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar ose të jetë shtyrë gjykimi për shkak kërkesave apo sjelljes të palëve. Mosveprimi i gjykatës administrative ka ardhur si pasojë e volumit të punës në raport me pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore për ta përballuar atë.

27. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është marrë duke respektuar kufijtë e objektit të saj dhe dispozitat që e rregullojnë këtë kërkim. Duke vlerësuar të gjitha elementet, si periudha që merret në konsideratë, sjellja e palëve ndërgjyqëse dhe ajo çka rrezikon kërkuesi, pretendimi nuk është i bazuar.

28. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, afat i arsyeshëm në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel do të konsiderohet përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë. Në rastin në shqyrtim, gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgjatur, ndaj për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, duhen analizuar rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. *Për sjelljen e kërkuesit,* sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret kërkuesi, pas mosveprimit të DPPSH-së për të shqyrtuar kërkesën e tij për njohjen e kohës së ndërprerjes së karrierës si vjetërsi në punë për efekt të shërbimit në Policinë e Shtetit, në datën 06.06.2018 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke nisur një proces gjyqësor ndaj DPPSH-së.

32. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2945 (80-2018-3008), datë 24.07.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kërkuesi në datën 07.08.2018 ka kundërshtuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja është regjistruar në atë gjykatë në datën 28.09.2018 dhe vijon të jetë në proces.

33. Nga parashtrimet shtesë të depozituara nga kërkuesi në Gjykatë, rezulton se ai ka paraqitur kërkesë në DRSSH-në, Tiranë për përfitimin e pensionit të parakohshëm, që është regjistruar me nr. 3638 në datën 11.11.2019 në njësinë përkatëse të vendbanimit të tij. Në datën 13.11.2019 ai i është drejtuar DPPSH-së, si dhe në datën 19.10.2021 Ministrisë së Brendshme, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje për kërkesën e tij.

34. Në kushtet kur çështja në Gjykatën Administrative të Apelit ishte

ende në proces, në datën 08.11.2023 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5683, datë 05.12.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se gjyqtari relator i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme organizative duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve sipas radhës së vjetërsisë së tyre *(shih faqen 5 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

35. Ndërkohë, kërkuesi në datën 14.11.2023 i është drejtuar përsëri DPPSH-së, e cila me shkresën nr. 1101-D-1 prot., datë 11.12.2023 ka kthyer përgjigje se për të përfituar pensionin e parakohshëm duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10142/2009 lidhur me moshën dhe vjetërsinë në shërbim. Kërkuesi e ka kundërshtuar përgjigjen duke iu drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje.

36. Në datën 26.03.2024 ka përsëritur kërkimin e tij duke iu drejtuar DPPSH-së, e cila me shkresën nr. 614-2/D, datë 08.05.2024 ka kthyer përgjigje se kërkesa e tij nuk mund të zgjidhet në rrugë administrative, pasi çështja është në proces gjyqësor dhe nuk është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Në vijim, në datën 06.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

37. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes gjyqësore.

38. *Për kompleksitetin e çështjes,* Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme *(shih vendimet*

nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

39. Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative, me objekt detyrimin e DPPSH-së për të nxjerrë aktin administrativ, për njohjen e vjetërsisë në shërbim në Policinë e Shtetit, për të cilën, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimin e tij pa provuar periudhat e shërbimit të njohura nga institucioni përgjegjës, si dhe pa pasur një vendimmarrje nga DRSSH-ja për kërkimin e tij për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kërkuesi nuk e ka mbushur moshën për pension dhe as ka paraqitur kërkesë për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10142/2009 dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova *(shih paragrafin 7 të vendimit)*. Gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar brenda një afati 1 muaj e gjysmë, pasi çështja është regjistruar në datën 05.06.2018 dhe vendimi është i datës 24.07.2018, duke pasur vetëm një palë të paditur, DPPSH-në. Duke iu referuar rrethanave, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse, e tillë që të justifikojë kohëzgjatjen prej më shumë se 6 vjetësh në Gjykatën Administrative të Apelit.

40. *Për sjelljen e autoriteteve,* në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 9, datë 04.03.2025; nr. 25, datë 11.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

41. Për këtë kriter, Gjykata konstaton se çështja e kërkuesit është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit prej më shumë se 6 vjetësh, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në KPC dhe në ligjin nr. 49/2012. Çështja i është caktuar me short gjashtë gjyqtarëve, konkretisht në datat 28.08.2019, 25.06.2020, 31.03.2021, 25.11.2021, 28.07.2022 dhe së fundmi në 19.09.2023. Pavarësisht kësaj, përveç organizimit të shorteve dhe kalimit të çështjes nga njëri gjyqtar relator tek tjetri, nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera me çështjen. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, duke arsyetuar se mosveprimi i gjykatës

së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por për shkak të ngarkesës së lartë dhe nuk mund t'i kërkohet gjykatës që të marrë masa për përshpejtim të procedurave, kur konstatohet se ajo ndjek kritere transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë *(shih faqet 3-4 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

42. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata konstaton se çështja konkrete është regjistruar në atë gjykatë në datën 28.09.2018, në një kohë kur reforma në drejtësi kishte filluar të zbatohej. Aktualisht, ajo gjykatë është me organikë të plotësuar, 13 gjyqtarë dhe po vijon me gjykimet aty ku ishin ndalur në vitin 2017. Gjyqtarja relatore, së cilës i është caktuar së fundmi çështja e kërkuesit, ka për shqyrtim 2639 çështje gjyqësore, ndërkohë që nuk rezulton që ndonjë nga relatorët të ketë kryer veprime me dosjen.

43. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuesit është pasojë e ngarkesës së lartë të gjyqtares relatore dhe në tërësi të Gjykatës Administrative të Apelit si pasojë edhe e zbatimit të reformës në drejtësi. Në këtë drejtim, Gjykata thekson në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët *(shih vendimin nr. 57, datë 17.09.2024 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këto rrethana, Gjykata çmon se vonesa prej më shumë se 6 vjetësh në Gjykatën Administrative të Apelit është në shkelje të afatit të arsyeshëm ligjor edhe si pasojë e sjelljes së gjykatës.

44. *Për rëndësinë e asaj çfarë rrezikohet,* Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar se çështja që është në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit lidhet me pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, i cili është një përfitim që jepet duke mbajtur në konsideratë

natyrën e punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Referuar rrethanave të çështjes, Gjykata vlerëson se pavarësisht faktit se në objektin e padisë së ngritur nga kërkuesi nuk është shprehur drejtpërdrejt ky kërkim, veprimet që ai ka kryer duke iu drejtuar disa herë me kërkesë DPPSH-së për nxjerrjen e aktit administrativ për të përfshirë në vitet e vjetërsisë në shërbimin në Policinë e Shtetit periudhën e largimit nga detyra, si dhe përgjigja nga DPPSH-ja se kërkesa e tij nuk mund të pranohet, pasi çështja është në proces gjyqësor, në thelb lidhen me të drejtën për pension të parakohshëm.

45. Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "*vetjakë e jetësorë*", duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në lidhje me të drejtën për pension, Gjykata ka pohuar se e drejta për pension është një e mjet i domosdoshëm për jetesën, në të njëjtën linjë sikurse edhe GJEDNJ-ja, e cila ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm", të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj *(shih vendimin nr. 60, datë 19.09.2024 të Gjykatës Kushtetuese).* Edhe vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor *(KLGJ)* në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 i ka vlerësuar çështjet e përfitimit të pensionit me natyrë specifike, të cilat duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë (*shih kreun II, pika 3, nënpika 3.1., shkronja "g", të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të KLGJ-së "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit"*).

46. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkimi kryesor në ankimin kushtetues individual lidhet me cenimin e së drejtës për pension të parakohshëm dhe që pavarësisht faktit se nuk është pension pleqërie, në thelb janë të ngjashëm, sepse janë përfitime vetjake dhe mjete jetese.

Gjykata, duke mbajtur në konsideratë kohën prej më shumë se 6 vjetësh për shqyrtimin e çështjes në raport me ngarkesën me të cilën përballet sistemi i drejtësisë, vlerëson se kjo çështje rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj ka përparësi në radhën e shqyrtimit. Për më tepër në kushtet kur kërkuesi i është drejtuar disa herë subjektit të interesuar, DPPSH-së, për të kryer veprimet përkatëse.

47. Për sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej kritereve kushtetuese, në rrethanat e rastit konkret, tejzgjatja e procedurave gjyqësore prej më shumë se 6 vjetësh për shqyrtimin e një çështjeje të tillë me kompleksitet të ulët paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuesit, si dhe për rëndësinë e së drejtës për pension të parakohshëm, ndaj Gjykata konstaton se kërkuesit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit dhe vlerëson se kërkesa duhet të pranohet, si dhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes së kërkuesit në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të shfuqizohet.

48. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës dhe volumin e çështjeve të ngjashme, Gjykata në rastin konkret çmon se duhet të urdhërohet shqyrtimi i çështjes së kërkuesit nga Gjykata Administrative e Apelit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-5683, datë 05.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen e kërkuesit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi .

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.03.2025
Shpallur më 18.04.2025

Vendim nr. 14, datë 25.03.2025
(V-14/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 25.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 17 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **ELDA KOZMA, TEA KOZMA,** përfaqësuar nga avokat Ervin Metalla, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
SHOQËRIA E SIGURIMEVE "SIGMA-VIENNA INSURANCE GROUP" SH.A.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3498 (508), datë 20.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueseve, Elda dhe Tea Kozma (*kërkueset*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve

me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimeve "SIGMA-Vienna Insurance Group" sh.a., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkueset janë trashëgimtare ligjore të të ndjerit Q.K. Ky i fundit ka qenë i punësuar si specialist pranë shoqërisë së sigurimeve "SIGMA-Vienna Insurance Group" sh.a *(shoqëria).* Në datën 15.07.2011, pranë godinës ku ndodhen zyrat e shoqërisë, në afërsi të hyrjes së garazheve, ka ndodhur një ngjarje. Shtetasi R.K., babai i një punonjësi të shoqërisë, ndërsa ka qenë duke larë një makinë të saj, në një moment, ndërsa është bllokuar elektropompa e vendosur brenda një pusete aty pranë dhe që shërbente për largimin e ujërave të bardha, në përpjekje për zhbllokimin e elektropompës, ka rënë në kontakt me rrymën elektrike duke mbetur i shtrirë mbi pusetë. Ndërkohë, trashëgimlënësi i kërkueseve, shtetasi Q.K., i cili ka qenë duke dalë nga zyrat e shoqërisë, pa e ditur shkakun e gjendjes në atë pozicion të shtetasit R.K., i është afruar atij menjëherë për t'i dhënë ndihmë, duke rënë në kontakt me rrymën elektrike. Si pasojë, të dy këta shtetas kanë gjetur vdekjen.

2. Për këtë ngjarje është realizuar inspektim nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sigurinë nga rreziku elektrik, konkretisht Inspektorati Qendror Teknik *(IQT),* i cili, në bashkëpunim edhe me shoqërinë e shpërndarjes së energjisë elektrike (CEZ sh.a.), ka përpiluar aktin e ekspertimit teknik të datës 15.07.2011, në të cilin janë përshkruar rrethanat dhe vlerësimet për shkaqet e ndodhjes së aksidentit. Po ashtu, pas njoftimit nga ana e shoqërisë, është realizuar inspektim edhe nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht Inspektorati Shtetëror i Punës *(ISHP),* i cili ka përpiluar aktet përkatëse të inspektimit dhe kontrollit.

3. Gjithashtu, për ngjarjen, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë *(Prokuroria e Tiranës)* ka filluar procedimin penal për veprën penale "Shkelja e rregullave të sigurimit në punë", të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal. Në kuadër të këtij procedimi penal janë marrë deklarimet e disa shtetasve, përfshirë edhe punonjës të shoqërisë. Është realizuar ekspertimi mjeko-ligjor dhe është administruar akti i ekspertimit

i datës 15.07.2011, sipas të cilit shkaku i vdekjes së dy viktimave ka qenë ndalimi i menjëhershëm i zemrës si pasojë e kontaktit me rrymën elektrike. Në kuadër të këtij procedimi penal është administruar edhe praktika dokumentare e ISHP-së, sikundër janë marrë edhe deklarimet e inspektorit përkatës, referuar të cilave shoqëria ka pasur mungesë të një rregulloreje të sigurimit teknik në punë, përveç edhe të një personi të specializuar për mbikëqyrjen e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të një personi të specializuar për trajnimin e punonjësve për zbatimin e rregullave të sigurisë në punë. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Tiranës, me vendimin e datës 05.12.2012, ka vendosur pushimin e çështjes penale, bazuar në nenin 328/b të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, me arsyetimin se ndonëse gjendeshim para veprimeve të subjektit punëdhënës në mospërmbushje dhe mosrespektim të detyrimeve për sigurinë në punë të punonjësve, në rastin konkret mungonte subjekti i veprës penale, pikërisht personi përgjegjës për sigurinë në punë, ndërsa shoqëria ka qenë ende brenda afatit për caktimin e një personi të tillë referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 29.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" *(VKM nr. 108/2011)*.

4. Në datën 22.04.2013 kërkueset i janë drejtuar gjykatës me padi kundër shoqërisë së sigurimeve, që ishte edhe punëdhënësja e trashëgimlënësit të tyre, me objekt detyrimin e saj për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror në masën 20.000.000 lekë si rezultat i vdekjes së të ndjerit Q.K. Sipas kërkueseve, shoqëria e paditur ka shfrytëzuar një ambient të godinës, ku ka edhe zyrat, për larjen e makinave të saj, veprimtari kjo që me miratimin në heshtje të saj është kryer nga shtetasi R.K., i cili zëvendësonte të birin e punësuar pranë saj. Për këtë veprimtari, sipas tyre, shoqëria ka pasur detyrimin për marrjen e masave për mënjanimin e rrezikut të shëndetit dhe sigurisë në punë, detyrim të cilin nuk e ka përmbushur dhe për pasojë ka ndodhur edhe vdekja e trashëgimlënësit të tyre. Padia është bazuar në dispozitat e Kodit Civil (KC) për detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit (nenet 608 e vijues), përfshirë edhe për përgjegjësinë e punëdhënësit ndaj dëmeve të shkaktuara për fajin e punonjësve të tij në shërbim (neni 618), ashtu edhe në dispozitat e Kodit të Punës në lidhje me përgjegjësinë e punëdhënësit për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë (neni 39).

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5757, datë 13.05.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueseve. Sipas asaj gjykate, nga analiza e çështjes në tërësi, nuk provohet ndonjë veprim/

mosveprim i paligjshëm i shoqërisë së paditur dhe, për pasojë, nuk mund të flitet për përgjegjësi në shkaktimin e dëmit dhe detyrimin për shpërblim të tij, duke mos u plotësuar në rastin konkret kërkesat e neneve 608 e vijues, 618 dhe 622 të KC-së. Kundër vendimit të sipërcituar kanë paraqitur ankim kërkueset.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3890, datë 01.12.2014, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur pranimin e padisë dhe detyruar shoqërinë e paditur për të dëmshpërblyer kërkueset në shumën 20.000.000 lekë. Gjykata e apelit ka arsyetuar se vdekja e trashëgimlënësit të kërkueseve ka ardhur si pasojë e mosveprimeve të shoqërisë së paditur, e cila, ndërsa ka pasur detyrimin ligjor për të marrë masa për mënjanimin e rrezikut në vendet e punës, ka lejuar të ndjerin R.K. të lante makinat, në ambientet që përdoreshin nga ajo, në shkelje të rregullave të ruajtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit është paraqitur rekurs nga shoqëria e paditur.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3498 (508), datë 20.09.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material të zbatueshëm në çështjen konkrete, neneve 608 e vijues të KC-së, ndërkohë që vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit material.

8. Në datën 29.07.2024 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 24.10.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkueset***, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se u janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar më ligj,* pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të saj kushtetues si gjykatë ligji, duke kryer një vlerësim tërësisht të ndryshëm nga gjykata e apelit të të njëjtave fakte

dhe arritur në përfundimin se vendimi i asaj gjykate duhet ndryshuar jo për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, por për shkak të vlerësimit të ndryshëm të provave. Kur gjykata e apelit ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i rivlerëson faktet dhe provat ndryshe, siç ka ndodhur në rastin konkret, Gjykata e Lartë në shqyrtimin e rekursit nuk mund të zgjedhë se cilin vlerësim të fakteve duhet të marrë për të vërtetë, por është e detyruar që të konsiderojë të drejtë vlerësimin e fakteve të bërë nga gjykata e apelit, si gjykata e fundit që ka vlerësuar faktet dhe provat dhe vendimi i së cilës është objekt rekursi. Diferenca midis vendimeve të gjykatave të faktit në rastin në shqyrtim ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe të fakteve dhe problematika në këtë rast lidhet vetëm me cilësimin juridik të tyre, por jo me zbatimin e ligjit nga gjykata e apelit. Ndërhyrja e Gjykatës së Lartë duke i rikualifikuar faktet bazuar në vlerësimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë, si dhe duke bërë edhe një vlerësim të mëtejshëm të tyre nuk është në pajtim me funksionin e saj si gjykatë ligji. Ajo gjykatë, edhe pse nuk gjeti zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit, e prishi vendimin e saj vetëm duke u bazuar në vlerësimin e provave dhe fakteve nga gjykata e shkallës së parë. Në respektim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata e Lartë, nëse vlerëson se për arritjen e një konkluzioni provat e administruara nuk janë të mjaftueshme ose nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme, nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, pikërisht për plotësimin e këtyre të metave, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit, siç ka ndodhur në rastin konkret.

9.1.2. *Së drejtës së aksesit substancial,* pasi ajo mënyrë disponimi nga Gjykata e Lartë u ka mohuar kërkueseve të drejtën për të kërkuar përgjegjësinë për të drejtën e shpërblimit për vdekjen e të afërmit të tyre, aq më tepër që ka kaluar një periudhë kohe shumë e gjatë nga momenti i ndodhjes së këtij fakti juridik. Në çdo rast, edhe nëse Gjykata e Lartë do të vlerësonte se hetimi gjyqësor nuk ishte kryer i plotë dhe në përputhje me

ligjin apo se çështja kishte nevojë për hetime të mëtejshme ose rivlerësim të provave, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore procedurale lidhur me fuqinë e tyre provuese, duhet ta kishte dërguar çështjen për rishqyrtim, por jo të linte në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për sa kohë gjykata e apelit nuk rezultonte të kishte zbatuar gabim ligjin material në raport me faktet e pranuara prej saj.

9.2. *Parimi i sigurisë juridike,* pasi vendimi i Gjykatës së Lartë ka anuluar pasojat e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, jo për zbatim të gabuar të ligjit, por për vlerësim të ndryshëm të fakteve dhe provave, në ndalim të juridiksionit të saj kushtetues si gjykatë ligji.

9.3. *E drejta e pronës*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, duke qenë produkt i një procesi të parregullt ligjor, për shkak të shkeljes së parimit të gjykatës së caktuar me ligj, u ka cenuar kërkueseve të drejtën e pronës. Ajo gjykatë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar padinë e kërkueseve, praktikisht i detyron ato të kthejnë shpërblimin e përfituar nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës së apelit pothuajse 9 vjet më parë.

10. ***Subjekti i interesuar, "SIGMA - Vienna Insurance Group" sh.a.,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

11. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000 që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për

rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkueset legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkueset i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 20.09.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është regjistruar në Gjykatë në datën 29.07.2024. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi i kësaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët dhe është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 04.06.2024. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkueset kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të së drejtës së aksesit substancial, si dhe të parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës.

17. Për sa i takon pretendimit lidhur me cenimin e së drejtës së aksesit substancial, kërkueset kanë parashtruar se mënyra e disponimit nga Gjykata e Lartë u ka mohuar atyre të drejtën për të kërkuar përgjegjësinë në lidhje me të drejtën e shpërblimit për vdekjen e të afërmit të tyre, aq më tepër kur ka kaluar një periudhë kohe shumë e gjatë nga momenti i ndodhjes së këtij

fakti juridik, me argumentin se ajo gjykatë ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata vëren se kërkueset nuk kanë parashtruar se si pretendimi i ngritur lidhet me argumentin e paraqitur nga ato. Fakti që Gjykata e Lartë ka disponuar për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e cila, nga ana tjetër, ka rrëzuar padinë e kërkueseve, nuk lë dyshime për cenimin atyre të së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë, në mungesë të parashtrimit të argumenteve kushtetuese, Gjykata çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkueset kanë parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka anuluar pasojat e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Mbi të njëjtin argument kërkueset kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private.

19. Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i parimit të sigurisë juridike, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse në lidhje me parimin *res judicata,* Gjykata ka theksuar se në aspektin formal e procedural gjë e gjykuar nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit *(shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa ajo ka disponuar për detyrimin e palës së paditur për pagimin e një dëmshpërblimi në favor të kërkueseve, për shkak të humbjes së jetës së të afërmit të tyre dhe ekzekutimin e tij si titull ekzekutiv nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, konsiderohet si vendim i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive (për sa kohë nuk ka një vendim të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të tij). Në këtë kuptim, ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*) për sa i përket zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, për sa kohë që palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit (pala e paditur ka paraqitur rekurs), duke e bërë në këtë mënyrë Gjykatën e Lartë kompetente për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur në lidhje me të. Për rrjedhojë, argumenti i parashtruar nga kërkueset nuk mund të shërbejë si argument

kushtetues në funksion të pretendimeve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronës private, ndaj këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

21. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, që lidhet me mënyrën e disponimit të Gjykatës së Lartë si pasojë e rivlerësimit të fakteve dhe provave ndryshe nga gjykatat e faktit, ai përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe do të trajtohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga gjykatë e caktuar me ligj

22. Kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të saj kushtetues si gjykatë ligji, duke kryer një vlerësim tërësisht të ndryshëm nga gjykata e apelit të të njëjtave fakte dhe arritur në përfundimin se vendimi i asaj gjykate duhet ndryshuar jo për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, por për shkak të vlerësimit të ndryshëm të provave. Kur gjykata e apelit ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i rivlerëson faktet dhe provat ndryshe, siç ka ndodhur në rastin konkret, Gjykata e Lartë në shqyrtimin e rekursit nuk mund të zgjedhë se cilin vlerësim të fakteve duhet të marrë për të vërtetë, por është e detyruar të konsiderojë të drejtë vlerësimin e fakteve të bërë nga gjykata e apelit, si gjykata e fundit që ka vlerësuar faktet dhe provat dhe vendimi i së cilës është objekt rekursi. Diferenca midis vendimeve të gjykatave të faktit në rastin në shqyrtim ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe të fakteve dhe problematika në këtë rast lidhet vetëm me cilësimin juridik të tyre, por jo me zbatimin e ligjit nga gjykata e apelit. Ndërhyrja e Gjykatës së Lartë duke i rikualifikuar faktet bazuar në vlerësimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë, si dhe duke bërë edhe një vlerësim të mëtejshëm të tyre nuk është në pajtim me funksionin e saj si gjykatë ligji. Ajo gjykatë, edhe pse nuk gjeti zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit, e prishi vendimin e saj vetëm duke u bazuar në vlerësimin e provave dhe fakteve nga gjykata e shkallës së parë. Në respektim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata e Lartë, nëse vlerëson se për arritjen e një konkluzioni provat e administruara nuk janë të mjaftueshme ose nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme, nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, pikërisht për plotësimin e këtyre të metave, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë

çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit, siç ka ndodhur në rastin konkret.

23. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ndërsa në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës parashikohet se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit.

24. Gjykata ka pohuar se përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas së cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Fjala "ligj", sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave (*shih vendimet nr. 16, datë 27.06.2022; nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 27, datë 27.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuadër, Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"*. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit *(shih vendimet nr. 23, datë 04.04.2024; nr. 52, datë 24.07.2017; nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*. Po ashtu, Gjykata është shprehur se kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilës ai është i detyruar të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar (*shih vendimet nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 44, datë 16.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata, bazuar në nenin 141 të Kushtetutës, përpara ndryshimeve të saj në vitin 2016, është shprehur, ndër të tjera, se Gjykata e Lartë ka juridiksion rishikues, ku në këtë nocion kushtetues

futet shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural *(shih vendimet nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 27, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit. Procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta *(shih vendimet nr. 36, datë 30.04.2024; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata po ashtu është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta (*shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 44, datë 19.07.2016; nr. 36, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Ndërkohë gjykimi i çështjeve civile në Gjykatën e Lartë rregullohet në mënyrë të detajuar në Kodin e Procedurës Civile (*KPC*). Neni 442 ka përcaktuar rekursin në Gjykatën e Lartë si një nga mjetet e ankimit, përmes të cilit palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kod (neni 442/b). Në vijim, neni 472 përcakton shkaqet për të cilat vendimet e gjykatës së apelit (po edhe ato të shkallës së parë në rastet e parashikuara në këtë kod) mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë, shkaqe të cilat në thelb

kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural të një natyre dhe rëndësie të veçantë për aspektet e një gjykimi të drejtë, qoftë në drejtim rregullshmërisë së procesit, ashtu dhe të rezultatit të gjykimit në pikëpamje të zbatimit të ligjit material në lidhje me drejtën subjektive të pretenduar. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, si rregull, bëhen brenda kufijve të rekursit, pra për çështje të zbatimit të ligjit, përveç kur ligji parashikon ndryshe (neni 473/a, pika 1). Neni 485 i kodit ka rregulluar edhe mënyrat e disponimit të Gjykatës së Lartë, ku për sa i përket zgjidhjes përfundimisht nga ajo të çështjes ka parashikuar kompetencën e asaj gjykate për të prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë (shkronja "b"), për të ndryshuar vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe zgjidhur përfundimisht çështjen kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes (shkronja "dh") dhe për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit (shkronja "e").

27. Nën dritën e garancive të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, duke pasur parasysh standardet kushtetuese të mësipërme dhe në referim të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruara nga kërkueset, Gjykata në vijim do të analizojë nëse Gjykata e Lartë ka vepruar ose jo brenda kompetencave të saj si gjykatë ligji, pra nëse ajo ka zgjidhur përfundimisht çështjen duke u bazuar në të njëjtat fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit.

28. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për çështjet e faktit dhe, për pasojë, edhe për sa i përket zbatimit të ligjit material. Kështu, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se faktet e pretenduara nga kërkueset nuk provohen, duke rrëzuar padinë e tyre, ndërkohë që gjykata e apelit ka arritur në një përfundim të ndryshëm dhe ka pranuar padinë.

29. Konkretisht, për sa u përket fakteve, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimet se paditëset (kërkueset), në përputhje me barrën e tyre të provës, nuk kanë provuar në gjykim faktin se i ndjeri R.K. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë së paditur, as se ajo i ka besuar atij larjen e makinave të saj, as se një veprimtari e tillë nga ai është kryer në vazhdimësi dhe është lejuar me mosveprime prej saj, sikundër as faktin se larja e makinës si proces pune ka qenë shkaku i ndodhjes së aksidentit, përkundrazi u provua se aksidenti ka ndodhur për shkak të shkeljes së rregullave teknike në

instalimin e elektropompës. Po sipas saj, nuk është provuar as fakti se vendi ku ka ndodhur ngjarja, puseta, përfshihet në ambientet e punës së shoqërisë së paditur dhe as se kjo e fundit ka instaluar elektropompën, përkundrazi u provua se puseta ndodhet në ambientet e përbashkëta të pallatit ku shoqëria e paditur është vetëm një nga "banorët" e saj, duke mos qenë ajo as administratore e ndërtesës, as mirëmbajtësja e pusetës dhe e elektropompës. Sipas gjykatës së shkallës së parë, vendimi penal i prokurorit për pushimin e çështjes penale, i paraqitur si provë nga paditëset, nuk është vendim penal i formës së prerë në kuptim të nenit 70 të KPP-së, i cili të ketë konkluduar për kryerjen e veprës penale dhe se ajo është kryer nga i gjykuari, ndaj ky vendim nuk është i detyrueshëm për gjykatën civile dhe konkluzionet e prokurorit nuk e kushtëzojnë atë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes civile, në të cilën gjykata shqyrton pretendimet e palëve dhe provat të marra konform ligjit procedural civil. Po sipas saj, deklarimet e personave të marra në kuadër të hetimeve të procedimit penal nga oficeri i Policisë Gjyqësore, pra jo duke iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, referuar KPP-së vlerësohen si prova vetëm nëse lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre, ndërsa referuar KPC-së provat merren në formën e parashikuar nga ky kod dhe në respektim të parimit të kontradiktoritetit, ndërkohë që në rastin konkret paditëset nuk kanë kërkuar thirrjen e atyre shtetasve me cilësinë e dëshmitarëve dhe për pasojë t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor.

30. Po sipas gjykatës së shkallës së parë nuk u provua fakti që shoqëria e paditur ka pasur një rregullore të sigurisë në punë, por se një gjë e tillë nuk është konstatuar si shkelje në aktin e inspektimit të ISHP-së gjatë hetimit të aksidentit, çka, sipas saj, përkonte me faktin se puseta dhe elektropompa brenda saj ndodheshin jashtë ambienteve të punës së shoqërisë së paditur dhe nuk i nënshtroheshin detyrimit për një rregullim teknik sigurie nga ana e saj. Po ashtu, sipas asaj gjykate, nuk u provua as fakti që shoqëria e paditur të ketë caktuar një person të specializuar për çështjet e sigurisë në punë, por megjithatë afati për përmbushjen e një detyrimi të tillë sipas VKM-së nr. 108/2011 daton pas datës së aksidentit në rastin konkret. Mbi këtë bazë, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se nuk vërtetohen veprime/mosveprime të paligjshme të shoqërisë së paditur në raport me pasojën e ardhur, ndaj nuk mund të flitet për përgjegjësi civile të saj në shkaktimin e dëmit dhe detyrim për shpërblim të tij.

31. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimet se provohet fakti se i ndjeri R.K., me miratimin në heshtje të shoqërisë së paditur, zëvendësonte të birin e punësuar pranë saj, duke pasur për detyrë mirëmbajtjen e ambienteve

funksionale të saj, përfshirë edhe larjen e makinave të shoqërisë. Ambienti ku i ndjeri lante makinat e shoqërisë, i cili ndodhej 4-5 metra nga garazhi i saj dhe shërbente si magazinë, edhe nëse pranohet se është pjesë e një ambienti të përbashkët të pallatit, në fakt është shfrytëzuar me dijeninë dhe lejen e shoqërisë pikërisht për këtë qëllim (larjen e makinave). Po sipas asaj gjykate, është provuar fakti se i ndjeri R.K. nuk ka qenë punonjës i kualifikuar për punën që kryente dhe se gjatë kryerjes së saj ditën e ngjarjes, në tentativë për të zhbllokuar elektropompën, duke mos qenë i specializuar, ka rënë në tension duke gjetur vdekjen, gjë të cilën e ka pësuar edhe trashëgimlënësi i paditëseve, i cili ka shkuar për t'i dhënë ndihmë atij. Shoqëria e paditur, arsyeton ajo gjykatë, nuk ka pasur rregullore për sigurinë në punë dhe as një person të specializuar për mbikëqyrjen e rregullave të sigurisë në punë, megjithëse ka pasur detyrim ligjor dhe profesional për t'u kujdesur për kushtet e punës dhe të instruktonte punonjësit e saj (viktimat) me qëllim mbrojtjen e shëndetit të tyre. Në këtë mënyrë shoqëria e paditur nuk ka marrë masa për mënjanimin e rrezikut në vendin e punës, duke lejuar të ndjerin R.K. të lante makinat në ambientin që përdorej prej saj, në shkelje të rregullave të sigurisë në punë. Sipas gjykatës së apelit, vendimi penal i prokurorit për pushimin e çështjes penale dhe aktet e procedimit penal janë prova shkresore në kuptim të nenit 254 të KPC-së, duke përbërë provë të plotë për përmbajtjen e tyre për sa kohë nuk janë kundërshtuar për falsitet. Mbi këtë bazë, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se vërtetohen mosveprime të paligjshme të shoqërisë së paditur në raport me pasojën e ardhur, ndaj ajo duhet të përgjigjet civilisht për dëmin e shkaktuar duke u detyruar për shpërblim të tij paditëseve.

32. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e shoqërisë së paditur kundër vendimit të gjykatës së apelit. Në analizë të kushteve të përgjegjësisë civile, për sa i përket atij të ekzistencës së dëmit, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se ky kusht nuk përmbushet, me arsyetimin se gjykatat e faktit në analizë të akteve të administruara në dosje kanë arritur në konkluzionin se humbja e jetës së të dy shtetasve ka ardhur si pasojë e lidhjes së xhuntos së pusetës dhe pompës, duke mos u vërtetuar kështu në gjykim se aksidenti ka ardhur si rrjedhojë e punës së viktimës R.K. pranë shoqërisë së paditur, se ky shtetas ka zëvendësuar në mënyrë ligjore në detyrë të birin dhe se ky i fundit ka pasur si detyrë funksionale larjen e makinave. Po ashtu, vijon ajo gjykatë, nuk rezulton që shoqëria e paditur të ketë pasur në pronësi ndonjë lavazh për larjen e makinave, ndërkohë që provohet se një veprimtari e tillë është kryer privatisht. Puseta

ku ka ndodhur aksidenti është e pallatit dhe jo e shoqërisë së paditur dhe ajo shërbente për tjetër qëllim. Bazuar në këto përfundime, Gjykata e Lartë, në vijim, ka gjetur të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë për mospërmbushjen edhe të kushteve të tjera të përgjegjësisë civile, atij për ekzistencën e veprimit a mosveprimit të paligjshëm dhe të lidhjes shkakësore midis tij dhe dëmit të ardhur.

33. Për sa i përket kushtit të fajit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se pala paditëse ka barrën e provës për të provuar elementet objektive, siç janë fakti i paligjshëm, dëmi dhe lidhja shkakësore dhe më tej barra e provës i kalon palës së paditur, e cila duhet të provojë se nuk ka vepruar me faj. Lidhur me këtë Gjykata e Lartë është shprehur se shoqëria e paditur ka provuar në gjykim se veprimtaria e larjes së makinave nuk është pjesë e objektit të saj të punës dhe se montimi dhe administrimi i pompës në oborrin e pallatit nuk është në përgjegjësinë e saj, por të administratorit të godinës ku ka selinë edhe ajo. Shoqëria nuk mund të prezumohet fajtore për dëmin e ardhur paditëseve, në kushtet kur ajo ka provuar të kundërtën. Gjykata e Lartë e ka gjetur të drejtë analizën e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me efektet e vendimit penal të prokurorit për pushimin e çështjes penale në kuptim të nenit 70 të KPP-së, duke theksuar se vlera e një vendimi të tillë trajtohet së bashku me provat e tjera të marra në gjykim dhe përputhshmërisë mes tyre, ndërsa të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit paraprak formohen si prova vetëm kur administrohen në debatin gjyqësor. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka konkluduar se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material të zbatueshëm në çështjen konkrete, neneve 608 e vijues të KC-së, ndërkohë që vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në zbatim dhe interpretim të drejtë të tij.

34. Fillimisht në analizën e çështjes Gjykata konstaton se në funksion të fakteve të pretenduara, kërkueset kanë paraqitur dhe gjykata e shkallës së parë ka pranuar marrjen si prova të vendimit penal të prokurorit për pushimin e çështjes penale, të disa prej akteve të administruara gjatë atij procedimi penal, si dhe të praktikës dokumentare të IQT-së. Megjithatë, për sa u përket akteve të administruara gjatë procedimit penal dhe në veçanti deklarimeve të shtetasve, ajo gjykatë nuk i ka çmuar ato në marrjen e vendimit, me arsyetimin se nuk janë marrë nga gjykata në një proces gjyqësor ku është respektuar parimi i kontradiktoritetit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, për sa i përket vendimit penal të prokurorit për pushimin e procedimit penal, ka çmuar se ai nuk ka efekt detyrues për procesin civil ku shqyrtohen pasojat civile të veprës penale. Pavarësisht kësaj, për disa

nga faktet e pranuara si të provuara, ajo gjykatë u është referuar edhe këtyre akteve. Nga ana tjetër, gjykata e apelit i ka konsideruar aktet e paraqitura nga kërkueset si prova shkresore, disa nga të cilat me fuqi të plotë provuese, duke i çmuar ato në marrjen e vendimit përfundimtar dhe, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, ka arritur në përfundimin se faktet e pretenduara nga kërkueset provohen. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, megjithëse gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me vlerën dhe fuqinë provuese të provave të paraqitura nga kërkueset, pra për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit procedural, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konfirmuar përfundimet e saj për çështje të faktit, madje duke zgjeruar edhe disa nga këto përfundime. Po ashtu, ajo nuk ka treguar as arsyet se përse qëndrimi i gjykatës së apelit ishte i gabuar në lidhje me çmuarjen e provave, megjithëse objekt kontrolli nga ana e saj ka qenë pikërisht ky i fundit. Thënë sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë pa ndonjë arsyetim nuk ka konsideruar përfundimet e gjykatës së apelit për çështjet e faktit, por ka zgjedhur që si të tilla të konsiderojë ato të gjykatës së shkallës së parë. Duke vepruar në këtë mënyrë duket se Gjykata e Lartë në rastin konkret praktikisht ka ripërcaktuar faktet e çështjes dhe mbi këtë bazë ka zgjidhur përfundimisht çështjen duke prishur vendimin e gjykatës së apelit, jo për zbatim të gabuar të ligjit procedural, por atij material.

35. Gjykata vëren se bazuar në nenin 141 të Kushtetutës interpretimi i dispozitave që lidhen me procedurën e shqyrtimit të rekurseve është detyrë funksionale e Gjykatës së Lartë, megjithatë ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetuese kur vihet në diskutim parimi i gjykatës së caktuar me ligj, në kuptimin që Gjykata analizon nëse Gjykata e Lartë u është përmbajtur kompetencave të saj të dhëna nga ligji. Në respektim të neneve 42, pika 2 dhe 135, pika 1, të Kushtetutës, përmes legjislacionit për organizimin gjyqësor, janë krijuar Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat ushtrojnë pushtetin gjyqësor, duke pasur për funksion dhënien e drejtësisë. Pavarësisht sistemit me tre nivele të ushtrimit të pushtetit gjyqësor, ligji procedural civil ka përcaktuar kufijtë e juridiksionit, pra të kompetencës për secilin nivel juridiksioni. Kështu, për gjykatën e shkallës së parë ligji ka përcaktuar se ka juridiksion të plotë gjyqësor, pra se ka kompetencë të zgjidhë çështjen në themel duke shqyrtuar meritat e saj si për aspekte të faktit, ashtu edhe të ligjit, ndërkohë që për gjykatën e apelit, si gjykatë e një niveli më të lartë, ligji ka përcaktuar se ka kompetencë të korrigjojë çdo gabim të mundshëm të gjykatës së shkallës

së parë për të dyja këto aspekte të procesit gjyqësor, duke pasur edhe ajo juridiksion të plotë gjyqësor për zgjidhjen e çështjes në themel. Pikërisht, nisur nga kompetencat e tyre për të vendosur për çështje të faktit, këto dy gjykata në jurisprudencë identifikohen edhe si gjykata fakti. Nga ana tjetër, për Gjykatën e Lartë Kushtetuta dhe ligji, në vijim, kanë përcaktuar një juridiksion të kufizuar, ngushtësisht ligjor, duke pasur ajo kompetencë të korrigjojë vendimet e gjykatave më të ulëta për aspekte të ligjit, por jo të faktit.

36. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se në një situatë kur dy gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje të faktit, Gjykata e Lartë ka juridiksion të kontrollojë zbatimin e ligjit procedural në lidhje me marrjen ose çmuarjen e provave nga gjykata e apelit, por ajo, si rregull, nuk mund të zgjidhë vetë çështjen përfundimisht duke ripërcaktuar faktet dhe cenuar vendimin e gjykatës së apelit, për sa kohë gjykatat më të ulëta nuk kanë të njëjtin qëndrim për faktet kryesore dhe të rëndësishme të çështjes. Kjo do të thotë se vetëm kur faktet janë të përcaktuara në mënyrë të njëjtë nga të dyja gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë, në ushtrim të kompetencës së kontrollit në lidhje me zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta, ka edhe kompetencën për të zgjidhur përfundimisht çështjen përmes zbatimit të drejtë të tij. Përndryshe, nëse Gjykata e Lartë e zgjidh çështjen përfundimisht duke i ripërcaktuar, në thelb, faktet dhe provat e çështjes, qoftë edhe duke konfirmuar ato të pranuara nga gjykata e shkallës së parë, kjo mënyrë të vepruari do të nënkuptonte zgjerim të juridiksionit të Gjykatës së Lartë edhe për çështje të faktit, çka është në tejkalim të juridiksionit ngushtësisht ligjor që Kushtetuta ka përcaktuar për të, për rrjedhojë edhe në cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

37. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë në rastin konkret ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të saj ngushtësisht ligjor, ndërsa ka rishqyrtuar dhe rivlerësuar faktet dhe provat e çështjes duke i ripërcaktuar në thelb vetë ato, mënyrë të vepruari kjo që bie ndesh me kompetencat e saj të përcaktuara në nenin 141 të Kushtetutës, në cenim të së drejtës së kërkueseve për proces të rregullt ligjor, për sa kohë kontrolli i saj nuk është fokusuar rreth mënyrës së zbatimit të ligjit nga gjykata e apelit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueseve për cenimin e së drejtë së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueseve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3498 (508), datë 20.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.03.2025
Shpallur më 21.05.2025

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që u përket kërkueseve Elda Kozma dhe Tea Kozma, me objekt: *"Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3498 (508), datë 20.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut",* jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi, në vlerësimin tim, pretendimi i kërkueseve është i pabazuar, për arsyet që do të parashtrohen në vijim.

2. Shumica e ka analizuar çështjen konkrete në këndvështrim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Në përfundim, shumica e ka gjetur këtë pretendim të bazuar, duke vlerësuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në arsyetimin e vendimit të tij, ka kryer një vlerësim të ndryshëm nga vlerësimi i të njëjtave fakte nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e kërkueseve për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

3. Shumica ka arsyetuar se në funksion të fakteve të pretenduara, kërkueset kanë paraqitur dhe gjykata e shkallës së parë ka pranuar marrjen si prova të vendimit penal të prokurorit për pushimin e çështjes penale, të disa prej akteve të administruara gjatë atij procedimi penal, si dhe të praktikës dokumentare të IQT-së. Megjithatë, për sa u përket akteve të administruara gjatë procedimit penal dhe në veçanti deklarimeve të shtetasve, ajo gjykatë nuk i ka çmuar ato në marrjen e vendimit, me arsyetimin se nuk janë marrë nga gjykata në një proces gjyqësor ku është respektuar parimi i kontradiktoritetit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, për sa i përket vendimit penal të prokurorit për pushimin e procedimit penal, ka çmuar se ai nuk ka efekt detyrues për procesin civil ku shqyrtohen pasojat civile të veprës penale. Pavarësisht kësaj, për disa nga faktet e pranuara si të provuara ajo gjykatë u është referuar edhe këtyre akteve. Nga ana tjetër, gjykata e apelit i ka konsideruar aktet e paraqitura nga kërkueset si prova shkresore, disa nga të cilat me fuqi të plotë provuese, duke i çmuar ato në marrjen e vendimit përfundimtar dhe, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, ka arritur në përfundimin se faktet e pretenduara nga kërkueset provohen. Në vijim, shumica ka argumentuar se megjithëse gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me vlerën dhe fuqinë

provuese të provave të paraqitura nga kërkueset, pra për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit procedural, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konfirmuar përfundimet e saj për çështje të faktit, madje duke zgjeruar edhe disa nga këto përfundime. Po ashtu, ajo gjykatë, arsyeton shumica, nuk ka treguar as arsyet se përse qëndrimi i gjykatës së apelit ishte i gabuar në lidhje me çmuarjen e provave, megjithëse objekt kontrolli nga ana e saj ka qenë pikërisht ky i fundit. Thënë sa më sipër, shumica ka vlerësuar se Gjykata e Lartë pa ndonjë arsyetim nuk ka konsideruar përfundimet e gjykatës së apelit për çështjet e faktit, por ka zgjedhur që si të tilla të konsiderojë ato të gjykatës së shkallës së parë. Duke vepruar në këtë mënyrë duket se Gjykata e Lartë në rastin konkret praktikisht ka ripërcaktuar faktet e çështjes dhe mbi këtë bazë ka zgjidhur përfundimisht çështjen duke prishur vendimin e gjykatës së apelit jo për zbatim të gabuar të ligjit procedural, por atij material (*shih paragrafin 34 të vendimit*).

4. Po kështu, shumica ka vlerësuar se në një situatë kur dy gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje të faktit, Gjykata e Lartë ka juridiksion të kontrollojë zbatimin e ligjit procedural në lidhje me marrjen ose çmuarjen e provave nga gjykata e apelit, por ajo, si rregull, nuk mund të zgjidhë vetë çështjen përfundimisht duke ripërcaktuar faktet dhe cenuar vendimin e gjykatës së apelit, për sa kohë gjykatat më të ulëta nuk kanë të njëjtin qëndrim për faktet kryesore dhe të rëndësishme të çështjes. Kjo do të thotë se vetëm kur faktet janë të përcaktuara në mënyrë të njëjtë nga të dyja gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë, në ushtrim të kompetencës së kontrollit në lidhje me zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta, ka edhe kompetencën për të zgjidhur përfundimisht çështjen përmes zbatimit të drejtë të tij. Përndryshe, nëse Gjykata e Lartë e zgjidh çështjen përfundimisht duke i ripërcaktuar, në thelb, faktet dhe provat e çështjes, qoftë edhe duke konfirmuar ato të pranuara nga gjykata e shkallës së parë, kjo mënyrë të vepruari do të nënkuptonte zgjerim të juridiksionit të Gjykatës së Lartë edhe për çështje të faktit, çka është në tejkalim të juridiksionit ngushtësisht ligjor që Kushtetuta ka përcaktuar për të, për rrjedhojë edhe në cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj (*shih paragrafin 36 të vendimit*).

5. Referuar rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim, vërej se midis kërkueseve dhe shoqërisë së sigurimeve ka pasur mosmarrëveshje për shpërblimin e dëmit të ardhur si pasojë e vdekjes së të ndjerit Q.K. familjar i afërt i kërkueseve. Për këtë shkak, nga ana e tyre është vënë në lëvizje

procesi gjyqësor, duke kërkuar shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror në vlerën 20.000.000 lekë. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka rrëzuar kërkesëpadinë, ndërkohë që mbi ankimin e kërkueseve, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e padisë. Ky vendim është rekursuar nga shoqëria e sigurimeve dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të saj kushtetues si gjykatë ligji, duke kryer një vlerësim tërësisht të ndryshëm nga vlerësimi i të njëjtave fakte nga gjykata e apelit, dhe ka arritur në përfundimin se vendimi i gjykatës së apelit duhej ndryshuar jo për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit nga kjo gjykatë, por për shkak të vlerësimit të ndryshëm të provave. Kur gjykata e apelit ndryshon vendimin e gjykatës së rrethit dhe rivlerëson faktet dhe provat ndryshe, Gjykata e Lartë nuk mund të zgjedhë se cilin vlerësim të fakteve duhet të marrë për të vërtetë, por është e detyruar të konsiderojë të drejtë vlerësimin e fakteve të bërë nga gjykata e apelit, vendimi i së cilës është objekt rekursi. Kjo qasje sjell kontradiksion midis dispozitivit të vendimit dhe arsyetimit të tij. Gjykata e Lartë jo vetëm ka nxjerrë konkluzion në të kundërt me konkluzionet e dy gjykatave të faktit, por ka bërë edhe vlerësim të mëtejshëm, i cili nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në atë gjykatë si gjykatë ligji.

7. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ndërsa në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës parashikohet se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit.

8. Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit. Procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës,

kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta *(shih vendimet nr. 36, datë 30.04.2024; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

9. Gjykata po ashtu është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 44, datë 19.07.2016; nr. 36, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këndvështrim të fakteve të parashtruara më sipër, unë gjyqtarja në pakicë vërej se, referuar dispozitave procedurale që zbatohen për shqyrtimin e rekurseve nga Gjykata e Lartë, në nenin 485, pika 1, shkronja "b", të KPC-së përcaktohet se Gjykata e Lartë pas shqyrtimit të çështjes vendos prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë, duke u bazuar në faktet e përcaktuara nga dy gjykatat e faktit, konkretisht nga gjykata e shkallës së parë, ka shpjeguar kuptimin e ligjit në mosmarrëveshjen konkrete, funksion i cili është brenda kompetencave të saj. Referimi që kjo gjykatë ka bërë në faktet dhe provat e administruara nga gjykatat më të ulëta, ka qenë në funksion të dhënies së një vendimit të arsyetuar, çka përforcohet me faktin se në përfundim të gjykimit, Gjykata e Lartë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien

në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pikërisht në përputhje me parashikimin e dispozitës së mësipërme.

11. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për faktin se veprimet e shoqërisë së sigurimeve nuk përbëjnë shkak për humbjen e jetës së R.K. dhe Q.K., është i lidhur me efektin provues që ka në procesin civil vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal, kjo në kushtet kur dy gjykatat e faktit kanë arsyetuar në mënyra të ndryshme për efektin provues të këtij vendimi. Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar si prova deklarimet e dhëna në kuadër të procedimit penal pasqyruar në vendimin e pushimit, ndërkohë që nga ana e gjykatës së apelit këto deklarime janë konsideruar me fuqi provuese në procesin objekt shqyrtimi. I gjendur para dy interpretimeve të ndryshme lidhur me fuqinë provuese të vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes (sipas nenit 70 të KPP-së dhe sipas nenit 254 të KPC-së), Kolegj Civil i Gjykatës së Lartë ka pranuar si të drejtë interpretimin e bërë nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, duke konkluduar se ai vendim nuk është i detyrueshëm për gjykatën civile sipas nenit 70 të KPP-së.

12. Në këtë kontekst, vlerësoj se Gjykata e Lartë në dhënien e vendimit ka vepruar brenda kompetencës së saj, përmes interpretimit të normave ligjore, çka, në veçanti, i përket rolit të saj si gjykatë ligji. Nga vendimi i saj nuk rezulton që ajo gjykatë të ketë shqyrtuar prova të reja, të ketë ripërcaktuar faktet e mosmarrëveshjes ose të ketë bërë rivlerësim të provave dhe nxjerrje të konkluzioneve të ndryshme nga gjykatat e faktit. Në vendimin e saj ajo gjykatë ka analizuar vlerësimin e bërë fakteve dhe provave nga ana e gjykatës së shkallës së parë, duke e konsideruar të drejtë atë arsyetim në raport me interpretimin e dispozitave materiale e procedurale. Pra Gjykata e Lartë, në rolin e saj si gjykatë ligji, ka ndërhyrë në këtë rast duke interpretuar ligjin procedural lidhur me faktin nëse deklarimet e dhëna para prokurorit ishin ose jo të detyrueshme për t'u marrë në shqyrtim nga gjykata civile referuar përcaktimeve të ndryshme që kishte ligji procedural penal në raport me atë civil. Në këtë kontekst nuk kemi të bëjmë me ripërcaktim provash, por me faktin nëse ato prova të mbledhur në kuadër të hetimit penal nga prokurori dhe të pa konfirmuara me një vendim përfundimtar janë apo jo të përdorshme në procesin civil

13. Po ashtu, në raport me konkluzionin e shumicës për mosmarrjen në analizë nga ana e Kolegjit Civil të faktit se ku kishte gabuar gjykata e apelit në lidhje me çmuarjen e provave, evidentoj se, në kundërshtim nga vlerësimi i shumicës, ai kolegj në paragrafin 18 të vendimit e merr

në shqyrtim dhe jep opinion për atë vendim në paragrafët vijues, duke konkluduar në paragrafin 26 dhe duke e konsideruar atë të gabuar.

14. Referuar arsyetimit të mësipërm, çmoj se procesi në këtë rast konsiderohet i rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për sa kohë Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, konkretisht në atë të shkallës së parë, ka vendosur të prishë vendimin e gjykatës së apelit duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Gjithashtu, duke pasur parasysh natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, vlerësoj se është i pashmangshëm referimi në provat gjyqësore për të interpretuar ligjin në përputhje me to.

15. Në përfundim të argumenteve të mësipërme, në vlerësimin tim, pretendimet e kërkueseve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej rrëzuar.

Anëtare: Sonila Bejtja

Vendim nr. 15, datë 03.04.2025
(V-15/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 03.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KLITON SPAHIU**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar nga kryetari Ilir Rusi.
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE, TIRANË, në mungesë.
GJYKATA E APELIT E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3089, datë 11.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe gjykimi i çështjes me procedurë të përshpejtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Kliton Spahiu (*kërkuesi*), që kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), që kërkoi rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës (*sot Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*) deri në datën 02.06.2021, kur KLGJ-ja ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra, si dhe ndërprerjen e menjëhershme të pagës dhe të përfitimeve të tjera të magjistratit. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga kërkuesi.

2. Pas mbarimit të funksionit të gjyqtarit, kërkuesi i është drejtuar DRSSH-së, Tiranë për përfitimin e pagesës kalimtare për 10 muaj. Kërkesa është kthyer pa veprim me argumentin se sipas dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi, ai nuk përfitonte pagesë kalimtare sipas ligjit.

3. Gjithashtu, kërkuesi ka kërkuar edhe nga KLGJ-ja përfitimin e pagesës kalimtare për një periudhë 2-mujore, bazuar në kuadrin ligjor për statusin e magjistratit dhe pensionet suplementare. Kërkesa është refuzuar me argumentin se statusi i tij i magjistratit kishte përfunduar për shkak të shkarkimit nga detyra, ndaj sipas ligjit nuk përfitonte pension suplementar.

4. Në këto rrethana, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar, shfuqizimin e akteve administrative të DRSSH-së, Tiranë dhe KLGJ-së, detyrimin e tyre për t'i paguar pagesën kalimtare për 12 muaj, tarifën dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm sipas përcaktimeve të nenit 317, paragrafi i parë, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2116 (80-2022-2158), datë 18.07.2022, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, shfuqizimin e aktit administrativ të DRSSH-së, Tiranë dhe detyrimin e saj për t'i paguar kërkuesit pagesën kalimtare për 10 muaj, detyrimin e Gjykatës së Apelit Durrës që t'i paguajë 2 paga bruto dhe rrëzimin e pjesës tjetër të padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi kërkuesi fillimisht ka paraqitur ankim të veçantë për sa i takon rrëzimit të kërkimit për ekzekutimin e përkohshëm, ndërsa më pas ka paraqitur apel për pranimin tërësisht të padisë. Po kështu, edhe DRSSH-ja, Tiranë ka paraqitur apel, duke kërkuar rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

6. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31154-02887-86-2022, datë 28.09.2022. Deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues, çështja e kërkuesit ka mbetur në pritje për t'u shqyrtuar.

7. Në datat 12.05.2023 dhe 02.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesa për përshpejtimin e çështjes së tij, të cilat nuk rezultojnë të jenë pranuar. Në vijim, në datën 16.06.2024 ai ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit në shkallë të dytë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3089, datë 11.07.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga gjyqtari relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, bazuar në kritere transparente, për marrjen në shqyrtim të çështjeve që i janë ngarkuar atij sipas radhës së vjetërsisë.

9. Në datën 17.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.10.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 03.12.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje

nga gjykata e apelit, ndonëse çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë.

11. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se tejzgjatja e procedurave nuk paraqet shkallë të konsiderueshme rreziku për kërkuesin dhe se vonesa është rrjedhojë e një problematike që e tejkalon këtë rast. Mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit.

12. ***Subjektet e interesuara, DRSSH-ja, Tiranë dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit në shqyrtimin e çështjes së tij dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkesë e cila është rrëzuar. Për rrjedhojë, i vetmi

mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

16. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 11.07.2024 dhe i është përcjellë kërkuesit në rrugë elektronike në datën 17.09.2024. Ky i fundit i është drejtuar Gjykatës në datën 17.10.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga data e marrjes dijeni përmes njoftimit elektronik të vendimit objekt kundërshtimi, në përputhje me nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do ta analizojë atë në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Apelit. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka interpretuar gabim dispozitat procedurale, pasi çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi nga gjykata, për më tepër që në rastin konkret janë tejkaluar edhe afatet maksimale të përcaktuara nga ligji, duke u zgjatur më shumë se 2 vjet. Po ashtu, sipas kërkuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë.

19. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve. Sipas tij, nuk duket që tejzgjatja e procedurave të paraqesë një shkallë të konsiderueshme rreziku për kërkuesin. Po kështu, subjekti i interesuar ka prapësuar se vonesa është rrjedhojë e një problematike që tejkalon rastin konkret dhe mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Në asnjë rast, sipas tij, cilësia nuk duhet të sakrifikohet për afatin e arsyeshëm ose ekonominë gjyqësore në tërësi.

20. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se mosmarrëveshja që është regjistruar për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit ka në objektin e saj detyrimin për kryerjen e pagesave kalimtare si pasojë e mbarimit të funksionit të magjistratit. Çështja është regjistruar fillimisht në gjykatën e shkallës së parë në datën 11.05.2022, e cila pas 2 muajve ka disponuar me vendimin e datës 18.07.2022. Në vijim, vetëm dy nga palët ndërgjyqëse kanë ushtruar ankim, i cili është regjistruar në gjykatën e apelit në datën 28.09.2022. Në analizë të këtyre të dhënave rezulton se ndonëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 10 muaj nga vënia në lëvizje e procesit gjyqësor, prej të cilave 2 vjet e 6 muaj në gjykatën e apelit, ende nuk ka një datë për përfundimin e tij.

22. Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ në apel. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa i takon *sjelljes së kërkuesit*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata konstaton se kërkuesi ka shfaqur interes për ecurinë e shpejtë

të gjykimit të çështjes, pasi i është drejtuar dy herë Gjykatës Administrative të Apelit, përkatësisht në datat 12.05.2023 dhe 02.04.2024, me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij. Në kushtet kur ai nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ajo gjykatë, në datën 16.05.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila e ka rrëzuar kërkesën dhe më tej ka paraqitur ankim kushtetues individual. Në këto rrethana nuk rezulton që kërkuesi të jetë bërë shkak për vonesën në gjykim, por ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale.

25. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes,* Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj kërkimin për përfitimin e pagesave kalimtare për një periudhë 10-mujore dhe të pagës 2-mujore bruto, bazuar në legjislacionin për statusin e magjistratit dhe për përfitimin e pensioneve suplementare për shkak të funksionit të kërkuesit si gjyqtar. Palë të paditura në gjykim janë tre institucione shtetërore, KLGJ-ja, DRSSH-ja, Tiranë dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Në thelb, çështja lidhet me përcaktimin e fakteve bazuar në dokumente dhe interpretimin e një numri të kufizuar ligjesh, pa pasur nevojë për marrjen e provave voluminoze dhe as për ndërthurje të shumta normash ligjore. Duke iu referuar këtyre aspekteve, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse.

26. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili pas mbarimit të funksionit të tij si gjyqtar ka kërkuar përfitimin e pagesave që rrjedhin nga zgjidhja e marrëdhënies së punës. Ky lloj kërkimi përfshihet në grupin e çështjeve që shqyrtohen me përparësi nga gjykata e apelit, i klasifikuar si i tillë në kalendarin e miratuar nga KLGJ-ja *(shih shkronjën "gj" të pikës 3.1 të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", të ndryshuar [vendimi nr. 78/2019]*). Ndërkohë që gjykata administrative e shkallës së parë e ka shqyrtuar padinë e kërkuesit brenda 2 muajve nga regjistrimi i saj, Gjykata Administrative e Apelit ende nuk ka caktuar një datë për shqyrtimin e ankimit, ndonëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 6 muaj nga regjistrimi i tij. Në gjykatën e apelit çështja e kërkuesit është rishortuar katër herë duke iu caktuar gjyqtarëve të ndryshëm, për shkak të riorganizimit të brendshëm. Përveç kalimit të akteve të çështjes nga njëri gjyqtar tek tjetri nuk rezultojnë të jenë kryer veprime të tjera, madje as kërkesat për përshpejtim të paraqitura nga kërkuesi nuk rezultojnë të jenë marrë në shqyrtim.

27. Edhe Gjykata e Lartë e ka refuzuar kërkesën për konstatimin e

shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, duke arsyetuar se vonesa në gjykim lidhej me ngarkesën e lartë të çështjeve, numrin e pakët të gjyqtarëve dhe të stafit ndihmës që ushtronin detyrën në atë gjykatë. Sipas saj, mosveprimi i gjyqtarit relator nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive, si dhe nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga ai. Mirëpo këto arsye bëjnë që barra e vonesës së shkaktuar nga faktorë të pavarur nga kërkuesi të zhvendoset tek ai, duke mos u respektuar standardi kushtetues në këtë drejtim *(shih paragrafin 20 të vendimit)*. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj duhet shfuqizuar.

28. Në lidhje me *atë çfarë rrezikon kërkuesi* në procesin gjyqësor, Gjykata ka vlerësuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm" dhe që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, KLGJ-ja, në qasje me jurisprudencën evropiane, e cila ka çmuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit për nga natyra e tyre kërkojnë vendimmarrje të përshpejtuar, i ka listuar ato si çështje prioritare për shqyrtim nga gjykata e apelit në vendimin e saj nr. 78/2019.

29. Ashtu siç u theksua (*shih paragrafin 21 të vendimit*), në themelin e procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuesi është pretendimi për përfitimet pas mbarimit të funksionit të magjistratit, pra në thelb është mosmarrëveshje në fushën e punësimit, e cila kërkon vendimmarrje të përshpejtuar. Për këto arsye, Gjykata çmon se çështja e kërkuesit, për shkak të natyrës që ka, lidhet me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, të tillë që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

30. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në kontekstin e situatës së përgjithshme të sistemit gjyqësor (burimet njerëzore, kushtet e punës dhe numri i lartë i çështjeve), kohëzgjatja e gjykimit administrativ (gjithsej 2 vjet e 10 muaj, nga të cilat 2 vjet e 6 muaj në apel) të çështjes së kërkuesit duket se nuk përbën *per se* shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave. Megjithatë, duke e ndërlidhur kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij me rrethanat e tjera, si mungesa e kompleksitetit të saj,

mosveprimi i gjykatës së apelit, përligjja e këtij mosveprimi nga Gjykata e Lartë, si dhe interesat vetjakë (përfitimi financiar i pensionit suplementar), Gjykata çmon se kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të pranohet.

31. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, çmon se bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate ta shqyrtojë rastin me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3089, datë 11.07.2024 të Kolegji Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 03.04.2025
Shpallur më 24.04.2025

Vendim nr. 16, datë 03.04.2025
(V-16/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 03.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 19 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KLITON SPAHIU**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, në mungesë.
GJYKATA E APELIT E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2809, datë 02.07.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe gjykimi i çështjes me procedurë të përshpejtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ),* nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Kliton Spahiu *(kërkuesi)* që kërkoi pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*) dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Gjykata e Apelit*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës (*sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*) nga data 26.05.2010 deri në datën 02.06.2021, kur KLGJ-ja ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra, si dhe ndërprerjen e menjëhershme të pagës dhe të përfitimeve të tjera të magjistratit. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga kërkuesi.

2. Në vijim, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e KLGJ-së të njohë të drejtën për të përfituar pagën referuese në shumën 132,100 lekë, shtesën mbi pagën sipas kategorisë G2, me 98%, si dhe vjetërsinë e shërbimit në detyrë, nga data 01.01.2019 deri në datë 28.05.2021. Detyrimin e Gjykatës së Apelit Durrës që të paguajë për diferencën e pagës së papaguar për periudhën 01.01.2019 deri në datë 29.05.2021, duke përfshirë edhe 10% të interesit ligjor mbi shumën e arrirë nga lindja e së drejtës e deri në momentin e shlyerjes së detyrimeve të papaguara. Detyrimin e të paditurve për të paguar tarifën, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe ato për kryerjen e ekzekutimit, si dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, në zbatim të nenit 317, paragrafi i parë, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2075 (80-2022-2019), datë 07.07.2022, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Gjykatës së Apelit Durrës t'i paguajë kërkuesit diferencat e pagës neto për periudhën nga data 01.01.2019 deri në datën 28.05.2021 në shumën 716,767 lekë, si dhe interesat bazuar në nenin 120 të Kodit të Punës në shumën 129,638 lekë, rrëzimin e padisë për palën e

paditur, KLGJ-në, për mungesë legjitimi pasiv. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31138-02761-86-2022, datë 15.09.2022. Deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, çështja e kërkuesit ka mbetur në pritje për t'u shqyrtuar.

5. Në datat 02.05.2023 dhe 02.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij, për të cilat nuk ka marrë përgjigje. Në datën 11.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2809, datë 02.07.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga gjyqtarja relatore, e cila i ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar kriteret transparente për marrjen e çështjeve që i janë ngarkuar asaj, sipas radhës së vjetërsisë.

7. Në datën 17.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.10.2024. Kolegji i Gjykatës, në datën 27.12.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, të lidhur me *të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Apelit, pavarësisht se çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi nga gjykata. Për më tepër, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë dhe për të pasur një datë sa më të afërt në kohë për gjykimin e çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit.

9. ***Subjektet e interesuara, KLGJ-ja dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit në shqyrtimin e çështjes së tij dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkesë e cila është rrëzuar. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 02.07.2024 dhe kërkuesi i është drejtuar asaj në datën 17.10.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se ankimi kushtetues individual

është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

14. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do ta analizojë atë në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e çështjes së tij dhe as një vendimmarrje nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e Lartë ka interpretuar gabim dispozitat procedurale, pasi çështja ka për objekt marrëdhëniet e punës, të cilat shqyrtohen me përparësi nga gjykata, për më tepër që, në rastin konkret, janë tejkaluar edhe afatet maksimale të përcaktuara nga ligji, duke u zgjatur më shumë se 2 vjet. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë dhe për të pasur një datë sa më të afërt në kohë për gjykimin e çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se mosmarrëveshja që është regjistruar për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit ka në objektin e saj detyrimin për kryerjen e pagesave të rrjedhura nga paga referuese dhe nga diferencat e pagave të papaguara për periudhën 01.01.2019 - 28.05.2021, për shkak të funksionit të tij si ish-magjistrat. Çështja është regjistruar fillimisht në gjykatën e shkallës së parë, e cila ka disponuar me vendimin e datës 07.07.2022 pranimin e pjesshëm të padisë. Në vijim, kërkuesi ka ushtruar ankim, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit

në datën 15.09.2022. Në analizë të këtyre të dhënave rezulton se ndonëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 6 muaj në Gjykatën Administrative të Apelit, ende nuk ka një datë për përfundimin e tij.

18. Duke iu referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, Gjykata vë në dukje se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ në apel. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i takon *sjelljes së kërkuesit*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata konstaton se kërkuesi ka shfaqur interes për ecurinë e shpejtë të gjykimit të çështjes, pasi i është drejtuar dy herë Gjykatës Administrative të Apelit, përkatësisht në datat 02.05.2023 dhe 02.04.2024 me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij. Në kushtet kur ai nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ajo gjykatë, në datën 11.06.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila e ka rrëzuar kërkesën dhe me tej ka paraqitur ankim kushtetues individual. Në këto rrethana, nuk rezulton që kërkuesi të jetë bërë shkak për vonesën në gjykim, por ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale.

21. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes,* Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj kërkimin për përfitimin e pagesave të rrjedhura nga paga referuese dhe nga diferencat e pagave të papaguara për periudhën 01.01.2019 - 28.05.2021, bazuar në legjislacionin për statusin e magjistratit, për shkak të funksionit të kërkuesit si gjyqtar. Palë të paditura në gjykim janë dy institucione shtetërore, KLGJ-ja dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në thelb, çështja lidhet me përcaktimin e fakteve bazuar në dokumente dhe në interpretimin e një numri të kufizuar normash ligjore pa pasur nevojë për marrjen e provave voluminoze dhe as për

ndërthurje të shumta aktesh ligjore. Duke iu referuar këtyre aspekteve, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse.

22. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili pas mbarimit të funksionit të tij si gjyqtar ka kërkuar përfitimin e pagesave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Ky lloj kërkimi përfshihet në grupin e çështjeve që shqyrtohen me përparësi nga gjykata e apelit, i klasifikuar si i tillë në kalendarin e miratuar nga KLGJ-ja *(shih shkronjën "gj" të pikës 3.1 të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", të ndryshuar [vendimi nr. 78/2019]*). Pavarësisht kësaj, Gjykata Administrative e Apelit ende nuk ka caktuar një datë për shqyrtimin e ankimit, ndonëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet e 6 muaj nga regjistrimi i tij. Në gjykatën e apelit çështja e kërkuesit është rishortuar duke iu caktuar gjyqtarëve të ndryshëm, për shkak të riorganizimit të brendshëm. Përveç kalimit të akteve të çështjes nga njëri gjyqtar tek tjetri nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera, madje as kërkesat për përshpejtim të paraqitura nga kërkuesi nuk rezulton të jenë marrë në shqyrtim.

23. Edhe Gjykata e Lartë e ka refuzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, duke arsyetuar se vonesa në gjykim lidhej me ngarkesën e lartë të çështjeve, numrin e pakët të gjyqtarëve dhe të stafit ndihmës që ushtronin detyrën në atë gjykatë. Sipas saj, mosveprimi i gjyqtarit relator nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive, si dhe nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e çështjes nga ai. Mirëpo këto arsye bëjnë që barra e vonesës së shkaktuar nga faktorë të pavarur nga kërkuesi të zhvendoset tek ai, duke mos u respektuar standardin kushtetues në këtë drejtim *(shih paragrafin 16 të vendimit)*. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj duhet shfuqizuar.

24. Në lidhje me *atë çfarë rrezikon kërkuesi* në procesin gjyqësor, Gjykata ka vlerësuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ato që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm" dhe që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme dhe pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, KLGJ-ja, në qasje me jurisprudencën evropiane,

e cila ka çmuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit për nga natyra e tyre kërkojnë vendimmarrje të përshpejtuar, i ka listuar ato si çështje prioritare për shqyrtim nga gjykata e apelit në vendimin e saj nr. 78/2019.

25. Ashtu siç u theksua (*shih paragrafin 17 të vendimit*), në themelin e procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuesi është pretendimi për përfitimet financiare të rrjedhura nga paga e magjistratit, pra në thelb është mosmarrëveshje në fushën e punësimit, e cila kërkon vendimmarrje të përshpejtuar. Për këto arsye, Gjykata çmon se çështja e kërkuesit për shkak të natyrës që ka, lidhet me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, të tillë që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në kontekstin e situatës së përgjithshme të sistemit gjyqësor (burimet njerëzore, kushtet e punës dhe numri i lartë i çështjeve), kohëzgjatja e gjykimit administrativ (2 vjet e 6 muaj në apel) të çështjes së kërkuesit duket se nuk përbën *per se* shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave. Megjithatë, duke e ndërlidhur kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij me rrethanat e tjera, si mungesa e kompleksitetit të saj, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit, përligjja e këtij mosveprimi nga Gjykata e Lartë, si dhe interesat vetjakë (përfitimi financiar i rrjedhur nga paga), Gjykata çmon se kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të pranohet.

27. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, çmon se bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-2809, datë 02.07.2024 të Kolegji Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 03.04.2025
Shpallur më 24.04.2025

Vendim nr. 17, datë 10.04.2025
(V-17/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 38 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ALEKSANDËR GJONMARKAJ,** përfaqësuar nga avokat Ndre Molla, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 555, datë 20.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 233, datë 17.06.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-797, datë 02.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 32, 35 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 3, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 432, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", 435, 441, pika 1, shkronja "ç" dhe 442, pika 1, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës**

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Aleksandër Gjonmarkaj (kërkuesi), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 23.06.2013 janë zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ndër të tjera edhe në qytetin e Lezhës, ku për këtë qëllim ishte ngritur dhe funksiononte Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 13 *(KZAZ nr. 13)*. Kërkuesi ka qenë me detyrë sekretar i kësaj KZAZ-je. Me përmbylljen e procesit zgjedhor, në datën 25.06.2013 materialet zgjedhore, procesverbalet e rezultatit të qendrave të votimit *(QV),* janë dërguar nga kryetarja e KZAZ-së nr. 13 dhe kërkuesi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *(KQZ).* KQZ-ja ka konstatuar se për 10 QV-të, tabelat e rezultateve ishin fotokopje të vulosura me vulën e KZAZ-së nr. 13, që sipas rregullit mbahej dhe administrohej nga kërkuesi. Për këtë arsye KQZ-ja në miratimin e rezultatit përfundimtar për këtë KZAZ, me vendimin nr. 701, datë 10.07.2013, i është referuar bazës elektronike të të dhënave, krijuar nga të dhënat që ishin dërguar në kohë reale nga ajo KZAZ.

2. Ky vendim është kundërshtuar nga dy subjektet kryesore politike (Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Socialiste e Shqipërisë (*PS*)). Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve fillimisht nga KQZ-ja dhe më tej nga Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ky i fundit ka vendosur përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 701, datë 10.07.2013 të KQZ-së dhe rinumërimin e votave pranë atij kolegji. Referuar të dhënave të rinumërimit në 10 QV-të, të cilat kanë rezultuar ndryshe nga rezultati fillestar, KQZ-ja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë *(prokuroria)* për komisionin e KZAZ-së nr. 13.

3. Prokuroria, pas përfundimit të hetimeve, ka dërguar çështjen për gjykim duke i akuzuar të gjithë anëtarët e KZAZ-së nr. 13 dhe kërkuesin për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve", të parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal *(KP),* të kryer në bashkëpunim. Gjatë zhvillimit të procesit në shkallë të parë, me gjykim të zakonshëm, fillimisht është bërë ndarja e çështjes penale lidhur me një nga të pandehurit GJ.GJ. dhe vazhdimi i gjykimit për të pandehurit e tjerë. Më tej, në datën 07.07.2017 prokuroria ka kërkuar pushimin e çështjes penale për 6 të pandehurit e tjerë pjesë e komisionit dhe vazhdimin e gjykimit vetëm për kërkuesin për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve". Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e datës 07.07.2017.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 555, datë 20.10.2017, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve", duke e dënuar përfundimisht atë me 3 vjet burg, konvertuar në shërbim prove për 3 vjet, si dhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 3 vjetësh. Ajo gjykatë ka arsyetuar se nga tërësia e provave ka rezultuar e provuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale, pasi ka qenë detyrë e tij funksionale të administronte procesin zgjedhor referuar nenit 34 të Kodit Zgjedhor. Sipas saj, ka rezultuar i provuar edhe fakti se kërkuesi ka zëvendësuar tabelat origjinale me fotokopje me korrigjime, të cilat i ka vulosur me vulën e njomë të KZAZ-së nr. 13. Gjithashtu, kryerja e veprës penale, sipas asaj gjykate, provohet edhe nga fakti se tabelat e dorëzuara nga kërkuesi janë të ndryshme me të dhënat e administruara në kohë reale nga KQZ-ja lidhur me rezultatin e numërimit në KZAZ-në nr. 13. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe shpalljen e tij të pafajshëm.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 233, datë 17.06.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 555, datë 20.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se vendimi i shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe në prova dhe se është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi e ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas gjykatës, pretendimi i kërkuesit për mosvënien në dispozicion të akteve shkresore të administruara si prova nuk qëndron për sa kohë ato i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në një procedurë gjykimi të zakonshëm. Edhe pretendimi se numërimi është bërë nën dhunën e simpatizantëve të subjektit politik, PS-së, nuk e shkarkon kërkuesin nga përgjegjësia penale për sa kohë

që ai nuk e ka referuar asnjëherë këtë fakt në organet kompetente, ndërkohë që provat e kërkuara nga ai për t'u marrë synonin të vërtetonin faktin se ai e ka kryer veprën në kushtet e presionit dhe dhunës. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-797, datë 02.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi me argumentin se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kolegji Penal, ndër të tjera, ka arsyetuar se gjykata e apelit ka analizuar dhe ka dhënë përgjigje të argumentuar për të gjitha pretendimet e kërkuesit. Sipas atij kolegji, janë të pambështetura argumentet e mbrojtjes lidhur me pavlefshmërinë e akteve të administruara, duke qenë se nuk ka pasur cenim të të drejtave të kërkuesit referuar nenit 34 të KPP-së. Gjithashtu, kërkuesi është njohur me përfundimin e hetimeve dhe aktet e fashikullit të gjykimit, aktet e marra gjatë hetimit paraprak i janë njoftuar të gjykuarit dhe mbrojtësit në përfundim të hetimeve, duke u dhënë mundësinë e kundërshtimit të tyre në gjykatë. Kolegji Penal, po ashtu, referon te neni 129 i KPP-së, i cili përcakton se pavlefshmëritë relative ngrihen nga palët në afatin e përcaktuar nga vetë dispozita.

7. Në datën 21.08.2024 (sipas shërbimit postar) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.09.2024. Në datën 27.11.2024 Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i çështjes. Kolegji i Gjykatës në datën 06.12.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1. *Parimit të paanshmërisë,* pasi nga ana e gjykatave të faktit ka pasur një sjellje të dukshme të njëanshme në favor të organit të akuzës.

8.1.2. *Parimit të barazisë së armëve, si dhe të së drejtës për mbrojtje efektive,* pasi dy gjykatat e faktit i kanë mohuar të drejtën për

të paraqitur prova në proces, si prova shkresore ashtu edhe me dëshmitarë, si dhe nuk kanë bërë të mundur njohjen me aktet e dosjes penale si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë gjykimit, fakte këto që e bëjnë hetimin të pavlefshëm. Këto gjykata nuk kanë pasur si qëllim të jepnin drejtësi, por kanë favorizuar dukshëm akuzën. Të gjitha kërkesat për provat janë refuzuar nga gjykata pa dhënë një arsye bindëse. Nëpërmjet paraqitjes së dëshmitarëve do të vërtetohej fakti se veprimet e kryera nga ana e tij ishin bërë në kushtet e nevojës ekstreme. Refuzimi për të marrë provat e kërkuara nga ai në proces përbën një shkelje të rëndë procedurale dhe kushtetuese, e cila i ka kufizuar atij edhe të drejtën për mbrojtje efektive.

8.1.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke qenë se pretendimet kishin lidhje me shkeljen e procedurës dhe zbatimin e gabuar të ligjit material.

8.1.4. *Së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* pasi hetimi dhe gjykimi i çështjes së tij, në mënyrë të qëllimshme për të mbuluar të vërtetën, ka zgjatur 11 vjet.

8.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit,* pasi dukshëm nga ana e gjykatave janë favorizuar të pandehurit e tjerë në proces, të cilët janë edhe ata të implikuar në veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, duke u shpallur të pafajshëm.

9. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

9.1. Për pretendimin për *cenimin e parimit të paanshmërisë* kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese që lidhen me testin subjektiv, i cili kërkon të vlerësohet bindja ose interesi personal i gjyqtarit në çështjen konkrete. Po ashtu, nuk janë sjellë prova që lidhen me testin objektiv, i cili analizon nëse gjyqtari ka siguruar garanci të mjaftueshme procedurale për të shmangur çdo dyshim të arsyeshëm për anshmërinë e tij.

9.2. Për pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë së armëve, si dhe së drejtës për mbrojtje efektive* rezulton se procesi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, duke u dhënë palëve mundësinë e plotë për të debatuar për çdo provë që i është nënshtruar gjykimit. Sipas të dhënave të pasqyruara në aktet e sjella nga kërkuesi dhe fashikujt hetimorë rezulton se kërkuesi është njoftuar për akuzën dhe ka pasur mundësi të njihet me

provat, fakt i vërtetuar me procesverbalin e njohjes së tij me aktet. Gjithashtu, gjatë gjykimit kërkuesi ka pasur mundësinë të shqyrtojë dhe të debatojë për provat, gjë që provohet nga procesverbalet e seancave, ndërkohë që edhe gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk ka pasur shkelje në këtë aspekt. Si përfundim, gjykatat kanë analizuar në mënyrë të plotë provat e administruara gjatë ekzaminimit të plotë të tyre në kushtet e gjykimit të zakonshëm dhe kanë dhënë vendime të bazuara në prova e në ligj dhe të argumentuara mbi bazën e tyre, pa shkelur asnjë nga dispozitat ligjore në fuqi gjatë administrimit të gjykimit në ngarkim të tij.

9.3. Për pretendimin për *pretendimin se Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë,* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur me relacionin e relatorit në dhomën e këshillimit dhe pasi ka konstatuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, çka e bën vendimin e dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë plotësisht legjitim. Gjithashtu, argumenti në mbështetje të këtij pretendimi nuk është i natyrës kushtetuese, pasi ka të bëjë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, i cili, për nga natyra e tij, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës.

9.4. Për pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit,* rezulton se për rastin në shqyrtim u janë krijuar mundësi të barabarta të gjitha palëve në gjykim. Gjykatat i kanë dhënë mundësi kërkuesit të paraqesë pretendimet e tij dhe të ofrojë prova të reja, të cilat pasi janë administruar i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Mbi bazën e këtyre provave dhe provave të tjera të administruara gjatë procesit gjyqësor, gjykatat kanë bërë vlerësimet e veta dhe kanë krijuar bindjen për një vendimmarrje të drejtë. Gjithashtu, argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton në aspektin formal që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, ndërsa në aspektin substancial që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha shkallët e gjykimit, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi në ankimin e tij ka pretenduar ndër të tjera, cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm,* pasi hetimi dhe gjykimi i çështjes së tij, në mënyrë të qëllimshme ka zgjatur 11 vjet.

14. Për sa u takon kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile *(KPC)* me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni në fuqi parashikon mjete juridike (nenet 399/1 e vijues të KPC-së) që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen

e kësaj të drejte kushtetuese. Dispozitat procedurale të sipërcituara nuk parashikojnë shprehimisht mjete të veçanta për kohëzgjatjen e procesit në tërësi, por vetëm për kohëzgjatjen e procesit në secilën prej fazave dhe shkallëve të gjykimit. Në këtë kuptim, edhe pse sipas ligjit zgjidhja përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese zbatohet për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, kohëzgjatja e procesit jo vetëm që vlerësohet në lidhje me kohëzgjatjen tërësore të procedurave, por, nga ana tjetër, ndikon drejtpërsëdrejti në këtë drejtim. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Bazuar në këto standarde kushtetuese, Gjykata evidenton se kërkuesi ka pretenduar kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit në tërësinë e tij si në hetim, ashtu edhe në gjykim, ndërkohë që nuk rezulton që në ndonjë fazë të caktuar, si të hetimit, ashtu edhe të gjykimit në të tria shkallët e gjyqësorit, ai t'i jetë drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për konstatimin e hetimit ose gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas neneve 399/6 e vijues të KPC-së. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

16. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, konkretisht për cenimin e parimit të paanshmërisë, të barazisë së armëve dhe mbrojtjes efektive, si dhe të barazisë përpara ligjit, Gjykata evidenton se kërkuesi i ka parashtruar ato në formë dhe përmbajtje në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Ndërkohë që për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, pasi Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore, duke qenë se lidhet me vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se për këto pretendime kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 02.05.2024 të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues

individual është paraqitur në Gjykatë në datën 21.08.2024, nëpërmjet shërbimit postar, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Prandaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimeve të paanshmërisë, të barazisë së armëve, të mbrojtjes efektive të barazisë përpara ligjit, si dhe së drejtës për t'u dëgjuar, të cilat hyjnë në juridiksionit e Gjykatës.

19. Për pretendimin se është cenuar *parimi i paanshmërisë*, kërkuesi ka parashtruar se nga ana e gjykatave të faktit ka pasur një sjellje të dukshme të njëanshme në favor të organit të akuzës. Ndërkohë, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese që lidhen me testin subjektiv, i cili kërkon të vlerësohet bindja ose interesi personal i gjyqtarit në çështjen konkrete. Po ashtu, nga ana e tij nuk janë sjellë prova që lidhen me testin objektiv, i cili analizon nëse gjyqtari ka siguruar garanci të mjaftueshme procedurale për të shmangur çdo dyshim të arsyeshëm për anshmërinë e tij.

20. Në jurisprudencën e Gjykatës e drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i kërkuesit është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar *(shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Bazuar në këto standarde kushtetuese, në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë ose argument kushtetues për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatave që kanë shqyrtuar çështjen e tij si në aspektin subjektiv, ashtu edhe në atë objektiv. Vetëm fakti se gjykatat kanë pranuar akuzën e ngritur nga prokuroria, nuk mund të provojë *a priori* se procesi penal i zhvilluar nga organet e drejtësisë, sipas

kompetencave të tyre kushtetuese, është i njëanshëm. Për këtë arsye, ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim.

22. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *barazisë përpara ligjit,* me argumentin se janë favorizuar të pandehurit e tjerë në proces, të cilët janë edhe ata të implikuar në veprën penale të falsifikimit. Prokuroria e Përgjithshme lidhur me këtë pretendim ka prapësuar se të gjitha palëve në gjykim u janë krijuar mundësi të barabarta. Gjykatat i kanë dhënë mundësi kërkuesit të paraqesë pretendimet e tij, të paraqesë prova të reja, të cilat pasi janë administruar i janë nënshtruar debatit gjyqësor, mbi bazën e të cilave si dhe provave të tjera të administruara gjatë procesit gjyqësor, gjykatat kanë bërë vlerësimet e veta dhe krijuar bindjen për një vendimmarrje të drejtë. Gjithashtu, sipas subjektit të interesuar, argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Referuar standardit të mësipërm dhe nisur nga argumenti i parashtruar nga kërkuesi, Gjykata vëren se në thelb pretendimet kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, pasi mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, të harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar,* pasi Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke qenë se pretendimet kishin lidhje me shkelje të

procedurës dhe zbatimin e gabuar të ligjit material. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur me relacionin e relatorit, në dhomën e këshillimit, ka konstatuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, prandaj ka vendosur mospranimin e rekursit, çka e bën vendimin e dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë plotësisht legjitim. Gjithashtu, argumenti në mbështetje të këtij pretendimi nuk është i natyrës kushtetuese, pasi ka të bëjë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, i cili, për nga natyra e tij, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës.

26. Gjykata vëren se referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën e parë, e cila njihet edhe si faza seleksionuese, neni 433 i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit gjyqësor. Ndërkohë, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, në fazën e dytë çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve (neni 436/a i KPP-së) ose në prani të palëve në raste përjashtimore, të parashikuara nga neni 437, pika 1, i KPP-së *(shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar në mënyrë konstante se shqyrtimi i rekursit nga Gjykata e Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore *(shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, bazuar në dispozitat procedurale të lartpërmendura, sipas të cilave shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotësonte kriteret për shqyrtimin e tij në seancë gjyqësore. Kjo do të thotë se shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit

nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji procedural. Për rrjedhojë, lidhur me këtë pretendim Gjykata vlerëson se vetëm fakti se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit është i pamjaftueshëm për të mbështetur pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar.

28. Nisur nga sa më lart, në vijim, Gjykata do të analizojë pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive

29. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve, si dhe të së drejtës për mbrojtje efektive, pasi dy gjykatat e faktit i kanë mohuar të drejtën për të paraqitur prova në proces, si prova shkresore, ashtu edhe me dëshmitarë, si dhe të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes penale si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë gjykimit, fakte këto që e bëjnë hetimin të pavlefshëm. Këto gjykata, sipas tij, nuk kanë pasur si qëllim të jepnin drejtësi, por kanë favorizuar dukshëm akuzën, pasi të gjitha kërkesat në lidhje me provat janë refuzuar nga gjykata pa dhënë një arsye bindëse. Nëpërmjet paraqitjes së dëshmitarëve do të vërtetohej fakti se veprimet e kryera nga ana e tij ishin bërë në kushtet e nevojës ekstreme. Kërkuesi, po ashtu, thekson se refuzimi për të marrë provat e kërkuara nga ai në proces përbën një shkelje të rëndë procedurale dhe kushtetuese, e cila i ka kufizuar atij edhe të drejtën për mbrojtje efektive.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se procesi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, duke u dhënë palëve mundësinë e plotë për të debatuar për çdo provë që i është nënshtruar gjykimit. Sipas të dhënave të pasqyruar në aktet e sjella nga kërkuesi dhe fashikujt hetimorë rezulton se kërkuesi është njoftuar për akuzën dhe ka pasur mundësi të njihet me provat, fakt i vërtetuar me procesverbalin e njohjes së tij me aktet. Gjithashtu, gjatë gjykimit kërkuesi ka pasur mundësinë të shqyrtojë dhe të debatojë për provat, gjë që provohet nga procesverbalet e seancave, ndërkohë që edhe Gjykata e Apelit Shkodër ka konfirmuar se nuk ka pasur shkelje në këtë aspekt. Si përfundim, gjykatat kanë analizuar në mënyrë të plotë provat e administruara gjatë ekzaminimit të plotë të tyre në kushte e gjykimit të zakonshëm dhe kanë dhënë vendime të bazuara në prova e në ligj dhe të argumentuara mbi bazën e tyre, pa

shkelur asnjë nga dispozitat ligjore në fuqi gjatë administrimit të gjykimit në ngarkim të tij.

31. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar. Bazuar në këto parime, gjykatave i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata. Këto kërkesa kushtetuese janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim është theksuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal mund të cenohet nëse refuzohet kërkesa e mbrojtësit për thirrjen e dëshmitarëve. Megjithatë, i akuzuari për të mbështetur pretendimin se i është cenuar e drejta e mbrojtjes për këtë shkak, duhet të bëjë të besueshme se pyetja e dëshmitarëve ishte e domosdoshme për të përcaktuar të vërtetën. Nëse

gjykatat e zakonshme çmojnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për thirrjen e dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjatë shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson. Në këtë kuptim, në kontekstin e rrethanave të çdo çështjeje të veçantë, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë procesit gjyqësor ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur realizimin e së drejtës së mbrojtjes dhe, për pasojë, zhvillimin e procesit në mënyrë të drejtë *(shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 7, datë 28.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi gjatë procesit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm ka pretenduar se (i) nuk është njohur me aktet hetimore të prokurorisë si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë gjykimit, si dhe se (ii) gjykatat e faktit nuk kanë pranuar provat me dëshmitarë dhe shkresore të kërkuara prej tij. Prandaj, bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, si dhe në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata do të analizojë nëse gjykatat e zakonshme, gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, kanë bërë të mundur që ai të njihet me provat e organit të akuzës, si dhe duke mos pranuar disa prej provave të kërkuara gjatë procesit gjyqësor i kanë cenuar atij parimin e barazisë së armëve të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur, në kuptim të zhvillimit të një gjykimi të drejtë.

35. Gjykata konstaton fillimisht se, sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çështja është gjykuar me ritin e gjykimit të zakonshëm, procedurë kjo që u jep mundësinë palëve të debatojnë lidhur me çdo provë. Për shkakun e parë të pretenduar nga kërkuesi, Gjykata konstaton se nga fashikujt hetimorë dhe ata gjyqësorë, të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, rezulton se në datën 25.07.2014 nga prokurorët e çështjes kërkuesit i është komunikuar akuza, akt ky ku janë të pasqyruara të gjitha veprimet hetimore dhe provat mbi të cilat është bazuar kjo akuzë. Gjithashtu, në po të njëjtën datë rezulton se kërkuesi është pyetur në cilësinë e të pandehurit (ka kërkuar të japë shpjegime pa praninë e avokatit) lidhur me ngjarjen, duke pasur mundësi të japë shpjegime për rrethanat dhe faktet e çështjes penale në ngarkim të tij. Në përfundim të komunikimit të akuzës

dhe marrjes së deklarimeve, kërkuesit i është dhënë mundësia të njihet me aktet e dosjes, fakt i provuar me procesverbalin përkatës. Gjithashtu, sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat e zakonshme, Gjykata konstaton se shumica e akteve hetimore janë akte të prodhuara nga KZAZ-ja nr. 13, ku ai vetë ai ka qenë sekretar, për rrjedhojë ka marrë pjesë në hartimin e tyre.

36. Gjykata vëren se edhe gjatë gjykimit kërkuesi ka pasur mundësinë të njihet dhe të debatojë për provat, qofshin këto dëshmi ose prova të tjera. Ky fakt mbështetet edhe nga procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 23.03.2017, 27.04.2017, 26.05.2017 07.06.2017 dhe 20.06.2017 të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në këto seanca nga ana e asaj gjykate janë shqyrtuar provat shkresore dhe janë pyetur dëshmitarët e çështjes (të thirrur nga organi akuzës) nga gjykata, si dhe nga palët. Konkretisht, gjatë këtyre seancave ajo gjykatë ka pyetur 8 shtetas në cilësinë e dëshmitarëve, të cilët kanë kryer detyrën e numëruesit në KZAZ-në nr. 13, si dhe 3 shtetas të tjerë në cilësinë e të bashkëpandehurve. Për më tepër, Gjykata vëren se seanca e datës 07.06.2017 është shtyrë në mënyrë që palët të njihen me të gjithë praktikën shkresore të administruar, me qëllim realizimin sa më efektiv të mbrojtjes. Gjithashtu, ky pretendim i kërkuesit ka qenë objekt kontrolli edhe i Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila nuk ka konstatuar të meta lidhur me procesin e gjykimit në shkallë të parë, duke konfirmuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nisur nga sa më sipër, pretendimet e kërkuesit për mosnjohjen me provat e procesit penal në ngarkim të tij nuk janë të bazuara.

37. Për sa i takon shkakut të dytë, pra pretendimeve të kërkuesit që lidhen me (mos)marrjen e provave të tjera gjatë gjykimit, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në seancën e datës 23.03.2017 kërkuesi ka kërkuar thirrjen e disa dëshmitarëve (vëzhgues të OSBE-së dhe vendas të paspecifikuar), me të cilat ai pretendonte të provonte dhunën psikologjike të ushtruar ndaj tij, si dhe kryerjen e ekspertimit grafik të tabelave të rezultateve të votimit për të provuar se nuk ishte autor i veprës penale të falsifikimit. Sipas kërkuesit, aktet ishin plotësuar nga kryetarja e KZAZ-së dhe më tej grupe kriminale prezente në ambientet e KZAZ-së e kishin detyruar atë (dhe anëtarët e tjerë të komisionit) të nënshkruante e vuloste aktet kundër vullnetit të tij, sikurse ishte provuar gjatë gjykimit edhe nga dëshmitarë të tjerë. Lidhur me thirrjen e dëshmitarëve nga ana e gjykatës së shkallës së parë, fillimisht kërkuesit i është kërkuar të paraqiste listë të detajuar me emrat dhe adresat e dëshmitarëve të cilët kërkoheshin të thërriteshin, listë kjo që është paraqitur e padetajuar në seancën e datës

20.06.2017, me shkakun se nuk njiheshin gjeneralitetet e këtyre personave, por që mund të identifikoheshin nga vetë gjykata. Kjo e fundit po në atë seancë nuk ka pranuar kërkesat e kërkuesit lidhur me thirrjen e dëshmitarëve dhe kryerjen e ekspertimit grafik.

38. Gjykata konstaton se në vendimin e gjykatës së shkallës së parë nuk arsyetohet për shkaqet e mospranimit të kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve, ndërkohë që gjykata e apelit në arsyetimin e refuzimit të kësaj kërkese ka vlerësuar se vërtetimi i faktit se ndaj kërkuesit ishte ushtruar dhunë psikologjike nuk mund të provohej me dëshmitarë, për sa kohë që kërkuesi kishte pasur të gjitha mundësitë të bënte kallëzimet përkatëse në organet e drejtësisë. Ndërsa për sa i takon kryerjes së ekspertimit grafik, në vendimin e shkallës së parë është arsyetuar se në rastin konkret vepra penale e falsifikimit rezulton e verifikuar për shkak të ndryshimit të rezultatit të votimit mes tabelave të rezultateve të dërguara në KQZ në kohe reale dhe atyre të dërguara KQZ-së në përfundim të procesit të zgjedhjeve. Për këtë arsye, ekspertimi grafik është konsideruar i panevojshëm nga ana e asaj gjykate. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër. Në lidhje me përgjegjësinë penale të kërkuesit të dyja gjykatat e faktit kanë arsyetuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale, pasi ka qenë detyrë e tij funksionale të administronte procesin zgjedhor referuar nenit 34 të Kodit Zgjedhor dhe ka rezultuar e provuar se kërkuesi ka zëvendësuar tabelat origjinale me fotokopje me korrigjime, të cilat i ka vulosur me vulën e njomë të KZAZ-së nr. 13. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

39. Çështjet që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet zgjedhore janë marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka vënë theksin në shqyrtimin efektiv të ankimeve individuale në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat zgjedhore, pasi kjo përbën një nga garancitë thelbësore të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Një shqyrtim i tillë siguron ushtrimin efektiv të të drejtave individuale për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, ruan besimin e përgjithshëm në administrimin e procesit zgjedhor nga shteti dhe përbën një mjet të rëndësishëm në dispozicion të shtetit për të arritur përmbushjen e detyrimit të tij për të zhvilluar zgjedhje demokratike (*Namat Aliyev kundër Azerbajxhanit, 2010, §§ 81 e vazhdim; Uspaskich kundër Lituanisë, 2016, § 93; Mugemangango kundër Belgjikës [DhM], 2020, § 69*).

40. Bazuar në këto konsiderata dhe në analizë të sa më sipër, Gjykata vëren se pavarësisht se kërkuesi gjatë procesit penal në ngarkim të tij,

në ushtrim të garancive procedurale e kushtetuese lidhur me të drejtën e mbrojtjes së tij, ka kërkuar, ndër të tjera, edhe pyetjen e dëshmitarëve për të vërtetuar faktin se ai ishte detyruar të firmoste dhe vuloste tabelat nën kanosjen e përfaqësuesve të partive politike në garë, si dhe një akt ekspertimi për të provuar se ai nuk ishte autori i veprës penale të falsifikimit, gjykatat e faktit jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij, por edhe nuk kanë dhënë argumente bindëse në vendimet e tyre në lidhje me mospranimin e këtyre provave. Gjithashtu, në kushtet kur të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit nuk janë deklaruar fajtorë, gjykatat e faktit duket se nuk kanë kryer një hetim të plotë e gjithëpërfshirës në drejtim të përcaktimit të saktë të fakteve të çështjes, por janë bazuar në prezumime fakti, duke e vënë kërkuesin në një pozitë dizavantazhi në raport me akuzën, pra duke mos i dhënë mundësinë e deklarimit të tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen.

41. Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se gjykatat e faktit, në përmbushje edhe të parimit të kontradiktoritetit, duhet të kishin dhënë arsye të mirargumentuara për refuzimin për marrjen e provave të kërkuara nga kërkuesi, duke qenë se ato mund të ndikonin në përcaktimin e rrethanave dhe fakteve të çështjes, të cilat, nga ana e tyre, janë determinante për identifikimin e elementeve të veprës penale. Thënë kjo, gjykatat e faktit jo vetëm nuk kanë kryer një hetim efektiv në funksion të evidentimit të krimeve zgjedhore, por nuk i kanë dhënë mundësinë kërkuesit për të realizuar një debat real me akuzën në drejtim të zbulimit të së vërtetës, pra për t'u mbrojtur në mënyrë efektive, duke bërë që argumentet e organit të akuzës të prevalojnë mbi ato të kërkuesit.

42. Po ashtu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga ana e tij, duke vendosur mospranimin e rekursit nuk e ka korrigjuar këtë situatë, pavarësisht pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Në këtë mënyrë, shkelja procedurale në raport me pasojat që kanë ardhur për kërkuesin (deklarimi fajtor i tij) duket se ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes, duke ia ka bërë atij të pamundur realizimin e së drejtës së mbrojtjes, si dhe duke vënë gjithashtu në dyshim në këtë mënyrë zhvillimin e një gjykimi të drejtë. Prandaj, Gjykata çmon se gjykatat e faktit dhe më tej Gjykata e Lartë nuk i kanë garantuar kërkuesit parimin e barazisë së armëve të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive.

43. Së fundmi, në kushtet kur referuar nenit 427 të KPP-së në raste të caktuara gjykata e apelit mund të përsëritë shqyrtimin gjyqësor, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohen vendimet nr. 233, datë 17.06.2019 të Gjykatës

së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2024-797, datë 02.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përputhje me kompetencën e saj lëndore. Kjo e fundit, duke u bazuar në kompetencat si gjykatë ligji dhe fakti, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesit dhe për t'iu dhënë përgjigje atyre në respektim të standardeve kushtetuese, si dhe duke plotësuar mangësitë dhe riparuar shkeljet e gjykatës së shkallës së parë.

44. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, si dhe të mbrojtjes efektive janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2024-797, datë 02.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 233, datë 17.06.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.04.2025
Shpallur më 02.05.2025

Vendim nr. 18, datë 10.04.2025
(V-18/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (Q) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **QERIME HOTI**, përfaqësuar nga avokate Enkelejda Musta, me prokurë të posaçme.
QAMIL HOTI, përfaqësuar nga avokat Erind Nanushi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT PRANË BASHKISË ELBASAN, në mungesë.
SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "BAILIFF OFFICERS" SH.P.K., në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. (80-2024-501) 492, datë 23.02.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 24, 27, 71, 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve Qerime Hoti dhe Qamil Hoti *(kërkuesit)*, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit *(IMT)* dhe shoqërisë së përmbarimit privat "Bailiff officers" sh.p.k. *(shoqëria "Bailiff officers")*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë nënë e bir. Ndërkohë, në një kontroll të ushtruar nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë Elbasan *(INU)* është konstatuar se kërkuesi Qamil Hoti po ndërtonte pa leje një objekt në qytetin e Elbasanit. Për këtë kundërvajtje administrative, INU-ja, Elbasan ka nxjerrë vendimin nr. 15, datë 05.09.2013, me të cilin kërkuesi në fjalë është dënuar me gjobë në masën 500.000 lekë *(vendimi i dënimit me gjobë nr. 15/2013)*. Po kështu, INU-ja, Elbasan ka nxjerrë edhe një vendim për prishjen e ndërtimit pa leje. Ndaj kërkuesit Qamil Hoti ka filluar edhe një procedim penal për kundërvajtjen penale "Ndërtimi i paligjshëm", të parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 1, i Kodit Penal. Pavarësisht se është konstatuar se ndërtimi pa leje i objektit ka ndodhur, madje edhe pas konstatimit të kundërvajtjes administrative, procedimi penal, në vijim, është pushuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e datës 16.06.2014, për shkak të amnistisë së dhënë me ligjin nr. 22/2014.

2. Për kërkesën e Bashkisë Elbasan, me vendimin nr. 106 (13-2014-769), datë 07.02.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për titullin ekzekutiv, vendimin e dënimit me gjobë nr. 15/2013, i cili është vënë në ekzekutim me kërkesën e Bashkisë Elbasan të datës 20.03.2014. Megjithatë, përmbaruesi gjyqësor privat nuk arriti të realizonte ekzekutimin, arsye për të cilën, në datën 27.09.2018, Bashkia Elbasan iu drejtua shoqërisë përmbarimore "Bailiff officers" sh.p.k. (ish-"Zike" sh.p.k.) dhe çështja përmbarimore iu transferua kësaj shoqërie. Kjo e fundit, në datën 14.11.2018, ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe kërkuesi debitor, në vijim, ka bërë disa pagesa të pjesshme, gjithsej 99.900

lekë. Në datat 15.07.2019 dhe 16.12.2019 janë bërë transferime të shumave të detyrimit në llogarinë bankare të kreditorit.

3. Në datën 08.11.2019 kërkuesit kanë paraqitur në gjykatë një kërkesëpadi kundër IMT-së, Elbasan *(ish-INU, Elbasan)* dhe shoqërisë përmbarimore "Bailiff officers" sh.p.k. Me pretendimin se dënimi administrativ me gjobë sipas vendimit nr. 15/2013 të INU-së, Elbasan është parashkruar, për shkak se nuk është ekzekutuar brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ndërsa vendimi është dërguar për ekzekutim në vitin 2018, kërkuesit, përmes padisë së tyre, kanë kërkuar pavlefshmërinë absolute të titullit ekzekutiv, anulimin e veprimeve përmbarimore për këtë shkak dhe kthimin e vlerës së paguar. Po kështu, ata kanë kërkuar edhe sigurimin e padisë, pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

4. Çështja fillimisht është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila, me vendimin nr. 364, datë 14.11.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesve për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Çështja ka mbetur pa u shqyrtuar deri në riorganizimin e ri gjyqësor dhe pas ndërprerjes së veprimtarisë së kësaj gjykate në datën 30.06.2023, ajo është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë *(gjykata administrative)*. Kjo e fundit, pasi e ka shqyrtuar çështjen, me vendimin nr. (80-2024-501) 492, datë 23.02.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Sipas asaj gjykate, padia e kërkuesve për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv ishte parashkruar në kuptim të nenit 112 të Kodit Civil *(KC),* ndërsa ajo është paraqitur në tejkalim të afatit 30-ditor nga marrja dijeni për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, që përcakton neni 609, pika 1, i Kodit të Procedurës Civile *(KPC).* Po sipas saj, në përputhje me nenin 45, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012),* vendimi është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohej ankim, pasi vlera e padisë ishte më e vogël se 20-fishi i pagës minimale në shkallë vendi.

5. Në datën 07.09.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.09.2024. Kolegji i Gjykatës, në datën 10.12.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1. *Së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, si dhe parimin e kontradiktoritetit,* pasi gjykata administrative e ka gjykuar çështjen në mungesë të tyre, pa pasur një njoftim të vlefshëm për seancën gjyqësore të datës 23.02.2024. Ajo gjykatë, në interpretim arbitrar të ligjit, ka konsideruar të rregullt njoftimin e nëpunësit postar, i cili në letërthirrje ka shënuar *"Njoftuar me telefon", "Objekt i pakërkuar",* por pa treguar ditën e komunikimit me ta, emrin e tij dhe numrin e telefonit me të cilin ka realizuar njoftimin. Pavarësisht kësaj, sipas neneve 129, pika 2, 130, pika 1 dhe 141, pika 1, të KPC-së, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 49/2012, shërbimi postar nuk mund të kryejë njoftimin e palëve me mjete elektronike, pra me telefon, gjë që mund të bëhet vetëm nga gjykata sipas rregullave që përcakton ligji. Gjykata administrative nuk ka njoftuar as avokatin e tyre, i cili, në kërkesën e datës 15.12.2022, për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, ka njoftuar gjykatën për zëvendësimin e avokatit të caktuar më parë dhe për ndryshimin e adresës, si dhe të të dhënave të kontaktit për efekt njoftimi, kërkesë kjo që as është administruar në dosjen gjyqësore. Si pasojë e mungesës së njoftimit, atyre nuk u është dhënë mundësia të dëgjoheshin për thelbin e çështjes, për faktet, për provat dhe për interpretimin e ligjit, ndërsa rezultati i çështjes nuk do të kishte qenë i njëjtë nëse ata do të ishin njoftuar.

6.2. *Së drejtës së aksesit,* pasi ata nuk kanë marrë nga gjykata administrative një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tyre në padi. Për shkak të parregullsisë së njoftimit, ajo gjykatë nuk i ka njoftuar as për prapësimet dhe as për provat e paraqitura nga të padituri, duke mos iu dhënë mundësia të paraqitnin pretendime për to. Pavarësisht kësaj, në marrjen e vendimit përfundimtar gjykata administrative është mbështetur edhe në prapësimet edhe në provat e të paditurve, përfshirë edhe të shoqërisë përmbarimore, e cila nuk i ka paraqitur brenda afatit 10-ditor, por vetëm pas

urdhrit të gjykatës. Në këtë mënyrë, atyre u është cenuar *e drejta për t'u dëgjuar* dhe *e drejta e mbrojtjes*, si dhe nuk është zbatuar *parimi i kontradiktoritetit* dhe *i barazisë së armëve*. Po kështu, duke mbështetur vendimin në prapësimet dhe provat e shoqërisë përmbarimore të paditur të paraqitura jashtë afatit 10-ditor, gjykata administrative ka cenuar edhe *standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi ajo nuk duhej t'i analizonte ato dhe as t'u referohej atyre.

6.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi gjykata administrative, sipas nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, shqyrton (parimisht) ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të provave, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, që përbëjnë edhe kufijtë e shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që në rastin konkret gjykata në marrjen e vendimit është mbështetur edhe në prapësimet edhe në provat e paraqitura jashtë afatit 10-ditor nga shoqëria përmbarimore e paditur. Duke pasur parasysh se rëndësia e vlerësimit të drejtë dhe tërësor të parakushtit procedural të parashkrimit të padisë është thelbësore për fatin e gjykimit të çështjes, në rastin konkret, gjykata administrative nuk duhet të shqyrtonte afatin e parashkrimit të padisë, referuar vetëm neneve 609 të KPC-së dhe 112 të KC-së, ndaj, për pasojë, ajo ka vepruar në cenim të kompetencës dhe rolit të saj kushtetues e procedural.

6.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës,* pasi padia e tyre synonte edhe mbrojtjen e së drejtës së pronës, të pasurisë ndërtesë që posedojnë dhe të vlerave monetare, e cenuar nga veprimet e paligjshme të të paditurve. Gjykata administrative, duke konsideruar të parashkruar padinë, nuk ka arsyetuar për pretendimet e tyre dhe as u është përgjigjur argumenteve të ligjore të parashtruara në padi. Arsyetimi i saj është i përciptë, i përgjithshëm dhe jologjik, ndërsa nuk ka një arsyetim të plotë dhe shterues për datat dhe veprimet a mosveprimet e palëve dhe për zbatimin e ligjit në lidhje me parashkrimin e padisë. Gjykata nuk ka përmbushur standardin e arsyetimit të vendimit, pasi ka dështuar të tregojë se ata janë dëgjuar rregullisht prej saj.

7. ***Subjektet e interesuara, IMT-ja dhe shoqëria e përmbarimit privat "Bailiff officers" sh.p.k.,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

8. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive,* neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, përcakton se Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi *(shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 56, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Në rastin konkret, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili, në përputhje me nenin 43 të Kushtetutës dhe nenin 45, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012, është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1/b, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në

jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar dhe nëse pala nuk është e pranishme, si datë e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij *(shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë mban datën 23.02.2024 dhe ai nuk është shpallur në prani të kërkuesve. Nga dosja gjyqësore e administruar për qëllime të gjykimit kushtetues nuk rezulton që vendimi i asaj gjykate t'u jetë njoftuar këtyre të fundit. Ndërkohë, sipas akteve të depozituara së bashku me ankimin kushtetues individual rezulton se në përgjigje të kërkesës së avokatit të kërkuesve, ajo gjykatë, me shkresën nr. 6670/1 prot., datë 07.05.2024, i ka dërguar vendimin e arsyetuar, të cilin ai e ka marrë në datën 08.05.2024. Duke mbajtur parasysh këtë datë, si dhe faktin se ankimi kushtetues individual është depozituar në datën 07.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

14. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e kontradiktoritetit, së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës*, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

15. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit, kërkuesit kanë parashtruar argumente në dy drejtime. Së pari, sipas tyre, ata nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata administrative për pretendimet e parashtruara në padi për shkak të rrëzimit të saj si e parashkruar. Së dyti, sipas kërkuesve, ata janë vënë në pamundësi për të paraqitur pretendime gjatë procesit gjyqësor në lidhje me prapësimet dhe provat e paraqitura nga të padituri për shkak të mosnjoftimit të tyre nga gjykata administrative.

16. Për sa i përket argumentit të parë të kërkuesve, për cenimin e së drejtës së aksesit, Gjykata konstaton se ai lidhet me pretendimin tjetër të tyre për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për të cilin ata kanë parashtruar se gjykata administrative ka

kapërcyer kompetencat e saj kur ka marrë në shqyrtim parashkrimin e padisë. Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson që pretendimin e kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj ta analizojë të ndërlidhur me pretendimin e tyre për cenimin e së drejtës së aksesit, për sa i përket argumentit të parë për këtë pretendim.

17. Kurse për argumentin e dytë të kërkuesve, për cenimin e së drejtës së aksesit, Gjykata konstaton se ai, në thelb, ka të bëjë me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe parimin e kontradiktoritetit, ndaj ky argument do të analizohet në kuadër të pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, si dhe parimin e kontradiktoritetit.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata konstaton se argumentet, në thelb, kanë të bëjnë me aksesin në gjykim, gjykatën e caktuar me ligj dhe të drejtën e njoftimit, ndaj ky pretendim do të analizohet në kuadër të tyre. Kurse për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e paraqitura lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesve, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

19. Për sa më lart, Gjykata, në vijim, do të analizojë në themel pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën e aksesit, si dhe së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e kontradiktoritetit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën e aksesit

20. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykata administrative, sipas nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, shqyrton (parimisht) ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të provave, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, që përbëjnë edhe kufijtë e shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që, në rastin konkret, gjykata në marrjen e vendimit është mbështetur edhe në prapësimet edhe në provat e paraqitura jashtë afatit 10-ditor nga shoqëria përmbarimore e paditur. Duke pasur parasysh se rëndësia e vlerësimit të drejtë dhe tërësor të parakushtit procedural të

parashkrimit të padisë është thelbësore për fatin e gjykimit të çështjes, në rastin konkret, gjykata administrative nuk duhet të shqyrtonte afatin e parashkrimit të padisë, referuar vetëm nenit 609 të KPC-së dhe nenit 112 të KC-së, ndaj, për pasojë, ajo ka vepruar në cenim të kompetencës dhe të rolit të saj kushtetues e procedural. Nisur nga kjo, sipas kërkuesve, ata nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata administrative për pretendimet e parashtruara në padi, ndërsa ajo është rrëzuar si e parashkruar.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik *(shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Sipas Gjykatës, shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit *(shih vendimet nr. 22, datë 25.04.2023; nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 7, datë 21.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve, të cilat duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimet nr. 67, datë 17.11.2015; nr. 7, datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe synon, ndër të tjera, garantimin e parimit të sigurisë juridike, miradministrimin e drejtësisë dhe shmangien e abuzimit me të drejtat *(shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë

drejtim, vlerësimi i parashkrimit ose jo të padisë përbën parakusht për shqyrtimin nga gjykatat e zakonshme të themelit të pretendimeve *(shih vendimin nr. 26, datë 09.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese *(shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se në shtator të vitit 2013 një nga kërkuesit është dënuar administrativisht me gjobë për kundërvajtjen administrative të ndërtimit pa leje. Për këtë vendim, në vijim, në shkurt të vitit 2014, gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, duke vlerësuar se ai përbën titull ekzekutiv sipas ligjit të posaçëm, kurse në mars të këtij viti është vënë në lëvizje procedura për ekzekutimin e tij. Megjithatë përmbaruesi gjyqësor nuk ka arritur të ekzekutojë titullin ekzekutiv deri në shtator 2018, kur çështja përmbarimore i është transferuar një subjekti tjetër përmbarimor gjyqësor, i cili në nëntor të këtij viti e ka kaluar atë në ekzekutim të detyrueshëm. Gjatë vitit 2019 kërkuesi debitor ka bërë disa pagesa për shlyerjen e detyrimit sipas titullit ekzekutiv, ndërkohë që në nëntor të këtij viti kërkuesit kanë paraqitur padi për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, anulimin e veprimeve përmbarimore për këtë shkak dhe kthimin e pagesave të bëra.

25. Padia e kërkuesve ka mbetur pa u shqyrtuar deri në datën 19.12.2023, kur gjyqtari i çështjes ka urdhëruar shqyrtimin e saj në seancë përgatitore, në dhomën e këshillimit, për në datën 17.01.2024. Në seancën përgatitore të kësaj date gjyqtari i çështjes ka urdhëruar njoftimin për të padituri të padisë së kërkuesve dhe akteve shoqëruese të saj, duke iu caktuar një afat 10-ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim, si dhe të akteve të plota shkresore për veprimet objekt padie. I padituri, IMT-ja, Elbasan, ka depozituar rregullisht prapësimet me shkrim. Në seancën përgatitore të radhës të datës 08.02.2024, e zhvilluar edhe ajo në dhomën e këshillimit,

gjyqtari ka vërejtur se shoqëria e paditur nuk ka paraqitur prapësime dhe prova megjithëse është njoftuar. Megjithatë, sipas dëftesës së komunikimit për këtë të paditur, del se ajo ka marrë njoftimin e gjykatës në datën 01.02.2024 dhe në datën e seancës përgatitore afati 10-ditor nuk ishte plotësuar. Nga ana tjetër, duke vlerësuar se janë kryer pothuajse të gjitha veprimet përgatitore procedurale, gjyqtari i çështjes ka urdhëruar shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore dhe njoftimin e palëve. Ndërkohë, në datën 09.02.2024, përmes shërbimit postar, shoqëria përmbarimore e paditur i ka dërguar gjykatës administrative prapësimet e saj me shkrim dhe praktikën dokumentare të ekzekutimit. Në seancën gjyqësore të datës 23.02.2024 gjykata administrative ka administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura nga palët dhe pasi i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor, ka marrë vendimin përfundimtar për rrëzimin e padisë së kërkuesve. Në marrjen e këtij vendimi ajo ka vënë në diskutim kryesisht një nga kushtet formale të padisë, pikërisht afatin e paraqitjes së saj, duke arritur në përfundimin se padia është parashkruar në kuptim të nenit 112 të KC-së, për shkak të paraqitjes së saj në tejkalim të afatit 30-ditor nga marrja dijeni për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, të përcaktuar në nenin 609, pika 1, të KPC-së. Sipas gjykatës administrative, kërkuesit kanë pasur dijeni për ekzekutimin e detyrueshëm të paktën nga data 15.07.2019, kur është bërë ekzekutimi pjesor i detyrimit, ndërkohë që padia është paraqitur në datën 08.11.2019.

26. Gjykata fillimisht vëren se referuar ligjit nr. 49/2012, që rregullon gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, sikundër edhe ajo në rastin në shqyrtim, por edhe KPC-ja, për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe, palët kanë të drejtë të paraqesin prova të cilat, si rregull, duhet të paraqiten përpara seancës së parë gjyqësore, ndërsa gjykata administrative e shqyrton çështjen në bazë të provave të paraqitura në gjykim. Në lidhje me padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, neni 609, pika 1, i KPC-së ka përcaktuar se ajo mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Ndërkohë, neni 18, pika 8, i ligjit nr. 49/2012, parashikon se afati për ngritjen e padisë shqyrtohet nga gjykata edhe kryesisht.

27. Nga sa konstatohet dhe referuar jurisprudencës kushtetuese të përmendur më lart, Gjykata vëren se gjykata administrative, referuar edhe objektit të gjykimit, ka administruar në gjykim edhe praktikën dokumentare të ekzekutimit të depozituar nga shoqëria përmbarimore e paditur, pas njoftimit asaj të padisë, duke mbështetur vendimin e saj edhe në të dhënat e treguara në aktet e kësaj praktike dokumentare. Po kështu,

në funksion të shqyrtimit të padisë dhe marrjes së vendimit përfundimtar, gjykata administrative ka shqyrtuar kryesisht afatin e paraqitjes së padisë nga kërkuesit, si parakusht për shqyrtimin në themel të saj, nga ku ka rezultuar se ajo është paraqitur tej afatit ligjor, ku mbi këtë bazë ka vendosur rrëzimin e padisë për shkak të parashkrimit, shuarjes së kësaj të drejte (të padisë). Në këtë kuptim, gjykata administrative ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj, duke e shqyrtuar çështjen brenda kufijve të saj dhe në ushtrim të kompetencave të dhëna nga ligji. Për sa i përket përfundimit për parashkrimin e padisë, gjykata administrative ka arsyetuar mjaftueshëm për ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij, ndërsa arsyetimi i saj nuk është alogjik. Kërkuesit nuk kanë parashtruar ndonjë argument konkret për ndonjë gabim faktik ose ligjor nga gjykata administrative, të tillë sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të tillë që e bën gjykimin të padrejtë.

28. Për sa më sipër, në kushtet kur gjykata administrative ka vepruar brenda kompetencave të saj, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet e vendimmarrjes së saj, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën e aksesit, është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, si dhe parimin e kontradiktoritetit

29. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykata administrative e ka gjykuar çështjen në mungesë të tyre, pa pasur për ata një njoftim të vlefshëm për seancën gjyqësore të datës 23.02.2024. Sipas tyre, ajo gjykatë, në interpretim arbitrar të ligjit, ka konsideruar të rregullt njoftimin e nëpunësit postar, i cili në letërthirrje ka shënuar *"Njoftuar me telefon", "Objekt i pakërkuar",* por pa treguar ditën e komunikimit me ata, emrin e tij dhe numrin e telefonit me të cilin ka realizuar njoftimin. Pavarësisht kësaj, vijojnë kërkuesit, sipas neneve 129, pika 2, 130, pika 1 dhe 141, pika 1, të KPC-së, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 49/2012, shërbimi postar nuk mund të kryejë njoftimin e palëve me mjete elektronike, pra me telefon, gjë që mund të bëhet vetëm nga gjykata, sipas rregullave që përcakton ligji. Po kështu, sipas kërkuesve, gjykata administrative nuk ka njoftuar as avokatin e tyre i cili, në kërkesën e datës 15.12.2022, për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, ka njoftuar gjykatën për zëvendësimin e avokatit të caktuar më parë dhe për ndryshimin e adresës dhe të të dhënave të kontaktit për efekt njoftimi, kërkesë kjo që as është administruar në dosjen

gjyqësore. Për shkak të parregullsisë së njoftimit, ata nuk janë njohur as me prapësimet dhe provat e paraqitura nga të padituri, duke mos iu dhënë mundësia të paraqitnin pretendime për to. Në përfundim, sipas kërkuesve, si pasojë e mungesës së njoftimit, atyre nuk iu dha mundësia të dëgjoheshin për thelbin e çështjes, për faktet, provat dhe interpretimin e ligjit, ndërsa rezultati i çështjes nuk do të kishte qenë i njëjtë nëse ata do të ishin njoftuar.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Ajo krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare *(shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023; nr. 34, datë 25.07.2011; nr. 34, datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson *(shih vendimet nr. 30 datë 18.04.2024; nr. 9, datë 26.02.2015; nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese).*

32. Duke pasur parasysh jurisprudencën e mësipërme, Gjykata, në vijim, do të analizojë nëse është respektuar nga gjykata administrative e drejta e kërkuesve për t'u njoftuar për seancën gjyqësore dhe, nëse jo, a ka sjellë kjo cenimin e aspekteve të pretenduara të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kontekst të rrethanave të rastit në shqyrtim dhe të vendimmarrjes së gjykatës. Thënë ndryshe, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesve u janë cenuar në tërësi ato aspekte të pretenduara të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke ndikuar në vendimmarrjen e gjykatës administrative dhe duke e bërë gjykimin të padrejtë.

33. Për sa i përket kuadrit rregullator në fuqi që përcakton njoftimin e

palëve për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata vëren se detyrimi për kryerjen e këtij njoftimi parashikohet në nenin 27 të ligjit nr. 49/2012. Ndërkohë, neni 21 i këtij ligji ka përcaktuar detyrimin e paditësit për të treguar saktë në padi: a) adresën e tij ose të përfaqësuesit të tij, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet; b) një numër telefoni të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike. Ndërsa neni 22 i ligjit, përveç mjeteve dhe mënyrave të njoftimit, të parashikuara nga KPC-ja, ka parashikuar se kur gjykata e çmon të dobishme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit, urdhëron njoftimin e palëve ose përfaqësuesve të tyre nga nëpunësi gjyqësor, nëpërmjet telefonit të gjykatës të përcaktuar për këtë qëllim me urdhër të kancelarit të gjykatës, duke përcaktuar edhe rregullat për mënyrën e dokumentimit të këtij njoftimi (pika 1, shkronja "a").

34. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se KPC-ja parashikon njoftimin shkresor dhe elektronik të akteve, ndërsa lë hapësirë edhe për mënyra të tjetra që garantojnë një njoftim të rregullt dhe të sigurt. Neni 130 i këtij kodi rregullon njoftimin shkresor, i cili realizohet përmes dorëzimit edhe nga shërbimi postar i letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të thirrur, kudo ku ai gjendet, ose në vendet e treguara në nenin 131 të tij, duke iu dorëzuar atij personalisht, ose një personi tjetër që tregohet në atë dispozitë.

35. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesit në kërkesëpadi kanë treguar adresën e vendbanimit të tyre, sikundër edhe një numër telefoni celular, duke pranuar të njoftohen edhe me mesazh (sms) në këtë numër telefoni. Në përmbajtje të kërkesëpadisë ata kanë kërkuar që kopjet e akteve që të padituri do të paraqesin t'u dërgohen në adresën e një avokati, i zgjedhur nga njëri prej tyre si përfaqësues në atë çështje, sipas një prokure të posaçme bashkëlidhur padisë. Ata nuk kanë lënë të dhëna adresash të postës elektronike. Për seancën gjyqësore të datës 23.02.2024, gjykata administrative ka dërguar njoftim për kërkuesit përmes letërthirrjes, në të cilën është shënuar edhe adresa e tyre e vendbanimit, sikundër dhe numri i telefonit, sikurse ato janë treguar në kërkesëpadi. Letërthirrja është dërguar përmes shërbimit postar. Në fletën shoqëruese të shërbimit postar, nëpunësi i saj ka shënjuar një nga alternativat që ajo fletë përmban, pikërisht *"Objekt i pakërkuar"*. Ndërkohë, me shkrim dore, në letërthirrje, nëpunësi postar ka shënuar *"Njoftuar në telefon"*. Gjykata administrative,

pasi ka verifikuar letërthirrjen e kthyer nga shërbimi postar, ka vlerësuar se kërkuesit janë njoftuar për seancën gjyqësore, për sa kohë në kërkesëpadi ata kanë pranuar të njoftohen nëpërmjet numrit të telefonit të treguar, njoftim i cili ishte bërë nga shërbimi postar. Kjo mënyrë njoftimi, sipas gjykatës, është në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 49/2012, duke vënë në dukje se sipas pikës 5 të kësaj dispozite është në detyrimin e paditësit të njoftojë gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës ose të numrit të telefonit, shkelja e të cilit i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmëri të njoftimit. Mbi këtë bazë, gjykata administrative ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuesve, por edhe të të paditurve, ku pasi ka administruar provat shkresore të paraqitura nga palët, ka marrë vendimin përfundimtar për rrëzimin e padisë për shkak të parashkrimit të saj.

36. Në analizë të sa më lart, Gjykata vëren se gjykata administrative, për sa i përket njoftimit të kërkuesve për seancën gjyqësore, është bazuar në shënimin e bërë në letërthirrje nga nëpunësi postar se ata janë njoftuar me telefon, sikurse vetë në kërkesëpadinë e tyre kanë pranuar për t'u njoftuar. Megjithatë, gjykata nuk ka vënë në diskutim se neni 22 i ligjit nr. 49/2012 për këtë mënyrë njoftimi ka ngarkuar nëpunësin gjyqësor, ku në funksion të sigurisë së njoftimit dhe dokumentimit të tij ka përcaktuar edhe një sërë elementesh që duhen respektuar. Në këtë situatë, nuk mund të pohohet me siguri se kërkuesit janë njoftuar për seancën gjyqësore dhe, për pasojë, që mosparaqitja e tyre në gjykim ka qenë një zgjedhje e vullnetshme nga ata. Në këtë kuptim, gjykata administrative nuk ka respektuar të drejtën e kërkuesve për t'u njoftuar për seancën gjyqësore.

37. Duke mbajtur parasysh se e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, mosrespektimi i saj, si rregull, do të nënkuptonte cenimin e të drejtave të tjera në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, Gjykata vëren se një gjë e tillë duhet të vlerësohet në raport me rrethanat e rastit, pra duke verifikuar nëse mosrespektimi për njërën palë i së drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim ka çuar në moskrijimin për atë të të njëjtave mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare.

38. Në rastin në shqyrtim, siç u parashtrua dhe më lart, Gjykata vëren se gjykata administrative ka vendosur rrëzimin e padisë për shkak të parashkrimit të saj. Në arritjen e këtij përfundimi, ajo është mbështetur në faktin se titulli ekzekutiv, për të cilin kërkuesit, me padinë e tyre, kanë

kërkuar pavlefshmërinë, ka qenë në ekzekutim të detyrueshëm, si dhe se ata kanë qenë në dijeni të këtij ekzekutimi, të paktën nga data 15.07.2019, kur kanë bërë një pagesë pjesore të detyrimit sipas titullit ekzekutiv. Këto të dhëna gjykatës i kanë rezultuar nga praktika dokumentare e ekzekutimit e paraqitur nga shoqëria përmbarimore e paditur, praktikë e cila nuk u është dërguar paraprakisht kërkuesve. Në këtë kuptim, ndërsa gjykimi është zhvilluar në mungesë të tyre, duket se ata nuk kanë pasur mundësi për t'u njohur dhe për të paraqitur pretendimet e tyre rreth atyre provave, pikërisht për sa u përket fakteve mbi të cilat gjykata administrative në vijim ka mbështetur vendimin e saj. Megjithatë, në realitet, faktet në fjalë kanë të bëjnë me veprimet e kërkuesve dhe ato janë pranuar dhe pohuar edhe nga vet ata në kërkesëpadinë e tyre. Edhe në ankimin e tyre kushtetues individual kërkuesit nuk ngrenë asnjë pretendim konkret për këtë aspekt të vendimit të kundërshtuar të gjykatës administrative. Në një situatë të tillë nuk mund të thuhet se mosnjoftimi i seancës gjyqësore, mosnjohja me praktikën dokumentare të ekzekutimit dhe zhvillimi i gjykimit në mungesë të kërkuesve, i ka vënë ata në kushte jo të njëjta me palën kundërshtare në lidhje me mundësinë për të paraqitur prova dhe argumente në raport me ato fakte që kanë të bëjnë me veprime të tyre dhe që vet ata i kanë pranuar në aktin për fillimin e procesit gjyqësor.

39. Për sa i përket çështjes së afatit të paraqitjes së padisë, siç u parashtrua dhe më lart, Gjykata vëren se një çështje të tillë gjykata administrative e ka marrë në shqyrtim kryesisht, pra jo për ndonjë prapësim të të paditurve. Ndërkohë, në kushtet kur gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesve, ata nuk kanë pasur mundësi të paraqisnin argumentet e tyre për këtë çështje. Megjithatë, ndërsa jemi përpara një mosmarrëveshjeje administrative dhe gjykimi i saj është vënë në lëvizje nga kërkuesit, këta të fundit kanë pasur mundësi, por edhe interes për të treguar se padia është paraqitur në afat, për sa kohë ligji i veçantë ngarkon gjykatën që të shqyrtojë edhe kryesisht këtë çështje. Ndërkohë, lidhur me këtë moment, Gjykata më lart arriti në përfundimin se kërkuesve nuk u është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pra se gjykata administrative ka vendosur në përputhje me kompetencat e saj, duke mos pasur ajo ndonjë gabim të dukshëm faktik ose ligjor. Në këtë kontekst, nuk mund të thuhet se mosnjoftimi i seancës gjyqësore dhe zhvillimi i gjykimit në mungesë të kërkuesve i ka vënë ata në kushte të pabarabarta me palën kundërshtare në lidhje me mundësinë për të paraqitur argumente në raport me afatin e paraqitjes së kërkesëpadisë.

40. Për rrjedhojë, në kontekstin e rastit konkret, Gjykata vlerëson

se vetëm shkelja formale e së drejtës së kërkuesve për t'u njoftuar për gjykimin e çështjes, për sa kohë ajo nuk është shoqëruar edhe me shkeljen e aspekteve të tjera të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe as nuk ka pasur ndikim në vendimmarrjen e gjykatës administrative, nuk duket se e bën gjykimin e padrejtë dhe as të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën administrative.

41. Në përmbledhje të sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e kontradiktoritetit, është i pabazuar.

42. Në kushtet kur pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës janë të ndërvaruara me ato për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për të gjitha shkaqet e përmendura më lart, Gjykata çmon se edhe këto pretendime janë gjithashtu të pabazuara.

43. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat "a" dhe "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.04.2025
Shpallur më 28.05.2025

Vendim nr. 19, datë 10.04.2025
(V-19/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "EKZON KALAJA COMFORT" SH.P.K.,** përfaqësuar nga avokat Arben Doda, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE LEZHË, përfaqësuar nga juristi Jetnor Sherri.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 819, datë 21.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 16, pika 2, 17, 41, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 49, 50, 70 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).***

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shoqërisë "Ekzon Kalaja Comfort" sh.p.k. *(kërkuesja)*, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë *(DRT)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.04.2010 kërkuesja është regjistruar si tatimpaguese në DRT-në, Lezhë, me objekt aktiviteti në fushën e turizmit, ndërtimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë etj. Në bazë të urdhrit nr. 1198, datë 19.07.2016 të drejtorit të DRT-së, Lezhë, inspektorët tatimorë të Drejtorisë së Verifikimit dhe të Koordinimit në Terren të DRT-së, Lezhë, në datën 20.07.2016 kanë ushtruar kontroll në adresën ku ushtronte aktivitetin kërkuesja.

2. Pas kontrollit të ushtruar inspektorët tatimorë kanë mbajtur aktkonstatimin e datës 20.07.2016, sipas të cilit rezultonte se kërkuesja nuk lëshonte kuponë tatimorë për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të shërbimeve dhe të mallrave, si dhe nuk kishte përditësuar ndryshimin e të dhënave. Inspektorët tatimorë kanë mbajtur procesverbalin e gjobës së datës 20.07.2016 për gjobitjen e kërkueses në shumën 50.000 lekë për konstatimin e moslëshimit të kuponëve tatimorë. Bazuar në aktin e konstatimit dhe në bazë të verifikimeve të kryera në sistemin CATS, Sektori i Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit të DRT-së, Lezhë ka mbajtur aktvlerësimin e datës 26.07.2016, nga ku ka rezultuar se kërkuesja nuk e ka deklaruar aktivitetin "Bar-restorant-hotel", ndaj është gjobitur në shumën 10.000 lekë.

3. Në vijim, DRT-ja, Lezhë, pasi është njohur me aktet e mësipërme, ka vijuar procedurat përkatëse dhe ka nxjerrë aktin administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. 15042/4 prot., datë 04.08.2016, të cilin ia ka komunikuar kërkueses në adresën e deklaruar. Kjo e fundit është njohur me aktin e mësipërm, por nuk ka ushtruar ankim administrativ në Drejtorinë e Apelimit Tatimor.

4. Në fund të vitit 2015 Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) kishte filluar

shqyrtimin e kërkesës së një shoqate, me objekt shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 5, 7, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 99/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" *(ligji nr. 99/2015),* i cili ka hyrë në fuqi në datën 12.11.2015. Gjykata, me vendimin përfundimtar nr. 33, datë 08.06.2016 *(vendimi nr. 33/2016)*, ka vendosur shfuqizimin e neneve 5, 14, 15, 16 (pika 4 e shtuar në nenin 121), 17, pikat 1 dhe 2, 18 (pika 2 e nenit 124) dhe 20 të ligjit nr. 99/2015, si të papajtueshme me Kushtetutën. Ky vendim ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 16.06.2016.

5. Në vijim, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 112/2016, datë 03.11.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 112/2016),* ku, ndër të tjera, ka pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse që lidheshin me dispozitat e shfuqizuara nëpërmjet vendimit nr. 33/2015 të Gjykatës. Ligji nr. 112/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi në datën 30.11.2016.

6. Në vitin 2023 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të njoftimit të vlerësimit për detyrimet të DRT-së, Lezhë, për shkak se ligji mbi bazën e të cilit ishte disponuar dhënia e gjobës ndaj saj ishte shfuqizuar.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.819, datë 21.03.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkueses. Në dispozitivin e vendimit përcaktohet se ai është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim. Pavarësisht kësaj, kërkuesja në datën 28.05.2024 ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin e datës 31.05.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit të saj.

8. Në datën 22.08.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.09.2024. Në datën 11.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së saj, në kushtet kur DRT-ja, Lezhë ka vepruar jashtë kompetencës së saj e në kundërshtim flagrant me ligjin dhe vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës, duke e gjobitur kërkuesen në bazë të një dispozite të shfuqizuar të ligjit nr. 9920/2008. Në momentin e vënies së gjobës nuk ka pasur dispozitë ligjore në fuqi për gjobitjen e kërkueses nga DRT-ja, Lezhë, pasi neni 122 i tij ishte shfuqizuar nëpërmjet vendimit nr. 33/2016 të Gjykatës. Ndryshimet e nenit 122 të ligjit nr. 9980/2008 janë miratuar me ligjin nr. 112/2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 30.11.2016. Vendimi nr. 33/2016 i Gjykatës nënkuptonte moszbatimin e mëtejshëm të atij ligji jo vetëm nga palët në gjykimin kushtetues, por nga të gjitha autoritetet shtetërore, për më tepër nga gjykata.

9.1.2. *Parimit të ligjshmërisë*, të garantuar nga neni 4, pika 1, i Kushtetutës, pasi gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkueses edhe pse konstatimi i bërë nga DRT-ja, Lezhë ishte i qëllimshëm, i padrejtë dhe në kundërshtim flagrant me ligjin. Grupi i inspektimit të DRT-së, Lezhë është ngritur në kundërshtim me ligjin, pasi inspektimi është kryer nga një organ që në përbërjen e tij ka pasur persona të cilët nuk e gëzonin cilësinë e inspektorit tatimor. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative *(KPA)*, aktet e nxjerra nga ky organ janë absolutisht të pavlefshme.

9.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit efektiv,* pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka respektuar haptazi vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës. Ajo gjykatë duhet të konstatonte se organi tatimor e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës, fakt i parashtruar nga kërkuesja në kërkesëpadi dhe në seancë gjyqësore. Edhe pse

ky pretendim është pasqyruar në vendim, gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar, duke mos u shprehur për bazueshmërinë e tij.

9.2. *E drejta e pronës,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë.

10. ***Subjekti i interesuar, DRT-ja, Lezhë***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor nuk qëndron, pasi akti administrativ është marrë pas një hetimi të rregullt dhe një procedimi që respekton të drejtat procedurale të kërkueses, duke i dhënë mundësinë e mbrojtjes dhe të apelimit në rrugë administrative, me qëllim mbrojtjen e interesave të saj. Nëpërmjet aktit administrativ DRT-ja, Lezhë ka vepruar në përputhje me detyrimet ligjore dhe kushtetuese për të siguruar mbledhjen e taksave dhe ndëshkimin e shkeljeve tatimore, duke respektuar ligjin dhe parimet e drejtësisë.

10.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i pabazuar, pasi kërkuesja, si çdo subjekt tjetër ekonomik, ka detyrimin të respektojë normat tatimore të vendosura nga shteti. Vendosja e gjobës për shkelje të normave fiskale është në përputhje me parimet e Kushtetutës. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, çdo individ gëzon të drejtën e pronës, por kjo e drejtë është subjekt i kufizimeve që vendosen për mbrojtjen e interesave të përgjithshëm të shoqërisë, përfshirë mbledhjen e taksave dhe përfitimin nga shërbimet publike.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet

të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuesja, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i së drejtës private dhe bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe legjitimohet *ratione personae,* në përputhje me nenet 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendimin gjyqësor të së cilës ajo kundërshton.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose të korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike efektive përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Subjekti i interesuar, DRT-ja, Lezhë, ka prapësuar se kërkuesja nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të saj, pasi nuk ka ndjekur instancat e zakonshme të ankimit përpara se t'i drejtohej Gjykatës. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se objekti i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në dispozitivin e të cilit është shënuar se ai është i formës së prerë dhe i paankimueshëm. Kjo do të thotë se paraqitja e kërkesës së saj në Gjykatë është zgjedhje e vetë kërkueses, mbështetur në objektin e padisë së saj për pavlefshmërinë absolute të akteve. Për rrjedhojë, mbështetur në këto rrethana, Gjykata vlerëson se

kërkuesja e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese.

15. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesja mban datën 21.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 22.08.2024. Ndërkohë kërkuesja është informuar për vendimin nga gjykata e shkallës së parë me shkresën nr. 3595/1, datë 22.05.2024. Duke iu referuar kësaj date si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave themelore, rezulton se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, rrjedhimisht kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

17. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se nga vendimi gjyqësor i kundërshtuar asaj i janë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike, ligjshmërisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit e të ankimit efektiv, si dhe e drejta e pronës, të garantuara nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, të cilat janë me natyrë kushtetuese.

18. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të ligjshmërisë, të garantuar nga neni 4, pika 1, i Kushtetutës, kërkuesja ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së saj edhe pse konstatimi i bërë nga DRT-ja, Lezhë është i qëllimshëm, i padrejtë dhe në kundërshtim flagrant me ligjin, pasi grupi i inspektimit është ngritur në kundërshtim me ligjin, ndaj, bazuar në nenin 108 të KPA-së, aktet e nxjerra nga ky organ janë absolutisht të pavlefshme. Gjykata konstaton se këto argumente, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin që gjykata e shkallës

së parë i ka bërë ligjit të zbatueshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ajo ka zhvilluar. Duke qenë se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të ligjshmërinë nuk mund të merret në shqyrtim, pasi ai nuk përmban argumente në nivel kushtetues.

19. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë.

20. Lidhur me të drejtën e pronës, në kontekst të fakteve të çështjes, Gjykata rithekson se kjo e drejtë, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore. Për sa u takon detyrimeve financiare, duke përfshirë edhe gjobën, ato janë pjesë e konceptit kushtetues të pronës private, pasi pagesa e një sasie të caktuar të hollash, e barasvlershme në këtë rast me masën e gjobave, është një shumë që merret nga pasuria e individit *(shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Nisur nga sa më lart, duke qenë se në rastin konkret ky pretendim, në thelb, lidhet me vlerësimin që gjykata e shkallës së parë i ka bërë çështjes në fjalë, Gjykata çmon ta trajtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

22. Për sa i takon kësaj të fundit (së drejtës për proces të rregullt ligjor), kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit e të drejtën e ankimit efektiv, për shkak se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë, sipas saj, është bazuar në një dispozitë ligjore të shfuqizuar. Mbështetur në thelbin e këtij argumenti, Gjykata çmon të analizojë në themel nëse gjykata e shkallës së parë ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat prima facie hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesja ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka respektuar haptazi vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës. Sipas kërkueses, ajo

gjykatë duhet të konstatonte se organi tatimor e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës, fakt i parashtruar nga kërkuesja në kërkesëpadi dhe në seancë gjyqësore. Sipas kërkueses, edhe pse ky pretendim është pasqyruar në vendim, gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar, duke mos u shprehur për bazueshmërinë e tij. Lidhur me këtë pretendim, subjekti i interesuar nuk ka prapësuar argumente.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht për forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të

Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit *(shih vendimet nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesja ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin se gjoba e dhënë ndaj saj është bazuar në një dispozitë ligjore të shfuqizuar, duke shqyrtuar nëse vendimi i kundërshtuar është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

28. Konkretisht, Gjykata vëren se nga njoftimi i vlerësimit, i cili caktonte ndaj kërkueses dy gjoba për moslëshimin e kuponit tatimor dhe për mospërditësimin e të dhënave, është nxjerrë nga DRT-ja, Lezhë në datën 04.08.2016. Në përmbajtjen e atij akti nuk konstatohet ndonjë bazë ligjore, por rezulton se ai është mbështetur, ndër të tjera, edhe te procesverbali i gjobës i datës 20.07.2016, i cili bazohej tek akti i konstatimit nr. 0757743 i së njëjtës datë. Procesverbali i gjobës rezulton se është nxjerrë në zbatim të nenit 122, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 9920/2008, i cili është ndryshuar me nenin 17, pika 1, të ligjit nr. 99/2015. Ky i fundit është shfuqizuar nga Gjykata me vendimin nr.33/2016, ndërkohë që veprimet e organit tatimor ndaj kërkueses janë kryer në momentin kur kjo dispozitë ka qenë e shfuqizuar nga Gjykata. Dispozita e mësipërme është ndryshuar nëpërmjet nenit 51 të ligjit nr. 112/2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 30.11.2016. Për këtë çështje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se akti administrativ është plotësisht i vlefshëm dhe është nxjerrë nga organi kompetent, konform parashikimeve ligjore. Sipas asaj gjykate, nuk janë konstatuar shkelje flagrante të procedurës së nxjerrjes së aktit ose të ndonjë dispozite urdhëruese që lidhet me formën e tij dhe që do të përbënte shkak për pavlefshmërinë absolute të tij *(shih faqen 9 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë),* duke mos u shprehur për bazueshmërinë e pretendimit të kërkueses në drejtim të respektimit të vendimit të Gjykatës për shfuqizimin e nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 99/2015.

29. Nisur nga sa më lart, Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka arsyetuar në vendimin e saj për forcën detyruese të vendimit të Gjykatës lidhur me shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 9920/2008 në raport me veprimet konkrete që ka kryer administrata tatimore gjatë asaj periudhe, edhe pse një pretendim i tillë ishte ngritur qartazi në kërkesëpadinë e kërkueses, si dhe vetë ajo gjykatë

e ka pasqyruar këtë pretendim në vendimin e saj. Nën këtë optikë, Gjykata çmon se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkueses, duke cenuar, për rrjedhojë, të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndaj pretendimet e saj janë të bazuara.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkueses duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 819, datë 21.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.04.2025
Shpallur më 09.05.2025

Vendim nr. 20, datë 11.04.2025
(V-20/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.02.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 23 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARBEN AHMETAJ**, përfaqësuar nga avokat Henrik Ligori, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Altin Dumani dhe Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 296 akti, datë 17.07.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 37 (87-2023-172), datë 10.08.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2023-2048, datë 07.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, pika 1, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj;**

neni 77 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 277 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 277/2020*) për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim, të parashikuara respektivisht nga nenet 248 e 25, 260, 287, paragrafi 2, shkronjat "a" dhe "b" dhe 245 e 25, të Kodit Penal (*KP*). Në themel të procedimit penal ka qenë procedura e lidhjes së kontratës së koncesionit me shoqërinë "Albtek Energy" sh.p.k. për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë në vitin 2014, si dhe zbatimi i kësaj kontrate nga ajo shoqëri. Ndërkohë, në lidhje me procedurën për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në qarkun Fier dhe prodhimin e energjisë, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 187 të vitit 2020.

2. Me vendimin e datës 19.09.2022 të prokurorit është vendosur ndarja e procedimit penal nr. 277/2020 në disa procedime penale të tjera, ku bën pjesë edhe ai nr. 277/1 i vitit 2022, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" nga funksionarët e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë për procedurat e ndjekura për kalimin për miratim të vendimeve

të Këshillit të Ministrave nr. 907, datë 17.12.2014 "Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë" dhe nr. 792, datë 09.11.2016 "Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k.".

3. Në datën 22.02.2023 një gazetar, me pretendimin se ishte në dijeni të fakteve penale lidhur me veprime financiare, fshehje të të ardhurave, si dhe pastrim të parave, ka paraqitur kallëzim penal ndaj deputetit Arben Ahmetaj (*kërkuesi*), i cili kishte mbajtur më parë edhe detyrat e ministrit të Financave dhe të zëvendëskryeministrit. Mbi bazën e këtij kallëzimi penal, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 30, datë 24.02.2023 për veprat penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara respektivisht nga nenet 260, 257/a dhe 287 të KP-së. Ky procedim penal është bashkuar me atë nr. 277/1 të vitit 2022 në një procedim penal të vetëm që është regjistruar me nr. 277/1 i vitit 2022 (*procedimi penal nr. 277/1/2022*), duke vijuar hetimet për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 260, 257/a dhe 287 të KP-së.

4. Në kuadër të këtij procedimi penal, në datën 17.03.2023 kërkuesi Arben Ahmetaj ka marrë cilësinë e personit nën hetim, në kuadrin e hetimeve që po kryhen për procedimin penal nr. 277/1/2022, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", vetëm dhe në bashkëpunim, në formën e deklarimit të rremë dhe në formën e fshehjes, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë e neni 25 i KP-së, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", të parashikuar nga neni 260 i KP-së, gjashtë herë, dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale, ose veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së. Hetimet në lidhje me kërkuesin janë shtrirë në rolin e tij jo vetëm në kuadrin e procedurës për dhënien me koncesion të projektit për ndërtimin dhe administrimin

e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë, por edhe në atë për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë, si dhe ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë.

5. Në kuadër të këtij procedimi penal prokuroria ka paraqitur në gjykatë kërkesë për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" për pasuritë: *tre apartamente* me sipërfaqe, përkatësisht 124.15 m^2, 148.8 m^2 dhe 178.68 m^2 dhe një garazh me sipërfaqe 21 m^2, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria "Sheron" sh.p.k., korpusi i parë, në vendin e quajtur "Selitë", aktualisht të regjistruara në pronësi të asaj shoqërie, por përfituar nga shtetasja A.M. (ish-bashkëshortja e kërkuesit) si pjesë nga investimi, sipas kontratës të datës 08.07.2014. Në vijim, kërkuesit i kanë kaluar detyrimet dhe përfitimet nga ekzekutimi i aktmarrëveshjes për investim, në bazë të marrëveshjes për zgjidhje martese me mirëkuptim mes kërkuesit dhe ish-bashkëshortes A.M., të miratuar me vendimin për zgjidhje martese të datës 15.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; *apartament* me sipërfaqe 167 m^2 në rrugën "Reshit Çollaku", Tiranë, regjistruar në pronësi të kërkuesit; *shuma 8,620.68 euro*, në llogarinë e kërkuesit në bankën "Intesa Sanpaolo Bank"; *shuma 115,692.84 euro*, në depozitën në bankën "Intesa Sanpaolo Bank" në emër të kërkuesit.

6. Me vendimin nr. 296 akti, datë 17.07.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*), ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme si të bazuar në ligj dhe në prova, duke vlerësuar se pasuritë që janë kërkuar të sekuestrohen plotësojnë kushtet për t`u kualifikuar si çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale në respektim të nenit 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së e që i nënshtrohet sekuestros preventive në respektim të nenit 274, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) dhe se ekziston dyshimi se mund të merren masa me qëllim tjetërsimin e tyre. Sipas pikës 4 të dispozitivit të vendimit, për administrimin e pasurive të sekuestruara ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (*AAPSK*). Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, përmes përfaqësuesve ligjorë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit për caktimin e masës së sekuestros për pasurinë e paluajtshme apartament në rrugën "Reshit Çollaku", në pronësi të kërkuesit, dhe shumave të parave në llogarinë dhe depozitën e tij bankare.

7. Sipas procesverbalit të datës 17.07.2023 "Mbi ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nr. 297 akti, datë 17.07.2023", oficerët e Policisë Gjyqësore kanë shkuar te pasuria e paluajtshme (apartament) në rrugën "Reshit Çollaku", Tiranë bashkë me specialistët e AAPSK-së, dhe pasi janë evidentuar dhe pasqyruar në procesverbal sendet që ndodheshin në ambientet e brendshme të apartamentit, ai u është lënë në dorëzim specialistëve të AAPSK-së për procedurat e mëtejshme.

8. Me vendimin nr. 37 (87-2023-172), datë 10.08.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*) ka miratuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke arsyetuar se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive", të parashikuar nga neni 274 i KPP-së dhe se në ankim nuk gjenden shkaqe që ta bëjnë të cenueshëm atë vendim. Sipas asaj gjykate, në kushtet që kemi të bëjmë me fazën hetimore dhe ka dyshime lidhur me origjinën e tyre, pasuritë e sekuestruara futen në kategorinë e sendeve që janë të sekuestrueshme, sipas parashikimeve të nenit 36 të KP-së, ndaj ato duhet të vazhdojnë të jenë të sekuestruara. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Me vendimin nr. 00-2023-2048, datë 07.12.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, duke mbajtur në konsideratë fazën në të cilën ndodhet çështja, për sa kohë që për pasuritë objekt sekuestro ka dyshime se përbëjnë produkt të veprave penale për të cilat po hetohet kërkuesi, gjykatat e posaçme kanë vlerësuar se ato duhet të qëndrojnë të sekuestruara, pasi ekziston dyshimi se mund të tjetërsohen, ndaj caktimi i masës pasurore parandaluese është e nevojshme me qëllim që të pengohet çdo transferim ose tjetërsim i mundshëm i këtyre pasurive.

10. Në datën 18.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës. Me vendimin e datës 17.07.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit me vendimin e datës 23.07.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesi*** ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

11.1. *Të drejtën e pronës private* në drejtim të tagrit të gëzimit të qetë të saj, në kundërshtim me kriteret e nenit 41, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi:

11.1.1. *Ndërhyrja nuk parashikohet me ligj,* sepse gjykatat kanë urdhëruar zbatimin e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" edhe mbi pasurinë apartament, të ndodhur në rrugën "Reshit Çollaku", e cila, nga aktet dhe vendimet gjyqësore, provohet se është produkt i një investimi të ligjshëm në kohën kur kërkuesi nuk kryente asnjë funksion shtetëror, pra shumë më herët se ndodhia e fakteve për të cilat akuzohet ai. Kjo pasuri është provuar se është pjesë e sipërfaqes së banimit të përfituar nga investimi i financuar nga kursime të familjes dhe kredia e marrë në bankën "Intesa Sanpaolo Bank", në shumën 100,000 euro. Pas zgjidhjes së martesës dhe pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore me marrëveshje mes palëve, apartamenti është regjistruar në pronësi të kërkuesit. Edhe masa e sekuestros mbi llogarinë dhe depozitën bankare nuk është e parashikuar në ligj, është arbitrare dhe nuk ndjek qëllim të ligjshëm, pasi nuk ekziston asnjë rrezik i disponimit të lirë të fondeve bankare.

11.1.2. *Ndërhyrja nuk plotëson kriterin e ligjshmërisë*, pasi ajo nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së, sipas të cilit duhet të provohet lidhja e sendit për të cilin kërkohet të vendoset masa e sigurimit pasuror me veprën penale prej së cilës besohet se ka rrjedhur ai. Për sa i përket pasurisë "apartament", ajo është fituar në vitin 2006 dhe është pjesëtuar në vitin 2022, ndaj nuk ka asnjë lidhje me faktet penale që i atribuohen kërkuesit, përveç pretendimit se një pjesë e papërfillshme e investimit të mëvonshëm të kryer në këtë apartament është paguar nga shoqëria "Integrated Technology Services" sh.p.k. (*shoqëria ITS*) me administrator shtetasin K.Z. Gjykatat nuk argumentojnë rrezikun e disponimit të lirë të sendit dhe se si mund të lehtësojnë tagrat e pronësisë mbi këtë send kryerjen

e veprave të tjera penale apo se si mund të rëndojnë apo të zgjasin pasojat e veprave penale për të cilat hetohet kërkuesi. Edhe për sa u përket llogarisë dhe depozitës bankare, në kuptim të nenit 274 të KPP-së nuk provohet asnjë lidhje e këtyre fondeve me veprat penale të atribuuara kërkuesit, ndërkohë që janë çelur në vitin 2011, para se të ndodhnin faktet për të cilat po heton Prokuroria e Posaçme. Ato janë financuar nga fonde të ligjshme dhe janë deklaruar rregullisht pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*ILDKPKI*). Po kështu, nuk ekziston asnjë rrezik i disponimit të lirë të tyre dhe ky sekuestrim e vendos kërkuesin në pamundësi të përmbushjes së disa detyrimeve jetike që burojnë nga vendimi gjyqësor i zgjidhjes së martesës.

11.1.3. *Nuk plotësohet kriteri i proporcionalitetit*, pasi kufizimi i së drejtës së pronësisë së kërkuesit është bërë përmes një mjeti të papërshtatshëm, siç është sekuestro preventive, që synon rekuizimin e pronës dhe është i papajtueshëm me qëllimin e ligjshëm që duhet të ndjekë juridiksioni gjyqësor. Shuma e pretenduar se është investuar në apartament nga shoqëria ITS është 2,007,373 lekë, e konsideruar në mënyrë të njëanshme si përfitim i paligjshëm, ndërkohë që referuar çmimeve të tregut vlera e apartamentit është shumëfish më e lartë, e provuar kjo me raportin e vlerësimit të përgatitur nga eksperti, i kryer për efekt të rivlerësimit të pronës dhe regjistrimit në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo pasuri është vendosur nën administrimin e AAPSK-së, duke ngarkuar një ent publik me administrimin e pasurisë së kërkuesit, ndërkohë që edhe nëse do të pranohej se mund të ekzistojë rreziku i tjetërsimit, ai mund të mënjanohej me regjistrimin e vendimit të gjykatës në regjistrin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*) me shënimin se është në sekuestro preventive. Kjo do të ishte një masë e mjaftueshme dhe e drejtpeshuar, duke pasur parasysh se sekuestrimi është shpërpjesëtimor në raport me vlerën reale të sendit në treg. Masa është represive dhe e panevojshme në një shoqëri demokratike për shkak se ekzekutimi i vendimit nga Policia Gjyqësore praktikisht e ka privuar kërkuesin nga gëzimi i

frutave të pasurisë, pasi apartamenti është përshtatur për biznes dhënieje me qira, sipas kontratave të paraqitura përpara Gjykatës.

11.2. *Të drejtën për proces të rregullt, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë jo vetëm është marrë me kërkesë të prokurorit, jashtë kontradiktoritetit të palës së prekur nga sekuestroja preventive, por vendimet janë tërësisht të paarsyetuara në drejtim të kritereve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Ato nuk kanë arsyetuar se përse duhej të cenohej e drejta e pronës së kërkuesit dhe nëse masa është e mbështetur në ligj dhe ndjek një qëllim të ligjshëm. Pretendimeve në ankim dhe në rekurs për mungesën e bazës ligjore për të vënë dorë mbi pasurinë e kërkuesit dhe për cenimin e parimit të proporcionalitetit gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë u janë përgjigjur në mënyrë stereotipe, pa dhënë përgjigje të argumentuar në drejtim të rrëzimit të tyre. Ato nuk kanë dhënë asnjë argument për të mbështetur rrezikun e disponimit të lirë të sendit, se si mund të lehtësojnë tagrat e pronësisë mbi këtë send kryerjen e veprave të tjera apo se si ato mund të rëndojnë ose zgjasin pasojat e veprave penale për të cilat hetohet kërkuesi.

12. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

12.1. Në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1/2022 është formësuar dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi, përgjatë kohës që ka ushtruar funksionin e deputetit dhe të ministrit, ka konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së, pasi ka marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi përfitime të parregullta, për vete ose persona të tjerë, nga shtetasit K.Z. e M.M. dhe shoqëria ITS, duke u mundësuar këtyre të fundit lidhjen e kontratave në kuadrin e procedurave koncesionare për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit, të qarkut të Fierit dhe për ndërtimin e landfill-it të Tiranës. Kërkuesi ka qenë në dijeni të problemeve të këtyre procedurave koncesionare, të cilat, në përfundim, kanë rezultuar me problematika të theksuara që kanë sjellë dëm në buxhetin e shtetit, ku për dy të parat (inceneratorët e Elbasanit dhe Fierit) ka edhe vendimmarrje të gjykatave për dërgimin e çështjes penale për gjykim. Kërkuesi ka konsumuar veprën penale të korrupsionit pasiv nga funksionari i lartë dhe ekziston dyshimi se

ka konsumuar edhe veprën penale të parashikuar nga nenet 257/a, paragrafi i dytë e 25 i KP-së, vetëm ose në bashkëpunim, në formën e deklarimit të rremë dhe fshehjes së pasurisë.

12.2. Për sa i përket investimit për ndërtimin e pallatit ku ndodhet apartamenti i sekuestruar, është hetuar për vlerën e investimit dhe burimin e tij, me qëllim identifikimin e vlerës së saktë, duke pasur parasysh moskoherencat në kohën e kryerjes së investimit dhe shumën e investuar. Në lidhje me këtë investim kërkuesi dhe ish-bashkëshortja kanë bërë deklarim të rremë në lidhje me burimin e parave të investuara ose edhe kohën e kryerjes së këtij investimi. Po kështu, në apartament është shpenzuar shuma 3,123,880.3 lekë për përshtatjen e tij si Airbnb, duke u shfrytëzuar në vijim për këtë qëllim dhe duke prodhuar frute, ku për një pjesë ekziston dyshimi se nuk justifikohet me burime të ligjshme dhe për një pjesë se është paguar si mitë nga shoqëria ITS. Në këto kushte është provuar lidhja e sendit me veprën penale prej së cilës ka ardhur.

12.3. Bazuar në nenin 274 të KPP-së sekuestroja përmbush kriterin e ligjshmërisë, pasi përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të mbështetur në prova për kryerjen e disa veprave penale, ekziston rreziku që disponimi i lirë i sendit mund të rëndojë dhe zgjasë pasojat e veprës ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, që janë gëzimi i produktit të veprës penale, përvetësimi i të ardhurave që derivojnë nga ky produkt dhe në vijim pastrimi i tij. Masa plotëson edhe kriterin e proporcionalitetit, pasi sendi i sekuestruar (apartament) nuk është vërtetuar se derivon nga burime të ligjshme dhe në lidhje me burimin e krijimit të tij janë plotësuar deklarata të rreme që janë dorëzuar në ILDKPKI. Hetimet nuk kanë përfunduar ndaj justifikohet masa e sekuestros për sa kohë që sekuestrimi, si fazë paraprake, mund të shtrihet në tërësinë e sendit, pavarësisht se deri në këtë moment është provuar se vetëm një pjesë e investimit është derivat i korrupsionit, por ndërkohë, edhe për pjesën tjetër, nuk është evidentuar se justifikohet me burime të ligjshme. Në lidhje me administrimin e apartamentit nga AAPSK-ja, zbatimi i sekuestros përcaktohet në ligjin nr. 34/2019, datë 17.06.2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", të ndryshuar (*ligji nr. 34/2019*) dhe nuk ka asnjë shkak se përse kjo pasuri duhet të lihet në disponim të personave

nën hetim/të pandehurve, duke pasur parasysh se vijimi i nxjerrjes së frutave nga kjo pasuri do të sillte vijimësinë e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

12.4. Për sa u përket llogarive bankare, kërkuesi është akuzuar se ka konsumuar veprën penale të korrupsionit pasiv në disa episode. Paratë produkt i korrupsionit, specifikisht nga shitjet fiktive, janë derdhur nëpër llogaritë bankare për të bërë të besueshme shitjet. Normalisht në llogaritë bankare nuk është e thënë të gjendet shuma e parave që është përfituar si mitë, por një ekuivalencë e tyre. Duke pasur parasysh edhe paratë e përftuara për udhëtimet dhe akomodimet në hotele gjatë udhëtimeve, kjo sekuestro është e drejtë dhe e ligjshme. Rreziku i zhdukjes së këtyre shumave nga llogaritë bankare është real, i dukshëm dhe i perceptueshëm lehtësisht. Në kërkesat e mëparshme për heqjen e sekuestros është pretenduar se kërkuesi kërkon të disponojë shumat me qëllim që të paguajë pensionin ushqimor për fëmijët, ndërkohë që ai, përmes prokurës së posaçme të datës 11.03.2023, i ka dhënë tagra shtetases E.H. edhe për të kryer veprime financiare, mes tyre transferime ose mbyllje llogarie, tërheqje etj.

12.5. Ndërhyrja në të drejtën e pronës private është bërë në përputhje me parimet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Masa është e përcaktuar nga ligji dhe ka një qëllim të ligjshëm, që është goditja e krimit. Ajo është në përputhje me parimin e ligjshmërisë, pasi është parashikuar nga KPP-ja si masë sigurimi dhe për vendosjen e saj janë shqyrtuar nga gjykatat kushtet dhe kriteret e kërkuara, siç është dyshimi që personi ka kryer veprat penale, roli i tij në kryerjen e tyre, si dhe që disponimi i sendit që lidhet me veprën penale ose me një pjesë ekuivalente të tij, rëndon ose zgjat pasojat, madje lehtëson kryerjen, vijimësinë e veprës penale. Po kështu, sendet janë nga ato të parashikuara në nenin 36 të KP-së. Në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes, veprat penale për të cilat dyshohet kërkuesi janë të rënda, si për atë çfarë i shkaktojnë shoqërisë dhe shtetit, produktet që prodhojnë, ashtu edhe lidhur me sanksionin e tyre. Qëllimi që kërkohet të ndiqet është i ligjshëm dhe proporcional, lufta ndaj korrupsionit dhe pastrimit të parave, si dhe ekziston një balancë e drejtë ndërmjet asaj që kërkohet të arrihet nga sekuestrimi dhe asaj që është cenuar. Për më tepër, që nga data e vendosjes së masës së

sekuestros hetimet kanë vijuar dhe kërkuesi bashkë me shtetasit e tjerë të përfshirë në këto veprime janë marrë në cilësinë e të pandehurit dhe u është njoftuar akuza penale.

12.6. Pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt janë të pabazuara. Në lidhje me pretendimin për mungesën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga mbrojtja e kërkuesit, duke analizuar të dhënat mbi produktet e veprës penale, veprën penale të atribuuar kërkuesit, kushtet e vendosjes së masës së sekuestros, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e saj. Për sa i përket kontradiktoritetit, sipas ligjit procedural penal edhe masa pasurore, si çdo masë sigurimi, nuk vendoset në prani të personit nën hetim, me qëllim që mos të merren masa për zhdukjen e pasurisë, por ai garanton të drejtën e kundërshtimit të saj në gjykatën e apelit, ku debati i nënshtrohet kontradiktoritetit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi jo vetëm që ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, por edhe ka provuar se pasojat e pretenduara në të drejtat e tij kushtetuese kanë ardhur nga vendimet gjyqësore objekt kërkese që kanë caktuar masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" mbi pasuritë e tij.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* Gjykata, edhe pse nuk e ka vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimeve për caktimin e masës së sekuestros së pasurisë, i ka përfshirë në juridiksionin e saj këto lloj vendimesh, të cilat, pavarësisht se kanë karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, janë të afta të ndërhyjnë në të drejtën kushtetuese të pronës private, ndërhyrje që vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Për sa kohë që pretendimet në ankimin kushtetues kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave substanciale kushtetuese, këto vendime konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po kështu, kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuesi i ka ngritur në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë konsiderohet i përmbushur edhe ky kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

17. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 07.12.2023, i cili, bazuar në informacionin e dërguar nga ajo gjykatë, si dhe shkresën e saj nr. 1362/1 prot., datë 13.03.2024, bashkëlidhur ankimit kushtetues, është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 19.02.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 18.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se edhe pse objekt i masës së sekuestros kanë qenë disa pasuri të paluajtshme, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore në atë masë dhe vetëm në atë pjesë që kanë vendosur sekuestrimin e pasurisë të paluajtshme apartament në rrugën "Reshit Çollaku", ashtu edhe në pjesën që kanë vendosur sekuestrimin e shumave të gjetura në llogarinë dhe depozitën e tij bankare. Sipas kërkuesit, masa e sekuestros ka cenuar të drejtën e pronës private, të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi

ndërhyrja nuk parashikohet me ligj, është arbitrare e nuk ndjek qëllim të ligjshëm, si dhe nuk plotëson as kriterin e proporcionalitetit në drejtim të përshtatshmërisë së saj. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregullt, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore si nga gjykata e shkallës së parë, që jo vetëm ka pranuar kërkesën e prokurorit jashtë kontradiktoritetit të palës së prekur nga sekuestro, por as nuk ka arsyetuar në drejtim të kritereve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, ashtu edhe nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, që pretendimeve të kërkuesit në këtë drejtim, të parashtruara në ankim dhe rekurs, u janë përgjigjur në mënyrë stereotipe, pa dhënë përgjigje të argumentuar për rrëzimin e tyre.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ndërsa Gjykata i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, bazuar edhe në thelbin dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata do të shqyrtojë në vijim: *(a) në aspektin procedural* pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*; *(b) në aspektin substancial* pretendimet për cenimin e *parimit të proporcionalitetit të masës së sekuestros pasurore.*

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës

B.1.1. Për cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural

20. Sipas kërkuesit, masa e sekuestros është vendosur mbi pasuri që janë provuar se janë të ligjshme dhe që janë vënë në kohën kur ai nuk kryente asnjë funksion shtetëror, pra shumë më herët se ndodhia e fakteve për të cilat akuzohet. Ai ka pretenduar se pasuria "apartament" është pjesë e sipërfaqes së banimit të përfituar nga investimi i financuar nga kursime të familjes dhe një kredi bankare, që i ka kaluar në pronësi pas zgjidhjes së martesës dhe pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, ndërkohë që llogaritë bankare janë çelur në vitin 2011 dhe janë financuar nga fonde të ligjshme

e janë deklaruar rregullisht në ILDKPKI. Sipas kërkuesit, në kuptim të nenit 274 të KPP-së, nuk provohet lidhja e sendeve me veprën penale të atribuuar atij, as rreziku i disponimit të lirë të tyre dhe as se si mund të lehtësojnë tagrat e pronësisë mbi to kryerjen e veprave të tjera penale apo se si mund të rëndojnë ose të zgjasin pasojat e veprave penale për të cilat po hetohet. Pasuria apartament është vendosur nën administrimin e AAPSK-së, ndërkohë që rreziku i pretenduar i tjetërsimit mund të mënjanohej me regjistrimin e vendimit të gjykatës në regjistrin e ASHK-së, çka do të ishte një masë e mjaftueshme dhe e drejtpeshuar. Sipas kërkuesit, vendimet e gjykatave janë të paarsyetuara në drejtim të kritereve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të masës, duke iu përgjigjur në mënyrë stereotipe pretendimeve të tij të parashtruara në ankim dhe rekurs, pa dhënë përgjigje të argumentuara për rrëzimin e tyre.

21. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1/2022 është formësuar dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi, përgjatë kohës që ka ushtruar funksionin e deputetit dhe të ministrit, ka konsumuar veprat penale për të cilat akuzohet. Për sa i përket investimit për ndërtimin e pallatit ku ndodhet apartamenti i sekuestruar, sipas subjektit të interesuar në lidhje me burimin e parave të investuara dhe kohën e kryerjes së investimit është bërë deklarim i rremë, kurse për sa u përket investimeve të kryera në apartament ekziston dyshimi se nuk justifikohen me burime të ligjshme dhe një pjesë është paguar si mitë. Subjekti i interesuar ka prapësuar se për vendosjen e masës së sekuestros janë shqyrtuar nga gjykatat kushtet dhe kriteret e kërkuara dhe masa është proporcionale, pasi veprat penale për të cilat dyshohet kërkuesi janë të rënda dhe ekziston një balancë e drejtë ndërmjet asaj që kërkohet të arrihet nga sekuestrimi dhe asaj që është cenuar. Administrimi i apartamentit nga AAPSK-ja bazohet në ligjin nr. 34/2019 dhe nuk ka asnjë shkak se përse pasuria duhet të lihet në disponim të personave nën hetim. Po sipas subjektit të interesuar, për sa u përket llogarisë dhe depozitës bankare paratë produkt i korrupsionit, specifikisht nga shitjet fiktive, janë derdhur në llogari bankare për të bërë të besueshme shitjet. Sipas këtij subjekti, nuk është e thënë të gjendet shuma e parave që është përfituar si mitë, por një ekuivalencë e tyre, duke pasur parasysh edhe paratë e përftuara për udhëtimet dhe akomodimet në hotele gjatë udhëtimeve jashtë vendit. Subjekti i interesuar ka prapësuar, gjithashtu, se gjykatat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke analizuar të dhënat për produktet e veprës penale, veprën penale të atribuuar, kushtet e vendosjes

së masës së sigurimit pasuror, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e saj.

22. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës, që garantohet nga neni 41 i Kushtetutës përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren, fillimisht, se masa e kundërshtuar e sekuestros preventive është marrë në kuadër të procedimit penal, mbi dyshimet se kërkuesi ka marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi përfitime të parregullta përgjatë kohës që ka ushtruar funksionin publik, për vete ose persona të tjerë, se ka bërë deklarim të rremë dhe ka fshehur pasurinë, si dhe se ka kryer veprime me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së pasurisë së paligjshme, të përfituar si pasojë e korrupsionit ose burime të tjera të paligjshme. Në rastin konkret, masa e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme të kërkuesit ka vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën për gëzimin dhe disponimin e këtyre pasurive, për rrjedhojë ka sjellë kufizim të së drejtës së tij kushtetuese të pronës private.

24. Gjykata ka theksuar se ndërhyrja që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës duhet: të jetë e ligjshme, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; të vendosë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës; të respektojë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. E drejta e pronës private, ashtu si edhe të drejtat dhe liritë e tjera, nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), i cili përfshin, mes të tjerash, edhe detyrimin për një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në lidhje me këtë standard kushtetues, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar

se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 29 datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë *(shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 20, datë 13.04.2012; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, edhe pse detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, ajo gjykatë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për rrjedhojë, edhe në çështjen konkrete Gjykata do t`i referohet arsyetimit të gjykatave të zakonshme, pra nëse ato, në vendimet për caktimin e masës së sekuestros, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë si për lidhjen e kësaj mase me objektivin e saj, që është parandalimi i pasojave të mëtejshme të veprës penale, ashtu edhe për respektimin e kritereve që lejojnë ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese

të pronës private. Kjo pasi, sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon atyre gjykatave që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit (*shih vendimet 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në sa më sipër, Gjykata nuk vë në dyshim se lufta kundër kriminalitetit është një çështje me interes publik, si një nga kriteret që justifikon ndërhyrjen në të drejtat themelore të individit, përfshirë atë të pronës private dhe se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale. Duke pasur në konsideratë prezumimin e ekzistencës së interesit publik për ndërhyrjen në të drejtat themelore, por edhe hapësirën e kontrollit kushtetues, si mjeti i fundit i brendshëm në dispozicion të individit, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, që shtrihet në verifikimin e respektimit të garancive procedurale të përshtatshme dhe efektive për mbrojtjen nga arbitrariteti në ushtrimin e pushtetit publik që çojnë në shkeljen e të drejtave substanciale, si dhe rolin e saj subsidiar, ajo ndalet në vlerësimin nëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë. Kjo sepse Gjykata vë në dyshim vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm vetëm atëherë kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen se janë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra kur gabimi ligjor ose faktik nga ato gjykata është aq i dukshëm sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për shkak se masa e sekuestros me karakter pasuror përbën një mjet kontrolli të pasurisë së individit nga shteti dhe në disa raste, për nga kohëzgjatja, mund të përbëjë edhe heqje të saj, si dhe duke pasur parasysh garancitë procedurale që duhet të sigurohen në këtë fazë të procedurave penale, arsyetimi i vendimeve gjyqësore i lejon palës së prekur jo vetëm që të njihet me shkaqet e kufizimit të së drejtës substanciale por edhe që ta kundërshtojë këtë masë efektivisht përpara gjykatave më të larta. Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret Gjykata do të vlerësojë nëse vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e prokurorisë për sekuestrimin e

pasurive të kërkuesit objekt ankimi përmbajnë bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të justifikuar këtë ndërhyrje në të drejtën e pronës.

30. Me qëllim që të arrijë në një përfundim të drejtë në këtë aspekt, Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht në natyrën dhe pasojat e sekuestros preventive, që rregullohet nga parashikimet e neneve 274-276 të KPP-së dhe që synon heqjen e sendit nga disponimi i lirë i subjektit që e zotëron atë, duke vendosur mbi të (sendin) një detyrim të caktuar.

31. Sipas nenit 274 të KPP-së sekuestro vendoset nga gjykata, me kërkesë të prokurorit, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ashtu edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP-së. Sekuestro preventive ka qëllim parandalues, pra synon të ndërpresë kryerjen e një vepre penale ose të parandalojë kryerjen e veprave penale të rejave. Nga ana tjetër, kjo masë synon të garantojë efektivitetin e një konfiskimi të mundshëm të mëvonshëm, duke bërë paraprakisht të padisponueshme, në një fazë që i paraprin dënimit, sendet që kanë shërbyer ose kanë qenë të destinuara për të kryer veprën penale, që janë produkti ose të ardhurat, apo sendet, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbën vepër penale (sekuestro e drejtpërdrejtë). Sekuestro preventive vendos një pengesë/kufizim mbi sendin me qëllim garantimin e arritjes së qëllimit të procedimit penal deri në marrjen e vendimit përfundimtar të fajësisë së autorit të veprës penale. Sekuestro preventive mund të urdhërohet jo vetëm mbi sendet që kanë një lidhje specifike me faktin penal që ndiqet penalisht, por edhe "për ekuivalencë", pra edhe mbi çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale (neni 36, pika 1, shkronja "ç", i KP-së). Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, sikundër praktikës gjyqësore, është e pranueshme që masa kufizuese e sekuestros të prekë edhe sende ose pasuri origjina e të cilave nuk vihet në diskutim në atë procedim penal, të cilat janë fituar apo kanë ekzistuar edhe përpara fakteve penale për të cilat ka filluar procedimi penal në kuadër të të cilit është vendosur masa e sekuestros, pra që nuk kanë një lidhje të posaçme me faktet objekt të veprës penale.

32. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se për të respektuar kriteret kushtetuese të kufizimit me ligj dhe standardet e gjykimit të drejtë, prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sekuestros dhe gjykatat e zakonshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e saj, duhet të specifikojnë dhe saktësojnë se në cilën prej kategorive sipas nenit 274 të KPP-së dhe nenit

36 të KP-së përfshihet secili prej sendeve që kërkohet të sekuestrohet, pra nëse bëhet fjalë për sende ose produkte të veprës penale (sekuestro e drejtpërdrejtë) apo për sekuestrim "për ekuivalencë" të sendeve të tjera që nuk hyjnë në kategorinë e atyre që lidhen drejtpërdrejt me veprën penale. Në rastin kur, për shkak se është e pamundur të rekuperohen sendet e vendosura në mënyrë të paligjshme, kërkohet aplikimi i shkronjës "ç të pikës 1 të nenit 36 të KP-së, është e nevojshme të saktësohet individualisht çdo send/pasuri që sekuestrohet për shkak të ekuivalencës së vlerës së tij me atë të produkteve të veprës penale. Për këtë qëllim nevojiten të kryhen disa veprime që kanë të bëjnë si me vlerësimin se sendi/produkti i veprës penale është i pamundur të gjendet apo rikuperohet, ashtu edhe me vlerësimin e secilit send që kërkohet të sekuestrohet "për ekuivalencë" për të konkluduar masën në të cilën është e nevojshme të shtrihet sekuestro.

33. Për rrjedhojë, sekuestro "për ekuivalencë", në ndryshim nga sekuestro e drejtpërdrejtë e sendeve/produkteve të veprës penale, duke mos qenë e identifikueshme për shkak të lidhjes me vetë veprën, kërkon zbatimin e disa filtrave që kanë të bëjnë me: i) zbatimin e saj vetëm kur është e pamundur të identifikohen ose gjenden sendet që lidhen me veprën penale; ii) ajo duhet të shtrihet, për aq sa është e mundur, në pasuri të të njëjtit lloj dhe; iii) duhet të synojë të jetë sa më pak e dëmshme në kuptim të qëllimit që synon të arrijë. Kjo e fundit kërkon nga gjykatat që të saktësojnë se mbi cilat tagra mund të shtrihet kufizimi dhe nëse sekuestrimi i plotë i sendit, pra kufizimi i së drejtës së pronës në të gjitha tagrat e saj, përputhet me qëllimin e kësaj mase dhe nëse, në kuptim të kriterit të proporcionalitetit, në drejtim të përshtatshmërisë së masës, qëllimi që synohet të arrihet nuk do të ishte i mundur të përmbushej edhe përmes kufizimit vetëm të një ose më pak tagrave të së drejtës së pronës. Në ato raste kur është e zbatueshme sekuestro "për ekuivalencë" gjyqtari duhet të arsyetojë në mënyrë të përshtatshme pamundësinë e arritjes së të njëjtit rezultat me një ndërhyrje më pak kufizuese, si për sa i përket shtrirjes së saj në sendet dhe pasuritë që do të preken, ashtu edhe në tagrat e vetë së drejtës substanciale të pronës private.

34. Në përputhje jo vetëm me parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, por edhe të prezumimit të pafajësisë, çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim gjatë procedurave penale, pra përpara dhënies së një vendimi përfundimtar të fajësisë, duhet të arsyetohet në drejtim të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestro, si çdo masë tjetër që kufizon ushtrimin e lirë të të drejtave të garantuara

kushtetutshmërisht, duhet të urdhërohet vetëm si mjeti i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë. Kjo nënkupton se prokurori në kërkesën për caktimin e masës dhe më pas gjykata gjatë shqyrtimit të saj duhet të verifikojnë dhe arsyetojnë se sekuestro që shtrihet mbi sende të tjera që nuk kanë lidhje me veprën penale dhe vetë vlera e sendeve të sekuestruara "për ekuivalencë" është proporcionale me "çmimin" ose "fitimin" e veprimtarisë së paligjshme, me qëllim shmangien e një kufizimi arbitrar të së drejtës së pronës private. Edhe pse këto masa kufizuese gjejnë mbështetje kushtetuese (nenet 41 dhe 17 të Kushtetutës), pasi synojnë realizimin e një interesi publik, në mënyrë që dëmi në të drejtat individuale të jetë në përputhje me garancitë kushtetuese, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kufizimi nuk mund të shkojë përtej asaj që synohet dhe që është e nevojshme për realizimin e qëllimit të parashikuar nga dispozitat penale dhe duhet t`i përgjigjet masës së proporcionalitetit në kuptim të *quantum* të pasurisë/të ardhurave që burojnë nga veprimtaria e paligjshme. Çdo tejkalim, në mungesë të analizës së këtyre elementeve, do të përbënte cenim të vetë thelbit të së drejtës së pronës private, duke e bërë ndërhyrjen arbitrare.

35. Si parim, masa e sekuestros preventive synon të prekë sendin që dyshohet se është fituar në mënyrë të paligjshme dhe vetëm nëse është e pamundur të gjendet ose të rekuperohet ai, atëherë synohet që të rekuperohen pasuri të tjera, vlera e të cilave u korrespondon atyre të produkteve të veprës penale. Kjo nënkupton se zbatimi i sekuestros së drejtpërdrejtë mbi vetë produktet e veprës penale apo të ardhurat e saj nuk lejon edhe zbatimin në të njëjtën kohë dhe paralelisht, pra për të njëjtin qëllim, edhe të sekuestros "për ekuivalencë" të pasurive të tjera të individit subjekt i procedimit penal.

36. Thënë sa më sipër, duke pasur parasysh qëllimin e sekuestros "për ekuivalencë" (*shih paragrafin 31 të vendimit)* si një masë që i paraprin konfiskimit të pasurisë, ajo duhet të synojë atë lloj sendi/aseti që është në gjendje të realizojë më lehtë ekuivalencën në vlerë me produktet e veprës penale. Nga ana tjetër, për sa kohë që masa shtrihet mbi sende të tjera, të ndryshme nga sendi ose produktet e veprës penale, pra sende për të cilat, siç u theksua më sipër, nuk verifikohet dhe as nuk certifikohet në atë procedim penal ligjshmëria e burimit të tyre, duhet të synohet të preken sa më pak tagra të sendit, në mënyrë që kjo masë, nga njëra anë, të jetë sa më pak e dëmshme për individin dhe, nga ana tjetër, të sigurojë qëllimin

e saj, që është ai për të shmangur tjetërsimin/humbjen e sendeve në pritje të përfundimit të procesit penal. Për këtë qëllim prokuroria duhet të argumentojë përpara gjykatës në mënyrë të qartë se çfarë ka rezultuar nga hetimi, mënyrën se si po veprohet dhe vlerësimin e kryer për të konkluduar si mbi vlerën e produkteve/sendeve/të ardhurave të dyshuara të veprës penale ashtu edhe vlerën e tyre korresponduese me atë të sendit për të cilin kërkohet nga gjykata caktimi i masës kufizuese, sikundër tagrat që synohen të preken/kufizohen në kuptim të proporcionalitetit të ndërhyrjes.-

37. Sekuestro "për ekuivalencë", që ka natyrë paraprake dhe përbën një kufizim të përkohshëm të pasurisë, ndryshon nga konfiskimi i sendeve, që konsiston në zhveshjen e personit nga pronësia dhe zbatohet për shkak të një vendimi penal dënimi. Megjithatë, pa u ndalur në diferencën mes këtyre dy mjeteve dhe pavarësisht se sekuestro preventive synon të garantojë efektivitetin e një konfiskimi të mundshëm në përfundim të procesit penal, Gjykata vlerëson se gjykatat e zakonshme duhet të tregojnë kujdes në zbatimin e nenit 274 të KPP-së të lidhur me nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së, duke bërë, për aq sa është e mundur, vlerësimin e mënyrës së zbatimit të këtyre dispozitave në drejtim të ekuivalencës me produktet e dyshuara të veprës penale.

38. Thënë sa më sipër, Gjykata do të ndalet, në vijim, në mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë zbatuar kriteret e mësipërme dhe se si kanë argumentuar në rastin konkret në drejtim të kufizimit të së drejtës së pronës private të kërkuesit.

39. Gjykata vëren se kërkuesi dyshohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 257/a, paragrafi i dytë e 25, 260 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së. Në kuadër të procedimit penal është formësuar dyshimi i arsyeshëm se gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e deputetit dhe ministrit, ai ka konsumuar veprën penale "Korrupsioni pasiv i funksionarit të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë", të parashikuar nga neni 260 i KP-së, pasi ka marrë drejtpërdrejt ose tërthorazi, për vete ose persona të tjerë: shumën 170,480 euro në vitet 2016 dhe 2017, shumën 130,000 euro në vitet 2017 dhe 2018 dhe shumën 140,000 euro në vitin 2018, pagesa të bëra kërkuesit dhe ish-bashkëshortes për disa shitje të dyshuara si fiktive, të disa apartamenteve dhe garazheve në pallatin e ndodhur në Selitë, për ndërtimin e të cilit kanë investuar edhe këta të fundit, duke u mbuluar natyra e vërtetë e burimit, vlera këto të paguara në mënyrë të tërthortë nga shtetasit K.Z. e M.M. dhe shoqëria ITS nëpërmjet shtetasve të tjerë; pasurinë truall+ndërtesë të ndodhur në Hamallaj, në vitin 2017, që

ka kaluar në pronësi të bashkëjetueses së kërkuesit dhe është përfituar në mënyrë të tërthortë nga shtetasit K.Z. e M.M.; shumën rreth 34,422 euro, në formën e shpenzimeve për pagesa hotelesh ose udhëtimesh jashtë vendit për kërkuesin dhe të afërm të tij përgjatë periudhës 2013-2017, të paguara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shtetasit K.Z. e M.M.; shumën 2,007,373 lekë në vitet 2019 dhe 2020, në funksion të një investimi në pasurinë apartament në rrugën "Reshit Çollaku", në pronësi të kërkuesit, me qëllim kthimin e tij në ambient *Airbnb*. Këto janë konsideruar sipas prokurorisë si përfitime të parregullta, të dhëna kërkuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllim kryerjen ose moskryerjen e veprimeve që lidhen me detyrën (*shih pikat 7 dhe 7.1. të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

40. Në lidhje me veprën penale "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë e 25 i KP-së, ka lindur dyshimi për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë të: shumës së investuar dhe burimit të saj për ndërtimin e pallatit ku ndodhet pasuria e sekuestruar, pasi nga hetimet ka rezultuar se kredia e referuar si burim i investimit ka pasur qëllim blerjen e një pasurie tjetër; shumës 3,123,880.3 lekë të paguar gjatë viteve 2019 dhe 2020 në investimin e bërë për punimet në ambientin e brendshëm *Airbnb*; shumës 2,007,373 lekë të paguar gjatë viteve 2019 dhe 2020 nga shoqëria ITS në investimin e bërë në ambientin e brendshëm *Airbnb*; shumave 170,480 euro, 130,000 euro dhe 140,000 euro në vitet 2016-2018, duke u mbuluar natyra e vërtetë dhe duke u paraqitur si pagesa të bëra përkundrejt shitjes së disa apartamenteve dhe garazheve në pallatin e ndodhur në Selitë; pasurisë truall+ndërtesë në Hamallaj; shumës minimalisht 137,000 euro të shpenzuar për investim në vilën në Hamallaj; pasurisë së porositur në vitin 2019 në Palasë, e cila, me qëllim fshehjen e pronarit të vërtetë, i ka kaluar një mikeshe të ish-bashkëshortes së kërkuesit, pasuri që nuk është deklaruar ndonjëherë në deklaratat e pasurisë dhe ekziston dyshimi se është përfituar me të ardhura që nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme. Duke pasur parasysh veprimet e kryera me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së pasurisë së paligjshme të përfituar si pasojë e korrupsionit ose burime të tjera të paligjshme, sipas prokurorisë ekziston dyshimi se është konsumuar edhe vepra penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, më shumë se një herë, e parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së (*shih pikat 10 dhe 10.1 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

41. Mbi dyshimet si më sipër, Prokuroria e Posaçme, ka kërkuar sekuestrimin e disa pasurive të paluajtshme në pronësi të kërkuesit, sikundër të shumave të ndodhura në llogarinë dhe depozitën e tij bankare në bankën "Intesa Sanpaolo Bank".

42. Në lidhje me apartamentet e sekuestruara në pallatin e ndodhur në Selitë, sipas prokurorisë apartamentet me sipërfaqe 124.15 m^2 dhe 148.8 m^2, konsiderohet se janë ekuivalente të shumës 170,480 euro, produkt i veprës penale, të dyshuar të marrë si mitë nga kërkuesi. Kurse apartamenti me sipërfaqe 178.68 m^2 dhe garazhi me sipërfaqe 21 m^2, janë pjesërisht ekuivalente të shumës 270,000 euro, që dyshohet se është marrë si mitë nga kërkuesi dhe është produkt i veprës penale (*shih pikat 24-26 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Prokuroria ka referuar në lidhje me këto pasuri edhe veprimet juridike të kryera mes palëve, si dhe veprimet bankare, të cilat rezulton të jenë bërë përmes pagesave nga persona të tretë dhe kreditimeve në llogarinë bankare në bankën "Intesa Sanpaolo Bank", llogari e përbashkët e kërkuesit dhe ish-bashkëshortes së tij.

43. Në lidhje me pasurinë apartament në rrugën "Reshit Çollaku", objekt ankimi, sipas Prokurorisë së Posaçme ekziston dyshimi se: investimi në të cilin ka marrë pjesë fillimisht kërkuesi dhe më pas ish-bashkëshortja e tij nuk justifikohet me para të ardhura nga burime të ligjshme, duke iu referuar këtu kredisë së marrë në datën 08.08.2006, për të cilën dyshohet se ka pasur destinacione të tjera; në këtë apartament janë kryer investime në shumën 3,123,880.3 lekë, për shndërrimin në *Airbnb*, nga të cilat shuma 2,007,373 lekë është paguar nga shoqëria ITS si mitë, ndërsa pjesa tjetër dyshohet se nuk mund të mbulohet me të ardhura të ligjshme, duke pasur parasysh edhe fshehjen e këtyre shpenzimeve në deklaratat e pasurisë të dorëzuara; në vilën në Palasë janë kryer investime të padeklaruara që dyshohen në vlerën 5,527,121.29 lekë. Duke konsideruar si produkt të veprës penale shumat e investimit në vlerën 2,007,373 lekë të paguar nga shoqëria ITS dhe 6,643,628.59 lekë që nuk justifikohet me burime të ligjshme, si dhe një pjesë e shumës 270,000 euro të derivuar nga shitjet fiktive, është kërkuar sekuestrimi i apartamentit si ekuivalent pjesërisht i tërësisë së këtyre përfitimeve të paligjshme (*shih pikën 27 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

44. Për sa i përket llogarisë bankare në bankën "Intesa Sanpaolo Bank", në emër të kërkuesit, me balancë 8,620.68 euro, ajo është konsideruar si ekuivalentja pjesërisht e shumës 34,442 euro që i është paguar kërkuesit dhe të afërmve të tij për shpenzime udhëtimi ose akomodimi jashtë vendit,

duke përbërë produkt të veprës penale. Për depozitën bankare në bankën "Intesa Sanpaolo Bank", me balancë 115,692 euro, është konsideruar si ekuivalentja pjesërisht e vlerës minimalisht 137,000 euro, investimi në vilën në Hamallaj që nuk është deklaruar në ILDKPKI dhe dyshohet se nuk mund të justifikohet me burime të ligjshme dhe janë përfitime të marra nga të tretë, si dhe vlerës 34,422 euro për shpenzime të udhëtimeve, të cilat janë produkte të veprës penale (*shih pikat 28 dhe 29 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

45. GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka gjetur të bazuar në ligj dhe në prova kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke vlerësuar se: nga provat e administruara çmohen të drejta arsyet për vendosjen e sekuestros preventive; pasuritë objekt kërkese plotësojnë kushtet për t`u kualifikuar si çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale, në respektim të nenit 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së e që i nënshtrohet sekuestros preventive, në respektim të nenit 274, pika 2, të KPP-së; ekziston dyshimi se për këto pasuri mund të merren masa për tjetërsimin e tyre, ndaj duhet të vendoset masa e sekuestros me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm, si dhe tërheqja e të hollave nga llogaritë bankare nga kërkuesi apo persona të pajisur me prokurë prej tij (*shih pikën 35 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

46. GJKKO-ja e Apelit, mbi ankimin e kërkuesit, ka vlerësuar se edhe pse masa e sekuestros ka sjellë kufizim të së drejtës së pronës dhe të të drejtave reale që burojnë prej saj, ky kufizim është në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, pasi është parashikuar në ligj, është i nevojshëm dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar. Gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar pretendimin në lidhje me sekuestrimin e pasurisë apartament në rrugën "Reshit Çollaku", duke arsyetuar se: i) pretendimi se pasuria është krijuar para ushtrimit të veprimtarisë kriminale (në vitin 2006) nuk përbën shkak të ligjshëm për përjashtimin nga sekuestro, për sa kohë që ajo është vendosur bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së me argumentin se mund të sekuestrohet çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale; ii) në këtë pasuri janë kryer investime me qëllim shndërrimin e saj në *Airbnb*, të paguara përgjatë viteve 2019-2020, në një kohë të mëvonshme të përfshirjes së dyshuar të kërkuesit në veprimtarinë kriminale të korrupsionit pasiv dhe vlera e tyre nuk është deklaruar në ILDKPKI. Shuma e shpenzuar për investime është 3,123,880.3 lekë, nga të cilat 2,007,373 lekë është evidentuar si e paguar nga shoqëria ITS si mitë, kurse pjesa tjetër dyshohet se nuk mund të mbulohet me të

ardhura të ligjshme; iii) në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, që është kredia bankare për përfshirjen në investimin për ndërtimin e pallatit ku ndodhet apartamenti, dyshohet se nuk është përdorur për këtë investim, por ka pasur destinacione të tjera; iv) në pasurinë e fshehur, vila në Palasë, janë kryer investime të padeklaruara, që dyshohen në vlerën 5,527,121.29 lekë. Sipas gjykatës së apelit, investimet si më sipër të kryera në pasuritë e paluajtshme janë në vlerën 8,651,001.59 lekë, ndërkohë që për pasuritë e llojit apartament dhe garazh në pallatin e ndodhur në Selitë, kërkuesi dhe ish-bashkëshortja A.M. kanë investuar jo më shumë se 121,000 euro. Sipas GJKKO-së së Apelit, produkt i veprës penale dyshohet se është shuma 2,007,373 lekë e paguar nga shoqëria ITS, duke u dyshuar si produkt edhe pjesa tjetër e investimit që nuk justifikohet me burime të ligjshme në vlerën 6,643,628.59 lekë, si dhe një pjesë e shumës 270,000 euro e përftuar nga "shitjet" fiktive të apartamenteve në pallatin e ndodhur në Selitë dhe se apartamenti i sekuestruar është ekuivalent pjesërisht i tërësisë së këtyre përfitimeve të paligjshme. Përveç sa më sipër, sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi se kërkuesi ka konsumuar edhe veprën penale të parashikuar nga nenet 257/a, paragrafi i dytë e 25 të KP-së, në formën e deklarimit të rremë të shumës së investuar dhe burimit për ndërtimin e pallatit ku ndodhet apartamenti i sekuestruar, dhe fshehjes së shumave të investimit në atë apartament. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, krijohet dyshimi se kërkuesi ka konsumuar edhe veprën penale të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, ndaj sekuestrimi i apartamentit është i nevojshëm, pasi ekziston rreziku real që disponimi i lirë i tij mund të zgjasë pasojat e kësaj vepre penale, pastrim që krijon "lehtësi" për kryerjen e veprave të tjera penale (*shih faqet 60-66 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

47. Mbi të njëjtin arsyetim gjykata e apelit ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për sekuestrimin e shumave në llogarinë dhe depozitën në bankën "Intesa Sanpaolo Bank", edhe pse pretendohet se ato janë krijuar me të ardhura të ligjshme. Sipas saj, nga hetimi ka rezultuar se produkt i veprës penale është shuma 34,422 euro, e paguar kërkuesit dhe të afërmve të tij si përfitim i paligjshëm, për shpenzime udhëtimi ose akomodimi jashtë vendit, ekuivalentja e së cilës gjendet pjesërisht në shumën e ndodhur në llogarinë bankare. Nga ana tjetër, dyshohet se shuma 137,000 euro për investime në vilën në Hamallaj, e padeklaruar në ILDKPKI, nuk justifikohet me burime të ligjshme dhe është përfitim i marrë nga të tretë, ekuivalenti i së cilës gjendet në shumën e ndodhur në depozitën bankare. Gjykata e apelit ka arsyetuar se ndërmjet pasurive të kërkuesit, ku bëjnë

pjesë edhe ato objekt ankimi, dhe veprave penale që po hetohen ekziston një lidhje e qëndrueshme dhe se këto pasuri dyshohet se përbëjnë produkt të veprës penale të sekuestrueshme sipas nenit 36 të KP-së (*shih faqen 66 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

48. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në konsideratë të fazës në të cilën ndodhet çështja, për sa kohë që për pasuritë objekt sekuestro ka dyshime se përbëjnë produkt të veprave penale për të cilat po hetohet kërkuesi, gjykatat e posaçme kanë vlerësuar se ato duhet të qëndrojnë të sekuestruara, pasi ekziston dyshimi se mund të tjetërsohen, ndaj caktimi i masës pasurore parandaluese është i nevojshëm me qëllim që të pengohet çdo transferim ose tjetërsim i mundshëm i këtyre pasurive. Në drejtim të së drejtës së pronës private dhe asaj për jetë private, Kolegji Penal ka vlerësuar se ndërhyrja (marrja e masës pasurore parandaluese) ka qenë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë dhe në proporcion të drejtë me qëllimin për të cilën ajo është marrë (*shih paragrafët 42-47 të vendimit të Kolegjit Penal*).

49. Gjykata konstaton se si apartamenti i sekuestruar objekt ankimi, ashtu edhe llogaria dhe depozita bankare janë pasuri të krijuara përpara ndodhjes së fakteve penale për të cilat ka filluar procedimi penal ndaj kërkuesit, pra përpara fillimit të detyrës publike në ushtrim të së cilës ai dyshohet se ka përfituar të ardhura dhe pasuri të paligjshme. Sipas gjykatave, këto pasuri janë sekuestruar në bazë të shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 36 të KP-së, për shkak se vlera e tyre është ekuivalente, pjesërisht ose tërësisht, e produkteve të veprave penale, duke prezumuar kështu ato (gjykatat), si faktin e ekzistencës së këtyre pasurive përpara regjistrimit të procedimit penal ashtu edhe mungesën e dyshimeve në drejtim të ligjshmërisë së krijimit ose të fitimit të tyre. Pavarësisht kësaj, referuar vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se kërkuesi, përveç kryerjes së veprës penale të korrupsionit pasiv, është dyshuar se ka kryer edhe veprat penale të fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurisë dhe pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë "apartament" të sekuestruar dhe burimit të shumave të investuara në të për shndërrimin në ambient *Airbnb*, sikundër burimit të pasurive të gjetura në llogarinë dhe depozitën bankare. Në këtë kuptim rezulton se në vendimet gjyqësore ka kontradikta mes fakteve penale dhe gjetjeve të Prokurorisë së Posaçme dhe konkluzioneve për mënyrën e zbatimit të nenit 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së, që është baza ligjore e përdorur për sekuestrimin e të tria pasurive objekt ankimi.

50. *Kontradikta e parë* ekziston në faktin se gjykatat e zakonshme kanë vënë në dyshim vetë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë "apartament" në rrugën "Reshit Çollaku", Tiranë, për shkak se kredia e marrë për përfshirjen në ndërtimin e pallatit ku ndodhet kjo pasuri dyshohet se ka pasur destinacion tjetër dhe se deklarimet ndër vite në deklaratat e pasurisë nuk janë të sakta, duke konkluduar se kërkuesi dhe ish-bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime të mjaftueshme, sikundër vlerën e investimit në të për shkak të mosdeklarimit të shumës së investuar prej tyre. Po kështu, dyshohet se shumat e sekuestruara, të gjetura në llogarinë dhe depozitën bankare të kërkuesit, duke pasur parasysh edhe se veprimet në lidhje me shitjet fiktive të pasurive të paluajtshme në pallatin që ndodhet në Selitë janë bërë përmes një llogarie tjetër të përbashkët të kërkuesit dhe ish-bashkëshortes në të njëjtën bankë, janë pasuri e vënë nga fitimet e paligjshme të përfituara nga persona të tretë, si produkt i veprës penale. Për rrjedhojë, këto dyshime të gjykatave për ligjshmërinë e këtyre pasurive, duke i konsideruar si produkte të veprës penale, pasi rrjedhin drejtpërdrejt nga këto të fundit, sjellin automatikisht zbatimin e shkronjës "b të pikës 1 të nenit 36 të KP-së, sa kohë që sekuestro "për ekuivalencë", ndonëse nuk certifikon as ligjshmërinë, as paligjshmërinë e sendeve të sekuestruara, është e zbatueshme për ato sende që nuk janë produkt i veprës penale ose që nuk janë objekt hetimi.

51. *Kontradikta e dytë* ka të bëjë me faktin se për të njëjtin *quantum* të dyshuar të përftuar përmes veprimeve të paligjshme që janë objekt i këtij procedimi penal, qartazi gjykatat kanë vendosur masën e sekuestros "për ekuivalencë" si mbi sendin e paluajtshëm "apartament", ashtu edhe mbi shumat e gjetura në llogaritë bankare të kërkuesit, por pa analizuar dhe verifikuar se sa dhe në çfarë mase vlera e sendeve të sekuestruara u korrespondon atyre të veprave penale në kuptim të përmbajtjes së nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së.

52. Gjykata vëren se as organi i akuzës në kërkesën për caktimin e masës së sekuestros, as gjykatat e zakonshme gjatë shqyrtimit të saj nuk kanë verifikuar mënyrën dhe masën në të cilën vlera e pasurisë apartament në rrugën "Reshit Çollaku", Tiranë, i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Ndërsa rezulton se për pasuritë e paluajtshme të ndodhura në Selitë, nga të cilat ka pasur dyshime se kërkuesi ka përfituar të ardhura si mitë, është vendosur sekuestrimi i tyre, sikundër është vendosur edhe sekuestrimi i pasurive të paluajtshme (vila) të ndodhura në Hamallaj dhe Palasë, një pjesë e shpenzimeve dhe fitimeve që lidhen me këto pasuri janë

përllogaritur edhe si vlera, ekuivalentja e të cilave gjendet në pasuritë e sekuestruara për ekuivalencë. Edhe pse Prokuroria e Posaçme ka përcaktuar në kërkesën për vendosjen e sekuestros shumat e dyshuara të përfituara në mënyrë të paligjshme, në lidhje me të cilat është kërkuar sekuestrimi i një pasurie të paluajtshme (apartament) ajo nuk ka bërë dhe nuk ka paraqitur asnjë vlerësim për raportin mes vlerës së atij sendi me atë të produkteve të veprave penale dhe një gjë e tillë nuk është kërkuar as nga gjykatat e zakonshme.

53. Jo vetëm kaq, por gjykatat e zakonshme, edhe pse e kanë konsideruar ndërhyrjen si në përputhje me kriteret e kufizimit, nuk kanë arsyetuar se përse një kufizim i tillë i tagrave të pronësisë të kërkuesit ishte mjeti i vetëm për të siguruar qëllimin e synuar dhe se nuk kishte asnjë mjet tjetër, në kuptim të parimit të proporcionalitetit, që të arrinte një rezultat më pak të dëmshëm në të drejtën kushtetuese të pronës private. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se mënyra se si gjykatat kanë vlerësuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sekuestros dhe mënyra se si kanë zbatuar parashikimet e shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 36 të KP-së ka sjellë një rezultat arbitrar në të drejtën kushtetuese të pronës private të kërkuesit, duke i bërë këto vendime të papajtueshme me Kushtetutën.

54. Po kështu, duke pasur parasysh se gjykatat e faktit janë në pozicion më të përshtatshëm për të vlerësuar në themel këtë çështje, si për sa u përket kompetencave të tyre, ashtu edhe volumit të fakteve dhe provave, si dhe juridiksionin e kufizuar të Gjykatës në drejtim të mënyrës së vlerësimit të provave të administruara gjatë gjykimit të zakonshëm, ato gjykata duhet që të analizojnë, në këndvështrim të sa më sipër, pretendimet e kërkuesit në drejtim të cenimit të së drejtës substanciale të pronës private për shkak të zbatimit të masës së sekuestros preventive.

55. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar. Për rrjedhojë, për sa kohë që gjeti shkelje në të drejtën e pronës private në aspektin procedural të saj, Gjykata vlerëson të mos ndalet më tej në vlerësimin e aspektit substancial të saj.

56. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronës private janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 37 (87-2023-172), datë 10.08.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nr. 00-2023-2048, datë 07.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, në pjesën që lidhet me sekuestrimin e pasurive:

- Apartament me nr. xxx, rruga "Reshit Çollaku", Tiranë.
- Llogari bankare nr. xxx, pranë Intesa SanPaolo Bank.
- Depozitë nr. xxx, pranë Intesa SanPaolo Bank.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Anonimizimin e të dhënave personale në tekstin e vendimit që publikohet.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.04.2025
Shpallur më 28.05.2025

Vendim nr. 21, datë 22.04.2025
(V-21/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi dhe Enina Kotoni, në datat 12.12.2024, 03.02.2025, 05.03.2025, 19.03.2025, 02.04.2025 dhe 10.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr. 11 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ELTON QYNO**, përfaqësuar nga avokat Dorian Matlija, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Bledar Maksuti dhe Ols Dado.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 501, datë 13.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për paraqitjen e të dhënave elektronike të kërkuesit, si dhe çdo akti procedural të prodhuar si pasojë e zbatimit të këtij vendimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Shfuqizimi i vendimit nr. 04 (87-2024-9), datë 06.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-255 (36), datë 20.02.2024 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me marrëveshjet

ndërkombëtare i vendimeve nr. 500 dhe 502, datë 13.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kontrollin e banesës, paraqitjen e të dhënave elektronike dhe kontrollin personal të kërkuesit, si dhe çdo akti procedural të prodhuar si pasojë e zbatimit të këtyre vendimeve; i vendimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, zbatuar sipas procesverbalit "Për sekuestrimin e sendeve", datë 14.12.2023, ora 00:05.

Shkatërrimi i të gjitha kopjeve të imazheve të hard disqeve të kompjuterëve dhe USB, si dhe ekstrakteve të memorieve të telefonave celularë dhe kartave SIM të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara, si dhe rezultatet e fiksuara prej tyre.

Marrja e masave deri në shkatërrimin e plotë të të gjitha kopjeve të imazheve të hard disqeve të kompjuterëve dhe USB, si dhe ekstrakteve të memorieve të telefonave celularë dhe kartave SIM të nxjerra nga pajisjet e sekuestruara, si dhe ndalimi i çdo aksesimi eventual, kryerja e çdo procedure filtrimi dhe/ose përzgjedhjeje e të dhënave, si dhe nxjerrja e kopjeve të tjera.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 22, 36, 37, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 8, 10 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 17 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (*PNDCP*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Elton Qyno *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme, në kuadër të procedimit penal nr. 75 të vitit 2022 (*procedimi penal nr. 75/2022*), ka hetuar kryerjen e 27 veprave penale të rënda kundër jetës dhe pronës nga një grup i strukturuar kriminal i përbërë nga 34 persona, prej të cilëve 21 janë proceduar nën masën e sigurimit "Arresti në burg". Procedimi penal aktualisht është në fazën e gjykimit në shkallë të parë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*).

2. Byroja Kombëtare e Hetimit *(BKH)* ka referuar pranë Prokurorisë së Posaçme se të dhënat sekrete hetimore të procedimit penal të mësipërm ishin zbuluar në kundërshtim me ligjin dhe një pjesë e tyre ishte publikuar edhe në media. Mbi bazën e materialit të referuar, në datën 12.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 245 të vitit 2023 për veprat penale "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete" dhe "Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin", të parashikuara përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi i tretë dhe 313/b, paragrafi i parë, të Kodit Penal (*KP*). Me vendimin e së njëjtës datë të dyja procedimet penale janë bashkuar në një të vetëm me nr. 75/2022.

3. Kërkuesi është gazetar në një medie audiovizive. Në datat 10.12.2023 dhe 11.12.2023 në faqen e internetit të medias audiovizive janë publikuar disa artikuj, që sipas referencave janë shkruar nga kërkuesi. Artikujt përmbajnë pjesë të komunikimeve që një bashkëpunëtor i drejtësisë (aktualisht i pandehur) ka bërë me disa persona (të paidentifikuar ende nga hetimet) në platformën e enkriptuar Sky ECC. Bisedat e bëra publike në media janë pjesë e akteve sekrete të hetimit paraprak, por të padokumentuara ende në akte procedurale nga ana e Prokurorisë së Posaçme.

4. Të nesërmen e regjistrimit të procedimit penal nr. 245/2023,

konkretisht në datën 13.12.2023 kërkuesi është thirrur në Prokurorinë e Posaçme për t'u pyetur se si ishte vënë në dijeni të materialeve që përbënin sekret hetimor. Prokuroria e ka pyetur kërkuesin bazuar në nenet 159, 297 dhe 312 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) për identifikimin e burimit të informacionit. Fillimisht kërkuesi është paralajmëruar për të mos publikuar në vazhdim materiale të tjera që i përkisnin hetimit dhe më pas është pyetur për të treguar përmbajtjen e dokumentit të gjetur dhe burimin që ia ka siguruar këtë informacion. Kërkuesi ka refuzuar zbulimin e burimit të informacionit, me argumentin se ai është sekret profesional i gazetarit.

5. Në këto kushte, bazuar në nenet 202, 202/a, 203, 205, pika 4, 206, 207 dhe 208 të KPP-së, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur përpara GJKKO-së së Shkallës së Parë tri kërkesa dhe konkretisht: (i) për lejimin e kontrolleve në banesën e kërkuesit dhe vendin e punës ku ushtron detyrën e gazetarit, me qëllim për të kërkuar, gjetur, marrë e sekuestruar sende dhe prova materiale që lidhen me veprën penale (*kërkesa e parë*); (ii) për lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në banesë dhe vendin e punës, duke kërkuar, hyrë, nxjerrë dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik (*kërkesa e dytë*); (iii) për lejimin e kontrollit personal të gazetarit për të gjetur sende e prova materiale që lidhen me veprën penale (*kërkesa e tretë*).

6. Në lidhje me *kërkesën e parë*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 500, datë 13.12.2023 (*vendimi nr. 500/2023*), ka vendosur pranimin e saj dhe lejimin e kontrolleve në banesë dhe në vendin e punës. Në pikën 5 të dispozitivit të vendimit gjykata është shprehur se kundër vendimit nuk lejohet ankim. Në ekzekutimin e këtij vendimi, në datën 13.12.2023, ora 20:00, në banesën e kërkuesit janë sekuestruar një hard disk i jashtëm, një njësi qendrore e kompjuterit, një zarf, 9 USB, 6 CD dhe një telefon. Pas katër ditëve kërkuesit i janë kthyer 6 CD, veprim që është dokumentuar me procesverbalin e datës 27.12.2023.

7. Për sa i përket *kërkesës së dytë*, me vendimin nr. 501, datë 13.12.2023 (*vendimi nr. 501/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e saj dhe lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës ku gazetari ushtron detyrën dhe në banesën e tij, duke kërkuar, hyrë, nxjerrë dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose sigurimin e të dhënave, ose të sistemit kompjuterik. Ajo gjykatë ka arsyetuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm

se janë konsumuar veprat penale, ndaj është e domosdoshme marrja e të dhënave në sistemin kompjuterik në funksion të hetimit dinamik të procedimit për të identifikuar personin përgjegjës për nxjerrjen e akteve sekrete hetimore, të cilat janë sensitive në drejtim të pasojës dhe për të ruajtur rendin e sigurinë publike nga publikimi i informacionit. Sipas gjykatës së shkallës së parë, liria e shprehjes nuk duhet të cenojë të drejtën për të jetuar të punonjësve të institucioneve të drejtësisë, sigurinë publike dhe dinamikën e hetimeve.

8. Në ekzekutim të vendimeve nr. 500/2023 dhe nr. 501/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me të cilat ishin disponuar kontrollet, si dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, në datën 13.12.2023, ora 22:30, janë sekuestruar në vendin e punës së kërkuesit një njësi qendrore e kompjuterit, një CD, një mandat arkëtimi dhe një letër me shënime. Pas 1 muaji e 18 ditëve, kërkuesit i është kthyer njësia qendrore e kompjuterit, veprim i cili është dokumentuar me procesverbalin e datës 30.01.2024.

9. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi nr. 501/2023 është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 04 (87-2024-9), datë 06.01.2024 (*vendimi nr. 4/2024*) dhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2024-255 (36), datë 20.02.2024 (*vendimi nr. 36/2024*).

10. GJKKO-ja e Apelit, në referim të vendimit njësues nr. 147, datë 23.11.2021 të Gjykatës së Lartë (*vendimi njësues nr. 147/2021*), ka vlerësuar se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike është i ligjshëm, pasi ekziston fakti penalisht i ndëshkueshëm i dhënies së informacioneve që kanë lidhje me një bashkëpunëtor të drejtësisë gjatë hetimit penal. Informacionet e publikuara përmbanin të dhëna sensitive që vinin në rrezik integritetin fizik dhe lirinë e bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe personave të tjerë. Ato informacione janë sekret hetimor dhe sigurojnë administrimin e mirë të drejtësisë dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Sipas gjykatës së apelit, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ka si qëllim të identifikojë personat përgjegjës për nxjerrjen e akteve sekrete, të ruajë fshehtësinë e hetimeve, si dhe të mbrojë jetën, integritetin fizik dhe lirinë e dëshmitarëve të pyetur dhe të bashkëpunëtorit të drejtësisë. Në këto rrethana, shprehet gjykata e apelit, sekuestrimi respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, sepse është me ligj, për interes publik dhe nuk cenon parimin e proporcionalitetit, pasi interesi publik i mbrojtur tejkalon të drejtën e mbrojtjes së burimit të gazetarit. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se edhe sekuestroja nuk ka dëmtuar garancitë për sinjalizuesit e mundshëm, pasi publikimet në media nuk kanë

të bëjnë me raportimin e sjelljeve të dyshuara të korrupsionit, joetike ose të jashtëligjshme, për të cilin sinjalizuesi do të gëzonte mbrojtje sipas ligjit. Sekuestroja, ka çmuar gjykata e apelit, nuk cenon as të drejtën për jetë private, e cila nuk është absolute. Edhe pretendimi se kërkuesi nuk është thirrur në seancën për urdhërimin e sekuestros, sipas gjykatës së apelit, është i pabazuar, pasi të drejtat e individit realizohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë, ndaj procesi gjyqësor në tërësi i jep mundësinë personit të prekur të vërë në vend të drejtën e tij.

11. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatave të faktit është në përputhje me ligjin procedural penal dhe pretendimet për cenimin e parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes që sekuestrimi ka bërë te liria e shprehjes, janë të pabazuara. Sipas Gjykatës së Lartë, të dhënat kompjuterike janë provë materiale, ndaj sekuestrimi i tyre ishte i domosdoshëm dhe në përputhje me ligjin për të verifikuar faktin penal të nxjerrjes së akteve sekrete hetimore dhe identifikuar autorët në burimin më të afërt dhe imediat. Në analizë të balancës ndërmjet interesit për të hetuar menjëherë pa pengesa dhe konfidencialitetit të burimeve të gazetarit prevalon i pari. Përmbajtja e publikimeve të kërkuesit, shprehet Gjykata e Lartë, nuk e justifikon interesin publik të përgjithshëm. Po kështu, sipas Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se kërkuesi është në pozitat e personit që ka dijeni për veprën penale dhe jo të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, prokuroria nuk ka ndalim për të zbatuar të gjitha mjetet procedurale. Gjithashtu, sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt vendimin njësues nr. 147/2021, si dhe kriteret e KEDNJ-së për kufizimin e të drejtave themelore.

12. Në lidhje me *kërkesën e tretë*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 502, datë 13.12.2023 (*vendimi nr. 502/2023*), ka vendosur pranimin e saj dhe lejimin e kontrollit personal të kërkuesit, me qëllim gjetjen e sendeve ose provave materiale që lidhen me veprën penale. Në pikën 5 të dispozitivit të vendimit gjykata është shprehur se kundër vendimit nuk lejohet ankim. Në ekzekutimin e këtij vendimi, në datën 13.12.2023, ora 17:43, kërkuesit i janë sekuestruar një çelës automjeti, i cili rezulton t'i jetë kthyer të nesërmen (dokumentuar me procesverbalin e datës 14.12.2023) dhe në orën 18:55 një USB, që i është kthyer pas 5 ditëve (dokumentuar me procesverbalin e datës 28.12.2023).

13. Përveç tri kërkesave të mësipërme, në datën 13.12.2023, ora 22:00, me aktin "Autorizim për lejimin e përdorimit të pajisjes teknike, gjurmuese (IMSI Catcher)", Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 75/a shkronja "b",

221, pikat 2 e 3/a dhe 222, pika 8, të KPP-së, ka autorizuar përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes për të lokalizuar numrin e telefonit të kërkuesit. Hetuesit e BKH-së në datën 14.12.2023, ora 00:05, kanë sekuestruar në ambientin e brendshëm të një subjekti tregtar dy aparate telefonike, veprim i cili është dokumentuar me procesverbal. Sekuestrimi është vleftësuar i ligjshëm nga Prokuroria e Posaçme me vendimin e datës 14.12.2023. Me vendim të të njëjtës datë, Prokuroria e Posaçme ka vendosur ekspertimin tekniko-kompjuterik të dy aparateve telefonike, duke caktuar edhe një ekspert.

14. Në datën 18.12.2023 kërkuesi i është drejtuar sërish GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për heqjen e sekuestros provuese për sendet e marra në datën 13.02.2023 gjatë kontrollit të banesës së tij (një hard disk, një njësi qendrore e kompjuterit, zarf, 9 USB, 6 CD dhe një telefon); gjatë kontrollit të zyrës (një njësi qendrore e kompjuterit, një CD, fletë mandati); gjatë kontrollit të automjetit (një USB); gjatë kontrollit në një ambient tregtar pranë Prokurorisë së Posaçme (dy telefona). GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 507, datë 27.12.2023, ka vendosur kthimin e USB-së së sekuestruar në automjetin e tij, me arsyetimin se ishin tejkaluar kufijtë e kontrollit personal. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vendosur zbatimin e urdhrit të prokurorisë për kthimin e disa sendeve në datën 25.12.2023 dhe rrëzimin e kërkimeve të tjera. Për sa u përket pretendimeve për kthimin e telefonave celularë, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se veprimi i prokurorisë është i mbështetur në ligj dhe në prova, duke theksuar se mbajtja e tyre është e domosdoshme për vijimin e hetimit, ndaj nuk mund t'i kthehen kërkuesit. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 24 (87-2024-33), datë 01.02.2024.

15. Për rekursin e kërkuesit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-515 (76), datë 25.03.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim. Gjykata e Lartë ka mbështetur argumentin e gjykatës së apelit se aparatet telefonike janë sende dhe jo sisteme kompjuterike, ndërsa për sa u përket sendeve të sekuestruara në banesë, përfshirë CD dhe kompjuterin, është shprehur se gjykata e apelit duhet të kishte verifikuar pretendimin për cenimin e jetës private dhe të dispononte kthimin e materialeve që lidheshin me jetën e fëmijëve ose të familjes. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit nuk ka verifikuar nëse ndër sendet e sekuestruara ka CD me përmbajtje të jetës personale e familjare ose nëse kompjuterët e sekuestruar

në banesë kanë qenë në funksion të lojërave të fëmijëve. Për këtë arsye, sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit duhet të verifikonte nëse mbajtja nën sekuestro e sendeve (mjete të punës) të gazetarit ishte e nevojshme dhe nëse prokuroria mund të zbatonte nenin 208/a, paragrafi 3, shkronja "b", të KPP-së për marrjen e të dhënave kompjuterike, si dhe paragrafin e parë të nenit 213 të po këtij kodi, për marrjen e dokumenteve. Ndërsa për sa i përket sekuestrimit të aparateve telefonike, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar se ato përbëjnë sende dhe jo sisteme kompjuterike.

16. Pas rigjykimit të çështjes, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 95 (87-2024-137), datë 21.05.2024, ka vendosur sërish miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

17. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2157 (311), datë 16.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me plotësimin: "Sendet e sekuestruara dhe të pakthyera duhet t'i kthehen kërkuesit brenda datës 16.02.2025.". Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ligjshmëria e sekuestrimeve ishte verifikuar në një proces tjetër nga gjykatat e posaçme dhe Kolegji Penal i saj. Në vijim, sipas Gjykatës së Lartë, për shkak të kohëzgjatjes prej 1 viti dhe në bazë të parimit të proporcionalitetit, prokuroria duhet të përfundonte analizat ose ekzaminimet teknike dhe t'i kthente sendet kërkuesit brenda datës 16.02.2025.

18. Në datën 14.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, duke kërkuar në thelb shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për lejimin e kontrolleve personale dhe të vendeve (banesë dhe vendi i punës), vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e provave materiale (sende dhe të dhëna kompjuterike) dhe vendimit të prokurorit për sekuestrimin e dy aparateve telefonike. Po kështu, ai ka kërkuar edhe zbatimin e vendimit të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së dhe pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore, konkretisht të veprimeve të përpunimit të imazheve dhe të të dhënave kompjuterike në pajisjet e sekuestruara. Me vendimin e datës 17.07.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 23.07.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve me përparësi. Me vendimin e po kësaj date, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore, me arsyetimin se Komiteti për të Drejtat e Njeriut i OKB-së i ka kërkuar shtetit shqiptar të ndalojë kryerjen e çdo inspektimi,

shpërndarjeje ose përpunimi gjyqësor të materialeve të sekuestruara nga kërkuesi dhe në kushtet kur vendimet e këtij komiteti duhet të respektohen, nuk ka shkak të përsëritet marrja e të njëjtave masa.

19. Në datën 03.03.2025 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e objektit të ankimit, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike; konstatimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore për lejimin e kontrolleve personale dhe të vendeve, si dhe të vendimit të prokurorisë për sekuestrimin e dy aparateve celulare; shkatërrimin e të gjitha kopjeve të imazheve dhe ekstrakteve të hard disqeve dhe aparateve telefonike, si dhe rezultatet e fiksuara prej tyre; marrjen e masave për shkatërrimin e plotë të tyre dhe ndalimin e aksesit ose kryerjes së çdo procedure filtrimi, përzgjedhje të të dhënave dhe nxjerrje të kopjeve të tjera.

20. Gjykata, në seancën plenare të datës 05.03.2025 mbi bazë të dokumenteve, duke konstatuar nevojën për përcaktimin e fakteve të çështjes, ka vendosur të ndryshojë formën e shqyrtimit të çështjes nga seancë plenare mbi bazë të dokumenteve në atë publike, me praninë e palëve. Në seancën plenare publike të datës 19.03.2025 Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të ankimit kushtetues individual, siç përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

21. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se aktet dhe vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

21.1. *Lirinë e shprehjes*, të garantuar nga neni 22 i Kushtetutës, neni 10, paragrafi 2, i KEDNJ-së dhe nenet 17 dhe 19 të PNDCP-së, pasi ndërhyrja nuk ka pasur qëllim legjitim dhe nuk ka qenë proporcionale, për arsyet e mëposhtme:

21.1.1. Nuk përmbushet kriteri i qëllimit legjitim, sepse nuk është vërtetuar nëse zbulimi i burimit të informacionit të gazetarit është e vetmja mënyrë për të provuar veprën penale. Liria e shprehjes mund të kufizohet kur ekziston nevoja për një hetim, pasi janë shteruar mundësitë e tjera hetimore. Të dhënat e kërkuara nga prokuroria mund të nxirren nga burime të tjera dhe në rastin konkret burimi i gazetarit, i cili dëmton konfidencialitetin e tij, nuk është i domosdoshëm.

21.1.2. Urdhri i Prokurorisë së Posaçme parashikon ndalimin e publikimit të deklarimeve të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, por nuk përfshin edhe aktet e dosjes hetimore ose komunikimet elektronike. Asnjë gazetar tjetër i cili ka publikuar këto të dhëna ose persona të përfshirë në hetime, nuk u janë nënshtruar sekuestrimeve si rasti i kërkuesit.

21.1.3. Urdhri i gjykatës është formuluar në terma të gjerë dhe ka lejuar sekuestrimin e çdo pajisjeje elektronike, duke u mundësuar hetuesve që të zbulojnë burimet dhe të hyjnë pa kriter në të gjitha të dhënat. Po kështu, mungojnë masat për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve gazetareske dhe informacioneve që nuk lidhen me çështjen. Kontrolli dhe aksesi i të dhënave ka ndodhur pa praninë e avokatit të kërkuesit dhe gjykatat kanë vënë në rrezik jo vetëm marrëdhëniet me burimet e gazetarit, por edhe sinjalizuesit e mundshëm që punojnë në institucionet shtetërore. Sekuestrimi i pajisjeve rrezikon edhe sekretet profesionale dhe personale të gazetarit.

21.1.4. Pajisjet e sekuestruara janë sisteme kompjuterike dhe mbartin të dhëna kompjuterike, ndërsa organi i akuzës i ka konsideruar ato si sende. Nëse do të ishin të tilla, ato do të sekuestroheshin vetëm për marrjen e gjurmëve të gishtave, por në fakt sekuestrimi është bërë për të siguruar të dhënat kompjuterike prej tyre, të cilat duhen mbrojtur në rastin e gazetarit profesionist. Qëllimi i masave është ndëshkimi i kërkuesit për publikimin e artikujve në media. Po kështu, ndërsa kryheshin sekuestrimet e materialeve personale dhe profesionale, kërkuesi është mbajtur i mbyllur me çelës për disa orë në ambientet e prokurorisë.

21.1.5. Prokuroria e Posaçme ka aluduar se kërkuesi ka kryer krim dhe po abuzon me imunitetin profesional, ndërsa gjykatat e kanë trajtuar rastin sikur gazetari të ishte i pandehur dhe akuzohej për një vepër penale që ishte në tejkalim të lirisë së shprehjes. Gjykata e Lartë ka analizuar balancën midis së drejtës së gazetarit për të mbrojtur burimet përkundrejt fshehtësisë së hetimit, kur në fakt ajo duhet të analizonte në drejtim të balancës e nevojës për ndërhyrje të prokurorisë dhe të gjykatës në raport me të drejtën e mbrojtjes së burimeve të gazetarit.

21.1.6. Prokuroria dhe gjykatat nuk kanë respektuar vendimet e Komitetit për të Drejtat e Njeriut në OKB për ndalimin e përpunimit dhe të shpërndarjes së informacionit të sekuestruar. Edhe Avokati i Popullit, nisur nga rasti i kërkuesit, ka publikuar një raport për respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore.

21.2. *Të drejtën e jetës private*, të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, neni 8 i KEDNJ-së dhe neni 17 i PNDCP-së, pasi sekuestrimi i pajisjeve elektronike krijon mundësi për akses në sekrete të jetës private, por edhe profesionale për shkrime që kërkuesi është duke përgatitur për median ku punon. Pajisjet elektronike të sekuestruara janë mjetet e punës së tij të përditshme, si dhe përdoren edhe nga fëmijët e tij të mitur.

21.3. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është mbajtur i izoluar në prokurori për 6 orë pa justifikim. Ai nuk është thirrur e dëgjuar në seancën gjyqësore për t'u urdhëruar nga gjykata të tregojë burimin dhe as në seancën gjyqësore të sekuestrimit. Sipas nenit 159, paragrafi 3, të KPP-së, është gjykata e cila urdhëron gazetarin të tregojë burimin e informacionit dhe jo prokurori, sikurse ka ndodhur. Gjykata duhet të thërriste kërkuesin dhe të vlerësonte nëse të dhënat ishin të domosdoshme dhe nuk mund të siguroheshin në mënyra të tjera. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për lejimin e sekuestrimit është menjëherë i ekzekutueshëm dhe ankimi kundër tij nuk është efektiv, pasi nuk mund të rivendosen në vend të drejtat. Vendimet e kundërshtuara nuk kanë respektuar vendimin njësues nr. 147/2021, i cili ka përcaktuar kriteret që duhet të analizojnë gjykatat për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Procedura e sekuestrimit të pajisjeve në ambientet e punës dhe të banimit është nisur pa praninë e mbrojtësit. Gjykimi i çështjes është kryer në kushtet e konfliktit të interesit, pasi prokurorët ishin të njëjtët me ata që dyshohen për veprat penale, për të cilat është urdhëruar sekuestrimi.

22. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

22.1. Pretendimi për cenimin e *lirisë së shprehjes* nuk është i bazuar. Të tria gjykatat kanë kthyer përgjigje shteruese, duke argumentuar se ekzistojnë dyshime për veprime penale, pasi publikimi i artikujve

përmbante të dhëna sensitive që mund të identifikonin personat e përfshirë në hetime dhe të rrezikonin jetën dhe integritetin e tyre, përfshirë bashkëpunëtorin e drejtësisë. Fshehtësia e hetimeve prevalon mbi interesin për të informuar publikun. Kufizimi i lirisë së shprehjes është bërë në përputhje me ligjin dhe është i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Publikimet në media nuk lidhen me bërjen publike të një raportimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sjelljeje joetike ose të jashtëligjshme, ose çështje të tjera të mbrojtura nga ligji për sinjalizuesit. Interesi publik për ruajtjen e fshehtësisë së hetimeve prevalon mbi mbrojtjen e burimeve të gazetarit dhe ndonëse gazetarët duhet të jenë të lirë të raportojnë ngjarjet, kërkuesi nuk ka bërë verifikime të mjaftueshme përpara publikimit të informacionit. Sekuestrimi i sendeve ka si qëllim vetëm marrjen e informacioneve që bëjnë të mundur zbulimin e të dhënave që mund të çojnë në identifikimin e personave përgjegjës të cilët kanë nxjerrë aktet sekrete të hetimit, me qëllim ndjekjen penale të tyre. Publikimi i të dhënave nuk ishte rezultat i një investigimi të një çështjeje me interes publik, pasi nuk shoqërohet me asnjë analizë gazetareske, por thjesht publikim i pjesëve të transkriptimit të bisedave midis bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe të dyshuarve të tjerë për veprat penale.

22.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së jetës private* nuk qëndron, pasi, siç kanë arsyetuar gjykatat e zakonshme, e drejta për jetë private nuk është absolute, por duhet të balancohet me funksionin dhe nevojat e shoqërisë; ndërhyrja është në përputhje me ligjin, përbën një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe është bërë për qëllime të ligjshme. Gjykatat e zakonshme kanë analizuar balancën midis së drejtës për jetë private të gazetarit dhe nevojës për të mbrojtur informacionet e ndjeshme relevante për hetimin, duke arritur në përfundimin se gjatë procedurave të kontrollit janë respektuar të drejtat dhe dinjiteti i kërkuesit. Ky i fundit nuk ka paraqitur prova bindëse që tregojnë shkelje; ndërhyrja në të drejtën e jetës private ka pasur qëllim mbledhjen e provave për çështjen penale dhe jo cenimin e privatësisë të të miturve.

22.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi, sikurse kanë pohuar gjykatat e zakonshme, gjykimi nga gjyqtari i hetimit paraprak zhvillohet pa pjesëmarrjen

e palës së interesuar, por personi i prekur ka të drejtën e ankimit menjëherë pas marrjes dijeni për sekuestron. Kjo procedurë nuk cenon standardin kushtetues të aksesit efektiv në gjykatë, kontradiktoritetin, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ato realizohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

23. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

24. Për sa i takon legjitimimit *ratione personae,* Gjykata ka pohuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore dhe të prokurorisë, të cilat kanë lejuar kontrollin personal, të vendit të punës dhe të banesës së tij, si dhe sekuestrimin e sendeve dhe të dhënave kompjuterike, me pretendimin se ato akte kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat themelore të tij. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi justifikon interesin në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

26. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë,

mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore dhe të prokurorisë, që kanë lejuar kontrollet dhe sekuestrimet, nuk kanë vendosur për themelin e akuzave, por janë vendime të ndërmjetme të procedimit penal në funksion të mbledhjes së provave për faktin penal. Në jurisprudencën kushtetuese, vendimet e ndërmjetme të sekuestros konservative ose preventive, të dhëna gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, edhe pse gjykimi i themelit të fajësisë ende nuk kishte përfunduar, duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për këto lloj vendimesh, Gjykata është shprehur se ndonëse me karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, ato ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale dhe, për rrjedhojë, konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetues*e).

28. Për sa u përket vendimeve të ndërmjetme për kontrollet, Gjykata vëren se KPP-ja nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj tyre, por vetëm ndaj vendimeve të sekuestrimit të provave materiale gjatë kontrolleve (nenet 202 - 212, 407 dhe 420 të KPP-së). Gjykata çmon se ligjvënësi duhet të vlerësojë nëse duhet plotësuar legjislacioni procedural penal për t'i ofruar individit mjetet juridike efektive për kundërshtimin përpara gjykatave të zakonshme të masës së kontrollit të vendeve ose atij personal edhe në rastin kur kontrolli nuk shoqërohet me masën e sekuestrimit, për sa kohë që kontrolli mbart në vetvete mundësinë për të cenuar të drejtat dhe liritë themelore. Megjithatë, duke iu referuar parashikimeve aktuale ligjore, Gjykata vë në dukje se kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individi në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Nëse nga kontrolli

nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual.

29. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi ka kundërshtuar pesë vendime gjyqësore dhe një vendim të prokurorisë, konkretisht: (i) vendimin nr. 500/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për lejimin e kontrollit në vendin e punës dhe në banesën e tij, ku janë sekuestruar prova materiale, vendim i paankimueshëm në gjykatat më të larta; (ii) vendimin nr. 501/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në vendin e punës dhe në shtëpi; (iii) vendimin nr. 502/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për lejimin e kontrollit personal, në zbatim të të cilit është kontrolluar edhe automjeti i tij, ku janë sekuestruar prova materiale, vendim i paankimueshëm në gjykatat më të larta; (iv) vendimin nr. 4/2024 të GJKKO-së së Apelit, me të cilin është lënë në fuqi vendimi për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në vendin e punës dhe në banesë; (v) vendimin nr. 36/2024 të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në vendin e punës dhe në banesë; (vi) vendimin e datës 14.12.2023 të Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e sekuestrimit të dy aparateve telefonike në një ambient tregtar.

30. Nga analiza e këtyre akteve dhe mbi bazën e standardeve kushtetuese për shterimin e mjeteve juridike në rastin e kontrolleve dhe të sekuestrimeve, Gjykata vëren se kërkuesi ka hapur dy procedura ankimore në gjykatat e zakonshme. Në të dyja këto procedura ai ka ngritur pretendimet për cenimin e lirisë së shprehjes, së drejtës për jetë private dhe atë të procesit të rregullt ligjor.

31. Procedura e parë lidhet me ankimet (apel dhe rekurs) ndaj vendimit nr. 501/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike gjatë kontrollit në banesë dhe në vendin e punës, kontrolle të lejuara me vendimin nr. 500/2023 të së njëjtës gjykatë. Në këtë procedurë ankimore GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, respektivisht me vendimet nr. 4/2024 dhe nr. 36/2024, kanë vendosur miratimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këto pretendime.

32. Procedura e dytë ankimore ka të bëjë me kërkesën për heqjen e sekuestros ndaj: provave materiale të sekuestruara gjatë kontrollit personal,

të lejuar me vendimin nr. 502/2023 dhe gjatë zbatimit të të cilit është kontrolluar edhe automjeti i kërkuesit; provave të tjera materiale, të ndryshme nga të dhënat kompjuterike, të sekuestruara gjatë kontrollit në banesë dhe në vendin e punës, të lejuar me vendimin nr. 500/2023 të së njëjtës gjykatë; dhe dy aparateve telefonike të sekuestruara nga Policia Gjyqësore në një ambient tregtar, sekuestrim që është vleftësuar i ligjshëm nga Prokuroria e Posaçme me vendimin e datës 14.12.2023. Shqyrtimi gjyqësor i kërkesës për heqjen e sekuestros ndaj këtyre provave materiale ka përfunduar në datën 16.12.2024, kur Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave të faktit për rrëzimin e kërkesës, me plotësimin e urdhërimit për kthimin e sendeve të sekuestruara kërkuesit brenda datës 16.02.2025 (*shih paragrafin 17 të vendimit*). Pas komunikimit të këtij vendimi kërkuesi ka mbajtur qëndrimin me shkrim dhe verbalisht në seancë plenare, që Gjykata nuk duhet të kontrollojë kushtetutshmërinë e tij, pasi synon të paraqesë ankim tjetër kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor, afat i cili ende nuk ka përfunduar. Në këto rrethana, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, çmon se pretendimet që lidhen me sendet e sekuestruara gjatë këtyre kontrolleve, përfshirë sekuestrimin e dy aparateve telefonike në një ambient tregtar, nuk mund të shqyrtohen në këtë gjykim kushtetues, për shkak se procesi ankimor në gjykatat e zakonshme për kundërshtimin e këtyre vendimeve ka përfunduar në datën 16.12.2024, pra pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual dhe se kërkuesi synon të paraqesë ankim tjetër kushtetues individual për atë proces.

33. Për sa më lart, Gjykata evidenton se objekti i gjykimit kushtetues kufizohet në kontrollin kushtetues të tre vendimeve gjyqësore (vendimet nr. 501/2023, nr. 4/2024 dhe nr. 36/2024) që kanë lejuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të nxjerra nga provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuesit, pavarësisht se vetë provat materiale, nga të cilat janë nxjerrë të dhënat kompjuterike, janë sekuestruar me vendimin tjetër gjyqësor (vendimi nr. 500/2023).

34. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procedurën e ankimit në gjykatat e zakonshme, mban datën 20.02.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 14.06.2024. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

35. Në seancën plenare të datës 10.04.2025, gjatë diskutimit përfundimtar, kërkuesi ka paraqitur për herë të parë pretendimin se izolimi i tij prej 6 orësh i ka cenuar lirinë personale, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Në vlerësimin e Gjykatës, ky pretendim i ri, në thelb, ndryshon shkaqet e ankimit kushtetues individual, duke shtuar një shkak të ri pas kalimit të çështjes në seancë plenare. Për rrjedhojë, Gjykata, në të njëjtën linjë qëndrimi që ka mbajtur edhe në çështje të ngjashme (*shih vendimin nr. 4, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), çmon se pretendimi për cenimin e lirisë personale nuk mund të merret në shqyrtim, sepse duhet të respektojë kriteret e përgjithshme të formës dhe të afateve të paraqitjes, të cilat i nënshtrohen fillimisht procedurës së shqyrtimit paraprak.

36. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi ai është mbajtur i izoluar për 6 orë në datën 13.12.2023 në ambientet e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykata e shkallës së parë e ka dhënë vendimin për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në një proces në mungesë të tij. Po sipas tij, vendimi gjyqësor i sekuestrimit është menjëherë i ekzekutueshëm dhe ankimi kundër tij nuk është efektiv, pasi nuk mund të rivendosen në vend të drejtat e cenuara. Për këtë pretendim subjekti i interesuar ka prapësuar duke iu referuar arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, sipas të cilit kjo lloj procedure nuk cenon standardin kushtetues të aksesit efektiv në gjykatë, kontradiktoritetit dhe të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ato realizohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë, ndaj procesi gjyqësor në tërësi i jep mundësinë personit të prekur të vërë në vend të drejtën e tij.

37. Gjykata rithekson se procedurat gjyqësore që vendosin për kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprak, të cilat ndërhyjnë në të drejtat themelore, si rregull, duhet të sigurojnë garancitë e duhura të procesit të rregullt për individin. Megjithatë ligji i ka kufizuar disa prej garancive të procesit të rregullt në këtë fazë në raport me ato të gjykimit të themelit. Kështu, kur liria personale kufizohet nga caktimi i masës së sigurimit të arrestit, ligji ka kufizuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, (në drejtim të thirrjes së dëshmitarëve apo marrjes së provave), i cili nuk zbatohet në të njëjtën masë dhe mënyrë si në gjykimin e themelit (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ky këndvështrim, Gjykata pohon se ligjvënësi në këto raste, duke mos parashikuar dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, si dhe duke mos i dhënë efekt pezullues ankimit, ka synuar që masa të

tilla hetimore, siç janë sekuestrimet e provave materiale, të mos pengohen nga individi me anë të taktikave të ndryshme në drejtim të zhdukjes ose dëmtimit të provave materiale. Në këtë mënyrë sigurohet efektiviteti i masës, për rrjedhojë edhe rezultati i procedimit penal në tërësinë e tij. Për këtë arsye, garancitë e procesit të rregullt realizohen në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit, e cila ka edhe kompetencën e marrjes dhe të shqyrtimit të provave, krahas zbatimit të ligjit, i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet dhe të kundërshtojë kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të procedimit në mungesë të tij në shkallë të parë dhe ekzekutimit të menjëhershëm të vendimit të sekuestrimit është haptazi i pabazuar.

38. Kërkuesi në drejtim të legjitimimit *ratione materiae* ka pretenduar gjithashtu cenimin e lirisë së shprehjes dhe së drejtës për jetë private, të garantuara nga nenet 22 dhe 35 të Kushtetutës. Për sa kohë pretendimi lidhur me cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor u vlerësua haptazi i pabazuar, Gjykata në vijim do të analizojë lirinë e shprehjes dhe të drejtën për jetë private në aspektin substancial.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë së shprehjes

39. Kërkuesi ka pretenduar se sekuestrimi nuk ishte e vetmja mënyrë për të provuar veprat penale, pasi të dhënat mund të nxirreshin nga burime të tjera prove. Sipas tij, asnjë gazetar tjetër, që ka publikuar të njëjtat të dhëna ose persona të tjerë që kishin dijeni për aktet e hetimit nuk u janë nënshtruar kontrolleve dhe sekuestrimeve si kërkuesi. Vendimi gjyqësor për sekuestrimin është formuluar në terma të gjerë dhe ka lejuar sekuestrimin e çdo pajisjeje elektronike, duke u mundësuar hetuesve që të zbulojnë burimet dhe të hyjnë pa kriter në të gjitha të dhënat. Po kështu, sipas kërkuesit, mungojnë masat për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve të gazetarit dhe të informacioneve që nuk lidhen me çështjen, të dhënat janë kontrolluar dhe aksesuar pa praninë e avokatit të tij dhe gjykatat kanë vënë në rrezik jo vetëm marrëdhëniet me burimet e gazetarit, por edhe sinjalizuesit e mundshëm që punojnë në institucionet shtetërore. Po sipas tij, pajisjet e sekuestruara janë sisteme kompjuterike dhe mbartin të dhëna kompjuterike, ndërsa organi i akuzës i ka konsideruar ato si sende. Sipas kërkuesit, Prokuroria e Posaçme ka aluduar se ai ka kryer krim dhe po abuzon me imunitetin profesional, ndërsa gjykatat e kanë trajtuar rastin

sikur gazetari të ishte i pandehur dhe akuzohej për një vepër penale që ishte në tejkalim të lirisë së shprehjes. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është thirrur e dëgjuar në seancë gjyqësore për urdhërimin e tregimit të burimit nga gjykata dhe më pas të sekuestrimit, në respektim të nenit 159, paragrafi 3, të KPP-së. Ai gjithashtu ka paraqitur një deklaratë të medias ku është i punësuar si gazetar, sipas së cilës pas datës 13.12.2023 ka pasur një kufizim të ndjeshëm në krijimtarinë investiguese dhe raportuese të gazetarit, përfshirë edhe periudha të konsiderueshme pa raportime, si dhe dalje publike të rralluara ndjeshëm.

40. Subjekti i interesuar ka prapësuar se gjykatat e zakonshme i kanë kthyer përgjigje shteruese, duke argumentuar se ekzistojnë dyshime për veprime penale, pasi publikimi i artikujve përmbante të dhëna sensitive që mund të identifikonin personat e përfshirë në hetime dhe të rrezikonin jetën dhe integritetin e tyre, përfshirë bashkëpunëtorin e drejtësisë. Sipas këtij subjekti, liria e shprehjes është kufizuar me ligj dhe kufizimi është i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Publikimet në media nuk lidhen me raportimin ose zbulimin e një praktike të dyshuar korrupsioni, sjellje joetike ose të jashtëligjshme apo çështje të tjera të mbrojtura nga ligji për sinjalizuesit. Prokuroria e Posaçme ka prapësuar gjithashtu se interesi publik për ruajtjen e fshehtësisë së hetimeve prevalon mbi interesin për të informuar publikun dhe atë për mbrojtjen e burimeve të gazetarit dhe ndonëse gazetarët duhet të jenë të lirë të raportojnë ngjarjet, kërkuesi nuk ka bërë verifikime të mjaftueshme përpara publikimit të informacionit. Sipas subjektit të interesuar, sendet janë sekuestruar për marrjen e informacioneve, të cilat shërbejnë për identifikimin e personave përgjegjës që kanë nxjerrë aktet sekrete të hetimit, me qëllim ndjekjen penale të tyre. Publikimi i të dhënave, sipas subjektit të interesuar, nuk ishte rezultat i një investigimi të një çështjeje me interes publik, pasi nuk shoqërohet me asnjë analizë gazetareske, por thjesht publikim i pjesëve të transkriptimit të bisedave midis bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe të dyshuarve të tjerë për kryerjen e veprave penale.

41. Kushtetuta në nenin 22 garanton lirinë e shprehjes (*pika 1*) dhe në mënyrë specifike lirinë e shtypit, të radios dhe të televizionit (*pika 2*), ndërsa ndalon censurën paraprake të mjeteve të komunikimit (*pika 3*). Kjo liri është e mbrojtur dhe nga neni 10 i KEDNJ-së dhe neni 19 i PNDCP-së.

42. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe

krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre, pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtash dhe lirish të tjera themelore (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese).*

43. Liria e shprehjes është konsideruar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) si një nga themelet kryesore të shoqërisë demokratike, një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo individi (*shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 07.12.1976, § 49*). Në veçanti për mbrojtjen e burimit të informacionit të një gazetari GJEDNJ-ja ka pohuar se përbën një nga themelet e lirisë së shtypit. Pa një mbrojtje të tillë burimet mund të pengohen të ndihmojnë shtypin në informimin e publikut për çështje me interes publik. Si rezultat, roli jetik i "mbrojtësit publik" të shtypit mund të minohet dhe aftësia e shtypit për të ofruar informacion të saktë dhe të besueshëm mund të ndikohet negativisht. Ndërhyrja në këtë të drejtë mund të justifikohet vetëm në rast të mbrojtjes së interesit publik (*shih Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 27.03.1996, § 39*). E drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk mund të konsiderohet thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë përbërëse e së drejtës për informacion, që duhet trajtuar me kujdesin më të madh (*shih Nagla kundër Letonisë, datë 16.07.2013 § 97; Tillack kundër Belgjikës, datë 27.11.2007, § 65*).

44. Po kështu, GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se urdhrat për të zbuluar burimet e gazetarëve potencialisht kanë një ndikim të dëmshëm, jo vetëm për burimin, identiteti i të cilit mund të zbulohet, por edhe për median, reputacioni i së cilës mund të ndikohet negativisht për burimet potenciale të së ardhmes (*shih Sanoma Uitgevers B.V. kundër Holandës [DhM], datë 27.11.2007, § 89; Financial Times Ltd dhe të tjerët kundër Mbretëria e Bashkuar, datë 15.12.2009, § 70*). Masat e marra nga autoritetet publike për të zbuluar burimin e informacionit mund të dekurajojnë individët të cilët kanë informacion në lidhje me një ngjarje dhe dëshirojnë të ndajnë njohuritë e tyre me shtypin (*shih Voskuil kundër Holandës, datë 22.11.2007, § 71*).

45. Në rastin kur gazetarët janë të akuzuar penalisht, GJEDNJ-ja ka

pranuar se ata ndonjëherë mund të përballen me konfliktin midis detyrës së përgjithshme për t'iu bindur ligjit penal, ndaj të cilit nuk janë të përjashtuar, si dhe detyrës profesionale për të marrë dhe shpërndarë informacion, në mënyrë që media të luajë rolin thelbësor të rojtarit publik. Në këtë situatë të konfliktit të interesave, koncepti i "gazetarisë së përgjegjshme" kërkon që kurdoherë që një gazetar, sikundër edhe punëdhënësi i tij, duhet të zgjedhë midis dy detyrave dhe ai zgjedh të shkelë detyrimin e ligjit penal, atëherë gazetari duhet të kuptojë që po ndërmerr rrezikun se ndaj tij do të jepen sanksione ligjore, përfshirë ato me karakter penal (*shih Pentikäinen kundër Finlandës [DHM], datë 20.11.2015, § 110*). GJEDNJ-ja ka theksuar në mënyrë të qëndrueshme se gazetarët nuk mund të përjashtohen nga detyra e tyre për t'iu bindur ligjit penal vetëm mbi bazën se neni 10 u jep atyre mbrojtje (*shih Stoll kundër Zvicrës [DHM], datë 10.12.2007, § 102*).

46. Në përmbledhje të standardeve të mësipërme dhe duke theksuar se në rastin konkret kërkuesi nuk është gazetar i akuzuar penalisht, Gjykata vë në dukje se liria e shtypit luan rolin jetik të mbrojtësit publik në përparimin e një shoqërie demokratike për ta bërë pushtetin shtetëror më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. E drejta e gazetarit për të ruajtur burimin e informacionit dhe për të mos e zbuluar atë është një nga kushtet e lirisë së shtypit. Mbrojtja e burimeve të gazetarit është një prej garancive kryesore të lirisë kushtetuese të shtypit, ndaj urdhërimi i gazetarit për të zbuluar burimet e tij mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën, përveçse kur ekziston një bazë e qartë ligjore që e autorizon dhe një interes publik mbizotërues që e dikton atë. Kjo e drejtë e gazetarit krijon kushtet për vendosjen e një marrëdhënieje besimi midis gazetarit dhe informatorit të tij, marrëdhënie që i mundëson gazetarit të marrë informacione për çështje me interes publik, edhe në rastet kur zbulimi i burimit të informacionit mund të jetë i ndaluar me ligj ose do të sillte sanksione të tjera. Mungesa e kësaj mbrojtjeje mund të dekurajojë informatorët për të ndihmuar shtypin për informimin e publikut rreth çështjeve me interes publik. Në këtë kuptim, konfidencialiteti i burimeve të gazetarit mbron jo vetëm gazetarin, por edhe vetë individët që janë burimet që e ndihmojnë gazetarin të informojë qytetarët për çështje me interes publik. E drejta e gazetarit për të mos zbuluar burimet e tij nuk është thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë së burimeve, pasi, në thelb ajo mbron edhe të drejtën e informimit të qytetarëve, që është në vetvete interes publik.

47. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se e drejta për të mbrojtur një burim të gazetarit, si pjesë e lirisë së shtypit, është një nga elementet thelbësore

të funksionimit të sistemit demokratik pluralist, megjithatë ajo mund të kufizohet vetëm me ligj për interes publik mbizotërues ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në raport të drejtë me gjendjen që e dikton kufizimin dhe pa asgjësuar thelbin e lirisë së shtypit. Kjo nënkupton që kufizimi i kësaj të drejte justifikohet vetëm nëse nuk ekzistojnë mjete alternative për të arritur të njëjtin qëllim, pra që identifikimi i burimit është mjeti i vetëm ose i fundit, në kuptimin që të gjitha mjetet e tjera të mundshme janë shteruar dhe se interesi legjitim për zbulimin e burimit të informacionit është më i rëndësishëm se sa interesi publik për ruajtjen e konfidencialitetit.

48. Në këtë pikëpamje, Gjykata vëren se KPP-ja ka vendosur disa kufizime të tilla që lidhen me lirinë e shtypit dhe burimin e gazetarit. Kështu, neni 103 i këtij kodi parashikon se ndalohet publikimi i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. Ndërsa neni 159 parashikon se gazetari profesionist nuk mund të detyrohet të dëshmojë emrat e personave nga të cilat ka marrë të dhënat, përveçse kur ato janë të domosdoshme për të provuar veprën penale; kur vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin të tregojë burimin e informacionit të tij. Gjykata çmon se këto kufizime të vendosura me ligj i shërbejnë në mënyrë proporcionale interesit publik të administrimit të mirë të drejtësisë në disa dimensione, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, efektivitetin e ndjekjes penale, gjykimin e drejtë, parimin e prezumimit të pafajësisë, mbrojtjen e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Këto janë interesa të mbrojtur nga ligji, që i shërbejnë jo vetëm palëve dhe subjekteve të një procesi gjyqësor konkret, por edhe publikut në tërësi, për shkak të besimit publik që duhet të gëzojë sistemi gjyqësor kur kryen me efektivitet funksionet kushtetuese të tij.

49. Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi, Gjykata thekson se kur zbatohen kufizimet e mësipërme ligjore, argumentet në favor të ruajtjes së sekretit hetimor ose të urdhërimit të gazetarit për të treguar burimet e tij duhet të parashtrohen nga prokuroria dhe gjykatat e zakonshme në mënyrë sa më bindëse që është e mundur, duke treguar njëherazi që ekspozimi i burimit të gazetarit është mjeti jo vetëm i domosdoshëm, por edhe i fundit në dispozicion për të vërtetuar veprën penale dhe për të garantuar efektivitetin e procedimit penal. Me fjalë të tjera, ato duhet të arsyetojnë përpjekjet e kryera për marrjen e të dhënave nga burime të tjera prove dhe pamundësinë e sigurimit të të dhënave të synuara nga burime të tjera, duke treguar në këtë mënyrë se ekspozimi i burimit të gazetarit është mjeti i vetëm për

ato të dhëna, të cilat janë të domosdoshme për efektivitetin e procedimit penal, pasi interesi për përfundimin me sukses të tij dhe vënia përpara përgjegjësisë penale është më i lartë në raport me mbrojtjen e burimit të gazetarit, si pjesë e lirisë së shprehjes. Po kështu, gjykatat e zakonshme duhet të dallojnë rastin kur prokuroria po zhvillon hetime që lidhen me një sjellje të supozuar penale të gazetarit nga rasti i hetimeve të cilat kanë si qëllim kryesor marrjen e informacionit lidhur me burimin e gazetarit dhe vetë gazetari nuk ka kryer ndonjë vepër penale. Në këtë rast të fundit, garancitë për ndërhyrje në të drejtën e mbrojtjes së burimit janë më të forta dhe nevoja për arsyetimin bindës të gjykatave është më e lartë.

50. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata do të analizojë nëse vendimet gjyqësore të kontrollit e të sekuestrimit të sendeve dhe të të dhënave kompjuterike kanë kufizuar lirinë e shtypit të kërkuesit, në aspektin e së drejtës për të mbrojtur burimet e gazetarit dhe nëse po, do të vlerësojë më pas nëse kufizimi ka respektuar kriteret e vendosura nga neni 17 i Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi duhet të jetë bërë me ligj, për arsye të rëndësishme publike/interes publik, dhe të ketë respektuar parimin e proporcionalitetit.

51. Për sa i takon kufizimit, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, për të konstatuar ndërhyrje në lirinë e shprehjes, është i mjaftueshëm edhe urdhri për të zbuluar burimin e informacionit të gazetarit (*shih Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 27.03.1996, § 28).*

52. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se kërkuesi është thirrur në ambientet e Prokurorisë së Posaçme në datën 13.12.2023 për t'u pyetur për burimin e informacionit të materialeve që ai kishte publikuar në cilësinë e gazetarit në një media *online*. Pas refuzimit të kërkuesit për të identifikuar burimin e informacionit, brenda së njëjtës ditë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka dhënë vendimin për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, të cilat gjendeshin në pajisjet kompjuterike të sekuestruara si prova materiale gjatë kontrollit të banesës dhe të vendit të punës së kërkuesit, kontroll i lejuar gjithashtu me vendimin e po asaj date të së njëjtës gjykatë. Kërkuesi nuk ishte subjekti ndaj të cilit kishte filluar procedimi penal, pra sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kishte për qëllim vetëm identifikimin e burimit. Ashtu siç pohon kërkuesi, parashtrim që nuk është kundërshtuar nga subjekti i interesuar, në të dhënat kompjuterike gjendeshin burimet e informacionit të kërkuesit, që shfrytëzoheshin nga ai në ushtrimin e detyrës së gazetarit. Vendimi gjyqësor për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike u vleftësua i ligjshëm edhe nga gjykatat më të larta, të cilat në arsyetimin e tyre kanë pohuar se kontrolli i vendeve (banesë

dhe zyrë) dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ndërhynte në lirinë e shprehjes së kërkuesit. Sipas tyre, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në pajisjet e sekuestruara si prova materiale gjatë kontrollit ka synuar zbulimin e burimit të informacionit të kërkuesit, në cilësinë e gazetarit dhe më pas gjykimin e personave përgjegjës si autorë të veprave penale të zbulimit të të dhënave sekrete dhe shpalljes së tyre në kundërshtim me ligjin. Në këto rrethana, Gjykata çmon se thirrja e kërkuesit për të treguar burimin e informacionit dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike nga pajisjet e sekuestruara gjatë kontrollit të vendeve kanë kufizuar lirinë e shtypit, në aspektin e identifikimit të burimeve që ai kishte për shkak të profesionit të gazetarit, ndaj, në vijim, do të analizojë nëse kufizimi është vendosur vetëm me ligj, për një interes publik dhe në mënyrë proporcionale.

53. Kriteri i parë i kufizimit, ai *"vetëm me ligj"*, ka për qëllim të ofrojë garanci sa më të plota në rastin e kufizimeve. Togfjalëshi "*vetëm me ligj*" ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 20, datë 04.04.2014; nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në rastin e kërkuesit, ai është thirrur nga prokuroria për të treguar burimin e informacionit dhe brenda së njëjtës ditë, me vendim gjyqësor, është lejuar sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të vendeve (zyrë dhe banesë). Këto veprime hetimore janë kryer në kuadër të procedimit penal për veprat penale "Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete" dhe "Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes të të dhënave në kundërshtim me ligjin", të parashikuara përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi i tretë dhe 313/b, paragrafi i parë, të KP-së, por vetë kërkuesi, si gazetar, nuk ishte autor i dyshuar i tyre. Për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat janë bazuar në nenet 159, 297 dhe 312 të KPP-së (marrja e të dhënave nga Policia Gjyqësore dhe prokuroria sipas rregullave për marrjen e dëshmisë), si dhe në nenet 208 dhe 208/a të po këtij kodi (sekuestrimi i provave materiale dhe i të dhënave kompjuterike). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kriteri i kufizimit vetëm me ligj është i përmbushur.

55. Kriteri i dytë ka të bëjë me *interesin publik ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve*, për të cilin Gjykata ka theksuar se duhet kuptuar në varësi të situatave të ndryshme që krijohen *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka pranuar se për kufizimin e të drejtave themelore

përbën interes publik mbrojtja e rendit dhe e sigurisë publike nga veprat penale (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), sikundër administrimi i mirë i drejtësisë (*shih vendimin nr. 70, datë 27.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Në rastin konkret, Gjykata fillimisht vëren se kërkuesi ka publikuar të dhëna sekrete hetimore, të cilat pasqyrojnë biseda të transkriptuara të një të pandehuri me disa persona të tjerë në platformën e enkriptuar SkyECC, në kuadër të një procedimi penal për vepra penale të krimit të organizuar, konkretisht për 27 vepra penale të rënda kundër jetës dhe pronës nga një grup i strukturuar kriminal i përbërë nga 34 persona. Personi i pandehur i pasqyruar në këto biseda ka marrë statusin e veçantë të bashkëpunëtorit të drejtësisë, të cilit, sipas ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i garantohet jeta dhe shëndeti personal dhe i familjarëve. Në gjykim nuk u provua që kërkuesi të kishte dijeni se të dhënat e publikuara mbuloheshin nga sekreti hetimor, ndërsa subjekti i interesuar pohoi se kërkuesi nuk ishte subjekt i procedimit penal. Vetë kërkuesi ka pretenduar se qëllimi kryesor i publikimit të komunikimeve ka qenë trysnia mbi prokurorët për t'i trajtuar me seriozitet këto komunikime, të cilat përmbajnë të dhëna serioze të kriminalitetit dhe ku dyshohet se janë të përfshirë një numër i madh personash të botës së krimit dhe persona të lidhur me politikën, biznesin ose median. Sipas tij, publikimi i akteve hetimore synonte t'i tregonte organit të akuzës se informacioni disponohej edhe nga media, ndaj duhej vepruar për të vënë përpara përgjegjësisë penale çdo individ, duke luajtur media në këtë mënyrë funksionin e saj të rojtarit publik.

57. Po kështu, Gjykata vëren se në vendimet e kundërshtuara janë konsideruar si bazë ligjore nenet 208 dhe 208/a të KPP-së, që rregullojnë vetëm sekuestron provuese, pa iu referuar sekuestros preventive. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike ka pasur qëllim jo vetëm mbledhjen e provave për vërtetimin e veprës penale, por edhe parandalimin e mëtejshëm të rrjedhjes së akteve sekrete, në kuptim të identifikimit të burimit të rrjedhjes së akteve sekrete, si dhe mbrojtjen e jetës së shtetasve të tjerë (bashkëpunëtorit të drejtësisë). Një qëndrim i tillë u pohua edhe nga subjekti i interesuar në prapësimet me shkrim dhe në seancën publike.

58. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se gjatë shqyrtimit të akteve ajo nuk analizon thjesht bazën juridike të referuar, por objektin dhe përmbajtjen e tyre (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 29, datë 02.07.2021 të*

Gjykatës Kushtetuese), arrin në përfundimin se pyetja e kërkuesit për identifikimin e burimit dhe sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të tij, të cilat kanë ndërhyrë në lirinë e shtypit, kanë pasur qëllime legjitime të administrimit të mirë të drejtësisë, mbrojtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si dhe të të drejtave themelore të të tjerëve, të cilat janë vlera që duhen mbrojtur në një shoqëri demokratike. Këto kufizime, përveç mbledhjes së provave, duket se kanë synuar edhe ndalimin e rrjedhjes së informacioneve të mbuluara nga sekreti hetimor që lidhen me një hetim në proces të krimit të organizuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale ndaj bashkëpunëtorit të drejtësisë, familjarëve të tij ose personave të tjerë, të cilët vihen në dijeni të fakteve të ndryshme nga bisedat e publikuara. Në këtë rast, bëhet fjalë për interesa të cilat edhe vetë ligji i merr në mbrojtje, kur parashikon procedurat e mbrojtjes së dëshmitarit të drejtësisë, procedurat e sekretimit të akteve hetimore, rregullat për pyetjen për burimin e informacionit deri te kontrollet dhe sekuestrimin e sendeve dhe të të dhënave kompjuterike. Ashtu siç u theksua më lart, e drejta e mbrojtjes së burimit të gazetarit, pavarësisht ligjshmërisë së burimit, nuk është privilegj, por i shërben interesit publik të informimit të qytetarëve. Megjithatë kjo e drejtë mund të kufizohet për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve (*shih paragrafin 47 të vendimit*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në rastin e kërkuesit përmbushet edhe kriteri i dytë i kufizimit që ka të bëjë me qëllimin legjitim.

59. Kriteri i tretë i kufizimit ka të bëjë me *proporcionalitetin e ndërhyrjes*, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra ose mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut *(shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Edhe GJEDNJ-ja në drejtim të proporcionalitetit ka analizuar mjetet e përdorura për ndërhyrjen në lirinë e shprehjes së gazetarit, duke filluar nga

urdhri për të zbuluar burimin e informacionit, i cili jo vetëm potencialisht ka një ndikim negativ te burimi i informacionit, të cilit i zbulohet identiteti, por edhe te reputacioni i gazetarit ose i medias (*shih Sanoma Uitgevers B.V. kundër Hollandës [DhM], datë 27.11.2007, § 89*); kontrolli i vendeve dhe sekuestrimi, si një masë më drastike, pasi aksesohet në mënyrë të plotë në të gjitha dokumentet e gazetarit (*shih Roemen dhe Schmit kundër Luksemburgut, datë 25.02.2003, § 57*); vendosja nën mbikëqyrje e gazetarit, nëse ajo miratohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor përpara vendosjen nën mbikqyrje ose pas (*shih Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerë kundër Hollandës, datë 22.11.2012, §§ 97, 98*); dhe detyrimi për të dëshmuar në kuadër të një procesi penal, nëse justifikohet nga interesi publik (*shih Becker kundër Norvegjisë, datë 05.10.2017, § 83*).

61. Po kështu, GJEDNJ-ja ka vendosur në disa raste se kontrolli i kryer me qëllim zbulimin e burimit të një gazetari është një masë më drastike se sa urdhri për të zbuluar identitetin e burimit. Kjo për shkak se hetuesit që kontrollojnë vendin e punës së një gazetari pa paralajmërim dhe të pajisur me urdhër sekuestrimi kanë kompetenca shumë të gjera hetimore, pasi kanë akses në të gjithë dokumentacionin e mbajtur nga gazetari *(shih Roemen dhe Schmit kundër Luksemburgut, datë 25.02.2003, § 57; Ernst dhe të tjerët kundër Belgjikës, datë 15.07.2003, § 103*). Në një rast GJEDNJ-ja është shprehur se kontrolli i kryer në ambientet profesionale të gazetarëve, kopjimi në disqe të jashtme të të gjithë përmbajtjes së kompjuterëve tyre dhe mbajtja e këtyre disqeve nga prokuroria kërcënonte mbrojtjen e burimeve në një shkallë të lartë. Marrja pa dallim e të gjitha të dhënave në paketat *software* u kishte mundësuar autoriteteve të mblidhnin informacione që nuk kishin lidhje me rastin në fjalë *(shih Görmüş dhe të tjerët kundër Turqisë, datë 19.01.2016, § 73*).

62. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata fillimisht vëren se rregullat procedurale penale për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike janë shtuar në KPP në vitin 2008 dhe nuk kanë pësuar ndryshime të tjera, pavarësisht zhvillimit të vrullshëm që ka njohur teknologjia e informacionit. Ndonëse ligjvënësi nuk ka ndërhyrë, përmbajtja e dispozitave procedurale penale është zhvilluar nga Gjykata e Lartë me anë të vendimit njësues nr. 147/2021, në të cilin janë përcaktuar kritere të detajuara për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike, kritere që janë në një linjë me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira në këtë drejtim. Po kështu, subjekti i interesuar shpjegoi në seancë plenare se Prokuroria e Posaçme vepron në praktikë, duke iu referuar procedurave standarde të

ekzaminimit kompjuterik të Policisë Shkencore, udhëzimit të INTERPOL-it, si dhe disa guidave dhe udhëzuesve të Këshillit të Evropës. Në këtë pikë, ndonëse vjetrimi i normës nuk përbën *per se* shkak për cenimin e të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 69, datë 27.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata sjell në vëmendje nevojën e përditësimit në të ardhmen nga ligjvënësi të rregullave ligjore që lidhen me procedurën e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, të cilat duhet t'u përgjigjen si duhet zhvillimeve aktuale të teknologjisë së informacionit, nevojës për hetime efektive, por mbi të gjitha mbrojtjes efektive të lirive themelore të individit. Kjo me qëllim garantimin e një kornize ligjore të qartë dhe të saktë për administrimin dhe përpunimin e të dhënave elektronike të marra gjatë sekuestrimit të tyre.

63. Në vijim të analizës së kriterit të proporcionalitetit, Gjykata, duke u bazuar në standardet kushtetuese dhe konventore, do të shqyrtojë nëse ndërhyrja në lirinë e shtypit dhe të drejtën e kërkuesit për të mbrojtur burimet e tij ka qenë mjeti i fundit dhe i vetëm në dispozicion të prokurorisë dhe gjykatave të zakonshme, si dhe nëse qëllimi legjitim i ndërhyrjes ka qenë mbizotërues. Për qëllime të kësaj analize, Gjykata do të verifikojë detyrimet e përcaktuara nga ligji për organin procedues dhe se si janë zbatuar ato në rastin konkret.

64. Veprimet e prokurorisë për të verifikuar të dhënat nga kërkuesi, në cilësinë e gazetarit profesionist, bazohen në nenet 159, 297 dhe 312 të KPP-së, sipas të cilave Policia Gjyqësore ose prokurori mund të marrin të dhëna nga gazetari profesionist për burimin e informacionit, nëse ato (të dhënat) janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e tyre mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, është e qartë që ligjvënësi ka zbatuar parimin e proporcionalitetit në ndërhyrjen e së drejtës për të mos treguar burimin e gazetarit, pasi ka vënë theksin jo vetëm te domosdoshmëria, por edhe te fakti që identifikimi i burimit është mjeti i vetëm për të provuar faktet penale.

65. Nën këtë optikë, Gjykata evidenton se në datat 10.12.2023 dhe 11.12.2023 kërkuesi ka publikuar artikuj, në të cilat pasqyroheshin të dhëna që u përkisnin akteve të hetimit paraprak të prokurorisë. Në datën 11.12.2023, prokuroria regjistroi procedimin penal dhe të nesërmen, më 13.12.2023, ora 11:00, kërkuesi është thirrur në Prokurorinë e Posaçme ku fillimisht ka nënshkruar një deklaratë për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimeve të akteve sekrete ose të dhënave që përmbanin këto akte

që i përkasin procedimit penal nr. 75/2022, detyrim të cilin ai e ka pohuar në seancën plenare se e ka respektuar dhe që nuk është kundërshtuar nga subjekti i interesuar. Ndërkohë, po në datën 13.12.2023, ora 15:15, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka miratuar kërkesën e prokurorit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, vendim i cili është ekzekutuar në orën 20:20 (në prani të kërkuesit) në banesë dhe në orën 22:30 në vendin e punës. Ndërkohë, nga të dhënat bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se kërkuesi ka qëndruar në Prokurorinë e Posaçme deri rreth orës 18:00. Ndërsa me urdhrin e datës 14.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka urdhëruar kërkuesin për ruajtjen e sekretit, ndalimin e publikimit të akteve dhe përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit dhe informacionit masiv për sa i përket procedimit penal nr. 75/2022 dhe se në rast moszbatimi ai do të mbante përgjegjësi penale, sipas nenit 295/a, paragrafët 4 dhe 5, të KP-së.

66. Pa pritur efektet e urdhrit për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit të akteve, dhe pa pasur ndonjë indicie që ky urdhër nuk do të zbatohej nga kërkuesi në cilësinë e gazetarit, prokuroria brenda pak orësh ka paraqitur në gjykatë kërkesat për kontrolle dhe sekuestrim të sendeve dhe provave materiale, kërkesa të cilat janë pranuar.

67. Në vlerësimin e Gjykatës dhe duke mbajtur në konsideratë qëllimet legjitime të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike (*shih paragrafin 58 të vendimit*), kjo mënyrë veprimi e organit procedues (prokurorisë dhe gjykatave) nuk ka qenë në përpjestim të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë. Kështu, për sa i takon qëllimit legjitim të parandalimit të rrjedhjes së informacionit dhe të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të bashkëpunëtorit të drejtësisë (qëllimi i sekuestros preventive), duket që prokuroria dhe gjykatat e zakonshme kanë vepruar pa pritur efektet e urdhrit të sekretit hetimor, dhe për rrjedhojë edhe pa analizuar përse ishte e nevojshme të përdorej me urgjencë mjeti i fundit, ai i sekuestrimit. Po ashtu, për sa i takon qëllimit legjitim të vërtetimit të veprave penale që po hetoheshin (sekuestro provuese), gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar se përse marrja e të dhënave të nevojshme për hetimin mund të realizohej vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit të gazetarit, si mjet i fundit dhe i vetëm, pra përse nuk ekzistonin mjete të tjera alternative për të arritur qëllimin provues të sekuestros. Gjithashtu, nga përmbajtja e këtyre vendimeve, nuk rezulton e pasqyruar as analiza e urgjencës në sekuestrimin e të dhënave kompjuterike të kërkuesit. Për më tepër, vetë kërkuesi nuk rezulton të ishte subjekt i procedimit penal, siç u pohua shprehimisht nga subjekti i interesuar në seancë plenare. Me fjalë të tjera, gjykatat e zakonshme nuk kanë mbajtur

në konsideratë se e drejta e mbrojtjes së burimeve të gazetarit nuk është thjesht një privilegj për t'u dhënë ose hequr në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë përbërëse e së drejtës për informacion, që duhet trajtuar me kujdesin më të madh dhe se urdhri për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike potencialisht ka pasur ndikim të dëmshëm jo vetëm për kërkuesin dhe burimet e tij, por edhe për median në tërësi.

68. Për sa më lart, Gjykata çmon se gjatë gjykimit, nuk u arrit të provohej se prokuroria ka ndërmarrë veprime të tjera hetimore të mjaftueshme për zbulimin e autorëve të dyshuar të veprave penale, të cilët, referuar veprave penale, janë subjekte të posaçme, prokurori ose oficeri i Policisë Gjyqësore ose zyrtarë të tjerë me akses në aktet sekrete të hetimit. Për këta të fundit nuk u tregua që, përpara kryerjes së veprimeve hetimore ndaj kërkuesit, të ishin kryer veprime hetimore. Nga ana tjetër, ndonëse prokuroria dhe gjykatat e zakonshme kanë vepruar ndaj kërkuesit brenda 24 orëve, prokurorët e çështjes janë ndërruar pas 8 muajve të hetimeve paraprake. Po kështu, Gjykata mban në vëmendje edhe faktin se, sikurse është pohuar nga subjekti i interesuar në seancën publike të datës 02.04.2025, hetimet për këto vepra penale (nenet 295/a dhe 312 të KP-së) ende nuk kanë përfunduar. Kohëzgjatja e hetimeve për pothuajse një vit e gjysmë në raport me urgjencën prej 24 orësh të kryerjes së veprimeve ndërhyrëse në burimet e informacionit të kërkuesit është tregues i qartë se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të tij nuk ka qenë mjeti i fundit hetimor, por ndër të parat për të kërkuar burimin e zbulimit të akteve sekrete hetimore.

69. Nga ana tjetër, për sa i përket mënyrës së aksesimit në të dhënat kompjuterike të sekuestruara, kërkuesi u shpreh se i ka mundësuar hetuesve që të zbulojnë burimet dhe të hyjnë pa kriter në të gjithë të dhënat, pa pasur garanci mbrojtëse të burimeve të gazetarit dhe të sinjalizuesve, përfshirë mungesën e mbrojtësit. Ndërsa subjekti i interesuar ka sqaruar se në funksion të këqyrjes janë hapur në mënyrë elektronike të dhënat dhe më pas është vijuar me këqyrjen e tyre, ku janë përdorur për analizimin mundësitë që ofron programi i aksesimit të të dhënave. Këto veprime janë kryer pa praninë e avokatit të kërkuesit, por edhe vetë prokurori nuk ka qenë i pranishëm. Sipas subjektit të interesuar, të dhënat nuk mund të kërkohen vetëm me fjalë kyçe për vetë aspektin teknik, pasi ka të dhëna elektronike të cilat nuk janë të kërkueshme, si fotografitë, komunikimet e koduara ose dokumente të formatit "pdf". Për këtë shkak, e vetmja mënyrë, sipas subjektit të interesuar, është analiza e përmbajtjes së këtyre

të dhënave, duke evidentuar vetëm ato raste kur gjenden të dhënat me interes në funksion të hetimeve. Po kështu, ky subjekt ka sqaruar se të dhënat janë nxjerrë dhe janë kopjuar në një *hard disk* të jashtëm që i është bashkëlidhur akteve të ekspertimit.

70. Në lidhje me sa më sipër, ndonëse nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara rezulton se është urdhëruar ruajtja dhe sekuestrimi vetëm i atyre të dhënave të cilat lidhen me veprat penale për të cilat po hetohet, ky fakt nuk përjashton cenimin e lirisë së shprehjes së kërkuesit, si masë e fundit. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se pavarësisht deklarimeve të subjektit të interesuar (si në parashtrime, ashtu edhe gjatë seancës plenare), për mënyrën e këqyrjes të të dhënave kompjuterike, kërkuesit nuk i janë ofruar garancitë e nevojshme kushtetuese dhe konventore, me natyrë procedurale, për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe ruajtjen e burimeve të tjera të informacionit, ose materialeve konfidenciale, të cilat nuk lidhen me hetimin në fjalë, duke sjellë, për pasojë, shkeljen e kësaj lirie.

71. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së shprehjes është i bazuar, prandaj vendimet objekt shqyrtimi duhen shfuqizuar.

72. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin e tij, për sa kohë ajo gjeti shkelje në lirinë e shprehjes së kërkuesit, duke shfuqizuar vendimet e mësipërme.

73. Për sa i përket kërkesës për shkatërrimin e të gjitha kopjeve të imazheve të kopjuara, të të dhënave kompjuterike, kërkuesi ka pretenduar marrjen e masave deri në shkatërrimin e plotë të të gjitha kopjeve të imazheve të hard disqeve të kompjuterëve dhe USB-ve, ndalimin e çdo aksesimi eventual, kryerjen e çdo procedure filtrimi dhe/ose përzgjedhjeje të të dhënave, si dhe nxjerrjes së kopjeve të tjera. Për sa i përket kësaj kërkese, bazuar në gjetjen e mësipërme për konstatimin si të bazuar të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e lirisë së shprehjes, Gjykata çmon se pretendimi për shkatërrimin e kopjeve të imazheve është i bazuar, ndaj kërkesa pranohet. Për rrjedhojë, Gjykata urdhëron asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara në provat materiale të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës dhe vendit të punës së kërkuesit.

74. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 501, datë 13.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 04 (87-2024-9), datë 06.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nr. 00-2024-255 (36), datë 20.02.2024 të Gjykatës së Lartë.

3. Asgjësimin e të dhënave kompjuterike të sekuestruara me vendimet e mësipërme, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.04.2025
Shpallur më 21.05.2025

Vendim nr. 22, datë 23.04.2025
(V-22/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 27.03.2025 dhe 23.04.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (GJ) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Genci Gjonçaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Engjëll Agaçi.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar nga kryetari Ilir Rusi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Neni 145, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*) e Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. KLGJ-ja, me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë.

2. Në datën 05.12.2022 një gjyqtar që ushtronte detyrën në një nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (*gjyqtari kandidat*), ka paraqitur pranë KLGJ-së kërkesë për të kandiduar në pozicionin e shpallur. Në zbatim të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*), KLGJ-ja ka filluar procedurën e verifikimit të plotësimit nga gjyqtari kandidat të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë, përfshirë edhe të kushteve dhe kritereve shtesë të sigurisë të përcaktuara në ligjin nr. 95/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar (*ligji nr. 95/2016*). Dokumentacioni i paraqitur nga gjyqtari kandidat në lidhje me kriteret e pasurisë, figurës dhe atyre shtesë të sigurisë i është përcjellë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës (*Komisioni i Posaçëm i Verifikimit*). Ky komision është ngritur sipas ligjit nr. 95/2016 pas përfundimit të periudhës kalimtare 4-vjeçare të parashikuar nga neni 57 i këtij ligji, kohë të në cilën funksioni i kontrollit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme dhe familjarëve të afërt të tyre është kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit 179/b të Kushtetutës.

3. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, pasi ka marrë informacione nga institucionet shtetërore përkatëse, në funksion të verifikimit të kushteve

të sigurisë, në datën 24.07.2024 ka përpiluar një raport të hollësishëm për ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës së gjyqtarit kandidat *(raporti i verifikimit).* Në raport është konkluduar se gjyqtari kandidat nuk plotëson kushtet e sigurisë, të parashikuara në nenin 6, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 95/2016. Raporti i verifikimit në vijim i është dorëzuar institucionit të emërtesës, KLGJ-së.

4. Gjatë vijimit të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë, KLGJ-ja ka njohur gjyqtarin kandidat me raportin e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit. Duke mos qenë dakord me gjetjet dhe konkluzionin e këtij raporti, gjyqtari kandidat e ka kundërshtuar atë gjyqësisht, duke ngritur padi në gjykatën referuese, përpara së cilës ka kërkuar, ndër të tjera, edhe pezullimin e shqyrtimit gjyqësor dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për t'u shprehur për antikushtetutshmërinë e pikave 5 dhe 6, të nenit 6, të ligjit nr. 95/2016. Çështja është regjistruar në atë gjykatë në datën 12.08.2024. Mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit kandidat për përshpejtimin e gjykimit me argumentin se zgjidhja e shpejtë e çështjes i hap rrugën KLGJ-së të vijojë procedurën e ngritjes në detyrë, gjykata referuese ka caktuar seancën përgatitore në datën 23.09.2024. Në këtë seancë, bazuar në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, gjykata referuese ka vendosur të parashtrojë para Gjykatës çështjen e kushtetutshmërisë së pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016, duke pezulluar gjykimin që po zhvillonte.

5. Pika 5 e nenit 6 të ligjit nr. 95/2016 (*dispozita e kundërshtuar*), parashikon se: "*Gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit krijojnë Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, të përbërë nga: a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit; b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit; c) një punonjës i seksionit të hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme; ç) një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i caktuar nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.".*

6. Kolegji i Gjykatës, në datën 21.11.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Gjykata, në seancën plenare të datës 27.03.2025, ka vendosur thirrjen si subjekt

të interesuar në këtë proces edhe të KLGJ-së, duke shtyrë shqyrtimin e çështjes për në datën 23.04.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Gjykata referuese***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se dispozita e kundërshtuar ka cenuar Preambulën e Kushtetutës, si dhe nenet 4, 7 dhe 138 të saj, në drejtim të:

7.1. *Parimit të shtetit të së drejtës të lidhur me pavarësinë e brendshme organizative të pushtetit gjyqësor,* pasi garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen me emërimin e drejtë, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë nga detyra, si dhe sigurimin e përfitimeve financiare. Pavarësia e pushtetit gjyqësor është thelbësore për ruajtjen e një sistemi drejtësie funksional dhe të besueshëm, që ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe në sigurimin e një shoqërie të drejtë.

7.2. *Parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve*, i cili gjen zbatim edhe në mekanizmat e tjerë kushtetues që ushtrojnë funksione kushtetuese, sipas rastit, në mënyrë të pavarur ose si ndërthurje të kompetencave të institucioneve të tjera kushtetuese. Në rastin konkret mungon balanca ligjore në përcaktimin e strukturave përfaqësuese në Komisionin e Posaçëm të Verifikimit, pasi numri i gjyqtarëve të posaçëm anëtarë është parashikuar të jetë më i vogël se numri i prokurorëve të posaçëm, për më tepër që Prokuroria e Posaçme ka një anëtar shtesë të seksionit të hetimit financiar, ndërkohë që edhe Byroja Kombëtare e Hetimit (*BKH*), organ në varësi të saj, ka një anëtar.

7.3. *Parimit të sigurisë juridike,* pasi karriera e gjyqtarit është një nga përfitimet e njohura me Kushtetutë, që duhet të garantohet nëpërmjet mekanizmave dhe procedurave që parashikohen nga ligji. Një proces transparent dhe i drejtë emërimi, i bazuar në merita, ndihmon në sigurimin e një gjyqësori të pavarur dhe profesional që respekton parimin e sigurisë për të drejtat e individëve.

8. ***Subjekti i interesuar***, ***Kuvendi***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1. Gjykata referuese *nuk përmbush kriteret e legjitimimit,* pasi nuk ka analizuar në mënyrë shteruese se përse procesi para saj nuk

mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues dhe as mekanizmin e brendshëm të funksionimit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të lidhur me rolin e secilit anëtar në procesin kolegjial të vendimmarrjes.

8.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës të lidhur me pavarësinë e brendshme organizative të pushtetit gjyqësor* nuk qëndron, sepse dispozita e kundërshtuar garanton pavarësinë institucionale, barazinë, meritokracinë dhe funksionimin efikas të institucioneve të drejtësisë dhe është në përputhje me nenin 135, pika 4, të Kushtetutës. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe hetuesit e BKH-së përfaqësojnë shtyllat e institucioneve më të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe prania e tyre garanton që procesi të kryhet nga profesionistë të kualifikuar dhe të paanshëm.

8.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve* është i pabazuar, pasi neni 7 i Kushtetutës nuk përjashton bashkëpunimin institucional për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit. Përfaqësuesit nga strukturat e posaçme kanë ekspertizën e duhur për të zbuluar fshehjen e pasurisë, konfliktet e interesit dhe lidhjet korruptive, duke siguruar që procesi të jetë rigoroz dhe i drejtë, ndaj përfshirja e tyre garanton një sistem drejtësie të pavarur dhe me integritet.

8.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi Komisioni i Posaçëm i Verifikimit nxjerr një raport që përmbledh të dhëna dhe analizon gjetjet nga institucionet e sigurisë dhe autoritetet ligjzbatuese në lidhje me figurën dhe burimet e pasurisë së kandidatit. Raporti është akt verifikues që buron nga natyra specifike e komisionit dhe nuk është akt emërtese që sjell pasoja të menjëhershme juridike për kandidatin në drejtim të emërimit ose shkarkimit nga detyra, pasi kjo detyrë i takon KLGJ-së.

9. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

9.1. Gjykata referuese *nuk plotëson kriteret e legjitimimit* për të kundërshtuar dispozitën objekt shqyrtimi, pasi formulimi i saj është një zgjidhje ligjore që përfshihet brenda hapësirës së pushtetit ligjvënës të Kuvendit. Gjykata referuese nuk mund të kërkojë interpretimin e normës ligjore, pasi kjo është detyrë e saj

dhe jo e Gjykatës, e cila interpreton vetëm Kushtetutën. Gjykata referuese nuk ka identifikuar ligjin e zbatueshëm dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të tij me gjykimin që ajo po zhvillon, nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar normën ligjore në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e saj. Gjykata referuese e ka paragjykuar dispozitën kushtetuese pa bërë interpretimin kushtetues të saj në raport me qëllimin e ligjvënësit.

9.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës të lidhur me pavarësinë e brendshme organizative të pushtetit gjyqësor* nuk qëndron, pasi Komisioni i Posaçëm i Verifikimit nuk cenon kompetencat e KLGJ-së, që është organi i vetëm me kompetencë për emërimin e gjyqtarëve. Procesi i verifikimit nuk kufizon të drejtën e KLGJ-së për të vlerësuar individualisht secilin kandidat dhe për të vendosur nëse ai i plotëson kriteret e emërimit.

9.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve* është i pabazuar, pasi përbërja e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit siguron ekuilibër funksional dhe nuk ka disproporcion dominues të përfaqësuesve ndaj njëri-tjetrit. Dy prokurorët dhe një gjyqtar janë përfaqësues të funksioneve të drejtësisë, ndërsa përfaqësuesit e BKH-së dhe seksionit financiar janë teknikë dhe mbështesin procesin pa rol vendimmarrës dominant. Detyrat e prokurorëve janë të kufizuara në verifikimin e aspekteve teknike dhe ligjore të kandidatëve dhe ata nuk kanë fuqi të vendosin në mënyrë të pavarur nga anëtarët e tjerë, pasi roli i tyre është i integruar në procesin kolegjial të vendimmarrjes.

9.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi gjykata referuese nuk ka evidentuar dallimin midis procesit të verifikimit teknik që kryen Komisioni i Posaçëm i Verifikimit me procesin përfundimtar të vendimmarrjes që kryen KLGJ-ja, duke ngatërruar kompetencat ndihmëse me ato vendimmarrëse. Raporti i atij komisioni është dokument ndihmës që i përcillet KLGJ-së për të mbështetur procesin e emërimit.

10. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja***, ka informuar se ushtron veprimtarinë sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjeve organike që rregullojnë funksionimin dhe kompetencat e saj institucionale, pa mbajtur qëndrim për kërkesën e paraqitur.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e gjykatës referuese

11. Nenet 134, pika 1, shkronja "dh" dhe 145, pika 2, të Kushtetutës parashikojnë se Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka pohuar se kërkesa për kontroll incidental përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues dhe rregullohet nga neni 145, pika 2, i Kushtetutës, sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tyre. Objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 7, datë 01.03.2022; nr. 22, datë 11.04.2016; nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, gjykata referuese ka pezulluar gjykimin dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatë, duke parashtruar se pika 5 e nenit 6 të ligjit nr. 95/2016 cenon parimet e shtetit të së drejtës të lidhura me pavarësinë e brendshme organizative të pushtetit gjyqësor, ndarjen dhe balancimin e pushteteve, si dhe sigurinë juridike, të garantuara nga nenet 4, 7 dhe 138 të Kushtetutës. Nga pikëpamja formale, gjykata referuese ka formuluar objektin dhe dispozitivin e vendimit duke kërkuar interpretimin e kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore të kundërshtuar, ndërsa në përmbajtje ka parashtruar argumentet se dispozita cenon parimet kushtetuese të lidhura me pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

13. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkimi i gjykatës referuese është i paqartë, gjë e cila duket në objektin dhe dispozitivin e vendimit, sepse ajo ka kërkuar interpretimin e normës ligjore, që është detyrë e saj, ndërsa detyra e Gjykatës është interpretimi i Kushtetutës.

14. Gjykata ka pohuar se, si rregull, në rastin e kontrollit incidental kërkesat duhet të jenë të qarta dhe të sakta nga pikëpamja formale, në kushtet kur ky lloj kontrolli vihet në lëvizje nga gjykatat, të cilat janë organizuar dhe funksionojnë bazuar në parimin e profesionalizmit (*nenet 135-136/a të Kushtetutës*). Megjithatë, përtej mënyrës së formulimit të kërkimit, nëse kërkesa ka si bazë juridike të objektit nenin 145 të Kushtetutës dhe në përmbajtje parashtrohen argumente për antikushtetutshmërinë e dispozitës

së kundërshtuar, kërkesa i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimin nr. 15, datë 22.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se, përtej mënyrës së formulimit të kërkimit të parashtruar nga gjykata referuese në objektin dhe dispozitivin e vendimit, kërkesa në objektin e saj paraqet si bazë juridike nenin 145 të Kushtetutës dhe në përmbajtje parashtrohen argumente për antikushtetutshmërinë e pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se, në ndryshim nga sa prapëson subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, gjykata referuese ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës së kundërshtuar, ndaj në vijim do të analizojë legjitimimin e saj.

16. Gjykata ka zhvilluar disa kritere kumulative për legjitimimin e gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas tyre, gjykata referuese duhet që gjatë gjykimit që zhvillohet pranë saj: (i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatë - pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; (ii) të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 8, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë kundërshtuar legjitimimin e gjykatës referuese, duke parashtruar se ajo nuk ka analizuar në mënyrë shteruese se përse procesi para saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues dhe as mekanizmin e brendshëm të funksionimit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të lidhur me rolin e secilit anëtar në procesin kolegjial të vendimmarrjes. Formulimi i dispozitës është një zgjidhje ligjore që përfshihet brenda hapësirës së pushtetit ligjvënës të Kuvendit. Sipas tyre, gjykata referuese nuk ka identifikuar ligjin e zbatueshëm dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të tij me gjykimin që ajo po zhvillon, nuk ka parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e dispozitës në fjalë dhe nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar normën ligjore në përputhje me Kushtetutën. Po kështu, sipas subjekteve të interesuara, gjykata referuese e ka cilësuar normën si të papajtueshme me Kushtetutën, duke e paragjykuar atë,

ndërkohë që nuk e ka interpretuar sipas qëllimit dhe arsyeve të ligjvënësit për miratimin e saj.

18. Për sa i takon kriterit *për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes*, Gjykata rithekson se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar për gjykimin pranë saj, duke e identifikuar si të zbatueshme për rastin konkret. Ky kriter nuk konsiderohet i plotësuar thjesht me paraqitjen e dispozitës ligjore formalisht në kërkesë, pasi ajo duhet të jetë individualizuar se zgjidh mosmarrëveshjen konkrete pranë gjykatës referuese. Dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje në atë masë që gjykimi nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e saj (*shih vendimet nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 30, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, gjykimi që po zhvillon gjykata referuese ka të bëjë me padinë e gjyqtarit kandidat për ngritjen në detyrë në gjykatën e posaçme, me të cilën është kundërshtuar raporti i verifikimit të pasurisë dhe figurës i administruar në procedurën që KLGJ-ja po zhvillon për plotësimin e pozicionit të lirë në atë gjykatë. Raporti është hartuar nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit i përbërë nga 5 anëtarë: 1 gjyqtar i gjykatës së posaçme; 2 prokurorë të posaçëm - njëri prej të cilëve me cilësinë e kryetarit të komisionit; 1 hetues i BKH-së - në cilësinë e relatorit të çështjes; 1 oficer i Policisë Gjyqësore Financiare - në cilësinë e sekretarit të komisionit. Në mbledhjen e datës 24.07.2024, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, pasi ka shqyrtuar materialet e mbledhura gjatë verifikimit, ka miratuar unanimisht raportin me konkluzionin se gjyqtari kandidat nuk plotësonte kushtet e sigurisë, të parashikuara në nenin 6, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 95/2016, dhe së bashku me dosjen e kandidatit, raportin ia ka përcjellë organit të emërtesës, KLGJ-së.

20. Gjykata vëren se çështja kushtetuese e parashtruar nga gjykata referuese lidhet me argumentin se përbërja e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit, e parashikuar në nenin 6, pika 5, të ligjit nr. 95/2016, cenon parimet kushtetuese. Sipas gjykatës referuese, përmbajtja e kësaj dispozite ligjore e pengon atë të shprehet për themelin e padisë për kundërshtimin e raportit të verifikimit, në kushtet kur vetë raporti është rrjedhojë e vendimmarrjes së Komisionit të Posaçëm të Verifikimit.

21. Për sa më lart, Gjykata çmon se përmbushet kriteri i identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë të tij me gjykimin në gjykatën referuese.

22. Në lidhje me kriterin për *parashtrimin e arsyeve të rëndësishme të antikushtetutshmërisë*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të legjitimimit për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues është po aq e rëndësishme që gjykata referuese të arsyetojë për parametrat kushtetues të referuar si të cenuar nga dispozita e kundërshtuar. Gjykata në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Për këtë arsye, lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese *(shih vendimet nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 5, datë 27.01.2017; nr. 52, datë 26.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin në shqyrtim, gjykata referuese ka parashtruar se përbërja e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit ka cenuar parimet kushtetuese që lidhen me shtetin e së drejtës, pavarësinë e brendshme organizative të pushtetit gjyqësor, ndarjen dhe balancimin e pushteteve, si dhe sigurinë juridike, të garantuara nga nenet 4, 7 dhe 138 të Kushtetutës. Sipas saj, ligjvënësi nuk ka vendosur një balancë në përcaktimin e strukturave përfaqësuese në këtë Komision, pasi numri i gjyqtarëve të posaçëm anëtarë është parashikuar të jetë më i vogël se numri i prokurorëve të posaçëm, për më tepër që Prokuroria e Posaçme ka një anëtar shtesë, atë të seksionit të hetimit financiar, ndërkohë që edhe BKH-ja, organ në varësi të saj, ka një anëtar. Parimi i ndarjes së pushteteve, sipas gjykatës referuese, duhet të gjejë zbatim jo vetëm në kuadër të mekanizmave ose institucioneve që veprojnë në një prej tre degëve kryesore të pushtetit shtetëror, por edhe në mekanizma të tjerë kushtetues që ushtrojnë funksionet e tyre kushtetuese sipas rastit në mënyrë të pavarur ose si ndërthurje të kompetencave të institucioneve të tjera kushtetuese. Sipas gjykatës referuese, garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen me emërimin e drejtë, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë nga detyra, si dhe sigurimin e përfitimeve financiare. Pavarësia e pushtetit gjyqësor është thelbësore për ruajtjen e një sistemi të drejtësisë, funksional dhe të besueshëm, që ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe në sigurimin e një shoqërie të drejtë. Gjithashtu, sipas gjykatës referuese, karriera e gjyqtarit është një nga përfitimet që Kushtetuta i njeh atij dhe që i garantohet nëpërmjet mekanizmave dhe procedurave që parashikohen nga ligji. Një proces transparent dhe i drejtë emërimi, i bazuar në merita, ndihmon në sigurimin e një gjyqësori të pavarur dhe profesional që respekton parimin e sigurisë për të drejtat e individëve.

24. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se dispozita e kundërshtuar garanton pavarësinë institucionale, barazinë, meritokracinë dhe funksionimin efikas të institucioneve të drejtësisë dhe është në përputhje me nenin 135, pika 4, të Kushtetutës. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe hetuesit e BKH-së përfaqësojnë shtyllat e institucioneve më të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas tyre, anëtarët në fjalë kanë ekspertizën e duhur për të zbuluar fshehjen e pasurisë, konfliktet e interesit dhe lidhjet korruptive, duke siguruar që procesi të jetë rigoroz dhe i drejtë, ndaj përfshirja e tyre garanton një sistem drejtësie të pavarur dhe me integritet. Po kështu, subjektet e interesuara kanë prapësuar se Komisioni i Posaçëm i Verifikimit nxjerr një raport me natyrë teknike, që përmbledh të dhëna dhe analizon gjetjet nga institucionet e sigurisë dhe autoritetet ligjzbatuese në lidhje me figurën dhe burimet e pasurisë së kandidatit. Raporti, sipas subjekteve të interesuara, është akt verifikues që buron nga natyra specifike e komisionit dhe nuk është një akt emërtese që sjell pasoja të menjëhershme juridike për kandidatin në drejtim të emërimit ose shkarkimit nga detyra, pasi kjo detyrë i takon KLGJ-së.

25. Kushtetuta në nenin 7 parashikon se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushteti gjyqësor, sipas nenit 135, pika 1, të Kushtetutës, ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Neni 136/a i Kushtetutës parashikon se gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga KLGJ-ja, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. Kompetenca e KLGJ-së për emërimin e gjyqtarëve konfirmohet edhe në nenin 147/a, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, sipas të cilit KLGJ-ja ushtron funksionin e emërimit, ngritjes në detyrë dhe transferimit të gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Kurse neni 138 i Kushtetutës garanton se paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve të parashikuara prej saj.

26. Vetë Kushtetuta ka krijuar edhe gjykatat e posaçme, të cilat kanë kompetencën për të gjykuar veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër funksionarëve të lartë publikë, të listuara shprehimisht në nenin 135, pika 2, të saj. Në pikën 4 të nenit 135 përcaktohet se gjyqtarët e gjykatave të posaçme emërohen nga KLGJ-ja dhe se kandidatët për gjyqtarë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e

afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

27. Për sa i përket KLGJ-së, neni 147, pika 1, i Kushtetutës përcakton se ajo është përgjegjëse për pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që sipas pikës 2 të kësaj dispozite, KLGJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë.

28. Lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të garantuar nga neni 7 i Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 24, datë 09.06.2011; nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 2, datë 18.01.2017; nr. 43, datë 26.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndarja e pushteteve nuk është gjë tjetër, në thelbin e vet, veçse ndarje kompetencash. Kompetenca është tagra që i jepet juridikisht një organi ose një pushteti për të vendosur për çështje të caktuara (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Po kështu, Gjykata ka pranuar se vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo pavarësi, e parë në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, nuk është privilegj, por një nga detyrimet më të rëndësishme të gjyqtarëve dhe gjykatave, që buron nga të drejtat e garantuara kushtetutshmërisht individit që pretendon cenimin e të drejtave dhe lirive të tij, për të pasur një arbitër të paanshëm të mosmarrëveshjes, që do ta zgjidhë atë në themel sipas Kushtetutës dhe ligjeve. Nën frymën e dispozitave të Kushtetutës për pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, elementet e pavarësisë, të cilat në thelb prekin vetë funksionin e dhënies së drejtësisë

nuk duhet të cenohen (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Pavarësia e gjyqësorit ka dy komponentë realë të saj që janë paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit (me dallimet përkatëse mes tyre). Pavarësia nënkupton jo vetëm një qëndrim të caktuar ndaj ushtrimit të funksionit gjyqësor, por një pozitë ose marrëdhënie në raport me të tjerët që bazohet në ekzistencën e kushteve dhe garancive objektive (*shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancitë ligjore, ku përfshihen sistemi i emërimit, pagës, karrierës, shkarkimit dhe trajtimit të posaçëm sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve në ushtrim të funksionit të tyre (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe duke theksuar se kompetenca kushtetuese e emërimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve i përket KLGJ-së, Gjykata do të ndalet fillimisht në analizën e natyrës së veprimtarisë dhe rolit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit, nëse një veprimtari e tillë prek sferën e kompetencës kushtetuese të KLGJ-së për ngritjen në detyrë/emërimin e gjyqtarëve në gjykatat e posaçme, për t'iu përgjigjur më pas pyetjes kryesore nëse formula e përbërjes së tij cenon parimet kushtetuese të evidentuara nga gjykata referuese, të cilat në thelb lidhen me pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

31. Gjykata vëren se ligji nr. 95/2016 ka si objekt të tij, ndër të tjera, përcaktimin e kushteve dhe kritereve shtesë të sigurisë që duhet të përmbushin gjyqtarët për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë pranë gjykatave të posaçme dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe të telekomunikacioneve, ndër të tjerë, edhe të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre (*neni 1*). Sipas nenit 6, pika 1, të ligjit, kandidati për gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet në këtë pozicion dhe asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë pa plotësuar këto kushte. Në shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike parashikohet se kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë janë kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës, dhënia e pëlqimit nga kandidati për kontrollin periodik të llogarive të tij bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilin ai plotëson dhe nënshkruan një deklaratë standarde me shkrim, si dhe dhënia e pëlqimit nga anëtarët e afërt të familjes së kandidatit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilin ata plotësojnë dhe

nënshkruajnë një deklaratë standarde me shkrim. Verifikimi i kushteve të sigurisë kryhet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, i cili përbëhet nga anëtarë të caktuar nga gjykatat e posaçme, Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja (*pika 5 po aty*). Konkretisht, gjykatat e posaçme zgjedhin me short 1 gjyqtar; Prokuroria e Posaçme zgjedh me short 2 prokurorë. Këta tre anëtarë zgjidhen nën monitorimin e Avokatit të Popullit. Po kështu, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme cakton 1 punonjës të seksionit të hetimit financiar dhe drejtori i BKH-së cakton 1 hetues.

32. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, pasi merr nga institucionet përkatëse të emërtesës deklaratat, kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën dhe i dorëzon institucionit të emërtesës një raport të hollësishëm për ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidatët ose institucionet shtetërore, të cilat bëhen pjesë e dosjes së kandidatit, sipas legjislacionit në fuqi. Po kështu, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, përveç dokumentacionit të paraqitur nga vetë kandidatët, mund të kërkojë të dhëna ose informacione zyrtare nga çdo institucion shtetëror që ka në objektin e ligjshëm të veprimtarisë hetimin dhe mbledhjen e të dhënave për pasurinë dhe figurën e individit. Nga ana tjetër, këto institucione shtetërore janë të detyruara të paraqesin informacionin ose dokumentacionin e kërkuar, që bëhen pjesë e dosjes së kandidatit dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat dhe informacionet zyrtare mund t'i vihen në dispozicion kandidatit, mbi bazën e një kërkese të arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rastit kur përhapja e informacionit ose dokumenteve cenon informacionin e klasifikuar sekret apo sigurinë publike, rast në të cilin ky informacion nuk përfshihet në dosjen individuale të kandidatit. Raporti i miratuar nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit dhe dosja e krijuar për kandidatin i përcillet organit të emërtesës.

33. Ndërkohë, procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme rregullohen nga ligji nr. 96/2016. Neni 48 i këtij ligji përcakton se pozicionet e lira në gjykatat e posaçme plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, e cila organizohet nga KLGJ-ja dhe në të cilën ftohen të marrin pjesë magjistratët që plotësojnë kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e ligjit për pozicionin e lirë të shpallur. KLGJ-ja verifikon kandidatët edhe për pasurinë dhe figurën, sipas parashikimeve të nenit 32 të ligjit, duke kërkuar dhe administruar raportet nga institucionet kompetente,

si dhe nga çdo organ publik ose subjekt tjetër që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë me sukses edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë, të cilat konsistojnë në renditjen e tyre sipas kritereve të përcaktuara nga ligji dhe, në vijim, KLGJ-ja ngre në detyrë kandidatin e renditur më lart.

34. Në analizë të sa më sipër, Gjykata konstaton se Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, i ngritur sipas nenit 6 të ligjit nr. 95/2016, me kërkesë të organit të emërtesës, KLGJ-së, pasi merr deklaratat e gjyqtarit kandidat për ngritjen në detyrë në gjykatat e posaçme, kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën e tij, duke mbledhur, krahas dokumentacionit të paraqitur nga vetë gjyqtari kandidat, edhe të dhëna dhe informacione zyrtare nga çdo institucion shtetëror, objekti i ligjshëm i veprimtarisë së të cilëve lidhet me hetimin dhe mbledhjen e të dhënave për pasurinë dhe figurën e individit. Në përfundim, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit përgatit dhe i dorëzon organit të emërtesës, KLGJ-së, një raport të hollësishëm për ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës së gjyqtarit kandidatit, së bashku me dosjen e tij të krijuar në kuadër të këtij procesi. Raporti i verifikimit dhe dosja e gjyqtarit kandidat, në vijim, bëhet pjesë e shqyrtimit nga KLGJ-ja, e cila ka kompetencën për të vendosur lejimin ose përjashtimin e gjyqtarit kandidat nga procedura e mëtejshme e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, ku në rast përjashtimi gjyqtari kandidat ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, vendimi i së cilës është përfundimtar dhe i formës së prerë.

35. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit për verifikimin e kushteve të sigurisë (pasurisë, figurës dhe kushteve shtesë të sigurisë) së kandidatëve gjyqtarë, është një veprimtari me natyrë të mirëfilltë hetimore administrative, që konsiston në mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave që kanë rëndësi për plotësimin nga kandidatët të kushteve të sigurisë për ngritjen në detyrë/emërimin në gjykatat e posaçme. Nga diskutimet parlamentare, gjatë shqyrtimit të ligjit nr. 95/2016, rezulton se krijimi i një organizmi të tillë, Komisionit të Posaçëm të Verifikimit, ka synuar të shmangë ndikimin e institucioneve në varësi të pushteteve të tjera në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, kjo në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor (*shih procesverbalet e datës 15.09.2016 të Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*).

36. Në këtë kuptim, Komisioni i Posaçëm i Verifikimit shfaqet në rolin

e një organizmi ndihmës të KLGJ-së në procedurat e ngritjes në detyrë/emërimit të gjyqtarëve në gjykatat e posaçme që gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Ndërsa ngritja në detyrë/emërimi i gjyqtarëve në këto gjykata është funksion kushtetues vetëm i KLGJ-së. Thënë kjo, raporti që përgatit Komisioni i Posaçëm i Verifikimit synon të ndihmojë KLGJ-në në ushtrimin e funksionit kushtetues, ndaj si i tillë ai nuk është një akt emërtese, por vetëm një akt me karakter informativ dhe analitik. Ky raport i nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit nga KLGJ-ja, sipas procedurave ligjore për këtë qëllim, ndaj për këtë arsye nuk e përcakton ai ngritjen në detyrë/emërimin e gjyqtarëve në gjykatat e posaçme, pasi lejimi ose jo i kandidimit dhe vendimi përfundimtar për ngritjen ose jo në detyrë është kompetencë e organit të emërtesës, pra KLGJ-së. Për rrjedhojë, veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit nuk prek sferën e kompetencës kushtetuese të KLGJ-së për ngritjen në detyrë/emërimin e gjyqtarëve në gjykatat e posaçme, ndaj formula e zgjedhur për përbërjen e këtij komisioni nuk paraqet atë rëndësi që mund të vërë në diskutim cenimin e parimeve kushtetuese të evidentuara nga gjykata referuese, të cilat në thelb lidhen me pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

37. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se gjykata referuese nuk ka dhënë arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar. Rrjedhimisht, në kushtet kur kriteret e legjitimimit janë kumulative dhe gjykata referuese nuk plotëson këtë kriter, Gjykata nuk do të ndalet në shqyrtimin e kriterit të tretë që lidhet me përpjekjet e gjykatës referuese për ta interpretuar dispozitën e kundërshtuar në përputhje me Kushtetutën (*shih paragrafin 16 të vendimit*).

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk plotëson kriteret kumulative për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa e saj duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "dh", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.04.2025
Shpallur më 27.05.2025

MENDIM KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (*gjykata referuese*), me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës bazuar në argumentin se gjykata referuese nuk ka paraqitur arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, pasi në vlerësimin tim arsyet kanë qenë bindëse, ndaj Gjykata duhet të kishte vijuar me shqyrtimin në themel të pretendimeve sipas qasjes së mëposhtme.

2. Fillimisht evidentoj se jam dakord me shumicën se gjykata referuese përmbush kriterin e identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë të tij me gjykimin para saj (*shih paragrafin 21 të vendimit*), por përkundër vlerësimit të saj (shumicës) çmoj se gjykata referuese plotëson edhe kriteret që lidhen me dhënien e arsyeve të rëndësishme për antikushtetutshmërinë dhe se ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar dispozitën në përputhje me Kushtetutën e, rrjedhimisht, plotëson të gjitha kriteret e legjitimimit, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000. Po kështu, vë në dukje se megjithëse çështja ndodhet në fazën e shqyrtimit në seancë plenare, shumica ka marrë në analizë dhe është ndalur në vlerësimin e kritereve të legjitimimit të gjykatës referuese, fazë kjo që i përket shqyrtimit paraprak të kërkesës, ndërsa në fazën e seancës plenare përmbushja e kritereve të legjitimimit konsiderohet e ezauruar dhe Gjykata analizon në themel bazueshmërinë e pretendimeve, gjë e cila duhet të kishte ndodhur edhe në rastin në shqyrtim. Nga ana tjetër, evidentoj se shqyrtimi në themel i çështjes merr një vlerë dhe rëndësi të posaçme, duke qenë se Gjykatës i jepej mundësia të shqyrtonte në seancë plenare kushtetutshmërinë e dispozitave të ligjit nr. 95/2016, që si pjesë e paketës së reformës në drejtësi së fundmi ka filluar të prodhojë efekte të ndjeshme në praktikë, ndaj dhe kontrolli nga pikëpamja e përputhshmërisë me Kushtetutën do të përbënte një hap pozitiv në forcimin e garancive kushtetuese të përmbajtjes së tij.

3. Duke iu kthyer kërkesës së gjykatës referuese, vlerësoj se pretendimi për cenimin e parimeve kushtetuese që lidhen me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, të para në aspektin e pavarësisë së brendshme organizative të tij

dhe ndarjes e balancimit të pushteteve në nivel horizontal brenda sistemit gjyqësor, duket të jetë i bazuar. Konkretisht, përpara gjykatës referuese është kundërshtuar raporti i hartuar nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, i cili ka verifikuar kushtet e sigurisë së një kandidati gjyqtar përpara ngritjes në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016. Gjykata referuese, pasi ka vlerësuar se kushtetutshmëria e pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016, që ka të bëjë me përbërjen e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit, duhet të merret në shqyrtim nga Gjykata, ka paraqitur kërkesën objekt shqyrtimi. Argumenti kyç i gjykatës referuese ka të bëjë me faktin se përbërja e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit ka cenuar parimet kushtetuese, pasi ligjvënësi nuk ka vendosur një balancë në përcaktimin e strukturave përfaqësuese në këtë komision, sepse numri i gjyqtarëve të posaçëm anëtarë është parashikuar të jetë më i vogël se numri i prokurorëve të posaçëm, për më tepër që Prokuroria e Posaçme ka një anëtar shtesë, atë të seksionit të hetimit financiar, ndërkohë që edhe BKH-ja, organ në varësi të saj, ka një anëtar. Sipas, gjykatës referuese, parimi i ndarjes së pushteteve duhet të gjejë zbatim jo vetëm në kuadër të mekanizmave ose institucioneve që veprojnë në një prej tre degëve kryesore të pushtetit shtetëror, por edhe në mekanizma të tjerë kushtetues që ushtrojnë funksionet e tyre kushtetuese sipas rastit në mënyrë të pavarur ose si ndërthurje të kompetencave të institucioneve të tjera kushtetuese.

4. Në kontekst të argumentit kryesor të gjykatës referuese, vë në dukje se ndonëse raporti i hartuar nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit nuk përbën aktin që vendos përfundimisht për ngritjen ose emërimin në detyrë të gjyqtarit kandidat pranë gjykatave të posaçme, pasi një akt i tillë duhet të dalë nga organi i emërtesës që është KLGJ-ja, një vlerësim negativ nga ana e komisionit përbën pengesë për të avancuar më tej në emërimin ose ngritjen përfundimtare në detyrë. Pa u ndalur në vlerësimin konkret të rastit që ka bërë Komisioni i Posaçëm i Verifikimit dhe pa vënë në dyshim rolin tepër të domosdoshëm të këtij komisioni në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor nga ndikimi i institucioneve ligjzbatuese në varësi të pushteteve të tjera, veçanërisht atij ekzekutiv, çmoj se raporti i anëtarëve në përbërje të tij paraqet problematika në aspektin kushtetues, pasi mund të krijojë premisa disavantazhuese ndaj kandidatëve. Thënë kjo, vlerësimi nga një komision i cili ka në përbërje të tij më shumë anëtarë që vijnë nga kategori të ndryshme funksioni me subjektin kandidat, në dukje cenon parimin kushtetues të pavarësisë së brendshme dhe balancimit të pushteteve në aspektin horizontal. Ky vlerësim vjen në qasje me

qëndrimin e Gjykatës, e cila ka pohuar se parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, i përcaktuar nga neni 7 i Kushtetutës, synon të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi ose të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 24, datë 09.06.2011; nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nën këtë optikë, theksoj se jo pa shkak kushtetutëbërësi dhe vetë legjislatori në aktet që rregullojnë statusin, organizimin dhe veprimtarinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndonëse u ka dhënë atyre statusin e magjistratit, ka normuar në mënyrë të ndryshme dhe të posaçme profilin profesional, pozicionin brenda hallkave të sistemit gjyqësor dhe organet e emërtesës (KLGJ/KLP). Këto të fundit (organet e emërtesës), jo pa qëllim, kanë në përbërje të tyre shumicën e anëtarëve që vijnë nga vetë kategoria e funksionit të subjektit që vlerësohet ose procedohet prej tyre. Konkretisht, te KLGJ-ja 6 prej 11 anëtarëve të saj zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor (*neni 147, pika 2, i Kushtetutës*), po kështu edhe te KLP-ja 6 nga 11 anëtarë zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë (*neni 149, pika 2, i Kushtetutës*). Pra, shumica e anëtarësisë së këtyre dy organeve kushtetuese, që kanë kompetencën për emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin, vendosjen e masave disiplinore dhe të tjera detyra, i përkasin së njëjtës kategori funksioni nga vjen subjekti që u nënshtrohet këtyre rregullave. Kjo mënyrë konceptimi, në vlerësimin tim, duhet të gjente shprehi dhe aplikim edhe në përbërjen e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit, çka do ta bënte logjike, të pranueshme dhe do të unifikonte qasjen e ndjekur nga vetë reformimi i sistemit për të garantuar pavarësinë e brendshme të tij në çdo hallkë dhe organ vendimmarrës. Në këtë kontekst, vlerësimi i kushteve të sigurisë për kandidatët gjyqtarë do të duhej të kryhej nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit me shumicë përbërëse të anëtarëve që vijnë nga kategoria e gjyqtarëve, ndërsa për kandidatët prokurorë shumica e përbërjes së anëtarësisë së komisionit do të duhet të vinte nga kategoria e prokurorëve. Për këtë qëllim, dispozita në fjalë e kundërshtuar nga gjykata referuese duhet të ndryshohej nga ligjvënësi, me qëllim përputhshmërinë e saj me vetë frymën kushtetuese, për të garantuar pavarësinë e brendshme të gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, elemente këto që prekin thelbin e funksionimit të dhënies së drejtësisë në të gjitha nivelet.

5. Në përmbledhje të sa më lart, vlerësoj se dispozita ligjore e kundërshtuar paraqet problematika për sa i takon përputhshmërisë së saj

me Kushtetutën, ndaj Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën dhe të deklaronte se ajo nuk është në përputhje me Kushtetutën duke mbajtur në konsideratë arsyetimin e mësipërm.

Anëtare: Sonila Bejtja

Vendim nr. 23, datë 23.04.2025
(V-23/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ILIR LLESHI**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

DREJTORIA RAJONALE E SHËNDETËSISË DIBËR, në mungesë.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, përfaqësuar nga Robert Gajda.

ARTAN MURATI, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi dhe shpallja e vendimit "Për kthimin e kërkesës" nr. 77105-00071-00-2024, datë 02.07.2024 të regjistrit themeltar, nr. 00-2024-3390, datë 01.08.2024 të Gjykatës së Lartë, marrë njoftim/dijeni në datën 09.09.2024, referuar "Dëftesës së komunikimit", datë 04.09.2024 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurës së gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, për sa i përket çështjes nr. 13703 akti., dhe nr. sistemi 31112-01973-86-2018, datë regjistrimi 24.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit që ka të regjistruar çështjen me nr. 13703 akti., dhe

nr. sistemi 3112-01973-86-2018, datë regjistrimi 24.05.2018 të procedojë brenda një afati të arsyeshëm të shqyrtimit të kësaj çështjeje.
Konstatimi i shkeljes së aksesit të një gjykate të caktuar me ligj për shkak të kthimit të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi dhe me pa të drejtë ankimi ndaj vendimit nr. 3390/2024 të Gjykatës së Lartë.
Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.
Konstatimi i statusit të "viktimës" përgjatë procesit gjyqësor, si pasojë dhe rrjedhojë direkt e shkeljes së aksesit në një gjykatë të krijuar me ligj dhe afatit të arsyeshëm, në përputhje me Scordino kundër Italisë.
Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ ka ardhur për shkak të vendimit të paligjshëm të konkretizuar sipas vendimit nr. 3390/2024 të Gjykatës së Lartë.
Pas konstatimit të shkeljeve veçmas dhe të gjitha së bashku (1) deri në (7), të caktojë një shpërblim të drejtë në referim të Olivieri dhe të tjerë kundër Italisë dhe Verrascina dhe të tjerë kundër Italisë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 2, 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1 dhe 13 të marra së bashku me nenin 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr.49/2012)*; ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore**

të organeve të administratës shtetërore", i ndryshuar; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*). Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Ilir Lleshi *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, mendimin me shkrim të subjektit të interesuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*Komisionieri*), konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 482, datë 15.09.2008 të Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë (*DRSH*), Dibër, kërkuesi është emëruar në detyrën e përgjegjësit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në këtë institucion. Me shkresën nr. 1 prot., datë 04.01.2013, kërkuesit i është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për braktisje të detyrës pa shkaqe të arsyeshme. Në vijim, me vendimin nr. 54, datë 31.01.2013 të DRSH-së, Dibër kërkuesi është liruar nga detyra e përgjegjësit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun, duke u emëruar jurist pranë kësaj zyre. Me shkresat nr. 178 prot., datë 18.04.2013 dhe nr. 181 prot., datë 19.04.2013, kërkuesit i është dhënë fillimisht masa disiplinore "Vërejtje për thyerje të disiplinës në punë" dhe më pas "Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna", për të cilat është njoftuar nga punëdhënësi. Me shkresën nr. 257, prot., datë 13.06.2013, kërkuesit i është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" për thyerje të disiplinës në punë me faj të rëndë, për shkak të thyerjes së disiplinës në punë në mënyrë të përsëritur.

2. Me vendimin nr. 80, datë 24.01.2014 "Për largim dhe emërim nga detyra" *(vendimi nr. 80/2014),* DRSH-ja, Dibër ka ndërprerë kontratën e punës me kërkuesin, me motivacionin "arsye politike". Duke mos qenë dakord me këtë akt, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe dëmshpërblimin nga zgjidhja e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme, pa shkaqe të justifikuara dhe në shkelje të afatit të njoftimit.

3. Me vendimin nr. 2884, datë 03.06.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, duke urdhëruar shpërblimin e kërkuesit me: pagën e 10 muajve për zgjidhjen e menjëhershme e pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës; pagën e 3 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; pagën e 2 muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës; 2.5 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit me vendimin nr. 270, datë 17.02.2017, e cila nuk ka gjetur shkaqe për të cenuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë.

4. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Komisionerit, me pretendimin se është diskriminuar për shkaqe politike. Sipas kërkuesit, drejtori i ri i DRSH-së, Dibër kërkonte që të largonte nga puna 40% të punonjësve të institucionit, veprim që kërkuesi, në cilësinë e përgjegjësit të sektorit, e ka kundërshtuar, pasi ishte në kundërshtim me urdhrin nr. 506, datë 18.09.2013 të ministrit të Shëndetësisë. Ai ka pretenduar në ankim se drejtori ka bërë disa largime nga puna pa vënë në dijeni kërkuesin, veprim për të cilin ky i fundit ka vënë në dijeni Ministrinë e Shëndetësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Avokaturën e Shtetit.

5. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri, me vendimin nr. 25, datë 08.02.2016 *(vendimi nr. 25/2016),* ndër të tjera, ka vendosur "*konstatimin e diskriminimit të shtetasit Ilir Lleshi nga ana e DRSH-së, Dibër për shkak të bindjeve politike. Rekomandohet DRSH-ja, Dibër të kryejë evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit në institucion dhe krijimin e mundësisë për kthimin në punë të Ilir Lleshit. Bazuar në nenin 33, pika 11, të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" drejtori i DRSH-së, Dibër, detyrohet që brenda 30 ditëve të njoftojë Komisionerin për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të këtij neni... në referim të pikës 1*", të këtij vendimi i rekomandohet subjektit ankues që gjyqësisht mund të kërkojë dëmshpërblim sipas parashikimeve

ligjore të bazuara në nenet 36/1, 37/1 dhe 38 të ligjit 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Komisioneri ka vlerësuar se vendimi nr. 80/2014 i drejtorit të DRSH-së, Dibër është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit dhe i të drejtave e lirive të individit të sanksionuara në Kushtetutë dhe se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së kërkuesit ka qenë diskriminuese për shkak të bindjeve të tij politike. Sipas tij, kërkuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë që ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin politik të tij, si dhe me faktin e denoncimeve prej tij për largimet dhe emërimet e punonjësve nga puna, pa shkaqe të arsyeshme nga institucioni.

6. Në vijim, në datën 23.01.2017, kërkuesi, bazuar në vendimin e Komisionerit, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit të tij nga DRSH-ja, Dibër; detyrimin e palës së paditur për ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura, duke e kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës; detyrimin për dëmshpërblim, duke e kompensuar për dëmet pasurore të shkaktuara në formën e fitimit të munguar për mosmarrjen e pagës deri në kthimin e tij në punë, si dhe dëmshpërblimin për dëmin jopasuror të shkaktuar nga diskriminimi; dënimin e ish-drejtorit të DRSH-së, Dibër me gjobë në vlerën pesëdhjetëfish të pagës minimale mujore. Gjatë gjykimit të çështjes kërkuesi ka hequr dorë nga kërkimi për detyrimin e palës së paditur për dëmshpërblimin për dëmin jopasuror të shkaktuar nga diskriminimi.

7. Me vendimin nr. 1156, datë 29.03.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se ky kërkim është i pambështetur proceduralisht, pasi nuk mund t`i kundërdrejtohej palës së paditur në proces, por është kërkim që i duhej drejtuar Komisionerit nëse ai do të çmonte se nuk është zbatuar vendimi i tij nr. 25/2016. Sipas gjykatës, gjatë gjykimit ka rezultuar se kërkuesi e ka zgjidhur me vendim të formës së prerë mosmarrëveshjen e punës me DRSH-në, Dibër. Ajo ka vlerësuar se dëmshpërblimi që rrjedh nga zgjidhja e kësaj mosmarrëveshjeje nuk mund të dublohet me kërkime në kuadër të procedurës administrative të nisur pranë Komisionerit dhe kërkimi për rikthimin në punë në të njëjtin pozicion të kërkuesit është në kundërshtim me legjislacionin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

8. Çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 13703 (31112-01973-86-2018) akti, datë 24.05.2018, por ende nuk ka një datë të caktuar për shqyrtimin e saj. Në datën 03.04.2024

kërkuesi i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij. Me shkresën nr. 2526/1 prot., datë 04.06.2024, kancelari i gjykatës e ka informuar kërkuesin se për çështjen e tij nuk ka datë të planifikuar nga gjyqtarja relatore dhe se kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes është refuzuar në datën 16.04.2024 nga ajo gjyqtare.

9. Në datën 01.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të çështjes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit. Me vendimin e datës 02.07.2024 gjyqtarja relatore e çështjes ka konstatuar se kërkesa përmban të metën e parashikuar nga neni 56/a, shkronja "d", të ligjit nr. 49/2012 dhe neni 474 i Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, konkretisht se i mungon nënshkrimi i avokatit, për plotësimin e së cilës i ka caktuar atij një afat 5-ditor nga e nesërmja e marrjes dijeni të vendimit. Në kushtet kur kërkuesi nuk e ka përmbushur detyrimin për plotësimin e kësaj të mete, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (gjyqtarja relatore), me vendimin nr. 00-2024-3390, datë 01.08.2024, ka vendosur kthimin e kërkesës.

10. Në datën 08.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 17.10.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 27.12.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesi*,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt* ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.1. *E drejta e aksesit për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e drejta për t'u dëgjuar,* pasi Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës pa veprime, si rrjedhojë e nënshkrimit të saj vetëm nga kërkuesi dhe jo nga një avokat i autorizuar me prokurë, pa pasur ai detyrim ligjor në këtë drejtim dhe duke vepruar në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese.

11.2. *E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, pasi që prej momentit të ankimit, edhe pse kanë kaluar më shumë se 6 vjet e

4 muaj dhe kërkuesi ka përdorur mjetet juridike në dispozicion, nuk është marrë asnjë masë procedurale në për çështjen e tij nga Gjykata Administrative e Apelit, madje është refuzuar kërkesa për përshpejtimin e gjykimit nga gjyqtarja relatore. Çështja objekt gjykimi është një çështje shumë e thjeshtë dhe nuk paraqet asnjë lloj vështirësie që të justifikohen vonesat në gjykimin e saj. Vonesat e gjykimit në kohë nga Gjykata Administrative e Apelit i shkaktojnë atij pasoja negative për shkak të një sëmundjeje të rëndë që po kalon, e cila kërkon shpenzime të jashtëzakonshme, por edhe për shkak të kushteve ekonomiko-familjare. Kërkuesi nga muaji dhjetor i vitit 2021 u është nënshtruar 4 ndërhyrjeve kirurgjikale si brenda dhe jashtë vendit, si dhe vijon kurimin e tij në klinikë private në Itali.

11.3. Në rastin e kërkuesit duhet të konstatohet mungesa e një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave gjyqësor, statusi i viktimës përgjatë procesit gjyqësor, si dhe shpërblimi i dëmit si pasojë dhe rrjedhojë direkte e shkeljes së afatit të arsyeshëm.

12. ***Subjekti i interesuar, Komisioneri,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se sjellja diskriminuese ndaj kërkuesit konsiston pikërisht në përfundimin e marrëdhënies së punës, për rrjedhojë dhe masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar duhet të jetë rivendosja në vend e së drejtës së shkelur, duke e kthyer kërkuesin në pozicionin e mëparshëm të punës.

13. ***Subjektet e tjera të interesuara*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë

edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

16. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, pasi i është drejtuar më parë gjykatës së apelit me kërkesë për përshpejtim dhe Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përshpejtimin e gjykimit, në zbatim të nenit 399/6, pika 1, shkronja "b", të KPC-së. Me vendimin nr. 00-2024-3390, datë 01.08.2024, gjyqtari i vetëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e kërkesës për shkak të mosplotësimit nga kërkuesi të së metës së konstatuar, që është mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit dhe e aktit të përfaqësimit, duke mos u dhënë kështu përgjigje pretendimeve të parashtruara për kohëzgjatjen e procesit në gjykatën e apelit. Gjykata ka theksuar se kthimi pa veprim i këtyre lloj kërkesash, bazuar në dispozitat që përcaktojnë nënshkrimin nga avokati të rekursit, përbën formalizëm të tepruar dhe kthen një rregull garantues procedural në një pengesë të aksesit në Gjykatën e Lartë, e cila ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv *(shih vendimet nr. 2, datë 21.01.2025; nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi ka shfrytëzuar mjetin juridik në dispozicion të saj, duke paraqitur kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përshpejtimin e procesit në Gjykatën e Lartë. Ajo nuk e ka shqyrtuar themelin e kërkesës, por e ka kthyer me arsyetimin se duhej nënshkruar nga një avokat dhe se duhej paraqitur akti i përfaqësimit, ndonëse kërkesa ishte nënshkruar personalisht nga kërkuesi. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka mbajtur qasje formaliste dhe e ka shndërruar kërkesën në mjet ankimi joefektiv. Në këto rrethana, Gjykata

çmon se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

18. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 08.10.2024, ndërsa vendimi gjyqësor që ka vendosur kthimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes mban datën 01.08.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, që garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, pretendim që përfshihet në kompetencën e Gjykatës. Duke mbajtur në konsideratë që thelbi i së drejtës kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm lidhet me kohëzgjatjen e procedurave, shkak për të cilin ligji procedural ka caktuar afatin e shpejtë 45-ditor për shqyrtimin e kërkesave të tilla nga gjykatat e zakonshme, Gjykata arrin në përfundimin se kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë nuk i përgjigjet mbrojtjes të së drejtës themelore në fjalë, ndaj çmon se duhet ta analizojë ajo vetë themelin e pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 2, datë 21.01.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

20. Kërkuesi ka pretenduar se edhe pse kanë kaluar më shumë se 6 vjet e 4 muaj nga regjistrimi i çështjes së tij në gjykatën e apelit dhe ai i ka përdorur mjetet juridike që parashikon legjislacioni në fuqi, nga ajo gjykatë nuk është marrë asnjë masë procedurale për shqyrtimin e çështjes, madje kërkesa për përshpejtimin e gjykimit nga gjyqtari relator është refuzuar. Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Lartë e ka kthyer kërkesën si me të meta, pasi edhe pse ishte nënshkruar nga kërkuesi, i mungonte nënshkrimi i avokatit.

21. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi *(shih vendimet nr.*

27, datë 11.04.2024; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Gjykata vëren se çështja konkrete, e vënë në lëvizje për kërkesën e kërkuesit, ka në objektin e saj konstatimin e diskriminimit dhe viktimizimit të tij për shkaqe politike, kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, dëmshpërblimin për dëmet pasurore të shkaktuara në formën e fitimit të munguar për mosmarrjen e pagës deri në kthimin e tij në punë, si dhe gjobitjen e ish-drejtorit të DRSH-së, Dibër. Rezulton se kërkesëpadia e paraqitur nga kërkuesi është regjistruar në datën 23.01.2017 dhe në përfundim të gjykimit, me vendimin e datës 29.03.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar, duke vlerësuar se kërkimi nuk mund t`i kundërdrejtohet palës së paditur në proces, por Komisionerit, nëse ai do të çmonte se nuk ishte zbatuar vendimi i tij nr. 25/2016. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit ku ai është regjistruar në datën 24.05.2018. Për rrjedhojë, referuar këtyre të dhënave, rezulton se ndonëse kanë kaluar rreth 7 vjet që prej regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit, referuar shkresës së datës 14.04.2025 të asaj gjykate, në përgjigje të informacionit të kërkuar për qëllime të këtij gjykimi, ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimi e saj.

23. Gjykata, në mbështetje të nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, vëren se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji si një afat i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këto rrethana, për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata thekson se, për sa u përket kritereve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuesit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson që të

ndalet në vijim vetëm në analizën e vlerësimit të kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuesi,* i cili, po sipas kësaj jurisprudence të konsoliduar, dhe në kushtet që ndodhet sistemi i drejtësisë, për shkak të reformës në drejtësi, përbën një element të rëndësishëm për të arritur në një përfundim të drejtë për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor.

25. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë " nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm" dhe që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke çmuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit për nga natyra e tyre kërkojnë vendimmarrje të përshpejtuar, i ka listuar ato si çështje prioritare për shqyrtim nga gjykata e apelit në vendimin e saj nr. 78/2019.

26. Gjykata vëren se në themelin e mosmarrëveshjes gjyqësore është kërkesa për konstatimin e diskriminimit të kërkuesit për largimin e tij nga puna për shkaqe politike. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar se vonesat e gjykimit në kohë të çështjes së tij nga gjykata e apelit i shkaktojnë atij pasoja negative për shkak të një sëmundjeje të rëndë që po kalon, e cila kërkon shpenzime të jashtëzakonshme, por edhe për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike. Gjykata, referuar objektit të çështjes gjyqësore dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, vlerëson se ajo, për nga natyra e saj, lidhet me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, të tilla që duhet të shqyrtohen me prioritet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për më tepër, kërkuesi ka arritur të parashtrojë shkaqe objektive, specifike dhe të mjaftueshme për të provuar se çështja e tij është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, për rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, për shkak të vonesës së gjykatës së apelit në shqyrtimin e çështjes së tij, Gjykata çmon se, në kontekst të rrethanave të rastit, ai ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilave justifikon trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit.

27. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në kontekstin e situatës së përgjithshme të sistemit gjyqësor (burimet njerëzore, kushtet e punës dhe

numri i lartë i çështjeve), kohëzgjatja e gjykimit administrativ (rreth 7 vjet në gjykatën e apelit) të çështjes së kërkuesit përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar tejzgjatje të procedurave. Për më tepër, duke e ndërlidhur kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij me rrethanat e tjera, si mungesa e kompleksitetit të saj dhe interesat vetjakë që kanë rëndësi për kërkuesin (që lidhet me gjendjen shëndetësore dhe ekonomike të tij), Gjykata çmon se kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të pranohet.

28. Gjithashtu, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, çmon se, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duhet urdhëruar detyrimi i kësaj gjykate ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3390, datë 01.08.2024 të Kolegji Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit ta shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.04.2025
Shpallur më 26.05. 2025

Vendim nr. 24, datë 23.04.2025
(V-24/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (V) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **VELI PËRLEKA**

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE, TIRANË

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1023 (86-2023-1558), datë 07.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1414, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Veli Përleka *(kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të

interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH)*, Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë oficer aktiv i Forcave të Armatosura nga data 01.11.1971. Ai ka shërbyer në aviacionin ushtarak dhe ka dalë në rezervë në datën 01.08.2003, ndërsa mbante gradën "nënkolonel".

2. Pas përfundimit të trajtimit me pagesë kalimtare deri në datën 01.08.2005, kërkuesi në vijim është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi *(pensioni i parakohshëm)* sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar *(ligji nr. 8087/1996).* Konkretisht, me vendimin nr. 3926, datë 04.05.2006, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH),* Tiranë i ka caktuar kërkuesit pension të parakohshëm në masën 15.963 lekë, me të drejtë pagese nga data 01.08.2005 deri në datën 15.11.2006, kur ai plotësonte kushtet për pension pleqërie. Përllogaritja e pensionit të parakohshëm është bërë mbi bazën e pagës referuese të kërkuesit prej 70.600 lekësh dhe vjetërsisë së tij në shërbim prej 31 vjetësh e 9 muajsh, e cila në kushtet kur kërkuesi ka shërbyer në aviacion ushtarak, sipas nenit 7 të ligjit nr. 8087/1996, është konvertuar në 47 vjet e 6 muaj. Kërkuesi ka përfituar pensionin e parakohshëm deri në datën 15.11.2006, kur ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, të cilin e ka përfituar në vijim.

3. Në datën 07.12.2012, me pretendimin se në llogaritjen e pensionit të parakohshëm DRSSH-ja, Tiranë ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996 dhe ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" *(ligji nr. 9210/2004)*, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së të rillogarisë e të caktojë masën e pensionit të parakohshëm sipas neneve 11 e 18 të ligjit nr. 8087/1996, nga data 01.08.2005 deri në datën 30.10.2006, si dhe t'i paguajë diferencat mes masës së pensionit të paguar nga data 01.08.2005 deri në datën 30.10.2006, së bashku me kamatëvonesat.

4. Pas shpalljes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të moskompetencës lëndore, çështja i ka kaluar për gjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 1521, datë 09.04.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e DRSSH-së, Tiranë t'i rillogarisë paditësit/kërkuesit pensionin e parakohshëm nga data 01.08.2005 deri në datën 30.10.2006, në përputhje me formulën e parashikuar në nenin 35 të ligjit nr. 9210/2004, si dhe pagimin e diferencave të papaguara gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër të saj. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesi dhe DRSSH-ja, Tiranë.

5. Me vendimin nr. 315, datë 19.02.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e DRSSH-së, Tiranë t'i paguajë paditësit/kërkuesit shumën 1.010.091 lekë, si diferencë të papaguar të pensionit të parakohshëm për periudhën 01.08.2005 - 15.11.2006, ndërkohë që ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër. Gjykata e apelit ka gjetur të drejtë qëndrimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, sipas të cilit masa e pensionit të parakohshëm për kërkuesin ishte në masën 50% të pagës referuese së bashku me shtesat 2% për çdo vit shërbimi mbi 15 vjet, pa u kufizuar me masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 dhe nenit 35 të ligjit nr. 9210/2004, kufizim i cili është shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210/2004. Kërkuesi dhe DRSSH-ja, Tiranë kanë ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi.

6. Me vendimin nr. 00-2017-1705 (545), datë 10.05.2017, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, duke arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të analizohen faktet për të zgjidhur çështjen, duke zbatuar ligjin sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi unifikues nr. 3/2016)*.

7. Në rigjykim, me vendimin nr. 1023 (86-2023-1558), datë 07.12.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, momentin e lindjes të së drejtës dhe përfundimet e vendimit unifikues nr. 3/2016, DRSSH-ja, Tiranë në caktimin për paditësin/kërkuesin të pensionit të parakohshëm ka zbatuar drejt ligjin, nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996,

sipas skemës me kufizime, pra jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

8. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, gjatë procedurës seleksionuese, me vendimin nr. 00-2024-1414, datë 08.04.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk ngre asnjë shkak nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*.

9. Në datën 06.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 01.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa në datën 11.11.2024 kjo e fundit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

10.1.1. *Parimit të sigurisë juridike* në aspekt të të drejtave të fituara, pasi:

10.1.1.1. Ndonëse kufizimi *"por jo më shumë se masa e pensionit maksimal në shkallë vendi",* i përcaktuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, ishte shfuqizuar me nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, në caktimin e shumës së tij të pensionit të parakohshëm gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes është bazuar në këtë dispozitë, duke ndryshuar masën e pensionit të tij të parakohshëm nga 80,484 lekë në muaj në 15,963 lekë. Edhe pse pensioni i tij i parakohshëm nuk është objekt i nenit 29 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit

të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 10142/2009)*, të ndryshuar, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë në rigjykimin e çështjes e kanë bërë atë objekt të tij, duke i cenuar të drejtën e fituar. Kjo dispozitë ligjore parashikonte rillogaritjen vetëm të pensionit të parakohshëm të përfituar me ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar dhe jo të pensionit të përfituar sipas nenit 35, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 9210/2004. Ky pension nuk është objekt rillogaritjeje, pasi efektet e saj shtrihen nga data 01.07.2009 e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009 dhe në vazhdim. Për rrjedhojë, gjykatat i kanë cenuar të drejtën për të përfituar pension të parakohshëm deri në daljen në pension, pra për periudhën 01.08.2005 - 15.11.2006, në masën e përcaktuar nga ligji prej 50% të pagës referuese prej 70.600 lekësh për 15 vjet shërbim, si dhe të shtesës prej 64% të pagës referuese për 32 vjet shërbim mbi 15 vjet.

10.1.1.2. *Vendimi unifikues nr. 3/2016* ka cenuar nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009 në lidhje me rillogaritjen e pensionit të parakohshëm, duke e vlerësuar dhe trajtuar këtë pension si pension suplementar, ndonëse ai jepej në zbatim të nenit 52, pika 2, të Kushtetutës, për shkak të papunësisë dhe mbetjes pa mjete jetese. Ky vendim nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka zbatuar nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, i cili kishte shfuqizuar shprehjen *"jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi"* në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996. Sipas këtij vendimi, edhe pse nga data 14.05.2004 ka qenë i zbatueshëm ligji nr. 9210/2004, llogaritja e pensionit të parakohshëm do të bëhej sipas ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, duke i dhënë ligjit fuqi prapavepruese. Vendimi unifikues ka urdhëruar moszbatimin e ligjit nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë" *(ligji nr. 9418/2005)*, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, nga data e hyrjes së tij në fuqi dhe deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, të ndryshuar, pavarësisht nëse masa e pensionit rritej ose ulej në raport me skemën

e parashikuar nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar. Zbatimi i këtij vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë ka çuar në uljen e masës së pensionit të tij të parakohshëm.

10.1.1.3. Me ligjin nr. 156/2020 është vendosur falja e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues nr. 3/2016. Mbështetur në nenin 2 të këtij ligji, Instituti i Sigurimeve Shoqërore duhet të kishte tërhequr ankimin për çështjen e tij.

10.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për asnjë prej pretendimeve të tij dhe nuk ka vlerësuar bazueshmërinë në ligj të shkaqeve të ngritura prej tij në rekurs, ndonëse ato kishin të bënin si me zbatimin e gabuar të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit në rigjykimin e çështjes, ashtu edhe me parimin e sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara.

10.2. *Parimi i shtetit të së drejtës dhe parimi i hierarkisë së akteve normative,* si rrjedhojë e zbatimit të gabuar nga gjykatat e zakonshme të legjislacionit në fuqi për sa i përket masës së përfitimit prej tij të pensionit të parakohshëm. Neni 14 i ligjit nr. 10142/2009, të ndryshuar është shprehje e cenimit të neneve 35, pika 3 dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9210/2004 dhe tejkalimit të kompetencave, në cenim të rendit juridik dhe hierarkisë së akteve. Neni 35, pika 3, i ligjit nr. 9210/2004 i ka njohur ligjit për sigurimet shoqërore vetëm të drejtën të përcaktojë kushtet dhe kriteret për dhënien e masës së pensionit të parakohshëm, sipas pikës 1, dhe jo ta ndryshojë atë.

10.3. *Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk kanë respektuar vendimet nr. 33, datë 24.06.2010 *(vendimi nr. 33/2010)* dhe nr. 2, datë 18.02.2013 *(vendimi nr. 2/2013)* të Gjykatës, përmes të cilave është pranuar se zvogëlimi i pensionit të parakohshëm nuk mund të përligjej me interesin publik, se rillogaritja e pensionit sipas nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009 do të bëhej vetëm në rast se ndryshonte pozitivisht situatën e përfituesve dhe se prekja e

skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhej kurrsesi të pësonte ndryshime të tilla që përkeqësonin ndjeshëm jetën e shtetasve që përfitonin këtë sigurim. Edhe pse ishin përpara një të drejte që buronte nga neni 52, pika 2, i Kushtetutës dhe të njohur me ligj të miratuar me shumicë të cilësuar, gjykatat kanë zvogëluar masën e tij të pensionit të parakohshëm pa marrë parasysh këto vendime të Gjykatës. Vendimi unifikues nr. 3/2016 ka përcaktuar rillogaritjen në përkeqësim të pensionit të parakohshëm.

11. ***Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar zyrtarisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimet e kundërshtuara të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të dhëna në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga ai, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës kushtetuese, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin

procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se kërkuesi nuk ka qenë palë në procesin për të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur me vendimin unifikues nr. 3/2016, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij në këndvështrim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues, për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata evidenton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai nr. 00-2024-1414 i Gjykatës së Lartë, mban datën 08.04.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 06.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *parimit të sigurisë juridike* e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, *parimit të shtetit të së drejtës*, *parimit të hierarkisë së akteve* dhe *standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

19. Gjykata vëren se në drejtim të parimit të sigurisë juridike kërkuesi ka parashtruar si argument edhe faljen me ligjin nr. 156/2020 të detyrimeve

të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme. Nga materialet e depozituara me kërkesën, si dhe aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata nuk konstaton që nga institucionet shtetërore të jetë përcaktuar ndonjë detyrim i kërkuesit në këtë drejtim. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky pretendim për këtë argument nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se, në thelb, ato parashtrohen ndaj procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuesi për shumën e pensionit të parakohshëm të caktuar dhe paguar nga DRSSH-ja, Tiranë, si dhe interpretimit nga gjykatat e zakonshme të jurisprudencës kushtetuese, legjislacionit në fuqi dhe vendimit unifikues nr. 3/2016 për këtë të drejtë. Duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Gjykata çmon t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

21. Kërkuesi ka pretenduar se vlera e pensionit të parakohshëm të caktuar nga DRSSH-ja, Tiranë është bërë në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi. Pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh nga gjykatat, të cilat, në rigjykimin e çështjes, për sa i përket përcaktimit të masës së përfitimit të këtij pensioni, nuk kanë interpretuar e zbatuar drejt jurisprudencën kushtetuese dhe legjislacionin e fushës. Sipas tij, interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë u kanë bërë dispozitave ligjore dhe vendimeve të Gjykatës, si dhe zbatimi i vendimit unifikues nr. 3/2016, kanë bërë që pensioni i tij i parakohshëm të rillogaritet në përkeqësim, në cenim të parimit të sigurisë juridike. Po sipas kërkuesit, edhe pse shkaqet e ngritura në rekursin e tij kishin të bënin si me zbatimin e gabuar të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar dhe nuk ka vlerësuar bazueshmërinë e tyre në ligj.

22. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues e ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka

pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra çojnë në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike, si dhe respektimin e pritshmërive legjitime *(shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Gjykata po kështu është shprehur edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Për këtë arsye, ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Nisur nga standardi i mësipërm kushtetues, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në rregullimin ligjor ndër vite të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Konkretisht, ky pension është njohur me ligjin nr. 8087/1996. Në nenin 11 të këtij ligji, të ndryshuar në vijim me ligjin nr. 8521/1999, parashikoheshin kushtet dhe masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm. Sipas tij, ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kishin dalë në rezervë e në lirim pas datës 03.07.1991 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përfitonin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësonin vjetërsinë e shërbimit si ushtarakë në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kishin mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi u parashikua të ishte: a) 50% të pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi; b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2%të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Gjithashtu, neni 10 i ligjit nr. 8521/1999 parashikonte se efektet e zbatimit të tij do të shtriheshin nga data 01.01.1999.

26. Shprehja "*por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi"* në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 u shfuqizua me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Gjithashtu, neni 35 i ligjit nr. 9210/2004 rregulloi të drejtën e pensionit të parakohshëm për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, duke parashikuar kushtet dhe masën e përfitimit të këtij pensioni. Në pikën 1 të këtij neni u përcaktua se "*oficerët, nënoficerët dhe ushtarët me pagesë/profesionistë, me vjetërsi shërbimi në Forcat e Armatosura 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm ushtarakut i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore"*. Kurse pika 3 e tij përcaktoi se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktohen në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror, të ndryshuar. Ndërkohë, në dispozitat e fundit, neni 48 i ligjit, për sa i përkiste zbatimit të nenit 35 të tij, ngarkoi Këshillin e Ministrave që brenda 24 muajve

nga hyrja në fuqi e ligjit, të paraqiste ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 8087/1996.

27. Në vijim u miratua një ligj i ri për sigurimet shoqërore suplementare për ushtarakët e Forcave të Armatosura, pikërisht ligji nr. 9418/2005. Ky ligj, në nenin 13, përcaktoi kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, të njëjta si ato në ligjin nr. 8087/1996 dhe ligjin nr. 9210/2004. Ndërsa neni 14 rregulloi masën e pensionit të parakohshëm, duke përcaktuar të njëjtën masë pensioni të parakohshëm sikurse dhe neni 35 i ligjit nr. 9210/2004, por me kufizimin se *masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë.* Neni 32 i tij ngarkoi Këshillin e Ministrave që brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të nxirrte aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4 dhe 14 të këtij ligji. Ndërkohë, neni 33 i dispozitave kalimtare parashikoi se ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji. Ligji hyri në fuqi në datën 01.01.2006.

28. Më pas, ligji nr. 9418/2005 u ndryshua me ligjin nr. 9481/2006, i cili ndryshoi dispozitat në lidhje me kushtet dhe masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm (nenet 13 dhe 14). Për kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, neni 1 i ligjit ndryshues përcaktoi të njëjtat kushte, por identifikoi dy kategori ushtarakësh përfitues: (i) ata që dilnin në rezervë/lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie sipas ligjit nr. 7703/1993, për të cilët masa e përfitimit përcaktohej në nenin 14 të ligjit; (ii) ata që kishin dalë në rezervë/lirim nga data 1 janar 1991 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004, pavarësisht nga çasti i lindjes të së drejtës për përfitimin e pensionit të parakohshëm, të cilët do të vazhdonin ta përfitonin sipas ligjit nr. 8087/1996. Kurse për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, neni 2 i ligjit ndryshues, ndërsa përcaktoi të njëjtën masë pensioni të parakohshëm, sikurse dhe neni 35 i ligjit nr. 9210/2004, vendosi kufizime sipas gradave të ushtarakëve, të cilat varionin nga 6-fishi i pensionit bazë për ushtarakët me gradën "gjeneral" deri në 3-fishin e pensionit bazë për ushtarakët e tjerë, ku për sa u përket ushtarakëve me gradën "nënkolonel" (gradë që e ka pasur edhe kërkuesi Veli Përleka), kufizimi i masës së pensionit shkonte deri në 4-fishin e pensionit bazë. Neni 9 i ligjit nr. 9481/2006 ndryshoi edhe dispozitën për hyrjen në fuqi të ligjit (nenin 34), duke parashikuar se hynte në fuqi në datën 16.04.2006.

29. Ndërkohë neni 1 i ligjit nr. 9481/2006, i cili ndryshoi nenin 13 të

ligjit nr. 9418/2005, për kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, u shfuqizua nga Gjykata me vendimin nr. 9, datë 26.02.2007, me arsyetimin se ai cenonte parimin e sigurisë juridike për shkak të paqartësisë dhe kontradiktave midis dispozitave të ligjit (në lidhje me nenin 33 të pandryshuar të ligjit nr. 9418/2005), por edhe parimin e barazisë përpara ligjit. Gjykata konstatoi se kjo dispozitë i ndante ushtarakët në dy kategori për efekt të përfitimit të pensionit të parakohshëm, ndërsa me ligjin e mëparshëm pagesa e pensionit shkonte deri në 4-fishin e pensionit bazë në shkallë vendi, me ligjin e ri u ul pagesa e pensionit të parakohshëm për ushtarakët e dalë në pension deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për statusin (ligji nr. 9210/2004), për të cilët kjo masë shkonte deri në masën e pensionit maksimal në shkallë vendi, e barabartë me 2-fishin e pensionit bazë, kur për ushtarakët e dalë në pension të parakohshëm pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, maksimumi i pagesës jepej i diferencuar sipas gradës dhe shumë më i favorshëm nga ajo që u jepej ushtarakëve që kishin dalë në pension përpara ligjit për statusin. Po kështu, Gjykata konstatoi se neni 1 i ligjit të kundërshtuar i bënte referencë ligjit të vitit 1996 (nr. 8087/1996) për përfitimet e një kategorie ushtarakësh, ndërkohë që neni 33 i pandryshuar i ligjit të vitit 2005 (nr. 9418/2005) ndalonte zbatimin e atyre dispozitave, duke krijuar kështu paqartësi në kuptimin e ligjit dhe në zbatimin e tij. Me këtë vendim Gjykata shfuqizoi edhe nenin 9 të ligjit nr. 9481/2006, përmes të cilit ishte shtyrë hyrja në fuqi e ligjit nr. 9418/2005, duke konstatuar edhe në këtë rast cenimin e parimit të sigurisë juridike.

30. Në vijim u miratua një ligj tjetër për sigurimin shoqëror suplementar edhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, ligji nr. 10142/2009, i cili ka hyrë në fuqi në datën 27.06.2009. Ky ligj shfuqizoi si ligjin nr. 8087/1996, ashtu edhe ligjin nr. 9418/2005, si edhe pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9210/2004. Sikurse rezulton nga rrethanat e çështjes dhe pretendimet e kërkuesit, ai ka përmbushur kriteret për pensionin e pleqërisë në datën 15.11.2006. Për rrjedhojë, për sa kohë në shqyrtim është procesi gjyqësor i zhvilluar nga kërkuesi për kundërshtimin e pensionit të parakohshëm, në të cilin ky ligj dhe aktet e tjera e nxjerra në zbatim të tij nuk janë të zbatueshme, ato nuk do të merren në analizë nga Gjykata.

31. Në lidhje me zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, për shkak të qëndrimeve të ndryshme të gjykatave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3/2016, kanë arritur edhe në përfundimin njësues se në gjykimin e

mosmarrëveshjeve për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, për periudhën nga data 01.01.1999 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999). Gjithashtu, sipas Kolegjeve të Bashkuara ligji nr. 9210/2004 ka hequr kufizimin në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të parashikuar, por zbatimi i parashikimit ligjor të këtij ligji ishte i kushtëzuar me nxjerrjen e rregullimeve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve në zbatim të këtij ndryshimi. Caktimi i pensionit të parakohshëm, sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), bëhej duke u llogaritur sipas skemës: a) 50% e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi; b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese. Por masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalonte masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Tavani i vendosur në lidhje me masën e pensionit të parakohshëm në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, duhet të zbatohej mbi të gjithë masën e pensionit të parakohshëm.

32. Për sa më lart, në rastin në shqyrtim, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në arsyetimin dhe interpretimin që Gjykata e Lartë i ka bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

33. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit, si ushtarak i dalë në rezervë, e drejta për pension të parakohshëm i ka lindur në datën 01.08.2005. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 15.963 lekë në muaj, sipas aktit administrativ nr. 3926, datë 04.05.2006 të DRSSH-së, Tiranë, i cili është kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuesi. Me vendimin nr. 1521, datë 09.04.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se masa e pensionit të parakohshëm të kërkuesit është në masën 50% të pagës referuese së bashku me shtesat 2% për çdo vit shërbimi mbi 15 vjet, pa e kufizuar me masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Sipas saj, kufizimi i zbatuar nga DRSSH-ja, Tiranë, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar

me ligjin nr. 8521/1999), se masa e pensionit të parakohshëm nuk duhet të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, nuk gjen zbatim, pasi ky kufizim është shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210/2004. Në këto kushte, DRSSH-ja duhej t'i paguante kërkuesit diferencat për të gjithë periudhën 01.08.2005 -30.10.2006. Ndërsa, për sa i përket kërkimit për kamatëvonesat, gjykata e ka vlerësuar atë të parashkruar, duke vënë në dukje se padia është paraqitur në vitin 2012, ndërsa kamatëvonesat e kërkuara lidhen me një të drejtë që i përket periudhës 2005 - 2006.

34. Çështja është shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila e ka gjetur të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me llogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm të kërkuesit, duke përcaktuar vlerën e diferencës së papaguar atij, mbështetur në përfundimet e një ekspertimi kontabël të realizuar gjatë gjykimit. Vendimi i kësaj gjykate në vijim është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material, konkretisht nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, pasi masa e përgjithshme e pensionit nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Sipas Gjykatës së Lartë, në rigjykim gjykata administrative duhet të kryejë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes dhe të analizojë faktet për të zgjidhur çështjen sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

35. Në rigjykim, me vendimin nr. 1023 (86-2023-1558), datë 07.12.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Sipas gjykatës së apelit, megjithëse parimi i sigurisë juridike është prekur nga rregullimi i ri, kjo ndërhyrje është bërë duke respektuar kriteret kushtetuese, ndërsa skema e re e rillogaritjes së miratuar me ligjin nr. 10142/2009 është gjetur e aplikueshme pas hyrjes së tij në fuqi dhe në përputhje me Kushtetutën, sipas vendimit të Gjykatës nr. 2/2013. Duke evidentuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk kishte përcaktuar detyra konkrete, por kishte vënë në dukje qëndrimin unifikues në vendimin nr. 3/2016, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejt ligjin material, ndërkohë që llogaritja e pensionit të parakohshëm të kërkuesit nga DRSSH-ja, Tiranë është bërë në përputhje me formulën e nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-1414, datë 08.04.2024 ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

36. Bazuar në standardet e mësipërme dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se, sikurse gjykatat e zakonshme kanë pranuar, kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.08.2005, moment në të cilin kjo e drejtë rregullohej nga neni 35 i ligjit nr. 9210/2004 dhe pavarësisht kësaj, në pikën 3 të tij, ishte përcaktuar se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktoheshin në ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, pra në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Në nenin 11 të këtij ligji parashikohej se masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ishte 50 për qind e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2 % të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Ndërkohë, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin 26 të vendimit*), për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme që ai do të përfitonte nga ky shfuqizim, pra se ndaj atij nuk do të zbatohej ky tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm.

37. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht momentit kur kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm dhe ndonëse me ligjin nr. 9210/2004 tavani i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar, Gjykata Administrative e Apelit edhe për periudhën 01.08.2005 - 15.11.2006, kur kërkuesi gëzonte të drejtën e pensionit të parakohshëm, duke u bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, Gjykata Administrative e Apelit duket se nuk e ka llogaritur masën e pensionit sipas parashikimit ligjor për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

38. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004, si dhe mënyra e interpretimit të tij nga gjykata e apelit nuk rezulton të jetë analizuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, ajo nuk shprehet pse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues edhe për periudhën pas vitit 2004, si dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm për këtë

periudhë vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për zbatueshmërinë e kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën objekt mosmarrëveshjeje 01.08.2005 - 15.11.2006 si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm apo se ajo (Gjykata e Lartë) ka dhënë mjaftueshëm argumente për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe për mënyrën e interpretimit të tij nga gjykata e apelit.

39. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë si gjykatë ligji duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Pra, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti, nëse kufizimi "jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" përfshin edhe periudhën kohore objekt mosmarrëveshjeje mes palëve. Prandaj vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji.

40. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit është i bazuar. Megjithatë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

41. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës pjesërisht.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1414, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.04.2025
Shpallur më 04.06.2025

Vendim nr. 25, datë 23.04.2025
(V-25/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.03.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (I) 2024 që u përket:

KËRKUES: **ISMET ISUFI,** përfaqësuar nga avokat Feriat Janushaj.

SUBJEKT I INTERESUAR:
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE, TIRANË, përfaqësuar nga zoti Fatjon Ferko.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 695, datë 05.10.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1416, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dhënia e një shpërblimi të drejtë për tejzgjatje të afatit të arsyeshëm ligjor të procesit gjyqësor 12-vjeçar në respektim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 17, 18, 42, 43, 44, 52, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* nenet 6, pika 1, 13 dhe 35, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 31, 49, pika 1, shkronja "e", 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000**

“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Ismet Isufi *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë *(DRSSH),* që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ismet Isufi ka qenë oficer aktiv i Forcave të Armatosura nga data 04.11.1970. Ai ka dalë në rezervë në datën 30.09.1992, ndërsa mbante gradën “nënkolonel”, duke pasur një vjetërsi në shërbimi si ushtarak aktiv prej 21 vjetësh e 10 muajsh.

2. Pas përfundimit të periudhës së trajtimit me pagesë kalimtare, në datën 12.01.2000 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për t’u trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi (*pension i parakohshëm*) sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe SHISH”, të ndryshuar *(ligji nr. 8087/1996)*. DRSSH-ja, Tiranë, me vendimin nr. 1477, datë 17.02.2000 *(vendimi nr. 1477/2000),* pasi ka verifikuar plotësimin e kushteve të përfitimit, e ka trajtuar kërkuesin me pension të parakohshëm në masën 8.000 lekë në muaj. Pensionin e parakohshëm kërkuesi e ka përfituar nga data 01.01.1999.

3. Kërkuesi në datën 20.06.2011 i është drejtuar me kërkesë DRSSH-së, tashmë për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Me vendimin nr. 3882, datë 25.07.2011, DRSSH-ja i ka caktuar kërkuesit pensionin e pleqërisë, për periudhën e sigurimit 40 vjet e 5 muaj, me masë pensioni fillestar 12.191 lekë dhe me të drejtë pagese nga data 17.06.2011. Ndërsa me vendimin nr. 187, datë 15.12.2011, kërkuesit i është caktuar edhe pensioni suplementar i pleqërisë, si ushtarak, me të drejtë pagese nga data 17.06.2011, në masën

fillestare 9.863 lekë. Përllogaritja është bërë në bazë të pagës neto mujore 50.729 lekë. Ndërkohë DRSSH-ja, me vendimin nr. D, datë 15.12.2011, ka vendosur mbylljen e pensionit të parakohshëm për shkak se kërkuesi kishte plotësuar kushtet për pensionin e pleqërisë dhe atë suplementar.

4. Masën dhe mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm dhe të pensionit të pleqërisë e atij suplementar kërkuesi i ka kundërshtuar nëpërmjet dy proceseve gjyqësore të ndryshme.

I. Procesi gjyqësor për pensionin e parakohshëm

5. Kërkuesi në datën 28.09.2012 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për kundërshtimin e vendimit nr. 1477/2000 të DRSSH-së, Tiranë, duke kërkuar rillogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm dhe indeksimin e tij në zbatim të ligjit nr. 8087/1996 sipas formulës së parashikuar në nenin 11 të tij (50% të pagës referuese për 15 vjet vjetërsi shërbimi dhe mbi 15 vjet masa e pensionit shtohet me 2 % të pagës). Kërkuesi ka pretenduar se masa e pensionit të parakohshëm të llogaritur nga DRSSH-ja është 3.632 lekë më pak. Ai ka kërkuar edhe detyrimin e DRSSH-së, Tiranë për t'i paguar diferencat që rezultonin nga llogaritja e gabuar e këtij pensioni për periudhën 01.01.1999-16.06.2011, sipas nenit 31, pika 3, të ligjit nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura" *(ligji nr. 9418/2005)*, të ndryshuar.

6. Pas shpalljes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të moskompetencës lëndore, çështja ka kaluar për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 3508, datë 24.06.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, që të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm në masën 50% të pagës referuese së bashku me shtesat 2% për çdo vit të vjetërsisë së shërbimit mbi 15 vjet, duke aplikuar rritjet e përvitshme sipas VKM-ve përkatëse, si dhe pagimin e diferencave të rezultuara nga shuma e përfituar nga paditësi/kërkuesi, nga data e lindjes së të drejtës 01.01.1999 deri në datën 01.07.2009, duke arsyetuar se kufizimi i vendosur nga DRSSH-ja, deri në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, i parashikuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, nuk ka qenë në fuqi, pasi është shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura" *(ligji nr. 9210/2004*), ndërkohë që e njëjta formulë për masën e pensionit të parakohshëm parashikohet

edhe nga ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar, i cili për ushtarakët me gradën nënkolonel parashikon se masa e pensionit nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, ligj ky që duhet të zbatohet edhe për paditësin/kërkuesin nga data 04.03.2007, e hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës nr. 9, datë 26.02.2007. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkimit për sa i përket indeksimit të pensionit të parakohshëm, pasi këto lloj pensionesh nuk përfitojnë nga rritja e indeksimit të përvitshëm. Gjykata ka vendosur rrëzimin edhe të kërkimit për detyrimin e DRSSH-së, Tiranë që të rillogarisë dhe përcaktojë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si dhe t'i paguajë diferencat nga rillogaritja e pensionit të parakohshëm të ushtarakut nga data 01.07.2009 deri në datën 16.06.2011, sepse, sipas saj, pas datës 30.06.2009 ndaj kërkuesit është zbatuar ligji nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 10142/2009*), i cili në pikën 2 të nenit 29 përcakton se rillogaritja bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në bazë të pagës neto referuese në momentin që ka lindur e drejta për përfitim.

7. Kundër vendimit kanë paraqitur ankim të dyja palët ndërgjyqëse. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2418, datë 27.07.2016 (vendimi nr. 2418/2016), ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3508, datë 24.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar DRSSH-së, Tiranë t'i paguajë paditësit/kërkuesit shumën prej 294.694 lekësh si diferencë e papaguar e pensionit të parakohshëm për periudhën 13.05.2004 deri në 30.06.2009, duke arsyetuar se në kohën kur kërkuesit i ka lindur e drejta e pensionit ka qenë në fuqi ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, që parashikonte se masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi dhe DRSSH-ja ka qenë e detyruar të zbatonte këtë parashikim ligjor. Gjithsesi, sipas asaj gjykate, duke qenë se ligji nr. 9210/2004 ka shfuqizuar shprehjen *"por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi"* në shkronjën "b" të nenit 11 të ligjit 8087/1996*,* pala e paditur duhet të reflektonte këto ndryshime. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera si të pabazuar në ligj, duke vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë.

8. Edhe ndaj këtij vendimi palët ndërgjyqëse kanë paraqitur rekurs. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-747 (346), datë 03.05.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2418, datë 27.07.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material dhe në rigjykim duhet të analizohen faktet për të zgjidhur çështjen duke zbatuar ligjin sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi unifikues nr. 3/2016)*.

9. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 227, datë 12.10.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk konsiderohej përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues.

10. Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë, ajo është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.06.2017. Rezulton se kërkuesi në datën 24.05.2021 i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të mosmarrëveshjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6/29, datë 17.01.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm.

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës edhe me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit dhe shfuqizimin e vendimit nr. 6/29, datë 17.01.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 142, datë 27.06.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se edhe pse ishin shteruar mjetet juridike në dispozicion, kërkesa për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor. Ndërsa për konstatimin e cenimit të së drejtës për shkak të mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vlerësuar se në situatën që ndodhej kërkuesi, në kuptim të parimit të subsidiaritetit dhe duke pasur parasysh kohën jo të shkurtër (mbi 15 muaj) që ka kaluar nga vendimi i mëparshëm i Gjykatës së Lartë deri në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, ai mund t`i drejtohej kësaj të fundit përsëri me kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, si mjeti

efektiv për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar dhe korrigjimin e pasojave të saj. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë kërkim kërkuesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion (*shih paragrafin 26 të vendimit nr. 142, datë 27.06.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

12. Pas kthimit të çështjes së themelit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 695, datë 05.10.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3508, datë 24.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, momentin e lindjes së të drejtës dhe përfundimeve të vendimit unifikues nr. 3/2016, ajo gjykatë ka vlerësuar se duhet të zbatohet neni 11 i ligjit nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, pra se pensioni i parakohshëm përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë që është një përqindje fikse (50%) për një minimum periudhe shërbimi (15 vjet) dhe pjesa e dytë që është një shtesë në përqindje për çdo vit më shumë shërbimi. Sipas gjykatës së apelit pensioni i parakohshëm (pra shuma e të dy pjesëve) nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, prandaj përllogaritja e DRSSH-së, Tiranë është bërë sipas ligjit. Kërkuesi ka kërkuar aplikimin e një skeme pa kufizime në masën e pensionit të parakohshëm në një kohë kur ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur ai ka dalë në pension të parakohshëm parashikonte kufizime.

13. Mbi rekursin e ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, gjatë procedurës seleksionuese, me vendimin nr. 00-2024-1416, datë 08.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi në përmbajtje të tij nuk parashtrohej asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" *(ligji nr. 49/2012).*

II. Procesi gjyqësor për pensionin e pleqërisë dhe atë suplementar

14. Vendimin nr. 3882, datë 25.07.2011, DRSSH-ja, Tiranë për caktimin e pensionit të plotë të pleqërisë, me periudhë sigurimi 40 vjet e 5 muaj, me masë pensioni fillestar 12.191 lekë, me të drejtë pagese nga data 17.06.2011, si dhe vendimin nr. 187, datë 15.12.2011 për caktimin e pensionit suplementar të pleqërisë *(shih paragrafin 3 të vendimit),* sikundër edhe rillogaritjen e këtij pensioni bazuar në ligjin nr. 10142/2009 kërkuesi e ka kundërshtuar në rrugë administrative dhe gjyqësore. Me vendim të formës së prerë nr. 1885 (86-2024-2049), datë 11.11.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur ndryshimi i datës së fillimit të së drejtës për pensionin e pleqërisë nga data 16.06.2011 në datën 17.06.2009

dhe detyrimi i DRSSH-së të paguajë diferencat e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të indeksuar sipas viteve për këtë periudhë.

15. Në vijim, kërkuesi në datën 22.07.2024 i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimet nr. 695, datë 05.10.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-1416, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), të cilat lidhen me procesin e parë gjyqësor për kundërshtimin e pensionit të parakohshëm. Kolegji i Gjykatës në datën 24.10.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 11.11.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. ***Kërkuesi*** ka parashtruar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar:

16.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

16.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë dhe së drejtës së ankimit efektiv në kuptimin substancial,* pasi Gjykata Administrative e Apelit e ka zhvilluar seancën në dhomën e këshillimit, pa njoftimin e palëve dhe praninë e tyre, duke mos u dhënë mundësi për t'u mbrojtur. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në shkelje të kompetencave të saj dhe të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, si dhe Gjykatës Kushtetuese. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit i ka hequr atij mundësinë për të kundërshtuar vendimin e paligjshëm të gjykatës së apelit.

16.1.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj,* pasi çështja e pensionit të parakohshëm për një periudhë 12-vjeçare nuk është zgjidhur edhe për shkak të veprimeve/mosveprimeve të gjykatave, gjë që ngre dyshime serioze dhe të arsyeshme për pavarësinë dhe paanësinë e tyre. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në kundërshtim me ligjin dhe vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara, në dispozitiv në

mënyrë të përgjithshme i ka vendosur palës së paditur një detyrim të pazbatueshëm, nuk ka marrë në konsideratë aktin e ekspertimit, sipas të cilit pala e paditur është debitore në shuma konkrete për periudhën 01.01.1999-30.06.2009 dhe nuk ka verifikuar kërkesën kryesore të kërkesëpadisë, nëse akti administrativ nr. 1477/2000 është i ligjshëm ose jo dhe nëse në këtë akt është pasqyruar drejt zbatimi i dispozitave ligjore të zbatueshme në kohë. Gjykata Administrative e Apelit në vitin 2016 nuk ka bërë hetim të plotë dhe nuk u ka dhënë përgjigje kërkesave kryesore të kërkesëpadisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2017 ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, duke dhënë orientime në favor të palës së paditur. Gjykata Administrative e Apelit në rigjykim, jo pa qëllim, e ka zvarritur procesin duke u hakmarrë për shkak të denoncimit në shtyp për shkeljen e ligjit në shqyrtimin e çështjes. Kjo gjykatë pas 6 vjetësh ka vendosur në dhomën e këshillimit rrëzimin e kërkesëpadisë, duke hedhur poshtë të gjithë procesin gjyqësor të zhvilluar në 11 vjet dhe nuk ka marrë parasysh praktikën dhe udhëzimet e Gjykatës së Lartë. Edhe në vitin 2024 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit ka marrë një vendim në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk ka ushtruar detyrimin kushtetues për kontrollin efektiv për kuptimin dhe zbatimin e ligjit procedural dhe material nga gjykata e apelit. Çështja është paragjykuar nga gjyqtarët dhe nuk është shqyrtuar në tërësi situata faktike e ligjore. Gjykatat kanë cenuar edhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi kanë vepruar haptazi në kundërshtim me ligjin dhe nuk kanë zbatuar me korrektësi rregullat juridike.

16.1.3. *Së drejtës për një gjykim të drejtë,* pasi gjykata administrative e apelit nuk ka lexuar materialet e dosjes gjyqësore dhe nuk ka dhënë një arsyetim minimal se përse nuk janë marrë në konsideratë pretendimet shtesë të ankimit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka lexuar rekursin dhe dokumentet që e shoqëronin, pasi në vendim ka mospërputhje të madhe, serioze dhe thelbësore midis shkaqeve që paraqet relatori dhe shkaqeve të shumta e thelbësore, me natyrë

ligjore e kushtetuese, të parashtruara në rekurs. Kolegji Administrativ nuk ka zhvilluar një gjykim të drejtë, në pajtim me ligjin, përkundrazi për shkak të procedurës së parregullt ka cenuar të drejtën e leximit të rekursit dhe nuk ka ushtruar kontroll efektiv ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit.

16.1.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* pasi kërkuesi, si pensionist, është në pozicion jo të favorshëm në krahasim me palën e paditur, që përfaqëson shtetin. Gjykata Administrative e Apelit duke shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit ka cenuar barazinë e palëve. Ajo nuk ka dëgjuar dhe verifikuar pretendimet e palëve, për më tepër në kushtet kur ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky parim është cenuar edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka lexuar pretendimet e parashtruara në rekurs.

16.1.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë rrjedhojë e një procesi të parregullt gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse nuk e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, sipas neneve 486 dhe 493 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) për zbatimin e konkluzioneve të lëna nga Gjykata e Lartë, sikurse ishte ndreqja e zbatimit të gabuar të ligjit të bërë në gjykimet e mëparshme, hetimi i plotë dhe i gjithanshëm, si dhe analiza e fakteve për zgjidhjen e çështjes sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3/2016. Ajo gjykatë vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë pa asnjë arsyetim. Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit mund të vendosë vetëm për pranimin ose jo të ankimit dhe nuk mund të marrë një vendim diametralisht të kundërt me vendimin e gjykatës së faktit. Vendimi i asaj gjykate nuk mbështetet në fakte që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, nuk përmban bazën ligjore dhe as analizën e fakteve e provave për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Të dyja vendimet, ai i apelit dhe i Gjykatës së Lartë, janë alogjike, kontradiktore dhe nuk plotësojnë kriteret minimale për arsyetimin e vendimit. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë të padrejtë ka fshehur shkaqet reale dhe objektive të rekursit.

Ky kolegj duke përdorur shprehjen deklarative se *"në rekurs nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012"* dhe duke mos e shoqëruar me argument bindës, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Pas studimit të fashikullit të Gjykatës së Lartë është konstatuar se e gjithë procedura e dokumenteve që e shoqërojnë atë deri edhe vendimmarrja i është lënë vetëm dhe kryesisht këshilltarit ligjor, i cili ka ushtruar funksionin e tij në kundërshtim të hapur e flagrant me Kushtetutën. Në relacionin e hartuar prej tij ka mospërputhje mes rrethanave të fakteve, problemeve dhe shkaqeve që paraqiten në rekurs. Janë paraqitur në mënyrë skematike e formale disa rrethana dhe janë anashkaluar ato më thelbësore, ndërkohë që nuk evidentohet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2418/2016, i cili është i formës së prerë dhe është ekzekutuar që në shtator të vitit 2016.

16.1.6. *Parimit të sigurisë juridike dhe i pritshmërive të ligjshme,* pasi Gjykata Administrative e Apelit duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë ka shkelur parimin e ligjshmërisë, sepse e drejta e pensionit ekziston ligjërisht si e drejtë subjektive e garantuar në Kushtetutë dhe në ligjin për sigurimet shoqërore. Masa e pensionit të parakohshëm të përcaktuar me aktin administrativ nr. 1477/2000 është në kundërshtim me ligjin dhe ka pësuar zvogëlim drastik. Për shkak të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ai detyrohet të kthejë shumën e përfituar, duke i rënduar edhe më tej gjendjen ekonomike. Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrën kushtetuese për të ushtruar kontroll për kuptimin dhe zbatimin e ligjit material e procedural. Procesi gjyqësor, pas 12 vjetësh, si rezultat i vendimeve të dhëna rezultoi pa asnjë dobi dhe në cenim të parimit të sigurisë juridike, duke mos pasur mundësi për mbrojtjen e të drejtave të fituara.

16.1.7. *Së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* pasi procesi gjyqësor ka zgjatur gati 12 vjet pa u zgjidhur përfundimisht. Çështja është e natyrës administrative, jo komplekse, por e thjeshtë. Faktor pengues në tejzgjatjen e paarsyeshme ka qenë mosfunksionimi i mirë i gjykatave të sistemit të zakonshëm. Kërkesat e drejtuara gjykatave për

përshpejtimin e gjykimit nuk rezultuan mjete efektive dhe tejzgjatja e procesit për 12 vjet, pa një zgjidhje përfundimtare tregon se nuk është respektuar e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

16.1.8. *Së drejtës për një shpërblim të drejtë,* të parashikuar në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577/2000, për shkak të cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të gëzimit të pensionit, si i vetmi burim ekonomiko-financiar, duke mos pasur asnjë të ardhur tjetër, si dhe për shkak të zgjatjes së afatit të arsyeshëm 12 vjet pa një zgjidhje përfundimtare.

16.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit,* pasi ushtarakët janë trajtuar arbitrarisht njëlloj si civilët qoftë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) ashtu edhe nga gjykatat. Gjithashtu, edhe mes vetë ushtarakëve ka ekzistuar trajtim jo i barabartë në përfitimin e pensionit të parakohshëm, megjithëse të ndodhur në kushte objektivisht të njëjta. Në rastin e kërkuesit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë përshkruan në mënyrë të përgjithshme e të pazbatueshme shumën detyruese, ndërsa në rastin e kolegut D.S., i trajtuar më parë, jepet shuma e saktë e masës së pensionit të parakohshëm dhe e shumës së kamatëvonesave. Po ashtu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në rastin e kërkuesit ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim, ndërsa në rastin e një kolegu tjetër, R.D., e ka zgjidhur vetë çështjen. Me ligjin nr. 10142/2009 është prekur vetëm kategoria e ushtarakëve, të cilëve u është zvogëluar masa e pensionit në mënyrë drastike. Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit unifikues nr. 3/2016 ka urdhëruar të zbatohet vetëm ky ligj, duke shuar të drejtën kushtetuese për të kundërshtuar vendimet e padrejta.

16.3. *Të drejtën për pension, të garantuar në nenin 52 të Kushtetutës,* pasi pensioni i parakohshëm është një e drejtë themelore që gëzon ushtaraku, bazuar në Kushtetutë dhe ligjin specifik. Pensioni i parakohshëm është përfitim monetar mujor që i garantohet ushtarakut në bazë të ligjeve, kur, pa dëshirën e tij, i ndërpritet karriera për shkak të reformës në Forcat e Armatosura, për aq kohë sa plotësohen kushtet ligjore për pensionin e pleqërisë. Vendimet gjyqësore kanë mohuar padrejtësisht të drejtën kushtetuese të gëzimit të pensionit. DRSSH-ja në kundërshtim me kuadrin ligjor

ka përcaktuar masën e pensionit të parakohshëm 4-5 herë më të vogël se masa që parashikon ligji, pasi nuk ka asnjë reflektim në vendim për ndryshimin e pensionit me ndryshimin e pagës referuese të ushtarakëve aktivë mbi të cilën është bërë llogaritja e pensionit për të gjithë periudhën nga data 01.01.1999-17.06.2011. Akti nr. 1477/2000 i DRSSH-së është absolutisht i pavlefshëm, sepse është shkelur parimi themelor, ai i ligjshmërisë, i parashikuar në nenin 9 të Kodit të Procedurave Administrative. Akti nuk ka dalë në bazë dhe për zbatimin e ligjit nr. 8087/1996 të ndryshuar dhe ka zvogëluar në mënyrë drastike masën e pensionit, fillimisht 30 % e në përfundim në 70 % të masës ligjore, duke cenuar rëndë të drejtën themelore kushtetuese, atë të gëzimit të pensionit të parakohshëm, si ushtarak i Forcave të Armatosura në lirim, si i vetmi burim jetik, pa asnjë të ardhur tjetër, në masën e parashikuar nga ligji specifik në fjalë. DRSSH-ja ka shtyrë në mënyrë të padrejtë edhe 2 vjet daljen në pension, nga data 17.06.2009 në 17.06.2011 dhe nga masa e pensionit të parakohshëm që ka përfituar kërkuesi është paguar 1.400 lekë në muaj më pak.

17. ***Subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë,*** në mënyrë në përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

17.1. *Pretendimi për të drejtën për pension* është i pabazuar, pasi DRSSH-ja me vendimin e datës 05.10.2016 ka rillogaritur përfitimin e kërkuesit sipas përcaktimeve në dispozitivin e vendimit të gjykatës, duke përllogaritur diferencat e pensionit të parakohshëm për periudhën 13.05.2004-30.06.2009 në shumën 294.694 lekë në total. Diferencat i kanë kaluar kërkuesit sipas urdhërpagesës së datës 05.10.2016. Llogaritja e diferencave deri në datën 30.06.2009 ka ardhur si pasojë e efekteve financiare të ligjit nr. 10142/2009. Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar, me të cilin deri në atë moment trajtoheshin ushtarakët e Forcave të Armatosura. Ligji nr. 10142/2009, i ndryshuar me aktin normativ nr. 5/2010, parashikonte skemë llogaritjeje të ndryshme dhe masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndryshoi përsëri. Në nenin 29 të këtij ligji parashikohej se pensioni i parakohshëm, si dhe pensionet e caktuara në përputhje me ligjin nr. 8087/1996 do të rillogariteshin duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me vendim gjykate, pra në këtë dispozitë përcaktohej shprehimisht detyrimi i DRSSH-së për të bërë

rillogaritjen e re. Në këto kushte, me të drejtë, DRSSH-ja, Tiranë ka bërë rillogaritjen e pensionit të parakohshëm në bazë të neneve 14 dhe 29 të ligjit nr. 10142/2009, duke iu referuar pagës mesatare referuese mujore neto dhe VKM-ve përkatëse. Me anë të vendimit nr. 1477/1, datë 22.04.2014 është bërë rillogaritja e pensionit të kërkuesit, i cili nuk ka qenë dakord me vendimin e caktimit të masës së pensionit (në një masë më të vogël), me indeksimin e tij dhe pagën referuese. Duke u referuar në ligjin material, si edhe në vendimin unifikues nr. 3/2016 të Gjykatës së Lartë, po ashtu edhe në frymën e vendimit nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese, kërkesa drejtuar Gjykatës është e pambështetur në prova dhe në ligj.

17.2. *Pretendimi për pagën referuese* nuk qëndron, pasi DRSSH-ja, Tiranë i është referuar dokumentacionit zyrtar të përcjellë nga Ministria e Mbrojtjes sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 579, datë 08.12.1999 "Për kushtet dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar i ushtarakëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në rastet e nxjerrjes së tyre në rezervë, lirim ose pension" *(VKM nr. 579/1999).* Ministria, bazuar në pikën 4 të VKM-së, pas kërkesës së palës së interesuar, ka përgatitur vërtetimin për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mbi të cilën është derdhur kontributi.

17.3. Pretendimi për cenimin e pozitës juridike nuk është i bazuar, pasi zbatimi i kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien është i detyrueshëm për palët dhe gjykatat. Akti normativ nr. 5/2010 ka qenë objekt shqyrtimi në Gjykatë, e cila ka vlerësuar se ndërhyrja e ligjvënësit në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës ka qenë e nevojshme dhe e diktuar nga një interes publik. Për më tepër, kërkuesi është subjekt i faljes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 156/2020 për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues nr. 3/2016.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

18. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesi si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, sepse është palë në procesin gjyqësor objekt kundërshtimi, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

20. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi në aspektin formal t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, por edhe që në aspektin substancial të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në thelb, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Kërkuesi në ankimin e tij ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*. Në lidhje me këtë pretendim ai ka parashtruar se procesi gjyqësor në tërësi ka zgjatur gati 12 vjet pa u zgjidhur përfundimisht dhe faktor pengues në tejzgjatjen e

paarsyeshme ka qenë mosfunksionimi i mirë i gjykatave të sistemit të zakonshëm. Edhe kërkesat e drejtuara këtyre gjykatave për përshpejtimin e gjykimit nuk kanë rezultuar mjete efektive. Po ashtu, kërkuesi, për shkak të zgjatjes së afatit të shqyrtimit të çështjes, në drejtim të gëzimit të pensionit, si i vetmi burim ekonomiko-financiar, ka pretenduar se i takon dhënia e *një shpërblimi të drejtë,* në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577/2000.

22. Lidhur me të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike (nenet 399/1 e vijues të KPC-së), që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individi duhet t'i shfrytëzojë ato përpara se t'i drejtohet asaj *(shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata vëren se dispozitat procedurale të sipërcituara (nenet 399/1 e vijues të KPC-së) nuk parashikojnë mjete të veçanta për kohëzgjatjen e procesit në tërësi, por vetëm për kohëzgjatjen e procesit në secilën prej fazave dhe shkallëve të gjykimit. Në këtë drejtim në jurisprudencën kushtetuese për sa i takon "fragmentarizimit të procedurave" është pohuar se edhe pse sipas ligjit zgjidhja përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese zbatohet për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, kohëzgjatja e procesit jo vetëm që vlerësohet në lidhje me kohëzgjatjen tërësore të procedurave, por, nga ana tjetër, ndikon drejtpërsëdrejti në këtë drejtim Për këto arsye, në rast se individi nuk i shteron mjetet juridike në momentin dhe kohën e duhur, në përputhje me mundësitë dhe të drejtat që i ofron legjislacioni i zakonshëm për korrigjimin e shkeljes së pretenduar, kjo nuk nënkupton se ai mund të rivendoset në të drejtën për të ngritur pretendime në Gjykatë në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes tërësore të procesit *(shih vendimin nr. 45, datë 11.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Në rastin në shqyrtim, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafët 9 – 11 të vendimit*), Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të mosmarrëveshjes nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ndërsa Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, duke pasur parasysh periudhën prej 15 muajsh që kishte kaluar nga vendimi i Gjykatës së Lartë deri në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, ka vlerësuar se ai kishte mundësi t'i drejtohej kësaj të fundit përsëri me kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, si mjeti efektiv për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar dhe

korrigjimin e pasojave të saj. Edhe pse kërkuesi nuk ka paraqitur përsëri përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, në kushtet kur pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve, Gjykata Administrative e Apelit kishte shpallur datën për gjykimin e ankimit të tij, Gjykata vlerëson se ai nuk kishte në dispozicion mjete të tjera juridike për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi për këtë pretendim i ka shteruar mjetet juridike. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se për sa kohë që gjykata e apelit kishte caktuar datën e shqyrtimit të çështjes së kërkuesit dhe ishte shprehur me vendim për ankimin e tij, mjetet procedurale të përdorura prej tij e kanë arritur qëllimin e tyre përshpejtues, prandaj ky pretendim i tij nuk do të merret në shqyrtim .

24. Ndërsa për pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe së drejtës për pension, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimet e tjera, pasi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

25. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 22.07.2024, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet prej tij është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 08.04.2024, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

26. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit dhe ankimit efektiv në kuptimin substancial, së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, së drejtës për një gjykim të drejtë, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, së drejtës për shpërblim të drejtë, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit dhe së drejtës për pension.

27. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për shpërblim të drejtë për shkak të cenimit të së drejtës për proces të rregullt nga gjykatat e zakonshme, të cilin ai e bazon në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vlerëson se kjo dispozitë ligjore lidhet me tejzgjatjen e gjykimit kushtetues. Prandaj ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit dhe ankimit efektiv*, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit e ka zhvilluar seancën në dhomën e këshillimit, pa njoftuar palët dhe pa praninë e tyre, duke mos u dhënë mundësinë për t'u mbrojtur. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit i ka hequr mundësinë për të kundërshtuar vendimin e paligjshëm të gjykatës së apelit. Gjykata vëren se në aspektin procedural shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe rregullat e njoftimit janë të përcaktuara në nenin 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara, kurse palët kanë të drejtë të paraqesin deri në 5 ditë përpara seancës parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit.

29. Në bazë të akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit të çështjes rezulton se me vendimin e datës 15.02.2019 gjyqtarja relatore e Gjykatës Administrative të Apelit ka caktuar seancën në datën 06.03.2019 për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, si dhe ka urdhëruar njoftimin e palëve nga sekretaria gjyqësore. Për shkak të paraqitjes së kërkesave për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes të dy gjyqtarëve të trupit gjykues, në datat 07.03.2019 dhe 20.05.2019 është vendosur shtyrja e seancës gjyqësore. Në datën 29.06.2020 kërkuesi ka paraqitur parashtrime shtesë të ankimit. Ndërkohë pas caktimit të gjyqtarit të ri sipas shortit të datës 12.09.2023, në datën 19.09.2023 është bërë shpallja për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit në datën 05.10.2023. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se jo vetëm Gjykata Administrative e Apelit i ka njoftuar palët sipas rregullave procedurale, por kërkuesi si nëpërmjet ankimit, ashtu edhe nëpërmjet parashtrimeve të paraqitura e ka ushtruar të drejtën për të marrë pjesë në gjykim. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur *nuk nënkupton vetëm atë për t'u paraqitur personalisht, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi* komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse

(*shih vendimet nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndaj pretendimi i tij në këtë drejtim është haptazi i bazuar. Edhe për pretendimin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit ka hequr mundësinë për të kundërshtuar vendimin e paligjshëm të gjykatës së apelit, Gjykata vëren se kërkuesi i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet për të kundërshtuar vendimet gjyqësore, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

30. Në lidhje me të *drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj* kërkuesi ka parashtruar mes të tjerave se moszgjidhja e çështjes së pensionit sipas ligjit për një periudhë 12-vjeçare është edhe për shkak të veprimeve/mosveprimeve të gjykatave, duke vënë në dyshim pavarësinë dhe paanësinë e tyre. Sipas kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit në rigjykim, jo pa qëllim e ka zvarritur procesin dhe e ka kthyer në hakmarrje personale për shkak të denoncimit të tij në shtyp për shkeljen e ligjit në shqyrtimin e çështjes. Po në lidhje me këtë pretendim, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat nuk kanë kryer hetim të plotë, nuk kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit, si dhe nuk janë shprehur për pretendimet e tij. Bazuar në shkaqet e paraqitura nga kërkuesi, Gjykata vlerëson se ato nuk përbëjnë argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, prandaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

31. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* në disa drejtime: i) Gjykata Administrative e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse nuk e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, sipas neneve 486 dhe 493 të KPC-së. Të njëjtat pretendime kërkuesi i ka paraqitur edhe për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*; ii) vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë alogjike, kontradiktore dhe nuk plotësojnë kriteret minimale për arsyetimin e vendimit. Gjykata e Lartë nuk ka paraqitur të gjitha pretendimet e parashtruara në rekurs. Të njëjtat pretendime kërkuesi ka paraqitur edhe për cenimin e *së drejtës për gjykim të drejtë*. Gjithashtu, në parashtrimet e datës 13.12.2024 kërkuesi ka parashtruar edhe se iii) e gjithë procedura në Gjykatën e Lartë është kryer nga këshilltari ligjor, në kundërshtim me Kushtetutën.

32. Për pretendimin se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse nuk e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, sipas neneve 486 dhe 493 të KPC-së, Gjykata vëren se në këto dispozita parashikohet se udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës

së Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen (neni 486 i KPC-së) dhe se në rigjykim gjykata zbaton të njëjtat rregulla procedurale të parashikuara në atë shkallë gjykimi (neni 493 i KPC-së). Gjykata vëren se ligji nr. 49/2012 parashikon se shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit (neni 49), ndërsa gjykon çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, konkretisht kur duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, kur vendimi i kundërshtuar është bazuar në shkelje të rënda procedurale ose kur për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. Prandaj në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, duke qenë se gjykata administrative e apelit nuk ndodhej përpara ndonjë prej rasteve për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në këtë drejtim së bashku me atë të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nuk mund të merret në shqyrtim.

33. Për pretendimet në lidhje me veprimtarinë e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se veprimtaria e këshilltarit ligjor ka natyrë ndihmëse dhe këshillimore për funksionet gjyqësore të trupit gjykues dhe dokumentohet në akte me karakter të brendshëm, të cilat nuk janë të detyrueshme për t'iu komunikuar palëve (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo do të thotë se mënyra dhe cilësia e përmbushjes së detyrave funksionale të këshilltarit ligjor, si rregull, nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues kur Gjykata verifikon pretendimet për procesin e rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese).* Për rrjedhojë, për sa kohë çështja e kërkuesit është marrë në shqyrtim nga trupi gjykues përkatës, Gjykata vlerëson se pretendimet e tij në këtë drejtim nuk mund të merren në shqyrtim.

34. Për pretendimin e cenimit të *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit* kërkuesi ka pretenduar se mes ushtarakëve ka pasur trajtim jo të barabartë në përfitimin e pensionit të parakohshëm, megjithëse të ndodhur në kushte objektivisht të njëjta. Në drejtim të këtij pretendimi, kërkuesi ka parashtruar se për çështjen e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2017 ka vendosur kthimin për rigjykim, kurse në një rast tjetër e ka zgjidhur vetë. Sipas tij, me ligjin nr. 10142/2009 është prekur vetëm kategoria e ushtarakëve, të cilëve u është zvogëluar masa e pensionit në mënyrë drastike dhe Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit

unifikues nr. 3/2016 ka urdhëruar të zbatohet vetëm ky ligj, duke shuar të drejtën kushtetuese për të kundërshtuar vendimet e padrejta. Gjithashtu, po sipas tij, gjykata administrative e shkallës së parë ka përshkruar në mënyrë të përgjithshme e të pazbatueshme shumën detyruese, ndërsa në rastin e kolegut D.S., i trajtuar më parë, jepet shuma e saktë e pensionit dhe e kamatëvonesave.

35. Në lidhje me vendimet e referuara nga kërkuesi, fillimisht konstatohet se nuk janë vendime njësuese, pra të jenë të detyrueshëm për zbatim nga gjykatat më të ulëta. Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e shqyrtimit të pretendimeve dhe provave të ndryshme të paraqitura prej palëve ndërgjyqëse, ndaj vendimmarrjet, në dukje, të mbështetura në fakte të njëjta, mund të jenë të ndryshme. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në raste të ngjashme, në vetvete nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për të gjitha këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit është haptazi i pabazuar.

36. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, parimit të sigurisë juridike e pritshmërive të ligjshme, si dhe për të drejtën për pension, Gjykata vëren se në thelb kërkuesi ka paraqitur të njëjtat argumente që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, prandaj ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

37. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk mbështetet në fakte që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, nuk përmban bazën ligjore dhe as analizën e fakteve e provave për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Të dyja vendimet, ai i Gjykatës Administrative të Apelit dhe i Gjykatës së Lartë, janë rrjedhojë e një procesi të parregullt gjyqësor, përmbajtja e tyre është e paarsyetuar dhe Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve në ngritura në rekurs. Gjykata Administrative e Apelit duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë e për rrjedhojë kthimin e shumave i ka rënduar edhe më tej gjendjen ekonomike. Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrën kushtetuese për të ushtruar kontroll për kuptimin dhe zbatimin e ligjit material e procedural. Procesi gjyqësor, pas 12 vjetësh, si rezultat i vendimeve të dhëna ka cenuar parimin e sigurisë juridike duke mos krijuar mundësi për mbrojtjen e të drejtave të fituara. Vendimet gjyqësore kanë mohuar padrejtësisht të drejtën kushtetuese të gëzimit të pensionit.

38. Subjekti i interesuar ka prapësuar se me vendimin e datës 05.10.2016 kërkuesit i është rillogaritur përfitimi sipas përcaktimeve të vendimit gjyqësor duke përllogaritur diferencat e pensionit të parakohshëm për periudhën 13.05.2004-30.06.2009 në shumën 294.694 lekë në total. Llogaritja e diferencave deri në datën 30.06.2009 ka ardhur si pasojë e efekteve financiare të ligjit nr. 10142/2009, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar, me të cilin deri në atë moment trajtoheshin ushtarakët e Forcave të Armatosura. Ligji nr. 10142/2009, i ndryshuar me aktin normativ nr. 5/2010, parashikonte një skemë llogaritjeje të ndryshme dhe masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndryshoi përsëri. Në nenin 29 të këtij ligji parashikohej se pensionet e parakohshme, si dhe pensionet e caktuara në përputhje me ligjin nr. 8087/1996 do të rillogariteshin, pra në këtë dispozitë përcaktohej shprehimisht detyrimi i DRSSH-së për të bërë rillogaritjen e re. Pretendimet për cenimin e së drejtës për pension të parakohshëm janë të pabazuara, pasi janë të mbështetura në vendimet e gjykatave dhe vendimin unifikues nr. 3/2016, si dhe në dokumentacionin e dërguar nga ministria.

39. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron

si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).*

40. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimin nr. 10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata po kështu është shprehur edhe se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

42. Nisur nga standardi i mësipërm kushtetues, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në rregullimin ligjor ndër vite të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Konkretisht, ky

pension fillimisht është njohur me ligjin nr. 8087/1996. Në nenin 11 të këtij ligji, i ndryshuar në vijim me ligjin nr. 8521/1999, parashikoheshin kushtet dhe masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm. Sipas tij, ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kishin dalë në rezervë e në lirim pas datës 03.07.1991 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përfitonin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësonin vjetërsinë e shërbimit si ushtarak në masën 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat dhe të kishin mbushur moshën: gratë 42 vjeç dhe burrat 47 vjeç. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi u parashikua të ishte: a) 50 për qind të pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi, b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2 për qind të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Gjithashtu, neni 10 i ligjit nr. 8251/1999 parashikoi se efektet e zbatimit të tij do të shtriheshin nga data 01.01.1999.

43. Ndërkohë, me ligjin nr. 9210/2004 shprehja "*por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi"* në shkronjën "b" të ligjit nr. 8087/1996 u shfuqizua (neni 49). Gjithashtu, neni 35 i ligjit nr. 9210/2004 rregulloi të drejtën e pensionit të parakohshëm për ushtarakët aktiv të Forcave të Armatosura, duke parashikuar kushtet dhe masën e përfitimit të këtij pensioni. Në pikën 1 të këtij neni u përcaktua se "*oficerët, nënoficerët dhe ushtarët me pagesë/profesionistë, me vjetërsi shërbimi në Forcat e Armatosura 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, gëzojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e mësipërm ushtarakut i jepet një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore"*. Kurse pika 3 e tij përcaktoi se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi përcaktohen në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror, i ndryshuar. Ndërkohë, në dispozitat e fundit, nenin 48 të ligjit, sa i përkiste zbatimit të nenit 35 të tij, ngarkoi Këshillin e Ministrave që brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të paraqesë ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 8087/1996.

44. Në vijim është miratuar një ligj i ri për sigurimet shoqërore suplementare për ushtarakët e Forcave të Armatosura, pikërisht ligji nr. 9418/2005. Ky ligj,

në nenin 13, përcaktoi kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, të njëjta si ato në ligjin nr. 8087/1996 dhe ligjin nr. 9210/2004. Ndërsa neni 14 rregulloi masën e pensionit të parakohshëm, duke përcaktuar të njëjtën masë pensioni të parakohshëm sikurse dhe neni 35 i ligjit nr. 9210/2004, por me kufizimin se *masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë*. Pika 7 e këtij neni parashikoi se për ushtarakët, të cilëve u ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit të parakohshëm para datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004, niveli i masës së përfitimit të llogaritur vendoset në kufijtë e parashikuar në këtë nen. Neni 32 i tij ngarkoi Këshillin e Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi, të nxirrte aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4 dhe 14 të këtij ligji. Ndërkohë, neni 33 i dispozitave kalimtare, parashikoi se ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që përfitojnë sipas këtij ligji. Ligji hyri në fuqi në datën 01.01.2006.

45. Më pas, ligji nr. 9418/2005 u ndryshua me ligjin nr. 9481/2006, i cili ndryshoi dispozitat në lidhje me kushtet dhe masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm (nenet 13 dhe 14). Për kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, neni 1 i ligjit ndryshues përcaktoi të njëjtat kushte, por identifikoi dy kategori ushtarakësh përfitues: (i) ata që dalin në rezervë/lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004 deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie sipas ligjit nr. 7703/1993, për të cilët masa e përfitimit përcaktohej në nenin 14 të ligjit; (ii) ata që kanë dalë në rezervë/lirim nga data 1 janar 1991 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9210/2004, pavarësisht nga çasti i lindjes të së drejtës për përfitimin e pensionit të parakohshëm, të cilët do të vazhdonin ta përfitonin sipas ligjit nr. 8087/1996. Kurse për masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, neni 2 i ligjit ndryshues, ndërsa përcaktoi të njëjtën masë pensioni të parakohshëm, sikurse dhe neni 35 i ligjit nr. 9210/2004 vendosi kufizime sipas gradave të ushtarakëve, të cilat varionin deri në 6-fishin e pensionit bazë për ushtarakët me gradën "gjeneral", deri në 3-fishin e pensionit bazë për ushtarakët e tjerë, ku për sa u përket ushtarakëve me gradën "nënkolonel" (gradë që e ka pasur edhe kërkuesi Ismet Isufi), kufizimi i masës së pensionit shkonte deri në 4-fishin e pensionit bazë. Neni 9 i ligjit nr. 9481/2006 ndryshoi edhe dispozitën për hyrjen në fuqi të ligjit (nenin 34), duke parashikuar se hynte në fuqi në datën 16.04.2006.

46. Ndërkohë neni 1 i ligjit nr. 9481/2006, i cili ndryshoi nenin 13 të ligjit nr. 9418/2005 për kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, u

shfuqizua nga Gjykata me vendimin nr. 9, datë 26.02.2007, me arsyetimin se ai cenonte parimin e sigurisë juridike për shkak të paqartësisë dhe kontradiktave midis dispozitave të ligjit (në lidhje me nenin 33 të pandryshuar të ligjit nr. 9418/2005), por edhe të parimit të barazisë përpara ligjit. Gjykata konstatoi se kjo dispozitë i ndante ushtarakët në dy kategori për efekt të përfitimit të pensionit të parakohshëm, ndërsa me ligjin e mëparshëm pagesa e pensionit shkonte deri në 4-fishin e pensionit bazë në shkallë vendi, me ligjin e ri u ul pagesa e pensionit të parakohshëm për ushtarakët e dalë në pension deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për statusin (ligji nr. 9210/2004), për të cilët kjo masë shkonte deri në masën e pensionit maksimal në shkallë vendi, e barabartë me 2-fishin e pensionit bazë, kur për ushtarakët e dalë në pension të parakohshëm pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, maksimumi i pagesës jepej i diferencuar sipas gradës dhe shumë më i favorshëm nga ajo që u jepej ushtarakëve që kanë dalë në pension përpara ligjit për statusin. Po kështu, Gjykata konstatoi se neni 1 i ligjit të kundërshtuar i bënte referencë ligjit të vitit 1996 (nr. 8087/1996) për përfitimet e një kategorie ushtarakësh, ndërkohë që neni 33 i pandryshuar i ligjit të vitit 2005 (nr. 9418/2005) ndalonte zbatimin e atyre dispozitave, duke krijuar kështu paqartësi në kuptimin e ligjit dhe në zbatimin e tij. Me këtë vendim Gjykata shfuqizoi edhe nenin 9 të ligjit nr. 9481/2006, përmes të cilit ishte shtyrë hyrja në fuqi e ligjit nr. 9418/2005, duke konstatuar edhe në këtë rast cenimin e parimit të sigurisë juridike.

47. Në vijim u miratua një ligj tjetër për sigurimin shoqëror suplementar edhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, ligji nr. 10142/2009, i cili ka hyrë në fuqi në datën 27.06.2009. Ky ligj ka shfuqizuar si ligjin nr. 8087/1996, ashtu edhe ligjin nr. 9418/2005, përveçse edhe pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9210/2004. Sikurse rezulton nga rrethanat e çështjes dhe pretendimet e kërkuesit, ai ka përmbushur kriteret për pensionin e pleqërisë në datën 17.06.2009. Për rrjedhojë, për sa kohë në shqyrtim është procesi gjyqësor i zhvilluar nga kërkuesi për kundërshtimin e pensionit të parakohshëm, në të cilin ky ligj dhe aktet e tjera e nxjerra në zbatim të tij, nuk janë të zbatueshëm, ato nuk do të merren në analizë nga Gjykata.

48. Në lidhje me zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, për shkak të qëndrimeve të ndryshme të gjykatave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3/2016, kanë arritur edhe në përfundimin njësues se në gjykimin e mosmarrëveshjeve për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, për

periudhën nga data 01.01.1999 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999). Gjithashtu, sipas Kolegjeve të Bashkuara ligji nr. 9210/2004 ka hequr kufizimin në masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të parashikuar, por zbatimi i parashikimit ligjor të këtij ligji ishte i kushtëzuar me nxjerrjen e rregullimeve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve në zbatim të këtij ndryshimi. Caktimi i pensionit të parakohshëm, sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 (i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), bëhej duke u llogaritur sipas skemës: a) 50% e pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi; dhe b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese. Por masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalonte masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Tavani i vendosur në lidhje me masën e pensionit të parakohshëm në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, duhet të zbatohej mbi të gjithë masën e pensionit të parakohshëm.

49. Për sa më lart, në rastin në shqyrtim, nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

50. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesit, si ushtarak në rezervë, e drejta për pension të parakohshëm i ka lindur në datën 01.01.1999. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 8.000 lekë në muaj, sipas aktit administrativ nr. 1477/2000 të DRSSH-së, Tiranë i cili është kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuesi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3508, datë 24.06.2014, ka vlerësuar se masa e pensionit të parakohshëm do të jetë në masën 50% të pagës referuese së bashku me shtesat 2% për çdo vit shërbimi mbi 15 vjet, pa e kufizuar me masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi ose me pensionin për gradë. Ajo ka arsyetuar se kufizimi i zbatuar nga DRSSH-ja, Tiranë sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), se masa e pensionit të parakohshëm nuk duhet të kalojë masën e pensionit

maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, nuk gjen zbatim, pasi ky kufizim është shfuqizuar nga neni 49 i ligjit nr. 9210/2004, ndërkohë që e njëjta formulë për masën e pensionit të parakohshëm parashikohet edhe nga ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), i cili për ushtarakët me gradën "nënkolonel" parashikon se masa e pensionit nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, ligj ky që duhet të zbatohet edhe për paditësin/kërkuesin nga data 04.03.2007 e hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës nr. 9, datë 26.02.2007.

51. Çështja është shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit, vendim i cili është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar gabim ligjin material, konkretisht nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar, duke vendosur kufizimin e masës maksimale të pensionit të pleqërisë në shkallë vendi vetëm te shtesa për vjetërsi (shkronja "b") dhe jo në masën totale të pensionit. Sipas Gjykatës së Lartë, në rigjykim gjykata administrative duhet të kryente një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes dhe të analizonte faktet për të zgjidhur çështjen sipas orientimeve të vendimit unifikues nr. 3/2016.

52. Në rishqyrtim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 695, datë 05.10.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë të kërkuesit. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, kërkuesi ka kërkuar aplikimin e një skeme pa kufizime në masën e pensionit të parakohshëm edhe pse ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur ka dalë në pension të parakohshëm parashikonte kufizime. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në momentin e lindjes së të drejtës nga DRSSH-ja është zbatuar si duhet neni 11 i ligjit nr. 8087/1996. Ligji i zbatueshëm për të gjithë periudhën është ligji nr. 8087/1996 (i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), sipas interpretimit të vendimit unifikues, ndaj Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka gabuar në interpretimin dhe zbatimin e saj. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1416, datë 08.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

53. Bazuar në standardet e mësipërme dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se sikurse ka arsyetuar edhe gjykata e apelit, kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 01.01.1999, moment në të cilin zbatohej ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Në nenin 11 të tij parashikohej se masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ishte 50 për qind e pagës referuese

mbi të cilën është derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohej me 2 % të pagës referuese, por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Ndërkohë, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin 43 të vendimit*), për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, kërkuesit iu krijuan pritshmëri të ligjshme që edhe ai do të përfitonte nga ky shfuqizim, pra se edhe ndaj atij nuk do të zbatohej më ky tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm.

54. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht këtij shfuqizimi, Gjykata Administrative e Apelit edhe për periudhën 2004-2009, pra nga shfuqizimi i tavanit e deri në momentin që kërkuesi ka fituar të drejtën për pension pleqërie, duke u bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, ka përcaktuar se masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, Gjykata Administrative e Apelit duket se nuk e ka llogaritur masën e pensionit sipas parashikimit ligjor në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

55. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se përmbajtja e ligjit nr. 9210/2004, si dhe mënyra e interpretimit të tij nga gjykata e apelit nuk rezultojnë të jenë analizuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, ajo nuk shprehet pse në rastin në shqyrtim kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues edhe për periudhën pas vitit 2004, si dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm për këtë periudhë vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar. Në këtë drejtim, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs lidhur me zbatueshmërinë e kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 2004-2009 si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm apo se ajo (Gjykata e Lartë) ka dhënë mjaftueshëm argumente për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe për mënyrën e interpretimit të tij nga gjykata e apelit.

56. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë si gjykatë ligji duhet t'i kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Pra, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim

të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti, nëse kufizimi "jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi" përfshin edhe periudhën kohore 2004-2009. Prandaj vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji, të paktën për periudhën kohore 2004 - 2009.

57. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit është i bazuar. Megjithatë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se i përket Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre, prandaj duhet të shfuqizohet vetëm vendimi i saj.

58. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj dhe ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1416, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.04.2025
Shpallur më 27.05.2025

Vendim nr. 26, datë 29.04.2025
(V-26/25)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.04.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 47 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARJAN ÇELAJ (alias EDISON ÇELAJ),** përfaqësuar nga avokatët Arjan Salati dhe Henrik Ligori, me akt përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-929, datë 23.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 30, 32, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Arjan Çelaj (alias Edison Çelaj) *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës *(Prokuroria e Durrësit)* për një ngjarje të ndodhur në mbrëmjen e vonë të datës 27.01.2010, ku pranë lokalit të shtetasit B.C., në qytetin e Durrësit, është afruar një motoçikletë, drejtuesi i së cilës mbante një kaskë mbrojtëse. Pasagjeri i saj, që mbante një kapuç në kokë, por që nuk i mbulonte fytyrën, pasi ka hyrë në lokal, ka qëlluar me një armë zjarri në drejtim të shtetasve L.C., A.C. dhe E.SH., duke u shkaktuar atyre vdekjen.

2. Për këtë ngjarje janë kryer veprimet e para hetimore, ndërkohë që ditën e nesërme, në një lagje tjetër të qytetit të Durrësit, është gjetur e braktisur një motoçikletë bashkë me një kaskë mbrojtëse, të cilat janë sekuestruar nën dyshimin se mund të ishin përdorur nga autorët e veprës penale. Pas këqyrjes së motoçikletës janë zbuluar disa gjurmë papilare, për të cilat në vijim, në datën 29.01.2010, është realizuar ekspertimi daktiloskopik vlerësues dhe, më pas, ai krahasues, ndërsa ekspertët kanë arritur në përfundimin se një gjurmë papilare gishti e fiksuar në këqyrjen e motoçikletës është formuar nga gishti i madh i dorës së djathtë i kërkuesit, përfundim që është arritur edhe në një riekspertim të kryer në vijim të hetimeve. Po në këtë datë, organi procedues ka realizuar edhe paraqitjen për njohje të motoçikletës së sekuestruar dhe shtetasi B.C., babai i viktimës A.C. dhe vëllai i viktimës L.C., ka identifikuar atë motoçikletë si mjetin që është përdorur nga autorët e veprës penale. Në datën 30.01.2010 kërkuesi është ndaluar me urdhër të prokurorit dhe në këtë datë është realizuar edhe paraqitja për njohje nga ana e shtetasit O.Xh., i cili ka qenë në lokal kur ka ndodhur ngjarja dhe ishte pyetur më parë si deklarues për rrethanat e ngjarjes dhe autorin e saj. Gjithashtu, në këtë datë, është realizuar edhe përgjimi ambiental i dy deklaruesve të pranishëm në ngjarje, shtetasve

O.Xh. dhe E.A., ku gjatë bisedës i pari është shprehur në lidhje personin që i ishte paraqitur për njohje. Gjatë vijimit të hetimeve, krahas të tjerash, organi procedues ka marrë edhe deklarimet e kërkuesit, i cili ka mohuar autorësinë në kryerjen e veprës penale.

3. Pas grumbullimit edhe të një sërë provash të tjera, në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Durrësit ka dërguar çështjen për gjykim, ndërsa kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" kundër dy ose më shumë personave, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79, shkronja "dh" dhe 25 të Kodit Penal (*KP*), si dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2011-6321) 797, datë 14.12.2011, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" kundër dy ose më shumë personave, të kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", duke e dënuar përfundimisht, në bashkim të dënimeve, me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. (10-2012-882) 306, datë 30.05.2012, kurse mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-754 (95), datë 04.05.2016, ka vendosur prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

5. Sipas atij Kolegji, vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në kundërshtim me ligjin procedural penal për sa i takon aspektit të arsyetimit të përshtatshëm për rrethanat e çështjes penale dhe arsyetimit lidhur me kriteret e vlerësimit të provave sipas nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*. Ai ka vërejtur se çështja në ngarkim të të gjykuarit bazohet në prova indirekte, ku vetëm përmendja e tyre, pa bërë një analizë kritike dhe analitike, nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme në pikëpamje të arsyetimit. Sipas tij, gjykata e faktit, në zbatim të nenit 152, pika 2, të KPP-së, ka për detyrë të vlerësojë çdo element indiciar provues, duke shqyrtuar aftësinë e tyre provuese në drejtim të tregimit të përgjegjësisë të të pandehurit, si dhe duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kriterin dhe logjikën e ndjekur nëpërmjet një arsyetimi korrekt juridik, gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin konkret, ndërsa gjykatat e faktit janë përqendruar vetëm në prova indirekte, por duke mos bërë një vlerësim tërësor edhe të provave të tjera, të cilat, sipas rastit, do të konfirmonin ose jo besueshmërinë e tyre. Në këtë kuptim, vijon ai, konkluzioni i tyre lidhur me rëndësinë, saktësinë

dhe përputhshmërinë e indicieve nuk është i arsyetuar në përputhje me nenin 383, pika 1, shkronja "ç", të KPP-së. Për rrjedhojë, ai kolegj ka arritur në përfundimin se vendimet e gjykatave të faktit konsiderohen të pavlefshme, ndaj çështja dërgohet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, e cila duhet të zhvillojë një gjykim në përputhje me parimet e procesit të drejtë e të rregullt dhe të riparojë të metat e konstatuara, duke respektuar përfundimet e arritura në këtë vendim gjatë shqyrtimit të pretendimeve të palëve.

6. Në rigjykimin e çështjes, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkuesi ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, por kërkesa e tij nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila në përfundim të gjykimit të zakonshëm, me vendimin nr. (11-2018-328) 24, datë 26.01.2018, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" kundër dy ose më shumë personave, të kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", duke e dënuar përfundimisht, në bashkim të dënimeve, me burgim të përjetshëm. Sipas asaj gjykate, fajësia e kërkuesit për veprat penale që akuzohej ishte provuar në gjykim tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, për të argumentuar fajësinë e kërkuesit, gjykata e shkallës së parë e ka organizuar analizën dhe arsyetimin ligjor në katër drejtime: (i) qenien e të pandehurit (kërkuesit) në Durrës ditën e vrasjes; (ii) qenien e tij në vendin e ngjarjes; (iii) përcaktimin e motoçikletës së sekuestruar si mjetin me të cilin u krye vepra penale; (iv) lidhjen e të pandehurit (kërkuesit) me motoçikletën e sekuestruar. Në përfundim, pasi ka analizuar elementet më sipër, ajo gjykatë ka arritur në konkluzionin se nga aktet e dosjes provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësia e kërkuesit në kryerjen e veprës penale, duke e dënuar përfundimisht atë me burgim të përjetshëm. Kundër këtij vendimi, sikundër edhe atij për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, kërkuesi ka paraqitur ankim.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2018-1475 (360), datë 19.07.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. (11-2018-328) 24, datë 26.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ajo gjykatë ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar të kërkuesit. Kurse për themelin e çështjes, gjykata e apelit, pasi ka analizuar dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, ka vlerësuar se në analizë tërësore të provave të verifikuara, ashtu siç me të drejtë ka konkluduar edhe gjykata e shkallës së parë, provohej tej

çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-929, datë 23.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Ai kolegj ka arsyetuar se në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e apelit i ka analizuar dhe vlerësuar provat në tërësi, në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar dhe paracaktuar asnjë provë, duke arritur në konkluzionin se kërkuesi i ka konsumuar plotësisht elementet e veprave penale për të cilat akuzohej. Gjithashtu, sipas Kolegjit Penal, gjykatat i kanë motivuar drejt shkaqet e rrëzimit të kërkesës së kërkuesit për gjykim të shkurtuar.

9. Në datën 29.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 05.11.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 15.01.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në vijim, në datën 22.01.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 05.02.2025 ka vendosur pranimin e kërkesës për përshpejtim. [1]

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi*,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, në drejtim të:

10.1.1. Mungesës së arsyetimit të vendimit lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar të paraqitur përpara fillimit të rigjykimit në shkallë të parë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar refuzimin e kërkesës me argumentin se përderisa Gjykata e Lartë e kishte kthyer çështjen për rigjykim në shkallë të parë, ajo nuk mund të gjykohej në gjendjen që ishin aktet, por megjithatë debati gjyqësor u zhvillua mbi të njëjtat prova të administruara në fashikullin e gjykimit dhe gjykata nuk mori ndonjë provë të re. Gjykata e apelit nuk i dha përgjigje të arsyetuar, sipas rregullave të mendimit të shëndoshë, pretendimit të ngritur në ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë. Pohimi

i gjykatës se debati gjyqësor ishte i domosdoshëm për zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, përbën mohim të hapur të drejtësisë, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj kritikonte arsyetimin e gjykatave të faktit, por nuk ka orientuar për marrjen e ndonjë prove të re. Po ashtu, edhe argumenti tjetër i gjykatës së apelit është bishtnim nga thelbi i problemit, pasi fakti që mbrojtja e kërkuesit ka debatuar për pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit daktiloskopik dhe papërdorshmërinë e procesverbalit të njohjes, ka qenë një qëndrim i detyruar që ka ndodhur *ex post*, vetëm pasi u vu përpara mohimit të së drejtës së kërkuesit për gjykim të shkurtuar, ndaj një rrethanë e tillë nuk mund të përligjë vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë. Vendimi për refuzimin e gjykimit të shkurtuar i ka mohuar kërkuesit në mënyrë arbitrare favoret që buronin nga ai në planin e sanksionit penal.

10.1.2. Mungesës së arsyetimit lidhur me provat e fajësisë, pasi pavarësisht detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, gjykatat e rigjykimit sërish nuk kanë arsyetuar për provat e fajësinë që rëndojnë mbi kërkuesin. Ato përsëri u mëshojnë provave të cilat janë deklaruar si të papërdorshme, sikurse janë deklarimet e kërkuesit në fazën e hetimit paraprak dhe akti i paraqitjes për njohje.

10.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë,* pasi dyshimet gjykatat i kanë çmuar në favor të akuzës, çka rezultonte qartë në raportin “”Paraqitje për njohje - përgjim ambiental”, ku ndonëse prova e paraqitjes për njohje u deklarua si e papërdorshme nga gjykata e shkallës së parë, të dyja gjykatat e faktit në vijim pranuan të mirëqenë rezultatet e përgjimit ambiental, megjithëse përmbajtja e tij tregon vetëm për një dyshim të shtetasit O.Xh. se kërkuesi mund të ishte autori i krimit. Po ashtu, gjykatat e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi ishte fajtor dhe duhej të dënohej, çka konfirmohet nga fakti se në përfundim të rigjykimit në shkallën e parë, gjykata e shpalli vendimin e fajësisë të arsyetuar vetëm 10 minuta pas fjalës së mbrojtjes, çka tregon se ajo e kishte arsyetuar vendimin pa dëgjuar ende pretendimet e mbrojtjes.

10.3. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme,* e garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës*,* pasi:

10.3.1. Gjykata e shkallës së parë, në shkelje të nenit 380, pika1, të KPP-së, ka përdorur në vendim deklarimet e kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake, të cilat janë përfshirë në fashikullin e gjykimit në kundërshtim flagrant me rregullat procedurale të provave, ndërsa nuk është lejuar paraprakisht leximi i tyre nga prokurori sipas nenit 370 të KPP-së. Një shkelje e tillë u pranua nga gjykata e apelit.

10.3.2. Përgjimi ambiental është kryer në shkelje të nenit 221, pika 3, të KPP-së, për rrjedhojë, referuar nenit 226 të KPP-së, rezultatet e tij janë të papërdorshme. Personat e përgjuar janë thjesht dëshmitarë të një vrasjeje dhe KPP-ja nuk lejon përgjimin e tyre kur nuk plotësohen kërkesat e shkronjave "b", "c" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 221 të saj, të cilat në rastin konkret nuk plotësohen. Ky përgjim, për më tepër, është në dhunim të së drejtës për privatësi të dëshmitarëve.

10.3.3. Akti i ekspertimit daktiloskopik krahasues, që është prova determinante që lidh kërkuesin me krimin, është e papërdorshme, pasi është mbështetur në gjurmën papilare të fiksuar në skatullën e motoçikletës së sekuestruar, gjurmë e cila është e manipuluar në dëm të kërkuesit për shkak të dyshimeve serioze për mënyrën e marrjes dhe të sigurimit të saj. Në procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së kësaj prove ajo pasqyrohet si "gjurmë e pjesshme, pjesë pëllëmbe" e tipit të papërcaktuar, ndërkohë që në aktin e ekspertimit daktiloskopik krahasues ajo është transformuar në "gjurmë papilare gishti" dhe ekspertët më pas kanë konkluduar për përputhshmërinë e saj me gjurmën papilare të gishtit të madh të dorës së djathtë të kërkuesit. Gjithashtu, gjurmëkopjuesit për fiksimin e kësaj prove janë ambalazhuar në zarf, por pa vulë dhe firma sigurie, gjë për të cilën ekspertët nuk dhanë ndonjë arsye se përse këto elemente sigurie mungonin.

11. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

11.1. Pretendimi për mungesën e arsyetimit të rrëzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar duhet të rrëzohet, pasi gjykatat me të drejtë kanë arsyetuar se në gjendjen që ndodheshin aktet, ndërsa çështja ishte kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë në fazën e shqyrtimit me debat, si dhe bazuar në faktin e një sërë pretendimesh të

kërkuesit për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave, nuk mund të pranonin kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar. Duke pasur parasysh *ratio legis* të institutit të gjykimit të shkurtuar, që është ekonomia gjyqësore, pranimi i gjykimit të shkurtuar në rastin konkret do të përbënte nonsens juridik, pasi tashmë nuk mund të flitej më për ekonomi gjyqësore, në kuptimin që legjislatori ka dashur të pasqyrojë në dispozitat përkatëse, edhe pse heqja dorë nga çdo provë, në vetvete, përbën ekonomi gjyqësore në vijim të procesit. Nga ana tjetër, edhe debati për çështjen nuk do të mund të bëhej vetëm mbi aktet e hetimit paraprak, në abstragim të gjykimeve të zakonshme që tashmë ishin zhvilluar, ndërsa palët sigurisht që do t'u referoheshin atyre dhe në këtë aspekt bie kërkesa për aplikimin e gjykimit të shkurtuar bazuar në pranimin e akteve të hetimit paraprak. I pandehuri gjatë gjithë procesit, përpara dhe pas kthimit të çështjes për rigjykim, ka pasur në vijimësi pretendime për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave, ndaj kërkesat për të përfituar nga ato dhe kërkesa për përfitim nga gjykimi i shkurtuar janë në kontradiktë me njëra-tjetrën. Për më tepër që vlerësimi nëse një vendim mund të merret mbi bazën e akteve në dispozicion, pa dëmtuar drejtësinë dhe interesat e ligjshëm të të pandehurit, është diskrecion i gjykatës.

11.2. Pretendimi për deklarimin fajtor mbi prova të marra në kundërshtim me ligjin nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka bërë një analizë shteruese për sa pretendohet për ligjshmërinë e provave. Në lidhje me deklarimet e kërkuesit në hetimet paraprake, gjykata e apelit e ka pranuar kundërshtimin e tij, duke e përjashtuar këtë provë nga gjykimi i saj. Për sa i takon përgjimit ambiental të dy dëshmitarëve, pretendimi i kërkuesit ka të bëjë me interpretimin e nenit 221 të KPP-së, por jo me rregullat që determinojnë përdorshmërinë e tij si provë dhe që vënë në diskutim vërtetësinë e informacionit të përftuar. Gjithsesi, gjykatat kanë arsyetuar se neni 221, pika 3, shkronja "ç", i KPP-së përcakton qartë dhe pa dyshime se përgjimi mund të urdhërohet edhe ndaj personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit, fakt i verifikuar edhe në këtë çështje. Për më tepër, pretendimi për pavlefshmërinë e vendimit të prokurorit në lidhje me përgjimin

ambiental ka rënë në dekadencë, për shkak të mosankimimit të tij. Për gjurmën papilare dhe kontradiktat e pasqyrimit të saj në dokumente të ndryshme, shqyrtimi gjyqësor ka sqaruar tej çdo dyshimi këtë kontradiktë, ndërsa akti i ekspertimit daktiloskopik i është nënshtruar debatit gjyqësor dhe ekspertët kanë dhënë shpjegime në lidhje me mënyrën e marrjes dhe formimit të saj, si dhe për konkluzionet e arritura, ndërkohë që gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim.

11.3. Pretendimi për mungesën e arsyetimit të provave të fajësisë është i pabazuar, pasi gjykatat kanë analizuar me kujdes dhe me detaje çdo provë dhe si këto prova e lidhin kërkuesin me veprat penale në këndvështrim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë. Ato kanë identifikuar provat e papërdorshme dhe i kanë përjashtuar ato nga vlerësimi i fajësisë së kërkuesit, sikurse janë paraqitja për njohje të kërkuesit nga dëshmitari O.Xh. dhe deklarimet e kërkuesit gjatë hetimit paraprak. Nga ana tjetër, gjykatat kanë analizuar fajësinë e tij vetëm për provat e përdorshme, të cilat janë vlerësuar në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë, të cilat i janë nënshtruar debatit gjyqësor nën parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe shteruese të gjitha pretendimeve të kërkuesit, ndërkohë që edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është i arsyetuar dhe shterues. Për sa i përket mënyrës së vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, ajo nuk është në juridiksionin kushtetues.

11.4. Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nuk gjen mbështetje në jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Gjykimi i çështjes ka vijuar për një kohë të gjatë, duke u zhvilluar dy herë në të tria shkallët e gjykimit, kohë e cila ka qenë në shërbim të faktit se gjykatat para se të jepnin drejtësi duhej të realizonin në mënyrë shteruese analizën e të gjitha provave dhe t'i përgjigjeshin çdo pretendimi të kërkuesit, duke zbatuar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat kanë bërë një vlerësim të kujdesshëm në lidhje me përdorshmërinë, vlerën dhe cilësimin e provave të paraqitjes për njohje dhe rezultatet e përgjimit ambiental në raport me të gjitha provat e tjera, ku nga çmuarja e tyre në përputhje me kërkesat

e nenit 152 të KPP-së, kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ka konsumuar plotësisht elementet e veprave penale për të cilat akuzohej. Për sa i përket kohës së shpenzuar nga gjykata e shkallës së parë për marrjen e vendimit në dhomën e këshillimit, vlerësimi i kërkuesit është i njëanshëm dhe nuk mund të kundërvendoset ndaj një gjykimi të gjatë dhe kompleks, ndaj një fakt i tillë nuk mund të mbështesë pretendimin e tij për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme* edhe me argumentin se përgjimi ambiental i dy dëshmitarëve është bërë në dhunim të së drejtës së tyre për privatësi.

Gjykata vëren se kërkuesi për këtë pretendim, në lidhje me këtë argument, nuk provon interesin e tij të drejtpërdrejtë, pasi ka pretenduar cenimin e të drejtave kushtetuese të personave të tjerë dhe nuk ka provuar të drejtën e cenuar e interesin e tij të ligjshëm vetjak në këtë drejtim, për pasojë nuk legjitimohet *ratione personae*. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual, Gjykata vëren se ato lidhen me procesin gjyqësor ku kërkuesi ka qenë palë dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi, për rrjedhojë legjitimohet *ratione personae*.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata evidenton se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 23.05.2024, i cili, sipas shkresës së asaj gjykate bashkëlidhur kërkesës, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 01.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 29.10.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

17. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të marra në mënyrë të paligjshme, të parashikuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, si dhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me vendimin për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe për provat e fajësisë. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me provat e fajësisë, Gjykata çmon se ai është i ndërlidhur me pretendimin për cenimin e prezumimit të pafajësisë, ndaj këto dy pretendime do të trajtohen së bashku. Për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke pasur parasysh thelbin e argumenteve të sjella nga kërkuesi, Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia*, vlerëson t'i trajtojë ato në kuadër të parimit të

mosdënimit pa ligj, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata në vijim do të analizojë pretendimet e kërkuesit në këndvështrim të së drejtës për mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, të parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës dhe të parimit të mosdënimit pa ligj, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, të ndërlidhura edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi, *së pari*, gjykata e shkallës së parë, në shkelje të nenit 380, pika 1, të KPP-së, ka përdorur në vendim deklarimet e tij në fazën e hetimeve paraprake, të cilat janë përfshirë në fashikullin e gjykimit në kundërshtim flagrant me rregullat procedurale të provave, ndërsa nuk është lejuar paraprakisht leximi i tyre nga prokurori sipas nenit 370 të KPP-së, shkelje e cila në vijim është pranuar nga gjykata e apelit. *Së dyti*, sipas tij, përgjimi ambiental është kryer në shkelje të nenit 221, pika 3, të KPP-së, për rrjedhojë, referuar nenit 226 të KPP-së, rezultatet e tij janë të papërdorshme. Personat e përgjuar, argumenton kërkuesi, janë thjesht dëshmitarë të një vrasjeje dhe KPP-ja nuk lejon përgjimin e tyre kur nuk plotësohen kërkesat e shkronjave "b", "c" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 221 të saj, të cilat në rastin konkret nuk plotësohen. *Së treti*, sipas kërkuesit, akti i ekspertimit daktiloskopik krahasues, që është prova determinante që e lidh atë me krimin, është e papërdorshme, pasi është mbështetur në gjurmën papilare të fiksuar në skatullën e motoçikletës së sekuestruar, gjurmë e cila është e manipuluar në dëm të tij për shkak të dyshimeve serioze për mënyrën e marrjes dhe sigurimit të saj. Kërkuesi argumenton se në procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së kësaj prove ajo pasqyrohet si "gjurmë e pjesshme, pjesë pëllëmbe" e tipit të papërcaktuar, ndërkohë që në aktin e ekspertimit daktiloskopik krahasues ajo është transformuar në "gjurmë papilare gishti" dhe ekspertët më pas kanë konkluduar për përputhshmërinë e saj me gjurmën papilare të gishtit të madh të dorës së djathtë të kërkuesit. Gjithashtu, sipas kërkuesit, gjurmëkopjuesit për fiksimin e kësaj prove janë ambalazhuar në zarf, por pa vulë dhe firma

sigurie, gjë për të cilën ekspertët nuk dhanë ndonjë arsye se përse këto elemente sigurie mungonin.

19. Subjekti i interesuar ka prapësuar duke i konsideruar si të pabazuara pretendimet e kërkuesit. Konkretisht, për sa i takon përdorimit të deklarimeve të kërkuesit të bëra në fazën e hetimeve paraprake, subjekti i interesuar është shprehur se gjykata e apelit e ka pranuar kundërshtimin e tij, duke e përjashtuar këtë provë nga gjykimi i saj. Ndërkohë, lidhur me përgjimin ambiental të dy dëshmitarëve, sipas subjektit të interesuar, pretendimi i kërkuesit ka të bëjë me interpretimin e nenit 221 të KPP-së, por jo me rregullat që determinojnë përdorshmërinë e tij si provë dhe që vënë në diskutim vërtetësinë e informacionit të përftuar. Gjithsesi, sipas tij, gjykatat kanë arsyetuar se neni 221, pika 3, shkronja "ç", i KPP-së përcakton qartë dhe pa dyshime se përgjimi mund të urdhërohet edhe ndaj personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit, fakt i verifikuar edhe në këtë çështje. Për më tepër, vijon ai, pretendimi për pavlefshmërinë e vendimit të prokurorit në lidhje me përgjimin ambiental ka rënë në dekadencë, për shkak të mosankimimit të tij. Për sa i takon gjurmës papilare dhe kontradiktave të pasqyrimit të saj në dokumente të ndryshme, subjekti i interesuar është shprehur se shqyrtimi gjyqësor ka sqaruar tej çdo dyshimi këtë kontradiktë, ndërsa akti i ekspertimit daktiloskopik i është nënshtruar debatit gjyqësor dhe ekspertët kanë dhënë shpjegime për mënyrën e marrjes dhe formimit të saj, si dhe për konkluzionet e arritura, ndërkohë që gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim.

20. Sipas nenit 32, pika 2, të Kushtetutës askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre *(shih vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobia dhe rëndësia e tyre provuese në një

çështje konkrete janë, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj *(shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Për sa i takon standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në kuptim të neneve 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se llojet e provave dhe mënyrat e marrjes së tyre rregullohen posaçërisht nga ligji procedural penal. Neni 149 i KPP-së përcakton kuptimin e provës dhe parashikon se provat janë njoftimet për faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Për sa i përket objektit të provave, ai parashikohet nga neni 150 i KPP-së, sipas të cilit janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale. Ndërkohë, neni 151 i KPP-së ka rregulluar konceptin e marrjes së provave, duke parashikuar se gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë kod (pika 1), kurse në gjykim ato merren me kërkesën e palëve dhe gjykata vendos me urdhër, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme (pika 2), ndërkohë që provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund

të përdoren, ndërsa papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit (pika 4).

24. Mbi bazën e standardeve kushtetuese të mësipërme, përkundër pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, referuar atij konteksti faktik dhe ligjor që evidentohet në rastin konkret, Gjykata do të analizojë nëse provat e pretenduara nga kërkuesi janë mbledhur në mënyrë të paligjshme dhe nëse ato janë përdorur për deklarimin e tij fajtor, duke verifikuar edhe arsyetimin e gjykatave të zakonshme në këtë drejtim.

25. Duke u kthyer tek çështja konkrete, për sa i takon argumentit të kërkuesit për përdorimin si provë nga gjykata e shkallës së parë për deklarimin e tij fajtor të deklarimeve të dhëna nga ai në fazën e hetimeve paraprake, Gjykata vëren se, sikurse pranohet edhe nga vetë kërkuesi, gjykata e apelit e ka pranuar kundërshtimin e tij, duke e konsideruar të gabuar përdorimin e kësaj prove nga gjykata e shkallës së parë, për sa kohë ajo nuk ishte marrë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal dhe, në vijim, ajo gjykatë e ka përjashtuar atë nga vlerësimi i saj në lidhje me fajësinë e kërkuesit. Në këtë kuptim, shkelja e lejuar nga gjykata e shkallës së parë në përdorimin e kësaj prove është korrigjuar nga gjykata më e lartë, e cila fajësinë e kërkuesit nuk e ka mbështetur në atë provë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

26. Për sa i takon pretendimit të kërkuesit për paligjshmërinë e përgjimit ambiental të dëshmitarëve dhe papërdorshmërinë e rezultateve të tij, Gjykata vëren se përgjimi në rastin konkret është bërë me vendim të prokurorit, në mjediset e policisë, kundër dy personave të cilët kanë qenë të pranishëm në ngjarje, ndërsa përgjimi në vijim është vlerësuar i ligjshëm nga gjykata e shkallës së parë me vendimin e datës 01.02.2010. Po ashtu, Gjykata vëren se përgjimi, si mjet për kërkimin e provës, rregullohet nga KPP-ja, ku neni 221 i saj ka përcaktuar kufijtë, rastet e lejimit të përgjimit, ndërsa pika 3 e këtij neni ka përcaktuar subjektet kundër të cilave përgjimi mund të lejohet dhe konkretisht ndaj të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale (shkronja "a"), personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari (shkronja "b"), personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin (shkronja "c") ose personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit (shkronja "ç"), ndërkohë që pika 4 parashikon se rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit. Ndalimi i përdorimit të rezultateve të përgjimit rregullohet nga neni 226 i KPP-së, sipas pikës 1 të të cilit rezultatet e

përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni.

27. Në vijim, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, në përgjigje të pretendimit të kërkuesit, ka vlerësuar se në interpretim të shkronjës "ç" të pikës 3 të nenit 221 të KPP-së, përgjimi mund të lejohet edhe ndaj personit i cili mund të identifikojë autorin e veprës penale, qoftë ky edhe dëshmitar, i cili mund të ishte edhe i frikësuar për të kryer identifikimin publikisht të autorit të krimit, sikurse ka ndodhur edhe në rastin konkret, ku dëshmitari O.XH., i paraqitur paraprakisht për njohje, gjatë një bisede me dëshmitarin E.A. ka pranuar se ka njohur kërkuesin si autor të vrasjeve. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, rezultatet e përgjimit ambiental janë të përdorshme. Ky pretendim i kërkuesit është marrë në shqyrtim edhe nga gjykata e apelit, e cila, përveçse ka konfirmuar qëndrimin e mbajtur nga gjykata e shkallës së parë, ka argumentuar edhe se kërkuesi nuk e ka ankimuar vendimin për pranimin e përgjimit sikurse lejohej nga neni 222/a i KPP-së, çka tregon se ai ka qenë dakord me përgjimin e kryer. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vijim, ka vlerësuar të pabazuar në ligj pretendimin e kërkuesit, duke arsyetuar se neni 221, pika 3, shkronja "ç", i KPP-së referon qartë, pa dyshime, që përgjimi mund të urdhërohet edhe ndaj personit, përgjimi/vëzhgimi i të cilit mund të çojë në vendndodhjen ose identitetin e të dyshuarit, fakt i verifikuar edhe në çështjen objekt gjykimi, ku dyshimi i arsyeshëm i organit procedues ka qenë se dëshmitarët mund të ishin të frikësuar për shkak të ngjarjes së rëndë me tre shtetas të vrarë.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit procedural nga gjykatat e zakonshme në lidhje me ligjshmërinë e përgjimit ambiental dhe përdorimin e rezultateve të tij në drejtim të identifikimit të kërkuesit si autor i veprës penale dhe, në këtë kuptim, edhe të fajësisë së tij, nuk duket të jetë arbitrar, për sa kohë ligji lejon përgjimin e çdo personi, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

29. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, papërdorshmërinë si provë të aktit të ekspertimit daktiloskopik krahasues, për shkak se është mbështetur në gjurmën papilare të fiksuar në skatullën e motoçikletës së sekuestruar, gjurmë e cila është e manipuluar në dëm të kërkuesit për shkak të dyshimeve serioze për mënyrën e marrjes dhe sigurimit të saj. Gjykata vëren se ditën e nesërme të ngjarjes, në datën 28.01.2010, është gjetur e braktisur një motoçikletë bashkë me një kaskë mbrojtëse, të cilat janë sekuestruar nga oficeri i Policisë Gjyqësore nën dyshimin se ky mjet lëvizës mund të ishte përdorur nga autorët

e veprës penale. Në vijim, bazuar në nenin 188 të KPP-së, oficeri i Policisë Gjyqësore ka realizuar këqyrjen e motoçikletës, në prani edhe të dy ekspertëve kriminalistë. Gjatë këqyrjes së këtij sendi është zbuluar prania e disa gjurmëve papilare, të cilat janë fiksuar me gjurmëkopjues dhe janë dërguar menjëherë për ekzaminime të mëtejshme në laboratorin kriminalistik. Këqyrja e sendit dhe fiksimi në të i gjurmëve papilare është dokumentuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore në një procesverbal me shkrim, i cili është nënshkruar edhe nga dy ekspertët e pranishëm. Në procesverbal janë pasqyruar metoda shkencore e përdorur për zbulimin e gjurmëve papilare, vendi ku ato janë zbuluar, përshkrimi i përgjithshëm i tyre si "gjurmë gishti", "gjurmë e pjesshme gishti", "gjurmë e pjesshme" ose "gjurmë e pjesshme, pjesë pëllëmbe" (në dy raste), identifikimi i tyre me një kod shkronjor (respektivisht A, B, C, D, E), si dhe marrja e tyre përmes metodave shkencore, me gjurmëkopjues transparent sipas procedurës. Këqyrja është shoqëruar edhe me fotografi, ndërkohë që oficeri i Policisë Gjyqësore në vijim, bazuar në nenin 300 të KPP-së, ka sekuestruar në cilësinë e provave materiale pesë gjurmëkopjues ku ishin fiksuar gjurmët papilare, sekuestrim që më pas është vleftësuar i ligjshëm nga prokurori.

30. Gjykata vëren, po ashtu, se prova materiale në fjalë është dërguar në Institutin e Policisë Shkencore. Në aktin e ekspertimit daktiloskopik vlerësues, të realizuar në datën 29.01.2010, fillimisht evidentohet se prova është dërguar në datën 28.01.2010 nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës së bashku me vendimin e ekspertimit, ndërsa evidentohet edhe mënyra e skedimit të saj, e konkretisht se filmat gjurmëkopjues janë të ngjitur mbi pllaka transparente, mbi të cilat është shkruar: "*Këqyrje motoçiklete - Yamaha - Dt. 28.01.2010 - DR/161/A, B, C, D, E",* çka evidentohet edhe në fotografitë që shoqërojnë ekspertimin. Po ashtu, në akt evidentohet edhe se gjurmëkopjuesit kanë qenë të ambalazhuar në zarf letre të mbyllur. Ndërkohë, në përmbajtje të aktit të ekspertimit evidentohet se gjurmëkopjuesi A pasqyron një gjurmë të pjesshme papilare të papërcaktuar, gjurmëkopjuesi B një gjurmë gishti, gjurmëkopjuesi C një gjurmë të pjesshme gishti, gjurmëkopjuesi D një gjurmë të pjesshme papilare të papërcaktuar dhe gjurmëkopjuesi E një gjurmë të pjesshme papilare gishti, me figurë jo të shprehur qartë, që paraqet pjesërisht qendrën e zonës përreth e sipër saj. Kjo e fundit, në vijim, është vlerësuar se ka karakteristika të veçanta të shprehura të mjaftueshme, për identifikim dhe vlerë për krahasim në rreth të kufizuar personash, ndërsa është pikërisht kjo gjurmë papilare që është përdorur më pas për kryerjen e ekspertimit

daktiloskopik krahasues, sipas të cilit kjo gjurmë është formuar nga gishti i madh i dorës së djathtë të kërkuesit.

31. Gjykata, gjithashtu, vëren se gjatë rigjykimit të çështjes në shkallë të parë, një nga ekspertët kriminalistë të pranishëm në këqyrjen e motoçikletës ka shpjeguar veprimet e kryera për zbulimin, fiksimin dhe marrjen e gjurmëve papilare, të cilat në vijim janë dërguar në Institutin e Policisë Shkencore. Sipas tij, përshkrimi në procesverbalin e këqyrjes i gjurmës papilare të emërtuar me shkronjën E si "gjurmë pëllëmbe" është një lapsus, pasi në fakt kishin të bënin me "gjurmë gishti", ndërsa ajo është fotografuar dhe fiksuar në gjurmëkopjuesin përkatës.

32. Gjykata çmon të evidentojë se gjurma papilare, në kuptim të nenit 187 të KPP-së, është provë materiale, ndërsa sipas kësaj dispozite, të tilla konsiderohen sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë ose që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes, ndërkohë që neni 188 i KPP-së përcakton se provat materiale përshkruhen hollësisht në procesverbal, kur ka mundësi fotografohen ose filmohen dhe me urdhër të organit procedues i bashkohen fashikullit gjyqësor. Për sa i përket këqyrjes, si mjet për kërkimin e provës, ajo rregullohet nga KPP-ja, e cila në nenin 198, pika 1, parashikon rastet dhe format e këqyrjes, duke përcaktuar, ndër të tjera, edhe këqyrjen e sendeve, kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët e veprës penale, ndërsa këqyrja dokumentohet përmes përshkrimit, por edhe përmes fotografimeve, filmimeve dhe çdo veprimi tjetër teknik. Në vijim, neni 208, pika 1, i KPP-së përcakton se objekt sekuestrimi janë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, kurse neni 215, pika 1, i tij përcakton se sendet e sekuestruara sigurohen me vulën e organit procedues ose, në varësi nga natyra e sendeve, me mjete të tjera të përshtatshme që tregojnë se ato ruhen për nevojat e drejtësisë. Për sa i përket veprimtarisë me iniciativë të Policisë Gjyqësore, neni 295 i KPP-së parashikon se për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet ajo kryen të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë edhe rilevimet daktiloskopike, kurse neni 300 parashikon se oficerët e Policisë Gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojë dhe kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, ata kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur

është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, sekuestrim ky që vleftësohet nga prokurori brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme. Ndërkohë, neni 303 i KPP-së rregullon dokumentimin e veprimeve të Policisë Gjyqësore, duke përcaktuar se ajo dokumenton, qoftë edhe në formë të përmbledhur, të gjitha veprimet e kryera, duke mbajtur procesverbal, ndër të tjera, edhe për këqyrjet dhe sekuestrimet. Për sa i përket provës së ekspertimit, neni 178, pika 1, i KPP-së parashikon se ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore, ndërsa neni 179, pika 1, i tij parashikon se caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse, ndërkohë që neni 185, pika 1, i KPP-së përcakton se mendimi i ekspertit jepet me shkrim.

33. Në vijim, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, në përgjigje të pretendimit të kërkuesit, ka vlerësuar se ai është i pavërtetë dhe i pasaktë, referuar dokumentimit të asaj gjurme papilare në procesverbalin e këqyrjes dhe fotografive shoqëruese të saj. Sipas asaj gjykate, mënyra e marrjes së provës së ekspertimit daktiloskopik dhe procedura e ndjekur nga organi i procedues kanë qenë në përputhje me nenet 179 e vijues të KPP-së, ndaj nga vlerësimi në tërësi i të gjitha provave që ndodhen në dosje arrihet në përfundimin se aktet e ekspertimit dhe riekspertimit janë të sakta e të marra në përputhje me ligjin procedural penal. Pretendimi i kërkuesit është shqyrtuar edhe nga gjykata e apelit, e cila e ka gjetur të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se nuk mund të vihet në dyshim mënyra e marrjes dhe administrimit të gjurmës papilare, si dhe akti i ekspertimit vlerësues i saj vetëm nga fakti se në procesverbalin e këqyrjes ajo nuk është përshkruar si gjurmë gishti, por si pjesë pëllëmbe, rrethanë e cila nuk e bën të papërdorshme atë provë në kuptim të nenit 151, pika 4, të KPP-së së kohës. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt provat e shqyrtuara, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të të pandehurit (kërkuesit) dhe mbrojtësit të tij në lidhje me gjurmën papilare të fiksuar në motoçikletë, të analizuara edhe në raport me përgjigjet e ekspertëve të pyetur në seancë gjyqësore, të cilët kanë marrë dhe analizuar këtë provë në konformitet me dispozitat ligjore procedurale. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vijim, ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për papërdorshmërinë e aktit të ekspertimit daktiloskopik nuk ka element diskutimi të kategorisë së zbatimit të ligjit, pasi ai akt i është nënshtruar debatit gjyqësor në të cilin

ekspertët kanë dhënë shpjegime për mënyrën e marrjes dhe të formimit, si dhe për konkluzionet e arritura, ndërkohë që fuqia provuese e tij nuk mund të ngrihet në diskutim prej tij (Kolegjit Penal), por si provë shkencore e plotë ajo është e mjaftueshme për të prodhuar identifikimin e autorit.

34. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se dokumentimi ligjor i provës së gjurmës papilare nuk duket se paraqet parregullsi të asaj natyre të cilat të vinin në dyshim vlefshmërinë procesuale të saj. Ajo është dokumentuar rregullisht në procesverbalin e këqyrjes së sendit, i cili është mbajtur nga autoriteti i ngarkuar nga ligji (oficeri i Policisë Gjyqësore) në prani edhe të dy ekspertëve të fushës, ku janë pasqyruar të dhënat e nevojshme që ligji kërkon, duke u shoqëruar edhe me fotografi. Zbulimi dhe marrja e gjurmës papilare evidentohet se janë bërë përmes metodave shkencore dhe po ashtu kjo provë është skeduar sipas rregullave të kriminalistikës, sikundër edhe sigurimi i saj në pikëpamje të ruajtjes fizike dhe integritetit duket se është bërë sipas kërkesave të ligjit, por edhe të rregullave të kriminalistikës referuar natyrës së veçantë të saj. Ndaj vetëm fakti se përshkrimi i përgjithshëm në procesverbalin e këqyrjes së sendit i llojit të gjurmës papilare si pjesë pëllëmbe dhe jo gishti, nuk është i mjaftueshëm për të çuar në përfundimin se marrja e kësaj prove nuk është bërë sipas ligjit. Nisur nga kjo, përdorimi i saj në vijim për marrjen e provës së ekspertimit daktiloskopik nuk e bën paligjshme dhe, për rrjedhojë, as të papërdorshme këtë provë (ekspertimin). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit procedural nga gjykatat e zakonshme në lidhje me mënyrën e marrjes dhe sigurimit fizik të gjurmës papilare, si dhe përdorimi i saj në vijim për marrjen e provës së ekspertimit daktiloskopik në drejtim të identifikimit të kërkuesit si autor i veprës penale dhe, në këtë kuptim, edhe të fajësisë së tij, nuk duket të jetë arbitrar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar për të gjitha argumentet e parashtruara prej tij.

B.2. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

36. Kërkuesi ka pretenduar se deklarimi i tij fajtor mbi bazën e dyshimeve është një cenim flagrant i së drejtës së tij për t'u prezumuar i pafajshëm dhe se dyshimet gjykatat i kanë çmuar në favor të akuzës, sikurse janë

rezultatet e përgjimit ambiental, përmbajtja e të cilit tregon vetëm për një dyshim të shtetasit O.Xh. se kërkuesi mund të ishte autori i krimit. Po sipas tij, pavarësisht detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, gjykatat e rigjykimit sërish nuk kanë arsyetuar për provat e fajësinë që rëndojnë mbi të, përveçse ato u mëshojnë përsëri provave të cilat janë deklaruar si të papërdorshme, sikurse janë deklarimet e tij në fazën e hetimit paraprak dhe akti i paraqitjes për njohje. Gjithashtu, sipas kërkuesit, gjykatat e kanë filluar procesin me paragjykim se ai është fajtor dhe duhet të dënohej, çka konfirmohet nga fakti se në përfundim të rigjykimit në shkallë të parë, gjykata e ka shpallur vendimin e fajësisë të arsyetuar vetëm 10 minuta pas fjalës së mbrojtjes, çka tregon se ajo e kishte arsyetuar vendimin pa dëgjuar ende pretendimet e mbrojtjes.

37. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi i kërkuesit nuk gjen mbështetje në jurisprudencën kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së. Sipas tij, gjykimi i çështjes ka vijuar për një kohë të gjatë, duke u zhvilluar dy herë në të tria shkallët e gjykimit, kohë e cila ka qenë në shërbim të faktit se gjykatat, para se të jepnin drejtësi, duhej të realizonin në mënyrë shteruese analizën e të gjitha provave dhe t'i përgjigjeshin çdo pretendimi të kërkuesit. Sipas këtij subjekti, gjykatat kanë bërë një vlerësim të kujdesshëm në lidhje me përdorshmërinë, vlerën dhe cilësimin e provave, kanë identifikuar provat e papërdorshme dhe i kanë përjashtuar ato nga vlerësimi i fajësisë së kërkuesit, sikurse janë paraqitja për njohje e kërkuesit nga dëshmitari O.Xh. dhe deklarimet e kërkuesit gjatë hetimit paraprak. Nga ana tjetër, vijon subjekti i interesuar, gjykatat kanë analizuar fajësinë e kërkuesit vetëm mbi provat e përdorshme, të cilat janë vlerësuar në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë, të cilat i janë nënshtruar debatit gjyqësor nën parimin e kontradiktoritetit, duke arritur në përfundimin se kërkuesi ka konsumuar plotësisht elementet e veprave penale për të cilat akuzohej. Gjykata e apelit, vijon ai, u ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe shteruese të gjitha pretendimeve të kërkuesit, ndërkohë që edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është i arsyetuar dhe shterues. Po sipas këtij subjekti, për sa i përket kohës së shpenzuar nga gjykata e shkallës së parë për marrjen e vendimit në dhomën e këshillimit, vlerësimi i kërkuesit është i njëanshëm dhe nuk mund të kundërvendoset ndaj një gjykimi të gjatë dhe kompleks, ndaj një fakt i tillë nuk mund të mbështesë pretendimin e tij për cenimin e prezumimit të pafajësisë. Së fundmi, sipas subjektit të interesuar, mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme nuk është në juridiksionin kushtetues.

38. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa

nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa neni 142, pika 1, i saj parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

39. Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërës të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese)*.

40. Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet dhe prapësimet e palëve, Gjykata do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, që kanë të bëjnë me ndalimin e sjelljes paragjykuese nga gjykata e shkallës së parë për shkak të shpejtësisë së marrjes së vendimit të dënimit, barrën e provës dhe vlerësimin e dyshimeve në favor të kërkuesit, si dhe prezumimet ligjore dhe të faktit në përcaktimin e fajësisë së tij. Po ashtu, Gjykata do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit për garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë.

42. Lidhur me sjelljen paragjykuese të gjykatës së shkallës së parë,

Gjykata, bazuar në kontekstin e rrethanave konkrete të çështjes, çmon se kohëzgjatja e pakët e bisedimeve të trupit gjykues në dhomën e këshillimit nuk përbën në vetvete argument të mjaftueshëm kushtetues. Në këtë vlerësim, Gjykata mban në konsideratë se gjykimi i çështjes ka vijuar në kohë për më shumë se një vit dhe anëtarët e trupit gjykues kanë pasur mundësi të dëgjojnë drejtpërdrejt dhe të reflektojnë në mënyrë kritike për çdo pretendim të palëve, sikundër edhe për provat e marra në gjykim dhe të dhënat e ofruara nga ato. Në këtë kuptim, nuk përjashtohet mundësia që vendimi i përmbledhur të jetë parapërgatitur nga kryetari i trupit gjykues dhe trupit gjykues t'i jetë dashur një kohë e shkurtër për vendimmarrje. Për këtë arsye, fakti që vendimi i gjykatës së shkallës së parë në rigjykimin e çështjes është shpallur i arsyetuar 10 minuta pas mbylljes së diskutimit të mbrojtjes nuk përbën argument të mjaftueshëm për të vërtetuar shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë, ndaj pretendimi i kërkuesit bazuar në këtë argument nuk qëndron.

43. Një argument tjetër i kërkuesit ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykatat, në kuptimin që provat e shqyrtuara, në veçanti përgjimi i komunikimeve, kanë ngritur vetëm dyshime dhe ndonëse dyshimet duhet të ishin vlerësuar në favor të kërkuesit, gjykatat e zakonshme, në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, i kanë vlerësuar në favor të akuzës, duke dhënë vendim fajësie për kërkuesin.

44. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, Gjykata vëren se vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi dhe në kushtet kur mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme është vënë në dyshim nga kërkuesi, si shkak për të cilin atij i është cenuar e drejta themelore për t'u prezumuar i pafajshëm, Gjykata çmon se prapësimi i subjektit të interesuar se vlerësimi i provave është jashtë juridiksionit kushtetues nuk qëndron. Për këtë arsye, Gjykata në vijim do të analizojë vlerësimin e provave në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit në kuptimin e garancive të parimit të prezumimit të

pafajësisë, pra nëse ka pasur zhvendosje të barrës së provës nga prokurori te kërkuesi dhe nëse fajësia e këtij të fundit është vendosur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

45. *Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar* për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se çështja penale është regjistruar për herë të parë në gjykatën e shkallës së parë në datën 31.01.2011 dhe gjykimi fillestar i saj në të tria shkallët ka vijuar përgjatë më shumë se 5 vjetëve. Çështja është regjistruar për rigjykim në shkallën e parë në datën 26.01.2018 dhe ka përfunduar aty pas më shumë se 1 viti. Në përfundim të rigjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se akuza ndaj kërkuesit provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në lidhje me fajësinë e tij, në *përmbushje edhe të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, gjykata e shkallës së parë ka analizuar provat duke përcaktuar rrethanat faktike të mëposhtme.*

46. Së pari, në kohën e ngjarjes, më 27.01.2010, rreth orës 22:30, kërkuesi (i cili banonte në Vlorë) provohet të ketë qenë në qytetin e Durrësit, ku ka ndodhur ngjarja. Ndonëse kërkuesi dhe mbrojtësi e kanë mohuar vazhdimisht këtë rrethanë, gjykata ka evidentuar se nga tabulatet telefonike dhe qelizat e logimit të marra nga kompania telefonike rezultonte se i pandehuri kishte pasur disa thirrje hyrëse-dalëse nga qyteti i Durrësit, ku ora e fundit ka qenë 23:00:40, e interceptuar nga antenat në qytetin e Shijakut. Kjo e dhënë, sipas gjykatës, është konfirmuar edhe me dëshmitë e dy dëshmitarëve, të cilët kanë dëshmuar se kërkuesi kishte fjetur në shtëpinë e tyre në Shijak natën e datës 27.01.2010, duke u gdhirë data 28.01.2010.

47. Së dyti, autorët e veprës penale kanë përdorur për kryerjen e krimit një motoçikletë, e cila është gjetur e braktisur një ditë pas ngjarjes dhe është sekuestruar. Në nxjerrjen e kësaj rrethane faktike, gjykata e shkallës së parë është bazuar në: (i) dëshminë e dëshmitarit B.C., i cili ka parë se autorët e veprës penale që kanë ardhur dhe janë larguar nga vendngjarja me motoçikletë; (ii) në procedurën e njohjes së sendit (motoçikletës) prej tij, të zhvilluar dy ditë pas ngjarjes. Dëshmitari rezulton të ketë pasur njohuri të specializuara për mjetet motorike për shkak të përvojës së punës, gjë që dëshminë e tij e bënte të besueshme. Nga ana tjetër, procedura e njohjes është zhvilluar pas dy ditëve nga ngjarja, kohë në të cilën dëshmitari ka pasur mundësi të kujtonte karakteristikat e motorit, ndërkohë që deri në këtë moment nuk dihej ende autori i ngjarjes, çka e bënte të besueshme njohjen.

48. Së treti, kërkuesi ka përdorur motoçikletën në kryerjen e krimit. Ky fakt është provuar nga motoçikleta e sekuestruar, gjurma papilare e identifikuar aty dhe ekspertimet daktiloskopike të gjurmës papilare.

49. Së katërti, kërkuesi ka qenë personi që ka qëlluar në lokalin e shtetasit B.C. kur ka ndodhur ngjarja. Ky fakt është provuar nga rezultatet e përgjimit ambiental të dëshmitarëve O.Xh. dhe E.A., ku i pari është shprehur me siguri të plotë se i pandehuri ka qenë personi që ka kryer krimin. Lidhur me argumentin e kërkuesit se përgjimi në përmbajtje tregon vetëm një dyshim në lidhje me autorësinë e tij në krim dhe ky dyshim është çmuar nga gjykatat e zakonshme në favor të akuzës, Gjykata evidenton se nga komunikimet e përgjuara, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, nuk rezultojnë dyshime apo aludime për autorësinë e tij. Megjithatë, kjo provë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme në harmoni edhe me provat e tjera të administruara, duke mos i dhënë përgjimit vlerë të paracaktuar dhe duke mos zhvendosur barrën e provës tek kërkuesi.

50. Çështja e kërkuesit është gjykuar në vijim nga gjykata e apelit, e cila i ka vlerësuar sërish provat sipas nenit 152 e vijues të KPP-së dhe ka arritur në përfundimin se fajësia e kërkuesit provohej plotësisht. Sipas gjykatës së apelit është provuar se kërkuesi ka shkuar në vendngjarje me motoçikletë, me një bashkëpunëtor të paidentifikuar, i cili ka qëndruar në motoçikletë. Kërkuesi është futur në lokal me kapuç në kokë, por pa e mbuluar fytyrën, dhe ka qëlluar me automatik në drejtim të viktimave. Pasi ka kryer vrasjen e tre shtetasve, ai ka hipur në motoçikletë dhe është larguar me bashkëpunëtorin. Më pas, ata kanë braktisur motorin dhe një skafandër në një lagje të qytetit të Durrësit. Në përcaktimin e këtyre fakteve, gjykata e apelit është bazuar në analizën e përmbajtjes së një numri provash, të tilla si: (i) motoçikleta e sekuestruar, gjurma papilare e identifikuar në motoçikletë dhe dy aktet e ekspertimit daktiloskopik, sipas të cilave gjurma papilare në motoçikletë ishte formuar nga gishti i madh i dorës së djathtë të të pandehurit; (ii) deklarimet e shtetasit B.C dhe procedura e njohjes së motoçikletës prej tij; (iii) shpjegimet e dëshmitarit O.Xh dhe rezultatet e përgjimit ambiental të tij dhe dëshmitarit tjetër E.A; (iv) tabulatet dhe qelizat e antenave telefonike të kompanisë përkatëse, sipas të cilave numri i telefonit të kërkuesit ka pasur thirrje hyrëse dhe dalëse në datën 27.01.2010, nga ora 18:07:12 deri në orën 23:00:40 dhe këto thirrje janë kapur nga qeliza, antena MUZEU (previously 89) Durrës; (v) dëshmitë e dëshmitarëve Xh.B. dhe M.B., të cilët kanë shpjeguar se kërkuesi ka shkuar dhe ka fjetur në shtëpinë e tyre në Shijak natën e datës 27.01.2010.

51. Gjykata e apelit ka shpjeguar në vendimin e saj edhe arsyet përse nuk qëndronin kundërshtimet që kërkuesi ka pasur për përmbajtjen e

provave dhe saktësinë e tyre. Konkretisht, gjykata e apelit ka shpjeguar se rezultatet e përgjimit ambiental dhe procedura e njohjes së kërkuesit nga dëshmitari O.Xh janë prova të veçanta, të ndara nga njëra tjetra, ndaj pavlefshmëria e njohjes nuk e bën të pavlefshëm përmbajtjen e përgjimit, arsye për të cilën vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka kontradiktë në këtë drejtim. Po ashtu, sipas gjykatës së apelit, fakti që qelizat telefonike përcaktojnë se kërkuesi ka qenë në zonën e Rrashbullit në 22:30:18 nuk përmbys faktin se ai nuk ka qenë në vendngjarje sepse ora e saktë e kryerjes së veprës penale nuk është përcaktuar nga aktet e procedimit penal, në të cilat është arritur në një përfundim të përafërt – rreth orës 22.30. Lidhur me këtë fakt, gjykata e apelit ka vënë në dukje se në kushtet e një ngjarjeje me tepër tension e pasoja dhe mjetit të përdorur, distanca nga vendngjarja në zonën e Rrashbullit përshkohet shumë shpejt. Gjithashtu, gjykata e apelit i është përgjigjur edhe pretendimit të kërkuesit për mungesën e debatit gjyqësor mbi tabulatet telefonike, duke vënë në dukje se ai ishte njohur me këtë provë në përfundim të hetimeve paraprake, se prokurori ka kërkuar marrjen e saj si provë, se gjykata e ka pranuar atë kërkesë, se ajo provë është administruar në seancën gjyqësore të datës 12.12.2017 dhe kërkuesi nuk ka pasur ndonjë kontestim lidhur me të.

52. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke ngritur ndër të tjera, edhe pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, të cilin e ka lidhur me mënyrën e vlerësimit të provave, të cilat sipas tij vetëm ngrenë dyshime, ndaj ato duhet të ishin vlerësuar në favor të tij dhe jo kundër tij. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke konfirmuar se nga gjykatat më të ulëta provat janë analizuar e shqyrtuar në zbatim të drejtë të nenit 152 të KPP-së dhe si rrjedhojë e analizës, është arritur në përfundimin se i gjykuari i ka konsumuar plotësisht elementët e veprave penale për të cilat ai akuzohet. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit, në zbatim të nenit 152 të KPP-së, ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë prove, si dhe duke i dhënë përgjigje të argumentuar dhe shteruese pretendimit të kërkuesit. Provat i janë nënshtruar debatit gjyqësor nën parimin e kontradiktoritetit, ku palët kanë pasur mundësinë të diskutojnë rreth fuqisë provuese të secilës provë të lejuar dhe administruar gjatë atij gjykimi. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka konfirmuar arsyetimin e gjykatës së apelit, duke evidentuar se pretendimi i kërkuesit për administrimin e tabulateve telefonike është i pabazuar në ligj. Në seancën e datës 21.03.2017, prokurori ka kërkuar shqyrtimin e atij dokumenti, së

bashku me aktet e tjera shkresore, të paraqitura në tetë fashikuj; tabulatet janë administruar nga gjykata si provë e kërkuar nga prokurori, duke u urdhëruar bashkimi i saj, sikundër i akteve të tjera shkresore të gjendura në 8 fashikujt e paraqitur nga prokurori, me fashikullin gjyqësor sipas nenit 371 të KPP-së. Po ashtu, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të shprehur edhe pretendimeve të kërkuesit lidhur me papërdorshmërinë e përgjimit të dëshmitarëve dhe aktit daktiloskopik të gjurmës papilare në motoçikletë, duke vlerësuar se ishin pretendime të pabazuara në ligj.

53. Për sa më lart, Gjykata çmon se gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprave penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar se si ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjërës prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një mori provash përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm. Po ashtu, gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë kanë dhënë përgjigje të arsyetuar përse pretendimi e kërkuesit lidhur me garancitë ligjore procedurale për vlerësimin e provave ishte i pabazuar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.3. Për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit

54. Kërkuesi ka pretenduar arsyetimin e gabuar të vendimit lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar të paraqitur përpara fillimit të rigjykimit në shkallë të parë. Sipas tij, gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar refuzimin e kërkesës me argumentin se përderisa Gjykata e Lartë e kishte kthyer çështjen për rigjykim në shkallë të parë, ajo nuk mund të gjykohej në gjendjen që ishin aktet, por megjithatë debati gjyqësor është zhvilluar mbi të njëjtat prova të administruara në fashikullin e gjykimit dhe gjykata nuk ka marrë ndonjë provë të re. Sipas tij, gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar, sipas rregullave të mendimit të shëndoshë, pretendimit të ngritur në ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë. Kërkuesi ka pretenduar se pohimi i gjykatës se debati gjyqësor

ishte i domosdoshëm për zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, përbën mohim të hapur të drejtësisë, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj kritikonte arsyetimin e gjykatave të faktit, por nuk orientonte për marrjen e ndonjë prove të re. Po ashtu, vijon kërkuesi, edhe argumenti tjetër i gjykatës së apelit është bishtnim nga thelbi i problemit, pasi fakti që mbrojtja e tij ka debatuar për pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit daktiloskopik dhe papërdorshmërinë e procesverbalit të njohjes, ka qenë një qëndrim i detyruar që ka ndodhur *ex post*, vetëm pasi është vënë përpara mohimit të së drejtës për gjykim të shkurtuar, ndaj një rrethanë e tillë nuk mund të përligjë vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi për refuzimin e gjykimit të shkurtuar i ka mohuar në mënyrë arbitrare favoret që buronin prej tij në planin e sanksionit penal.

55. Subjekti i interesuar ka prapësuar se gjykatat me të drejtë kanë arsyetuar se në gjendjen që ndodheshin aktet, ndërsa çështja ishte kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë në fazën e shqyrtimit me debat, si dhe bazuar mbi faktin e një sërë pretendimesh të kërkuesit për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave, nuk mund të pranonin kërkesën për gjykim të shkurtuar. Sipas këtij subjekti, duke pasur parasysh *ratio legis* të institutit të gjykimit të shkurtuar, që është ekonomia gjyqësore, pranimi i gjykimit të shkurtuar në rastin konkret do të përbënte nonsens juridik, pasi nuk mund të flitej më për ekonomi gjyqësore në kuptimin që legjislatori ka dashur të pasqyrojë në dispozitat përkatëse, edhe pse heqja dorë nga çdo provë, në vetvete, përbën ekonomi gjyqësore në vijim të procesit. Nga ana tjetër, po sipas tij, edhe debati për çështjen nuk do të mund të bëhej vetëm mbi aktet e hetimit paraprak, në abstragim të gjykimeve të zakonshme që tashmë ishin zhvilluar, ndërsa palët sigurisht që do t'u referoheshin atyre dhe, në këtë aspekt, bie kërkesa për aplikimin e gjykimit të shkurtuar bazuar në pranimin e akteve të hetimit paraprak. Ai ka prapësuar se kërkuesi gjatë gjithë procesit, përpara dhe pas kthimit të çështjes për rigjykim, ka pasur në vijimësi pretendime për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave, ndaj kërkesat për të përfituar nga ato dhe kërkesa për përfitim nga gjykimi i shkurtuar janë në kontradiktë me njëra-tjetrën. Për më tepër, sipas tij, që vlerësimi nëse një vendim mund të merret mbi bazën e akteve në dispozicion, pa dëmtuar drejtësinë dhe interesat e ligjshëm të të pandehurit, është diskrecion i gjykatës.

56. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet

dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, për sa i takon ritit procedural të gjykimit të shkurtuar, Gjykata ka pohuar se ai (gjykimi i shkurtuar) nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

57. Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjykimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

58. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive *(shih vendimet nr. 56, datë 09.11.2023; nr. 6 datë 22.02.2022; nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

59. Për sa i takon ndarjes së detyrave midis juridiksionit kushtetues dhe atij të gjyqësorit të zakonshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrë

e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Mbi bazën e këtyre standardeve kushtetuese, Gjykata do të kontrollojë nëse interpretimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka garantuar efektivitetin e së drejtës individuale me natyrë procedurale të gjykimit të shkurtuar, e cila është në funksion të parimit të mosdënimit pa ligj, të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës.

61. Për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar, neni 404 i KPP-së së kohës parashikonte se gjykata e shqyrton këtë lloj kërkese përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor dhe kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet vendos të pranojë gjykimin e shkurtuar. Në të kundërt, ajo e refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Vendimi i gjykatës, si në rastin kur pranon gjykimin e shkurtuar, ashtu edhe kur e refuzon atë, është një vendim i ndërmjetëm.

62. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se nga aktet e paraqitura bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur përpara ndryshimeve që ka pësuar KPP-ja me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", kur me ligjin e kohës lejohej kërkimi i gjykimit të shkurtuar edhe për veprat penale që parashikonin si dënim burgimin e përjetshëm, siç është edhe ajo për të cilën akuzohej kërkuesi.

63. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në vendimin e saj ka arsyetuar se për kërkesën për gjykim të shkurtuar të paraqitur përpara fillimit të rigjykimit në shkallë të parë ka disponuar me vendim të ndërmjetëm, duke i argumentuar arsyet në procesverbalin e seancës dhe duke e rrëzuar atë. Konkretisht, ajo gjykatë ka arsyetuar dhe vendosur si më poshtë: "*Të mos pranojë kërkesën e mbrojtjes për ushtrimin e së drejtës për gjykim të shkurtuar në gjendjen që janë aktet për faktin se vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal i saj, i cili ka prishur dy vendimet, vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, e*

ka kthyer çështjen për rigjykim dhe për rrjedhojë nuk mund të gjykohet në gjendjen që janë aktet.".

64. Gjykata e Apelit Durrës, nga ana e saj, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuesit, e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Gjykata e apelit ka arsyetuar se në vlerësim dhe respektim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë ka qenë e domosdoshme që për gjykimin e çështjes së kërkuesit gjykimi të zhvillohej me ritin e gjykimit të zakonshëm, në mënyrë që të gjitha provat e marra t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor, e parë kjo edhe në raport me qëndrimet dhe pretendimet e vet kërkuesit. Gjithashtu, sipas saj, refuzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar ishte i drejtë nisur edhe nga fakti se kërkuesi, gjatë vijimit të procesit, ka ngritur pretendime për pavlefshmëri të akteve dhe për papërdorshmëri të provave.

65. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, ndërkohë për pretendimin e ngritur nga ai për refuzimin e gjykimit të shkurtuar, pasi ka konstatuar se arsyetimi i vendimit të ndërmjetëm nga gjykata e shkallës së parë është bërë në procesverbalin e seancës gjyqësore, ka theksuar faktin se ky qëndrim është mbështetur dhe arsyetuar nga gjykata e apelit në vendimin e saj. Sipas atij kolegji, kjo vendimmarrje e gjykatave më të ulëta ka qenë e imponuar nga urdhërimet e vendimit të parë të Gjykatës së Lartë *(nr. 00-2016-754 (95), datë 04.05.2016)* që ka dërguar çështjen për rigjykim *(shih paragrafin 47 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

66. Duke mbajtur parasysh qasjen e gjykatave të zakonshme për kërkesën për gjykim të shkurtuar, Gjykata vëren se ato e kanë arsyetuar qëndrimin e tyre për këtë çështje bazuar në tre qëndrime: *së pari*, sepse kthimi i çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë ka sjellë si pasojë humbjen e së drejtës për kërkim për gjykim të shkurtuar (qëndrim ky i mbajtur nga gjykata e shkallës së parë), *së dyti*, sepse gjykimi i shkurtuar nuk ishte i mundur duke pasur parasysh natyrën e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë për gjykatat e rigjykimit dhe, *së treti,* sepse gjykimi i shkurtuar nuk ishte i mundur përderisa kërkuesi gjatë procesit kishte ngritur pretendime për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave.

67. Duke marrë në analizë këto tre qëndrime, Gjykata vëren se për *qëndrimin e parë* të gjykatave të zakonshme, atë që lidhet me argumentin se kthimi i çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë ka sjellë si pasojë humbjen e së drejtës për kërkim të gjykimit të shkurtuar, rezulton se në procesin penal i pandehuri gëzon të drejtën procedurale për të kërkuar

gjykim të shkurtuar sipas nenit 403 të KPP-së (sipas përmbajtjes në kohën e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar) dhe fakti që çështja ishte kthyer për rigjykim nuk përbënte sipas ligjit një rrethanë përcaktuese ose skualifikuese për moslejimin e kërkimit për gjykim të shkurtuar nga kërkuesi. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në këto kushte (të rishqyrtimit të plotë) procesi konsiderohet se fillon nga e para dhe, për pasojë, i pandehuri gëzon të gjitha të drejtat procedurale që do të gëzonte në një gjykim të zakonshëm, përfshirë edhe të drejtën për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, pasi vetëm në këtë mënyrë e drejta individuale me natyrë procedurale e gjykimit të shkurtuar është efektive. Në këtë kuptim, për sa kohë norma ligjore nuk përmban ndonjë ndalim të shprehur për të proceduar me gjykim të shkurtuar në rigjykimin e çështjes dhe, për rrjedhojë, bërjen ekonomi gjyqësore për procesin në vijim, sikundër pranohet edhe nga subjekti i interesuar, interpretimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme në këtë drejtim nuk duket i arsyeshëm.

68. Për sa i takon *qëndrimit të dytë*, i cili lidhet me faktin se gjykimi i shkurtuar nuk ishte i mundur duke pasur parasysh natyrën e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë për gjykatat e rigjykimit, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka urdhëruar rigjykimin e çështjes në mënyrë që gjykatat e faktit "*të vlerësojnë çdo element indiciar provues në drejtim të tregimit të përgjegjësisë së kërkuesit, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kriterin e logjikën e ndjekur nëpërmjet një arsyetimi korrekt juridik*". Thënë ndryshe, Gjykata e Lartë ka gjetur shkelje në arsyetimin e gjykatave të faktit për çmuarjen e provave të fajësisë dhe lidhjen mes tyre (provave). Ndryshe nga sa vlerësojnë Gjykata e Lartë (në rigjykim) dhe ajo e apelit, Gjykata çmon se detyra e lënë nga Gjykata e Lartë në kuadër të rigjykimit nuk është e tillë që të përbëjë pengesë për gjykatat e rigjykimit që të vlerësojnë dhe vendosin për pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar për sa kohë që ekziston mundësia që arsyetimi dhe çmuarja e provave (detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë) mund të realizohen edhe në gjendjen që janë aktet, çka përbën edhe thelbin e gjykimit të shkurtuar. Natyrisht, ashtu siç ka theksuar edhe Gjykata në jurisprudencën e saj në lidhje me institutin e gjykimit të shkurtuar, vendimi për të pranuar ose jo kërkesën për gjykim të shkurtuar mbetet në çmimin dhe bindjen e gjyqtarit të seancës, i cili, në kushtet kur nuk ekziston një pengesë për zbatimin e këtij riti gjykimi si rezultat i vendimit që ka urdhëruar rigjykimin, ka detyrimin që të arsyetojë vetë dhe në mënyrë shteruese arsyet e rrëzimit të kërkesës, pra duke parashtruar argumente konkrete, të cilat tregojnë, nga njëra anë, nevojën për të proceduar me gjykim të zakonshëm dhe, nga ana tjetër, për

pamundësinë e zgjidhjes së çështjes në gjendjen që janë aktet. Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme në raport me atë situatë faktike dhe ligjore në rastin konkret nuk duket i arsyeshëm.

69. Lidhur me *qëndrimin e tretë*, atë që ka të bëjë me faktin se gjykimi i shkurtuar nuk ishte i mundur përderisa kërkuesi, gjatë procesit, kishte ngritur pretendime për pavlefshmëri të akteve dhe për papërdorshmëri të provave, Gjykata vëren se në procesin e rigjykimit në shkallë të parë, referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 21.02.2017, pas hapjes së seancës dhe përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, në kuadër të kërkesave paraprake, mbrojtësi i kërkuesit i pajisur me të gjitha tagrat nga ai, ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar. Për këtë kërkesë, pasi ka marrë mendimin e prokurorit, gjykata është shprehur në seancën e radhës, atë të datës 06.03.2017, duke vendosur mospranimin e saj. Pas parashtrimit hyrës dhe kërkesës për prova nga prokurori, seanca gjyqësore është shtyrë. Në seancën e datës 21.03.2017, mbrojtësi i kërkuesit ka depozituar një kërkesë me shkrim për deklarimin e papërdorshmërisë së aktit të ekspertimit daktiloskopik vlerësues të gjurmës papilare, pavlefshmërinë relative për shkak të formës dhe papërdorshmërinë për shkak të përmbajtjes së aktit të njohjes së personit (të pandehurit) nga shtetasi O.Xh., si dhe papërdorshmërinë e përgjimit ambiental të dëshmitarëve O.Xh. dhe E.A. Për këtë kërkesë, për sa u përket pretendimeve për papërdorshmëri të provave, gjykata ka vendosur që të shprehet në vendimin përfundimtar, kurse për sa u përket pretendimeve për pavlefshmëri të aktit, për shkak të formës, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar. Procesi gjyqësor më pas ka vijuar me marrjen e provave.

70. Gjykata vëren gjithashtu se sipas nenit 129, pika 2, të KPP-së së kohës, edhe pavlefshmëria e akteve të hetimit paraprak duhet të kundërshtohet përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor. Ndërkohë, për sa i përket marrjes së provave, neni 151 i KPP-së së kohës parashikonte se në gjykim provat merren nga gjykata me kërkesën e palëve, ndërsa pretendimet për papërdorshmërinë e provave, për shkak të marrjes së tyre në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji, mund të ngrihen në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Neni 355 i kodit parashikon se pas fazës së shqyrtimit të kërkesave paraprake, deklarohet hapja e shqyrtimit gjyqësor dhe në vijim, palët, sipas radhës së përcaktuar në nenin 356, bëjnë parashtrimet hyrëse dhe kërkesat për prova, ndërsa është gjykata ajo që vendos për marrjen e tyre dhe se palët mund të ngrenë pretendime për marrjen e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor (neni 357).

71. Nga sa më lart, duket se kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur dhe gjykata e shkallës së parë ka disponuar në lidhje me të, përpara se i pandehuri (kërkuesi) gjatë vijimit të procesit të ketë ngritur pretendime për pavlefshmëri të akteve ose për papërdorshmëri të provave. Në këtë kuptim, ndërsa ngritja e pretendimeve të tilla mund të përbënte shkak për revokimin e vendimit të ndërmjetëm për të proceduar me gjykim të shkurtuar, e kundërta, paraqitja e tyre gjatë vijimit të procesit pas refuzimit nga gjykata të kërkesës për gjykim të shkurtuar, nuk mund të shërbejë si argument justifikues për atë vendim të ndërmjetëm të saj që tashmë ishte marrë. Përmes kërkesës për gjykim të shkurtuar i pandehuri (kërkuesi) hoqi dorë nga çdo pretendim për pavlefshmëri të akteve ose për papërdorshmëri të provave, ndaj fakti i mëvonshëm i ngritjes nga ai të pretendimeve të tilla, pra vetëm pasi gjykata refuzoi kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar dhe vijoi gjykimin me procedurë të zakonshme, nuk mund të interpretohet se ky shkak pengues për të proceduar me gjykim të shkurtuar ka qenë prezent në kohën e atij vendimi të ndërmjetëm të gjykatës. Bazuar në këtë analizë, arsyetimi i gjykatave të zakonshme, sipas të cilit gjykimi i shkurtuar në rastin e kërkuesit nuk ishte i mundur, përderisa ai kishte ngritur pretendime për pavlefshmëri të akteve ose për papërdorshmëri të provave, duket se është rrjedhojë e një interpretimi të paarsyeshëm të ligjit.

72. Gjykata vlerëson të theksojë gjithashtu efektet që sjell gjykimi i shkurtuar, për sa i përket masës së dënimit. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, influencon mbi masën ose llojin e dënimit që caktohet nga gjykata dhe, për rrjedhojë, kjo e drejtë procedurale ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtën materiale të mosdënimit pa ligj. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit kanë refuzuar kërkesën e kërkuesit për gjykim të shkurtuar, duke i mohuar atij përfitimet e njohura nga ligji për dënimin.

73. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, si gjykatat e faktit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk i kanë interpretuar dhe zbatuar normat procedurale penale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar në atë mënyrë që të bëjnë tërësisht efektive të drejtën e parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës. Mënyra sesi kanë vepruar gjykatat e zakonshme në rastin konkret, duke mos i garantuar kërkuesit të drejtën për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar gjatë procesit gjyqësor penal ka sjellë, në thelb, cenimin e garancive efektive kundër dënimit arbitrar në kuptim të së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj.

74. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-929, datë 23.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.04.2025
Shpallur më 25.06.2025

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Arjan Çelaj (alias Edison Çelaj), me objekt "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-929, datë 23.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", ne, gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi, jemi të qëndrimit se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i bazuar, ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar edhe për këtë shkak. Për rrjedhojë, në vijim parashtrojmë argumentet që mbështesin qëndrimin tonë.

2. Në drejtim të këtij pretendimi kërkuesi ka parashtruar se është deklaruar fajtor mbi bazën e dyshimeve, të cilat gjykatat i kanë çmuar në favor të akuzës, sikurse janë rezultatet e përgjimit ambiental, përmbajtja e të cilit tregon vetëm për një dyshim të shtetasit O.Xh. se kërkuesi mund të ishte autori i krimit. Sipas tij, gjykatat e rigjykimit nuk kanë zbatuar detyrat e Gjykatës së Lartë dhe nuk kanë arsyetuar për provat e fajësinë që rëndojnë mbi të, përveçse u kanë mëshuar përsëri provave të cilat janë deklaruar si të papërdorshme, sikurse janë deklarimet e tij në fazën e hetimit paraprak dhe aktit të paraqitjes për njohje. Po sipas kërkuesit, gjykatat e kanë filluar procesin me paragjykim se ai është fajtor dhe duhet të dënohej, çka konfirmohet nga fakti se në përfundim të rigjykimit në shkallë të parë, gjykata e shpalli vendimin e fajësisë të arsyetuar vetëm 10 minuta pas fjalës së mbrojtjes.

3. Në këndvështrim të analizës në lidhje me këtë parim kushtetues, vlerësojmë të evidentojmë, fillimisht, se ndërsa i bashkohemi shumicës në lidhje me përfundimin se nuk ka cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë për shkak të kohëzgjatjes së bisedimeve të trupit gjykues në dhomën e këshillimit (*shih paragrafin 42 të vendimit*), ne kemi mbajtur qasje të ndryshme për sa i përket argumenteve të tjera në lidhje me këtë aspekt të gjykimit, për sa kohë që jemi të qëndrimit se në rastin konkret ka pasur zhvendosje të barrës së provës nga akuza tek i pandehuri dhe se fajësia e kërkuesit nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

4. Sipas shumicës, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë ka analizuar provat duke përcaktuar rrethanat faktike si vijon: i) në kohën e ngjarjes kërkuesi provohet të ketë qenë në qytetin e Durrësit, ku ka ndodhur ngjarja; ii) autorët e veprës penale kanë përdorur për kryerjen e krimit

një motoçikletë, e cila është gjetur e braktisur një ditë pas ngjarjes dhe është sekuestruar, bazuar ky përfundim në dëshminë e dëshmitarit B.C. dhe procedurën e njohjes së sendit (motoçikletës) nga ai; iii) kërkuesi ka përdorur motoçikletën në kryerjen e krimit, bazuar në gjurmën papilare të identifikuar; iv) kërkuesi ka qenë personi që ka qëlluar në lokalin e shtetasit B.C., kur ka ndodhur ngjarja, bazuar në rezultatet e përgjimit ambiental të dëshmitarëve O.Xh. dhe E.A., ku i pari është shprehur me siguri të plotë se i pandehuri ka qenë personi që ka kryer krimin. Lidhur me argumentin e kërkuesit se përgjimi në përmbajtje tregon vetëm një dyshim në lidhje me autorësinë e tij në krim dhe se ky dyshim është çmuar nga gjykatat e zakonshme në favor të akuzës, sipas shumicës, nga komunikimet e përgjuara, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, nuk rezultojnë dyshime apo aludime për autorësinë e tij (*shih paragrafët 47-49 të vendimit*).

5. Po sipas shumicës, gjykata e apelit i ka vlerësuar sërish provat sipas neneve 152 e vijues të KPP-së dhe ka arritur në përfundimin se fajësia e kërkuesit provohej plotësisht dhe ka shpjeguar edhe arsyet se përse nuk qëndronin kundërshtimet e tij për përmbajtjen e provave dhe saktësinë e tyre, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke konfirmuar se gjykatat më të ulëta kanë analizuar e shqyrtuar provat në zbatim të drejtë të nenit 152 të KPP-së. Për rrjedhojë, shumica ka arritur në përfundimin se gjykatat e zakonshme kanë përmbushur detyrimin për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, duke përcaktuar fajësinë e tij përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një mori provash përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm dhe duke u dhënë përgjigje të arsyetuar se përse pretendimi për garancitë ligjore procedurale për vlerësimin e provave ishte i pabazuar (*shih paragrafët 50-53 të vendimit*).

6. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për

vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t`i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime (*shih vendimet nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016; nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancitë kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale (prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Kështu, parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 4 të këtij kodi, sipas të cilit i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të tij. Vendimi i fajësisë jepet nga gjykata kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Ky parim është parashikuar edhe në nenin 6 § 2 të KEDNJ-së dhe sipas GJEDNJ-së ai parim shihet në dy aspekte: *i*) si garanci procedurale në kuadrin e vet procesit penal, ku imponon kërkesa në lidhje me, ndër të tjera, barrën e provës; prezumimet juridike të faktit dhe ligjit; mbrojtjen nga vetë-inkriminimi dhe shprehjet e parakohshme, nga gjykata ose nga zyrtarë të tjerë publikë për fajësinë e të pandehurit; dhe *ii*) si garanci për mbrojtjen e individëve që janë deklaruar të pafajshëm ose për të cilët procedimi penal është pushuar që të mos trajtohen nga zyrtarët publikë dhe autoritetet sikur të ishin në fakt fajtorë për veprën penale të akuzuar (*shih Telfner kundër Austrisë, 20.03.2001, § 15; Radio France dhe të tjerë kundër Francës, 30.03.2004, § 24; G.C.P. v. Rumanisë, 20.12.2011, § 46; Nešťák kundër Sllovakisë, 20.12.2007, § 88).*

8. Duke analizuar respektimin e këtij parimi në këndvështrim të fakteve me natyrë kushtetuese të evidentuara në rastin konkret, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit është i bazuar pasi fajësia e tij rezulton që të jetë përcaktuar nga gjykatat: i) mbi bazën e indicieve, pa pasur prova të plota referuar kuptimit që i jep atyre KPP-ja, të cilat, në harmoni me njëra-tjetrën të jenë të afta të çojnë në përfundimin e fajësisë të të pandehurit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm; ii) duke i dhënë vlerë të paracaktuar përgjimit të dëshmitarit, por pa përcaktuar se përse në rastin konkret ai merrte vlerë kundrejt deklarimeve mohuese në procedurën e njohjes.

9. Për sa i përket përcaktimit të fajësisë së kërkuesit konstatohet se gjykatat e faktit janë bazuar edhe në aktin e ekspertimit daktilografik të gjurmës papilare të formuar nga gishti i madh i dorës së djathtë të

kërkuesit dhe rezultatet e përgjimit ambiental. Edhe pse ne kemi mbajtur të njëjtën qasje si shumica për ligjshmërinë e marrjes së këtyre provave dhe përdorshmërinë e tyre në proces, jemi të qëndrimit se ato në vetvete janë të pamjaftueshme për të provuar fajësinë e kërkuesit. Organi i akuzës fillimisht, edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, dhe më pas gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit, edhe pse e kanë referuar dhe përshkruar këtë provë në vendimet e tyre nuk kanë qenë të afta të analizojnë aftësinë dhe vlerën e saj provuese në drejtim të fajësisë, për sa kohë që nuk rezulton që ajo të jetë shoqëruar me prova të tjera në kuptim të nenit 149 të KP-së, të kryqëzuara dhe të lidhura në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën, por vetëm me indicie që kanë lindur dyshimin se kërkuesi mund të ketë qenë i pranishëm në vendngjarje dhe mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, por pa e çuar këtë dyshim në atë nivel provueshmërie që kërkon parimi i prezumimit të pafajësisë.

10. Me vendimin nr. 95, datë 04.05.2016, Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen për rigjykim, duke urdhëruar gjykatën e faktit që të vlerësojë çdo element indiciar provues, duke shqyrtuar aftësinë e tyre provuese në drejtim të tregimit të përgjegjësisë së të pandehurit dhe duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kriterin dhe logjikën e ndjekur nëpërmjet një arsyetimi korrekt juridik, që eventualisht mund të kontrollohet nga gjykatat më të larta. Megjithatë, gjykatat e faktit, në rigjykimin e çështjes ndaj kërkuesit, në kundërshtim edhe me detyrat e lëna nga gjykata më e lartë, në ndryshim nga sa arsyeton shumica, sërish nuk kanë arritur të bazojnë qëndrimin dhe arsyetimin e tyre në prova direkte dhe të analizojnë fuqinë provuese sipas nenit 152 të KPP-së të secilës provë më vete dhe, më tej, fuqinë provuese në lidhje me njëra-tjetrën.

11. Nga ana tjetër, në datën 30.01.2010, kur është ndaluar kërkuesi, është realizuar edhe paraqitja për njohje nga ana e shtetasit O.Xh., i afërm i një prej viktimave, i cili ka qenë në lokal kur ka ndodhur ngjarja dhe ishte pyetur më parë si deklarues për rrethanat e ngjarjes dhe autorin e saj. Ky veprim hetimor është përsëritur tre herë dhe shtetasi në fjalë ka identifikuar kërkuesin si autor të veprës penale, ku në rastin e parë identifikimi nga ai i kërkuesit nuk është bërë me siguri të plotë. Po në këtë datë, pasi kishte përfunduar paraqitja për njohje, është realizuar edhe përgjimi ambiental i dy deklaruesve të pranishëm në ngjarje, shtetasve O.Xh. dhe E.A., ku gjatë bisedës i pari i ka deklaruar të dytit me siguri të plotë se personi që i ishte paraqitur për njohje, kërkuesi, ishte autori i ngjarjes. Sipas shumicës, nga komunikimet e përgjuara, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, nuk

rezultojnë dyshime apo aludime për autorësinë e tij, megjithatë, kjo provë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme në harmoni edhe me provat e tjera të administruara, duke mos i dhënë përgjimit vlerë të paracaktuar dhe duke mos zhvendosur barrën e provës te kërkuesi (*shih paragrafin 49 të vendimit*).

12. Referuar fakteve me natyrë kushtetuese të këtij gjykimi rezulton se në paraqitjen për njohje dëshmitari O.Xh. ka deklaruar se nuk ka siguri se ka qenë kërkuesi autor i veprës penale, çka bën që në kuptim të parimit të prezumimit të pafajësisë kjo të çmohej në favor të kërkuesit. Megjithatë, gjykatat nuk e kanë vlerësuar këtë deklarim në favor të kërkuesit, por e kanë mbështetur qëndrimin e tyre në përgjimin ambiental të kryer ndaj këtij dëshmitari, jo vetëm duke e marrë të mirëqenë atë, për rrjedhojë duke i dhënë vlerë të paracaktuar, por edhe duke mos analizuar se përse kjo prevalonte kundrejt deklarimeve të dëshmitarit O.Xh. të dhëna në procedurën e njohjes.

13. Në përfundim të argumenteve të mësipërme, në vlerësimin tonë, gjykatat e zakonshme, në mënyrën se si kanë vlerësuar në rastin konkret çështjen e kërkuesit e kanë zhvendosur barrën e provës nga akuza tek i pandehuri, duke mos arritur të përcaktojnë fajësinë e tij përtej dyshimeve të arsyeshme dhe duke mos interpretuar dyshimet e lindura në favorin e tij. Për rrjedhojë, në vlerësimin tonë pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i bazuar, ndaj duhej të ishte pranuar.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Arjan Çelaj (alias Edison Çelaj), me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-929, datë 23.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, në vijim do të parashtrojmë argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprave penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese" kundër dy ose më shumë personave, të kryer në bashkëpunim, dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 79, shkronja "dh", 25 dhe 278, paragrafi i dytë, të KP-së, pasi së bashku me një shtetas tjetër, në datën 27.01.2010, rreth orës 22:30, në qytetin e Durrësit janë afruar me një motoçikletë në vendin e ngjarjes dhe kanë qëlluar në drejtim të tre personave, njëri prej të cilëve i mitur i moshës 17 vjeç, duke u shkaktuar vdekjen. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale sipas akuzave, duke e dënuar me burgim të përjetshëm, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës. Për rekursin e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e këtyre vendimeve dhe kthimin për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Në rigjykimin e çështjes, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkuesi ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, por kërkesa e tij nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Kjo e fundit, pasi ka argumentuar fajësinë e tij, ka vendosur sërish dënimin e kërkuesit me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

3. Në këto kushte, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke ngritur disa pretendime, të cilat janë analizuar nga shumica në këndvështrim të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, si dhe të parimit

të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Teksa i jemi bashkuar qëndrimit të shumicës për vlerësimin se pretendimet për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor bazuar në prova të paligjshme dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë janë të pabazuara, ndajmë qëndrim të kundërt për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.

4. Lidhur me këtë të fundit, shumica ka evidentuar fillimisht se kërkuesi ka paraqitur kërkesën për gjykimin e shkurtuar të çështjes përpara ndryshimeve në KPP kur lejohej zbatimi i gjykimit të shkurtuar edhe për veprat penale që parashikonin dënim me burgim të përjetshëm (*shih paragrafin 62 të vendimit*). Bazuar në tre argumentet e përdorura nga gjykatat e zakonshme për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, shumica ka vlerësuar se gjykatat e faktit, ashtu edhe Gjykata e Lartë i kanë interpretuar normat procedurale penale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar në mënyrë të paarsyeshme dhe, për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka përfituar nga ulja e dënimit penal. Për këtë arsye, sipas shumicës, nga vendimi i Gjykatës së Lartë është cenuar parimi i mosdënimit pa ligj i parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës.

5. Duke ruajtur të njëjtën strukturë argumentesh si shumica, nuk pajtohemi me vlerësimin e pretendimit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit për tre arsyet e mëposhtme.

6. Në parantezë theksojmë se, sikurse ka pranuar shumica në vendim, gjykimi i shkurtuar hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme. Gjykata është shprehur se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime për këtë vlerësim, kjo mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

7. Mbi bazën e këtij standardi, shumica ka arsyetuar, *së pari*, se fakti që çështja ishte kthyer për rigjykim nuk përbënte një rrethanë skualifikuese për të vendosur gjykimin e shkurtuar, pasi procesi konsiderohet se fillon nga e para dhe, për pasojë, i pandehuri gëzon të gjitha të drejtat procedurale që do të gëzonte në një gjykim të zakonshëm, përfshirë edhe të drejtën për

të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, pasi vetëm në këtë mënyrë e drejta individuale me natyrë procedurale e gjykimit të shkurtuar është efektive (*shih paragrafin 67 të vendimit*). Ky argument i shumicës jo vetëm që e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën për gjykim të shkurtuar të çështjes, duke tejkaluar tekstin kushtetues, por gjithashtu e ka konceptuar këtë institut si prerogativë të të pandehurit. Në ndryshim nga shumica, jemi të mendimit se në një situatë rigjykimi nuk përjashtohet *per se* dhe automatikisht procedura e gjykimit të shkurtuar, megjithatë kjo nuk ka të bëjë me efektivitetin e së drejtës procedurale të të pandehurit për gjykim të shkurtuar, por me shkakun për të cilën çështja penale kthehet për rigjykim nga gjykatat më të larta. Në thelb, gjykimi i shkurtuar nuk është një prerogativë ligjore e të pandehurit, në kuptimin e privilegjit ekskluziv të tij, por është një institut ligjor që vihet në lëvizje ekskluzivisht nga i pandehuri dhe që vendoset nga gjykata, me kushtin që çështja penale të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Kur gjykimi i shkurtuar vendoset nga gjykata, ai sjell përfitime në të dyja anët e kundërta të akuzës: (i) për të pandehurin passjell uljen e dënimit me 1/3; (ii) për interesin publik dhe viktimat e veprës penale passjell administrim të shpejtë dhe pa shpenzime të drejtësisë. Në këtë pikëpamje, kur çështja penale kthehet për rigjykim me detyrën e riparimit të shkeljeve procedurale në vlerësimin e provave dhe dhënien përgjigje pretendimeve eventuale të të pandehurit për pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e provave, qartësisht nuk bëhet fjalë që nga pikëpamja kushtetuese gjykatat e zakonshme kanë detyrimin të pranojnë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar në mënyrë që ta bëjnë atë efektive.

8. *Së dyti,* shumica ka vlerësuar se nuk qëndron arsyetimi i gjykatave të zakonshme për refuzimin e gjykimit të shkurtuar kur ato janë shprehur se shkaku lidhej me natyrën e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë për gjykatat e rigjykimit. Në këtë pikë, shumica ka evidentuar se Gjykata e Lartë ka urdhëruar rigjykimin e çështjes në mënyrë që gjykatat e faktit "*të vlerësojnë çdo element indiciar provues në drejtim të tregimit të përgjegjësisë së kërkuesit, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kriterin e logjikën e ndjekur nëpërmjet një arsyetimi korrekt juridik*". Sipas shumicës, kjo detyrë e lënë nga Gjykata e Lartë nuk përbën pengesë për gjykatat e rigjykimit që të vlerësojnë dhe vendosin për pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar për sa kohë që ekziston mundësia që arsyetimi dhe çmuarja e provave (detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë) mund të realizohen edhe në gjendjen që janë aktet, çka përbën edhe thelbin e gjykimit të shkurtuar (*shih paragrafin 68 të vendimit*). Nuk pajtohemi me këtë argument të shumicës, sepse ai është rrjedhojë e interpretimit të fragmentarizuar të ecurisë së procesit penal të

kërkuesit. Konkretisht, Gjykata e Lartë ka urdhëruar rigjykimin e çështjes në kontekstin e kundërshtimeve që kërkuesi ka pasur për mënyrën e marrjes së provave, pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e tyre. Në këtë kuptim, detyra e lënë nga Gjykata e Lartë për gjykatën e rigjykimit kishte të bënte me zhvillimin e një procesi të rregullt, bazuar në parimin e kontradiktoritetit, të drejtën e mbrojtjes dhe standardin e arsyetimit. Me fjalë të tjera, në rigjykim, i pandehuri duhet të kishte mundësinë të paraqiste kundërshtimet e veta për vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e provave, si dhe për përmbajtjen e tyre, dhe gjykata duhet të arsyetonte për ato kundërshtime, nëse qëndronin ose jo. Është e qartë që kjo detyrë e lënë nga Gjykata e Lartë synonte debat gjyqësor për provat, i cili mund të realizohej përmes procedurës normale të gjykimit dhe jo me gjykim të shkurtuar.

9. *Së treti,* shumica ka arsyetuar se vlerësimi i gjykatave të faktit ishte rrjedhojë e një interpretimi të paarsyeshëm të ligjit, kur shprehen se gjykimi i shkurtuar nuk ishte i mundur përderisa kërkuesi kishte ngritur pretendime për pavlefshmërinë e dy provave (aktit të ekspertimit dhe të përgjimit ambiental). Në këtë kontekst shumica ka analizuar radhën e veprimeve procedurale që gjykata zhvillon në shkallë të parë referuar dispozitave të KPP-së, ku kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet përpara se të debatohen provat (*shih paragrafët 70-71 të vendimit*). Jemi të mendimit që kjo analizë nuk përputhet me parashikimet ligjore procedurale penale dhe as me praktikën konstante të gjykatave të zakonshme. Në këtë pikëpamje, duhet vënë në dukje se KPP-ja nuk përcakton radhë strikte kronologjike të kërkesave procedurale, pra të atyre kërkesave që i paraprijnë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, kërkesa të cilat emërtohen nga ligji si kërkesa paraprake (*shih për ilustrim nenin 354 të KPP-së*). Për paraqitjen e këtyre kërkesave duhet plotësuar vetëm kriteri kohor "gjersa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor", i cili sipas nenit 358 të KPP-së është moment solemn ligjor i deklaruar nga kryesuesi i seancës, pikërisht sepse lidhet me rënien në dekadencë të kërkesave të tilla.

10. Përtej pasaktësisë formale të argumentit, jemi të mendimit se, në rastin konkret, çështja kryesore nga pikëpamja kushtetuese kishte të bënte me kontrollin e diskrecionit që gjykata e zakonshme ushtron kur refuzon kërkesën për gjykimin kushtetues, për sa kohë që ushtrimi i këtij diskrecioni vë në rrezik përfitimin e të pandehurit për uljen e dënimit me 1/3 e tij, sipas nenit 406 të KPP-së, që në thelb fut në lojë parimin e mosdënimit pa ligj të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës. Mirëpo ky diskrecion ka të bëjë me vlerësimin e provave, pasi gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar kur vlerëson se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Për rrjedhojë, vlerësimi i akteve, që në thelb është vlerësim provash,

për kontrollin kushtetues të diskrecionit të gjykatës së zakonshme merr rëndësi thelbësore ndarja e qartë e juridiksionit kushtetues nga ai gjyqësor i zakonshëm. Për këtë qëllim, jemi të mendimit se ky lloj diskrecioni duhet vlerësuar nga Gjykata vetëm për arbitraritet, pra nëse gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 4 datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Mbi bazën e këtij standardi, nga analiza e vendimeve gjyqësore që kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit, konstatojmë se ai që në fillim të procesit gjyqësor ka pasur pretendime për pavlefshmërinë e akteve të ekspertimit në lidhje me shenjat e gjurmëve të gjendura në motoçikletë. Gjykata e Lartë kur urdhëroi rigjykimin e çështjes në shkallë të parë ka lënë detyrën që gjykatat e faktit të vlerësonin "*çdo element indiciar provues në drejtim të tregimit të përgjegjësisë së kërkuesit*". Edhe në rigjykimin e çështjes, kërkuesi i ka ngritur pretendimet për provat në të gjitha shkallët e gjykimit deri në ankimin kushtetues individual, sikurse janë evidentuar edhe nga shumica në vendim. Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të tij, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe ka zhvilluar debat të plotë gjyqësor për provat shkresore dhe ato me dëshmitarë, si dhe ka pyetur në seancë edhe ekspertët për të saktësuar procedurën e marrjes dhe të fiksimit të gjurmëve të gjetura në motoçikletën e përdorur për kryerjen e veprës penale. Gjykata e apelit e ka konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar, duke arsyetuar se debati gjyqësor ishte i nevojshëm në raport me qëndrimin dhe pretendimet e kërkuesit për provat. Po në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka pranuar se gjykata e shkallës së parë në procesverbalin e seancës gjyqësore ka motivuar qëndrimin e saj për rrëzimin e asaj kërkese, i cili është mbështetur edhe nga gjykata e apelit, për shkak se kërkuesi ka pasur pretendime për vlefshmërinë e provave.

12. Në vështrim të sa më sipër, në vlerësimin tonë, refuzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar nga gjykatat e zakonshme nuk rezulton të jetë rrjedhojë e gabimeve faktike ose ligjore, në kuptimin që ta bëjë atë arbitrar në aspektin kushtetues. Për rrjedhojë, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtare: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

Indeks i vendimeve të vitit 2025

INDEKSI ALFABETIK

A

- Administrimi
  - *i akteve në gjykim (V-5/25 f. 123, Vol. I)*
  - *i drejtësisë (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
- Afat
  - *i arsyeshëm ekzekutimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i arsyeshëm gjykimi (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
  - *i ngritjes së padisë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *ligjor (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
  - *llogaritje afati (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *rivendosje në afat (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Akses substancial *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*
- Aksident
  - *rrugor (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *në punë (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
- Akt
  - *administrativ (V-19/25 f. 425, Vol. I)*
  - *ekspertimi (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *ekspertimi biologjik (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *ekspertimi grafik (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *ekspertimi teknik-elektronik (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *fuqi provuese e aktit (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *individual (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *normativ (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *pavlefshmëri absolute e aktit (V-19/25 f. 425, Vol. I)*
  - *pavlefshmëri relative e aktit (V-3/25 f. 85, Vol. I)*
  - *përfaqësimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Aparat telefonik celular *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Arbitrazh ndërkombëtar *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Arsye antikushtetutshmërie *(V-22/25 f. 497, Vol. I)*
- Arsyetim
  - *arbitrar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *de plano i vendimit (V-10/25 f. 272, Vol. I)*

  - *formal (V-4/25 f. 113, Vol. I)*
  - *i kufizuar (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
  - *i vendimit (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V26/25 f. 577, Vol. I)*
- Asgjësim i të dhënave kompjuterike të sekuestruara *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*
- Autonomi parlamentare *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Autorizim për heqjen e lirisë *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*

B
- Barazia e armëve *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*
- Barrë prove *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Bashkëpunim gjyqësor penal *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Bindje e brendshme e gjyqtarit *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*; *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*
- Burim gjenerues energjie *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

C
- Cilësim
  - *juridik i faktit penal (V-11/25 f. 286, Vol. I)*
  - *juridik i veprës penale (Nuk ka vendime në Vol. I)*

D
- Decentralizim i qeverisjes vendore *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Detyrim
  - *financiar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
  - *ushqimor (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Dëm
  - *biologjik (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *jashtëkontraktor (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *jopasuror (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
  - *pasuror (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *shkaktim dëmi (V-2/25 f. 62, Vol. I)*
  - *shpërblim dëmi (V-10/25 f. 272, Vol. I)*
- Dënim
  - *me gjobë (V-19/25 f. 425, Vol. I)*
  - *parashkrim i dënimit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *ulje e dënimit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Dëshmitar *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*
- Direktiva BE 2024/1260, datë 24.04.2024 *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Direktiva 42/2014 BE, datë 24.04.2024 *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Direktiva 2006/126/EC "Për lejet e drejtimit" *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Dispozitë kalimtare *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

- Dyshim
  - *i arsyeshëm (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *i justifikuar (V-9/25 f. 255, Vol. I)*

E

- E drejta
  - *analizë e së drejtës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *e informimit (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *e jetës private (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *e pronës (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *e punës dhe profesionit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *e drejta për të qëndruar në heshtje (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *për gjykim të drejtë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *për pension (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
  - *për të mos u dëbuar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *për të marrë në pyetje dëshmitarë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *për t'u dëgjuar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
  - *për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-18/25 f. 408, Vol. I)*
  - *për t'u mbrojtur (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi) (V-1/25 f. 7, Vol. I)*; *(V-5/25 f. 123, Vol. I)*; *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-12/25 f. 304, Vol. I)*; *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*; *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*
  - *pozitive*
- Ekstradim *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ekzekutim
  - *i vendimit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i vendimit penal (Nuk ka vendime në Vol. I)*

F

- Fajësia *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Fakt
  - *analizë e fakteve (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *penal (V-1/25 f. 7, Vol. I)*
  - *prezumim fakti (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *ripërcaktim i fakteve (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
  - *vlerësimi i fakteve (V-10/25 f. 272, Vol. I)*
- Falsifikim i dokumenteve *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*
- Faturë financiare e projektligjit *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Flora dhe fauna *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Fshehje e kufomës *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Funksionarët e lartë shtetërorë *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*
- Funksionet GJL *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*; *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*; *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*

- Fuqia detyruese
  - *e vendimeve GJK (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I)*
- Fuqia prapavepruese e normës juridike *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

GJ
- Gjobë *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*
- Gjykatë
  - *e posaçme (V-22/25 f. 497, Vol. I)*
  - *ligji (V-3/25 f. 85, Vol. I)*
- Gjykim
  - *i drejtë (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *i shkurtuar (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *në mungesë (V-18/25 f. 408, Vol. I)*

H
- Harmonizim i kuadrit ligjor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Hetim
  - *administrativ (V-3/25 f. 85, Vol. I)*
  - *i të dhënave (V-22/25 f. 497, Vol. I)*
- Hierarki e normave juridike *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Humbja e jetës *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*

I
- Identitet kulturor *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Imunitet i deputetit *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*
- Inspektorati Qendror Teknik *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*
- Instituti i Trashëgimisë Kulturore *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Interes
  - *i drejtpërdrejtë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i kërkuesit (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
  - *i ligjshëm (V-5/25 f. 123, Vol. I)*
  - *jetësor (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I)*
  - *pasuror (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *publik (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *vetjak (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
- Interpretim
  - *arbitrar i ligjit (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
  - *konstruktiv dhe funksional (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i ligjit (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-22/25 f. 497, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Investim strategjik *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*

J

- Juridiksion
  - *fillestar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *rishikues (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
  - *tejkalim juridiksioni (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
  - *kushtetues (Nuk ka vendime në Vol. I)*

K

- Karta e Bolonjës *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Karta Europiane e Autonomisë Vendore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Karriera e gjyqtarit *(V-22/25 f. 497, Vol. I)*
- Kategoritë e motomjeteve *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kërkesë
  - *për heqje dorë nga gjykimi i çështjes (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *për përjashtim të gjyqtarit (V-1/25 f. 7, Vol. I)*
  - *për përshpejtim të gjykimit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Këshilli i Lartë Gjyqësor *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*
- Komiteti i Kulteve dhe Fesë *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*
- Kompensim për burgim të padrejtë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kompetencë
  - *lëndore (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *tejkalim kompetence (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kompleksiteti i çështjes *(V-2/25 f. 62, Vol. I)*; *(V-4/25 f. 113, Vol. I)*; *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*; *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*; *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*
- Koncesion *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Konfidencialitet i burimit të gazetarit *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*
- Konflikt interesi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kontratë
  - *sipërmarrjeje (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *shitblerjeje (V-7/25 f. 170, Vol. I)*
- Kontroll
  - *abstrakt (V-6/25 f. 145, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *i banesës (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *incidental (V-22/25 f. 497, Vol. I)*
  - *konkret (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-17/25 f. 390, Vol. I); (V-18/25 f. 408, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Konventa e Aarhusit "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin" *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet Shtesë *(V-2/25 f. 62, Vol.*

I); *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*; *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*; *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Konventa Europiane për Ekstradimin *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Konventa e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale" *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Konventa e Parisit "Për mbrojtjen e pronësisë industriale" *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*
- Kryetar i bashkisë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kthim shume *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kufijtë e shqyrtimit të çështjes *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*
- Kufizim
  - *i lirisë individuale (V-1/25 f. 7, Vol. I)*
  - *i masës së përfitimit të pensionit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i moshës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kushte të urgjencës dhe flagrancës *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Kuorum vendimmarrjeje *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

L
- Lajthim *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Largim nga puna *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*
- Legalizim i ndërtimit pa leje *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Legjitimim *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*; *(V-2/25 f. 62, Vol. I)*; *(V-3/25 f. 85, Vol. I)*; *(V-4/25 f. 113, Vol. I)*; *(V-5/25 f. 123, Vol. I)*; *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*; *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*; *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-12/25 f. 304, Vol. I)*; *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*; *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*; *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*; *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*; *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*; *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*; *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*; *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*; *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*; *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Leje drejtimi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Leje ndërtimi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Letërporosi *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*
- Ligjshmëri
  - *e veprimit administrativ (V-18/25 f. 408, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I)*
  - *e ndërhyrjes (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
- Liria e shprehjes *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*
- Lirim nga detyra *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Luajalitet kushtetues *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Lufta kundër kriminalitetit *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*

M
- Mandat
  - *i anëtarit KQZ (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *kohëzgjatje e mandatit të gjyqtarit kushtetues (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *mbarimi dhe fillimi ideal i mandatit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *mbarimi i mandatit të anëtarit të Kuvendit (Nuk ka vendime në Vol. I)*

- *mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues (Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Marrëdhënie
  - *jashtëkontraktore (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *juridiksionale me autoritetet e huaja (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *keqbesimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *pune (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I)*
• Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
• Marrje dijeni mbi gjykimin *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Markë e regjistruar *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Masë
  - *arresti në burg (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *dënimi (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *efektivitet i masës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *proporcionalitet i masës (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *ligjshmëri e masës së sigurimit (V-1/25 f. 7, Vol. I)*
  - *qëllimi i masës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *sekuestro e akteve shkresore (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *sekuestro e aparateve telefonikë (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *sekuestro provuese (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *sekuestro preventive (V-20/25 f. 436, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *sigurimi personal (V-1/25 f. 7, Vol. I)*
  - *vleftësim i masës nga prokurori (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *zëvendësim mase sigurimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Mbrojtës
  - *kryesisht (Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Mbrojtja e mjedisit *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Mbrojtja e trashëgimisë kulturore *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
• Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Mekanizimi i përtëritjes së pjesshme *(rotacionit) (Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Mendim
  - *kundër (vendimi i GjK) (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-22/25 f. 497, Vol. I)*
  - *paralel (vendimi i GjK) (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *pakice (vendimi i GjK) (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *pjesërisht kundër (vendimi i GjK) (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
• Metodologji e vlerësimit të dëmit *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Mjet
  - *i jashtëzakonshëm ankimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *jetese (V-13/25 f. 332, Vol. I)*
  - *i kërkimit të provës (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
• Mocion
  - *mosbesimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
• Moslegjitim *(V-22/25 f. 497, Vol. I)*
• Mosmarrëveshje
  - *administrative (V-9/25 f. 255, Vol. I)*

N
- Ndarje e çështjes *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ndërgjyqësia *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ndërhyrës kryesor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ndërhyrje arbitrare e autoritetit publik *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ndërtim pa leje *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*
- Ndihmë juridike falas *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ndihmë shtetërore *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Ndjekje penale
  - *parashkrim i ndjekjes penale (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Nevoja dhe urgjenca *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Nënshkrim i mbrojtësit *(V-2/25 f. 62, Vol. I)*
- Nëpunës publik *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ndreqje gabimi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

NJ
- Njëzëri *(vendimi i GJK) (V-4/25 f. 113, Vol. I)*; *(V-5/25 f. 123, Vol. I)*; *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*; *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*; *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*; *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*; *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*; *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*; *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*; *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Njoftim
  - *i akuzës (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *i aktit të vlerësimit (V-19/25 f. 425, Vol. I)*
  - *i gjykimit (V-18/25 f. 408, Vol. I)*
  - *individual i aktit administrativ (V-7/25 f. 170, Vol. I)*
  - *i vendimit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *pavlefshmëri e njoftimit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Njohje e vendimit penal të huaj *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*

O
- Objekt shqyrtimi:
  - *Saktësim dhe plotësim i vendimit GJK (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *Rihapje procesi gjyqësor nga GJEDNJ (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *Interpretim i Kushtetutës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *Ligje dhe norma të tjera me fuqinë e ligjit (V-6/25 f. 145, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I); (V-22/25 f. 497, Vol. I)*
  - *Vendime të Kuvendit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *Vendime të Këshillit të Ministrave (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *Vendime të gjykatave (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-17/25 f. 390, Vol. I); (V-18/25 f. 408, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *Konstatim i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (V-2/25 f. 62, Vol.*

I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)
  - *Zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Organ emërtese *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Organe të pushtetit vendor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

P
- Padi
  - *afat i paraqitjes së padisë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *parashkrimi i padisë (V-18/25 f. 408, Vol. I)*
  - *rivendikimi (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *sigurimi i padisë (V-12/25 f. 304, Vol. I)*
  - *shkak ligjor i padisë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *vlera e padisë (V-18/25 f. 408, Vol. I)*
- Pagë
  - *e arsimtarit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *elementët e pagës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *ndërprerje e pagës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *referuese (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Pagesë kalimtare *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*
- Pakicë parlamentare *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Panele diellore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Parimi
  - *i barazisë para ligjit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i barazisë së armëve (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *i disponibilitetit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i gjësë së gjykuar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i kontradiktoritetit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i hierarkisë së akteve (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i ligjshmërisë (V-2/25 f. 62, Vol. I)*
  - *i mosdënimit pa ligj (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (ne bis in idem) (V-11/25 f. 286, Vol. I)*
  - *i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *i ndalimit të "reformatio in peius" (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i paanshmërisë (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I)*
  - *i pavarësisë së gjyqësorit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i prezumimit të pafajësisë (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *i proporcionalitetit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i sigurisë juridike (V-3/25 f. 85, Vol. I)*
  - *i shtetit të së drejtës (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Pasuria
  - *barrë mbi pasurinë (V-12/25 f. 304, Vol. I)*
  - *konfiskim i pasurisë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *origjina e pasurisë (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *pjesëtim i pasurisë bashkëshortore (V-20/25 f. 436, Vol. I)*

  - *publike (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *regjistrim i pasurisë (V-12/25 f. 304, Vol. I)*
- Papajtueshmëri me mandatin e deputetit *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Papajtueshmëri dhe pazgjedhshmëri e funksionit *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Person i zhdukur *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Person në dijeni për veprën penale *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Pension
  - *i parakohshëm (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
  - *pleqërie (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
  - *suplementar (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Pezullim
  - *i gjykimit (V-12/25 f. 304, Vol. I)*
  - *i pjesshëm i dekretit të Presidentit (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *i vendimit të Këshillit të Ministrave (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *i zbatimit të ligjit (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *i zbatimit të vendimit gjyqësor (V-11/25 f. 286, Vol. I)*
- Përgjegjësi ligjore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Përgjim ambiental *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Përligjje e arsyeshme dhe objektive *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Pritshmëritë e ligjshme *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Privatizimi *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*
- Pjesëmarrje e publikut në vendimmarrje *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Porti i Durrësit *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Pranim kërkese *(vendim i GJK) (V-4/25 f. 113, Vol. I)*; *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*; *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*; *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*; *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*; *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Pranim kërkese pjesërisht *(vendim i GJK) (V-2/25 f. 62, Vol. I)*; *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-12/25 f. 304, Vol. I)*; *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*; *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*; *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*; *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Proces i rregullt ligjor *(V-1/25 f. 7, Vol. I)*; *(V-2/25 f. 62, Vol. I)*; *(V-3/25 f. 85, Vol. I)*; *(V-4/25 f. 113, Vol. I)*; *(V-5/25 f. 123, Vol. I)*; *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-12/25 f. 304, Vol. I)*; *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*; *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*; *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*; *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*; *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*; *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*; *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*; *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*; *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*; *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Proces i zgjedhjes së gjyqtarit kushtetues *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Procesi zgjedhor *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*
- Procedim penal *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Produkte të veprës penale *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Prodhim pijesh energjike *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Pronë
  - *kthim dhe kompensim i pronës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *lirim dhe dorëzim prone (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *mbivendosje prone (Nuk ka vendime në Vol. I)*

  - *publike (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *shpronësim (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *vlera e pronës (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Pronësi intelektuale *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Proporcionalitet i ndërhyrjes *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Protokolli i Marrëveshjes së Madridit "Për regjistrimin ndërkombëtar të markave" *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Provë
  - *elektronike (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *materiale (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *mënyra e marrjes së provës (V-17/25 f. 390, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *vlerësimi i provës (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *ripërcaktim i provave (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
- Punonjës policie *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Punësimi në sistemin shëndetësor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Pushim *(vendim i GJK) (Nuk ka vendime në Vol. I)*

Q
- Qëllim
  - *i ligjshëm (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Qëndrim arbitrar i gjykatës *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Qëndrim formal i gjykatës *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

R
- Raport i Komisionit të Venecias CDL-AD*(2014) (V-1/25 f. 7, Vol. I)*
- Reciprocitet *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Reforma në drejtësi *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*
- Regjim tranzitor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Rekursi
  - *afat i paraqitjes së rekursit (V-3/25 f. 85, Vol. I)*
  - *individual (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *pretendime në rekurs (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *shkaqe ligjore të rekursit (V-10/25 f. 272, Vol. I)*
- Rezervë konventore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Rikthim në detyrë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Rishqyrtim
  - *në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-17/25 f. 390, Vol. I)*
  - *në Gjykatën e Lartë (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Rivendosje e së drejtës *(V-2/25 f. 62, Vol. I)*

RR
- Rregullore AMF *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Rregulla të qarkullimit rrugor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Rrethi i subjekteve të interesuara në gjykimin kushtetues *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Rrjedhje informacioni hetimor *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*
- Rënie në dekadencë *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Rrëzim kërkese *(vendim i GJK) (V-1/25 f. 7, Vol. I)*; *(V-3/25 f. 85, Vol. I)*; *(V-5/25 f. 123, Vol. I)*; *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*; *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*; *(V-18/25 f. 408, Vol. I)*; *(V-22/25 f. 497, Vol. I)*

S
- Sekret hetimor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Siguria
  - *në plazhe (V-10/25 f. 272, Vol. I)*
  - *në punë (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
- Sigurim i detyrueshëm *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Sigurim
  - *shoqëror suplementar (V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- *Sine qua non (V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Sistemi arsimor parauniversitar *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Sistem shëndetësor *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Sjellja e
  - *kërkuesit (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
  - *autoriteteve (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I)*
- Subjekte kërkues:
  - *Grup deputetësh (V-6/25 f. 145, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *Gjykatat (V-22/25 f. 497, Vol. I)*
  - *Shoqata dhe organizata të tjera (V-9/25 f. 255, Vol. I)*
  - *Individët dhe shoqëritë (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-17/25 f. 390, Vol. I); (V-18/25 f. 408, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
- Statusi i magjistratit *(V-15/25 f. 372, Vol. I)*; *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*

SH
- Shkarkim nga detyra *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Shfuqizim
  - *ligji (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *vendim gjykate (V-2/25 f. 62, Vol. I)*; *(V-4/25 f. 113, Vol. I)*; *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*; *(V-9/25 f. 255, Vol. I)*; *(V-10/25 f. 272, Vol. I)*; *(V-11/25 f. 286, Vol. I)*; *(V-12/25 f. 304, Vol. I)*; *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*; *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*; *(V-15/25 f. 372,*

Vol. I); *(V-16/25 f. 381, Vol. I)*; *(V-17/25 f. 390, Vol. I)*; *(V-19/25 f. 425, Vol. I)*; *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*; *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*; *(V-23/25 f. 518, Vol. I)*; *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*; *(V-26/25 f. 577, Vol. I)*

- Shkelje disiplinore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Shoqëritë huamarrëse *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Shoqëri sigurimi *(V-14/25 f. 348, Vol. I)*
- Shpenzime gjyqësore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Shpenzime përfaqësimi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Shpërblim i drejtë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Shpërdorim detyre *(V-20/25 f. 436, Vol. I)*
- Shqyrtim i kufizuar *(V-5/25 f. 123, Vol. I)*
- Shumicë
  - vendimi i GJK *(V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-22/25 f. 497, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)*

T

- Tagër përfaqësimi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Tarifë gjyqësore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Taksë e ndikimit në infrastrukturë *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Tejzgjatje gjykimi *(V-13/25 f. 332, Vol. I)*
- Të dhëna
  - *kompjuterike (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *personale (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Titull ekzekutiv *(V-3/25 f. 85, Vol. I)*
- Titull pronësie *(V-7/25 f. 170, Vol. I)*
- Trashëgimia
  - *ligjore (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Të drejtat e fituara *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Të dhëna sensitive *(V-21/25 f. 465, Vol. I)*
- Të dhënat personale *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

U

- Urdhër ekzekutimi *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Ushtarak i FA *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

V

- Vendim
  - *i Gjykatës Europiane të Drejtësisë (V-8/25 f. 184, Vol. I)*
  - *i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-17/25 f. 390, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I)*
  - *i gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *gjyqësor i formës së prerë (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I)*
  - *i mëparshëm i GJK (V-1/25 f. 7, Vol. I); (V-2/25 f. 62, Vol. I); (V-3/25 f. 85, Vol.*

I); (V-4/25 f. 113, Vol. I); (V-5/25 f. 123, Vol. I); (V-6/25 f. 145, Vol. I); (V-7/25 f. 170, Vol. I); (V-8/25 f. 184, Vol. I); (V-9/25 f. 255, Vol. I); (V-10/25 f. 272, Vol. I); (V-11/25 f. 286, Vol. I); (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-13/25 f. 332, Vol. I); (V-14/25 f. 348, Vol. I); (V-15/25 f. 372, Vol. I); (V-16/25 f. 381, Vol. I); (V-17/25 f. 390, Vol. I); (V-18/25 f. 408, Vol. I); (V-19/25 f. 425, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I); (V-21/25 f. 465, Vol. I); (V-22/25 f. 497, Vol. I); (V-23/25 f. 518, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I); (V-26/25 f. 577, Vol. I)
  - *i ndërmjetëm (V-12/25 f. 304, Vol. I); (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *kontradiktor (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *njësues i Gjykatës së Lartë (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *përfundimtar (Nuk ka vendime në Vol. I)*
  - *unifikues KBGJL (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Veprime hetimore të domosdoshme *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Veprim i normës juridike në kohë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Veprim me iniciativë të oficerit të policisë gjyqësore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Veprimtari parlamentare *(V-6/25 f. 145, Vol. I)*
- Veprimtari fitimprurëse *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Vepër penale
  - *produkt i veprës penale (V-20/25 f. 436, Vol. I)*
  - *person që ka dijeni për veprën penale (Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Verifikim i funksionarëve në sistemin e drejtësisë *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Vijimësi e shkeljes së pretenduar *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Vjetërsi në shërbim *(V-24/25 f. 530, Vol. I)*; *(V-25/25 f. 548, Vol. I)*
- Vrasje me paramendim *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

Z

- Zbatimi
  - *arbitrar i ligjit (V-26/25 f. 577, Vol. I)*
  - *i gabuar i ligjit (V-3/25 f. 85, Vol. I); (V-24/25 f. 530, Vol. I); (V-25/25 f. 548, Vol. I)*
  - *i ligjit nga gjykatat më të ulëta (V-11/25 f. 286, Vol. I)*
- Zgjedhje vendore *(Nuk ka vendime në Vol. I)*
- Zonë arkeologjike *(V-8/25 f. 184, Vol. I)*
- Zonë e mbrojtur *(Nuk ka vendime në Vol. I)*

INDEKSI SISTEMATIK

1. E DREJTA KUSHTETUESE

1.1. Juridiksioni kushtetues

1.1.1. Statusi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese

1.1.1.1. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.2. Subjektet kërkuese

1.2.1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.2.2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I
Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

1.2.3. Gjykatat
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I

1.2.4. Shoqata dhe organizata të tjera
Shoqata "Dëshmitarët e Jehovait në Shqipëri"
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I

1.2.5. Individët, shoqëritë
Sali Berisha
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Dashmira Zaro
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Florion Bregasi, Sadete Topi, Fatbardha Shpendi, Lavdije Keta
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Tom Dedaj
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I

Shoqëria “DEA-Z” sh.p.k.
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Tonin Mhilli, Vera Mhilli, Valentin Mhilli, Nikolin Mhilli
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Dhurata Boçi, Elvisa Boçi, Rosela Boçi
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Ilir Paja
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Shoqëria “Ksamili Investment” sh.p.k., Rebani Bocai
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Dear Muça
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Elda Kozma, Tea Kozma
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Kliton Spahiu
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Aleksandër Gjonmarkaj
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Qerime Hoti, Qamil Hoti
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Shoqëria “Ekzon Kalaja Comfort” sh.p.k.
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Arben Ahmetaj
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Elton Qyno
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Ilir Lleshi
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Veli Përleka
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Ismet Isufi
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I
Arjan Çelaj (alias Edison Çelaj)
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.3. Objekti i shqyrtimit

1.3.1. Interpretimi i Kushtetutës
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.3.2. Ligje dhe norma të tjera me fuqinë e ligjit
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I

1.3.3. Vendime të Kuvendit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.3.4. Vendime të Këshillit të Ministrave
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

1.3.5. Zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.3.6. Vendime të gjykatave
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.3.7. Konstatim i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I

1.3.8. Rihapje e procesit gjyqësor nga GJEDNJ
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.3.9. Saktësim, plotësim i vendimit të GjK
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.4. Vendimet e Gjykatës

1.4.1. Votimi i anëtarëve

1.4.1.1. Njëzëri

Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I

1.4.1.2. Shumicë
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 (nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh) ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.5. Arsyetimet individuale të anëtarëve

1.5.1. Mendim pakice
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I

1.5.2. Mendim paralel
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.5.3. Mendim kundër
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I

1.5.4. Mendim pjesërisht kundër
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

1.6. Mënyra e përfundimit të çështjeve të gjykuara

1.6.1. Pranim

Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.6.2. Pranim pjesërisht

Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I

1.6.3. Rrëzim

Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I

1.6.4. Pranim & Rrëzim
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.6.5. Pushim
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.6.6. Deklarim i mbarimit të mandatit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.7. Juridiksioni

1.7.1. Llojet e kontrollit

1.7.1.1. Kontroll abstrakt
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

1.7.1.2. Kontroll incidental
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I

1.7.1.3. Kontroll konkret
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.8. Procedura

1.8.1. Subjektet (legjitimimi)
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I

Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

1.8.2. Moslegjitimimi
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I

1.8.2.1. ***Ratione personae***
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.8.2.2. ***Shterimi i mjeteve***
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.8.2.3. ***Ratione temporis***
(Nuk ka vendime në Vol. I)

1.8.3. Procedurat e ndërmjetme

1.8.3.1. Pezullimi
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I

1.8.3.2. Ndarja e çështjes
(Nuk ka vendime në Vol. I)

2. BURIMET E SË DREJTËS KUSHTETUESE

2.1. Rregullat e shkruara

2.1.1. Instrumentet ndërkombëtare

2.1.1.1. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet shtesë
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I

Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

2.1.1.2. Konventa Europiane për Ekstradimin
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.3. Karta Europiane e Autonomisë Vendore
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.4. Konventa nr. 108 e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.5. Deklarata e përbashkët e Ministrave Europianë të Arsimit, Bolonjë, 19 qershor 1999
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.6. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

2.1.1.7. Direktiva 42/2014 BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 3 prill 2014, "Për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Europian"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.8. Direktiva BE 2024/1260, 24 prill 2024, "Për rikuperimin dhe konfiskimin e pasurive"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.9. Direktiva 2006/126/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 20 dhjetor 2006, "Për lejet e drejtimit"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.10. Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë, 1993, "Për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.11. Konventa e Aarhusit, 25 qershor 1998, "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.12. Konventa e Parisit "Për mbrojtjen e pronësisë industriale"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.13. Protokolli i Marrëveshjes së Madridit "Për regjistrimin ndërkombëtar të markave"
(Nuk ka vendime në Vol. I.)

2.1.1.14. Raporti i Komisionit të Venecias CDL-AD(2014)011 "Mbi shtrirjen dhe heqjen e imuniteteve parlamentare"
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I

2.1.2. Jurisprudenca

2.1.2.1. Jurisprudenca ndërkombëtare

2.1.2.1.1. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I

2.1.2.1.2. Gjykata Europiane e Drejtësisë
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

2.1.2.1.3. Vendime të gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera
(Nuk ka vendime në Vol. I)

2.1.2.2. Jurisprudenca kombëtare

2.1.2.2.1. Vendime të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I

Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I
Vendim nr. 22, datë 23.04.2025 ..... f. 497, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

2.2. Hierarkia

2.2.1. Hierarkia ndërmjet akteve ndërkombëtare dhe akteve të brendshme
(Nuk ka vendime në Vol. I)

3. PARIME TË PËRGJITHSHME

3.1. Parimi i barazisë para ligjit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

3.2. Parimi i hierarkisë së akteve
(Nuk ka vendime në Vol. I)

3.3. Parimi i shtetit të së drejtës
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

3.4. Parimi i sigurisë juridike
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I

3.5. Të drejtat e fituara
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I

3.6. Parimi i proporcionalitetit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

3.7. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

3.8. Parimi i mosdënimit pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*)
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

3.9. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

4. INSTITUCIONET

4.1. Presidenti

4.1.1. Kompetencat

4.1.1.1. Marrëdhëniet me organet gjyqësore (Gjykatën Kushtetuese)
(Nuk ka vendime në Vol. I)

4.2. Legjislativi/Kuvendi

4.2.1. Statusi i anëtarëve të Kuvendit (Imuniteti)
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I

4.2.2. Përbërja

4.2.2.1. Mandati i anëtarit të Kuvendit

4.2.2.1.1. Mbarimi i mandatit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

4.2.3. Organizimi

4.2.3.1. Zhvillimi i seancave plenare, mbledhjeve
Vendim nr. 6, datë 10.02.2025 ..... f. 145, Vol. I

4.2.4. Procedura ligjvënëse
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

4.2.5. Marrëdhëniet me organet gjyqësore (Gjykatën Kushtetuese)
(Nuk ka vendime në Vol. I)

4.3. Pushteti gjyqësor

4.3.1. Gjykata e Lartë
(Nuk ka vendime në Vol. I)

4.4. Qeverisja vendore

4.4.1. Parimet themelore

4.4.1.1. Autonomia vendore
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

4.4.2. Ekzekutivi (Kryetari i Bashkisë)

4.4.2.1. Shkarkimi nga detyra i Kryetarit të Bashkisë
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5. TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

5.1. Barazia (Mosdiskriminimi)

5.1.1. Qëllimi i zbatimit

5.1.1.1. Punësimi
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.1.1.1.1. Punësimi në sektorin publik
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.1.1.1.2. Punësimi në sektorin privat
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.1.2. Kriteret e dallimit (diferencimit)

5.1.2.1. Mosha
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2. Të drejtat civile dhe politike

5.2.1. Liria individuale

5.2.1.1. Kufizimi i lirisë individuale

5.2.1.1.1. Masat e sigurimit
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I

5.2.2. E drejta për të mos u dëbuar
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3. Garancitë procedurale

5.2.3.1. Procesi i rregullt ligjor dhe fushat e zbatimit

5.2.3.1.1. Procedurë administrative
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I

Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I

5.2.3.1.2. Procedurë civile
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 ..... f. 85, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ..... f. 348, Vol. I

5.2.3.1.3. Procedurë penale
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ..... f. 390, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

5.2.3.1.4. E drejta për gjykim të drejtë
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.5. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi)
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 ..... f. 7, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 ..... f. 123, Vol. I
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ..... f. 408, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I

5.2.3.1.5.1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi substancial)
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.6. E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm
Vendim nr. 2, datë 21.01.2025 ..... f. 62, Vol. I
Vendim nr. 4, datë 21.01.2025 ..... f. 113, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 ..... f. 255, Vol. I
Vendim nr. 13, datë 25.03.2025 ..... f. 332, Vol. I
Vendim nr. 15, datë 03.04.2025 ..... f. 372, Vol. I
Vendim nr. 16, datë 03.04.2025 ..... f. 381, Vol. I
Vendim nr. 23, datë 23.04.2025 ..... f. 518, Vol. I

5.2.3.1.6.1. Ekzekutimi i vendimit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.7. E drejta për t'u dëgjuar
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.8. E drejta për t'u mbrojtur
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ……f. 390, Vol. I

5.2.3.1.9. E drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët (për të thirrur dëshmitarë)
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.10. Parimi i paanshmërisë
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 …… f. 7, Vol. I
Vendim nr. 9, datë 04.03.2025 …… f. 255, Vol. I

5.2.3.1.11. Barazia e armëve
Vendim nr. 17, datë 10.04.2025 ……f. 390, Vol. I

5.2.3.1.12. Parimi i kontradiktoritetit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.13. Prezumimi i pafajësisë
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ……f. 577, Vol. I

5.2.3.1.14. E drejta për të qëndruar në heshtje

5.2.3.1.14.1. E drejta për të mos inkriminuar veten
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.15. Ligjshmëria e provave
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ……f. 577, Vol. I

5.2.3.1.16. E drejta për t'u gjykuar nga një "*gjykatë e caktuar me ligj*"
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 …… f. 85, Vol. I
Vendim nr. 14, datë 25.03.2025 ……f. 348, Vol. I
Vendim nr. 18, datë 10.04.2025 ……f. 408, Vol. I

5.2.3.1.17. Parimi i gjësë së gjykuar *(res judicata)*
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.3.1.18. Arsyetimi i vendimit
Vendim nr. 1, datë 17.01.2025 …… f. 7, Vol. I
Vendim nr. 3, datë 21.01.2025 …… f. 85, Vol. I
Vendim nr. 5, datë 29.01.2025 …… f. 123, Vol. I

Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 10, datë 13.03.2025 ..... f. 272, Vol. I
Vendim nr. 12, datë 18.03.2025 ..... f. 304, Vol. I
Vendim nr. 19, datë 10.04.2025 ..... f. 425, Vol. I
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I
Vendim nr. 26, datë 29.04.2025 ..... f. 577, Vol. I

5.2.4. Parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale *(ne bis in idem)*
Vendim nr. 11, datë 13.03.2025 ..... f. 286, Vol. I

5.2.5. Liria e shprehjes
Vendim nr. 21, datë 22.04.2025 ..... f. 465, Vol. I

5.2.6. E drejta e jetës private

5.2.6.1. Mbrojtja e të dhënave personale
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.7. Paprekshmëria e banesës
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.8. Paprekshmëria e komunikimit

5.2.8.1. Korrespondenca *(fshehtësia e korrespondencës)*
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.9. E drejta e pronës

5.2.9.1. Shpronësimet
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.2.9.2. Kufizime të tjera
Vendim nr. 7, datë 20.02.2025 ..... f. 170, Vol. I
Vendim nr. 20, datë 11.04.2025 ..... f. 436, Vol. I

5.2.10. E drejta e informimit
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

5.3. Të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore

5.3.1. Liria për të pasur një punë të paguar
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.3.2. Liria e veprimtarisë ekonomike dhe industriale
Vendim nr. 8, datë 21.02.2025 ..... f. 184, Vol. I

5.3.3. E drejta e punës dhe profesionit
(Nuk ka vendime në Vol. I)

5.3.4. E drejta për pension
Vendim nr. 24, datë 23.04.2025 ..... f. 530, Vol. I
Vendim nr. 25, datë 23.04.2025 ..... f. 548, Vol. I

Statistika mbi vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese për vitin 2025

Vendime të dhëna gjithsej	429
Lloji i vendimit	
Vendime të seancës	85
Vendime moskalimi	344
Mënyra e përfundimit të çështjeve të gjykuara	
Pranim	24
Pranim pjesërisht	35
Konstatim + Rrëzim	1
Rrëzim	23
Pushim	1
Deklarim i mbarimit të mandatit	1
Efektet e vendimeve*	
Ex tunc (me efekt prapaveprues)	-
Ex nunc (me efekt nga dhënia e vendimit)	
Erga omnes (me efekt të përgjithshëm)	
Inter partes (me efekt mes palëve në gjykim)	
Të menjëhershëm	-
Shtyrje në kohë	-
Subjektet kërkuese	
Presidenti i Republikës	2
Kryeministri	-
1/5 e deputetëve	4
Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit	-
Gjykata	2
Avokati i Popullit	-
Organe të pushtetit vendor	-
Bashkësi fetare	-

* Në këto statistika janë përfshirë vetëm vendimet e marra mbi çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore.

Partitë politike dhe organizatat të tjera	3
Individë, shoqëritë	74
Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese	-
Objekt kontrolli	
Kushtetuta (Interpretim)	1
Saktësim, plotësim i vendimit të GJK	2
Ligje	6
Marrëveshje ndërkombëtare	-
Vendime të Kuvendit	1
Vendime të Këshillit të Ministrave	3
Vendime të gjykatave	68
Zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës	2
Mosekzekutim i vendimit gjyqësor të formës së prerë	-
Konstatim cenimi i procesit të rregullt ligjor	9
Rihapje e procesit gjyqësor nga GJEDNJ	3
Lloji i kërkesave	
Proces i rregullt ligjor	
Konflikt kompetence	2
Konflikt zgjedhor	1
Kushtetutshmëri e partive politike	-
Shkarkim i Presidentit të Republikës	-
Kushtetutshmëri e akteve normative organeve qendrore	3
Kushtetutshmëri e ligjit	6
Interpretim i Kushtetutës	1
Kushtetutshmëri e marrëveshjeve ndërkombëtare	-
Mbarim i mandatit të gjyqtarit të GjK	2
Llojet e kontrollit	
Kontroll konkret	79
Kontroll abstrakt	4
Kontroll incidental	2
Kontroll a priori	-
Kontroll a posteriori	85

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Shqipëri. Gjykata Kushtetuese
Vendime të Gjykatës Kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë : 2025
/ Gjykata Kushtetuese.
- Tiranë : Onufri, 2026-
3 Vëllime ; 17x24.5 cm.
ISBN 9789928861580 (Set)
Vëllim 1, Vendime 1-26. - 2026. - 658 f.
ISBN 9789928861597 (v. 1)
Gjykata kushtetuese 2. Vendime gjyqësore
3. Shqipëri

342.565.2(496.5) "2025"